

ENVER HOXHA

VEPRA

36

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPËRISË



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

36

QERSHOR 1967 — TETOR 1967

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1932

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 36-TË

Në vëllimin e 36-të të Veprave të shokut Enver Hoxha janë përfshirë fjalime, diskutime, biseda etj. të periudhës qershor-tetor 1967. Një pjesë e madhe e tyre botohen për herë të parë.

Materialet e këtij vëllimi janë një pasqyrë e gjallë dhe konkrete e situatës revolucionare që kishin krijuar në vendin tonë vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë, fjalimi i shokut Enver Hoxha më 6 shkurt 1967, si dhe vendimet e materialet e tjera të Partisë sonë për thellimin e mëtejshëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat e, në veçanti, në fushën ideologjike. Në një sërë fjalimesh, diskutimesh, takimesh e bisedash shoku Enver Hoxha vë theksin në punën e madhe të Partisë për t'i përkrahur lëvizjet dhe iniciativat revolucionare, për t'i orientuar e për t'i udhëhequr, që ato të mos shuheshin, por të ngriheshin vazhdimisht, duke zgjidhur nëpërmjet tyre objektiva gjithnjë e më të përparuar.

Metoda themelore e punës që rekomandohej nga Partia në betejën për të pastruar ndërgjegjen e njerëzve nga konceptet idealiste e fetare, nga pikëpamjet e huaja për gruan etj. ishte ajo e bindjes nëpërmjet argumentimit të vijës së drejtë të Partisë, duke nguli-

tur çdo ditë e më shumë te njerëzit tanë, të rinj e të moshuar, botëkuptimin marksist-leninist.

Në mjaft materiale të këtij vëllimi, sidomos në fjalimet e mbajtura në takimet me popullin në Kelmend, në Troshan, në bisedën me të rinjtë dukagjinas, vullnetarë në Vaun e Dejës etj., udhëheqësi i Partisë dhe i popullit jep një shembull të qartë të punës bindëse, sqaruese e edukuese që bën Partia me shtresat e gjera të masave punonjëse. Në to shpjegohet thelbi i vijës së Partisë, objektivat e saj, argumentohen dëmi i mbeturinave të së kaluarës dhe domosdoshmëria e zhdukjes së tyre për të mirën e atdheut e të popullit. Një vend të madh zë në këto fjalime problemi i emancipimit të gruas shqiptare, problem që trajtohet në mënyrë të gjerë e të thellë në fjalën e mbajtur në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH më 15 qershor 1967, «Mbi disa aspekte të problemit të gruas shqiptare».

Në situatën revolucionare të krijuar, kur kishin shpërthyer një sërë lëvizjesh të masave, merrte një rëndësi të veçantë çështja e forcimit dhe e kalitjes së mëtejshme të Partisë, e cila ishte udhëheqësja dhe frymëzuesja e këtyre lëvizjeve. Në disa materiale të këtij vëllimi, si në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 27 shtator 1967, shoku Enver Hoxha trajton probleme themelore të jetës së Partisë, si: të ndërtimit të saj organizativ, të forcimit të rolit të plenumeve të komiteteve të Partisë, të shtimit të numrit të punëtorëve në forumet udhëheqëse, të rritjes së rolit pararojë të komunistëve në të gjithë sektorët etj. Ideja e përbashkët që i përshkon këto materiale është që veprimtaria udhëheqëse e Partisë

t'u përgjigjet vrullit të punës e të jetës së punonjësve, si dhe kërkesave të kohës, në mënyrë që këtyre kërkesave t'u përgjigjen edhe metoda e stili i punës së Partisë, të forumeve dhe të aparateve, të organeve të pushtetit dhe të organizatave të masave.

Analizat që u bënë shoku Enver Hoxha këtyre problemeve mbështeten në parimet marksiste-leniniste mbi rolin, ndërtimin dhe jetën e Partisë, si dhe në përvojën aktuale të zhvillimit të shoqërisë sonë. Vrulli revolucionar që kishte marrë një hov të paparë sugjeronte me forcë braktisjen e formave të ngurta, të skematizmit e të formalizmit në punën e Partisë në të gjitha sferat e aktivitetit të saj, në edukim, në organizim, në punën me kuadrin etj. Në mënyrë të veçantë shoku Enver Hoxha insiston për forcimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm të Partisë me futjen e gjakut të ri në radhët e saj. Ky gjak i ri, i domosdoshëm për të siguruar vitalitetin e Partisë, ishin të rinjtë e të rejat, burrat dhe gratë që dalloheshin çdo ditë në punë, në prodhim, në revolucion. Këta ishin, në radhë të parë punëtorët, fshatarët dhe intelektualët që shquheshin për punën, pjekurinë dhe për vrullin e tyre. Duke theksuar karakterin imperativ të këtij problemi jetik, shoku Enver Hoxha dënon shfaqjet e burokratizmit e të formalizmit, qëndrimet e ngurta ndaj shifrave e proporcioneve në pranimet e reja etj.

Në luftën e madhe që kishte ndër marrë Partia, në krye të masave punonjëse, një rol të madh kishin organizatat e masave. Para tyre shtrohej detyra të organizonin, të sqaronin e të edukonin masat me vijën dhe mësimet e Partisë. Një rol të rëndësishëm do të lu-

ante Fronti Demokratik i Shqipërisë, si organizata më e madhe e masave në vendin tonë. Në raportin e mbajtur në Kongresin e 4-t të Frontit Demokratik, në shtator të vitit 1967, shoku Enver, përveç trajtimit historik të rolit të madh që kishte luajtur gjatë Luftës Nacionalçlirimtare Fronti Nacionalçlirimtar, paraardhës i drejtpërdrejtë i Frontit Demokratik, si dhe të rolit të këtij në rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit, trajton teorikisht e praktikisht misionin dhe detyrat e kësaj organizate në etapën aktuale të revolucionit e të ndërtimit socialist, si dhe në perspektivë. Lufta kundër burokratizmit, kundër fesë e zakoneve prapanike, lufta për emancipimin e plotë të gruas etj., i ngarkonin Frontit një varg detyrash të rëndësishme, të cilat, nën udhëheqjen e Partisë, ai do t'i kryente me sukses.

Siç del edhe nga materialet e këtij vëllimi, atmosfera revolucionare e krijuar në vendin tonë kishte përfshirë të gjitha fushat e jetës. Në mënyrë të veçantë vrulli i masave pasqyrohej në fushën ekonomike, ku vihej re një mobilizim i madh, i konkretizuar në plotësimin dhe në tejkalimin e planeve në shumë sektorë. Në një sërë fjalimesh, diskutimesh e bisedash trajtohen probleme të rëndësishme të politikës ekonomike të Partisë, si: thellimi i procesit të industrializimit socialist, zhvillimi i mëtejshëm i industrisë nxjerrëse, kimike, energjetike etj., përmirësimi i strukturës së blegtorisë, rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore, zhvillimi i zonave malore etj. Në këto materiale shohim qartë se veprimtaria e Partisë dhe e masave në këtë periudhë ishte në funksion të zbatimit të de-

tyrave që caktoi Kongresi i 5-të i PPSH për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese nëpërmjet rritjes së prodhimit industrial dhe intensifikimit të bujqësisë.

Një vend të veçantë zë në materialet që trajtojnë këto probleme fjala e shokut Enver Hoxha në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH «Mbi kooperimin dhe revolucionin tekniko-shkencor», që u bë një program i gjerë e shkencor për punën e Partisë dhe të masave punonjëse gjatë periudhës së mëvonshme.

Në mënyrë thellësisht parimore e shkencore trajtohen në këtë vëllim edhe probleme të gjendjes ndër-kombëtare, të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, të zhvillimit e të forcimit të lëvizjes marksiste-leniniste në botë. Në materialet e kësaj periudhe del qartë se Partia jonë jo vetëm luftonte pa kompromis kundër revizionistëve sovjetikë, por mendimin e vet për ta ua shfaqte hapur edhe atyre që mund të kishin iluzione për këta armiq të rrezikshëm të revolucionit e të popujve. Nga ana e saj ajo nuk kishte dhe nuk ka pasur asnjë iluzion për revizionistët sovjetikë dhe i kishte të qarta qëllimet demagogjike të udhëheqësve të rinj hrushovianë, të cilët, në kushtet e një aktivizimi të elementëve shovinistë në vendet fqinje, derdhnin lot krokodili e «shqetësoheshin» për rrezikun që gjoja i kërcënohej vendit tonë.

Me një vëmendje të veçantë ndiqte Partia e Punës e Shqipërisë edhe zhvillimin e ngjarjeve në Kinë. Një interes të posaçëm për këtë problem paraqit fjala e shokut Enver Hoxha «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të

Revolucionit Kulturor Proletar kinez», mbajtur në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH.

Nëpërmjet studimit të materialeve të vëllimit të 36-të të Veprave të shokut Enver Hoxha komunistët dhe masat punonjëse të vendit tonë do të njohin më mirë politikën e Partisë në atë periudhë dhe do të nxjerrin mësimet e orientime me vlerë në punën për zbatimin e detyrave që ka shtruar Partia në etapën e sotme të ndërtimit socialist.

MBI DISA ASPEKTE TË PROBLEMIT TË GRUAS SHQIPTARE

Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH¹

15 qershor 1967

Shokë,

Si konkluzion të pikës së parë, dëshiroj të them edhe unë disa mendime mbi këtë problem.

Partia i ka vënë vazhdimisht rëndësi shumë të madhe çështjes së gruas, këtij problemi shoqëror jash-tëzakonisht të madh, me të cilin janë lidhur fatet e popullit, të socializmit dhe të komunizmit, e ardhmja e vendit tonë. Problemet e gruas nuk janë të veçanta, specifike, të veçuara e të izoluara nga problemet e tjera të shoqërisë, ato nuk janë probleme që mund të trajtohen dhe të zgjidhen me lehtësi ose, ca më

¹ Plenumi i 2-të i KQ të PPSH, që u mbajt më 15-16 qershor 1967, në pikën e parë të rendit të ditës dëgjoi e diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi thellimin e mëtejshëm të luftës për emancipimin e plotë të gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Ramiz Alia.

keq, të injorohen. Problemi i gruas nuk është vetëm një problem sentimentesh dhe, pra, nuk mund të trajtohet në mënyrë sentimentale dhe romantike. Ai është një problem i madh i jetës, i zhvillimit dialektik materialist të historisë së njerëzimit.

Për këtë arsye Marks, Engelsi, Lenini e Stalini dhe të gjithë nxënësit e tyre i kanë vënë një rëndësi të dorës së parë problemit të gruas, çlirimit të saj, emancipimit dhe formimit të personalitetit të vet në një shoqëri të lirë, pa shtypës, pa shfrytëzues.

Partia jonë jo vetëm nuk e la pas dore dhe as e nënvleftësoi kurrë problemin e gruas shqiptare, por gjatë gjithë luftës së saj dhe në të gjitha aspektet e kësaj lufte pati kujdesin e veçantë të theksonte, dhe jo në mënyrë sentimentale, rolin e madh të gruas si në luftën për çlirim, ashtu edhe në luftën për ndërtimin e socializmit. Këtë Partia jonë e bëri me plot pjekuri marksiste dhe, duke pasur parasysh në çdo hap vështirësitë që do të haste në rrugë (duke vënë, gjithashtu, përpara parimin e palëkundur se, në luftën për çlirimin e popullit nga çfarëdo zgjedhe, çlirimi i gruas shqiptare ishte i ngutshëm dhe kusht nga të dorës së parë), ajo arriti suksese të mëdha, që ne po i shtojmë dhe po i thellojmë çdo ditë. Prandaj merr një rëndësi të madhe kjo mbledhje e Plenumit të Komitetit Qendror për problemet e gruas shqiptare në rendin tonë socialist.

Studimi me vëmendje të madhe i fenomeneve shoqërore në zhvillimin e tyre, i marrëdhënieve të njerëzve në prodhim, i zhvillimit dhe i zbatimit të ideve të reja që frymëzon Partia jonë, gjendja e kla-

save të shoqërisë sonë në etapa të ndryshme dhe ndryshimet që ato bëjnë gjatë këtij procesi në vazhdim, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për Partinë, pasi ato vërtetojnë saktësinë e parimeve, pasurojnë teorinë me praktikën e socializmit, i japin mundësinë e madhe Partisë të përgjithësojë dhe ta çojë në masa këtë përgjithësim, i cili do të krijojë mundësi të reja, situata të reja, vlera të reja, që do të sigurojnë zhvillimin dhe përparimin e pandërprerë.

Socializmi është vepra e Partisë dhe e masave, prandaj direktivat e saj nuk mund të kuptohen e të zbatohen pa njohur e pa përpunuar terrenin ku ato do të zënë rrënjë dhe do të transformohen në një realitet objektiv. Zbatimi i drejtë i direktivave të Partisë varet, në radhë të parë, nga kuptimi i drejtë dhe i thellë që do të gjejnë ato në masat. Pra, masat duhet të jenë në gjendje, ose më mirë të bëjmë që të jenë në gjendje, t'i kuptojnë ato plotësisht. Kjo varet nga shkalla e punës politike, ideologjike dhe organizative të Partisë dhe që të kryhet mirë kjo punë, duhet absolutisht të bëhet ajo që thashë më lart: duke studiuar problemet shoqërore, të njihet mirë terreni.

Unë mendoj se kjo është një punë e të gjithëve dhe jo vetëm e disa specialistëve në filozofi, në problemet shoqërore ose në ekonominë politike; por as edhe vetëm e shkrimtarëve, e dramaturgëve ose e artistëve. Kjo është, në radhë të parë, një çështje partie, një çështje vije, është një çështje pa të cilën nuk mund të ecë puna e Partisë, pra, nuk mund të frymëzohen drejt, ose të thellohen në studime, apo të krijojnë vepra të realizmit socialist dhe shkencore

marksiste-leniniste as shkrimtarët, as artistët, as dijetarët.

Kështu, pra, duhet të veprojmë ne për problemet shoqërore të fshatit dhe të qytetit, kështu duhet të veprojmë për problemet e veçanta të rinisë; po kështu edhe për problemin e madh shoqëror të gruas e të familjes sonë, që na preokupon sot në këtë Plenum të Komitetit Qendror.

Revolucioni ynë proletar, i udhëhequr nga Partia jonë marksiste-leniniste, do t'i përmbyste, siç i përmbysi, sistemin e vjetër feudalo-borgjez dhe orvatjen për fashistizimin e vendit tonë me pushtimin e tij nga fashisto-nazistët italianë dhe gjermanë, si dhe organizmat e pushtetit dhe superstrukturën e tyre. Revolucioni ynë proletar do të vendoste, siç vendosi, zhvilloi dhe pasuroi, nën udhëheqjen e Partisë sonë marksiste-leniniste, sistemin socialist, diktaturën e proletaariatit, organizmat e saj të rinj proletarë dhe do të ndërtonte superstrukturën e vërtetë socialiste, të bazuar, të frymëzuar, të udhëhequr dhe të pasuruar nga teoria marksiste-leniniste dhe nga praktika socialiste.

Në kuadrin e kësaj përmbysjeje të madhe revolucionare, kur bota e vjetër u shemb dhe mbi gërmadhat e saj u ngrit bota e bukur, e re socialiste, u bë edhe çlirimi i gruas shqiptare, si gjysma e popullsisë së vendit tonë, i cili ka një rëndësi të pallogaritshme për fatet e atdheut dhe të socializmit.

Revolucioni proletar, me revolucionin ekonomik-shoqëror, me shkatërrimin e pushtetit ekonomik-politik të feudo-borgjezisë, krijoi terrenin e vërtetë dhe kushtet e përshtatshme të çlirimit të popullit nga

shfrytëzimi i njeriut prej njeriut dhe veçanërisht të gruas shqiptare.

Shoqëria jonë socialiste është në zhvillim, më anë të revolucionit tonë popullor po bëhen të transformime të mëdha cilësore. Këto ndryshime cilësore qëndrojnë në transformimin materialist të shoqërisë sonë dhe kanë krijuar e po krijojnë ide e teori të reja shoqërore, që luftojnë me të vjetrat dhe i zëvendësojnë këto. Idetë e reja janë një forcë e madhe, që përfaqësojnë ndryshimet e jetës materiale të vendit dhe e çojnë këtë përpara drejt progresit.

Është e domosdoshme të shpjegohen dhe të kuptohen idetë e reja, pasi pa to nuk bën dot shoqëria jonë. Këto ide i duhen asaj, sepse ato mobilizojnë dhe organizojnë masat kundër ideve e paragjykimëve të vjetra idealiste, mistike, borgjeze, që na i ka lënë si trashëgimin më të keq shoqëria e vjetër.

Partia po u hap rrugën forcave përparimtare të shoqërisë, një nga të cilat janë gratë. Idetë marksiste-leniniste të Partisë sonë pasqyrojnë nevojat objektive të zhvillimit të mëtejshëm të jetës materiale dhe morale të shoqërisë. Është, pra, e qartë dhe e domosdoshme që gruaja shqiptare të çlirohet nga çdo prangë e së kaluarës, nga çdo ide, nga çdo opinion ose paragjykim reaksionar, që e ka burimin në idetë e shoqërisë së vjetër feudo-borgjeze. Çlirimi i gruas shqiptare duhet të udhëhiqet nga teoria marksiste-leniniste e zhvillimit ekonomik të shoqërisë, nga ligjet e zhvillimit të prodhimit. Nën këtë prizëm ne shohim sa urgjente bëhet pjesëmarrja e gruas në prodhim dhe sa drejt e shpejt duhet t'i rregullojë Partia marrëdhëniet

e reja në prodhim. Zhvillimi ekonomik i socializmit është në luftë me prapambetjen morale dhe materiale të gruas. Si në çdo gjë, edhe këtu veprojnë ligjet e dialektikës materialiste.

Pra, detyrat që shtron Partia për çështjen e gruas, puqen plotësisht me kushtet materiale të vendit, të krijuara nga Partia.

Krijimi i pronës socialiste të përbashkët të popullit, si në industri, edhe në bujqësi, në vend të asaj feudalo-borgjeze, dhe ligjet e përshtatshme revolucionare që e organizojnë, që e drejtojnë, që e pasurojnë dhe e çimentojnë atë në interes të të gjitha masave punonjëse, bënë që të ndryshojë progresivisht në mendjen e njerëzve koncepti i pronës, nga ai i pronës private në atë të pronës së përbashkët.

Me ndryshimet materiale, nëpërmjet një pune edukative intensive ideopolitike nga ana e Partisë, kurdoherë në mënyrë të organizuar, filluan të ndryshojnë edhe konceptet e vjetra idealiste borgjeze mbi këto probleme themelore të jetës sonë ekonomiko-shoqërore. Është e qartë që këto ndryshime, natyrisht, nuk kanë marrë fund, ato janë dhe do të jenë kurdoherë në zhvillim dialektik. E vjetra që vdes do të jetë kurdoherë në luftë e në përpykje me të rene që lind dhe forcohet. Ne kemi akoma shumë e shumë për të bërë dhe për të luftuar kundër koncepteve reaksionare idealiste, që janë struktur në mendjen, në ndërgjegjen dhe në ndjenjat e njerëzve dhe që shfaqen në manifestimet e jetës, që veprojnë diku me virulencë, diku me më pak virulencë dhe që pengojnë ecjen përpara. Marksi, diku në një vend, thotë se të

gjitha paragjykimet e të gjithë të vdekurve rëndojnë si një ankth i madh mbi ata që rrojnë. E tillë është forca e së kaluarës.

Pikërisht këtu qëndron rëndësia që po i vë Partia problemit të revolucionarizimit të mëtejshëm të saj dhe të gjithë popullit, pasi vetëm në këtë mënyrë do t'i kuptojmë më drejt e më thellë transformimet e jetës materiale dhe shpirtërore që po bëjmë, do t'i kuptojmë më drejt e më thellë ligjet që i udhëheqin këto transformime ekonomiko-shoqërore në socializëm, do të dimë t'i zotërojmë më mirë dhe më me efikasitet ato, për të bërë sa më shpejt dhe me baza të çelikta ndërtimin e socializmit dhe kalimin në komunizëm.

Më falni se po dal ca nga tema që po trajtojmë, por këtë po e bëj posaçërisht për të hyrë në temë. Sistemi kapitalist i shenjtërimit të pronës private, i shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, i skllavërimit ekonomik dhe shpirtëror të njeriut, ka rënduar mbi të gjithë, por veçanërisht dhe në mënyrën më barbare mbi gruan. Gruaja ka qenë e para skllave, dhe më parë nga skllavi, në historinë e njerëzimit. Gjatë gjithë kësaj historie, pa kaluar në prehistori, qoftë në kohën e qytetërimit helenik, qoftë në epokën romake ose në mesjetë, në epokën e Rilindjes apo në kohën moderne dhe deri në «qytetërimin e rafinuar» kontemporan borgjez, gruaja ka qenë dhe është krijesa njerëzore më e skllavëruar, më e shtypur, më e shfrytëzuar, më e përbuzur nga çdo pikëpamje. Ligjet, zakonet, feja, seksi mashkullor atë e shtypin, e mbajnë nën thundër.

«...antagonizmi i parë i klasave në histori, — thotë Engelsi, — bie në një kohë me zhvillimin e antagonizmit midis burrit dhe gruas në monogami, dhe shtypja e parë e klasës bie në një kohë me skllavërimin e seksit femëror nga seksi mashkullor»¹.

«Gjeta gruan më të hidhur se vdekja», thotë diku Ekleziasti, kurse shën Jan Krizostomi ka një mendim tjetër për gruan. Ai thotë: «Në mes të kafshëve më të egra nuk mund të gjesh më të dëmshme se gruaja».

Shën Toma d'Akuini, teologu filozof, që ka qenë një nga filozofët dominues të obskurantizmit mesjetar, mendonte dhe profetizonte se «fati i gruas është të rrojë nën thundrën e burrit»; dhe, më në fund, për ta mbyllur me këto citate barbare, «natyra i ka bërë gratë skllavet tona», ka thënë Napoleoni.

Të tilla ishin pikëpamjet e kishës dhe të borgjezisë për gruan. Të tilla vazhdojnë të jenë ato edhe tani. Në Evropë dhe në gjithë botën ka filozofë e letrarë të panumërt që epërsinë e burrit mbi gruan e kanë bërë një mit. Për ata burri është i fortë, luftëtar, kurajoz dhe, pra, më i zgjuar, prandaj ai është i predestinuar të sundojë, të drejtojë. Kurse gruaja, nga ana e saj, është prej natyre e dobët, pa mbrojtje, pa kurajë, pra duhet të sundohet dhe të drejtohet. Teoricienë të borgjezisë, si Niçe dhe Frojd, mbrojnë, gjithashtu, teorinë se mashkulli është aktiv dhe femra

¹ K. Marks e F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. II, f. 234. Tiranë, 1975.

pasive. Kjo teori reaksionare dhe antishkencore të çon, siç çoi, në politikë në nazizëm dhe, në seksologji në sadizëm.

Nënat, gjyshet dhe stërgjyshet tona e kanë vuajtur këtë skllavëri të rëndë, i kanë hequr në kurrizin e tyre plot plagë këto mizori trupore dhe shpirtërore. Tani, kur te ne ka triumfuar revolucioni, kur ndërtohet me sukses socializmi, Partia na vë si detyrë të madhe, në mes detyrave më të mëdha, çlirimin e plotë dhe përfundimtar të gruas nga çdo prangë e së kaluarës së hidhur, na vë për detyrë emancipimin e plotë të gruas shqiptare.

Marksizmi na mëson se pjesëmarrja në prodhim dhe çlirimi nga shfrytëzimi kapitalist janë dy fazat e emancipimit të gruas. Partia jonë, që ndjek e zbaton me besnikëri parimet marksiste-leniniste, e çliroi me luftë dhe me revolucion popullin, dhe veçanërisht gruan, nga shfrytëzimi kapitalist dhe e hodhi atë në prodhim.

Mund të themi, pra, se duke i plotësuar këto dy faza, duke e zhdukur plotësisht që nga rrënjët shfrytëzimin kapitalist dhe duke e zhvilluar me vrull më tej pjesëmarrjen në prodhim, ne kemi arritur suksese të mëdha në emancipimin e gruas, emancipim që duhet të zhvillohet e të thellohet më tej. Gruaja, që është një forcë kolosale, përparimtare, po merr pjesë, krahas me punën prodhuese shumë të frytshme, në revolucionin e madh arsimor e kulturor, po thyen çdo barrikadë, po kapërcen çdo pengesë e paragjykim, tregon në çdo lëmë forcën e saj krijuese, fizike dhe mendore, pastërtinë e saj shpirtërore dhe morale; ajo po

merr dhe do të marrë çdo ditë e më shumë pjesë në qeverisjen e vendit, në drejtimin e industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të kulturës. Direktiva e Leninit se «çdo kuzhiniere duhet të mësohet të drejtojë shtetin», po zbatohet çdo ditë e më me sukses nga Partia jonë.

Prandaj çështjen e pjesëmarrjes masive të grave në prodhim, në drejtimin e ekonomisë dhe të shtetit, në marrjen e arsimit dhe të kulturës, Partia duhet ta kuptojë thellë, jo vetëm si një faktor ekonomik përparimtar të rëndësishëm, por, pse është i tillë, ai ka njëkohësisht edhe rëndësi të madhe ideologjike, politike, kulturore. Pa zgjimin e gruas, pa pjesëmarrjen e saj aktive e të ndërgjegjshme, asgjë nuk mund të ecë drejt dhe si duhet.

Njerëzit duhet ta kuptojnë një herë e mirë dhe thellë se emancipimin e gruas, përkrahjen dhe ndihmën që duhet t'i japim asaj për të zënë vendin e merituar në shoqërinë socialiste, nuk duhet t'i konsiderojnë si dhuratë, por si detyrë imperative, nuk duhet ta konsiderojnë si mëshirë që seksi i ashtuquajtur i fortë i jep seksit të ashtuquajtur të dobët, ose si njëfarë koncesioni, ose disi si hapje rrugë femrave nga burrat, që gjoja janë eprorë dhe të predispozuar të udhëheqin e të komandojnë, nga intelekti ose nga struktura fizike e tyre. Njerëzit, pra, duhet ta zbatojnë këtë mësim të Partisë jo vetëm pse e tha Partia, por të kuptojnë thellë arsyet ideologjike, politike dhe ekonomike që e bënë Partinë të ngulë këmbë fort në këtë problem të madh.

I ritheksoj këto gjëra pasi shumë shokë partie i

kuptojnë përciptas, disa nuk i kuptojnë ose i kuptojnë shtrembër. Të marrim çështjen e pranimit të shoqeve në Parti. Kjo punë diçka ka lëvizur dhe po lëviz, por akoma nuk ka një kuptim të thellë parimor, ashtu siç duhet për të. Fakt është se në Parti shumica dërrmuese e anëtarëve janë burra. Pse ngjet kjo dhe sidomos pas Çlirimit? Unë mendoj se burimin kjo e ka në paqartësinë ideologjike të anëtarëve të Partisë mbi rolin e gruas në revolucion e në socializëm, në ato pikëpamje prapanike, të fjetura, feudalo-borgjeze në ndërgjegjen e komunistëve, në të ashtuquajturën epërsi në aftësitë fizike dhe mendore të burrit mbi gruan; e ka burimin në pikëpamjet që theksova më lart, që, natyrisht, janë të atenuara, por që prapë ekzistojnë, se burri duhet ta qeverisë shtetin, të drejtojë punët, pra në Parti ai duhet të jetë para gruas. Këto pikëpamje të gabuara duhet t'i luftojmë dhe t'i çrrënjësim, të kuptojmë rrezikshmërinë e tyre dhe pranimi i gruas në Parti të vihet absolutisht në kushte të barabarta me ato të burrit. Pranimet për të dy sekset duhet të udhëhiqen nga të njëjtat kushte dhe rregulla të Statutit të Partisë, por në radhë të parë nga ideologjia e Partisë, që përshkon çdo fjalë të Statutit dhe të veprimtarisë së saj. Kjo është pikë kyç nevralgjike.

Gruaja duhet ta ndiejë efektivisht që është brenda në Partinë e vet, ajo drejton nëpërmjet Partisë së saj, merr pjesë aktive në përpunimin e ligjeve të Partisë dhe i zbaton e i kontrollon ato me pjesëmarrjen e vet aktive revolucionare në jetë, në prodhim dhe në drejtim.

Problemi i madh i emancipimit të plotë të gruas nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të zgjidhet pa marrë pjesë aktive në të gruaja, jo vetëm në praktikë, në zbatim, por edhe në drejtimin e kësaj pune të madhe, që përbën një nga faktorët vendimtarë të ndërtimit dhe të kalitjes së njeriut të ri socialist, në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për brezat e rinj që do të përjetësojnë socializmin dhe komunizmin.

Le të përfitojmë nga ky diskutim shumë i frytshëm që po bëjmë në këtë Plenum të Komitetit Qendror mbi këtë problem kaq të rëndësishëm, për ta thelluar dhe për ta sqaruar atë më tej nga ana filozofike dhe ideologjike, duke u bazuar në mësimet e pavdekshme të klasikëve tanë dhe në realitetin objektiv të shoqërisë sonë.

Një nga deduksionet e mëdha shkencore të marksizëm-leninizmit është ai që thotë se skllavërimi i gruas është i lidhur me shfaqjen e pronës private. Ky deduksion i madh teorik ndodhet në librin e famshëm të Engelsit «Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit». Që t'i kuptojmë si duhet nga ana teoriko-filozofike marksiste-leniniste këto probleme, që të kuptojmë mirë zhvillimin dialektiko-materialist të shoqërisë sonë shqiptare në të kaluarën dhe në të tani-shmen, që të kuptojmë dhe të interpretojmë drejt fenomenet e jetës që zhvillohen me vrull para nesh dhe të përcaktojmë në mënyrë korrekte marksiste-leniniste vijën që duhet të ndjekim për ndërtimin e jetës së re, çdo komunist duhet të bëjë përpjekje dhe ta studiojë këtë libër ose pjesët e tij të zgjedhura, të

cilat, edhe në qoftë se nuk ekzistojnë, t'i përgatitim në mënyrë të përpunuar, që t'i kuptojnë të gjithë.

Po të studiojmë me kujdes veprën e At Shtjefën Gjeçovit, «Kanunin e Lekë Dukagjinit», dhe veçanërisht kapitujt mbi pronën, mbi trashëgiminë, mbi familjen, mbi gruan dhe martesat, do të shohim në realitetin tonë vërtetësinë e madhe e gjeniale të Engelsit. Do të shohim se si prona private e mban në skllavëri të tmerrshme gruan, se si ajo, në fakt, është shndërruar në një pronë të thjeshtë, që mund të blihet, të shitet. Në të thuhet konkretisht: «Burri ka të drejtë me e rrah gruen, me e lidh gruen kur ia përbuz fjalën dhe urdhnin... Kurse baba ka të drejtë me rrah, me lidh, me burgos e me vra të birin dhe të bijën... Grueja e ka për detyrë ndaj burrit me i ndej nën sundim... Gjaku i grues ban 1500 grosh» etj.

Natyrisht, jemi larg me shekuj nga zbatimi integral i Kanunit të Lekë Dukagjinit. Jemi, gjithashtu, larg periudhës kur At Gjeçovi bëri përmbledhjen e tij. Por kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë deri diku, natyrisht, jo në mënyrë të mprehtë si përpara, fryma dhe rutina e tij në zbatimin e mjaft prej këtyre zakoneve që neve na dalin përpara, sidomos në jetën shoqërore të malësive.

E meta e Partisë në Veri, dhe në përgjithësi e studiuesve tanë teoriko-shoqërorë, është ajo që ata as e kanë shikuar si duhet realitetin shoqëror dhe zhvillimin e tij në këto krahina dhe as që kanë marrë mundimin ta studiojnë seriozisht veprën e At Shtjefën Gjeçovit, që ka një rëndësi historike dhe shoqërore. Studimi i kësaj vepre do t'i ndihmojë studiuesit tanë

ta bëjnë mirë diagnozën e gjendjes aktuale të marrëdhënieve shoqërore në Veri, për të parë përmbysjet, evolucionet dhe për të forcuar punën tonë ideologjike, propagandistike dhe organizative.

Ndryshime kolosale janë bërë në jetën shoqërore të vendit tonë, në marrëdhëniet shoqërore dhe private të njerëzve, si dhe në botëkuptimet filozofike të tyre, jo vetëm duke i krahasuar këto me Kanunin e mbledhur nga Gjeçovi, jo vetëm me kohën e regjimit feudo-borgjez të Zogut, por neve na vihet detyrë të rishikojmë Kodin tonë Civil, të hartuar në pushtetin tonë dhe që, i parë në dritën e ndryshimeve revolucionare që po bën Partia, shumë kapituj e nene të tij mund të jenë vjetruar.

Të marrim pikërisht çështjen e pronës private, burimin e kaq të këqijave. Atë Partia po e përmbys, po e shkatërron nga themelet materialisht dhe teorisht, ajo nuk është më baza materiale e rendit tonë socialist, i cili mbështetet në pronën e përbashkët të mjeteve të prodhimit. Bashkë me pronën private, duke u mbështetur në filozofinë tonë materialiste, ne po shkatërrojmë tani edhe gjithë superstrukturën dhe filozofinë e saj dhe po e zëvendësojmë atë me superstrukturën tonë, me filozofinë tonë materialiste. Këtu qëndron veçanërisht burimi i suksesit tonë në problemin që na intereson sot në këtë Plenum, në çështjen e emancipimit të plotë të gruas.

Por çështjen e zhdukjes së pronës private ne nuk duhet ta konsiderojmë si plotësisht të arritur fizikisht, dhe ca më pak ideologjikisht. Marksii thotë:

«Prona private na ka bërë aq budallenj e të njëanshëm, saqë një send është yni vetëm kur e zotërojmë, domethënë, kur ai ekziston për ne si kapital, ose kur e zotërojmë drejtpërsëdrejti, e hamë, e pimë, e veshim...»¹.

Dhe vazhdon:

«Prandaj vendin e të gjitha ndjenjave fizike e shpirtërore e ka zënë jetërsimi i të gjitha këtyre ndjenjave — ndjenja e zotërimit»².

Është pikërisht ky terren që okupohet nga ndjenjat dhe sentimentet e pronës private, personale, që thotë Marksi, të cilin ne nuk e kemi spastruar akoma, punë kjo për të cilën na duhet të bëjmë një luftë të madhe, të gjatë, ideologjike dhe politike, për të arritur reformat materiale në ndryshimet fizike të pronës e të shumë çështjeve të tjera.

Revolucioni ynë proletar, i udhëhequr nga Partia, ka krijuar të gjitha kushtet materiale dhe morale që pikërisht nga terreni ynë, me një luftë revolucionare të vazhdueshme dialektike të të kundërtave, të spastrohen mbeturinat e ideologjisë idealiste nga ndërgjegjja e njerëzve. Neve na bie barra ta çojmë kurdoherë më tej revolucionin, të krijojmë e të forcojmë botëkuptimin e ri në mendjen dhe në ndërgje-

1 K. Marks e F. Engels. «Mbi letërsinë dhe artin», vëll. I, f. 188. Tiranë, 1976:

2 Po aty.

gjen e njerëzve, të cilët të mendojnë dhe të rrojnë si revolucionarë, t'i shpjegojnë fenomenet e jetës, t'i zhvillojnë, t'i zgjidhin marrëdhëniet në mes tyre, në mes tyre dhe shoqërisë, jo më në mënyrën e vjetër, jo më me botëkuptimet idealiste, fetare, borgjeze, por me botëkuptim materialist, ateist, socialist. Në këtë fushë Partia, krahas me zhvillimin material të shoqërisë sonë socialiste, për shumë kohë ka për të bërë një luftë të madhe për zhvillimin moral në rrugën marksiste-leniniste të shoqërisë sonë.

Edukimin marksist-leninist të njerëzve tanë Partia nuk ia ka lënë dhe as do t'ia lërë kurrë spontaneitetit. Por që të mos ia lërë spontaneitetit, duhet të forcohet e të thellohet organizimi i edukimit të Partisë dhe të masave.

Çdo gjë që ne ndërtojmë, transformojmë, krijojmë, bëhet sipas ligjeve marksiste-leniniste, asgjë nuk bëhet jashtë ligjeve objektive të natyrës dhe të shoqërisë. Por çdo gjë duhet të shpjegohet dhe të kuptohet, pasi ajo ka anën e vjetër që shembet, që vdes, dhe anën e re, që lind e forcohet. Dhe e vjetra vdes me zor e pikërisht për këtë edhe e reja lind me përpjekje dhe me luftë. Që e reja të rritet si duhet, shpejt dhe e shëndetshme, natyrisht, duhet t'i shpjegojmë mirë ligjet e zhvillimit dhe ligjet, si të thuash, të pengimit, pasi vetëm kështu edukata bëhet e plotë.

Për problemet e gruas, që shumë mirë i vuri në dukje raporti i Byrosë Politike, mbajtur nga shoku Ramiz, dhe diskutimet e mira të shokëve, në drejtimet që përcakton raporti, ne duhet të marrim edhe

masa materiale organizative që, pavarësisht se duken si të veçanta, janë pjesë e pandarë e zhvillimit dhe e forcimit të ekonomisë së përgjithshme socialiste, pasi krijojnë kushte të mëtejshme të pjesëmarrjes më të gjerë të gruas në prodhim, lehtësojnë ngarkesën e saj nga punët e rënda shtëpiake dhe nuk janë aspak të paefektshme në të gjitha fushat. Në të kundërtën, ato ndihmojnë për luftimin e mbeturinave ideologjike mikroborgjeze që e mbajnë akoma gruan nën njëfarë zgjedhe ose gjendjeje inferioriteti ndaj burrit.

Po të studiojmë me kujdes zhvillimin e shoqërisë sonë, dhe jo vetëm sonës, ne do të konstatojmë se ka rrënjë të thella çështja që vetë gruaja e gjen si një gjë të drejtë, krejt të natyrshme, inferioritetin e saj përpara burrit. Ky zakon është rezultat i kushteve shoqërore në të cilat kanë jetuar dhe menduar nënat dhe motrat tona. Këtë zakon ne duhet të përpiqemi ta zhdukim, pasi edhe kushtet shoqërore po i ndryshojmë. Këto ndryshime shoqërore që po bën revolucioni ynë proletar, synojnë edhe në zhdukjen e antagonizmit të sekseve, domethënë të nënshtrimit të gruas ndaj burrit.

Antagonizmi i sekseve, siç na mëson Engelsi, mund të konsiderohet si i pari manifestim i luftës së klasave në historinë e njerëzimit.

Revolucioni proletar, ashtu siç zhduk kapitalizmin, borgjezinë dhe ideologjinë e saj, ashtu siç zhduk shfrytëzimin e njeriut nga njeriu dhe e çon njerëzimin në një shoqëri pa klasa, ashtu zhduk edhe këtë antagonizëm në mes sekseve. Këtë ai e bën duke e çli-

ruar plotësisht gruan nga çdo gjë që pengon liritë dhe të drejtat e saj të barabarta me burrin.

Martesa është një moment me shumë rëndësi në jetën e njeriut, me të cilën janë lidhur shumë zakone prapanike, që, aktualisht, edhe në qoftë se nuk ekzistojnë më te ne në atë mënyrë të acaruar si më parë, ekzistojnë prapëseprapë disa tradita të rënda që ruhen.

Engelsi thotë se martesa e bazuar mbi dashurinë është morale dhe atje ku dashuria qëndron, vetëm atje është martesa.

Në shoqërinë tonë socialiste për këtë ngjarje të madhe të jetës së njeriut duhet të udhëhiqemi nga ky parim.

Duhet njohur se te ne ekzistojnë dhe shprehen mentalitete të gabuara e prapanike mbi dashurinë. Kjo konsiderohet si diçka e turpshme, e palejueshme, jonormale. Mjaft herë dashuria, në mos plotësisht, taksohet si një gjë amorale, «që gruan e çon në kurvëri dhe burrin në degjenerim». Këto janë mentalitete jo të drejta. Në qoftë se ka diçka që s'ka të bëjë aspak me kurvërinë, kjo është dashuria e vërtetë. Në kurvëri nuk ka dashuri.

Për fat të mirë vendi ynë nuk e ka njohur këtë plagë të tmerrshme të kurvërisë, që ne duhet ta luftojmë deri në tendencën më të vogël të shfaqjes së saj, tendencë që mund të ndodhë nga shtruarja jo drejt, jo në rrugën marksiste-leniniste, e çështjes së dashurisë dhe të martesës, nga mosluftimi si duhet në praktikë dhe në teori i pikëpamjeve dhe i praktikave borgjeze e idealiste në këto çështje.

Vendi ynë ka njohur martesat me dhunë, ka njohur ligjet skllavëruese, poligamike dhe torturuese të shariatit për gratë; ai ka njohur ligjet e katolicizmit, të Vatikanit, që jo vetëm e skllavëronin dhe e poshtëronin gruan, por e torturonin atë egërsisht dhe shpirtërisht. Ndarja e shtetit nga kisha, vendosja e Kodit Civil, Lufta Nacionalçlirimtare dhe ndërtimi i socializmit bënë që, në bazë të ligjeve, në vendin tonë të mos njihet tjetër martesë, përveç asaj të pranuar me dëshirë dhe me vullnet krejt të lirë nga djali dhe nga vajza përpara gjendjes civile të shtetit; ata shkelmuan përgjithmonë praktikat shoqërore të së kaluarës. Por me gjithë këtë realitet, megjithëse në praktikë janë zhdukur shumë paragjykime, do të gabonim në rast se do të mendonim që çdo gjë në këto probleme e kemi vënë drejt dhe s'duhet të preokupohemi më, ose të shkojmë nga rruga që këto t'ia lëmë kohës t'i ndreqë. Duhet punuar që koha të shfrytëzohet mirë për të krijuar zakone socialiste dhe opinionin e përshtatshëm publik për të sotmen dhe për brezat që vijnë.

Megjithëse në vendin tonë po ndërtohet socializmi, me gjithë përparimet e mëdha ekonomike, politike, ideologjike, kulturore etj., në popull dhe në komunistë jo vetëm ekzistojnë opinione të gabuara, patriarkale, por konstatojmë se si pa gjë të keq vazhdohet akoma zakoni i egër i shitjes së vajzave dhe i fejesave që në djep. Ishin këto që na hapën akoma më mirë sytë për të mos i lënë më pas dore këto çështje kaq të rëndësishme dhe të rrezikshme.

Martesa është një akt, një fakt shoqëror, ajo nuk

duhet të konsiderohet si një koncept filozofik. Por ky fakt shoqëror ka filozofinë e tij, si në shoqërinë tonë, ashtu edhe në atë borgjeze.

Për borgjezinë martesë është bërë një treg ku burri dhe gruaja shiten reciprokisht. Në bazë të kësaj martesë nuk qëndrojnë në fakt ndjenjat e pastra, por ndjenjat e egra të pronës dhe të interesit privat, të pasurisë, të trashëgimisë, të kurvërisë së burrit dhe të gruas. Në regjimet kapitaliste-borgjeze aparenat e lirisë janë të gënjeshtërtë, gjoja modernizmat duan të tregojnë atë që në realitet nuk ekziston aspak, lirinë e individit, çlirimin e gruas nga zgjedha kapitaliste dhe ndjenjat e pastra. Këto fenomene shoqërore pozitive, në vendet ku sundon kapitali i gjen vetëm në gjirin e proletariatit.

Kurse te ne, ku çlirimi i gruas është siguruar, janë arritur kushtet e krijimit të martesave të bazuara në dashurinë. Te ne po kalohet, siç e ka thënë Engelsi, «nga mbretëria e domosdoshmërisë në mbretërinë e lirisë».

Ndjenjat e kulluara duhet të përpunohen dhe të kaliten më tej nga ideologjia jonë marksiste-leniniste. Ne kemi për të bërë shumë në këto drejtime. Ç'na thotë Engelsi? Duke folur për reperkusionet e regjimit komunist mbi familjen, ai thotë se regjimi komunist,

«...do t'i transformojë raportet ndërmjet seksëve në raporte krejt personale... Kjo do të arrihet kur të zhduket prona private, kur të sigurohet edukimi shoqëror i fëmijëve dhe do

të shkatërrohen kështu dy baza themelore të martesës aktuale (borgjeze), domethënë: nënshtrimi i gruas ndaj burrit dhe ai i fëmijëve ndaj prindërve»¹.

Ky është një program i madh pune për ne. Sa shumë duhet të mendojmë ne mbi këto mësimë të marksizëm-leninizmit!

A nuk na vihet neve si një detyrë nga më të rëndësishmet të rishikojmë vazhdimisht me një sy marksist-leninist karakterin e marrëdhënieve prindër-fëmijë, t'i vëmë këto marrëdhënie në rrugë të drejtë dhe t'i spastrojmë nga çdo gjë e vjetër idealiste, mikroborgjeze? Sigurisht, na vihet.

Shumë herë në këto çështje kaq të gjera sa edhe delikate, ndjenjat dhe sentimentet e pastra reciproke dhe këshillat e drejta të prindit ndaj fëmijëve dhe, anasjelltas, të këtyre ndaj prindërve, konfondohen me koncepte borgjeze e mikroborgjeze të pronës dhe të pikëpamjeve idealiste lidhur me të.

Nuk e kam fjalën këtu për ndjenjat e pastra të dashurisë së prindërve ndaj fëmijëve, për kujdesin e rritjes dhe të edukimit të tyre; po kështu, as për dashurinë e madhe, respektin dhe mirënjohjen që fëmijët duhet të kenë dhe të ruajnë për prindërit e tyre gjatë gjithë jetës. Këto marksizëm-leninizmi jo vetëm nuk i zhduk, por, përkundrazi, i kalit, i forcon, i zhvillon në një diapazon madhështor, që nuk kufizohen vetëm në familje, por në mbarë shoqërinë. Çështjen e

1 K. Marks e F. Engels. Veprat, bot. rus., vëll. 4, f. 336-337.

rë», ose «gruaja duhet të punojë më shumë se gomari, pasi gomari ha kashtë, kurse gruaja ha bukë».

Partia jonë duhet të punojë intensivisht ideologjikisht që familja shqiptare të kalitet, gjë që bëhet vetëm kur vendosen marrëdhënie të drejta, të barabarta, të lira, të pleksura me ndjenja të pastra e të thella, larg çdo nënshtrimi ose mbeturine të pronës private dhe koncepteve të saj, pasi duhet të njohim që koncepte të huaja ekzistojnë në kokat tona.

Në disa intelektualë ekziston koncepti për të mos u martuar me shoqe të mësuara, qofshin këto edhe me origjinë ose gjendje punëtore, të shtyrë nga pikëpamja mikroborgjeze, për të sunduar mbi gruan, për të qenë eprorë ndaj saj, për ta destinuar atë brenda katër mureve dhe për punët shtëpiake. Natyrisht, të tilla pikëpamje të huaja për shoqërinë tonë duhen luftuar.

Disa herë nuk ka harmoni në familje. Unë nuk do t'i analizoj të gjitha shkaqet, por në qoftë se s'gabohem, arsytet e vërteta duhet t'i gjejmë vetëm në interesin e pronës. Atje e kanë ato burimin, pavarësisht nën ç'petk shfaqen. Këtë burim populli e shpreh kështu: «Fukarallëku sjell grindje». Nga pikëpamja e filozofisë sonë kjo do të thotë se fukarenjtë nuk grinden me njëri-tjetrin, por ngrenë krye kundër atyre që kanë pushtetin ekonomik, por edhe atë politik, si të thuash.

Në familje ka mosmarrëveshje dhe disa herë grindje në mes nuses së re dhe prindërve të burrit. Mund të themi se fajet i kanë të dyja palët. Mundet, por nuk duhet harruar se (sidomos te brezat e prindërve tanë, bile edhe te ne vetë, sido që shumë më

lehtë se te të parët) ekziston tendenca e prindërve që djali dhe nusja duhet t'u binden atyre në çdo gjë. Botëkuptimet e tyre janë të papastruara dhe kjo është e kuptueshme. Ata duke qenë të rritur në një shoqëri borgjeze patriarkale, e kanë vështirë ta kuptojnë plotësisht se nusja nuk duhet të jetë e bindur ndaj tyre për çdo gjë. Çdo veprim të nuses, e ardhur e huaj në familje, ata e shohin me dyshim, se mos ajo e bën për vete djalin, «shtyllën e shtëpisë», se mos e largon djalin e tyre nga pushteti i prindërve dhe cenohet kështu interesi i tyre ekonomik personal. Kjo ngjet ca më shumë kur prindërit tanë pleq nuk kanë asnjë burim ekonomik, përveç të ardhurave të djalit të tyre. Këta, bile, grinden edhe me djalin e tyre kur e shohin se ky e dashuron gruan e tij. Këtëj linden xhelozitë, fërkimet dhe, disa herë, mungesa e ndjenjave të mira në mes nuses dhe prindërve të burrit të saj.

Nga ana e saj, nusja, gjithashtu, ka tendenca të drejta të çlirohet, të fitojë pozita në familje, jo vetëm ndaj prindërve të burrit, por edhe ndaj vetë burrit të saj. Këto tendenca të së resë i kupton fare mirë plaka, pasi në kohën e saj instinktivisht e ka tentuar dhe, meqë atëherë ajo ka dështuar në këto përpjekje të saj të ligjshme, nuk e gjen të drejtë që e reja e saj të fitojë.

Këtu qëndron kontradikta, të cilën u bie barra të gjithëve ta zhdukin, pleqve dhe të rinjve, por unë mendoj se barra dhe përgjegjësia më e madhe, në radhë të parë, na bie neve më të rinjve. Partia na ka armatosur me ideologjinë e klasës, e cila duhet të na bëjë më të kuptueshëm e më të durueshëm ndaj pri-

ndërve tanë, ndaj të cilëve disa njerëz, bile edhe shokë komunistë, duke u hequr si njerëz me «parime moderne», disa herë gabojnë, i lënë në mes të katër rrugëve. Kjo nuk është e drejtë, kjo nuk është as marksiste, as njerëzore, qoftë edhe sikur këta të kenë një pjesë të fajit. Ne duhet t'i kuptojmë prindërit tanë, t'i kuptojmë kohët kur kanë jetuar dhe t'i ndihmojmë të ecin me kohën tonë të re. Partia ndërton kohë të ndritura.

Brezat e ardhshëm të vendit tonë do të jenë çliruar plotësisht nga shumë paragjykime e mbeturina prej të cilave vuajtën brezat tanë. Vajzat tona, mëmat dhe qytetarët e denja të ardhshme nuk do ta ndiejnë më veten të ndrydhura si mëmat tona, ato nuk do të vuajnë më nga padija, nuk do të jenë më të varura ekonomikisht nga burrat, djentë apo vajzat e tyre, siç janë mëmat tona. Çlirimi i plotë ekonomik i tyre, arsimit, kultura socialiste, vendi i merituar që gruaja shqiptare do të zërë në prodhim, në shtet dhe në shoqëri, do të kontribuojnë fuqimisht në përsosjen e kësaj bote të re që farkëton Partia, ku të lulëzojë jeta materiale dhe shpirtërore si kurrë ndonjëherë, ku ndjenjat e pastra të njëriut për njëriun, të burrit dhe të gruas për njëri-tjetrin, të prindërve ndaj fëmijëve dhe anasjelltas, të gjejnë zhvillim të plotë, të natyreshëm dhe krejt të çliruar nga mbeturinat prapanike, idealiste, fetare, patriarkale, borgjeze, që ende krijojnë dhe ushqejnë te ne opinione të dëmshme dhe frenuese.

Ë gjithë kjo punë e madhe që ka akoma përpara për të bërë Partia, jemi të ndërgjegjshëm se do të

ndeshë në shumë vështirësi dhe nuk do të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Kjo është punë brezash të tërë, por rëndësi të madhe kanë rruga, vija, metoda e Partisë për t'i drejtuar në këtë rrugë brezat e ardhshëm. Çdo brez do të kryejë punën e vet të zhvillimit dhe të perfeksionimit. Brezit tonë Partia i vuri si detyrë të hedhë themelet e shëndosha dhe të dalë në rrugën e ndritur të socializmit. Partia na udhëheq me trimëri, me guxim, me pjekuri në këtë rrugë të qartë. Në një kompleks të madh, të harmonishëm, me luftë dhe me përpjekje të mëdha, që karakterizohen nga një frymë e thellë revolucionare, të gjitha masat e popullit po transformojnë vendin, po transformojnë veten e tyre, po forcohet ekonomia socialiste, po zhvillohen kultura dhe arsimit, po revolucionarizohet më tej njeriu i ri i vendit tonë, i cili, në luftë me pikëpamjet e vjetra, po pajiset me ideale të reja, të denja për socializmin. Në këtë rrugë të ndritur, komplekse, që përbën revolucionin tonë proletar, i cili ecën me vrull përpara, kemi bindjen e plotë që sa më shpejt, më mirë e plotësisht e ndërgjegjshme të bëhet gruaja shqiptare për rolin, për të drejtat dhe detyrat e saj në shoqërinë e vendit tonë, aq më të mëdha do të jenë fitoret e revolucionit tonë dhe aq më shumë do të shkurtohet koha e arritjes së asaj periudhe të lumtur që brezat që vijnë pas këtij tonit, do ta ndërtojnë dhe do ta zbukurojnë më tej.

Partia jonë e ka konsideruar dhe e konsideron luftën e madhe për emancipimin e gruas si një pjesë përbërëse të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit, si një kusht *sine qua non* të zhvillimit dhe të

përparimit në liri dhe në demokraci të vërtetë. Partia jonë i ka kurdoherë parasysh mësimet e Marksit, i cili zhvillimin e një epoke historike e kushtëzon me shkallën e përparimit të grave në rrugën e lirisë dhe shikon në marrëdhëniet midis burrit e gruas shkallën e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Pra, derisa në shoqërinë e një vendi nuk ka liri të vërtetë për gruan, në atë vend nuk mund të ketë liri të vërtetë.

Partia jonë në këtë problem të madh nuk është mjaftuar vetëm të bëjë ligje për barazinë e gruas me burrin dhe këto ligje të mbeten të vdekura në kartë, por këto ligje ajo i ka zbatuar, i zbaton dhe është duke i thelluar në jetë, pasi Lenini na mëson se kjo barazi e gruas dhe e burrit me ligj nuk është akoma barazi në jetë. Dhe në pasqyrën e vrullshme të jetës sonë socialiste ne shohim vërtetësinë e teorisë gjëniale të Leninit se, me gjithë ligjet që kemi për këtë çështje, hasim shumë vështirësi e pengesa në rrugë dhe ndiejmë se duhet të marrim shumë masa të mëtejshme për t'ia arritur plotësisht qëllimit.

Partia dhe mbarë populli ynë për asnjë minutë të mos e nënvleftësojnë rolin e madh të gruas në jetë dhe në revolucion. Prandaj gruas dhe vajzës shqip-tare t'u hapen të gjitha portat e punës, të mësimi, të prodhimit, të drejtimit, të mbrohen ato nga rreziqet e burimeve të prapambetjes, të ndihmohen që me baza të shëndosha të krijojnë personalitetin e tyre, të fitojnë besimin dhe guximin në çdo gjë, që nuk janë monopoli i asnjë seksi, po krijojnë, fitohen, kaliten në jetë, në punë dhe me mësim.

«Arsimi, kultura, qytetërimi, liria, — thotë Lenini, — të gjitha këto fjalë të bujshme në të gjitha republikat borgjeze kapitaliste të botës bashkohen me ligjet çuditërisht të poshtra, tmerrësisht të fëlliqura, egërsisht brutale mbi pabarazinë e gruas, siç janë ligjet mbi të drejtën e martesës dhe ndarjen, mbi pabarazinë e fëmijëve... mbi privilegjet e burrit, mbi poshtërimin dhe fyerjen e gruas»¹.

Prandaj emancipimi i gruas në vendin tonë nuk ndjek as rrugën dhe as qëllimet që ndjekin vendet borgjeze kapitaliste. Në drejtim të emancipimit të gruas ne duhet të punojmë në mënyrë që të fitojmë kohën e humbur. Emancipimi i gruas shqiptare s'ka asgjë të përbashkët me atë që quhet «emancipim i kukullave të borgjezisë». Emancipimin e gruas sonë ne e realizojmë në rrugën e revolucionit proletar, me frymën marksiste-leniniste dhe me cilësitë e mrekullueshme të grave të Shqipërisë në histori.

Me gjithë shtypjen shoqërore dhe mbajtjen në injorancë (brenda injorancës së përgjithshme ku e kanë mbajtur popullin tonë shkelësit e huaj dhe feudo-borgjezia e vendit), roli i gruas në Shqipëri nuk ka qenë i vogël dhe për të mos u përfillur në forcimin e familjes shqiptare, në forcimin e kombit tonë, në ruajtjen e traditave dhe të virtyteve të popullit shqiptar.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 30, f. 120.

«Në historinë e njerëzimit, — ka thënë Stalini, — asnjë lëvizje çlirimtare e rëndësishme nuk është bërë pa pjesëmarrjen direkte të grave...»¹.

Gruaja shqiptare, dhe sidomos ajo fshatare, me gjithë kushtet shtypëse, ka qenë një faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomiko-shoqëror, pra, një faktor përparimtar, me ndjenja të theksuara lirisdashëse, patriotike, e lidhur me punën dhe me tokën, që e bënë atë një heroinë të shkathët dhe të zgjuar.

«Revolucioni i sotëm, — ka thënë Lenini, — mbështetet te fshati, dhe këtu qëndron rëndësia dhe forca e tij. Nga eksperiencia e të gjitha lëvizjeve çlirimtare është parë se suksesi i revolucionit varet nga shkalla e pjesëmarrjes së gruas në të»².

Kur flasim për luftëra çlirimtare të popullit shqiptar në histori, nuk mund të ndahen për asnjë çast nga ato lufta dhe rezistenca e madhe e gruas shqiptare përkrah burrave, vëllezërve dhe djemve të saj, qoftë me armë, qoftë me rezistencë pasive kundër shkelësve, kundër armiqve të popullit dhe të truallit tonë. Ne e kuptojmë fare mirë se, në kushtet shoqërore të paraçlirimit, kontributi i gruas nuk vihej në dukje, por ky kontribut i madh ishte konkret, i pamohueshëm, i fuqishëm, moral dhe material. Në Luftën Nacionalçlirimtare ky kontribut dhe pjesëmarrja

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 5, f. 57.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, i. 196.

e gruas shqiptare krah për krah burrave, djemve dhe vajzave të saj ishin masivë, të fuqishëm, të dukshëm, në fshatra e në qytete. Forca, trimëria, pjekuria dhe patriotizmi i saj pas Çlirimit shpërthyen me një forcë të madhe, që do të shkonte duke u shtuar si një lunë e madh, i pandalshëm kurrë.

Ç'ndryshime kolosale janë bërë në jetën e gruas shqiptare, sa përparime të mëdha janë realizuar në të gjitha fushat e veprimtarisë së jetës sonë të re, që raporti i mbajtur sot në Plenumin e Komitetit Qendror, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ishte në gjendje t'i pasqyronte si duhet! Vetëm jeta e gjallë në të gjithë madhësinë e saj mund të të japë idenë e vërtetë se ç'forca të mëdha jetësore çliroi Partia me çlirimin e gruas, ç'forca krijuese përparimtare fshihe-shin në këtë pjesë të madhe të popullit tonë, ç'mrekulli po bën dhe do të bëjë ajo paskëtaj dhe me ç'vlera të pallogaritshme morale dhe materiale do ta pasurojë ajo jetën tonë socialiste.

Emancipimi i gruas në vendin tonë, i udhëhequr nga Partia, nuk është aspak një «lëvizje feministe», si në vendet kapitaliste, por është përparimi i femrës në një nivel të lartë, është ngritja e gruas në nivelin e të drejtave të plota me ato të burrit, është marshimi dorë për dorë i burrit dhe i gruas në harmoni ndjenjash, qëllimesh, idealesh më të pastra dhe më të larta të njerëzimit, është marshimi drejt komunizmit.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 147 (5872), 20 qershor 1967

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 116. Tiranë, 1969

MBI ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË REVOLUCIONIT KULTUROR PROLETAR KINEZ

Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH¹

16 qershor 1967

Udhëheqja e Partisë, në përgjithësi, është në dijeni të zhvillimit të mëtejshëm të Revolucionit Kulturor Proletar në Kinë. Qysh në muajin tetor të vitit të kaluar kur shumë aspekte të këtij revolucioni, për arsyt që dini, nuk i kishim fort të qarta, Plenumit të Komitetit Qendror iu parashtruan disa mendime paraprake², të bazuara në njohjen e gjeratëhershme të ngjarjeve të zhvilluara në Kinë.

Por tani ngjarjet që zhvillohen në Kinë i kemi më të qarta, sepse gjatë këtyre muajve, përveç informimit nga materialet e shumta të shtypit dhe të ATSH-së, kemi pasur rast të këmbëjmë mendime me

1 Në një nga pikat e rendit të ditës të Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha mbajti fjalën: «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të Revolucionit Kulturor Proletar kinez».

2 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 33, f. 378.

shokët kinezë, në mes të tjerash, edhe për Revolucionin Kulturor Proletar, dy herë me radhë, një herë kur delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës, i kryesuar nga shoku Kan Shen, erdhi në vendin tonë për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 5-të të Partisë dhe, herën e dytë, në janar të këtij viti, kur Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë vendosi që dy anëtarë të saj të bënin një vizitë në Republikën Popullore të Kinës.

Në nëntor 1966, fill pas Kongresit të 5-të të Partisë, nga delegacioni i PK të Kinës na u dha një pasqyrë e shkurtër mbi disa çështje të Revolucionit Kulturor në Kinë. Kan Sheni, me porosi të Mao Ce Dunit, na foli për historikun dhe etapat e zhvillimit të këtij revolucioni dhe na parashtroi mendimet e mëposhtme të udhëheqjes kineze, që po i përmbledhim shkurtazi, ashtu siç na i tha ai:

«Së pari, Revolucioni Kulturor Proletar është një zhvillim i domosdoshëm i luftës klasore, i revolucionit socialist. Pas marrjes së pushtetit nga ana e proletariatit më 1949, në Kinë filloi revolucioni për transformimin ekonomik... Por, me thellimin e revolucionit socialist, me përhapjen e lëvizjes së edukimit socialist në qytet dhe në fshat, lufta në frontin ideologjik bëhej një kërkesë gjithnjë më e dukshme.

Së dyti, Revolucioni Kulturor Proletar është një lëvizje e gjerë, e thellë dhe në përpjesëtime të mëdha masive, lëvizje e vetedukimit revolucionar të masave.

Së treti, Revolucioni Kulturor Proletar synon të luftojë ata që, duke pasur poste drejtuese në parti dhe në shtet, kanë hyrë në rrugën kapitaliste, për t'i prerë

kështu rrugën uzurpimit të udhëhoqjes nga ana e revizionistëve dhe restaurimit të kapitalizmit në Kinë.

Së katërti, Revolucioni Kulturor Proletar nxori përvojën e zhvillimit të gjerë të demokracisë në kushtet e diktaturës së proletariatit, eksperiencën e centralizmit demokratik (të shprehur në formulën kineze: «diskutim i gjerë, shprehje e lirë e mendimeve, dacibao, debat i madh në mes të masave»).

Së pesti, Revolucioni Kulturor Proletar hedh bazat e përgatitjes dhe të edukimit të një ushtrie të madhe intelektualësh të klāsës punëtore.

Së gjashti, ky revolucion i jep një nxitje të madhe revolucionarizimit ideologjik të njerëzve, krijon mundësi që ideja të kthehet në një forcë të madhe materiale për zhvillimin e forcave prodhuese. Eksperiencia, tha Kan Shen, vërteton se ky revolucion nuk e pengon prodhimin, përkundrazi, e shtyn atë përpara.

Së shtati, Revolucioni Kulturor Proletar ndihmon luftën kundër imperializmit, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me qendër udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por, që të luftohet me sukses kundër imperializmit dhe revizionizmit, duhet të luftohet, në radhë të parë, në shkallë kombëtare, kundër pikëpamjes së evolucionit paqësor. Revolucioni Kulturor Proletar ndihmon për mobilizimin dhe përgatitjen e masave për luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Dhe së teti, përfundoi Kan Shen, Revolucioni Kulturor Proletar kombinohet me studimin e veprave të Mao Ce Dunit nga masat qindramilionëshe».

Siç e shihni, në nëntor të vitit 1966, Partia Komuniste e Kinës, nëpërmjet kryetarit të delegacionit të saj, për herë të parë na vuri në dijeni zyrtarisht për qëllimet e këtij revolucioni dhe për udhëheqësit kryesorë të vijës reaksionare borgjeze, Liu Shao Çi dhe Ten Hsiao Pin, që i janë kundërvënë vijës së përfaqësuar nga Mao Ce Duni.

Lufta midis këtyre dy vijave, tha Kan Shen, bazohet në çështjen se ç'qëndrim mbahet ndaj masave. Ndërsa vija e Maos mbështetet te masat dhe ka besim tek ato, tek iniciativat e tyre, është për mobilizimin, organizimin dhe çlirimin e ndërgjegjes së punonjësve nga mbeturinat borgjeze e feudale, vija reaksionare borgjeze shpreh mosbesim dhe ka frikë nga masat, shkon kundër tyre, kundër revolucionit, orvatet të shtypë çdo lëvizje revolucionare të masave.

Kan Shen na foli vetëm në përgjithësi që Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini kanë bërë gabime gjatë jetës së tyre. Ai nuk na shpjegoi se ku konsistonin gabimet e tyre, por theksoi se Mao Ce Duni është përpjekur vazhdimisht t'i korrigjonte atë, me shpresë që të ndreqeshin.

Kan Shen na tha pastaj se, kur u dënua veprimtaria armiqësore e Pen Çenit, Lu Din Isë, Lo Zhui Çinit e të tjerëve, megjithëse në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë Politike në maj të vitit 1966 Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini nuk shprehën asnjë kundërshtim, domethënë ishin dakord, në praktikë, pas mbledhjes, që të dy ndoqën një kurs të kundërt. Ata dërguan ekipe të shumta në bazë për të neutralizuar e mbytur iniciativat e masave dhe, kur ato kundërshtuan, Liu

Shao Çia, Ten Hsiao Pini dhe shokët e tyre e cilësuan si kundërrevolucionare veprimtarinë revolucionare të masave kundër elementëve armiq dhe ndërmorën kundër tyre veprime arbitrare, hodhën poshtë deri edhe vërejtjet e bëra nga ana e grupit të Revolucionit Kulturor Proletar pranë Komitetit Qendror. Liu Shao Çia e Ten Hsiao Pini nuk i raportuan fare Mao Ce Dunit për këto veprime të tyre, që ishin në kundërshtim të hapët me vendimet që ishin marrë nga udhëheqja e partisë.

Siç duket, këto ngjarje imponuan thirrjen në gusht të vitit 1966 të plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës që kishte katër vjet pa u mbledhur. Në këtë plenum «u analizua» vija reaksionare borgjeze, u mor vendimi prej 16 pikash dhe doli komunikata për të cilën jeni në dijeni. «Plenumi, tregoi Kan Shenin, kritikoi Liu Shao Çinë dhe Ten Hsiao Pinin, shtoi përbërjen e anëtarëve të përhershëm të Byrosë Politike nga 7 në 12 veta dhe u bënë ndryshime në radhitjen e vjetër të personaliteteve kryesore udhëheqëse të partisë».

Kan Shenin na informoi, gjithashtu, se në muajin tetor Komiteti Qendror thirri një mbledhje pune, për të diskutuar rreth masave që duheshin marrë për zbatimin e vijës së përfaqësuar nga Mao Ce Duni, në të cilën morën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të partisë të rajoneve më të mëdha të Kinës. Në këtë mbledhje u bë një diskutim i mëtejshëm për vijën e gabuar të Liu Shao Çisë dhe të Ten Hsiao Pinit, të cilët i paskëshin bërë Komitetit Qendror autokritikë me shkrim e me gojë, ku gjoja kishin pra-

nuar gabimet. Por, referoi Kan Shen, Mao Ce Duni, duke u nisur nga formula «Unitet-kritikë, përsëri unitet», u përpoq t'i ndihmonte ata që të ndreqnin gabimet, duke i mbajtur si anëtarë të përhershëm të Byrosë Politike. Njëkohësisht, mbledhja diskutoi rreth masave që duhen marrë për të luftuar çdo ndikim të vijës së tyre reaksionare në parti dhe në masa dhe për të udhëhequr lëvizjen e gjerë masive në kritikën ndaj kësaj vije. Për rezultatet e kësaj mbledhjeje dhe vendimet që u morën, Kan Shen nuk na foli, mbasi delegacioni i Partisë Komuniste të Kinës, i kryesuar prej tij u nis për në Shqipëri, kur mbledhja ishte duke i vazhduar punimet.

Duke përfunduar ekspozenë, Kan Shen na tha se gjatë zhvillimit të Revolucionit Kulturor Proletar u demaskuan elementët armiq, si: Pen Çeni, Lu Din Ija dhe Lo Zhui Çini, njëkohësisht, u zbulua vija e gabuar e dy anëtarëve të komitetit të përhershëm të Byrosë Politike, Liu Shao Çisë dhe Ten Hsiao Pinit.

Në ekspozenë që u bë Plenumit tonë të Komitetit Qendror në muajin tetor të vitit të kaluar vihej theksi në një sërë fenomenesh negative dhe gabimesh në jetën dhe në punën e Partisë Komuniste të Kinës, që neve na tërhiqnin dhe na tërheqin me të drejtë vëmendjen, sidomos, mbi disa shkelje të rënda të normave leniniste të statutit të partisë, siç janë mosthirrja e kongresit të partisë prej më se 10 vjetësh, mungesa e mbledhjeve të plenumit të Komitetit Qendror, duke eliminuar kështu në praktikë udhëheqjen supreme të partisë, që as vendime merrte, as e pyeste njeri etj. dhe duke u realizuar udhëheqja e partisë dhe e

vendit vetëm nëpërmjet Byrosë Politike. Në të tilla kushte, gjersa bëheshin shkelje kaq flagrante, shumë të rrezikshme për fatet e partisë dhe të Republikës Popullore të Kinës, kuptohej që në udhëheqje të partisë duhej të ekzistonte patjetër një gjendje e rëndë, shumë e sëmurë. Pra, edhe pa të dhënat e Kan Shenit, duke u mbështetur në ngjarjet reale të jetës, ne e merrnim me mend se në gjirin e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës duhej të ekzistonte një gjendje jonormale. Dyshimet tona u provuan nga të dhënat që na parashtrroi ai për ekzistencën e një fraksioni shumë të fuqishëm e të rrezikshëm në udhëheqjen e partisë, të kryesuar nga Liu Shao Çia, Ten Hsiao Pini e të tjerë, të cilët, duke qenë për një kohë të gjatë në udhëheqje, nuk mund të mos kishin mbjellë farën e punës së tyre të keqe në të gjitha instancat edhe në bazë.

Qysh në tetor 1966, duke u mbështetur në eksperiencën marksiste-leniniste të Partisë, Plenumi ynë i Komitetit Qendror gjykoi drejt se njerëz si Pen Çeni nuk mund të ishin të izoluar. Ata, për të realizuar pikësynimet e tyre, me siguri, duhej të kishin punuar prej kohësh që, në një mënyrë ose në një tjetër, të kishin kudo, në komitetet e partisë, në organet e pushtetit, në organizatat shoqërore etj. njerëzit e tyre dhe, sado që të dhënat nuk i kishim të plota (duke u bazuar në eksperiencën e Partisë sonë, në udhëheqje të së cilës kanë dalë herë pas here elementë armiq trockistë, revizionistë, agjentë të imperialistëve, të tististëve, të hrushovianëve, që kanë dashur dhe janë përpjekur të godasin Partinë, e cila, duke u qëndruar

besnike parimeve marksiste-leniniste, kurdoherë i ka zbuluar në kohë dhe i ka shpartalluar), merrnim me mend se aluzionet në fjalimet e Lin Biaos dhe të të tjerëve shprehin një situatë aspak normale në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës.

Pas vajtjes së shokut Hysni dhe të delegacionit tonë ushtarak në Kinë në muajin janar, ne i pasuruam më tej njohuritë për gjendjen atje. Janari ishte koha e një ngritjeje të gjithanshme të Revolucionit Kulturor Proletar, periudha e një etape të re në ashpërsimin e luftës kundër atyre që ndjekin rrugën borgjezo-kapitaliste. Shokët tanë bënë vizita dhe patën takime të shumta me udhëheqësit kinezë, me masat e popullit dhe të ushtrisë. Ata konstatuan se, me hedhjen e masave në Revolucionin Kulturor në Kinë, është ngritur në një shkallë të lartë lufta klasore kundër shfaqjeve e qëndrimeve të huaja antisocialiste, kundër elementëve në fuqi që ndiqnin vijën borgjeze reaksionare; është shtuar urrejtja e masave punonjëse kundër reaksionit, borgjezisë, ish-çifligarëve e pasanikëve; janë nxitur iniciativa dhe guximi i tyre për të goditur pa mëshirë cilindo qoftë që ka hyrë në rrugën armiqësore. Kudo që shkuan në Kinë, shokët tanë vunë re se populli shfaqte urrejtje të thellë kundër elementëve armiq. Masat që merrnin pjesë në revolucion paraqiteshin të gatshme të mbështetnin çdo masë radikale për likuidimin e armiqve. Siç theksonin kinezët, thellimi i revolucionit i ka dhënë shtytje edhe luftës që zhvillon Kina kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Udhëheqësit kinezë u folën shokëve tanë për disa

probleme preokupante që u kishin dalë gjatë Revolucionit Kulturor Proletar, si: lufta kundër ekonomizmit e anarkizmit; mungesa e koordinimit të punës drejtuese të organizatave të «gardistëve të kuq» dhe të punëtorëve të rebeluar; çështja e marrjes në dorë të organeve të partisë, të pushtetit, të organizatave shoqërore dhe ekonomike, si dhe problemi i zhvillimit të Revolucionit Kulturor në fshat. Për të gjitha këto probleme, përveç orientimeve të përgjithshme që jepen në shtyp nga ana e komisionit qendror të Revolucionit Kulturor pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, nuk ka pasur asnjë formë organizimi, asnjë drejtim të centralizuar nga ndonjë organ qendror, as direktiva konkrete të përpunuara për t'iu rekomanduar bazës si të veprojnë. Dhe më e rënda është se as partia nuk ndodhej në drejtim të kësaj pune. Këtë shokët kinezë e shpjegojnë me mungesën e eksperiencës dhe me fitimin e kësaj eksperience gjatë revolucionit etj., etj. Me një fjalë, partia është e paralizuar, nuk qëndron në drejtimin e revolucionit proletar, si detashment i organizuar udhëheqës.

Për të gjithë ne është o qartë se kudo objektivi numër një i armiqve të komunizmit, i imperialistëve dhe i veglave të tyre, i revizionistëve e i të gjithë tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, është, në radhë të parë, të godasin, të dobësojnë partinë, ta degjenerojnë dhe më së fundi ta shkatërrojnë atë. S'ka dyshim se revizionistët kinezë, të udhëhequr nga Liu Shao Çia e Ten Hsiao Pini, duke pasur për një periudhë të gjatë funksione udhëheqëse në parti, kanë punuar për këtë qëllim final dhe e kanë dëmtuar rëndë partinë.

Në fakt, sot në Kinë, organizatat-bazë të partisë gati nuk ekzistojnë, ato janë paralizuar krejt dhe as që merren me drejtimin e Revolucionit Kulturor Proletar. Anëtarët e partisë janë bashkuar me hunveibinët, me organizatën e punëtorëve të rebeluar etj. Kandodhur, bile, që, në të njëjtën qendër pune ose institucion, ku gjatë revolucionit janë ngritur disa organizata edhe revolucionare, edhe kundërrevolucionare, komunistët janë të hallakatur, të ndarë sipas simpative individuale, të bashkuar me këtë ose me atë organizatë. Puna e rrezikshme armiqësore e Liu Shao Çisë dhe e Ten Hsiao Pinit me shokë, e mbuluar me maskën e ideve të Mao Ce Dunit, siç po duket, e ka pasë krimbur partinë nga kreu në fund. Jo vetëm organizata-bazë, po komitete të tëra partie, si ai i Shangait etj., kanë qenë në pozita kundërrevolucionare, saqë patën arritur të ndërmerren aksione të egra armiqësore, deri në orvatje për sabotimin e ujit e të dritës, për shkatërrimin e radiostacioneve, për të korruptuar punëtorët, duke u dhënë para, shtëpi etj., etj., që ju i dini.

Në Kinë, ashtu siç nuk ekzistojnë organizatat e partisë, nuk ekzistojnë as ato të pushtetit (përveç aparateve), as udhëheqjet e organizatave shoqërore, për arsye se në krye të tyre revizionistët kinezë, që prej kohësh, kanë pasë vënë elementë të djathtë, partizanë të tyre. Jo vetëm në krye, por edhe në forumet vartëse të këtyre organizatave, Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini kanë pasë vendosur me kohë pasuesit dhe simpatizantët e tyre. Për këtë arsye shokët kinezë, duke zbuluar këtë gjendje të rrezikshme, formuluan parullat e njohura të hedhura në shtyp e në

mitingjet e mëdha masive, si: «Të merret pushteti», «Të sulmohen shtabet» etj., me të cilat viheshin në lëvizje e mobilizoheshin masat në Revolucionin Kulturor Proletar kundër elementëve armiq. Pra, vihej, me tërë kuptimin e fjalës, detyra që të merrej pushteti me armë, se ua kishin marrë të tjerët më parë. Hap pas hapi u përmbysën gjatë revolucionit nga organizatat e hunvebinëve dhe të punëtorëve të rebeluar një sërë forumesh udhëheqëse të partisë, të pushtetit dhe të organizatave shoqërore, të cilat mendohet që të rizgjidhen porsa të krijohen kushtet, në kongreset përkatëse të punëtorëve, të fshatarëve, të rinisë, të studentëve, të ushtarëve etj. Por informatat e mëvonshme tregojnë se në Kinë, në më të shumtat e provincave, nuk është marrë akoma pushteti nga duart e të djathtëve.

Shokët kinezë u treguan shokëve tanë, që ishin në Kinë në fillim të këtij viti, se mjaft kuadro të lartë të partisë e të shtetit kinez kanë qenë armiq, guomindanistë, çankaishistë etj. dhe kjo është e kuptueshme. Është e qartë se, si në parti, si në pushtet, ashtu dhe në organizatat shoqërore, që nga lart e gjer në bazë, revizionistët kinezë, nëpërmjet politikës së kuadrit, kishin vendosur kudo partizanët e tyre. Ata kishin në dorë pushtetin, prandaj u duhej rimarrë ky pushtet.

Pastrimi i radhëve të partisë, të organizatave të masave dhe të aparateve të tyre nga të gjithë elementët revizionistë, është një domosdoshmëri pa të cilën revolucioni në Kinë nuk mund të ecë përpara, nuk mund të shpartallohen përfundimisht atje mbe-

turinat e klasave shfrytëzuese. Për këtë arsye ne, sa herë kemi pasur rastin të takohemi kohët e fundit me shokët kinezë, u kemi sugjeruar t'u japin sa më parë një grusht dërrmues, tronditës krerëve të revizionizmit kinez, Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit e të tjerëve, të cilët i kanë sjellë një dëm kaq të madh çështjes së socializmit. Ne u kemi vënë mirë në dukje shokëve kinezë, sidomos, rolin vendimtar të partisë, pa të cilën asgjë nuk mund të bëhet.

Roli i ushtrisë në zhvillimin e këtyre ngjarjeve ka qenë dhe është i rëndësishëm, pavarësisht se në Kinë gjendja nuk duhej të kishte arritur gjer aty sa partia të vihej në bisht të situatës. Sipas shokëve kinezë, ushtarët dhe oficerët, në përgjithësi, me përjashtim të një pjese të kuadrove të lartë të reparteve të mëdha ushtarake, ku kanë pasë depërtuar elementë të djathtë, janë me Mao Ce Dunin, prandaj, nëpër repartet, porsa i zbulojnë elementët e djathtë, i spastrojnë. Spastrimi nga këta elementë është i domosdoshëm, se, sidomos, ushtria është një armë shumë delikate, e cila kërkon që kuadrot, nga lart e gjer në kompani, t'i kesh të pastër, ndryshe nuk mund të ecësh i sigurt në luftën e madhe vendimtare kundër imperia-lizmit dhe revizionizmit.

Gjatë takimeve shokët kinezë nuk na kanë folur për asnjë vështirësi ekonomike, bile kanë pohuar se prodhimi kudo shkon mirë, por është e kuptueshme që ai duhet të jetë dëmtuar nga orvatjet e panumërta të të djathtëve për të mashtruar punëtorët dhe nga shqetësimi e konfuzioni i madh që ekziston aktualisht në Kinë. Megjithatë, furnizimi i tregjeve është i rre-

gullt jo vetëm në qytetet e mëdha, po kudo. Gjatë vitit 1966 në Kinë ka pasur prodhime të larta bujqësore dhe industriale.

Sigurisht, armiqtë nuk harrojnë ta dëmtojnë edhe ekonomikisht socializmin me vjedhje e sabotime, po, në radhë të parë, ata përpiqen të shkatërrojnë zemrën dhe mendjen e njerëzve, të dëmtojnë partinë politikisht dhe ideologjikisht. Prandaj Revolucioni Kulturor Proletar në Kinë, siç thonë shokët kinezë, krahas përpjekjeve për të likuiduar sabotazhet ekonomike dhe çdo veprim tjetër shkatërrues të armiqtve, drejtohet, në radhë të parë, kundër politikës dhe ideologjisë borgjeze e revizioniste, për të mbajtur të pastra mendjet dhe shpirtrat e njerëzve.

Në Kinë tani ka një shtab për çështjet e Revolucionit Kulturor Proletar, që punon për ndreqjen e vijës në të gjithë sektorët, për ta pastruar atë nga shtrembërimet që po e çonin vendin në katastrofë. Ky shtab udhëhiqet nga Mao Ce Duni. Elementët e vijës së djathtë, duke punuar të maskuar, që prej një kohe të gjatë, kishin arritur të shtinin në dorë shumë pozita në parti, në shtet dhe në organizatat shoqërore, prandaj, shokët kinezë pohojnë se po të mos ishin marrë masat siç po bëhet, ata, një mëngjes të mirë, do të kishin triumfuar.

Në takimin që bënë shokët tanë me Mao Ce Duni në janar të këtij viti, ai u foli në përgjithësi edhe për gabimet e vërtetuara tek udhëheqësit e tjerë kinezë dhe tek ai vetë. Maoja u ankua se disa njerëz trumbetojnë sikur ai të mos kishte bërë kurrë gabime. «Ja, — tha ai, — shikoni çfarë rrëmujë e madhe është krijuar në të gjithë Kinën, kudo ka konfuzion...». Dhe

la të kuptohet se për këtë gjendje ka edhe ai përgjegjësinë e tij.

Në mënyrë të veçantë, shokëve kinezë u mbetet detyrë e dorës së parë të normalizojnë sa më shpejt gjendjen e rëndë në parti, se këtë situatë e shfrytëzojnë armiqtë. Ata duhet të ndërmarrin sa më parë një verifikim rrënjësor të radhëve të partisë dhe ta riorganizojnë këtë në baza të shëndosha. Mao Ce Duni dhe udhëheqës të tjerë kinezë u folën edhe për këtë problem shokëve tanë, duke e konsideruar si një detyrë të domosdoshme punën për kontrollin dhe pastrimin e radhëve të partisë, por theksuan se në këtë drejtim, hëpërhë, janë akoma në fazën e debateve, të diskutimeve politike e ideologjike, të demaskimit të elementëve të djathtë. Më vonë kanë për të kaluar në fazën e masave ndëshkimore dhe me karakter organizativ. Ne kemi besim se në Kinë do t'u bëhet analiza gabimeve të vërtetuara dhe do të merren masa në rrugë të drejtë. Vetë Mao Ce Duni u tha shokëve tanë se këtë vit shokët kinezë mendojnë të bëjnë kongresin e partisë, ku do të analizojnë gjithë punën e saj, do të ndreqin vijën e gabuar, do të caktojnë edhe detyrat perspektive. Por, në bazë të zhvillimit të situatave në Kinë, neve na duket e zorshme se mund të mbahet sivjet ky kongres¹.

Lufta midis dy vijave në parti dhe në udhëheqjen e saj, siç pohojnë shokët kinezë, ka ekzistuar prej kohësh në Partinë Komuniste të Kinës. Vetë Liu Shao

¹ Në fakt, Kongresi i 9-të i PK të Kinës u mbajt nga 1 deri më 24 prill 1969.

Çia, qysh më 1931-32, kur punonte në sindikata, pas-kësh pasur pikëpamje të djathta, oportuniste, ka predikuar vijën ekonomike të shkëputur nga politika etj.

Më 1946, pas kapitullimit të Japonisë, thonë shokët kinezë, Liu Shao Çia pati propozuar që partia t'ia dorëzonte Guomindanit ushtrinë e kuqe çlirimtare, duke e shkrire këtë në ushtrinë e Çan Kai Shisë, pra, u orvat kështu të likuidonte ushtrinë dhe rolin udhëheqës të partisë në të.

Më 1949 Liu Shao Çia ka mbajtur një fjalim krejt oportunist, revizionist, sipas të cilit socializmi nuk mund të ndërtohet në Kinë, ndërsa më 1951, kur fshatarët e provincës Shansi donin të bashkoheshin në kooperativa, ka shkruar një artikull, në të cilin dëshirat e fshatarëve i cilësonte utopike. Pikëpamjet antisocialiste të Liu Shao Çisë u konkretizuan më tej në tezat mbi kolektivizimin, që u parashtruan në Kongresin e 8-të të PK të Kinës në vitin 1956 (në raportin e mbajtur prej tij në këtë kongres duket qartë se revizionizmi aty është me mjekër), si dhe në qëndrimet negative të mëvonshme, qoftë ndaj komunave popullore, për ndërtimin ekonomik të pavarur, ashtu dhe për çështjet e revolucionit kulturor e ideologjik. Dhe ky njeri është presidenti i Republikës!

Vija revizioniste e Liu Shao Çisë në fushën politike dhe ideologjike, na kanë informuar shokët kinezë, është reflektuar edhe në çështjet organizative të partisë. Liu Shao Çia ka bërë sidomos lëshime për të pranuar në parti elementë nga radhët e armikut dhe për t'i ngritur në përgjegjësi këta elementë armiq e spiunë. Në ushtri Liu nuk udhëhiqej nga parimi i

vënies së politikës në komandë, gjithashtu, edhe në ekonomi, në vend të politikës, i jepte prioritet teknikës, ndërsa në fushën kulturore e arsimore u përpoq të përçonte një vijë borgjeze reaksionare.

Kur partia ishte në luftë kundër Kao Ganit e Van Minit (Van Mini sot rron në Moskë, ai është edhe anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, merr rrogë çdo muaj nga shteti kinez dhe flet e shan Kinën Popullore në radio), Liu Shao Çia, i pasuar nga Pen Çeni, ishte pro vijës së tyre. Ai ishte partizan i bisedimeve paqësore, ishte kundër luftës së armatosur, kundër mobilizimit të masave dhe pro një fronti të gjerë me shtresat e larta të Guomindanit, kundër luftës së masave fshatare etj.

Kur në parti u zhvillua lufta kundër grupit të Pin De Huasë, rreth çështjeve të vijës së përgjithshme, të hopit të madh dhe ngritjes së komunave popullore, dolën tezat e Liut mbi ekonominë individuale në fshat.

Më vonë, thonë shokët kinezë, dolën tezat e Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit dhe Pen Çenit për krijimin e frontit unik të luftës kundër imperializmit, së bashku me revizionistët, kundër të cilave Partia jonë, siç e dini, mbajti menjëherë qëndrim të prerë.

Shokët kinezë i vunë në dijeni shokët tanë edhe për qëndrimet e pikëpamjet e Ten Hsiao Pinit, i cili zinte një nga vendet më të rëndësishme në udhëheqje. Ky, si sekretar i përgjithshëm, as që e vinte fare në dijeni Mao Ce Dunin për gjendjen e partisë, për zbatimin e vijës së saj, megjithatë, delegacionit tonë, kur ishte për vizitë në Kinë, Maoja i tha: «E shikoni këtë, ky është i vogël si floriri, po ka vlerë të madhe». T'eni

nuk ishte për vënien e politikës në udhëheqje të ndërimit ekonomik dhe kishte besim të madh te Pen Çeni, që kryente, në fakt, funksionet e zëvendëssekretarit të përgjithshëm të partisë. Pas zbulimit të Pen Çenit, Ten Hsiao Pini solli menjëherë në udhëheqje të partisë njerëzit e Liu Shao Çisë, siç ishte Tao Çuja, që ka qenë njeri i Kao Ganit.

Në marrëdhëniet me partitë motra, Liu dhe Teni kanë manifestuar qëndrime shoviniste të shtetit dhe të partisë së madhe.

Shokët kinezë kishin parashikuar që rezultatet paraprake të Revolucionit Kulturor Proletar t'i arrinin deri në muajin prill të këtij viti, ndërsa rezultatet përfundimtare deri në pranverën e vitit që vjen. Lufta midis dy vijave atje po vazhdon shumë e ashpër, bile edhe me derdhje gjaku, se armiku e di që lufton për jetë a vdekje. Armikut nuk i mbetet tjetër rrugë veç luftës, prandaj reziston me këmbëngulje dhe egërsi për të mbajtur me çdo kusht pushtetin që pati shtënë në dorë dhe për të krijuar anarki, konfuzion, që shokëve kinezë u kanë dalë si probleme të mëdha. Edhe në rastin konkret, në Kinë, vërtetohet përsëri teza e pagabueshme marksiste-leniniste se armiku kurrë nuk i hedh vetë armët, ai kurrë nuk largohet vullnetarisht nga skena. Nga fillimi i muajit maj të këtij viti Mao Ce Duni njoftoi Partinë tonë se Revolucioni Kulturor Proletar është duke ndeshur akoma vështirësi, por populli kinez është ngritur i tëri në këmbë, në revolucion dhe shpreh besimin se këto vështirësi do të kapërcehen.

Goditja që po i bën Maoja vijës së djathtë ka një

rëndësi të madhe. Këtë gjë në Kinë nuk do ta bënte asnjë udhëheqës tjetër në shkallën që kanë arritur punët. Përkrahja e popullit kinez për Maon duket në manifestimet e fuqishme që janë zhvilluar e po zhvillohen vazhdimisht kundër Liu Shao Çisë, Ten Hsiao Pinit dhe pasuesve të tjerë të bandës së tyre.

Imperialistët, revizionistët modernë dhe të gjithë reaksionarët, qysh kur filloi Revolucioni Kulturor Proletar, u ngritën në këmbë dhe, të bashkuar në kor për një qëllim, po sulmojnë me tërbim masat që po merren në Kinë. Ata nuk lënë rast pa dalë në mbrojtje të tradhtarëve revizionistë kinezë, Liu Shao Çi, Ten Hsiao Pin, Pen Çen e të tjerë, të cilët, prej kohësh, kanë punuar dhe kanë krijuar një situatë shumë të rrezikshme për fatet e socializmit në Kinë. Armiqtë duan që Kina të rrojë në moçal, të krimbet, t'i hapë dyert ideologjisë borgjeze, të mbytet në sëmundje dhe, më së fundi, të kthehet në rrugën kapitaliste, siç ndodhi, më parë, në Jugosllavi dhe, më pas, në Bashkimin Sovjetik e në vendet e ish-demokracive popullore.

Ne do të jemi shumë të gëzuar po të shpëtojë Kina nga ky rrezik i madh dhe situata atje të forcohet. Këtë e kemi shprehur në të gjitha rastet, këtë e shprehën shokët tanë edhe gjatë vizitave që bënë në RP të Kinës. Sigurisht, nga gjithë kjo punë e gjatë armiqësore, atje ka dhe do të ketë vështirësi, sidomos për arsye se partia ka pësuar goditje të rëndë dhe akoma nuk po e merr veten si duhet, se ka e mund të ketë akoma tradhtarë të tjerë, që, për shkak të tufanit të madh që ka shpërthyer, qëndrojnë të maskuar dhe

nuk po goditen me atë ashpërsi marksiste-leniniste që duhet dhe mund të dalin më vonë. Po ne kemi besim se zjarri i madh që është ndezur do t'i përlejë armiqtë. Për sa kohë do të normalizohet kjo situatë, këtë, natyrisht, s'jemi në gjendje ta themi, por kemi besim se me masat që po merren dhe që duhet të merren akoma më me konsekuencë e më me rreptësi, ajo do të ecë kurdoherë në drejtimin pozitiv.

Natyrisht, duke i gjykuar çështjet nga pozitrat e shëndosha të Partisë sonë, mund të na duket dhe na duket çudi si janë zhvilluar kështu ngjarjet në Kinë dhe me të drejtë themi: Përse shokët kinezë nuk kanë marrë me kohë masat e duhura? Sigurisht, kjo e ka burimin në vijën e PK të Kinës, ku ka pasur oportunitizëm, janë vërtetuar lëshime të rënda, prandaj, në kushtet ekzistuese, nuk është dhe kaq e lehtë të korrigjohet brenda një kohe të shkurtër e gjithë kjo vijë.

Qëndrimet që mban Partia jonë ndaj ngjarjeve që po ndodhin në Kinë, ne gjykojmë se janë të drejta. Në rast se kemi vepruar edhe jashtë disa limiteve që kemi pasë vendosur (për shembull, ngandonjëherë, na është dashur të themi ndonjë fjalë më shumë nga sa duhet për Mao Ce Dunin ose për Revolucionin Kulturor), këtë e kemi bërë se e lypte situata, e lypte interesi i çështjes sonë të madhe dhe na duket se nuk kemi bërë keq. Është fakt se ndihma, mbështetja, solidariteti i Partisë dhe i popullit tonë në këto momente shumë të vështira për Partinë motër Komuniste të Kinës dhe për Maon, janë pritur dhe janë vlerësuar jashtëzakonisht shumë nga shokët kinezë. Në kushtet ku ndodhet Kina, jo vetëm fjala e Partisë sonë, që

shërben si një frymëzim i madh e shumë i çmuar për Partinë Komuniste dhe popullin vëlla kinez, por edhe deklarata e shqiptarit më të thjeshtë, që ka pasur rastin të shkojë gjatë këtyre ngjarjeve në Kinë, është dëgjuar me vëmendje, është shfrytëzuar dhe çmuar si një ndihmë e madhe. Prandaj vendimi i Byrosë Politike, për të dërguar në Kinë shokë të udhëheqjes e të tjerë, ishte një ndihmë e jashtëzakonshme për shokët kinezë, të cilët i shfrytëzuan shumë vizitat e tyre, i vlerësuan ato si një përkrahje të madhe që Partia jonë i jep Republikës Popullore të Kinës në momentet e vështira që kjo është duke kaluar. Duke vepruar në këtë mënyrë, duke u dhënë shokëve kinezë ndihmën më të madhe të mundshme, ne kemi synuar që, në çdo rast, të fitojmë kryesoren dhe kryesorja për çështjen tonë është shpëtimi i Kinës nga rreziku i revizionizmit.

Pavarësisht se si janë zhvilluar ngjarjet, gabimet e vërtetuara në Kinë duhet të vlejné si mësim të mëdha edhe për ne. Nga raporti që na bënë shokët, që vizituan në janar Kinën, si dhe nga ngjarjet e mëvonshme, kemi krijuar tani një ide që na e bën më të qartë zhvillimin e mëtejshëm të gjendjes në këtë vend. Natyrisht, nuk jemi ne që do t'u rregullojmë punët shokëve kinezë. Gabimet që janë bërë atje, ata duhet t'i ndreqin vetë. Neve na bie detyrë t'i studiojmë me kujdes këto gabime dhe të nxjerrim mësim të vlefshme që të mos biem në to. Ne duhet të mësojmë jo vetëm nga gabimet tona, po edhe nga gabimet e partive motra, ashtu siç mësojmë edhe nga eksperiencia e tyre e mirë. Studimi i eksperiencës negative të të

tjerëve na ndihmon të evitojmë gabime, prandaj që të mësojmë prej saj, ta njohim mirë nga ana marksiste-leniniste këtë eksperiencë.

Detyra numër një, që duhet të nxjerrim në këto situata të gjendjes ndërkombëtare dhe të zhvillimit të lëvizjes komuniste në botë, është të mbajmë Partinë, si kurdoherë, të pastër dhe të marrim vazhdimisht, siç po marrim, masa të atilla që t'i presim rrugën lindjes së revizionizmit në vendin tonë, duke luftuar çdo shfaqje që është në kundërshtim me vijën e Partisë, sado e vogël që të jetë. Partia ka punuar dhe do të punojë edhe në të ardhmen, që atdheu ynë socialist të rrojë jo tre, katër ose pesë dekada, por përgjithmonë, që popullit tonë kurrë të mos i dhembë koka. Ne duhet të punojmë në mënyrë të atillë që imperializmi, revizionizmi, ideologjia e tyre, të mos gjejnë kurrë terren të zhvillohen në Shqipëri. Ruajtja, pra, e pastërtisë së radhëve të Partisë, forcimi i saj i gjithanshëm ideopolitik dhe organizativ, kalitja e komunistëve në luftën e përditshme, kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe edukimi i tyre me shpirtin e sakrificës dhe të këmbënguljes për kapërcimin e çdo vështirësie e pengese, lidhja e tyre e ngushtë me masat e popullit janë, si kurdoherë, detyra të dorës së parë që duhet t'i realizojë Partia dhe te të cilat udhëheqja duhet të ketë syrin dhe kujdesin e saj të pandërprerë.

E pajisur me një disiplinë të hekurt dhe e udhëhequr nga ideologjia proletare, Partia jonë ka mbajtur kurdoherë në nivel të lartë vigjilencën revolucionare, duke demaskuar e duke goditur, që në vezë, çdo or-

vatje ose shmangie, të kujtdo qoftë, nga vija e saj marksiste-leniniste. Ajo kurrë s'u ka bërë lëshime armiqve, nuk i ka lejuar asnjëherë ata të ngrinin kokën, përkundrazi, i ka goditur pa mëshirë, qysh në shfaqjet e para, veprimet e tyre armiqësore, se nuk mund të lejonte dhe kurrë nuk do të lejojë të shkojnë dëm sakrificat e bëra në shekuj, gjaku i derdhur lumë gjatë Luftës së madhe Nacionalçlirimtare për të përzënë pushtuesit, për të përmbysur pushtetin e feudo-borgjezisë dhe për të vendosur pushtetin popullor.

Partia jonë e ka pasur kurdoherë parasysh dhe e ka zhvilluar me konsekuencë luftën e klasave në të gjitha drejtimet, brenda dhe jashtë Partisë. Kjo luftë te ne është bërë kurdoherë me ashpërsinë e duhur dhe për këtë arsye Partia jonë, vazhdimisht, e ka pasur dhe e ka situatën plotësisht në duart e saj. Do të bënim një gabim të pafalshëm, bile krim të madh, po të flitnim vetëm për sukseset dhe të mos goditnim me rreptësinë e duhur çdo orvatje armiqësore të drejtuar kundër Partisë dhe shtetit tonë. Po të kishte vepruar ndryshe, po të kishte ecur Partia në rrugën e lëshimeve, nuk do të ekzistonte dhe nuk do të lulëzonte sot Republika Popullore e Shqipërisë, që ndërton me sukses socializmin dhe që është bërë shembull në botë për zbatimin pa lëkundje të parimeve marksiste-leniniste.

Rëndësi të madhe për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit kanë kuptimi dhe zbatimi i vijës së masave. Kjo vijë rrjedh nga ideja marksiste-leniniste që pushteti i diktaturës së proletariatit është pushteti i klasës

punëtore, i cili shpreh dhe mbron interesat e masave punonjëse. Demokracia, gjatë kësaj periudhe tranzitore, është demokraci e vërtetë dhe e plotë për masat e popullit. Gjatë diktaturës së proletariatit vetëm për armiqtë e klasës nuk ka demokraci. Shteti i demokracisë popullore është armë në duart e klasës punëtore për të shtypur armiqtë e klasës. Por ky shtet duhet të udhëhiqet nga partia marksiste-leniniste. Prandaj, si konkluzion, del se kush është kundër idesë së mbështetjes të masat, ai është reaksionar, borgjez i maskuar, është njëkohësisht edhe kundër vijës sonë.

Partia jonë, qysh me lindjen e saj, ka ecur dhe kurdoherë ecën e vendosur në rrugën e vijës së masave dhe të mbështetjes së plotë tek ato. Këtë vijë ne duhet dhe vazhdimisht po e perfeksionojmë. Sidomos, pas botimit të Letrës së Hapur të Komitetit Qendror të Partisë, u ngritën në këmbë popull dhe komunistë, kapërcyen vështirësi të mëdha dhe arritën një tok suksesesh. Punimet e Kongresit të 5-të e kanë revolucionarizuar në një nivel edhe më të lartë cilësor jetën e Partisë dhe të popullit shqiptar. Revolucionin ynë ecën gjithnjë përpara me vrull të pandalshëm. Hovi i madh revolucionar, kurdoherë në ngritje, që ka shpërthyer në vendin tonë, dëshmon për gjendjen e shëndoshë revolucionare të ne dhe për vijën e drejtë të Partisë që po thellohet çdo ditë e më shumë dhe që është bërë, si asnjëherë tjetër, mish e gjak i popullit tonë. Lëvizjet dhe iniciativat e shumta revolucionare, që kanë lindur gjatë kohëve të fundit, janë rezultat i punës së pandërprerë që ka bërë dhe bën

vazhdimisht Partia jonë për kalitjen e ndërgjegjes komuniste të punonjësve. Deklarata e Komitetit Qendror të Partisë dhe e Këshillit të Ministrave u bëri vlerësimin e duhur luftës së papërkulur për ruajtjen e fitoreve të arritura dhe gjithë këtyre lëvizjeve e iniciativave të mrekullueshme, që do të ndihmojnë për revolucionarizimin e mëtejshëm të punës për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë. Probleme të tilla të mëdha e jetike, si: lufta për emancipimin e gruas, lufta kundër fesë dhe zakoneve prapanike etj., që përpara mund të mos ishin edhe aq të lehta për t'u trajtuar në atë shkallë si tani, në sajë të punës me perspektivë që ka bërë vazhdimisht Partia, porsa u shtruan, gjetën mbështetjen e plotë nga masat e gjera të popullit, që ishin të gatshme, si kurrë ndonjëherë, për zbatimin e vijës së Partisë. Uniteti i çeliktë Parti-popull përbën garancinë e fitoreve tona në të ardhmen. Tani njerëzit tanë nuk ndalen më në rrugën e filluar. Dita-ditës ne shikojmë se si po ngjitet gjithnjë, lart e më lart, revolucioni në vendin tonë, se në ç'shikallë të gjerë marrin pjesë në të masat e popullit të udhëhequra nga Partia.

Për sa i përket zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare është e tepërt të zgjatem, sepse ju jeni plotësisht në dijeni të situatave nëpërmjet materialeve që boton vazhdimisht organi i Komitetit Qendror të Partisë, «Zëri i popullit». Ky organ ka pasqyruar çdo ditë zhvillimin e ngjarjeve ushtarake dhe politike që kanë ndodhur kohët e fundit në Lindjen e Afërt, ku imperialistët amerikanë dhe anglezë, si kurdoherë, edhe kësaj radhe, e përdorën Izraelin si kobure

për të sulmuar popujt arabë. Në këtë vepër agresioni ata u përkrahën edhe nga revizionistët sovjetikë.

Agresorët imperialisto-izraelitë, për arsye të regjimeve që janë sot në fuqi në shtetet arabe, gjetën në to ushtri të dobëta. Këto ushtri janë ushtri klikash, të destinuara për të shtypur popujt, për të bërë puçe pallatesh, për të sjellë në fuqi një grup e për të përmbysur një tjetër. Kuadrot e këtyre ushtrive, që janë bij të pashallarëve, të agallarëve, të kapitalistëve, kanë studiuar dhe janë edukuar ose në shkollat ushtarake jashtë shtetit, ose janë përgatitur brenda vendeve të tyre nga instruktorë të vendeve të mëdha kapitaliste, si anglezë e të tjerë. Këtyre shteteve edhe armatimet u janë dhënë sipas interesave të imperialistëve të ndryshëm. Të gjitha këto bënë të ndodhnin ato që dini: brenda një dite 700 tanke mbetën në rërë, 400 avionë u prishën nëpër aerodromet dhe pjesa dërrmuese nga të 140 000 ushtarët që ishin përqendruar në Sinai, ua mbathi këmbëve. Kjo që ngjau ishte një fatkeqësi e rëndë për vendet arabe, por, njëkohësisht, edhe një mësim i madh për to. Megjithëkëtë, udhëheqjet borgjeze të vendeve arabe, edhe në të ardhmen, mbështetjen do ta kenë kurdoherë po të këta kuadro, por tani, natyrisht, kjo do të evoluojë, sepse ata kanë frikë nga populli.

Ajo që ka rëndësi është se, gjatë këtyre ngjarjeve, revizionistët sovjetikë u demaskuan plotësisht, për faktin se Kosigini, qysh më parë, e kishte «siguruar» Naserin që Izraeli nuk do t'i sulmonte vendet arabe, por edhe sikur të vendoste t'i sulmonte, atëherë sovjetikët do të ndërhyjnë menjëherë për t'u dhënë «ndih-

më». Edhe Xhonsoni, nga ana e vet, bëri mbi këto vende presion, duke e paralajmëruar Naserin që, në qoftë se do të sulmohej Izraeli, amerikanët do të merrnin masa të rënda etj., etj. Udhëheqjet e vendeve arabe «shfajësohen» duke thënë se u gënjen dhe e fjetën mendjen mbasi kishin gjoja besim te «miku» që i la në baltë e i tradhtoi. Dhe fakt është se, pikërisht në kohën kur po u bëheshin këto presione e u jepeshin «sigurime» nga sovjetikët e amerikanët, Izraeli e goditi dhe e shpartalloi Egjiptin.

Natyrisht, ne e kemi pasur kurdoherë të qartë ç'janë revizionistët sovjetikë, po gjatë këtyre ngjarjeve u bë e qartë edhe një herë, për të gjithë, se ata janë kapitullantë, tradhtarë dhe bashkëpunëtorë të imperializmit amerikan. Tani, për të mbuluar tradhtinë e tyre ndaj vendeve arabe, revizionistët sovjetikë do të përpiqen të bëjnë një fushatë të madhe politike demagogjike në OKB. Pikërisht, për këtë qëllim, Kosisini do të vejë nesër në SHBA. Flitet se atje do të shkojnë edhe Titoja e krerë të tjerë revizionistë. Të gjithë mund të bëjnë zhurmë se kush duhet të tërhiqet dhe sa kilometra, sa do të marrë njëri, sa do të japë tjetri etj., etj., por, tani për tani, nuk ka më rrezik për luftë, për arsye se shtetet arabe nuk janë në gjendje të hyjnë përsëri në luftë. Akoma në këto shtete revizionistët sovjetikë janë në ambientin e vet, po një gjë ka rëndësi, që tashmë ata janë diskredituar, e kanë humbur kredinë që kishin gjer pak më parë në vendet arabe.

Jo vetëm popujt, por edhe zyrtarë të vendeve arabe kanë një simpati të madhe për vendin tonë, të

cilën e shprehin në çdo rast. Edhe ne kemi simpati për popujt arabë dhe, si gjer tani, do të vazhdojmë edhe në të ardhmen ta mbrojmë luftën e drejtë të tyre, duke demaskuar imperializmin gjakatar e provokator amerikan dhe revizionizmin sovjetik.

Nga këto situata, neve na krijohen edhe ca vështirësi për arsye të mbylljes së kanalit të Suezit, i cili përkohësisht është i bllokuar dhe mund të vazhdojë të qëndrojë kështu edhe për një kohë. Kjo kohë nuk do të përcaktohet nga pastrimi i kanalit (gjatë ditëve të agresionit në kanal u mbytën disa vaporë, që fundi i fundit mund të hiqen kollaj), por nga përfundimi i tratativave, sepse egjiptianët kanë deklaruar që kanalin nuk do ta hapin në rast se nuk largohen forcat izraelite. Si do të vejë puna, do ta shikojmë, por, gjersa gjendja të vazhdojë kështu, do të kemi vështirësi në transportimin e materialeve tona të nevojshme, se vaporët do të jenë të detyruar t'i bien rreth Afrikës, gjë që zgjat 17 deri 18 ditë më shumë se rruga e zakonshme. Natyrisht, ne do ta marrim parasysh këtë vështirësi, që do të na shërbejë edhe si një kalitje tjetër për përgatitjen tonë. Dhe përgatitja duhet të konsistojë në atë që Partia dhe populli ynë të jenë plotësisht të mobilizuar politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. E theksoj këtë, se nuk është çështja vetëm te kanali i Suezit. Gjërat duhet t'i shohim realisht e me kujdes dhe të jemi kurdoherë vigjilentë e të përgatitur, se imperializmi amerikan dhe revizionistët hrushovianë mund të bëjnë gjithçka kundër vendit tonë.

Të mobilizojmë të gjitha forcat për kryerjen

e punëve në bujqësi. Gruri të futet sa më parë brenda dhe tokat të punohen sa më shpejt që të mbillet menjëherë misri hamullor. Kulturave bujqësore t'u bëhen deri në fund të gjitha shërbimet.

Edhe punonjësit e industrisë të mobilizohen dhe ta kuptojnë drejt situatën. Mund të qëllojë që ndonjë ndërmarrjeje t'i mungojë çeliku për një ose dy muaj, prandaj kudo të punohet me ekonomi, të shfrytëzohet çdo material, të mobilizohen të gjitha mundësitë e brendshme, të bëhet çdo gjë e mundur që të mos ulet prodhimi. Nga ana tjetër, edhe nga tregtia e jashtme të bëhen të gjitha përpjekjet që gjithçka e nevojshme të na vijë në kohë, në mënyrë që planin ta realizojmë si duhet.

Mbi të gjitha të mos harrojmë detyrën e përgatitjes ushtarake. Në këtë drejtim duhet të merren masa serioze, si nga komanda, ashtu edhe nga komitetet e Partisë të rretheve. Ju, shokët e ushtrisë, në radhë të parë, duhet të jeni vetë në rregull. Kur caktohet për t'u bërë një stërvitje ushtarake, të gjithë ushtarakët të jenë në këmbë, që asnjë minutë të mos humbë nga ana e tyre. Ata duhet të jenë të përpiktë, shembullorë dhe të disiplinuar në këtë punë. Me të njëjtin seriozitet ta marrin këtë çështje edhe shokët e rretheve dhe të mos ndodhë që, për shkak të të korrave, të lihet pas dore kjo detyrë shumë e rëndësishme, mbasi është një punë që nuk pret. Prandaj edhe të lashtat të korren, edhe stërvitjet ushtarake të bëhen medoemos, sepse nesër, po të ngjasë gjë, kur je i përgatitur, nuk të trembet syri, ashtu sikurse nuk na është trembur.

Kaq kisha për të thënë lidhur me këtë çështje. Të gjithë ju, shokë, i kuptoni detyrat e rëndësishme që na dalin përpara, prandaj Partinë dhe popullin t'i mbajmë kurdoherë të mobilizuar.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Plenu-
mit të 2-të të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

GJYKATËSIT TË ZBATOJNË DREJT DHE NGA POZITAT E PARTISË FRYMËN E LIGJIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor të RPSH¹*

20 qershor 1967

Kisha një mendim për pikën e parë dhe të dytë të rendit të ditës, që na paraqiten për shqyrtim, domethënë për ndryshimet që propozohen të bëhen në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Penal. Mos do të ishte më mirë që këto ndryshime të mos bëhen tani, por të presim që të rishikohen një herë e mirë të dy kodet? A nuk është më mirë kështu, sesa të veprojmë duke ndryshuar herë këtë nen e herë atë tjetrin?

Këto norma, të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin Penal, janë rrjedhim i domosdoshëm i parimeve të pranuar prej nesh, prandaj, që të zbatohen mirë këto parime, duhet të zba-

1 Në pikën e parë dhe të dytë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua për projektdekrete «Mbi disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile» dhe «Mbi ndryshimin e nenit 174 të Kodit Penal».

tohen pa asnjë lëshim edhe normat ligjore ku ato konkretizohen. Në qoftë se ndryshojmë disa dispozita, pa rishikuar edhe të tjerat, atëherë do të detyrohemi të bëjmë disa ndryshime të reja, që do të na diktohen nga rishikimi i këtyre kodeve. Në qoftë se na duket që disa dispozita janë të tepërta e formale, dakord, t'i rishikojmë, por me kujdes që të dihen sa dhe cilat dispozita janë të tepërta. Kështu, për shembull, zgjidhja e mosmarrëveshjeve civile midis palëve me pajtim, përveç gjykatës, bëhet edhe me ndërhyrjen e organizatave të masave në rrugë të tjera. Por edhe këtë pajtim jashtëgjyqësor duhet ta parashikojë Kodi i Procedurës Civile? Kjo duhet parë. Si thua ti, shoku Aranit?

*SHOKU ARANIT ÇELA*¹: Po kështu kemi edhe çështjen e pjesëtimit të pasurisë, që, për shkak të ligjit procedural, na duhet ta bëjmë gjykimin me dy faza.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështjet e procedurës duhen parë në varësi nga e drejta materiale, nga parimet që janë pranuar në fushën e së drejtës. Procedura është ligj, prandaj duhet t'u përgjigjet parimeve të së drejtës sonë. Kështu, për shembull, mund të studihet si të trajtohet e drejta e pronësisë, që të bëhet procedura e përshtatshme për të. Pra, nuk kemi si ta ndryshojmë procedurën mbi gjykimin e pjesëtimit të pasurisë kur ligji material, domethënë Kodi Civil mbetet ai që është.

Është e nevojshme të shikohet, gjithashtu, çështja e lejimit të provës me dëshmitarë. Dëshmitarët, që ka-

¹ Kryetar i Gjykatës së Lartë të RPSSH.

në dijëni për fakte që kanë parë e dëgjuar, të vijnë në gjyq për të dëshmuar të vërtetën. Procedura të mos vërë kufizime për dëgjimin e mendimeve të dëshmitarëve. Gjykatësit të popullit nuk mund t'i ndalohet të pyesë shtetasit rreth atyre fakteve që i interesojnë për gjykimin e çështjes.

SHOKU ARANIT ÇELA: Procedura e sotme i ndalon dëshmitarët në shkallë të dytë dhe pranon vetëm dokumente.

SHOKU ENVER HOXHA: Pikërisht këto çështje duhet të shikohen në esencë. Prandaj nuk mund t'i shkëputim këto probleme pa i bërë një rishikim të përgjithshëm Kodit të Procedurës Civile. Ne jemi për atë që gjykatat të forcojnë punën e tyre, që gjyqtarët të mos jenë burokratë në drejtimin e seancës, por të shkathët, të mos jenë automatë e teknokratë në interpretimin e ligjit, por të thellohen me ndër-gjegje për të zbatuar drejt dhe nga pozitat e Partisë frymën e ligjit. Për shembull, në çështjen e pajtimit të palëve, ata të mos mbajnë qëndrim formal, sa për ta pasqyruar në procesverbalin gjyqsor «tentativën për pajtim», por të përpiqen që pajtimi të arrihet efektivisht.

Për sa i përket çështjes së dytë, për ndryshimin e nenit 174 të Kodit Penal¹, këtu ka një çështje të madhe parimore, që duhet ta shikojmë. Ne e kemi pranuar të drejtën e shkurorëzimit, por, në fakt, në shumë raste, shtetasit nuk e përdorin këtë të drejtë.

¹ Neni 174 i Kodit Penal të RPSH bënte fjalë për dënimin e bashkëjetesës së ndaluar.

Kur njëri bashkëshort, burri apo gruaja, nuk dëshiron të bashkëjetojë me bashkëshortin tjetër dhe veçohet prej tij, në këtë rast familja është prishur. Është e drejtë që në një rast të tillë gjykata ta refuzojë padinë e shkurorëzimit? Nuk është e drejtë, se s'ka kuptim të mbahet më këmbë juridikisht një martesë e vdekur. Atëherë, në qoftë se është kështu, gjykata, pasi të ketë bërë të gjitha përpjekjet për t'i pajtuar bashkëshortët dhe është bindur se pajtimi është i pamundur, le të vendosë shkurorëzimin. Në qoftë se gjykata nuk vendos shkurorëzimin, ky vendim i saj nuk është i drejtë, sepse e detyron shtetasin të qëndrojë i lidhur me një bashkëshort me të cilin ai, faktikisht, nuk bashkëjeton prej një kohe të gjatë.

Pra, të mos shikojmë vetëm njërën anë të problemit, domethënë, faktin se burri bashkëjeton si bashkëshort me një grua tjetër pa u vendosur shkurorëzimi me bashkëshorten e tij të ligjshme dhe ta dënojmë për këtë veprim, por të kemi kujdes që të mos bëhemi ne shkaktarë me qëndrimin e padrejtë në gjykimin e shkurorëzimeve.

Derisa nuk ekziston harmonia në marrëdhëniet bashkëshortore, derisa bashkëshortët nuk bashkëjetojnë prej shumë vjetësh, gjykata duhet të vendosë shkurorëzimin.

Në qoftë se një person i martuar shkurorëzohet dhe lidh martesë me një tjetër, këtu nuk ka vend për përgjegjësi penale, por kur një burrë ka gruan e ligjshme dhe, pa iu drejtuar gjykatës me padi shkurorëzimi, bashkëjeton si bashkëshort me një grua

tjetër, duhet dënua penalisht, sepse kjo është shfaqje e bigamisë, që ligji ynë duhet ta dënojë.

SHOKU ARANIT ÇELA: Kur burri e ka gruan e parë të pashkurorëzuar dhe mban edhe një grua të dytë, në këtë rast ne luftojmë që të dënohet.

SHOKU ENVER HOXHA: Në qoftë se burri e ka ngritur padinë për shkurorëzim, por nuk është shkurorëzuar dhe nuk bashkëjeton më prej vitesh me gruan e ligjshme, kjo çështje duhet shikuar me kujdes që ai të mos dënohet. Në rast se burri nuk e ka ngritur fare padinë për shkurorëzim dhe megjithëkëtë bashkëjeton si bashkëshort me një tjetër, atëherë ai meriton të dënohet.

Kur burri ngre padinë e shkurorëzimit në gjykatë dhe gjykata i refuzon padinë, ai nuk do të rrijë pa u martuar me një tjetër, vetëm pse gjykata mendon që duhet të vazhdojë të dojë gruan e ligjshme! Kur burri, edhe pas refuzimit të padisë nuk pajtohet me gruan, se nuk ka më asnjë afeksion për të, ai, edhe pse merr një grua tjetër, nuk mund të dënohet penalisht. Ky problem duhet kuptuar parimisht. Nuk mund të detyrohet burri të rrijë tërë jetën pa u shkurorëzuar dhe pa u martuar, duke e kanosur me burg po që se bashkëjeton me një grua tjetër. E drejta e shkurorëzimit nuk mund t'u hiqet shtetasve.

Duhet bërë të gjitha përpjekjet që bashkëshortët të pajtohen. Në qoftë se nuk arrihet pajtimi, atëherë të bëhet shkurorëzimi dhe jo të arrihet në një gjendje të atillë që, ndërsa gjykata, formalisht, nuk e vendos shkurorëzimin, burri të bashkëjetojë

si bashkëshort me një grua tjetër. Është delikate kjo çështje, prandaj, mendoj që ky projekt të shikohet edhe një herë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor
të RPSH që gjendet në AQP*

REVIZIONISTËT SOVJETIKË — ZJARRFIKËSIT NDERKOMBËTARË TË REVOLUCIONIT DHE TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE TË POPUJVE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

21 qershor 1967

Valët e stuhisë antiamerikane po ngrihen tani gjithnjë e më lart në të gjitha kontinentet e botës. Popujt e Vietnamit e të Kongos, të Laosit e të Angolës, të Mozambikut e të Venezuelës, popujt e vendeve arabe e të Bolivisë, të revoltuar nga politika agresive e skllavëruese e imperializmit amerikan dhe e shërbëtorëve të tij, po zhvillojnë një luftë heroike revolucionare për lirinë dhe pavarësinë, për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror. Me gjithë epërsinë në armatime të armikut, me gjithë intrigat djallëzore të imperializmit dhe tradhtinë e revizionistëve, guximi dhe trimëria e popujve kryengritës janë të pamposhtshme, vendosmëria për të luftuar deri në fund dhe për të fituar është e pathyeshme. Duke dashur të rrethojë popujt dhe të vendosë kudo me dhunë skllavërinë e tij, imperializmi amerikan u fut vetë në

rrethimin e zjarhtë të revolucioneve e të luftërave çlirimtare, flakët e të cilave po e djegin dhe po e zhuritin.

Dikur kontinenti latino-amerikan quhej me mburrje nga Uashingtoni si një «prapavijë e sigurt» e tij. Por tani kohët kanë ndryshuar. Amerika Latine është shndërruar në një nga qendrat e stuhive revolucionare, ku imperialistët amerikanë dhe veglat e tyre po marrin goditje të rënda e të drejtpërdrejta.

Të zemëruar dhe të revoltuar nga politika luftënxitëse dhe skllavëruese e imperialistëve janki, nga shtypja dhe nga shfrytëzimi i tyre i dyfishtë, popujt e këtij kontinenti janë hedhur në beteja klasore, në luftë për çlirim kombëtar e shoqëror. Lëvizja anti-imperialiste, kundër klikave reaksionare në fuqi, ka përfshirë tani, në një mënyrë apo në një tjetër, gati të gjitha vendet e Amerikës Latine.

Cila është gjendja aktuale në këtë kontinent? Në Bolivi, në Kolombi, në Guatemalë, në Venezuelë, në Peru, në Nikaragua, në Republikën Dominikane etj. ka shpërthyer, në forma dhe në shkallë të ndryshme, lufta e armatosur kundër imperializmit amerikan dhe veglave të tij. Dhunës kundërrevolucionare popujt e këtij kontinenti po i përgjigjen me dhunë revolucionare. Lufta e armatosur nacionalçlirimtare e popullit bolivian ka marrë përpjesëtime të gjera. Qeveria reaksionare e Barientosit, e ndihmuar dhe e përkrahur nga imperializmi amerikan, shpalli para pak kohësh gjendjen e jashtëzakonshme, ndërmoi kundër zonave të çliruara nga forcat partizane operacione ndëshkimore, kërkoi bile edhe ndihmë nga juntat ushtarake të Ar-

gjentinës e të Brazilit. Por forca e luftës popullore të masave i hodhi në erë planet e reaksionit bolivian për të mposhtur lëvizjen çlirimtare. Aksionet luftare të gerriljeros-ve (partizanëve) bolivianë janë shtrirë tani edhe në krahinat e Santa Kruzit, Shukusakas etj.

Flakët e luftës popullore për çlirim kombëtar e shoqëror janë përhapur anekënd Kolombisë, në zonat që zënë rreth 100 mijë kilometra. Në përlëshjet e ashpra të zhvilluara në rajonet e Guayanteros, Bajo Patos, Medio Patos, në departamentin e Huiles, në krahinën e Santanderit etj., «ekspeditat» e organizuara nga klika sunduese vendase, me pjesëmarrjen e dhjetëra mijë ushtarëve të pajisur me armë moderne, kanë pësuar humbje të rënda. Ushtria e Çlirimit Kombëtar të Kolombisë (ELN) ka rritur dhe ka forcuar radhët e saj. Me vendosmërinë, me guximin dhe me heroizmin e tyre luftëtarët kolombianë po tregojnë se nuk janë armët moderne, por është ndërgjegjja revolucionare e popullit ajo që, në fund të fundit, vendos fatin e luftës.

Vrull të fuqishëm ka marrë lëvizja partizane, nacionalçlirimtare, edhe në Peru, në Venezuelë, në Nikaragua, në Guatemalë etj. Në malet El Baciler, 160 km larg Karakasit, muajt e fundit janë zhvilluar luftime të ashpra midis forcave çlirimtare dhe njësisve të ushtrisë e të policisë venezuelase. Një mijë «bereta të blerta» (njësi amerikane të përgatitura posaçërisht për luftën antipartizane), përveç mijëra ushtarëve guatemalas, gjatë prillit dhe majit, u hodhën në luftime të ashpra kundër forcave nacionalçlirimtare, që veprojnë në rajonin Jones dhe El Progresos.

Një luftë të vendosur dhe të guximshme kundër ndërhyrjes së imperializmit amerikan dhe shtypjes së reaksionit të brendshëm bëjnë revolucionarët brazilianë, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Brazilit.

Para dy vjetësh, për të shtypur kryengritjen e armatosur të popullit dominikan, qeveria amerikane dërgoi në këtë vend të vogël 30 mijë mërins. Për një kohë u duk sikur këtu «u vendos qetësia». Por popujt nuk përkulen lehtë. Sigurisht, procesi revolucionar nuk zhvillohet në rrugë të drejtë. Ai ka zigzaget e tij, kalon përmes sulmesh e tërheqjesh, me sukseset e disfatat e tij të përkohshme. Nga dështimet e përkohshme revolucionarët nuk dekurajohen, nuk i lëshojnë armët. Përkundrazi, ata nxjerrin konkluzionet dhe mësimet e nevojshme, rigrupojnë forcat për t'u hedhur në aksione të reja. Kështu po ndodh edhe tani në Republikën Dominikane. Në shumë rajone të vendit shkëndijat e luftës çlirimtare popullore janë ndezur përsëri. Popujt e këtij kontinenti, ashtu siç thuhet edhe në një deklaratë të Partisë Komuniste të Bolivisë, shohin se «në konditat e krijuara e vetmja rrugë për çlirim është zhvillimi i revolucionit nëpërmjet luftës së armatosur».

Në Amerikën Latine, ashtu si kudo ku mbi popujt rëndojnë shtypja dhe shfrytëzimi kapitalist, çështja shtrohet kështu: A duhen luftuar me të gjitha format dhe mjetet imperializmi dhe oligarkia vendase, apo duhet kapitulluar para tyre? Ky është një kufi që ndan forcat revolucionare nga ato kundërrevolucionare. Por ç'qëndrim mbajnë udhëheqësit revizionistë ndaj kësaj ngritjeje të fuqishme revolucionare të

popujve të Amerikës Latine, ndaj këtij zgjerimi të madh të luftës çlirimtare e antiimperialiste? Ata kanë marrë përsipër rolin e turpshëm të zjarrfikësit kundërrevolucionar, të sabotatorit dhe të bashkëpunëtorit të SHBA-së, për të shuar zjarrin që i është vënë kështjellës së tronditur neokolonialiste të imperializmit amerikan në Amerikën Latine.

Revizionistët hrushovianë kanë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillojnë veprimtarinë e tyre përçarëse në lëvizjen komuniste të Amerikës Latine. Me parullat e tij të «kalimit paqësor» dhe të «bashkekzistencës paqësore», «për ruajtjen e paqes me çdo kusht» dhe «kryerjen e transformimeve shoqërore demokratike», grupi tradhtar Brezhnjev-Kosigin kërkon ta futë lëvizjen çlirimtare në Amerikën Latine në binarët e pacifizmit socialdemokrat, të bashkëpunimit klasor. Ai bën thirrje të hapëta për bashkëpunim dhe aleancë me këdo: me socialdemokratët, kristiandemokratët, radikalët, peronistët, mjafton që t'i shërbejnë «bashkekzistencës paqësore», aq shumë të reklamuar prej tyre, t'i shërbejnë shuarjes së zjarreve të luftërave çlirimtare, atje ku kanë shpërthyer. Amerikën Latine udhëheqësit revizionistë sovjetikë e shikojnë si një zonë influence të pakontestueshme të imperializmit amerikan, prandaj edhe luftën çlirimtare në këtë kontinent e shikojnë si një gjë të dëmshme, që cenon «të drejtat» e SHBA-së, që prish raportin e forcave dhe qëllimet e përbashkëta të të dy fuqive të mëdha.

Klika drejtuese e Bashkimit Sovjetik, ndërsa tradhton interesat e popujve të Amerikës Latine, është bashkuar hapur me regjimet kukulla proamerikane

të këtyre vendeve. Po rritet e po forcohet bashkëpunimi i gjithanshëm midis oligarkisë së vendeve latino-amerikane dhe borgjezisë së re sovjetike. Ato po përpiqen të zhdukin çdo pengesë për qarkullimin e lirë të kapitaleve, të mallrave, të ideve etj. Përfaqësuesi sovjetik në OKB, Fedorenko, në një intervistë që i dha në muajin prill korrespondentit të agjencisë italiane të lajmeve, ANSA, deklaroi se «Bashkimi Sovjetik mund të ndihmojë në forcimin e ekonomisë së vendeve latino-amerikane, si dhe në zgjerimin e tregjeve të tyre». Me një fjalë, ai la të kuptohet se udhëheqësit revizionistë sovjetikë janë të gatshëm të forcojnë pozitat e diktaturave fashiste, si të Barientosit, të Onganias etj., ose duke i ndihmuar me kapitalet e tyre, ose duke hapur dyert e tregjeve sovjetike për tregtarët amerikano-latinë. Udhëheqja revizioniste sovjetike ka kohë që po tregohet «bujare» në këtë drejtim. Në gusht të vitit të kaluar ajo i akordoi regjimit diktatorial fashist brazilian një hua me afat të gjatë, që arrinte shumë prej 100 milionë dollarësh amerikanë. Ndërsa gjatë këtij viti, ajo ka nënshkruar marrëveshje tregtare-ekonomike me shumë vende të tjera, si me Kolombinë, me Kilin, me Argjentinën etj. «Marrëveshjet me Bashkimin Sovjetik, — shkruante revista kolombiane «Apuntes ekonomikos», — janë një nevojë esenciale. Ato janë drejtuar në forcimin e sovranitetit të Kolombisë, në mbrojtjen e të cilit ka dalë qeveria». Ja, pra, revizionistët sovjetikë dalin me vepra si mbrojtës dhe forcues të pozitave të regjimeve antipopullore, që po lëkunden nga vrulli i lëvizjeve çlirimtare, ata dalin në rolin e zjarrfikësve të luftë-

rave të popujve për liri të vërtetë, çlirim kombëtar dhe shoqëror.

Rolin e zjarrfikësve ndërkombëtarë të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve revizionistët sovjetikë nuk e luajnë vetëm në Amerikën Latine. Si të tillë, bile edhe më keq, ata veprojnë në Kubë e në Vietnam, në Indonezi e në Pakistan, në Evropë e në Afrikë.

Klika e Brezhnjevitet dhe e Kosiginit tundet e shkundet si mbrojtëse e vendosur e revolucionit kuban, hiqet sikur kundërshton orvatjet e imperializmit amerikan për ndërhyrjen e armatosur në Kubë etj. Por cila është e vërteta? Udhëheqësit e rinj të Kremlinit janë trashëgimtarë dhe zbatues konsekuentë të politikës kapitulluese kubane të Nikita Hrushovit. Qëllimi i parë dhe i fundit i marrëdhënieve të tyre me Kubën është nënshtrimi i saj vijës së bashkëpunimit sovjetiko-amerikan dhe kthimi në një bazë dhe urë të politikës revizioniste sovjetike në kontinentin latino-amerikan. Tanimë është bërë fare e qartë se aventura e dërgimit të raketave në Kubë nuk synonte aspak ta mbronte atë nga sulmet amerikane, por ishte një blufë e ulët e Hrushovit, i cili, siç doli edhe nga marrëveshjet e tij me Kenedin, drejtohej që në fillim jo kundër Amerikës, por kundër vetë Kubës.

Qëllimet e revizionistëve hrushovianë në kurdisjen e çështjes së raketave ishin mjaft të përcaktuara dhe precize: Në radhë të parë, duke krijuar një situatë në pamje të rëndë e të komplikuar, ata kërkonin ta vinin Kubën nën zgjedhën e tyre dhe, me anën e presionit të ndihmave ekonomike, t'i diktonin asaj poli-

tikën e vet kapitulluese. Në radhë të dytë, ata synonin t'i impononin Kubës ujdinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, domethënë t'i impononin bashkekzistencën e saj me imperializmin amerikan, kapitullimin e saj përpara Amerikës, heqjen dorë përfundimisht nga revolucioni. Me një fjalë, ata kërkonin që Kuba të mos ishte më një rrezik për Amerikën.

Përveç këtyre, revizionistët sovjetikë donin të krijonin një gjendje në të cilën Kuba të ishte e detyruar t'i ndiqte ata si në politikë, ashtu edhe në ideologji, të hiqte dorë nga predikimi i luftërave të armatosura revolucionare, që edhe Partia e saj Komuniste të radhitej me partitë e tjera revizioniste të Amerikës Latine në rrugën hrushoviane kapitulluese, oportuniste, antirevolucionare e antimarksiste, që kishte filluar të zbatohej me vrull në Bashkimin Sovjetik pas kongreseve të 20-të e të 22-të.

Në vijim të këtij plani të pabesë e monstruoz, revizionistët hrushovianë donin, më në fund, që Kuba të kthehej në një trampolin të tyre për ndërhyrje në Amerikën Latine. Kjo ndërhyrje, siç u provua edhe nga ngjarjet e mëvonshme, ishte e koordinuar dhe e aprovuar nga SHBA, pra edhe u lejua nga qarqet më të larta të Uashingtonit.

Në këto kushte, është krejt e natyrshme dhe e kuptueshme që Kuba, herët ose vonë, do t'i kuptojë këto dredhi, nuk do t'i pranojë të gjitha këto diktate sovjetike dhe do të rebelojë kundër tyre. Sigurisht, rebelimi i saj do të pësojë nga karakteristikat dhe natyra e pikëpamjeve të lëkundshme dhe anarkiste të udhëheqjes së saj, por, sidoqoftë, ai është një re-

belim, megjithëse në fillim i heshtur. Nesër ky rebelim ose do të shpërthejë me gjithë forcën, ose do t'i nënshtrohet diktatit sovjetik dhe do të shuhet fare. Rrugë tjetër nuk ka. Nuk mund të ketë as «forcë të tretë», siç dëshironin revizionistët sovjetikë, kur mendonin ta përdornin Kubën për t'u nxjerrë gështenjat nga zjarri në Amerikën Latine.

Vështirësitë që u kanë dalë revizionistëve sovjetikë me Kubën, në lidhje me qëllimet dhe synimet e tyre në Amerikën Latine, shprehen qartë edhe në veprimtarinë e drejtpërdrejtë që pasardhësit e Hrushovit po zbatojnë tani në vendet e këtij kontinenti. Ata i janë futur vetë punës në dy drejtime: nga njëra anë, ata e ndihmojnë drejtpërdrejt borgjezinë reaksionare, që është në fuqi në Amerikën e Jugut për t'u forcuar dhe për të konsoliduar pozitat e saj; nga ana tjetër, u shkojnë në ndihmë partive komuniste revizioniste atje dhe, tok me ato, po luftojnë partitë e vërteta marksiste-leniniste të Amerikës Latine, revolucionarët dhe revolucionin në ato vende. Ja zjarrfikësit kundërrevolucionarë në veprim.

Të njëjtin qëndrim reaksionar, të njëjtën vijë kapitulluese e proimperialiste kanë zbatuar revizionistët sovjetikë edhe në Indonezi. Edhe këtu ata kanë vepruar e veprojnë si zjarrfikës të zellshëm të revolucionit, si sabotatorë të frontit antiimperialist të popujve të Azisë. Për një kohë mjaft të gjatë ata zhvilluan kundër Partisë Komuniste të Indonezisë, e cila mbronte lirinë e pavarësinë e vendit të saj dhe luftonte për ta shpëtuar atë nga neokolonializmi dhe ndërhyrja e huaj, një fushatë të tërbuar shpifëse e de-

nigruese, duke e akuzuar për «politikë sektare» «aventureske» etj. Klika hrushoviane e Bashkimit Sovjetik u mundua me të gjitha mjetet, duke ushtruar presione nga më të ndryshmet dhe duke përdorur shantazhet e kërcënimet më të ulëta ndaj udhëheqjes së Partisë Komuniste të Indonezisë, me qëllim që ta detyronte atë të ndryshonte qëndrimin e saj revolucionar, antiimperialist e antirevizionist, të tradhtonte interesat e popullit të saj dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ajo e kërcënoi hapur Partinë Komuniste të Indonezisë se, në qoftë se ajo nuk do të pranonte diktatin e saj, atëherë, udhëheqësit sovjetikë gjithë përkrahjen e tyre do t'ia jepnin partisë trockiste të Adam Malikut, ose do të orvateshin të krijonin një parti tjetër komuniste të tipit revizionist, të bindur ndaj Moskës.

Në rrugën e sabotimit, të goditjes dhe të shuarjes së revolucionit indonezian revizionistët sovjetikë shkuan edhe më tej, deri atje, sa u bënë ortakë me imperializmin amerikan për të përkrahur puçin e gjeneralëve të bardhë, të cilët vendosën regjimin fashist në Indonezi. Tani ata mbajnë marrëdhënie mjaft të përzemërta e miqësore me klikën fashiste Suharto-Nasution, që, nën flamurin e antikomunizmit më ekstrem, ka mbytur në gjak Indonezinë dhe e ka shndërruar atë në një bazë proimperialiste e antirevolucionare. Ata vazhdojnë t'i japin regjimit indonezian një ndihmë të konsiderueshme në armatime, duke i krijuar, sidomos, lehtësi të mëdha në furnizimin e pajisjeve dhe të pjesëve të këmbimit për ushtrinë. Ata u treguan jashtëzakonisht bujarë për t'i zgjatur regjimit

indonezian afatin e shlyerjes së huave prej rreth 1 miliard dollarësh dhe i ofruan atij kredi.

Të gjitha këto nuk kanë qëllim tjetër përveçse ta mbajnë në këmbë regjimin e tanishëm gjakatar indonezian, ta armatosin atë që të vrasë komunistët e njerëzit përparimtarë dhe të shuajë revolucionin.

Gjithnjë e më qartë po del roli i turpshëm i revizionistëve sovjetikë, si zjarrfikës kundërrevolucionarë në qëndrimin që ata mbajnë kundër luftës çlirimtare antiamerikane të popullit të Vietnamit. Këtu ata veprojnë pikërisht si ai hajduti që të vret natën dhe të qan ditën. Sa për sy e faqe, ata hiqen si miq të popullit të Vietnamit, hiqen sikur janë solidarë me të, bëjnë sikur e ndihmojnë, sikur u vjen keq për vuajtjet e tij etj., kurse në të vërtetë e sabotojnë me të dy duart luftën çlirimtare të popullit vietnamez, punojnë dhe dëshirojnë disfatën e tij, nënshtrimin ndaj imperializmit amerikan. Tanimë nuk është ndonjë sekret fakti që udhëheqësit sovjetikë bëjnë lloj-lloj presionesh mbi Republikën Demokratike të Vietnamit, që të braktisë vëllezërit e saj në Jug dhe të pranojë kushtet poshtëruese e skllavëruese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Diplomacia sovjetike është vënë e tëra në shërbim të planit famëkeq të Uashingtonit për «pushimin e luftës nëpërmjet ndalimit të bombardimeve». Moska është bërë qendra e bisedimeve të fshehta dhe e kompleteve imperialisto-revizioniste kundër Vietnamit. Atje shkojnë e bisedojnë për Vietnamin Harrimani e Uilsoni, Indira Gandhi e Titoja, Brauni dhe të dërguarit e papës së Romës, të gjithë ata që e ndihmojnë imperializmin amerikan

për të shpëtuar nga disfata e sigurt që e pret në xhunglat e Vietnamit. Dhe ata janë të gjithë të mirëpritur, dëgjohen me vëmendje dhe koordinohen planet e përbashkëta për të goditur pas shpine Vietnamin, hartohen manovra të reja për ta shtyrë Vietnamin në rrugën e kapitullimit, thuren intriga djallëzore për të shitur «bisedimet paqësore» të Xhonsnit. Dhe, ndërkaq, revizionistët thërresin për «unitet veprimi» për të ndihmuar Vietnamin për «front të përbashkët kundër imperializmit» etj. Ç'hipokrizi! E vetmja dëshirë e tyre, i vetmi qëllim i tyre është që ta futin zgjidhjen e çështjes së Vietnamit në kuadrin e bashkëpunimit sovjeto-amerikan për ndarjen e zonave të influencës dhe sundimin e botës nga dy fuqitë e mëdha.

Çdo qëndrim i udhëheqësve sovjetikë në lidhje me Vietnamin, çdo hap i tyre politik ose propagandistik shikohet nga ata në prizmin e miqësisë dhe të aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nën prizmin e asaj se sa i shërben ai forcimit të kësaj aleance të re të shenjtë, sa i shërben ai qëllimit të shuarjes së luftës çlirimtare të popullit vietnamez dhe popujve të tjerë. Prandaj, sado fjalë të bukura që të thonë, sado mashtrime të holla që të përdorin, qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë ndaj luftës çlirimtare të Vietnamit është një qëndrim kapitullues e proamerikan. Ai është një shfaqje e veprimtarisë së tyre zjarrfikëse kundërrevolucionare.

Po ku nuk kanë vepruar dhe ku nuk veprojnë revizionistët sovjetikë, si zjarrfikës të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare?

Për hir të bashkëpunimit me imperialistët amerikanë dhe të mosprishjes së qejfit me ta, ata votuan për dërgimin e trupave të OKB-së në Kongo, gjë që çoi në vrasjen e Lumumbës dhe mbytjen në gjak të revolucionit kongolez. Lufta heroike e popullit kongolez, i cili rrëmbeu armët për të shpëtuar nga zgjedha e vjetër dhe e re kolonialiste, i tronditi nga rrënjët politikën neokolonialiste të SHBA-së dhe vijën oportuniste të «bashkekzistencës paqësore» të revizionistëve hrushovianë. Kryengritja e Lumumbës, që u bë në qendër të Afrikës, ishte një shembull i madh i zgjimit të popujve të këtij kontinenti të skllavëruar, ishte një flakë, që ndizte zjarr zemrat e etura për liri e pavarësi të të gjithë popujve afrikanë, që ngjallte urrejtjen për shfrytëzimin imperialist dhe për çdo shtypje kombëtare e sociale. Por ajo cenonte marrëveshjet dhe politikën e afrimit e të bashkëpunimit sovjetoto-amerikan për ndarjen e zonave të influencës midis dy fuqive të mëdha.

Tani revizionistët sovjetikë mundohen me të gjitha mënyrat të përçajnë lëvizjet çlirimtare në vendet afrikane, nxitin fraksionizmin dhe këshillojnë paqtimin e kapitullimin përpara forcave kolonialiste e imperialiste. Ata mundohen kudo, nëpërmjet agjentëve të tyre, të ngjallin frymën disfatiste dhe të krijojnë mendimin se vendet afrikane nuk kanë ndonjë perspektivë për zhvillim të pavarur politik e ekonomik, se ato janë të destinuara për një kohë të gjatë të mbeten baza të lëndës së parë për ish-metropolet dhe sfera të investimeve të kapitalistëve perëndimorë. Nga ana tjetër, revizionistët sovjetikë nuk e fshehin

shpresën dhe nuk i maskojnë aspak orvatjet për të konkurruar edhe ata vetë në pushtimin kapitalist të tregjeve afrikane.

Udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik janë autorët e së ashtuquajturës frymë të Tashkentit. Kur India sulmoi Pakistanin, ata u bënë copë për të ndihmuar reaksionin indian dhe regjimin e tij të kalbur. Ata ndërhyjnë në mënyrë brutale dhe bënë çmos që Pakistanit t'i mohoheshin të drejtat e tij, që India të vazhdojë të mbajë të pushtuara territoret pakistaneze etj. Por, duke organizuar takimin e Tashkentit, revizionistët sovjetikë donin të krijonin një psikozë dhe një frymë të përgjithshme të heqjes dorë nga lufta për çlirimin kombëtar e shoqëror, të krijonin përshtypjen se konfliktet klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare mund të zgjidhen me anë bisedimesh e kompromisesh me armikun, se dy fuqitë e mëdha janë arbitra të mirë dhe duhen thirrur për gjykim kur lindin konflikte të ndryshme midis shteteve. Nuk është e rastit që «fryma e Tashkentit» përmendet shpesh nga propaganda amerikane, kur ajo mundohet të shesë «bisedimet paqësore» të Xhonsnit për luftën në Vietnam. «Fryma e Tashkentit» është, pra, fryma e zjarrfikësve kundërrevolucionarë sovjetikë në veprim.

Për të shuar çdo frymë revolucionare, për të kundërshtuar luftën klasore e socializmin, revizionistët hrushovianë u mblodhën në Karlovi-Vari. Vija që doli nga kjo mbledhje ishte vija për bashkëpunimin dhe integrimin me borgjezinë e madhe evropiane, vija e qetësimit pacifist në Evropë dhe e lënies së duarve të

lira imperializmit e reaksionit për të vepruar në Azi, Afrikë e në Amerikën Latine, për të shtypur atje përpjekjet dhe aspiratat e popujve për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Për të ruajtur statukuonë, zonat e tyre të influencës dhe për të vendosur sundimin e dy fuqive të mëdha, revizionistët sovjetikë, së bashku me imperializmin amerikan, manipulojnë OKB-në dhe marrin nëpër këmbë interesat jetikë të popujve të vegjël. Përse revizionistët sovjetikë kërkojnë me këmbëngulje të krijojnë «forcat ushtarake të Kombeve të Bashkuara»? Mos vallë për të mbrojtur popujt nga agresioni imperialist? Plani i krijimit të kësaj xhandarmërie ndërkombëtare synon pikërisht në atë që këto forca të përdoren nga SHBA-ja dhe Bashkimi Sovjetik, që e sundojnë OKB-në, për të shtypur revolucionet dhe luftërat çlirimtare të popujve, për të ndërhyrë kudo ku dy fuqitë e mëdha do ta shikojnë se u preken interesat e tyre, për të bërë shantazh e kërcënim kundër atyre shteteve që nuk pranojnë diktatet sovjeto-amerikane.

Revizionistët sovjetikë janë hequr si miq të ngushtë të popujve arabë, kishin bërë premtime se do t'i mbronin nga agresioni i huaj etj. Por tani që Izraeli, i përkrahur nga imperialistët, kreu agresionin kundër tyre, ata i tradhtuan dhe i lanë në baltë. U provua edhe një herë se ruajtja dhe forcimi i aleancës sovjeto-amerikane ishin për revizionistët sovjetikë shumë më të shtrenjtë nga parimet e larta të përkrahjes dhe të mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së popujve, të luftës që këta bëjnë kundër imperializmit e kolonia-

lizmit. U vërtetua se revizionistët sovjetikë donin të prishej uniteti arab, që bazohej mbi antiimperializmin, t'i jepej një goditje përgjithësisht lëvizjes çlirimtare në Afrikë, e cila shihte në vendet e lira arabe një shembull të mirë dhe i kishte baza e mbështetje. Ata i goditën pas shpine RAB-in, Sirinë e vendet e tjera arabe për të ngjallur në popujt, që janë ngritur në luftë kundër imperializmit, frymën e mosbesimit në të ardhmen e tyre, frikën përpara forcave të imperializmit, frymën e tërheqjes e të kapitullimit përpara armikut. Tani udhëheqësit sovjetikë mundohen që çështjet e konfliktit arabo-izraelit t'ia kalojnë për shqyrtim OKB-së. Kjo është një manovër tjetër për të marrë në duar, bashkë me imperializmin amerikan, interesat e lartë të popujve arabë, për të bërë pazarllëqe në kurriz të tyre, për të thyer frymën e tyre patriotike dhe të kundërshtimit të agresionit të huaj.

Ndaj agresionit imperialisto-izraelit kundër popujve arabë revizionistët mbajtën një qëndrim të hapët tradhtar e kapitullues dhe sado zhurmë demagogjike që të bëjnë për ta mbuluar këtë turp, ai do të mbetet një tjetër njollë e ndyrë në ndërgjegjen e tyre të shitur.

Një luftë të ulët, shoviniste, antimarksiste e antisocialiste zhvillojnë revizionistët sovjetikë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Ndaj vendit tonë ata ndoqën politikën e egër shoviniste imperialiste të shtetit të madh, grisën të gjitha marrëveshjet politike, ekonomike e ushtarake, ndoqën vijën e sabotimit të socializmit, të bllokadave ekonomike, të kompleteve e të provokacioneve. Por lufta që ata bëjnë kundër

nesh, kundër revolucionarëve dhe marksistë-leninistëve të vërtetë, është një luftë e dëshpëruar, e pashpresë dhe pa rrugëdalje. Popujt e botës po binden çdo ditë e më shumë nga vetë eksperiencia e tyre për rolin e ulët që revizionistët sovjetikë luajnë, si zjarrfikës ndërkombëtarë të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve. Ata e shohin se vija e revizionistëve hrushovianë synon në forcimin e aleancës së re midis tyre me imperializmin amerikan, për ndarjen e zonave të influencës, për vënien nën sundimin e dy fuqive të mëdha të të gjitha shteteve të botës. Ata janë bashkuar me imperializmin kundër socializmit, janë bashkuar me SHBA-në kundër popujve, janë bashkuar me gjithë reaksionarët kundër revolucionarëve, janë bashkuar me klikën e Titos dhe gjithë renegatët e klasës punëtore kundër marksizëm-leninizmit dhe partive e forcave që u qëndrojnë besnike atij dhe çështjes së revolucionit.

Tradhtia e poshtër që revizionistët sovjetikë u kanë bërë çështjes së revolucionit dhe të çlirimit kombëtar të popujve është e madhe. Ajo u ka sjellë dhe vazhdon t'u sjellë atyre dëme jo të vogla. Por, sado e madhe që të jetë veprimtaria kundërrevolucionare revizioniste, ajo është shumë e vogël dhe e pafuqishme në krahasim me valën gjigante të fuqisë dhe me vullnetin e popujve. Revolucionarët, të gjithë ata që luftojnë për lirinë e pavarësinë e vendeve të tyre, do të dinë me siguri të nxjerrin mësimë mjaft të vlefshme nga tradhtia dhe nga goditjet pas shpine që bëjnë revizionistët. Ata jo vetëm që do të zbulojnë fytyrën e vërtetë të revizionistëve sovjetikë, të këtyre miqve të

imperializmit dhe armiqve të revolucionit, por do të binden se, për të kundërshtuar me sukses imperia-
lizmin, është e domosdoshme të kundërshtohen po
me atë vendosmëri e po me atë patos dhe revizionistët
sovjetikë. Ky është një kusht i domosdoshëm për
fitoren e revolucionit, ashtu siç është një kusht i do-
mosdoshëm për ruajtjen dhe forcimin e lirisë e të pa-
varësisë kombëtare.

*Botuar për herë të parë
në gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 148 (5873), 21 qershor 1967*

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

NUK MUND TË THYHET NJË POPULL QË UDHËHIQET NGA MARKSIZËM-LENINIZMI

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike
të Vietnamit*

21 qershor 1967

Mbasi u përshëndet dhe zuri vend, ambasadori vietnamez foli mbi përshtypjet e tij të mira për Shqipërinë dhe i shprehu shokut Enver Hoxha mirënjohjen e partisë, të qeverisë dhe të popullit të Vietnamit ndaj Partisë, Qeverisë dhe popullit të vendit tonë për ndihmën dhe përkrahjen që i kanë dhënë luftës së popullit heroik të Vietnamit. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Ju faleminderit shumë, shoku ambasador, për këto fjalë kaq të ngrohta e miqësore, për këto ndjenja vëllazërore që shprehët në emrin e popullit tuaj, të Partisë së Punonjësve të Vietnamit dhe tuajin për Partinë dhe popullin tonë. Na vjen keq që do të largoheni nga Shqipëria, sepse kemi kaluar së bashku një kohë trevjeçare plot ngjarje, luftëra e suksese të rëndësishme, që kanë ndodhur në vendin tuaj dhe në vendin tonë. Por, siç e thatë dhe ju, ka edhe rrethana, të

cilat e lypin që miqtë dhe shokët të ndahen nga njëri-tjetri, por vetëm fizikisht, pasi lidhjet e dashurisë dhe të miqësisë që kanë, nuk i largojnë ata kurrë nga njëri-tjetri, sado larg që të jenë. Përkundrazi, lidhjet e kësaj miqësie të sinqertë, me kohë kthehen në një forcë të madhe që na shton besimin dhe fuqinë në luftën tonë të përbashkët.

Nga sa jemi në dijëni, lufta në vendin tuaj shkon mirë dhe ky është një gëzim i madh për ne.

Lufta e popullit heroik vietnamez është si një pishtar, që po i tregon gjithë botës, çdo ditë e më shumë, heroizmin e madh, vendosmërinë e palëkundshme të një populli të vogël, por të pamposhtur, i cili, pavarësisht nga sakrificat supreme, po i qëndron me sukses kuçedrës më të madhe dhe më të armatosur, imperializmit amerikan, po korr çdo ditë fitore mbi të. Gjithashtu, ajo i tregon botës se përpara kuçedrës, sado e tmerrshme që të jetë, një popull që është i bashkuar në unitet të çeliktë rreth partisë së tij, jo vetëm i bën ballë me sukses, por edhe i shkakton asaj dëme të pandreqshme.

Lufta që bën Vietnami heroik i tregon, gjithashtu, njerëzimit se një popull i vogël trim, siç është populli vietnamez, është në gjendje të qëndrojë, të godasë dhe të fitojë jo vetëm kundër kësaj force, por edhe kundër gjithë intrigantëve, kundër gjithë politikës djallëzore të komplotistëve, që përpiqen ta dobësojnë luftën heroike të popullit tuaj dhe ta detyrojnë Vietnamin të gjunjëzohet.

Lufta juaj, pra, po i tregon botës se në fushën e betejës, populli juaj është i pamposhtur. Ndodh

kështu sepse populli vietnamez, i Jugut dhe i Veriut, mban qëndrime të drejta. Kur një popull udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste ai nuk mund të thyhet, ashtu siç nuk mund të thyhen marksistët. Ne kemi bindjen se armiqtë imperialistë e tradhtarët e tjerë, në çfarëdo mënyre që ata të shfaqen, nën çfarëdo maske që të fshihen, nuk do ta mposhtin dot popullin vietnamez. Dhe pse është kështu, prandaj nuk kanë sukses në Vietnam agresorët amerikanë. Sukseset po korr vetëm populli vietnamez dhe jo armiqtë e tij, prandaj jemi të bindur se ai, më së fundi, do të dalë fagebardhë.

Me luftën e tij populli vietnamez i bën një shërbim shumë të madh gjithë njerëzimit, u jep zemër gjithë popujve që luftojnë për t'u shkëputur nga skllavëria imperialiste. Lufta e tij frymëzon, inkurajon dhe shton vendosmërinë e popujve që duan të jetojnë të lirë e të pavarur. Tani të gjithë e kuptojnë se ç'rëndësi të madhe ka për mbarë popujt e botës lufta juaj, se vetëm duke u qëndruar dhëmb për dhëmb imperialistëve amerikanë, anglezë, izraelitë, koreanojugorë dhe gjithë koalicionit imperialisto-revizionist, ashtu sikurse po u qëndroni ju agresorëve amerikanë, mund të sigurohet fitorja.

Me gjithë disfatën e përkohshme ushtarake që pësuan popujt arabë, ata duhet ta vazhdojnë luftën, sepse vetëm një luftë e tillë do t'i shpëtojë.

Udhëheqës të vendeve arabe tani po reflektojnë mbi demagogjinë e të ashtuquajturve miq dhe mbi të ashtuquajturën ndihmë të tyre ushtarake dhe politike. Në mos tërësisht, disa kanë filluar të mendojnë se

«Nuk jetohet me miell hua», siç thotë populli ynë, por se duhet vepruar, ashtu siç po bën populli vietnamez, që lufton dhe fiton. Kjo, natyrisht, i detyrohet në radhë të parë popullit të Vietnamit, prandaj edhe popujt e vendeve arabe duhet të nxjerrin mësim nga rruga që ndjek populli vietnamez, i cili di t'i dallojë si duhet miqtë e tij të vërtetë nga pseudomiqtë.

Lufta e popullit tuaj, pra, ka një rëndësi të madhe në botë, ajo ka një rëndësi të veçantë sidomos për ne miqtë e sinqertë të popullit të Vietnamit, siç janë Shqipëria jonë e vogël dhe popujt e tjerë.

Ajo që bëjmë ne për Vietnamin, është fare e vogël, prandaj kemi për detyrë ta shtojmë ndihmën dhe përkrahjen tonë për ju, sepse kemi një qëllim dhe e çmojmë se, kur derdhet gjaku juaj, është njëlloj si të derdhet gjaku ynë, sepse, kur ju luftoni për vete, luftoni njëkohësisht edhe për ne, dhe anasjelltas, edhe ne luftojmë, gjithashtu, për vete dhe për ju dhe, kështu së bashku, luftojmë dhe fitojmë.

Imperializmi amerikan ndodhet tani në një krizë të madhe. Ju keni meritën që këtë krizë, kalbëzim e dobësi të madhe të tij ua vutë në dukje popujve të botës. Kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

Mendimi i Partisë sonë është se propaganda, radio-televizioni, shantazhet atomike të imperializmit dhe e gjithë demagogjia e orkestruar edhe nga ana e revizionistëve sovjetikë, kanë për qëllim të frikësojnë popujt. Por lufta e popujve dhe e marksistë-leninistëve po e shkatërron mitin e rremë të pathyeshmërisë së imperializmit amerikan. Dhe është fakt se në këtë luftë qëndron në pararojë Vietnami.

Armiqtë kanë frikë nga ne, nga popujt që luftojnë e janë në këmbë. Dhe kanë arsye që ta kenë këtë frikë. Kjo nuk është një frikë imagjinare, por u është futur atyre me të vërtetë në palcë gjatë shumë vjetëve luftërash, nga sukseset revolucionare gjithnjë në rritje. Ata e kanë perspektivën të errët, kurse perspektiva jonë është e ndritur. Ne do të fitojmë.

Nuk mposhtet dot Vietnami! Le të guxojnë imperialistët amerikanë të hyjnë më thellë në aventurën e tyre dhe të sulmojnë më në veri. Ata, në fakt, po e bombardojnë Vietnamin e Veriut dhe e vërteta është se po e dëmtojnë, por qëllimit as ia kanë arritur, as do t'ia arrijnë. Vietnamin ata nuk do ta mposhtin dot. Mund të digjen Hanoi, Hajfongu etj., mund të digjen në rast agresioni Tirana, Durrësi etj. në Shqipëri, por popujt tanë nuk do të mposhten. Pas fitores ne do t'i rindërtojmë ato përsëri edhe më të mira, por armiqtë ama nuk do të arrijnë të na thyejnë dot kurrë. Qëllimin e fundit do ta arrijmë ne dhe jo imperialistët, megjithëse ata do të bëjnë ç'është e mundur, do të vënë forca akoma më të mëdha, do të shkallëzojnë më tej luftën. Por shkallëzimi i luftës nuk tregon tjetër veçse kalbësirën e tyre dhe paralajmëron disfata të tjera për ta. Sa më shumë që ta shkallëzojnë ata luftën në Vietnam, aq më shpejt do të shkatërrohen.

Ata i preokupon, gjithashtu, edhe çështja se si do të bëhet me përpjekjet për mospërhapjen e armëve bërthamore. Nga ana tjetër, ata patën varur shumë shpresa te traktati famëkeq i Moskës për ndalimin e provave në hapësirë dhe mospërhapjen e armëve bërthamore. Këto përpjekje kanë për qëllim ruajtjen e

monopolit bërthamor, të ombrellës bërthamore nga ana e imperialistëve amerikanë dhe e revizionistëve sovjetikë. Por ky monopol tani u prish. Në këto rrethana, shteteve të tjera kapitaliste u mbeten dy rrugë: ose të jenë në mëshirën e sovjetikëve dhe të amerikanëve, ose të ecin në rrugën që ndjek Dë Goli. Mund të ngjasë një ditë që edhe Japonia, një fuqi e madhe kapitaliste në Azi, edhe Gjermania Perëndimore, një tjetër fuqi e madhe në Evropë, të mos dëshirojnë të qëndrojnë më nën zgjedhën e amerikanëve. Kështu do të humbasë monopoli, kështu do të prishen edhe aleancat imperialisto-revizioniste.

Revizionisti Kosigin mund të llogotitë se duke e pasur edhe Gjermania, edhe Japonia armën bërthamore do të vihet paqja në rrezik. Askush nuk i ha këto gjëra, pasi bombat bërthamore, qofshin gjermane ose amerikane, japoneze ose sovjetike, janë njëlloj, të gjitha mbi kokat e njerëzve do të binin. Edhe sikur të mos i kishin Gjermania me Japoninë, gjersa këto armë i kanë SHBA-ja e Bashkimi Sovjetik, asnjë siguri nuk do të ketë se këta nuk do t'i hedhin ato mbi popujt.

Ne jemi realistë kur themi se gjendja në botë është në favor të luftës së popujve. Fitoret nuk vijnë pa luftë, pa përpjekje, pa sakrifica, por gjatë këtyre luftërave e përpjekjeve ne vazhdimisht do të fitojmë, kurse armiqtë imperialistë e revizionistë kurdoherë do të humbasin.

Në emër të të gjithë shokëve të udhëheqjes dhe të Partisë do t'ju lutem, shoku ambasador, që, kur të ktheheni në Vietnam, t'u thoni shokut Ho Shi Min, udhëheqjes të partisë suaj, qeverisë dhe popullit viet-

namez që te ne, te Partia e Punës e Shqipërisë, te Qeveria e Republikës sonë dhe tek i gjithë populli shqiptar, ata kanë e do të kenë miqtë e tyre më besnikë dhe më të qëndrueshëm, gjer në fund. Forcat që kemi ne nuk do t'i kursejmë për të dhënë kontributin tonë për vëllezërit tanë vietnamezë, që po luftojnë me kaq heroizëm. Çështjen e Vietnamit ne po e bëjmë, dhe vazhdimisht do ta bëjmë çështje të popullit tonë, ashtu sikurse e kemi bërë gjer tani. Me propagandën, me shtypin dhe me fjalimet tona do të përpiqemi çdo ditë e më shumë që t'ia bëjmë edhe më shumë të njohur popullit shqiptar luftën heroike të popullit të Vietnamit, me qëllim që të gjithë njerëzit tanë ta kuptojnë atë politikisht dhe ideologjikisht dhe ta ndihmojnë. Kështu veprojmë ne, kudo në Shqipëri, për të krijuar mundësitë që, me ato forca të pakta materiale që kemi, ta vazhdojmë ndihmën tonë të vogël për ju, sepse kjo është një detyrë e lartë internacionaliste ndaj luftës së popullit vëlla të Vietnamit.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

HISTORIA E PARTISË I FRYMËZON KOMUNISTËT DHE POPULLIN PËR FITORE TË REJA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

30 qershor 1967

Teksti i Historisë së Partisë, në përgjithësi, mendoj se është ndërtuar dhe hartuar mirë. Faktet, ngjarjet, vija e Partisë në të gjitha etapat dhe për të gjitha problemet janë pasqyruar drejt, me objektivitet, pa fioritura e mburrje të paqena. Hartuesit janë bazuar plotësisht në zhvillimin konkret të ngjarjeve, në dokumentet zyrtare dhe jo në «thënie» subjektive të njërit ose të tjetrit. Stili është konciz, i rrjedhshëm, i qartë dhe unë mendoj se i tillë duhet të mbetet edhe mbasi të reflektohen vërejtjet që bënë shokët, që janë shumë të mira dhe të rëndësishme. Paraqitja e historisë së Partisë, mendoj unë, është bërë në mënyrë të atillë që kushdo është në gjendje ta kuptojë e të reflektojë. Teksti i Historisë së Partisë u shërben të gjithë lexuesve, punëtorëve, fshatarëve, inteligjencies dhe të

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua maketi i tekstit të «Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë».

rinjve, ajo i nxit e i ndihmon të tërë që në punën dhe në luftën e tyre të udhëhiqen nga vija e Partisë. Ajo ndihmon dhe u hap perspektiva edhe dijetarëve që të bëjnë studime më të thella e speciale. Ne duhet t'i falënderojmë përpunuesit e maketit të Historisë së Partisë dhe t'i urojmë ata përzemërsisht për punën e vlefshme që kanë bërë.

Vërejtje parimore për maketin që na është paraqitur, në përgjithësi, unë nuk kam, kurse vërejtje të natyrës që kanë bërë një sërë shokësh kam edhe unë. Ato nuk dua t'i numëroj, se shumë prej tyre, në mos tërësisht, pjesërisht puqen me mjaft nga vërejtjet që kanë bërë shokët. Duke i studiuar të gjitha këto vërejtje, bashkohem me vlerësimin që u bëhet atyre në relacionin plotësues që na ka dhënë shoku Ramiz.

Jam dakord që komisioni i redaktimit t'i shqyrtojë një nga një të gjitha vërejtjet e mëparshme dhe ato që u bënë sot nga shokët e Byrosë Politike dhe ta shfrytëzojë mirë këtë ndihmë të vlefshme, duke ruajtur, mendoj unë, origjinalitetin e veprës, planin dhe kriteret bazë të ndërtimit të saj.

Bashkohem me mendimin e komisionit, se rëndimi i tekstit të Historisë së Partisë me citate të klasikëve të marksizëm-leninizmit do t'i jepte librit karakterin e një referati ideologjik. Edhe trajtimi gjerësisht i anëve teorike të problemeve, siç thonë disa, dhe më në fund, polemizimi me revizionistët dhe me armiqtë e tjerë të marksizëm-leninizmit më duket se nuk duhen bërë jashtë formave dhe caqeve të maketit, përndryshe ai do ta humbiste karakterin e një historie të shkurtër dhe koncize të Partisë.

Çështjet e ekspozuara, të ilustruara me fakte, me dokumente, me citate të klasikëve tanë (dhe nuk është e thënë që të mos bëhen edhe disa retushe plotësuese), mua më duken të mjaftueshme dhe të qarta, ashtu siç janë. Shokët që kërkojnë të flitet më gjerë besoj se janë shtyrë më shumë nga profesionalizmi i tyre. Ata, duke e shpjeguar me detaje Historinë e Partisë nëpër shkolla e fakultete, duke u thelluar vazhdimisht në të, e kanë bërë jetë këtë punë, prandaj vazhdojnë të thonë përse nuk është vënë në maket edhe kjo ose ajo çështje.

E kësaj natyre është edhe vërejtja që në tekstin e Historisë së Partisë sonë të trajtohet gjerë edhe historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo çështje, mendoj unë, nuk duhet të dalë nga caqet e maketit.

Në maket s'duhet të ketë vend asnjë panegjirik për mua. As kërkesa që bëhet nga një shok se ne «duhet të nxjerrim rolin e madh ndërkombëtar të Partisë sonë» nuk duhet të merret parasysh. Cilido që dëshiron, le t'i nxjerrë vetë deduksionet për këtë nga lufta e Partisë sonë, nga zbatimi prej saj në mënyrë korrekte dhe revolucionare i vijës marksiste-leniniste.

Edhe dhënia që në fillim e një tabloje të plotë të vijës së Partisë në një etapë të caktuar historike, siç propozojnë disa, nuk është shumë e përshtatshme, si për arsyet që dha komisioni, ashtu dhe për faktin se paraqitje të tilla e ngushtojnë mendimin te lexuesit, i pengojnë ata që ta lexojnë me kujdes librin, të thellohen në brendinë dhe deri diku të reflektojnë edhe

me kokën e tyre. Por këtu nuk ekskludohet të bëhet diçka.

Unë, kur studioj një libër, zakonisht i lë mënjanë parathëniet e përmbledhjet e shkurtra. Pra, më parë lexoj librin, formoj vetë idenë mbi të dhe pastaj, po të kem kohë, ose po të bëhem kurioz, i lexoj edhe ato, për të parë idetë subjektive të atyre që i bëjnë parathëniet ose përmbledhjet e shkurtra.

Mendimi im është se në këtë vepër nuk mund të analizohen dhe të përcaktohen më tepër nga ç'i kemi përcaktuar (edhe këtu nuk përjashtohet bërja e disa saktësimeve të domosdoshme) epokat historike të vendit tonë, që dalin nga kuadri i historisë së Partisë së Punës ose të zgjerohen ngjarjet historike, që në fakt, në lidhje me ne, kanë qenë të kufizuara, ose të kthehet historia e Partisë në një kurs të historisë së Shqipërisë. Për këto ne kemi tekste e libra të veçantë, prandaj, vërejtjet që janë bërë në këtë drejtim, më duket se janë frymëzuar nga profesionalizmi dhe subjektivizmi i disa njerëzve. Natyrisht, ka momente që mund të vihen më mirë në dukje. Kështu, për shembull, mund të trajtohen më gjerë, por kurdoherë duke ruajtur proporcionet, gjendja sociale dhe ekonomike e klasës punëtore dhe e fshatarësisë, kontradiktat jo-antagoniste në gjirin e popullit dhe kontradiktat antagoniste midis Ballit Kombëtar dhe Frontit Nacionalçlirimtar, përbërja klasore e Ballit Kombëtar, që e çoi atë në prehrin e armikut dhe në luftë kundër popullit.

Për një sërë çështjesh për këshillat dhe për Frontin Nacionalçlirimtar (sido që nuk kam vërejtje, se

shokët, më duket, i kanë shtruar drejt në maket), unë kam dorëzuar disa teza për raportin e Kongresit të ardhshëm të Frontit Demokratik, të cilave shokët, po të duan, mund t'u hedhin një sy.

Mendoj të hiqet nga libri biografia ime e shkurtër. Mund të vihet një pasazh vetëm për të hedhur poshtë propagandën jugosllave që trumbeton se gjoja Partinë tonë e kanë krijuar titistët. Për sa u përket disa emrave të shokëve të tjerë, ata të jenë medoemos në tekstin e Historisë së Partisë, se vepra e këtyre shokëve është pjesë përbërëse e historisë së lavdishme të Partisë.

Disa nga vërejtjet e mëposhtme mund t'i kenë parasysh shokët e komisionit të redaktimit, më shumë për të bërë disa saktësime.

Kur trajtohet Revolucioni i Qershorit i vitit 1924, më duket se duhen përcaktuar edhe pak më gjerë karakteri dhe tendencat e ndryshme politike të tij, të përcaktohet më qartë karakteri demokratiko-borgjez dhe jo vetëm demokratik i qeverisë së Nolit, që të shpjegohen më mirë lëkundjet e kësaj qeverie dhe natyra e paqëndrueshme dhe jo e sigurt e saj.

Kjo, së pari, ka rëndësi se është e vetmja qeveri demokratiko-borgjeze në historinë moderne të Shqipërisë, prandaj, ky karakter të dalë qartë nëpërmjet programeve të saj politike, ekonomike, kulturore dhe ushtarake, «mbështetjes» së saj në masat ose në klasat e ndryshme; politikës së saj të jashtme (dhe jo vetëm të dalë si bazë e kësaj politike njohja e qeverisë sovjetike, që ka, natyrisht, rëndësi) dhe, më në fund, të jepen shkaqet pse u rrëzua kjo qeveri.

Dhe, së dyti, kjo do të shërbejë që njerëzit që studiojnë historinë e Partisë, të orientohen dhe të kenë të qarta tri format e regjimeve në Shqipëri: atë të demokracisë borgjeze, regjimin absolut, të egër dhe antidemokratik të Zogut dhe regjimin tonë të demokracisë popullore, diktaturën e proletariatit. Natyrisht, këto gjëra duhen dhënë shkurt, në mënyrë shumë koncize dhe jo së toku, por në vendin ku trajtohet secila nga këto periudha.

Kur flitet për Revolucionin e Qershorit, duhet theksuar, veçanërisht, pjesëmarrja e rinisë në të, se vetë krijimi i shoqërisë «Bashkimi» u bë për grumbullimin dhe organizimin e rinisë, sidomos të rinisë shkollore (ky fenomen na del edhe në fillim të luftës sonë), për të cilën vrasja e Avniut ishte kushtimi për fillimin e kryengritjes. Në vazhdim të kësaj ideje dhe përsëri në mënyrë shumë koncize, kur flitet për regjimin e Zogut, duhet përcaktuar karakteri feudal anadollak i diktaturës së tij, karakteri i pushtetit dhe i ushtrisë së tij. Kjo ka rëndësi për të kuptuar mirë karakterin feudo-borgjez, ultrareaksionar të këtij pushteti dhe të ushtrisë e të xhandarmërisë zogiste, të organizuar dhe të udhëhequr nga të huajt. Një parashtrim i tillë do të shërbejë për qëllimin që thashë më lart, për të bërë krahasimin me pushtetin tonë, për të cilin flitet në kohën dhe vendin e vet. Për mënyrën si është ekspozuar çështja e pushtetit tonë në përgjithësi, nuk kam vërejtje.

Disa vërejtje kalimthi, por që kanë rëndësi:

Duhet t'i matim termat kur përcaktojmë rolin e organizatave të të mërguarve politike pas vitit 1924

dhe të tregohet kujdes në epitetet për disa patriotë të emigruar të kësaj periudhe.

Termi «fshatarët e vegjël» është më mirë të zëvendësohet me termin «fshatarë të varfër», që ka hyrë në historinë tonë dhe është më i drejtë.

Mund të flasim që në fillim, në ndonjë vend të përshtatshëm të maketit, për pjesët që iu shkëputën territorit të Shqipërisë nga fuqitë e huaja.

Po kështu (edhe kjo është një vërejtje tjetër e vogël), duhet të përcaktohet se mbeturinat patriarkale të fisit etj. kanë ekzistuar jo vetëm në jetën shoqërore të malësive të Veriut (ku kanë qenë më të theksuara), por edhe në anët e tjera të Shqipërisë.

Dalja në dritë e librit të Historisë së Partisë do të jetë një nga datat e shënuara të historisë së Partisë dhe të popullit tonë. Komunistët dhe populli do të gjejnë të sintetizuar në këtë libër heroizmat, luftërat dhe betejat legjendare; do të gjejnë përpjekjet dhe theroritë që ata kanë bërë në Luftën Nacionalçlirimtare, në luftën klasore dhe në luftën për ndërtimin e socializmit; do të gjejnë urtësinë, mençurinë, rezistencën e tyre në momentet më të vështira të historisë shekullore të Shqipërisë; do të shohin se si Partia jonë heroike diti më së miri të frymëzohet fuqimisht nga doktrina e pavdekshme e marksizëm-leninizmit dhe ta vërë atë në zbatim në mënyrë të shkëlqyer, pa asnjë lëkundje, në kushtet konkrete të vendit tonë dhe të situatave të ndërlikuara ndërkombëtare. Ata do të shohin dhe do të mësojnë atje se si Partia diti të përcaktojë drejt detyrat dhe vijën e saj marksiste-leniniste në çdo etapë dhe për çdo problem, diti të lidhet

si mishi me thoin, në një unitet të çeliktë me popullin, dhe se si, tok me të e në udhëheqje të tij, duke kapërcyer me hov revolucionar vështirësi kolosale, doli fitimtare nga çdo betejë.

Duke botuar historinë e saj, Partia e Punës e Shqipërisë, u vë në dorë komunistëve dhe punonjësve të vendit tonë një armë politike e ideologjike të mprehtë dhe të fuqishme. Me të ata do të mburren në mënyrë të ligjshme. Historia e Partisë do t'u hapë atyre horizonte dhe perspektiva të reja të shkëlqyera. Ajo do t'i mbrujë më tej komunistët dhe popullin me idetë e mëdha marksiste-leniniste të Partisë, do t'i kalitë më mirë e do t'i frymëzojë në luftën për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të pushtuar të gjitha kalatë dhe për të arritur fitore të reja madhështore në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste e të komunizmit. Ky është një gjykim modest i rëndësisë kolosale të historisë së Partisë sonë.

U lumtë shokëve të Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që, duke përgatitur këtë maket, arritën një sukses të merituar.

Natyrisht, për t'i dhënë dorën përfundimtare tekstit të Historisë së Partisë, shokët e komisionit dhe shoku Ramiz kanë akoma një punë për të bërë. Ata duhet të shikojnë të gjitha vërejtjet që janë bërë dhe, pasi t'i realizojnë ato, na bie neve detyra ta shqyrtojmë maketin përfundimisht dhe të japim aprovimin për shtyp.

Libri i Historisë së Partisë edhe nga paraqitja duhet të jetë i përkryer, libri më i bukur, i shtypur më pastër dhe në tirazh të madh. Historinë e Partisë,

mendoj, duhet ta shtypim edhe në disa gjuhë të huaja.

Jemi dakord që, gjer në fund të vitit, shokët e komisionit t'i bëjnë korrigjimet e nevojshme dhe t'i japin dorën përfundimtare maketit. Megjithatë, ky afat nuk ka shumë rëndësi, sepse kryesorja është që Historia e Partisë të dalë sa më e mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE BËJME NJË KTHESE VENDIMTARE NË ZHVILLIMIN E MALESIVE TONA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

30 qershor 1967

Do të prek vetëm dy çështje, sepse për të gjitha të tjerat diskutuan shokët: për zhvillimin e kulturës në fshat si dhe për probleme të zhvillimit të zonave malore.

Shumë nga arsimtarët që punojnë në fshat nuk po e kryejnë si duhet rolin pararojë në çështjen e përhapjes së kulturës, të ruajtjes së higjienës e të jetesës së kulturuar, të zhdukjes së zakoneve prapanike, të luftës kundër fesë etj.

Përse nuk i kryejnë ata si duhet këto detyra?

Unë mendoj se arsyt kryesore janë mosedukimi

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve të paraqitura nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, e Industrisë dhe e Minierave, e Tregtisë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale lidhur me zbatimin e vendimeve të Plenumit të KQ të PPSH të Qershorit të vitit 1963, për përmirësimin e gjendjes ekonomike, sociale e kulturore të fshatit.

sa duhet politik i tyre, moskontrollimi me rreptësi i punës së tyre, mungesa e kërkesës së llogarisë nga komitetet e Partisë, nga pushteti në bazë e nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe organet e saj. Këto u vënë rëndësi të dorës së dytë këtyre problemeve shoqërore dhe nuk u bëjnë aspak përshtypje të metat që ekzistojnë në këto drejtime.

Të marrim çështjen e pastërtisë dhe të higjienës, të cilat kanë rëndësi të dorës së parë për njeriun, pse nga mungesa e tyre shkaktohen sëmundje, dobësi trupore, mendore dhe vdekje. S'ka gjë më të keqe se papastërtia. Atje ku ka papastërti, bëjnë fole mikrobet, zhvillohen epidemitë, dobësohet njeriu, kalamanët vijnë të dobët dhe vdesin me shumicë, siç ngjiste më parë, sidomos, në fshatrat e Veriut. Tani, edhe atje, gjendja ka ndryshuar, por përsëri nuk është e mirë. Nuk mungojnë as uji, as sapuni ose, në fund të fundit, as finja. Vetëm se nuk është në lartësinë e duhur edukimi, kanë zënë rrënjë prapanizmi, përtacia, njerëzve nuk u bën sa duhet përshtypje se miza ka ngritur fole në shtëpi, se ekzistojnë miu, aty-këtu morri, pleshti, tartabiqja etj. Një gjendje e tillë, mjaft e rëndë në disa fshatra, nuk është aspak e denjë për ne. Si e durojnë një gjë të tillë komunistët, mësuesit, kuadrot? Si mund t'u lejohet atyre të pajtohen me një gjendje të tillë?

Është gjetur në këtë drejtim parulla prapanike dhe reaksionare «I mbyt situata e fshatit». S'është e vërtetë se fshati është dhe duhet të jetë qendra e pisllekut. Fshati është qendër e lavdërueshme e punës, e djersës, e tokës dhe në vendin tonë ka me

shumicë fshatra që janë po aq të pastër, në mës më shumë, se qyteti, ka fshatarë që punojnë tërë ditën dhe trupin, fëmijët e shtëpitë e tyre i sheh të pastra. Por, edhe sikur të supozojmë se ngjet e kundërta, përse atëherë disa mësues duhet të rrojnë në pisllek, përse e lënë ata pas dore higjienën e trupit të tyre dhe, në vend që të bëhen edukatorët e fshatarëve edhe në këtë fushë, japin vetë shembullin më të keq? Nuk mund të themi se një mësuesi të tillë i mungojnë koha, uji ose sapuni, jo, këtij i mungojnë kujdesi, këmbëngulja.

Le të supozojmë sikur disa fshatarë nuk i dëgjojnë si duhet këshillat e mësuesit mbi pastërtinë. Po te nxënësit dhe nxënëset, ku fjala e tij ndikon aq shumë dhe që ata e dëgjojnë për çdo gjë, përse nuk e ushtron mësuesi gjithë ndikimin e tij? Ai nuk e bën një gjë të tillë, se këtë problem nuk e çmon dhe pranon, në këtë mënyrë, që fëmijët t'i vijnë pis në shkollë, nuk u kërkon të vijnë me rroba të lara dhe t'i mbajnë ato pastër; nuk punon t'i edukojë me këmbëngulje që prindërit t'ua lajnë trupin të paktën një herë në javë dhe, kur janë të rritur, të lahen vetë, në mënyrë që ashtu siç u është bërë nevojë fiziologjike të hanë e të pinë, ashtu t'u bëhet zakon edhe për t'u larë e pastruar. Jo, mësuesi e gjen më të rëndësishme t'u mësojë nxënësve vetëm abëcënë, pse ajo i kërkohet, ndërsa për pastërtinë nuk i kërkohet sa duhet llogari. Unë nuk e besoj atë kërkesë llogarie që na tregoi këtu ministri i Arsimit dhe i Kulturës. Po të veprimej siç tha ai, mësuesi diçka do të bënte dhe po të merreshin masa për këtë problem, për të cilin mendoj se duhet të merren menjëherë, edhe atë që nuk e ka

bërë gjer tani, ai do të përpiqet ta bëjë më mirë. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe organizatat e Partisë duhet të jenë shumë të rrepta në këtë çështje.

Por roli i mësuesit dhe i mësueses në këtë drejtim të mos kufizohet vetëm në shkollë dhe me nxënësit. Ata këtë punë ta bëjnë me këmbëngulje me prindërit e nxënësve dhe të mos tërhiqen nga mallkimet e ndonjërit prej këtyre. Vete tjetri në shtëpinë e fshatarit, e shikon atë që fle në baltë e në fier, ndërsa stromën e jorganin i ruan për mikun, dhe nuk i thotë asgjë; ose e shikon të hajë me duar e në një çanak me pjesëtarët e tjerë të familjes, kur në treg ka lugë, pirunë e pjata dhe jo vetëm nuk i thotë një fjalë, por fillon të hajë edhe vetë me duar. Ç'mund të themi pastaj për gjërat e tjera, që janë ca delikate, por që duhet të ndërhyhet edhe për to medoemos, siç janë fejesat e të miturve, rrahja e grave, ngarkesa e tyre e shumë e shumë zakone të tjera të këqija? Në bankat e shkollës, përpara mësuesit, qëndrojnë fëmijë që i kanë fejuar qysh në vegjëli, ose që rrinë të brengosur se babai u ka rrahur mëmën apo motrën dhe ai, që i di këto, më rri me gojë të qepur, duke menduar se e ka kryer detyrën vetëm se u ka mësuar fëmijëve historinë e lashtë të romakëve.

Mësuesit dhe mësueset kanë një mision të madh në fshat, të cilin ata duhet ta kryejnë duke dhënë edhe jetën, siç e dha mësuesi hero i Mirditës. Në këto çështje të mos ketë tërheqje nga ana e tyre, kush tërhiqet gabon, kush thyhet nga vështirësitë, nuk është për mësues. Mësuesi është dhe duhet të jetë edukator për çdo gjë.

Flas ca si ashpër sot për këtë çështje, por nuk dua të nënvleftësoj punën e madhe dhe heroike të mësuesve të fshatrave, për të cilët kam respektin dhe admirimin më të madh. Megjithatë, nuk mund të lë pa kritikuar ata mësues që lënë pas dore këtë anë të rëndësishme të misionit të tyre të shenjtë.

Një çështje tjetër, që ka të bëjë me zhvillimin kulturor të fshatit, është ajo e politikës së librit në fshat. Këtu ka shumë të meta objektive dhe subjektive, të qendrës dhe të bazës, të anës thjesht organizative dhe teknike, por edhe nga ana e shkrimtarëve, sepse çështjen po e kufizoj vetëm në literaturën artistike dhe jo edhe në literaturën teknike, që është një tjetër problem i madh, të cilin do ta diskutojmë nesër në Sekretariatit e Komitetit Qendror.

Është e vërtetë se ka pak libra të letërsisë artistike për fshatin, sepse tirazhi është i vogël. Nga ana tjetër, edhe tematika është e ngushtë dhe e varfër. Ky është një problem i madh që na vihet për detyrë ta rishikojmë në kompleks, por edhe në veçanti për fshatin, ku ndihet nevoja për një punë më të madhe edukative.

Në radhë të parë, në rast se nuk gabohem, tematikën e letërsisë artistike ne pothuaj ia kemi lënë spontaneitetit, duke pritur ç'do të krijojnë, ç'do t'u ngjallë frymëzim shkrimtarëve dhe kur të duan ata. Mendoj se kjo nuk është një rrugë plotësisht e drejtë. Me këtë nuk dua të them se ne duhet t'i detyrojmë shkrimtarët ç'të shkruajnë, por në këtë çështje të madhe, duke pasur parasysh edhe nevojat tona, nuk mund t'i lëmë krijuesit pa një orientim jo vetëm ideopolitik, por edhe drejt tematikës dhe kohës së krijimit të

veprave. T'i orientojmë shkrimtarët drejt jetës sonë, që ka një patos e një frymëzim socialist të papërshkrueshëm, ka shembuj të mrekullueshëm, ka tema për çdo shkrimtar e për çdo gjini.

Ne, pra, duhet të organizojmë më mirë punën në këtë drejtim. Në këtë gjë të mos kufizohemi vetëm me shkrimtarët e afirmuar, disave nga të cilët u ka hipur mania ose megalomania e krijimit të «kryeveprave» për hir të famës së tyre personale, por të drejtohemi edhe te të rinjtë, te bari i njomë që lind, që rritet dhe që kuptohet më mirë sesa frazat e fryra e të komplikuarra të atyre që gjoja bëjnë «analiza të thella» të momenteve dhe të ndjenjave të ndërlikuara psikologjike.

Një burim tjetër për të përgatitur libra për fshatin duhet të jetë përmbledhja në libra dhe në vëllime e tregimeve, e novelave dhe e vjershave më të mira, me përmbajtje të shëndoshë e tematikë të larmishme, që botohen në gazeta e revista të ndryshme.

Shumë nga këto tregime e reportazhe artistike nuk i kanë lexuar fshatarët, pse ne e dimë si këndohen dhe sa këndohen gazetatat. Kurse përmbledhja e tyre në libra do të shërbejë më mirë. Unë mendoj dhe propozoj të kemi një komision të zgjedhur pranë Shtëpisë Botuese, që të punojë edhe më mirë në këtë drejtim.

Çështja e tirazhit është prapë një problem teknik, që duhet ta shikojmë në dritën e këtyre nevojave shumë të ngutshme. Por mendoj se proporcionet e shpërndarjes së librit fshat-qytet duhet të vihen në rrugë të drejtë, sipas sasisë së popullatës dhe nevojave që paraqiten. Me këtë dua të them se sasia më e ma-

dhe e librave duhet të vejë në fshat. Dhe sasinë që do t'ia rezervojmë fshatit mendoj ta ndajmë më dysh, shumica të destinohet për vatrat e kulturës dhe pakica të shkojë në treg për ta blerë kush të dojë. Në të dy rastet të organizojmë mirë leximin dhe qarkullimin e librit, qoftë nga bibliotekat, qoftë nga individët. Këto forma janë të domosdoshme të bëhen, pse sado që ta rritim tirazhin, ky përsëri do të jetë deficit te ne përpara nevojës dhe kërkesave për lexim.

Për sa i përket çështjes së zhvillimit të gjithanshëm të vendeve malore dua të theksoj se, për të gjitha problemet organizative, politike, ekonomike dhe kulturore të tyre, duhet të ketë një kuptim të lartë politik dhe zgjidhja e tyre të kthehet në një aksion shumë të madh e të vazhdueshëm nga e gjithë Partia, nga Qeveria, nga organet e bazës dhe të qendrës.

Duhet të njohim se, me gjithë kujdesin e madh të Partisë dhe të Qeverisë, zonat fushore kanë qenë më të favorizuara nga ato malore për shumë arsye: për nevojat e ngutshme, rrethanat etj. Kjo të ndryshojë në kuptimin që jo të lëmë pas dore fushën dhe tani të interesohemi vetëm për malin, po ka ardhur koha që për malin të interesohemi aq sa edhe për fushën. Bile na vihet detyrë e ngutshme patriotike dhe politike që, duke e pasur situatën ekonomike e kulturore më të fortë në fusha, të fitojmë sa më parë kohën e humbur në malësi.

Zhvillimi i natyrshëm dhe me baza i ekonomisë së zgjeruar të përbashkët në fushë, ndihma e madhe teknike që iu dha bujqësisë dhe investimet në këtë sektor, ndërtimi i fabrikave të reja dhe, në përgjithë-

si, i industrisë, i dhanë një shtytje të madhe përparimit në zonat e ulëta. Në to u ndërtua një rrjet i gjerë rrugësh moderne që e kërkonte zhvillimi i vullshëm i ekonomisë; arsimit, kultura dhe rrjeti i tregtisë këtë zhvillim e ndoqën me të njëjtat ritme dhe proporcione.

I gjithë ky kompleks bëri të natyrshëm një interesim më të veçantë për zonat e ulëta, një kontroll dhe një ndihmë më të vazhdueshme e më të shpeshtë në krahasim me atë që iu dha zonave kodrinore e malore. Megjithatë, edhe në vende të larta dhe afër lëndëve të para, ne ngritëm miniera e fabrika, ndërtuam edhe rrjetin e nevojshëm rrugor, që është një nga mjetet e rëndësishme të zhvillimit, hapëm shkolla të të gjitha niveleve, që u dhanë arsimit e kulturës edhe në këto vende një zhvillim të paparë.

Qendrat e rretheve të krahinave kodrinore e malore kanë bërë ndryshime të mëdha nga çdo pikëpamje, po e marrin veten mirë edhe qendrat e lokaliteteve, por, po ta studiojmë këtë situatë me një sy kritik, ne do të dallojmë se ekziston akoma një diferencë e madhe në mes qyteteve të fushës dhe atyre të malësisë dhe këtë, mendoj, nuk duhet ta rrafshojmë duke thënë se «Nuk i bëjmë dot të gjitha përnjëherësh» ose «Do të bëjmë atje ku nevoja është më e madhe dhe urgjente» etj. Këto arsye janë të vërteta, por ato të mos mbulojnë mungesën e interesimit tonë sa duhet për këto rrethe. Atje ku puna na çonte më dendur, se rrugët ishin më të shtruara, dyqanet më të shpeshta, se vendi kishte më shumë shkolla të çdo shkalle e kështu me radhë, interesimi ynë ishte më i madh, kërkesat shikoheshin dhe plotësoheshin më

mirë. Kuadrot me arsim e kulturë venin më lehtë në qendrat e mëdha dhe në vendet e ulëta, kurse në qendrat e vogla dhe në vendet e thella malore shkonin me shumë vështirësi, bile disa herë me imponim, megjithëse u krijonim edhe kushte favorizuese për vështirësi jetese dhe pune.

Rrugët që lidhnin fshatrat me njëri-tjetrin dhe me qendrat, edhe për natyrën e terrenit, por pjesërisht edhe nga interesimi i diferencuar, janë më të zhvilluara në vendet e ulëta sesa në malësi. Një gjendje e tillë e ka penguar shumë zhvillimin e barabartë të të gjitha krahinave. Kësaj situatë i shtoheshin edhe vështirësitë klimatike më të egra në male se në fusha.

Ne nuk kemi marrë masa të shumanshme, të organizuara fort mirë, të kontrollueshme dhe të një natyre të tillë që, të gjitha këto pengesa në kompleks, si dhe shumë të tjera si këto, t'i zhdukim, në mënyrë që disnivelin që ekzistonte dhe ekziston midis fushës dhe malit ta zbutim më shumë nga sa kemi mundur ta zbutim deri tash.

Për arsyet që dimë, kolektivizimi i bujqësisë në zonat malore nuk mund të bëhej me po ato ritme si në fushë. Partia dha orientimin për ngritjen e kooperativave në të gjithë malësinë, kur u krijuan kushtet për këtë. Por hyrja e zonave malore më me vonesë në rrugën e kolektivizimit, ndonëse e arsyetuar për një kohë, ka qenë një nga shkaqet që ky disnivel të mos zbutej shpejt. Dhe kjo ka ardhur nga vetë mungesa e kooperimit, i cili sjell përparim të shpejtë në të gjitha fushat e jetës, por nuk duhet ta fshehim se kjo ka ardhur edhe nga interesimi i paktë, ndonjëherë

edhe formal, i Partisë dhe i pushtetit në zonat ku nuk kishim kooperativa bujqësore.

Pra, të bëjmë një kthesë vendimtare në zhvillimin e gjithanshëm të malësive tona, ku jeton, punon dhe lufton një popull i mrekullueshëm, besnik i Partisë, i vijës së saj të drejtë, një popull patriot, i zgjuar dhe i etur për përparimin, një popull që ka shpërthyer si vullkan dhe që do të bëjë mrekullira në rrugën e Partisë.

Në radhë të parë, çdo gjë në malësi të shikohet me syrin e rreptë politik.

Forcimi, organizimi, ndihma shtetërore e caktuar për malësinë, duhet të marrin prioritet në të gjitha drejtimet dhe Partia e Qeveria të kontrollojnë me rreptësi zbatimin e çdo kërkesë plotësuese brenda mundësive tona. Të ketë prioritet ndihma për vendet malore, në Jug dhe sidomos në Veri. Partia të mobilizohet totalisht për t'iu përgjigjur si duhet etjes së madhe të popullit të malësisë për edukim, për arsim, për kulturë. Atje t'i drejtojnë ajo kuadrot më të mirë, nga më heroikët e më të zhvilluarit, punëtorë partie nga më të përgatiturit, mjekë, mami, infermierë nga më të zotët, agronomë, zooveterinerë dhe teknikë të mesëm nga më të mirët, mësues nga më të aftët. Partia të organizojë mirë shpërndarjen dhe leximin e librit dhe të shtypit, të ndihmojë fuqimisht zhvillimin e artit dhe të kulturës popullore. Qeveria, siç u shtrua edhe këtu, duhet të marrë masa të rrepta për tregtinë dhe për kooperativat e konsumit në malësi dhe të luftojë tendencën e lënies pas dore të zhvillimit të rrjetit tregues në këto vende, duke nxjerrë arsye të kota për

vështirësitë e terrenit ose kënaqen vetëm me furnizimin e zonave që bllokohen nga dimri. T'i furnizojmë këto zona me kohë, se i zë bora, por medoemos t'i furnizojmë shumë më mirë të gjitha zonat malore, i zë apo nuk i zë bora, kemi apo nuk kemi rrugë.

Furnizimet në malësi të mos shikohen sipas mentalitetit të vjetër të fshatarit malësor, por me syrin e qartë politik dhe në pajtim me revolucionin e madh që kërkojmë të bëjmë atje. Kjo nuk do të thotë që në dyqanet e këtyre zonave të ketë çorapë najloni ose stofa kashmiri, por të ketë me shumicë basmë, pjata, lugë, pirunë, mobilje të thjeshta etj., etj.

Vetë rrethet duhet ta rritin interesimin që, me forcat e veta, t'i lidhin këto fshatra me rrugë, të shpejtojnë brenda mundësive elektrifikimin e tyre, të interesohen për ujin e pijshëm etj., etj. dhe në këto drejtime ata kanë shumë për të bërë.

Pasi i thashë të gjitha këto për organizatat e Partisë të rretheve malore, dhe veçanërisht për të dy sekretarët e parë të komiteteve të Partisë, të Kukësit dhe të Librazhdit, që janë thirrur për këtë çështje edhe nesër në mbledhjen e Sekretariatit, më duhet të theksoj se këto të meta dhe interesimi i përgjithshëm jō në shkallën e duhur për vendet malore, të mos konsiderohen si pretekste për të fshehur të metat serioze të punës së tyre, mungesën e interesimit sa duhet nga ana e tyre, brenda mundësive që kanë pasur dhe që u janë akorduar rretheve nga planet e shtetit, të cilat nuk kanë qenë të vogla. Shumë gjëra, për të cilat ne po ju vëmë sot përpara përgjegjësisë, nuk kanë të bëjnë shumë lidhur me ndonjë kredi ose investim, por

janë në radhë të parë probleme politike, ideologjike, edukative.

Pastërtia nuk është virtyt i atij që ka me bollëk, por, në radhë të parë, është virtyt i njeriut të thjeshtë, i njeriut të ngritur nga ana politike dhe kulturore.

Në parim, ju e kuptoni se të gjitha këto të meta serioze në punën për ta bërë jetën e fshatarëve më të kulturuar mund të zhduken vetëm me luftë dhe me përpjekje, por luftën e përpjekjet ju nuk i organizoni mirë, nuk u futeni thellë problemeve shoqërore, nuk i analizoni ato me durim për ta pasur të qartë gjithë zinxhirin e tyre. Këtë punë serioze ia lini, më të shumtat e rasteve, spontaneitetit fshatar ose kënaqeni me iniciativa të bujshme që ne, me të drejtë, i propagandojmë për të gjithë vendin, por kur vijnë shokët dhe shohin zbatimin e tyre, na del se është bërë më shumë zhurmë sesa punë.

Unë i di dhe i kuptoj vështirësitë që hasim dhe do të hasim akoma në rrugën e zhvillimit kulturor të malësive tona, po kam një besim jashtëzakonisht të madh (dhe kjo nuk bazohet në sentimentalizëm, por në gjendjen reale) te populli i mrekullueshëm i malësive tona që është aq i etur për zhvillim, për kulturë. Vajzat e malësive tona janë ato që në aksione, si në atë të hekurudhës, shkojnë të turpshme, të mbyllura, kurse pas dy muajsh, e theksoj: pas dy muajsh, ato largohen nga hekurudha zjarr. Një ndryshim i habitshëm, kolosal. A nuk është kjo një gjë shumë e madhe, që duhet t'ju bëjë të mendoheni, shokë të Kukësit dhe të Librazhdit, për efektivitetin e punës suaj, për punën tuaj politike jo të organizuar si duhet?

Vetëm dy muaj iu deshën vajzës së malësisë të bëjë këtë hop cilësor. S'ka dyshim, ky është rezultat i përgjithshëm i punës së Partisë, por vajtja në hekurudhë nuk do të përfshijë dot të gjitha cucat e malësisë. Pra, një hop të tillë cilësor duhet ta bëjë Partia në rreth, ta bëni ju atje, shokë, në vend. Aksionet nacionale janë vetëm ndihmë dhe shembull.

Marr si shembull diskutimet e nrekullueshme të disa vajzave që folën në Kongresin e 5-të të Rinisë me një pjekuri marksiste-leniniste të jashtëzakonshme. Me mijëra e me dhjetëra mijë ka të tilla në malësitë tona, të reja e të rinj, kështu është atje i gjithë populli ynë.

A kam të drejtë të jem optimist? A jam realist kur them se faj kemi ne që nuk i mësojmë si duhet vajzën dhe djalin e malësisë, të cilët, me fjalën e mësimet e Partisë, janë në gjendje të çajnë malet, të kapin qiejt dhe jo më të mos zhdukin pisllekun, të mos shqelmojnë prapanizimin dhe të mos përqafojnë të renë, socializmin?

Shokë, të mendojmë ç'thesare ka Shqipëria te njerëzit e saj dhe sa e lavdishme do të bëhet puna jonë, kur t'i shohim të gjitha këto çështje politikisht dhe t'i zgjidhim në mënyrë revolucionare. Tjetër rrugë për ne nuk ka, prandaj ta forcojmë, ta forcojmë akoma më shumë punën tonë të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë*

*Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

MË TEPËR KUJDES, KONTROLL, INICIATIVË E ORGANIZIM PËR KUALIFIKIMIN E KUADRIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

1 korrik 1967

Me rastin e shqyrtimit të përgatitjes dhe të kualifikimit të mëtejshëm të kuadrit, në këtë mbledhje, dua të theksoj edhe unë disa çështje, pavarësisht se ato preken në raportet e ndryshme që na janë paraqitur. Dëshiroj t'i vë në dukje këto gjëra, në mes shumë të tjerave, për të cilat diskutuan edhe shokët Hysni Kapo e Ramiz Alia, me qëllim që organizatat e Partisë në rrethe, dikasteret e veçanta etj. të tregojnë më shumë kujdes, të kenë më shumë iniciativë, të ushtrojnë më tepër kontroll dhe ta organizojnë më mirë punën për kualifikimin e kuadrit.

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve të komiteteve të Partisë të rretheve të Beratit e të Mirditës, si dhe të Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave e të asaj të Bujqësisë «Mbi përgatitjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të kuadrove».

Partia, me punën e saj shumë të kujdesshme, të vëmendshme e këmbëngulëse, ka arritur suksese në përgatitjen dhe në ngritjen e kuadrove. Ajo ka ecur drejt edhe në këtë çështje e kështu duhet të ecë dhe paskëtaj, domethënë të kujdeset, në radhë të parë, që kuadrot e të gjithë sektorëve dhe të çdo rangu të jenë bij besnikë të popullit, njerëz të sakrificës, të edukuar dhe të frymëzuar nga teoria marksiste-leniniste, që të vënë politikën e Partisë në plan të parë dhe të kuptojnë se vetëm kështu do të kenë të qartë çdo gjë, se vetëm kështu do t'u hapen horizonte të gjera veprimi dhe krijimi. Partia t'i mësojë kurdoherë kuadrot që të kuptojnë se edukimi i tyre, mësimi, perfeksionimi nuk mund të quhen kurrë dhe në asnjë periudhë të mjaftueshëm dhe të plotë, të kuptojnë se ata duhet të shkrihen me masat e gjera të punonjësve dhe të vënë të gjitha forcat që masat të ngrihen, të mësojnë, të edukohen, pse këto bëjnë historinë, revolucionin, ndërtojnë socializmin e komunizmin. Kuadrot të kuptojnë mirë fjalën e urtë të popullit tonë: «Me një lule nuk vjen behari», bile as edhe me një mijë ose me njëzet mijë. Me një fjalë, pra, të bëjmë që të gjitha masat të ngrihen në nivelin e duhur.

Një problem lidhur me përgatitjen e kuadrove është mosplotësimi i kontingjenteve për shkollat e larta nga ana e rretheve. Një gjë e tillë, më parë, kur na mungonin shkollat e mesme, kur nuk kishim sa duhet edhe kandidatë për bursat që akordonte shteti, mund të ishte e kuptueshme dhe e falshme për rrethet, por tani, shokë, kur këto kontingjente ekzistojnë, kur bursa jepen, por rrethet nuk i shpërndajnë, duke e

marrë lehtë këtë mosplotësim, kjo atyre nuk u falet, pse është e dënueshme. Ne sot kemi shumë nevojë për kuadro të lartë në të gjithë sektorët, prandaj nuk mund të sillet dhe të pranohet asnjë justifikim. Mund të thuhet vetëm se rrethet nuk e kanë vlerësuar si duhet nevojën e mësimit, të përgatitjes së kuadrit, të përparimit dhe të diturisë. Ato mund të thonë sa të duash, çdo ditë dhe çdo orë, se socializmi nuk ndërtohet pa i mësuar njerëzit etj., etj., por, në fakt, mundësitë reale të krijuara i kanë neglizhuar pjesërisht.

Në kohën e rinisë sonë të vështirë ne copëtoheshim për të marrë një bursë, trokitnim në shumë dyer, bënim disa lutje, kurse tash që Partia është në fuqi, kur shteti cakton kaq shumë bursa, është e vështirë të kuptohet arsyeja pse këto të mos merren, të mos përfitohet prej tyre. Shkaku është vetëm mosinteresi mi sa duhet nga ana e disa kuadrove të Partisë dhe të pushtetit në rreth për këtë problem.

Kjo gjendje të marrë fund këtej e tutje dhe të mos dëgjojmë më «shfajësime» ose autokritika formale nga shokët përgjegjës. Ata jo vetëm të punojnë që të dërgojnë kontingjentet që u caktohen, por të kërkojnë shtimin e kontingjenteve, me bursa e pa bursa, që të krijojnë edhe rezerva. Sot janë krijuar situata aq të favorshme, sa që vetë familjet me nga dy dhe tre pjesëtarë të tyre në punë, i kanë mundësitë ekonomike t'i dërgojnë fëmijët në shkollë.

Kujdes i veçantë nga dikasteret përkatëse dhe nga komitetet e Partisë të rretheve t'u vihet edhe teknikumeve, sidomos Teknikumit të Përrenjasit, sepse kam përshtypjen që ky kujdes nuk është në shkallën e du-

hur. Në këto teknikume ne përgatitim në masë kuadro teknikë. Mendoj që të vlerësohen më mirë shkencat e teknika. Ata që mbarojnë teknikumet dhe shkollat profesionale janë një shtyllë e fuqishme e industrisë, e bujqësisë, e shëndetësisë, e kulturës, e arsimit të përgjithshëm dhe teknik.

Në ç'drejtime nuk tregohet kujdesi i duhur? Në radhë të parë për mësuesit. Mendoj që mësues të caktohen aq sa duhet dhe nga specialistët më të mirë. Po nënvleftësuam rëndësinë e tyre, ne kemi dënuar veten, kemi humbur kohën që është flori dhe nuk u kemi dhënë bijave dhe bijve të popullit atë që duhet t'u japim e që duhet t'ua japim me rrënjë. Po nënvleftësuam këtë çështje, teknikët e mesëm do të dalin të papërgatitur dhe atëherë u rroftë diploma. Në vend që t'i bëjmë mësues e pedagogë disa nga specialistët më të mirë, ne i dërgojmë këta në prodhim dhe harrojmë se edhe teknikumet kanë nevojë për ta, sepse duhet të nxjerrin teknikë të mesëm, të aftë që të revolucionarizojnë tërë prodhimin, që të bëhen edukatorë të masave të gjera punonjëse.

Me këtë nuk dua të them të dobësojmë punën dhe prodhimin në ara, në fabrika, në shëndetësi, duke i çuar të gjithë specialistët më të mirë mësues në teknikume, por të mos harrojmë se industria, bujqësia etj., nuk mund të ecin pa pasur kuadro të mesëm të aftë, edhe sikur të kenë inxhinierë dhe agronomë të mirë. Ne nuk mund t'i evitojmë vdekjet e kalamanëve nën një vjeç, të cilat janë problem shumë shqetësues, sidomos në malësi, në rast se nuk dërgojmë atje mami dhe infermiere me shumicë dhe të kualifikuara, edhe

pse mund të kemi në këto zona disa mjekë të zotë, se vetëm këta nuk mund të na i zgjidhin problemet. Problemet tona janë të mëdha e të gjera, por duhet të dimë të gjejmë kyçet për zgjidhjen e tyre. Prandaj kësaj çështjeje t'i vëmë rëndësi të madhe, gjendja të shikohet me shumë kujdes, të zbulohen boshllëqet dhe të plotësohen ato sa më parë e sa më mirë.

Programet e teknikumeve nuk mund t'i ndërrojmë as çdo ditë, as çdo vit, por në lidhje me disa kërkesa që na paraqesin shokët, mendoj se mund të veprohet me iniciativën e dikastereve dhe të vetë teknikumeve. Në ç'drejtime dhe në ç'masë mund të jenë këto iniciativa? Natyrisht, jo në ndërrimin e programeve bazë, por në të mësuarit nga ana e nxënësve të ndonjë zanati suplementar që të ketë lidhje me jetën dhe me punën e nxënësit pas mbarimit të teknikumit. Nuk e kam fjalën te ndërrimi i teknikumit në politeknikum, që është një problem tjetër i madh, i cili nuk mund të zgjidhet nga teknikumet, por kjo s'do të thotë që ato të vënë qerren përpara qeve dhe të mos krijojnë vetë, brendapërbrenda, me forcat e tyre, me ndihmën e dikastereve dhe të rrethit, mundësi për zhvillimin e këtyre iniciativave praktike. Kjo kërkon që mësuesit e teknikumeve të luftojnë formalizmin, dogmatizmin dhe shkollarizmin dhe, duke zbatuar gjallërisht programin, të lidhen me jetën, me praktikën e sidomos me praktikën e ardhshme më të gjerë të nxënësve.

Për sa i përket çështjes së teksteve dhe të laboratorëve në teknikume unë nuk jam në gjendje të them saktësisht situatën e tyre, po di se shkollat nuk janë as pa tekste dhe as pa laboratorë. Megjithatë mendoj

se përmbajtja e tyre duhet të pasurohet dhe të kontrollohet vazhdimisht. Mund që gabohet, por në rrethe nuk ka shumë kujdes nga Partia për këto çështje dhe dikasteret, nga të cilat varen teknikumet, interesohen pak për tekstet dhe për zhvillimin e pasurimin e tyre. Tekstet bëhen, raportohet se janë në rregull dhe pastaj lihen, ashtu siç janë, dhe, kur kërkohet për t'u bërë ndonjë përmirësim, nxirren një mijë arsye me qëllim që të mos plotësohen, ose plotësohen çalë. Ky, mendoj unë, nuk është interesimi i duhur, prandaj del detyrë që kujdesi në këtë drejtim të jetë më i madh.

Nga ana tjetër, po të mos interesohen Partia dhe dikasteret, specialistët, në përgjithësi, e bëjnë njëherë e përgjithmonë tekstin e lëndës së tyre dhe as që interesohen ta përmirësojnë më tej, duke pasuruar, në radhë të parë, dijenitë e tyre. Por që mësuesit të pasurojnë dijenitë e tyre, duhet t'i nxitësh, t'i edukosh politikisht, t'u krijosh edhe disa kushte. Ndryshe, ka rrezik që mësuesi të mbulohet nga rutina, nga pluhuri, tekstin që ka përpara ta quajë si shumimin e shkencës dhe ta ndiejë veten «gjeni» përpara nxënësve. Kështu, ai nuk e ndien nevojën të bëjë përpjekje për të ngritur nivelin teoriko-shkencor, por synon vetëm të jetë formalisht në rregull me planin mësimor e me ministrinë dhe mendjen e ka të transferohet për shembull, nga Përrenjasi, për të shkuar në një qendër tjetër më të madhe.

Këto probleme, mendoj se nuk duhet t'i lëmë pas dore, se kanë rëndësi të madhe.

Edhe çështja e përkthimeve dhe shtypja e teksteve teknike, si për teknikumet, ashtu edhe për fakul-

tetet, siç duket, nuk ka gjetur zgjidhjen e duhur, kurse tekstet e tjera shkollore, me gjithë të metat që përmenda, janë vënë disi në rregull. Aktualisht, këto punë bëhen të hallakatura, librat disa herë mungojnë ose shtypen keq dhe me shumë vonesë. Puna nuk mund të ecë më kështu, prandaj duhet studiuar gjendja dhe të merren masa. Mund të bënim disi më parë, kur kishim më pak teknike e fakultete dhe më pak nxënës e studentë në to, por tani këto na janë shtuar dhe, veç tyre, edhe specialistët, që janë në një numër të madh, duan literaturë teknike, ndryshe shterojnë. Nuk mund t'ia dalim dot duke sjellë sasi të mëdha librash nga jashtë, si në numër, ashtu edhe në llojet që nevojiten, por këtë çështje duhet ta shohim realisht, se, edhe sikur të sjellim, ata nuk kanë si të shfrytëzohen plotësisht, së pari, se kuadrot nuk mund t'i ndjekin në çdo bibliotekë, pasi do të na duheshin shumë ekzemplarë, së dyti, dhe kjo është vështirësia tjetër e madhe, shfrytëzimi i tyre kërkon zotërimin e gjuhëve të huaja nga njerëzit tanë. Porositë e vazhdueshme që nxënësit dhe studentët tanë të mësojnë gjuhë të huaja, janë dhënë e puna për zbatimin e tyre ka nisur, por edhe kjo nuk e zgjidh problemin, prandaj duhen bërë përkthime të teksteve shkollore e të librave të tjerë tekniko-shkencorë dhe të shtypen. Kjo punë duhet bërë në mënyrë të centralizuar, nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës dhe nën kujdesin e drejtpërdrejtë të dikastereve përkatëse e të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Përkthimi i literaturës teknike për teknikumet mund të bëhet nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe nga ministritë e intere-

suara, kurse për literaturën e shkollave të larta dhe për nevojat e specialistëve të interesohet universiteti. Për shtypjen e këtyre materialeve nuk duhet pritur radha, por të krijojmë një shtypshkronjë të veçantë për këtë punë. Mendoj që ky problem të merret në studim të gjithanshëm dhe të dilet me propozime.

Një çështje tjetër është ajo e studentëve që mbeten në provime dhe nuk mbarojnë fakultetet. Siç po shohim, numri i tyre është shqetësues. Kjo na dëmtton shumë. Sigurisht, mund të na thuhet se studentët nuk mësojnë, ose vijnë të dobët në universitet. Kjo është një arsye, po jo e tëra. Unë s'them se nuk ka shqetësim për këtë çështje, po mendoj se ky është më tepër formal dhe i përciptë. Prandaj nga pedagogët, nga katedrat, nga organizata e rinisë të bëhet çdo përpjekje që te studentët të kalitin vullnetin për të studiuar e për të mbaruar me rezultate të mira fakultetin.

Mendoj se me studentët nuk bëhet që në fillim një punë sistematike, në radhë të parë, punë intensive politike, edukative, që ata të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrën e tyre. Partia, organizata e rinisë dhe pedagogët jo vetëm duhet të punojnë mirë, me kujdes dhe me këmbëngulje me ta, por çdo ditë t'u mësojnë edhe metodën më të mirë të të mësuarit, e cila ndryshon nga metoda e të mësuarit në shkollat e mesme.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës interesohet për kalueshmërinë e nxënësve e të studentëve nëpërmjet raporteve që i vijnë dhe jo sa duhet drejtpërsëdrejti e konkretisht. Për sa u përket ministrive të tjera, që i presin studentët të mbarojnë shkollat e larta

për t'i dërguar me punë në sektorët e tyre, mendoj se nuk interesohen shumë, kurse rrethet që i kanë dërguar akoma më pak.

Mund të thuhet se nuk është kjo arsyeja që disa studentë mbeten, por interesimi i dikastereve dhe i rretheve për mbarëvajtjen e studentëve do t'i ndihmonte ata që të mobilizoheshin më tepër në mësim, sepse jeta tregon se jo kudo dhe jo të gjithë e kryejnë detyrën pa i nxitur, pa u ndenjtur mbi kokë me ndihma dhe me këshilla.

Kërkesa ndaj nxënësve dhe studentëve të mos dobësohet, por mësuesit e pedagogët duhet të reflektojnë politikisht për këtë problem, të ruhen nga subjektivizmi që vihet re te mjaft prej tyre. Nuk them t'u jepet diploma studentëve që s'mësojnë, por duhet shikuar pak edhe tendenca e rreptësisë së tepruar e disa pedagogëve. Një student mund të mbarojë fakultetin me nota më të dobëta se të tjerët, por pastaj, në praktikë, në jetë, ai do t'i mbushë medoemos boshllëqet, duke i shtruar atij kërkesa më të shumta që të perfeksionohet. Kështu duhet vepruar në praktikë, të interesohen të gjithë për aftësimin e vazhdueshëm e të pandërprerë të kuadrove, për t'i zhvilluar më tej njohuritë e fituara në shkollë.

Më në fund diçka mbi shpërndarjen më të drejtë të kuadrit. Mua nuk më bind kënaqësia e shokëve të Ministrisë së Bujqësisë kur thonë për këtë problem se e kanë bërë shpërndarjen dhe kooperativave bujqësore do t'u japin më shumë kuadro në të ardhmen. Tabela që na japin ata ma forcojnë bindjen se ka akoma për të bërë në këtë drejtim. E kam fjalën sidomos për

agronomët dhe për zooveterinerët. Me gjithë masat e marra, në ndërmarrjet bujqësore punon pothuajse gjysma e specialistëve të bujqësisë që ndodhen në fshat. Ky përpjesëtim nuk është i drejtë. Ai duhet të përputhet me realitetin: me sasinë e tokës, me nivelin e organizimit të punës, me mungesën e kuadrove të mesëm, si dhe me shkallën relativisht të ulët të dijeve që ka fshatarësia në lëmin e agroteknikës.

Prandaj mendoj që kjo çështje të shikohet më thellë nga Ministria e Bujqësisë, me qëllim që të ndihmohen kooperativat bujqësore, të ndihmohet, sidomos, malësia dhe të rinjtë që mbarojnë shkollat, të dërgohen me shumicë në fshat. Nga këta të bëhet seleksionimi se cilët do të dërgohen në kooperativat dhe cilët në ndërmarrjet bujqësore, duke mbajtur parasysh faktin se këto të fundit janë ekonomi më të organizuara, më të disiplinuar e me tradita, ku kuadrot kanë mundësi të perfeksionohen më shpejt, ndërsa në malësi, të çojmë kuadro të përgatitur, që ata jo vetëm të mos humbasin si kuadro, por edhe të kontribuojnë për zhvillimin e malësisë.

Kështu të veprohet edhe për shpërndarjen e mjekëve, të infermierëve e të mamive. Numri i mjekëve për frymë të popullsisë në fshat duhet të rritet patjetër. Dërgimin e mamive e të infermiereve në fshat e, sidomos, në malësi dhe në zonat e thella, Ministria e Shëndetësisë ta shikojë me shumë kujdes, se raporti për vdekjen e fëmijëve nën një vjeç, sidomos në Veri, më ka alarmuar fort. Është e palejueshme që qendrat sanitare për lindjen e fëmijëve në rrethet e Veriut nuk përdoren veçse në masën 40-50 për qind. Këtë ta sho-

hin mirë organet e Partisë dhe të pushtetit në këto rrethe, të cilat kanë përgjegjësi të madhe që ndodh kështu. Partia kërkon të thyhen medoemos kjo prapambetje, ky konservatorizëm dhe injorancë në trajtimin e fëmijës së vogël, të zhduket papastërtia, pse këto janë probleme të jetës dhe të shëndetit.

Prandaj në këto çështje që përmenda u rekomandoj shokëve të rretheve të vepronë si komisarë politikë, me rreptësi revolucionare. Nuk duhet lejuar më që nga papastërtia e mungesa e konsultimeve nga ana e personelit mjekësor, të na vdesin fëmijë, nuk duhet të lejojmë që mësuesi ta shohë me indiferentizëm nxënësin që i vjen pis në klasë. Këto gjëra duhet të marrin fund jo vetëm me lutje, jo vetëm me këshilla, por edhe me masa të forta. Masa të tilla për këto probleme jetike nuk na bëjnë dëm, përkundrazi, na bëjnë shumë mirë.

Në këtë drejtim dua të theksoj, gjithashtu, se kooperativat bujqësore duhet t'u japin leje të paguar grave shtatzëna, para dhe pas lindjes. Kjo leje mund të mos jetë aq e gjatë sa u jep shteti, por minimumi mjekësor duhet të sigurohet patjetër, pse kjo mbron mëmën dhe fëmijën. Ministria e Shëndetësisë ta caktojë këtë leje dhe t'ua rekomandojë kooperativave bujqësore; Partia e pushteti të bëjnë çmos që ajo të zbatohet, të ndihet si një nevojë e domosdoshme.

*Botohet për herë të parë stpas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

DOBËSITË T'I SHOHIM DREJT NË SY

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

1 korrik 1967

Mendoj se organizata e Partisë e rrethit të Sarandës duhet të jetë e ndërgjegjshme se ka të meta serioze në punën e saj dhe, në radhë të parë, udhëheqja e Partisë dhe ajo e pushtetit ta shohin punën me një sy shumë kritik, pse kanë përgjegjësi të rëndë për dobësitë që vërtetohen në këtë rreth, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet të zvogëlohen. Dobësitë t'i shohim drejt në sy.

Nuk është i drejtë, mendoj unë, qëndrimi i udhëheqjes së këtij rrethi dhe kjo bindje m'u forcua edhe ca më shumë nga diskutimi i sekretarit të parë, sipas të cilit instruktorët e Komitetit Qendror nuk tregohen realistë në vërejtjet dhe në kritikën që u bëjnë sho-

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth disa çështjeve të jetës së brendshme dhe të punës politiko-ideologjike të Partisë në rrethin e Sarandës.

këve të Sarandës. Mendoj se vërejtjet dhe kritikrat e tyre jo vetëm janë të drejta dhe objektive, por ato mund dhe duhet të ishin edhe më të rrepta, sepse faktet dhe shifrat, qoftë në punën e Partisë, qoftë në sektorin ekonomik, flasin qartë për dobësi të theksuara, të cilat as nuk mund të fshihen e të shtrembërohen, por as edhe të zbkurohen me zor. Ne nuk e shtrojmë çështjen sikur organizata e Partisë në rrethin e Sarandës nuk punon, po themi atë që është dhe si duhet të jetë.

Po të shikosh shifrat e ekonomisë së këtij rrethi të krahasuara me shifrat e treguesit ekonomikë të rretheve të tjera dhe të llogaritësh klimën ideale, investimet e bëra dhe pjellorinë e tokës, Saranda është shumë prapa. Kështu, në rendimentin e drithërave ajo zë vendin e 19-të, domethënë qëndron edhe pas rrethit të Matit, të Krujës e të Mirditës, që zënë respektivisht vendin e 5-të, të 8-të e të 11-të; në grurë zë vendin e 12-të, pas Vlorës, Krujës dhe Mirditës; në misër, ndërsa rrethi i Dibrës zë vendin e parë, i Tropojës të 2-tin, i Matit të 6-tin dhe i Shkodrës të 7-tin, Saranda zë vendin e 8-të; në patate zë vendin e 19-të dhe në oriz vendin e fundit nga katër rrethet që merren me kultivimin e tij.

Siç shihet, pra, në shumë tregues Saranda është prapa edhe nga shumë rrethe malore, ku nuk janë bërë shumë investime dhe toka nuk është aq pjellore. Prandaj, shokët e Sarandës nuk kanë arsye as të mburren për rezultatet që kanë arritur dhe as të qahen për kritikrat që u bëhen. Detyra e tyre urgjente si komunistë, është të ulin kokën në punë, të reflektojnë

thellë për problemet, të shohin drejt në sy të metat e t'i korrigojnë ato sa më parë dhe jo të përpiqen të shfajësohen.

Por të metat nuk mund të zhduken, Saranda nuk mund të dalë nga prapambetja relative në të cilën ndodhet, në krahasim me kushtet objektive që ka, pa forcuar punën e Partisë në këtë rreth. Prej kohësh po vazhdon të nënvleftësohet kjo punë vendimtare. Unë nuk do t'i përsërit dobësitë që ekzistojnë në drejtime të ndryshme, pse raporti ato i vë mirë dhe drejt në dukje, por organizatat e Partisë në këtë rreth duhet t'i kundërvihen më mirë propagandës së huaj, të mos u kalojnë përciptazi problemeve dhe fakteve që kanë rrënjë të thella. Rrënjët e këqija të së kaluarës duhen shkukur përfundimisht me një organizim të shëndoshtë, me një punë politike e ideologjike këmbëngulëse, të qartë e të pareshtur dhe me një kujdes të veçantë për çështjet organizative të Partisë. Prandaj, shokë të Sarandës, duhet të shtroheni këmbëkryq, t'i analizoni një për një punët dhe hallet e Partisë, t'i merni dhe t'i zgjidhni ato frontalisht e me durim; jo përciptas, por thellë; jo njëjërën, por të gjitha; jo të shkëputura, por në kompleks; jo në mënyrë statike, por në dinamikën e tyre; jo vetëm në mënyrë imediate, por me perspektivë.

Në qoftë se ju, udhëheqja e Partisë në rreth dhe komunistët e bazës, do të veproni kështu, atëherë ne do të shohim se si do të forcohet Partia, si do të gjallërohet populli dhe puna e armikut nuk do të zërë vend, si do të zhduken më shpejt e me rrënjë zakonet e vjetra prapanike, besimet fetare dhe sa shpejt e me

baza shkencore do të zhvillohet bujqësia në këtë vend të begatshëm e pjellor.

Dielli i nxehtë, klima e bukur, pa të ftohta e ngriça, si dhe pjelloria e tokës, nganjëherë ndikojnë negativisht në jetën dhe në qëndrimet e njerëzve ndaj punës, i bëjnë ata më pak të kujdesshëm, më pak punëtorë, më pak këmbëngulës përpara vështirësive, i bëjnë të kënaqur dhe i pengojnë të bëjnë më shumë përpjekje, i shtyn në një natyrë ekzuberante, pa baza dhe të dëmshme.

Prandaj të mendoni seriozisht dhe t'i kuptoni drejt kritikën që ju bëjnë shokët. Nuk themi se ju keni lidhur duart, se në rrethin tuaj asgjë nuk shkon mirë, por unë them që punët duhet t'ju shkojnë shumë më mirë, se dielli te ju është aq i ndritur, sa që edhe vendet e errëta i ndrit. Syri i mprehtë i Partisë nuk mund të gënjëhet nga mirazhet e diellit; diellin dhe klimën ajo të dijë t'i shfrytëzojë, jo për të mbuluar të metat, por për të gjallëruar njerëzit dhe natyrën, e cila duhet të japë atje gjithçka për të mirën e njerëzve.

Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP

**NË RADHË TË PARË E MBI TË GJITHA QËNDRON
ÇËSHTJA E PARTISË, PA TË NUK MUND
TË KETË FITORE**

*Nga biseda me një delegacion
të «gardistëve të kuq» kinezë*

8 korrik 1967

*Pasi miqtë zunë vend, fjalën e mori shoku
Enver Hoxha:*

Ardhja juaj, shokë «gardistë të kuq», është një ngjarje me rëndësi për rininë e vendit tonë, sepse ju sollët ndjenjat e pastra dhe revolucionare të rinisë kineze. Gjatë kohës që qëndruat në Shqipëri ju patë, veç të tjerave, dhe se çfarë dashurie të madhe e të sinqertë ushqejnë rinia dhe populli ynë për rininë dhe për popullin e madh kinez.

Ne mund të themi se në vendin tonë kemi një rini të lavdishme, heroike dhe revolucionare, të patrembur, punëtore, të edukuar dhe të frymëzuar nga Partia me parimet e ideologjisë sonë marksiste-leniniste dhe të internacionalizmit proletar, të kalitur për çdo punë dhe në çdo drejtim. Rinia jonë, e bashkuar në një uni-

tet të çeliktë rreth Partisë, është e përgatitur dhe qëndron syptrembur përpara çdo rreziku, qoftë edhe përpara rrezikut të një luftime. Kjo është një nga fitoret tona më të mëdha që i kushtohet kujdesit të madh që ka treguar e tregon vazhdimisht Partia për edukimin e brezit tonë të ri.

Ju e patë vetë se sa ngushtë është e lidhur rinia me Partinë tonë. Kjo pasqyron, në të njëjtën kohë, edhe lidhjet e shëndosha që ekzistojnë midis popullit dhe Partisë. Ashtu si na mësojnë klasikët tanë të mëdhenj të marksizëm-leninizmit, Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini, në radhë të parë e mbi të gjitha qëndron çështja e partisë, ekzistenca e një partie të vërtetë marksiste-leniniste, sepse pa partinë nuk mund të ketë fitore. Ajo është pararoja e klasës punëtore, udhëheqësja e fshatarësisë dhe e të gjitha masave punonjëse. Partia, thotë populli ynë, është zemra dhe truri i tij. Pa zemrën nuk mund të rrojë truri dhe pa trurin e pastër njeriu është kurdoherë në errësirë, i çoroditur.

Populli dhe rinia jonë e kanë kuptuar drejt e thellë këtë dhe, siç e vutë re edhe ju, mbi gjithçka duan Partinë. Ata e dinë se pa Partinë nuk do të kishte sot Shqipëri të lirë, të pavarur e sovranë, pa atë vendi ynë do të ishte përsëri një koloni e të huajve dhe në të do të sundonin borgjezia e reaksionarët. Ishte Partia ajo që me vijën e saj të qartë, të drejtë e revolucionare e ngriti popullin në këmbë kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve dhe e futi vendin në rrugën e socializmit. Ajo që dhe është frymëzuesja, udhëheqësja, organizatorja e farkëtuesja e revolucionit tonë popullor dhe e fitoreve të arritura.

Armiqtë tanë, borgjezia reaksionare, imperialistët dhe revizionistët modernë, e dinë fare mirë se, po të dobësojnë e të shkatërrojnë Partinë tonë marksiste-leniniste, atëherë qëllimi i tyre do të arrihet me të shpejtë. Pra sot objektivi kryesor i tyre është dobësimi, kalbëzimi dhe shkatërrimi i partive marksiste-leniniste. Këtu i kanë përqendruar ata bateritë e tyre. Po të arrijnë të dobësojnë, të kalbëzojnë dhe të shkatërrojnë partitë marksiste-leniniste, që këto të deformatojnë parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të partisë, të ideologjisë së partisë, të luftës klasore revolucionare të partisë, atëherë ata kanë arritur të çoroditin edhe popullin, ta lënë në kaos dhe më në fund ta vënë nën zgjedhë. Prandaj, në radhë të parë e mbi gjithçka, ne jemi përpjekur dhe do të përpiqemi që Partinë ta ruajmë, ta mbajmë kurdoherë të pastër, revolucionare dhe në udhëheqje të pazëvendësueshme të vendit.

Kundër Partisë sonë kanë punuar shumë armiç. Shigjetat e tyre ata i kanë drejtuar gjithnjë në çështjen më jetike, që është mbështetja e Partisë në parimet revolucionare marksiste-leniniste. Me orvatjet e tyre ata kanë synuar pikërisht largimin e Partisë sonë nga këto parime, por asnjëherë ne nuk kemi lejuar që armiqtë, qofshin këta të brendshëm apo të jashtëm, t'ia arrijnë qëllimit të tyre. Armiqtë e brendshëm i kemi vënë kurdoherë përpara, i kemi detyruar të tregojnë kalbësitë e tyre, i kemi detyruar të punojnë atje ku duam e ashtu si duam ne, dhe, kur kanë lëvizur bishtin, i kemi goditur pa mëshirë. Këtë e kemi bërë, sepse duhej mbrojtur Partia, këtë e kërkonin in-

teresi i madh i popullit, i socializmit dhe i komunizmit, interesi i revolucionit. Po të mos vepronim kështu do t'i dëmtonim rëndë këta interesa.

Në rast se brenda Partisë dalin tradhtarë, për ne nuk është aspak e lejueshme që këta të mos i dënojmë e të lëmë që krimbi të futet në mollën e kuqe dhe më në fund të arrijë ta shkatërrojë atë. Kurrë nuk e kemi lejuar një gjë të tillë dhe as do ta lejojmë. Lufta e pandërprerë, parimore dhe revolucionare që Partia jonë ka zhvilluar kundër të gjithë armiqve, ka bërë që ajo të mbetet kurdoherë marksiste-leniniste dhe të jetë mbi çdo gjë, e dashur për popullin dhe veçanërisht për rininë tonë. Partia ka bërë që çdo ditë e më shumë të marshojmë përpara.

Në vendin tonë, ata që hodhën themelet e Partisë ishin të rinj, sepse, kur u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë, komunistët ishin në moshën e rinisë. Ata qenë nga elementët më revolucionarë të rinisë punëtore, fshatare dhe asaj shkollore, që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në luftën revolucionare të popullit tonë.

Duke zbatuar parimet dhe normat themelore të marksizëm-leninizmit dhe duke i ruajtur ato si sytë e ballit, ne shikojmë se uniteti brenda radhëve të Partisë, si dhe uniteti i popullit dhe i rinisë rreth Partisë, janë të çeliktë. Tani çështja qëndron që këtë unitet ta ruajmë e ta çelikosim çdo ditë, të jemi vigjilentë që të mos preket e të mos dobësohet nga armiqtë, sepse, siç thotë populli ynë: «Lumi fle, po hasmi s'fle». Prandaj Partia dhe gjithë populli ynë asnjëherë nuk i mbyllin sytë.

Një rëndësi shumë të madhe kanë pasur për ne organizimi dhe disiplina e çeliktë si dje në luftë, edhe sot në ndërtimin e socializmit. Reaksionarët thoshin se shqiptarët janë të hallakatur e nuk bëhen dot kurrrë dy, prandaj ata mendonin se nuk do të ishte e mundur që ne të arrinim të kishim një unitet, një ideologji dhe një disiplinë të fortë në revolucion. Por, në kundërshtim me dëshirat dhe shpresat e tyre, kjo u arrit, dhe u arrit vetëm sepse ne u mbështetëm dhe zbatuam parimet e marksizëm-leninizmit.

Gjatë gjithë veprimtarisë së saj, Partia jonë e ka pasur dhe e ka në rendin e ditës çështjen e organizimit dhe të disiplinës, sepse, atje ku s'ka disiplinë ka anarki, ka çoroditje, atje infiltrojnë më lehtë edhe armiqtë. Eksperienca jonë e fituar në luftë dhe në punë, tregon se atje ku ka punë të dobët ideologjike dhe politike, atje ku lejohen shthurje, krijohen «kë-neta» e mblidhen «mushkonjat». Në të kundërtën, atje ku edukimi revolucionar është në qendër të vëmendjes, atje ku ka organizim e disiplinë të hekurt, «kënetat» kthehen në toka pjellore dhe «mushkonjat» ngordhin, zhduken. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme, e provuar gjatë revolucionit tonë proletar që zhvillohet në mënyrë të pandërprerë.

Rinia jonë, ashtu sikurse e konstatuat edhe ju, duke luftuar dhe duke punuar kurdoherë nën udhëheqjen e Partisë (por duke ruajtur në organizatën e saj karakteristikat e veçanta të rinisë, domethënë jo rreptësinë organizative të punës së Partisë), ka ditur të marrë prej saj tiparet e luftëtares revolucionare, të vendosur për të mbrojtur me konsekuencë parimet e

marksizëm-leninizmit. Të rinjtë tanë e dinë fare mirë se shpirti dhe zemra e tyre është Partia, ata e kanë të qartë kujdesin e vazhdueshëm të Partisë dhe të Komitetit të saj Qendror për edukimin revolucionar të tyre. Rinia jonë ka krijuar besim të patundur te Partia dhe këtë e tregojnë veprat. Kjo ka shumë rëndësi për revolucionin.

Marksii, Engelsi, Lenini e Stalini na mësojnë se revolucioni është një çështje shumë serioze. Këtë mësim të marksizëm-leninizmit Partia jonë është përpjekur ta bëjë mishin dhe gjakun e saj. Asnjëherë ajo nuk ka lejuar të turbullohet uji, nuk ka lejuar kërkënd të peshkojë në ujëra të turbullta. Partia e Punës e Shqipërisë ka goditur, u ka rënë në kokë e i ka shpartalluar me shpejtësi, rreptësi dhe në kohën e duhur të gjithë ata elementë që kërkonin ta bënin një gjë të tillë. Po të lejonim që uji të turbullohej, sidomos në disa situata të veçanta që i janë paraqitur Partisë sonë, do të ndodheshim përpara rreziqesh të mëdha. Kur krijohet një situatë e turbullt, elementët armiq e tradhtarë, revizionistët veçanërisht, përpiqen të gruponen, të organizohen. Me ta duhet mbajtur qëndrim i prerë. Përvoja ka treguar se, po të bëhen tratativa e bisedime joparimore me kundërshtarët, me armiqtë, se po të përdoren për një arsye ose për një tjetër disa forma organizative që pengojnë ecjen e revolucionit përpara dhe po t'i lësh kohë një situatë të turbullt, revolucionit i krijohet vështirësi, i kanosen shumë rreziqe. Prandaj, sa më pak tratativa e bisedime me kundërshtarët dhe këto vetëm kur janë në interes të revolucionit e pa shitur parimet; asnjë formë organiza-

tive që e pengon atë dhe asnjë situatë e turbullt s'duhet të ketë jetë të gjatë. Vetëm kështu revolucioni marshon përpara.

Po përse duhet të ndodhë kështu? Sepse veprimtaria e elementëve armiq është shprehje e kontradiktave antagoniste, është aspekt i zhvillimit të luftës së klasave. Prandaj dhe ne zhvillojmë luftën e klasave. Por lufta që zhvillojmë kundër armiqve tanë është revolucionare marksiste-leniniste, si e tillë ajo është e do të jetë e pamëshirshme kundër të gjithë armiqve, në çdo formë e në çdo ngjyrë që të paraqiten. Për armiqtë e klasës nuk mund të ketë lëshime. Në këtë luftë ka, nga ana jonë, edhe veprime taktike, por këto duhet të jenë revolucionare, të mos bien në kundërshtim me parimet marksiste-leniniste dhe të kenë për qëllim të likuidojnë sa më parë dhe pa mëshirë armiqtë që kanë si objektiv kryesor shkatërrimin e Partisë. Sa më parë të likuidohet grupi kundërrivolucionar që mund të ketë nxjerrë krye, aq më mirë është për revolucionin. Vonësa në zbatimin e masave drakoniane kundër armiqve dhe mëshira për ta janë në dëm të popullit, të partisë, të revolucionit. Këtë duhet ta kuptojmë mirë. Shpartallimi dhe likuidimi i shpejtë i armiqve që ngrenë krye bëhen duke përdorur kundër tyre dhunën revolucionare, duke përdorur në mënyrë të organizuar kritikën e ashpër të masave që Partia i ka ngritur politikisht e ideologjikisht, kritikë kjo, e cila është gjyqi më i madh e më popullor për armiqtë, dhe së fundi, duke siguruar një disiplinë të ndërgjegjshme.

Partia jonë është një parti e vogël, por edhe ajo ka eksperiencën e vet në këtë drejtim. Gjatë historisë

së saj ajo ka nxjerrë mësime të mëdha për këto probleme. Kështu, për shembull, edhe te ne ka pasur ndonjë forum partie rrethi që për një periudhë të shkurtër ka ulur vigjilencën revolucionare. Kjo bënte që në disa organizata-bazë partie të depërtonin elementë jo të mirë. Në këto situata, për likuidimin e tyre Partia jonë ka vepruar me zgjuarsi, me urtësi, por edhe me shpejtësi, duke zbatuar parimet dhe normat marksiste-leniniste. Kryesore kanë qenë spastrimi i organizatave të Partisë nga elementët armiq dhe likuidimi i pasojave të veprimtarisë së këtyre armiqve. Për këtë qëllim, Partia i ka flakur menjëherë jashtë radhëve të saj ata që janë burokratizuar dhe janë larguar nga binarët, bile, kur ka qenë rasti, ka shpërndarë edhe një komitet partie të tërë rrethi, pastaj e ka shtruar këtë problem në organizatat-bazë të Partisë, ka bërë diferencimin e elementëve të këqij nga të gabuarit, ka ngritur ndërgjegjen politike e ideologjike të komunistëve, të mirët i ka këshilluar e i ka edukuar, kurse ata që nuk bindeshin i ka flakur jashtë Partisë dhe pasi janë marrë tërë këto masa ka organizuar zgjedhjen e komitetit të ri të Partisë të rrethit, sepse situatat nuk e lejonin të veprohej ndryshe. Në këtë rast, në fillim, janë shkarkuar ish-drejtesit dhe në zgjedhjet, në krye të komitetit janë caktuar njerëzit më të mirë e më revolucionarë. Kështu e kemi shëndoshur gjendjen jashtëzakonisht shpejt. Në raste të tilla situatën e kemi kapërcyer pa dhimbje, bile kemi korrur suksese: është ngritur më lart ndërgjegjja politike dhe ideologjike e komunistëve dhe e masave.

Shokë, situata sot në botë është revolucionare.

Lufta e armatosur ka filluar të përhapet kudo, në Azi, në Amerikën Latine etj. Ka vende ku komunistët marksistë-leninistë, që e udhëheqin këtë luftë, kanë marrë në disa krahina pushtetin në dorë. Në Birmani, në Tajlandë etj. luftojnë forcat revolucionare, në Indonezi, gjithashtu. Megjithëse Partia Komuniste e Indonezisë bëri gabime dhe pësoi një disfatë të rëndë, ajo do t'i kalojë vështirësitë. Në Amerikën Latine lufta revolucionare rritet çdo ditë. Në Evropë grupet revolucionare marksiste-leniniste po bashkohen dhe po krijojnë partitë e reja marksiste-leniniste, po rritet numri i grevave dhe i demonstratave të punonjësve etj. Ata e kuptojnë se pa luftë dhe pa përmbyse revolucionare nuk mund të zhduket asgjë e vjetër e reaksionare.

Imperialistët dhe revizionistët punojnë e bëjnë të gjitha përpjekjet që të shuajnë vatrat revolucionare, të ndërpresin revolucionin, por s'do t'ia arrijnë kurrë qëllimit. Lufta revolucionare, që është kudo në ngritje, pasqyron edhe nervozizmin e imperialistëve e të revizionistëve, sepse synimi i tyre ka qenë dhe është që çdo gjë të mbetet në qetësi për ata dhe tradhtia të mbulojë botën. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë ndërhyjnë kudo ku ndizen zjarri dhe lufta revolucionare e popujve, për t'i shuar ato. Kjo tregon, gjithashtu, se ata e shohin që po u shket toka nën këmbë. Por më kot mundohen. E ardhmja u takon proletariatit, popujve.

Gjatë ditëve që ishit këtu, ju ndietë pulsën e popullit tonë, forcën e miqësisë e të dashurisë së sinqertë kudo që vajtët, në fusha dhe në male, te punëtorët e fshatarët, te shkollarët e studentët, tek

ushtarët dhe marinarët. Në bazë të kësaj miqësie ne vëmë ideologjinë tonë, marksizëm-leninizmin. Ne jemi shokë e miq në kohë të mira dhe të vështira. Por, për popujt që udhëhiqen nga marksizëm-leninizmi, do të ketë gjithnjë kohë të mira. Natyrisht, në rrugën dhe në luftën tonë të përbashkët, do të ketë edhe vështirësi dhe këto janë të paevitueshme, sepse ato janë pjesë të revolucionit, por ato do të kapërcehen. Prandaj revolucioni duket edhe më i bukur për ne.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**REVOLUCIONI FITON VETËM KUR PARTIA
MARKSISTE-LENINISTE I ZGJON MASAT
DHE I BËN ATO TË NDËRGJEGJSHME
PËR DOMOSDOSHIMËRINË E TIJ**

Nga biseda me dy shokë sudanezë

12 korrik 1967

Si u përshëndet me mysafirët sudanezë, shoku Enver Hoxha i pyeti si ia kaluan në vendin tonë, ç'qendra vizituan dhe ç'përshtypje kishin. Që në fillim ata vlerësuan lart sukseset e arritura nga populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Pastaj shoku Enver Hoxha, vazhdoi:

Me të vërtetë transformimet që kanë ndodhur te ne pas Çlirimit janë të mëdha. Sot kudo në vendin tonë ju shikoni ara të punuara, tarracat e kodrave të mbushura me ullinj e vreshta, por nuk mund ta imagjinoni si ishte Shqipëria më parë. Në Tiranë nuk shikoje nëse kishte fushë ose jo. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fushat kaq të bukura të Myzeqesë dhe të Durrësit, që më parë ishin vetëm kënetat. Ato i lulëzuan puna, lufta dhe përpjekjet e popullit, i

cili kur e kupton dhe e përqafton vijën e drejtë të Partisë, ngrihet e bën mrekulli. Po të vini vitin tjetër do të shikoni gjëra akoma edhe më të bukura. Tani njerëzit tanë u janë qepur maleve. Më parë atje nuk punohej në dimër, kurse tani nëpër male njerëzit hapin toka të reja. Kush i bëri të gjitha këto? Mendja dhe duart e njerëzve tanë të edukuar nga Partia, vija e drejtë e saj, kooperativizmi.

Pas kolektivizimit të bujqësisë janë bërë ndryshime të mëdha edhe në sektorin e blegtorisë, të cilat nuk mund të krahasohen me të kaluarën kur ekzistonte prona private. Kështu, janë arritur rezultate të mira në zgjedhjen e racës, në rritjen e pjellshmërisë dhe në përmirësimin e llojeve që prodhojnë më shumë qumësht, yndyrna dhe mish. Këto suksese në fushën e bujqësisë dhe të blegtorisë ne i kemi arritur duke zbatuar gjer në fund idenë e Leninit mbi kooperativizmin.

Akoma më të dukshme janë sukseset tona në zhvillimin e industrisë. Kudo janë ngritur fabrika, uzina dhe numri i tyre po rritet çdo ditë. Tani punohet për zgjerimin e rrjetit hekurudhor, i cili para Çlirimit s'ka ekzistuar fare. Pra, suksese ne kemi në të gjithë sektorët.

Këto s'mund t'i mohojnë dot as armiqtë tanë, të cilët e kanë të vështirë t'ua fshehin ato masave punonjëse të vendeve të tyre, sepse sot realiteti ynë është bërë pak a shumë i njohur për popujt e tjerë e sidomos për fqinjët. Kjo është arsyeja që në disa raste politikanë, diplomatë, gazetarë e specialistë borjezë, kur flasin për Shqipërinë, janë të detyruar të

përmendin edhe realizimet tona, të cilat, pa dyshim, i shohin nga këndi i botëkuptimit të tyre. Kohë më parë na erdhën disa specialistë italianë për të parë hidrovorët në vendin tonë. Ata ishin elementë që e kishin njohur Shqipërinë edhe më përpara, sepse kishin qenë te ne gjatë kohës së pushtimit italian. Kur u kthyen në Itali, ata botuan një artikull në gazetën e tyre më të madhe, ku, megjithëse deklarorin se s'ishin dakord me regjimin tonë, flitnin edhe për përparimet e përndryshimet e mëdha që janë bërë te ne gjatë viteve të pushtetit popullor. Pra, realiteti ynë jo vetëm i hedh poshtë të gjitha shpifjet që kanë përhapur e përhapin armiqtë për vendin tonë, por çdo ditë e më shumë i detyron ata t'i pranojnë realizimet tona në një mënyrë ose në një tjetër, qoftë edhe me gjysmëzëri.

Baza e të gjitha fitoreve tona është rendi ynë socialist. Populli shqiptar ka punuar e ka luftuar vazhdimisht, por ai filloi t'i gëzojë me të vërtetë frytet e punës së tij vetëm kur, nën udhëheqjen e Partisë, bëri revolucionin dhe mori pushtetin në duart e veta. Socializmi është e ardhmja e popujve, i cili i çliron me të vërtetë ata nga çdo lloj shtypjeje e shfrytëzimi. Por kalimi në këtë rend ekonomiko-shoqëror nuk bëhet vetvetiu. Në socializëm kalohet vetëm me revolucion, i cili zhvillohet me sukses kur organizohet e udhëhiqet nga partia që mbron me konsekuencë interesat e proletariatit. Këtë rrugë do të ndjekë çlirimi i të gjithë popujve, pra edhe i popullit tuaj.

Por jemi të ndërgjegjshëm se, me gjithë sukseset

e arritura, kemi akoma shumë për të bërë, prandaj për t'i çuar më përpara ato, në të gjithë vendin kanë shpërthyer iniciativa të mëdha revolucionare.

Zhvillimi i gjithanshëm i shoqërisë sonë socialiste është baza dhe garancia për ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale të masave punonjëse, që të ne po rritet nga dita në ditë, kurse mirëqenia që trumbetojnë revizionistët për vendet e tyre, me sa konstatojmë, nuk është reale. Kjo duket edhe në faktin se tani ata po u shtrijnë dorën imperialistëve jo vetëm për kredi, por edhe për produkte ushqimore e sidomos për drithë.

Dikur në disa nga vendet ish-socialiste kishte një bazë ekonomike të mirë dhe bujqësi të zhvilluar, kurse me futjen e tyre në rrugën revizioniste gjendja ka ndryshuar krejtësisht, kooperativat bujqësorë kanë filluar të braktisen, po rriten kopshtet personale dhe po zhvillohet tregu i zi. Është e qartë se rruga ku kanë hyrë do t'i çojë nga batakun në batak.

Populli sudanez është një popull i thjeshtë, punëtor e trim. Gjatë historisë së tij shekullore ka luftuar dhe i ka mundur pushtuesit turq e anglezë. Por megjithatë edhe sot jeton në mjerim. Këtë ai e ndien thellë në palcë, prandaj ka nisur të organizohet për t'u hedhur në revolucion. Natyrisht, këtë do ta bëjë mirë vetëm kur të jetë organizuar atje partia e vërtetë marksiste-leniniste, e aftë për ta mobilizuar, për ta organizuar, për ta hedhur në revolucion e për ta udhëhequr atë nga fitorja në fitore.

Partia jonë që në fillim i ka kushtuar rëndësi të veçantë, në radhë të parë, çështjes së organizimit

të masave për t'i hedhur ato në revolucion. Çështja e marrjes së pushtetit me armë, me dhunë, është në vijën tonë marksiste-leniniste. Çdo teori tjetër që përjashton këtë parim, është revizioniste. Borgjezia, me të mirë, nuk të lëshon asgjë, prandaj duhen përgatitje për përmbysjen e saj. Duke pasur të qarta vijën dhe nevojën e organizimit të revolucionit, partia, në radhë të parë, është e ndërgjegjshme se ajo dhe masat duhen përgatitur, duhen armatosur, pse, pa krisur pushka dhe pa plasur bomba, armiku nuk përmbysët. Dhe kur ta ketë të qartë këtë, atëherë do të ketë të qartë teorinë e Marksit e të Leninit që revolucioni është një çështje shumë serioze, me të cilin nuk mund të bëhet shaka, po e fillove, duhet ta çosh gjer në fund.

Një parti e organizuar dhe e udhëhequr në jetën e saj nga parimet marksiste-leniniste ka mundësi që gjatë revolucionit, çdo pengesë ose vështirësi që i del përpara, ta zgjidhë me sukses nëpërmjet luftës. Parimet marksiste-leniniste gjejnë zbatim në qoftë se ato lidhen organizativisht dhe politikisht me situatën konkrete. Ne kemi pasur rast të takohemi disa herë me shokun Stalin. Ai kurdoherë na porosiste të kishim kujdes që parimet të mos i shtrembëronim, por t'i zbatonim dhe t'i zhvillonim në bazë të kushteve konkrete, politike dhe ekonomiko-shoqërore të vendit, të popullit tonë. Kur ne bënim hapat e parë drejt socializmit, Stalini disa herë, na kishte tërhequr vëmendjen të kishim parasysh që shembullin e Partisë Komuniste Bolshevike dhe të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të mos e merrnim në mënyrë

shablone. Ju do të arrini patjetër këtu ku jemi ne, na thoshte ai, por duhet që gjithnjë të hidhni hapa të matur. Dhe ne, mësimet e marksizëm-leninizmit, këshillat e Stalinit i zbatuam me përpikëri dhe në çdo etapë korrëm suksese.

Në fillim ne e organizuam Partinë në qytet me elementë të klasës punëtore, të rinisë, të nëpunësve të vegjël dhe me disa fshatarë. Të tilla ishin kushtet tona. Luftën, gjithashtu, e filluam në qytet, pse në qytet ishin grumbulluar forcat kryesore të armikut dhe administrata e tij e egër. Partia i goditi këto forca me të gjitha format e luftës, forcoi besimin në vetvete dhe i tregoi popullit se ajo ishte në gjendje t'i bënte ballë këtij armiku të madh e të armatosur gjer në dhëmbë. Pra, Partia jonë u formua në qytet dhe këtu ajo goditi armikun në fillim, këtu komunistët bënë demonstratat, atentatet dhe sabotimet e para. Këto, nga njëra anë, shërbyen për të tronditur armikun në të gjithë Shqipërinë, nga ana tjetër, i treguan masës se kush po i dilte për zot Shqipërisë, cila ishte ajo që do ta udhëhiqte në beteja deri në fitore të plotë. Por ne e kishim të qartë se Partia nuk mund të shkonte vetëm në revolucion, as vetëm me proletariatin, por me të gjitha masat e gjera punonjëse, pra edhe me fshatarësinë. Prandaj, Partia, duke organizuar luftën në qytet, njëkohësisht nuk harroi fshatin, sepse, po ta harronim këtë, nuk do të ishim as marksistë, as realistë; po ta harronim këtë do të harronim popullin; pse shumicën e popullsisë e përbënin fshatarët, do të harronim momentin e madh të çlirimit nacional dhe që atdheu, toka, pas së cilës

fshatarësia ishte e lidhur aq ngushtë, duheshin çliruar me luftë kundër pushtesve.

Të gjithë ne, marksistë-leninistët, duhet ta kuptojmë mirë rëndësinë e madhe që ka fshati për revolucionin. Si e ka kuptuar dhe si e ka zbatuar këtë çështje Partia jonë? Natyrisht, te ne ka ndikuar edhe momenti i çlirimit nacional që fshatarësia përkrahu aq shpejt Partinë dhe ka luajtur një rol vendimtar në Luftën Nacionalçlirimtare. Por Partia jonë i kishte të qarta parimet e marksizëm-leninizmit. Pavarësisht se klasa punëtore ishte e vogël në numër dhe fshatarësia, që ishte patriote, trime e revolucionare, përbënte shumicën e popullsisë, qysh në fillim ajo theksoi se në udhëheqje të luftës duhet të jetë klasa punëtore e armatosur me ideologjinë e proletariatit, marksizëm-leninizmin, kurse fshatarësia është aleatja e saj. Pati «teoricienë» që pyetnin me dyshim: «Do ta ndjekë fshatarësia klasën punëtore?». Ne përgjigjeshim: «Po, do ta ndjekë». Megjithatë kishim parasysh se nga ana e saj do të kishte edhe lëkundje, sepse, siç dihet, fshatarësia ka karakter të dyfishtë.

Fakti është që te ne, Partia, shtylla kurrizore e klasës punëtore, duke qenë e armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste, e udhëhoqi fshatarësinë në luftë dhe siguroi fitoren. Ne e dimë se pa përkrahjen e fshatarësisë nuk do ta kishim siguruar fitoren. Me forcat që kishte Partia studioi karakteristikat e fshatarësisë sonë dhe pa se ajo kishte pluset dhe minuset e saj. Minuset e saj ishin se borgjezia jonë e re, kapitalizmi dhe feudalizmi kishin bazat e tyre në

fshat. Shumë udhëheqës të organizatave reaksionare njiheshin para pushtimit fashist si demokratë, bile disa prej tyre kishin luftuar më parë edhe kundër italianëve, natyrisht, për interesat e tyre; një pjesë tjetër, gjatë regjimit të Zogut, duke mos iu kënaqur interesat e tyre u armiqësuan me këtë regjim dhe ishin arratisur si emigrantë politikë. Të gjithë këta pseudo-demokratë u kthyen përsëri pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Këta njerëz kishin njëfarë emri, me të cilin spekulonin, kurse ne në atë kohë ishim të rinj dhe populli nuk na njihte. Këta «patriotë» u munduan të mashtronin fshatarësinë gjatë luftës, por shpejt u dolën horllëqet, sepse, kur u krijua Partia dhe goditi menjëherë pushtuesin, kur fshatarët panë se komunistët po derdhnin gjakun lumë thanë: «Këta qenkan për ne, kjo Parti të na udhëheqë!». Veçanërisht me ardhjen e nazistëve gjermanë në Shqipëri demagogët e hoqën maskën, ndërsa patriotët e ndershëm, nën udhëheqjen e Partisë, s'e lëshuan pushtimin nga dora deri në Çlirimin e plotë të vendit. Pra, që gjatë luftës u bë edhe diferencimi midis patriotëve dhe pseudopatriotëve. Kështu veproji Partia jonë me fshatarësinë.

Por çdo parti duhet të veprojë sipas kushteve të vendit të vet. Kjo ka rëndësi të madhe. Situatat në vendet ku militojnë partitë marksiste-leniniste me stazh të gjatë dhe që qëndrojnë në pozita të forta, apo partitë e grupet e reja marksiste-leniniste që po zhvillohen, nuk paraqiten kudo njëjloj. Ka vende agrare me një industri thujse krejtësisht të prapambetur, pra, me një klasë punëtore fare të vogël,

ka vende me industri e me klasë punëtore të zhvilluar, ka vende të tjera ku ekziston një shfrytëzim i madh kapitalist, diku ka një klasë fshatare shumë konservatore etj. Situatat, pra, ndryshojnë sa në një vend në tjetrin. Kjo kërkon që përvoja revolucionare marksiste-leniniste të zbatohet nga çdo parti me një qartësi të madhe, në kushtet konkrete të çdo vendi.

Partia marksiste-leniniste duhet ta përcaktojë mirë qëndrimin e saj ndaj klasave dhe shtresave të ndryshme të popullsisë së vendit. Kur do të bësh bukën, duhet të kesh miellin më parë, të dish pastaj me ç'miell do të gatuash. Edhe partia pra, duhet të njohë mirë cilat klasa dhe shtresa të popullsisë janë më afër saj, kush është kolona e saj vertebrore, cila është aleatja e klasës punëtore, cilët do të drejtojnë dhe do të udhëheqë partia etj. Çdo gjë, në çdo vend, varet nga vlerësimi i drejtë marksist-leninist i gjendjes konkrete dhe i forcave lëvizëse. Kështu, në ndonjë vend ekziston e përbën një forcë të madhe edhe proletariati i fshatit, i cili, sipas mendimit tim, qëndron shumë afër klasës punëtore, ose mund të themi bile që është pjesë përbërëse e saj nga ana klasore, pse ashtu si proletariati i qytetit edhe ai i fshatit nuk ka asgjë përveç krahëve të veta. Këta njerëz rrojnë e punojnë në fshat, aspiratat e tyre janë, për shembull, për përmbysjen e trusteve të çajit apo të kafesë të kapitalistëve të tokave, qofshin këta të huaj ose të brendshëm, për të realizuar dëshirën që toka të bëhet e tyre. Por proletariati i fshatit shndërrohet në një forcë të madhe revolu-

cionare dhe në një levë të rëndësishme të partisë kur udhëhiqet nga idealet e klasës punëtore në çështjet konkrete të fshatit.

Lenini na mëson se për të shkuar në revolucion partia komuniste duhet t'u vërë rëndësi bashkimeve profesionale, sindikatave, që këto t'i ketë nën drejtimin e saj, të influencojë në to, të krijojë një lidhje të fortë me elementët e klasës punëtore, pse ata do të jenë pionierët më të vendosur, më të qartë e tej-pamës për ta çuar vijën e partisë edhe në fshat. Në vendet ku mbizotërojnë feudalizmi e gjysmëfeudalizmi jeta është shumë e rëndë, ekziston një shtypje e madhe dhe shumëformëshe, prandaj edhe atje masat janë të predispozuara për revolucion.

Rinia është thesari ynë më i çmuar, e ardhmja jonë. Sa më e pastër të jetë rinia, aq më e sigurt është e ardhmja e Partisë. Sa më mirë të edukohet rinia, aq më e fortë është Partia, pse ajo është fidanishtja e Partisë. Po të jetë e degjeneruar rinia, edhe e ardhmja e Partisë është e errët. Kjo është një çështje jetike për popullin. Kush do Partinë dhe popullin, duhet të kujdeset që rinia të jetë e pastër. Me të gjitha forcat revizionistët sot punojnë për të degjeneruar rininë, sepse kështu duan të degjenerojnë partinë dhe më në fund të arrijnë që kapitalizmi të sundojë në gjithë botën.

Të marrim çështjen e Frontit. Kur krijuam Partinë, në Shqipëri s'kishte asnjë parti tjetër, bile as pas krijimit të Partisë te ne nuk ka pasur parti të tjera. Ndryshe është në vendin tuaj. Në Sudan, përveç grupit revizionist, ekzistojnë edhe parti borgjeze. Pra-

ndaj krijimin e Frontit ju, patjetër, e llogaritni ndryshe nga ne, në përputhje me kushtet tuaja.

Me krijimin e Frontit ne hodhëm parullën që rreth tij të bashkoheshin të gjithë, pa dallim feje dhe pikëpamjesh politike, vetëm me kusht që ata të hidheshin në luftë kundër pushtuesit. Si kundër-reaksion ndaj Frontit Nacionalçlirimtar doli organizata Balli Kombëtar, në të cilën bënë pjesë klasat e pasura të vendit, po edhe njerëz të thjeshtë të mashtruar. Edhe kjo nuk ishte parti. Ne i bëmë thirrje kësaj organizate të bashkohej në Front, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, por ajo nuk e bëri këtë, dhe, natyrisht, s'do ta bënte, sepse s'mund të tradhtonte qëllimin për të cilin ishte krijuar. Balli Kombëtar ishte krijuar nga forcat reaksionare për të na luftuar ne. Megjithatë ne bëmë të gjitha përpjekjet që kjo organizatë të hidhej në luftë kundër pushtuesit, kurse ajo, meqenëse përfaqësonte interesat e klasave shfrytëzuese, vuri si qëllim kryesor luftën kundër nesh dhe jo luftën kundër tij. Më në fund, përpjekjet tona bënë që ajo të demaskohej si bashkëpunëtore e pushtuesit. Kështu u fillua dhe u zhvillua Lufta Nacionalçlirimtare nën udhëheqjen e Partisë, pa u ndier aspak nevoja të krijohej një parti tjetër. Ky ishte një zhvillim real e origjinal i marksizëm-leninizmit në kushtet tona.

Në situatën tonë reale kjo ishte më demokratike, pse të gjitha qëllimet politike, ekonomike dhe luftarake realizoheshin në mënyrë më demokratike brenda Frontit Nacionalçlirimtar. A duhej Partia jonë në këto kushte të inkurajonte krijimin e partive të tjera? Në

asnjë mënyrë jo! Ne të inkurajonim krijimin e partive të tjera me qëllim që borgjezia të mos na akuzonte për vendosjen e diktaturës? Po ne nuk e mendojmë se jemi për diktaturën e klasës punëtore, që përfaqëson demokracinë më të gjerë për masat punonjëse dhe shtypjen për armiqtë.

Po sikur në vendin tonë të ekzistonin parti të tjera, ashtu siç ndodh te ju, çfarë do të bënim? Ne do të përpiqeshim të merreshim vesh me ato përparimet dhe, atje ku të përqeshim, do të kryenim aksione të përbashkëta momentale ose perspektive, por kurdoherë duke ruajtur mëvetësinë e Partisë dhe rolin e saj udhëheqës dhe duke mos bërë asnjë lëshim në parimet. Dhe, në qoftë se nuk do të kishim mundësi të merrnim drejtimin e lëvizjes që në fillim, do të përpiqeshim ta merrnim atë patjetër më pas. Pra, në asnjë mënyrë nuk duhej të ecnim në bisht të partive të tjera, por të qëndronim në pararojë dhe t'u impononim atyre pikëpamjet tona revolucionare, pa iu trembur goditjeve të armikut.

Në kohën e regjimit feudal të Zogut në Shqipëri ishin krijuar grupe komuniste që grindeshin me njëri-tjetrin. Këto grindje morën fund me formimin e Partisë, por jo pa luftë. Ajo, që me themelimin e saj, përcaktoi një vijë të drejtë për kryengritjen e armatosur. Kjo ka shumë rëndësi, pse revolucionin nuk mund të fitohet me trëndafila dhe as me parlamentarizëm, por me luftë të armatosur. Kur themi se fitorja e revolucionit arrihet me luftë, kjo do të thotë që ka brenda edhe rreziqet e goditjes, gjakderdhjen. Ajo që i ngjau Partisë Komuniste të Indonezisë është

një eksperiencë e hidhur, që rrodhi nga lëkundja në vijë, nga krijimi i disa iluzioneve jomarksiste mbi demokracinë borgjeze, nga mosorganizimi i partisë në forma të atilla për të përballuar çdo të papritur. Revolucioni nuk ecën kurdoherë në vijë të drejtë, ai ka përparim, po mund të ketë edhe tërheqje. Ai godet, por edhe mund të goditet. Prandaj, për ne, vihet çështja të godasim më shumë dhe të mbrohemi më mirë.

Sipas mendimit tonë, ju zhvilloni një punë organizative partie të drejtë, pse, për të evituar goditjet e armikut, keni parasysh edhe çështjen e ilegalitetit të partisë.

Organizimi ilegal i partisë në vendet ku sundon borgjezia, për mendimin tonë, është një problem shumë i rëndësishëm. Ai është një art që u përket komunistëve të çdo vendi që, si arkitektë, ta ndërtojnë atë e ta kombinojnë me punën legale, sipas kushteve konkrete të terrenit të tyre. Në këtë drejtim ka disa përparime në lëvizjen marksiste-leniniste, por ne mendojmë se përparimet duhet të shpejtohen e të lidhen më ngushtë me situatat që po kalojmë.

Ka shumë forma për organizimin e punës legale e ilegale të Partisë. Po kush e përcakton qëndrimin legal ose ilegal? Kjo përcaktohet nga kushtet konkrete. Ku duhet të jetë qendra, në qytet apo në fshat? Edhe kjo përcaktohet nga kushtet. Cilët duhet të jenë më shumë në ilegalitet, punëtorët apo fshatarët? Ata që janë më të vendosur, më të rrezikshmit për borgjezinë. Jeta këtë ka vërtetuar.

Desha të theksoj se, siç na mëson doktrina jonë marksiste-leniniste, çdo gjë zhvillohet në hapësirë dhe

në kohë. Kjo duhet pasur parasysh shumë nga partia marksiste-leniniste, ndryshe, ajo do të gabojë. Ajo çdo hap duhet ta hedhë të matur, veçanërisht kur çështja ka të bëjë me ndjenjat e popullit.

Partia duhet të jetë një detashment i organizuar dhe i kalitur me një disiplinë të hekurt. Një disiplinë të tillë të hekurt kemi pasur ne që në kohën e luftës. Partia dha atëherë direktivën që partizanët të mos preknin asnjë kokërr kumbull të fshatarit, të mos preknin nderin e gruas, ndryshe do të merreshin masa të rënda, deri edhe me pushkatim. Këto vërtet janë probleme moralo-shoqërore, por kanë të bëjnë edhe me vijën, pse, pa një disiplinë të hekurt në parti, në revolucion, krijohet anarki dhe me anarki partia dhe revolucioni dështojnë.

Në lidhje me atë që çdo gjëje i duhet gjetur koha dhe vendi po jap një shembull: Në qoftë se ne menjëherë pas Çlirimit do të zbatonim për emancipimin e gruas, për luftën kundër fesë dhe paragjykimeve fetare politikën që ndjekim sot deri në mbylljen e kishave dhe të xhamive, manastireve e teqeve, do të bënim një gabim të madh dhe me siguri nuk do të kishim këtë unitet të çeliktë që ekziston tani midis popullit dhe Partisë, nuk do të kishim këtë hov të madh revolucionar. Populli nuk do ta kuptonte drejt hedhjen e këtyre hapave, në qoftë se Partia nuk do të përgatiste më parë terrenin, opinionin shoqëror.

Prandaj, pas fitores, si marksistë, ne nuk mund t'i pritnim me thikë të gjitha këto, por duhej të ishim prudentë, sepse ata që besonin, bile edhe nga klerikët, kishin marrë pushkën dhe ishin hedhur në

luftë, pra, e donin Partinë tonë, e mbronin dhe e ndiqnin atë në ndërtimin e socializmit. Nga ana tjetër, Partia jonë i dha popullit të kuptojë, nëpërmjet vijës dhe edukimit të saj, se, në kushtet e luftës dhe të rindërtimit, çështja e besimit te zoti, te fuqia e mbinatyrshme duhej të lihej në radhë të tretë a të katërt. Megjithatë Partia jonë ka zhvilluar kurdoherë një luftë sistematike kundër fesë, si ideologji reaksionare. Natyrisht, ajo nuk i ndau artificialisht fazat nëpër të cilat do të kalonte lufta për këtë problem, por, gradualisht, pa bujë, me propagandën antifetare që bëri, ngriti politikisht e ideologjikisht masat e popullit, dhe në radhë të parë rininë, punëtorët, më pas fshatarët, pleqtë dhe gratë. Partia ka ditur t'i analizojë drejt këto situata, sepse e kuptonte që kishte të bënte me çështje të rëndësishme ideologjike. Ajo ishte e bindur se, duke edukuar masat me ideologjinë marksiste, patjetër, do të shkatërronte nga rrënjët ideologjinë fetare dhe gjithë ideologjinë borgjeze. Por, siç thashë, Partia nuk harroi që në këtë çështje kishte të bënte me popullin, i cili ishte i lidhur ngushtë me të. Çrrënjësja e botëkuptimit fetar do të vinte si pasojë e bindjes ideologjike të masave. Prandaj Partisë i duhej t'i sqaronte mirë masat derisa të arrinte të krijonte me punën e saj një situatë të atillë si ajo e këtyre muajve të fundit që Partia e gjeti se tashmë ishin pjekur kushtet për të bërë një hap cilësor të paparë dhe e bëri këtë me sukses.

Shokët tanë mund t'ju kenë informuar se gjatë shpërthimit dhe zhvillimit të lëvizjes kundër fesë e zakoneve prapanike nuk ngjau as gjëja më e vogël

e papëlqyeshme. Partia e kishte të qartë se mbyllja e kishave dhe e xhamive, mosmbajtja e ramazanit, mosfestimi i krishtlindjeve e i bajramit, zhdukja e mbeturinave dhe e zakoneve të vjetra, të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me fenë, në asnjë mënyrë nuk mund të bëheshin me masa administrative, por me bindje. Vetëm kështu korrëm fitore mbi errësirën. Megjithëkëtë, a mund të themi se i kemi shkukur fenë dhe të gjitha zakonet prapanike nga rrënjët? Jo. Për këtë do të duhen akoma dhjetëra e dhjetëra vjet, ndofta edhe më shumë. Por rëndësi ka që këto do të zhduken dhe brezat e rinj s'do ta ndiejnë më helmin e kësaj ideologjie.

Pra e kam fjalën këtu: Ne nuk e morëm këtë çështje të rëndësishme shabllon dhe të mendonim se mbasi jemi ateistë, marksistë, e meqë jemi në fuqi dhe ndërtojmë socializmin të nxirrnim një dekret për të prishur institucionet fetare e të tjera, pra, të trajtonim në mënyrë skematike dhe sektare një gjë kaq delikate për popullin. Jo. Partia jonë në këtë luftë është udhëhequr vazhdimisht nga parimi i lirisë së ndërgjegjes, që njerëzit të bindeshin nga vetë përvoja e tyre në kotësinë e fesë dhe në dëmin që i sjell ajo shoqërisë socialiste. Unë nuk e di mirë se si paraqitet gjendja në Sudan lidhur me këtë çështje, ju e njihni atë më mirë, por në vendin tonë, sado që është në Evropë, ku feja ka pasur një zhvillim të madh, populli ynë, megjithëse besonte te zoti, e kishte të lëkundur, në mos të humbur, besimin te klerikët. Kjo gjendje ka origjinën e saj. Ajo është shkaktuar nga veprimtaria e tyre reaksionare. Fetë e ndryshme, si kudo,

edhe në Shqipëri u kanë shërbyer si armë ideologjike sunduesve të brendshëm e pushtuesve të huaj për ta përçarë dhe për ta robëruar popullin, ndërsa shumica e klerikëve ishin vegla të tyre. Kështu, klerikët myslimanë kanë qenë të lidhur me pushtuesit otomanë, ata ortodoksë me pushtuesit grekë, kurse klerikët katolikë me fashistët italianë. Kjo ka sjellë që populli shqiptar të mos ketë qenë i lidhur fort me fetë, të mos ketë qenë aq fanatik, që kleri të mos ketë pasur atë ndikim në masat popullore si në shumë vende të tjera dhe klerikët të mos gëzonin besimin e popullit, por të ishin në kontradiktë me të. Duke pasur parasysh historinë e popullit sudanez, besoj se edhe te ju do të jetë e njëjta gjendje, siç ka qenë te ne më parë.

Pra, kushtet konkrete kanë rëndësi të madhe. Ato mund t'i analizojë e t'i shfrytëzojë në mënyrë objektive vetëm një parti marksiste-leniniste me parime të qarta dhe, në bazë të tyre, të përcaktojnë punën organizative, politike dhe ideologjike që duhet të bëjë me masat e gjera të popullit, me punëtorët dhe me fshatarët, pa prekur ndjenjat e tyre. Partia jonë gjithmonë porosiste të mos prekeshin ndjenjat e besimit të popullit, ndërsa komunistëve u kërkonte patjetër të ishin afetarë, domethënë të kuptonin thelbin e doktrinës sonë materialiste, që është në kundërshtim me teorinë idealiste, shtylla kurrizore e së cilës është feja. Partia kishte porositur që komunistët të evitonin interpretimet morale të fesë, qoftë myslimane, qoftë ortodokse, qoftë katolike, me marksizmin, siç bëjnë sot disa «teoricienë», të vetëquajtur komu-

nistë, andej nga ju, që pretendojnë se socializmi mund të ndërtohet duke u bazuar në fenë islame.

Baza teorike e fesë islame, ashtu sikurse e feve ortodokse dhe katolike, është idealiste. Fetë, në radhë të parë, kanë pasur si qëllim të gënjejnë popullin dhe klasat sunduese janë përpjekur t'u adaptohen disa situatave objektive në favor të tyre. Prandaj, komunistëve, duke kuptuar mirë parimet materialiste të doktrinës sonë, as u shkante ndër mend të bëheshin interpretë dhe ta shpjegonin marksizmin me dogmat e Kuranit apo të Ungjillit.

Mund të themi se në radhët e Partisë sonë gjen shumë pak të atillë që bien në kundërshtim me ideologjinë dhe filozofinë tonë materialiste. Në parim edhe këta të paktë e kanë kuptuar këtë, por, ngandonjëherë, kur vjen çështja në praktikë, sidomos për zakonet, ndodh që bien në kundërshtim, sepse feja ka ditur shumë mirë të infiltrojë dhe të plekset në mënyrë djallëzore në shfaqjet e jetës së njerëzve që kur lindin e gjersa vdesin. Ne sot jemi hedhur në front të gjerë në luftë për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të gjithë jetës së vendit. Për këtë revolucionarizim që bëjmë, ne kemi krijuar baza të shëndosha, në radhë të parë besimin e madh të popullit të Partia, pse ç'thotë Partia populli e ka bërë dhe e bën, mbasi ai e kupton se çdo gjë është në interesin e tij. Prandaj ne po i godasim sot me qaq forcë e më shumë se kurrë dhe frontalisht të gjitha pleksjet e ideologjisë idealiste me zakonet prapanike.

Këto probleme në vendin tuaj besoj se janë në një fazë që kanë qenë dikur te ne, por, natyrisht,

me karakteristikat e tyre, të cilat partia marksiste-leniniste nuk mund t'i neglizhojë. Këto probleme shoqërore të mëdha ekzistojnë edhe në qytet, po veçanërisht në fshat. Në mos gabohem, shumica e popullsisë së Sudanit është fshatare dhe në jetën shoqërore të fshatit këto të këqija ekzistojnë, por fshati te ju, sikurse edhe te ne, ashtu si e thashë në fillim, është një bazë e rëndësishme për luftën dhe revolucionin. Prandaj atje duhet punuar me prurëncë.

Tëni desha të flisja edhe pak për çështjen arabe. Në OKB ne e mbrojtëm me vendosmëri këtë çështje dhe, siç na thanë disa udhëheqës arabë, e mbrojtëm sikur të ishim vetë arabë, bile pati miq që na thanë: «Atë që nuk mund ta thoshin qeveritë tona borgjeze e tha Qeveria Shqiptare». Qëndrimi ynë i drejtë e miqësor i ka përmirësuar në mënyrë të dukshme marrëdhëniet tona me vendet arabe. Projekti i paraqitur në OKB nga Qeveria Shqiptare për ndalimin e agresionit izraelito-imperialist, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të popujve arabë në kanalin e Suezit dhe në gjirin e Akabasë u vë kufirin te thana, si imperializmit dhe revizionizmit. Ne përkrahim botërisht popujt arabë kundër sulmeve agresive të Izraelit, të nxitura nga imperialistët amerikanë e revizionistët sovjetikë.

Çështja e parë që ka rëndësi, mendojmë ne, është se me këtë rast popujt arabë panë më mirë se kush ishin miqtë dhe armiqtë e vërtetë. Ata e kuptuan se armiqtë kryesorë për ta dhe për të gjithë popujt e botës janë imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, si dhe

aleatët e tyre. Popujt arabë e panë këtë konkretisht në goditjen direkte që ata u bënë intercsave të tyre.

Çështja e dytë, edhe kjo me rëndësi, është ajo e unitetit midis vendeve arabe. Uniteti që u arrit në fillim midis udhëheqësve të qeverive borgjeze, nuk pati suksesin e kërkuar, sepse ai ishte një unitet i rremë, i paqenë. Por, sido që është, arritja e këtij uniteti kundër imperializmit, megjithëse s'dihet sa do të zgjatë, ne e kemi të qartë se ishte refleks i dëshirës së popujve arabë, i luftës kundër armikut të tyre kryesor. Fitorja arrihet vetëm duke u mbështetur te populli.

Çështja e tretë, ndofta më e rëndësishmja, është që këto dy fitore të popujve arabë, njohja e miqve dhe e armiqve, si dhe uniteti, sido që është, të konsolidohen. Por si? Ky është problemi themelor. Ato duhet të konsolidohen duke pasur bazë popullin dhe duke intensifikuar luftën kundër imperializmit e revizionizmit modern, të cilët shkaktuan disfatën e popujve arabë, si dhe duke bërë çmos për të arritur unitetin e popujve arabë kundër këtyre armiqve. Këtu konsiston ndihma që duhet të japin marksistë-leninistët dhe patriotët e vërtetë të Sudanit dhe të të gjitha vendeve arabe etj., me qëllim që arritja e këtij uniteti të mos pritët vetëm nga qeveritë borgjeze të vendeve arabe, sepse, po t'u lihet në dorë vetëm atyre, ky nuk është i sigurt, por i lëkundshëm. Popujt arabë, të gjitha forcat përparimtare dhe lëvizja marksiste-leniniste, duhet t'u bëjnë presion për të arritur unitetin e vërtetë kundër armikut të përbashkët.

Lufta kundër Izraelit është një luftë që ka të

bëjë me momentin nacional, me çlirimin, prandaj qeveritë borgjeze, duan s'duan, janë të detyruara të veprojnë. Pikërisht këtu popujt arabë duhet të përfitojnë për t'u bërë presione të vazhdueshme qeverive të vendeve të tyre. Pra, uniteti i vërtetë mund të arrihet vetëm kur mbështetet në masat dhe kur masat t'i bëjnë presion kësaj apo asaj qeverie, por duhet pasur parasysh se ka edhe nga ato qeveri që, duke pasur frikë nga masat, fshehtas nga këto, nëpër kulisa, thurin intriga e kompromise deri edhe për të shitur vendin. Prandaj popujt të jenë vigjilentë.

Disa nga udhëheqësit e vendeve arabe po reflektojnë disi mbi demagogjinë e të ashtuquajturve miq dhe për të ashtuquajturën ndihmë të tyre ushtarake dhe politike. Popujt e vendeve arabe edhe në të ardhmen do të nxjerrin mësimë dhe do të dinë të dallojnë miqtë e tyre të vërtetë nga pseudomiqtë, do të dinë se te cili mik të mbështeten dhe nga cili të ruhen. Populli ynë përdor një shprehje: «Na ruajtë zoti nga armiku që të hiqet si mik e të ha në besë, se armikun e hapët e kam merak vetë».

Për t'ia arritur qëllimit final, në popujt arabë dhe të të gjithë Afrikës të krijohet besimi se ata janë më të fortë nga imperialistët, nga revizionistët dhe nga borgjezia e vendit që ka tendencë të bëjë kompromise me këdo në dëm të interesave të popujve për të ruajtur interesat e veta dhe se në luftën e tyre të drejtë popujt arabë nuk janë të izoluar, por kanë mbështetjen e gjithë popujve, forcën dhe solidaritetin e tyre ndërkombëtar.

Detyra e partive marksiste-leniniste, mendojmë

ne, është të bëjnë të gjitha përpjekjet që popujt arabë të kuptojnë se problemet e tyre nuk mund të zgjidhen me amerikanët dhe me sovjetikët, të kuptojnë se këto dy fuqi të mëdha janë armiq të popujve dhe veçanërisht të popujve arabë, se çdo veprim i imperialistëve dhe sidomos i revizionistëve sovjetikë, pse këta bëjnë demagogji të madhe, është në dëm të popujve, në dëm të unitetit, në dëm të revolucionit në vendet arabe dhe të Afrikës.

Ato duhet të ngjallin te popujt arabë dhe afrikanë besimin në forcat e tyre. Është e vërtetë se juve ju mungojnë armët dhe se lufta nuk bëhet veçse me armë. Por kujtoni si kanë luftuar stërgjyshërit, gjyshërit, baballarët dhe vëllezërit tuaj kundër kolonizatorëve anglezë e francezë dhe me ç'armë i kanë detyruar ata të mbylleshin në kalatë e tyre që kishin ndërtuar në shkretëtira? Me këllëçe, me deve, me heshta! Po pushtuesit çfarë kishin? Topa, mitraloza, të gjitha i kishin. Me çfarë luftuan tunizianët në shekullin e 16-të kundër pushtuesve spanjollë? Me çfarë luftoi Abdel Kaderi¹ kundër pushtuesve francezë? Me çfarë luftuan në kohën tonë algjerianët? Me çfarë luftuan shqiptarët kundër hordhive nazifashiste? Pra, është populli, teknika dhe zemra e tij, që i shkatërron të gjitha qëllimet e imperialistëve dhe të revizionistëve. Kjo realizohet kur udhëheqja, partia, janë në pozita të shëndosha dhe të brumosura me mësimet e marksizëm-leninizmit.

1 A. Kader (1808-1883) — udhëheqës i kryengritjes algjeriane kundër pushtuesve francezë gjatë viteve 1832-1847.

Për të arritur fitoren, natyrisht, duhen përpjekje të mëdha dhe lufta nuk është kaq e thjeshtë. Por ne nuk tërhiqemi përpara vështirësive. Një shembull i mrekullueshëm në historinë botërore është lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë. Një popull i vogël po bën një luftë kolosale me armiqtë më të egër të njerëzimit. Prandaj Partia jonë ka plotësisht të drejtë kur thotë se situatat janë të favorshme për zhvillimin e revolucionit. Të gjitha këto luftëra lokale, që ndez imperializmi, tregojnë dobësinë e imperialistëve dhe të revizionistëve. Ata duan të shtypin e të shfrytëzojnë në qetësi, por popujt nuk i lënë të qetë, ndaj armiqtë janë të detyruar të godasin e të humbasin.

Tani revizionistët sovjetikë zhvillojnë një punë politike intensive demagogjike në vendet arabe. Ata bëjnë presion për të siguruar koncesione nga Naseri. Thuhet se në Egjipt kanë vajtur mjaft këshilltarë sovjetikë. Ata duan që në radhë të parë Egjipti dhe vendet e tjera arabe të qëndrojnë të nënshtruara, të rimarrin lidhjet me amerikanët e anglezët, por gjithnjë frenat t'i kenë sovjetikët. Me këto manovrime ata shtypin ndjenjat e mëdha revolucionare të popujve arabë dhe të Afrikës.

I njohim mirë revizionistët sovjetikë. Ne u kishim kërkuar hrushovianëve para 1960-s të na ndihmonin me gjeologët e tyre për të zbuluar fosforite. Specialistët sovjetikë erdhën e brodhën gjithë vendin dhe më në fund na njoftuan se nuk gjetën! Ne u thamë të shikonin mirë, mbasi kishim të dhëna se vendi ynë ishte i pasur në to. Por «miqtë» nuk «gjetën» dhe

na sabotuan. U deshën vite që gjeologët tanë të rinj të zbulonin male të tëra me fosforite, të cilat, kur të vihen në shfrytëzim, mjaftojnë jo vetëm për të plotësuar nevojat tona, por edhe për të eksportuar. Edhe një shembull tjetër: Kur ishim njëherë në Moskë Hrushovi na pyeti: «Sa drithë ju duhet juve në vit?». Kur ne iu përgjigjëm, ai na tha: «Mos u bëni merak për bukë, atë që ju konsumoni në një vit, të ne e hanë minjtë». Por kur erdhi koha që populli shqiptar po rrezikohej për bukë, ai «harroi» ç'kishte thënë dhe na bëri gjithë ato presione për të na nënshtruar. Po në Shqipëri nuk i mori lopata ujë.

Hrushovi ishte intrigant. Pas demaskimit që i bëme në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë më 1960, shoku Hysni Kapo i tha: Mos e prek Shqipërinë, se, po e preke, të gjen gjëma! — ai u përgjigj: Ju, shqiptarët, ma punuat. Me atë që më bëtë, as lumi i Vollgës nuk më lan me ju.

Në atë mbledhje, meqë ra fjala, revizionistët sovjetikë, me lajka e kërcënime u përpoqën që ne të mos i atakonim, por, siç dihet, më në fund përpjekjet e tyre dështuan. Hrushovi e kishte zakon që gjithmonë të ndërpriste fjalën, kurse këtë radhë «shokët e tij», e themi në thonjëza se po këta e hodhën në erë për t'i zënë fronin, i kishin vënë fre që të mos na ndërpriste kur ne flitnim, sepse, po fole, i kishin thënë ata, shqiptarët të bëjnë helaq. Prandaj, kur ne flitnim, e i binim me gjithë forcën e marksizëm-leninizmit, ai mbante kokën me duar.

Do të vijë koha që dhe arabët t'i njohin mirë se ç'janë revizionistët hrushovianë sovjetikë. Ne jemi të

bindur se sytë e popujve të Afrikës, veçanërisht të arabëve, do të hapen. Qysh tani kanë filluar reagimet e hapëta. Grumbullime sasiore po bëhen kudo. Dhe ndryshimet sasiore, me siguri, do të kthehen në ndryshime cilësore. Ky është ligj i zhvillimit dialektik. Për partitë e vërteta marksiste-leniniste ka një rëndësi të veçantë çështja e cilësisë. Këtu mund të përmendim përvojën e Partisë sonë, e cila edhe në momente shumë të vështira, si ai i kohës së luftës, numrin e anëtarëve të saj e kishte të vogël, por rëndësi kishte se të gjithë këta ishin të vendosur.

Duke luftuar kundër revizionizmit, s'duhet harruar imperializmi. Imperializmi amerikan është armiku më i egër, fashizmi i kohëve aktuale, armiku kryesor i të gjithë popujve. Të nënvleftësosh reaksionin e imperializmin amerikan veçanërisht dhe imperializmin e vjetër e me tradita të Evropës, është gabim. Lënia pas dore e luftës kundër imperializmit amerikan do të ishte një gabim i pafalshëm, sepse ai, për të forcuar pozitat e tij, për të vënë në gjumë afrikanët, përhap idenë se Amerika është larg Afrikës, kështu që s'ka qëllime për ta pushtuar atë. Këto synime i paskan gjoja vetëm Anglia, Franca dhe Gjermania Perëndimore. Ç'demagogji! Populli ynë thotë: «Të gjithë derrat një turi kanë», prandaj s'duhet mbyllur sytë. Edhe këta të fundit dihet që janë armiq. Edhe kundër këtyre duhet luftuar me ashpërsi. Domosdo, po t'i krijohet një rezistencë e fuqishme revolucionare imperializmit në Evropë, edhe imperializmi amerikan nuk do ta ketë aq të lehtë të shtypë e të robërojë popujt, aq më tepër që të gjitha forcat e tij

ai i ka shpërndarë në Afrikë, në Evropë, në Azi dhe jo vetëm në Amerikë. Ai ka qenë dhe mbetet xhandar e xhelat i popujve.

Ne jemi të sigurt se e ardhmja i takon botës së re, socializmit e komunizmit. Fitorja u takon popujve. Por ne jemi realistë se fitoret nuk vijnë pa luftë, pa përpjekje, pa sakrifica, por, gjatë këtyre luftërave e përpjekjeve, ne, vazhdimisht, do të fitojmë, kurse armiqtë, imperialistë e revizionistë, do të humbasin.

Më falni se ndoshta u zgjata. Në këtë ekspozitë desha të flisja shkurtimisht për eksperiencën tonë modeste dhe për disa probleme që sot shqetësojnë popujt, veçanërisht ata arabë, dhe lëvizjen marksiste-leniniste. Komunistët duhet të përfitojnë nga eksperiencat e njëri-tjetrit për të pasuruar teorinë dhe praktikën tonë, por secili e zbaton atë sipas kushteve konkrete.

Është e nevojshme që ne të mbajmë lidhje të gjalla, të diskutojmë dhe të shkëmbejmë eksperiencë me njëri-tjetrin. Ju nuk duhet të mjaftoheni me këtë ardhje, të mendoni se tani u pamë dhe mirupafshim, por, përkundrazi, të vini sa herë të doni. Për miqtë e vërtetë dyert e Shqipërisë socialiste janë të hapura.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern 1965-1967», f. 532

Botohet sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**TË MBROSH MARKSIZËM-LENINIZMIN
DO TË THOTË TË MBROSH
TË ARDHMEN E BOTËS**

Nga biseda me disa marksistë-leninistë francezë

12 gusht 1967

Pasi miqtë zunë vendet dhe iu përgjigjën pyetjeve të shokut Enver se si janë me shëndet dhe nëse e vizituan sadopak Shqipërinë, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:

Është gëzim për ne kur presim shokë francezë që vijnë në Shqipëri. Këtë e kemi vlerësuar si një ndihmë të madhe dhe mjaft të dobishme, sepse bashkëbisedimet që bëjmë na ndihmojnë në punën tonë dhe sepse ju mund të na jepni mendime të sakta për gjendjen në Francë. Ne gëzohemi për luftën që bëjnë marksistë-leninistët e Francës. Sipas mendimit tonë ata kanë bërë përparime të mëdha. Celulat e vogla u kthyen në një lëvizje të gjerë, gjë që ka rëndësi të madhe jo vetëm për ju, por edhe për gjithë lëvizjen marksiste-leniniste në botë. Në këtë mënyrë i çmojmë përpjekjet e shokëve marksistë-leninistë francezë.

Ne kemi ndjekur gjithnjë me vëmendje punën tuaj, vijën tuaj politike, ideologjike dhe organizative. Prandaj gëzohemi që po krijoni partinë marksiste-leniniste të Francës. Formimi i partisë marksiste-leniniste është një domosdoshmëri po që se duam të bëjmë luftë dhe beteja të organizuara kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Ne jemi dakord me mendimin tuaj se tani është koha e përshtatshme për ta formuar partinë, për dy arsye: E para, ju tashmë keni një lëvizje punëtores, por dihet që në të mund të infiltrojnë elementë të ndryshëm, kurse partia proletare është e aftë t'i zgjedhë elementët revolucionarë, t'i organizojë dhe t'i hedhë në revolucion. E dyta, formimi i partisë marksiste-leniniste në Francë është një kërkesë e domosdoshme, jo vetëm për lëvizjen komuniste franceze, por për gjithë lëvizjen komuniste botërore, para së cilës edhe marksistë-leninistët francezë kanë detyra të mëdha.

Lëvizja juaj sot vërtet është e vogël në numër, por, duke marrë parasysh rolin që luan ajo, detyrat dhe perspektivën e saj, nuk mund të themi se është e tillë. Ajo do të forcohet edhe më tepër kur të krijohet partia e vërtetë marksiste-leniniste e Francës, e cila do të trashëgojë shpirtin e madh revolucionar, forcën e popullit francez me një të kaluar të madhe revolucionare.

Ndaj grupeve të ndryshme marksiste-leniniste që ekzistojnë, kemi mbajtur dhe mbajmë një qëndrim të qartë politik e ideologjik, i ndihmojmë ato. Por ne mendojmë se nuk është e drejtë t'i ndihmojmë të gjitha grupet që pretendojnë se luftojnë kundër impe-

rializmit dhe kundër revizionizmit, por t'i japim gjithë ndihmën e nevojshme atij grupi që ka me të vërtetë një vijë të drejtë, që çon përpara lëvizjen dhe krijon partinë e vërtetë marksiste-leniniste. Ndërsa forcat e tjera që nuk janë në pozita armiqësore, le të bisedojnë me marksistë-leninistët e vërtetë, të zhdukin divergjencat që kanë midis tyre dhe të futen në lëvizjen ose në partinë e re marksiste-leniniste.

Si marksistë-leninistë, ne jemi të sinqertë me ju dhe nuk ju fshehim asgjë, as të metat tona dhe e dimë se kështu veproni edhe ju me ne. Pra, jemi shokë dhe sakrifikojmë gjithçka për marksizëm-leninizmin dhe revolucionin, sepse kemi një rrugë të përbashkët. Unë kështu mendoj. Deri tani ne kemi ndihmuar me sa kemi mundur lëvizjen tuaj, por në të ardhmen do t'ju përkrahim edhe më fort, me të gjitha forcat tona.

•Duke marrë fjalën, kryetari i delegacionit vlerësoi politikën e drejtë të PPSH, falënderoi për ndihmën që u jep ajo marksistë-leninistëve francezë dhe foli për lëvizjen marksiste-leniniste në Francë. Pastaj fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Ju falënderojmë shumë për vlerësimin që i bëni Partisë sonë. Ne do të jemi, gjithmonë, në vijën e parë të luftës për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe të mbrosh marksizëm-leninizmin, do të thotë të mbrosh të ardhmen e botës. Partia jonë mendon se çdo parti, e madhe ose e vogël qoftë, çdo popull, i madh ose i vogël qoftë, kanë për detyrë të forcojnë unitetin me të gjitha forcat revolucionare që luftojnë

për një qëllim të vetëm, kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Ne, marksistë-leninistët, duhet të jemi të përgatitur për çdo situatë, sepse kemi armiq të shumtë e të egër, që kanë mjete të shumta për të dëmtuar çështjen tonë. Në luftën kundër tyre ne do të fitojmë duke qenë të bashkuar midis nesh. Këtë luftë të madhe Partia jonë dhe marksistë-leninistët kudo në botë e kanë zhvilluar drejt, me sukses, por edhe me të meta, pasi ajo nuk ka qenë e nuk do të jetë e lehtë. Por vështirësitë nuk na dekurajojnë, sepse, po të dekurajoheshim, nuk do ta meritonim të quheshim komunistë. Duke pasur besim në doktrinën tonë marksiste-leniniste, në përpjekjet e popullit shqiptar dhe të komunistëve tanë, që kanë kaluar vështirësi të panumërta gjatë luftës kundër armiqve të shumtë e të egër, ne kemi kurajë dhe besim në fitoren. Përse atëherë të mos ketë besim lëvizja revolucionare marksiste-leniniste botërore në fitoren kundër kapitalizmit? Arritja e fitores është vetëm çështje kohe. Fitorja do të jetë patjetër e socializmit.

Ne mbrojmë marksizëm-leninizmin, sepse ai na ndriçoi rrugën për ta nxjerrë Shqipërinë nga errësira në dritë. Siç e dini, gjatë gjithë historisë së tij populli ynë ka luftuar dhe ka derdhur gjak kundër imperialistëve të ndryshëm, por megjithatë ai s'ka mundur të fitojë pavarësinë dhe lirinë. Pavarësinë, lirinë, socializmin ai i fitoi vetëm atëherë kur u udhëhoq nga partia marksiste-leniniste. Prandaj detyra jonë është që populli jo vetëm ta kuptojë, por ta ndiejë thellë gjer në fund se është Partia ajo që, e

udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste, e ngri-
ti në luftë dhe e shpëtoi njëherë e përgjithmonë nga
shtypja e shfrytëzimi, është uniteti i marksistë-leninis-
tëve që do ta ndihmojë të ecë përpara në ndërtimin
e socializmit, është uniteti i tij rreth Partisë që do
ta çojë përpara në këtë rrugë, në të cilën kemi pa-
sur mjaft suksese.

Tani ne po bëjmë përpjekje të mëdha në të gjitha
drejtimet sidomos në fushën e edukimit politik e ideo-
logjik të njerëzve tanë, në mënyrë që masat puno-
njëse të kuptojnë thelbin e marksizëm-leninizmit, që
është ideologjia e klasës punëtore. Në këtë fushë ne
kemi akoma shumë për të bërë. Megjithatë, me punën
që ka zhvilluar Partia, populli ynë ka arritur të kuptojë
esencën e politikës së Partisë dhe luftën që ajo
bën kundër revizionizmit modern. Bile edhe me sho-
kët që kanë dalë nga radhët e klasës punëtore, ne
punojmë që t'u bëhet sa më i qartë roli udhëheqës
i Partisë, i këshillojmë të mësojnë ideologjinë mark-
siste-leniniste, ta asimilojnë atë dhe pastaj t'ua bëjnë
të njohur masave, t'ua futin atyre në mendje dhe
në zemër. Por për masat kjo nuk është e lehtë. Këto
e kuptojnë më mirë marksizëm-leninizmin, po të përdoren
forma të thjeshta pune, por me përmbajtje të
thellë dhe jo duke u dhënë vetëm formula të nxjerra
nga librat e që janë të pakuptueshme për nivelin
e tanishëm të tyre. Ne shikojmë se në këtë drejtim
bëhen përpjekje të mira, si nga komunistët, ashtu
edhe nga vetë masat. Frytet e studimit të marksizëm-
leninizmit ne i matim me rezultatet konkrete që arri-
hen në plotësimin e detyrave.

Ju do të keni rastin të shikoni vetë në praktikë, si dhe nëpërmjet shtypit se kudo në vendin tonë ka shpërthyer një frymë e lartë revolucionare, se revolucioni ynë proletar është i pandërprerë, zhvillohet dhe shkon përpara.

Ka afro një vit që në vendin tonë lufta kundër fesë, kundër zakoneve të vjetra dhe bestytnive fetare, kundër mentaliteteve mikroborgjeze etj. ka marrë një intensitet të veçantë. Një lëvizje e madhe ka filluar për emancipimin e plotë të gruas. Ju nuk mund ta kuptoni se çfarë përpjesëtimesh të mëdha kanë marrë të gjitha këto lëvizje në vendin tonë! Te ne sot s'ka më xhami, kisha, manastire, s'ka priftërinj dhe hoxhallarë. Ata që nuk e njohin zhvillimin e revolucionit në Shqipëri, dhe ka njerëz të tillë, mund të mendojnë e të thonë se ne jemi sektarë. Por nuk është kështu. Kjo punë nuk u bë brenda një dite. Qysh para Çlirimit të vendit tonë, Partia, duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, ka ndjekur ndaj fesë një vijë të caktuar, me etapa. Me forcën e ideologjisë së saj dhe në mënyrë revolucionare ajo ka demaskuar fenë dhe të këqijat e saj, rolin negativ që ka luajtur feja për pavarësinë dhe çlirimin e Shqipërisë, ka shpjeguar shkencërisht fenomenet e ndryshme dhe me anën e zhvillimit ekonomik të gjithanshëm të vendit tonë, bëri që të piqet kjo situatë që shohim sot. Po të lexoni materialet e Partisë sonë, ju do të shihni se ajo u thoshte komunistëve të mos luftojnë kundër njerëzve që besojnë te zoti, i këshillonte ata që ta lënë popullin të veprojë vetë, të shprehet lirisht dhe nëpërmjet punës ideologjike dhe ekspe-

riencës ata që besojnë te feja do të binden gradualisht për kotësinë e këtij besimi. Në Parti dhe në popull të gjithë e dinë se kjo përmbysje, që u bë dhe që u realizua brenda një kohe relativisht të shkurtër te ne, është rezultat i punës së gjatë që ka bërë Partia jonë. Përveç kësaj, në luftën që zhvillohet sot në vendin tonë kundër fesë, ka edhe disa faktorë të tjerë favorizues. Klerikët, sidomos ata myslimanë dhe ortodoksë, te ne kanë qenë pothuajse injorantë. Ndryshe ishte me klerikët katolikë, të cilët ishin më të ditur, por këta gjatë gjithë kohës janë treguar armiq të pushtetit popullor, prandaj humbën edhe besimin e besimtarëve.

Me gjithë punën e bërë, ne nuk mund të themi se sot edhe pleqtë nuk besojnë më te zoti ose në një fuqi të mbinatyrshme. Për këtë Partia është e vetëdijshme, por ajo dhe komunistët bënë që edhe ata të futen në valën e revolucionit. Tani ne shikojmë se në luftën kundër fesë nuk ka kundërshtime, vetëm shumë rrallë dëgjohet ndonjë vërejtje nga pleqtë dhe kjo është e natyrshme. Kështu, pra, te ne çështjen e xhamive dhe të kishave e mori vetë populli në dorë.

E rëndësishme është edhe lëvizja për emancipimin e plotë të gruas, për t'i dhënë vendin që i takon në shoqëri, për të evidentuar rolin e madh që luan ajo në ndërtimin e socializmit, për të zhdukur mentalitetet skllavëruese ndaj saj, për t'i dhënë të drejtat e plota, sepse, siç ka thënë Lenini, gruas duhet t'i jepen të drejtat realisht dhe jo vetëm në letër.

Në vendin tonë, pas vendosjes së pushtetit popullor, gruaja ka bërë një përparim të madh. Gratë

zënë përqindjen më të madhe të arsimtarëve, të punonjësve të shëndetësisë dhe 40 për qind të të gjithë punëtorëve etj. Por nuk mund të themi se janë zhdukur të gjitha zakonet e vjetra që e ndrydhin gruan. Partia jonë ka vepruar duke marrë parasysh nivelin e masave, se në to ekzistonin zakone të vjetra, të cilat nuk mund të zhdukeshin menjëherë. Kurse tani, gratë e ndiejnë veten të lira, me qindra dhe me mijëra vajza, që gjer dje nuk kishin kaluar pragun e shtëpisë së tyre, janë ngritur dhe shkojnë për të punuar në ndërtimin e hekurudhës e kudo. Prindërit e tyre na shkruajnë se kur vajzat kthehen nga aksioni, i presin me gëzim dhe se ato kanë ndryshuar krejtësisht. Ne organizuam edhe vajtjen e pleqve për të parë se si punojnë dhe mësojnë vajzat e tyre në hekurudhë dhe në aksionet e tjera. Në këtë mënyrë, pra, ne i shpjegojmë popullit ideologjinë dhe politikën tonë, të materializuara në jetë, i mësojmë ideologjinë e marksizëm-leninizmit.

Sukseset që kemi arritur në këto drejtime janë të mëdha. Kryesorja është se ekonomia jonë po ecën shumë mirë. Kolektivizimi i bujqësisë te ne ka marrë fund. Kjo ka qenë një punë shumë e vështirë, sepse, përveç të tjerave, duhej të luftonim edhe kundër pikëpamjeve të revizionistëve, si ata jugosllavë e të tjerë, të cilët, edhe ato kooperativa që kishin ngritur në fillim, i prishën. Në fshatrat tona, kudo që të shkosh, shikon vetëm shtëpi të reja. Tokat, sidomos në fusha, pothuajse të gjitha, ujiten. Në fushë kudo punon traktori. Ky është një vit shumë i mirë për bujqësinë. Një revolucion i vërtetë po bëhet në rrit-

jen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore. Partia hodhi parullën «Të çelen toka të reja» dhe tani shikon që njerëzit i ngjiten malit për t'i hapur ato. Çdo ditë fshatarësia shikon të mirat e socializmit, të kolektivizimit.

Edhe në industri, gjithashtu, punët venë mirë. Kuadrot tanë, megjithëse të rinj, kanë marrë në dorë drejtimin e saj. Kudo të gjithë mësojnë.

Por, me gjithë këto suksese, nuk do të thotë se ne ia kemi arritur qëllimit, sepse kemi edhe mjaft për të bërë. Në tërë këtë punë, natyrisht, ka edhe të meta, prandaj duhet të punojmë më shumë. Ka edhe njerëz që nuk na kuptojnë, por ne shikojmë se populli ka besim të madh te komunistët, te Partia dhe te marksizëm-leninizmi. Populli ecën përpara dhe s'ka frikë as nga titistët, as nga revizionistët sovjetikë, as nga armiqtë e tjerë rreth kufijve tanë e kudo që janë. Partia ka marrë të gjitha masat për të përballuar çdo agresion që mund të ndërmerret kundër Shqipërisë. Kufijtë tanë nuk mund të preken. Në rast se armiqtë do të orvaten ta bëjnë një gjë të tillë, do të gjejnë vdekjen.

Tani i gjithë reaksioni imperialist e revizionistët sovjetikë po bëjnë një fushatë të madhe propagandistike se gjoja Shqipëria është në rrezik. Natyrisht, ne nuk mbyllim sytë përpara manovrave të imperialistëve e të revizionistëve, sepse ata mund të bëjnë çdo gjë, por edhe ne jemi në gjendje të studiojmë situatat dhe dimë që ka kontradikta midis armiqve tanë. Të gjitha këto i shikojmë.

Revizionistët sovjetikë na dërguan bile edhe një

mesazh ku na thonë se amerikanët dhe grekët kanë përgatitur një plan për të sulmuar Shqipërinë. Po ne nuk harrojmë se edhe Titoja më 1948, me qëllim që të pushtonte Shqipërinë, bëri të njëjtën gjë. Kurse tani janë revizionistët sovjetikë që, për të realizuar qëllimet e tyre ndaj nesh, bëjnë zhurmë të madhe dhe thonë se Shqipëria është në rrezik. Por ne mbajmë qëndrimin tonë të vendosur dhe nuk biem në grackën e tyre.

Në vendin tonë, jo vetëm ushtria, por i gjithë populli është i armatosur. Në fshatra janë organizuar formacionet territoriale dhe në to populli mëson si të përdorë armët, taktikën e luftës etj. Ai mëson në shkollë, punon në fabrikë apo në ara, përgatitet për mbrojtjen e atdheut dhe ka kohë t'i bëjë të gjitha këto, sepse janë ideali i lartë dhe vija e drejtë e Partisë që i japin atij një forcë të tillë. Me popullin tonë të mrekullueshëm ne jemi të sigurt se çdo rrezik do ta kalojmë. Ai është shumë vigjilent.

Një punë të kujdesshme ka bërë Partia edhe me brezin e ri të vendit tonë. Rinia te ne nuk është si në Francë dhe në vendet e tjera kapitaliste e revizioniste. Ajo nuk e bën dy fjalën e Partisë. Kohët e fundit rinia shkollore iu përgjigj plot entuziazëm thirrjes që i bëri Partia që gjatë pushimeve verore të punojë një muaj në aksionet e rinisë për ngritjen e veprave të reja. Kështu, tani të gjithë të rinjtë, nxënësit e klasave të larta dhe studentët, shkojnë në aksione, ku bëhet lidhja e punës mendore me punën fizike.

Një çështje me shumë rëndësi dhe që na intere-

son mbi të gjitha është Partia. Duke zbatuar me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit, në Partinë tonë s'ka elementë fraksionistë. Partia jonë krenohet që është një parti marksiste-leniniste e tipit të partisë së Lenin-Stalinit dhe do të qëndrojë gjithmonë e tillë, sepse sheh drejtësinë e parimeve marksiste-leniniste dhe u qëndron besnike atyre. Ajo nuk ka lejuar dhe nuk lejon që në gjirin e saj të ketë dy vija. Komunistët mund të kenë dhe kanë ide, dhe Partia nuk kërkon që në radhët e saj të ketë njerëz automatë, prandaj ata janë të lirë që mendimet e tyre t'i shfaqin. Në qoftë se këto mendime janë të drejta, merren parasysh; në qoftë se jo, dhe kur kjo ndodh për arsye se nuk i kanë çështjet të qarta, sqarohen; kurse po të kenë pikëpamje antiparti, atëherë flaken jashtë Partisë. Kështu ka vepruar kurdoherë Partia jonë, prandaj në gjirin e saj ka ekzistuar dhe ekziston vetëm një vijë. Për këtë arsye revizionistët na akuzojnë se jemi stalinistë integralë. Por ne të tillë jemi, sepse, po të lejonim që brenda në Parti të mbanim tradhtarët, që herë pas here kanë nxjerrë krye në Partinë tonë, apo siç kanë dalë edhe në Partinë Komuniste të Kinës, do të ishte një fatkeqësi e madhe. Revizionistët mund të na akuzojnë për këtë gjë, por ne goditjen e këtyre armiqve nuk e konsiderojmë fatkeqësi, sepse veprimtarinë armiqësore dhe antiparti të elementëve që kemi likuiduar ideologjikisht dhe fizikisht, e kemi të dokumentuar me fakte. Revizionistët mund të thonë se Sejfulla Malëshova dhe Koçi Xoxe nuk ishin tradhtarë, por, po të mos i kishim dënuar ata, ekzistenca e Partisë

dhe ndërtimi i socializmit në Shqipëri do të ishin rrezikuar.

Revizionistët na akuzojnë si stalinistë. Por çfarë ka bërë Stalini? Stalini është një marksist-leninist i madh. Ai mund të ketë bërë ndonjë gabim, sigurisht joparimor, por ne nuk i besojmë kurrë ato që thonë tradhtarët revizionistë për të. Ne mbështetemi vetëm në ato që ka shkruar dhe ka bërë Stalini, domethënë në realitetin, jo në ato që thonë tradhtarët. Asnjë gabim parimor nuk mund të gjendet në veprat e këtij marksist-leninisti të shquar.

Thonë se Stalini ka qenë «brutal», «vrasës» dhe «megaloman». Ne nuk besojmë asnjë nga këto. Unë kam pasur fatin të takohem me Stalinin dhe s'kam konstatuar asnjë nga këto në personin e tij. Kur jam takuar me Stalinin fill pas fitores së revolucionit në vendin tonë, unë isha i ri, megjithatë kam biseduar kokë më kokë me të. Stalini ishte njeri i qetë. Tek ai kam parë një udhëheqës parimor dhe të drejtë.

Pas vdekjes së Stalinin ne kemi pasur kontakte me N. Hrushovin dhe me të gjithë bashkëpunëtorët e tij të tjerë. Hrushovi me shokë janë kriminelë dhe kanë dashur ta vrasin Stalinin. Këtë na e ka thënë vetë Mikojaani kur kemi qenë në Moskë. Mikojaani kishte marrë për detyrë të na bënte për vete. Përveç të tjerash, ai na tha se ata kishin menduar që në një kohë të përshtatshme ta zhduknin fizikisht Stalinin, por më pas e kishin lënë këtë plan, sepse, sipas tyre, nuk do të kuptoheshin nga masat. Pra, siç e shihni, ata vetë e thonë që kanë dashur ta likuidojnë

Stalinin. Atëherë si mund t'u besohet këtyre banditëve për ato që thonë për Stalinin?

Por edhe në qoftë se Stalini ka bërë gabime, ato nuk mund të gjykohen me situatën e tanishme, por me gjendjen dhe me rrethanat e asaj kohe, e atyre momenteve në të cilat ai ka jetuar e ka vepruar. Si mund të gjykohet Stalini për sa u përket pikëpamjeve të tij politike, organizative, aleancave që ka bërë në kohën e Kominternit? Në rast se duam të gjykojmë qëndrimin e Stalinit në Komintern, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore ose për çështje të tjera, duhet të kemi dokumente dhe këto të studiohen me objektivitet, kurse Partia jonë këto nuk i ka. Para se të prisheshim me Hrushovin, ne i kërkuam atij të na jepte dokumentet e Kominternit lidhur me Shqipërinë, por ai asgjë nuk na dha. Lërc pastaj për të tjerat.

E gjithë lufta dhe balta që revizionistët i hodhën Stalinit kishin vetëm një qëllim: për të atakuar marksizëm-leninizmin. Nga kjo arsye u nis Partia jonë që nuk u bashkua me korin borgjezo-revizionist kundër Stalinit, sepse nuk mund të bazoheshim në shpifjet e revizionistëve sovjetikë.

Stalini porosiste gjithnjë të ishim të thjeshtë. Këtë cilësi ai e kishte edhe vetë. Jetonte me thjeshtësinë më të madhe. Stalinin e akuzojnë për ndërhyrje në punët e brendshme të vendeve të tjera, por ndaj nesh ai, megjithëse e dinte që ishim një parti e vogël, nuk ka bërë as ndërhyrjen më të vogël. Kur vajtëm së bashku me Zahariadhysin te Stalini, për arsye se Partia Komuniste Greke na akuzonte ne për qëndrime jo të drejta, ai i dëgjoi me vëmendje dhe me qetësi ar-

gumentet e të dyja palëve dhe, në fund, i dha të drejtë Partisë sonë.

Çfarë nuk thonë revizionistët për Stalinin lidhur me Jugosllavinë! Ata thonë se Stalini ka dashur të futet në Jugosllavi etj., etj. Por të gjitha këto janë gënjeshtër. Unë kam biseduar vetë në atë kohë me Stalinin. Ai më tha se Titoja është tradhtar, por çështja e tij i përket popullit jugosllav. Në qoftë se populli nuk e kupton se ai është i tillë, asgjë nuk mund të bëhet. Me këtë ai, njëkohësisht, donte të na thoshte neve që të kishim mendjen dhe të mos ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë, meqë kishim atje një milion shqiptarë. Çështja e shqiptarëve që jetojnë në tokat e veta në Jugosllavi, është një problem që nuk mund të zgjidhet tani për tani, por kur Jugosllavia të bëhet një vend socialist, theksonte Stalini. Duke parë këto, atëherë si mund t'u besojmë gënjeshtërave të fabrikuarra të Titos për Stalinin?

Pra, Stalini jo vetëm që nuk ndërhynte në punët e të tjerëve, por duke qenë i matur, i mençur dhe internacionalist i madh na ndihmonte pa u kursyer dhe pa interes. Stalini na thoshte se ndihma që kërkon Shqipëria nuk është ndonjë gjë e madhe. Kurse me Hrushovin ishte ndryshe. Me këtë kishte historira kur ishte fjala për të dhënë ndonjë «ndihmë». Sa herë e ngrinte dhe e ulte zërin! Dhe bënte pazarllëqe: Ju keni kërkuar 200, na thoshte ai, ne po ju japim 100 etj., kurse përqindjet e interesit që merrte i donte në rregull. Specialistët dhe inxhinierët sovjetikë, të cilët kishin kryer të njëjtën shkollë me inxhinierët tanë, Hrushovi kërkonte që t'i paguanim tri herë më

shumë nga rroga ime. Ndërsa Stalini na thoshte: «Studentë për të mësuar te ne dërgoni, por ju duhet të hapni universitetin tuaj dhe për këtë ne do t'ju ndihmojmë me specialistët tanë. Po të keni specialistë të vjetër në Shqipëri, na thoshte ai, i merrni ata dhe nën kontrollin e Partisë hapni universitetin!». Kur ne i kërkonim specialistë, ai na thoshte: «Mirë, merrini, por mos i paguani më shumë se specialistët tuaj». Kurse specialistët sovjetikë që dërgohen sot në Vietnam kërkojnë gjashtëfishin e rrogës që merr Ho Shi Mini. Po kështu sillen edhe me algjerianët, saqë edhe këta janë çuditur, pasi u kërkojnë rroga të majme për specialistët.

Për sa u përket çështjeve organizative, Partia jonë ka punuar me shumë vigjilencë për të ruajtur parimet e marksizëm-leninizmit. Dëshironi t'ju them mendimet e mia lidhur me këtë çështje? Në këtë situatë shumë të vështirë, kur kemi për të përballuar një luftë të ashpër kundër revizionizmit, duhet të kemi një parti të çeliktë dhe të fortë, që zbaton dhe mbron parimet, ashtu sikurse thoshte Lenini. Po t'i kemi të qarta parimet ideologjike dhe organizative të partisë dhe po t'i zbatojmë ato me besnikëri, nuk do të biem në gabime. Nga ana tjetër, vetëm me një parti me një strukturë luftarake mund të luftohet kundër të gjithë armiqve të hapët e të fshehtë. Kur të krijoni partinë tuaj juve do t'ju duhet ta spastroni atë nga ndonjë element që nuk e meriton të jetë në radhët e saj. Për të mos lejuar që të likuidohet partia, është e domosdoshme që ajo të jetë e pastër dhe për këtë duhet të qëndrosh fort në parimet. Është një detyrë e madhe dhe e ndërlikuar të jesh komunist dhe luftëtar në

këto momente kaq të vështira për klasën punëtore dhe për fshatarësinë. Ju keni eksperiencën tuaj të madhe dhe e kuptoni fare mirë se në luftë duhen bërë sakrificat, se pa to nuk bëhet, sepse të jesh në ballë të luftës nuk mund që të mos luftosh.

Partia jonë mendon se revizionizmi modern tani është në zbritje, jo vetëm sepse ai është demaskuar dhe vazhdon të demaskohet gjithnjë e më shumë, por edhe sepse shikojmë një shthurje të atij «uniteti», që gjoja ekziston në radhët e tij, qoftë nga ana politike, qoftë nga ana ekonomike, qoftë nga ana ushtarake.

Manrim për shembull Rumaninë. Partia Komuniste Rumune është një parti revizioniste dhe kjo do të arrijë shumë shpejt në rrugën revizioniste të Titos. Udhëheqësit rumunë e fshehin këtë rrugë ku kanë hyrë, me kontradiktat që kanë me sovjetikët. Por këto kontradikta nuk janë parimore, sepse të dyja palët janë revizioniste, si partia rumune, ashtu edhe ajo sovjetike. Ata kanë mosmarrëveshje me Bashkimin Sovjetik edhe për çështjen e kufirit. Është e vërtetë se revizionistët sovjetikë kanë bërë presion të madh mbi rumunët për t'i mbajtur nën fre. Këta u treguan shumë të frikësuar dhe u drejtuan e kërkuan mbështetjen e Titos. Lidhur me këtë, Partia jonë i dërgoi partisë rumune një letër. Në atë kohë ne ishim në luftë me udhëheqësit rumunë, për arsye se ata na kishin atakuar hapur, kurse ne nuk kishim folur kundër tyre. Kjo ndodhte jo se ne i kishim frikë ata, por sepse taktika jonë ishte të goditnim kokën, revizionistët sovjetikë, pra, i kishim drejtuar bateritë kundër këtyre dhe nuk u ishim përgjigjur sulmeve të udhë-

heqësve të partisë rumune e të partive të tjera të vendeve ish-socialiste. Në letrën që i dërguam udhëheqjes rumune thoshim: Në qoftë se ata ishin në kontradikta parimore me revizionistët sovjetikë, rruga që po ndiqnin duke u lidhur me Titon nuk ishte e drejtë, sepse ai është renegat dhe tradhtar; nga ana tjetër, shtonim që nuk ishte e drejtë që të merrnin ndihmë ekonomike nga imperialistët, të cilët njihen se kush janë dhe në qoftë se kërkimin të gjenin rrugën e drejtë marksiste-leniniste, atëherë duhej të ishin vigjilentë ndaj imperialistëve, ndaj Titos dhe ndaj revizionistëve sovjetikë. Në fund të letrës theksonim se ne, shqiptarët, nuk jemi të pasur, megjithatë, po të kishin vështirësi nga imperialistët dhe revizionistët, ne ishim gati t'u vinim rumunëve në ndihmë me të gjitha mundësitë tona, sado modeste.

Letrës sonë udhëheqësit rumunë nuk iu përgjigjën. Kjo nuk na prishi gjë neve. Tani vëmë re se kontradiktat midis tyre dhe Titos, që u erdhi në ndihmë, po thellohen. Ata i kanë kthyer kurrizin Titos dhe u janë futur tratativave me imperialistët italianë, gjermanoperëndimorë dhe francezë, nga të cilët marrin ndihma të mëdha. Të gjitha këto fshihen nën parullën e një «ekonomie të lulëzuar». Rumunët thonë se kanë naftën dhe se me këtë janë në gjendje t'i shlyejnë kreditë e tyre. Por fakti është se ata ecin në rrugën e kapitalizmit.

Të njëjtën gjë po bëjnë edhe polakët e hungarezët. Hungarezët kanë krijuar kontakte të rregullta me imperialistët, sidomos me ata të Gjermanisë Perëndimore. Edhe revizionistët çekë janë, gjithashtu, tradh-

tarë shumë të këqij. Ata e heqin veten sikur janë me Bashkimin Sovjetik, por nga ana tjetër, lidhin marrëdhënie të ngushta me Bonin. Njohja e qeverisë së Bonit nga ana e tyre është çështje muajsh. Nga një situatë e tillë, natyrisht, përfitojnë Dë Goli dhe Boni. Kapitali gjermanoperëndimor, sidomos, është shumë aktiv, ai është futur kudo. Më parë sovjetikët u thoshin krerëve të vendeve të ish-demokracisë popullore të Evropës të mos lidhnin marrëdhënie me Gjermaninë Perëndimore, ndërsa për vete ata mbanin lidhje me të. Kurse tani këto vende po krijojnë lidhje direkt me Bonin dhe kanë filluar që shumë mallra t'i blejnë atje dhe jo në Bashkimin Sovjetik. Kështu, pra, kontraktat që janë krijuar në gjirin e revizionistëve do të thellohen gjithnjë e më shumë.

Pavarësisht nga këto, popujt do të rezistojnë përpara veprimtarisë së revizionistëve. Ne dimë që ka rezistencë në Bullgari, në Poloni, në Çekosllovakia.

Për sa i përket Jugosllavisë, ajo është një vend kapitalist. Atje çdo ndërmarrje lejohet të tregtojë me vendet kapitaliste. Kapitalistët e huaj janë të lirë të kenë deri në 49 për qind të aksioneve në ndërmarrjet jugosllave dhe nga fitimet që nxjerrin, 80 për qind i futin në xhepat e tyre, kurse 20 për qind kanë të drejtë t'i investojnë përsëri në atë ndërmarrje ose në ndërmarrjet e tjera të Jugosllavisë, ndërsa shteti jugosllav s'ka asnjë të drejtë të ndërhyjë në këto traktativa. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë kolonializëm. Popujve jugosllavë u duhet të luftojnë dhe të bëjnë shumë beteja për t'u çliruar dhe për të fituar mbi këta tradhtarë.

Revizionizmit modern patjetër do t'i vijë fundi. Partitë marksiste-leniniste, të vjetra ose të reja, janë parti luftarake. Ato vërtet do të hasin gjatë rrugës shumë vështirësi, por nuk tërhiqen para tyre. Ato parti që nuk luftojnë dhe nuk kapërcejnë vështirësi nuk luajnë ndonjë rol në histori. Përse kemi ne një respekt të madh për Partinë Bolshevike të Leninit dhe të Stalinit? Sepse ajo ka luftuar dhe ka bërë revolucionin. Tani, kur në Bashkimin Sovjetik kanë ardhur në fuqi revizionistët, atje duhet të ribëhet revolucioni që nga themeli.

Tani ju jeni para formimit të partisë marksiste-leniniste. Ne e ndiejmë për detyrë që t'ju japim ndihmën tonë dhe për këtë qëllim do të shfrytëzojmë botimet tona, si dhe Radio Tiranën. Neve na vijnë letra nga të katër anët e botës nga njerëz që dëgjojnë emisionet e Radio Tiranës në gjuhë të huaj dhe nga të tjerë që kërkojnë ta dëgjojnë atë. Këto na inkurajojnë. Ne do t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë tona që t'ua plotësojmë kërkesat këtyre miqve e dashamirëve të vendit tonë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**NË LUFTE DHE NË REVOLUCION MARKSISTË-
-LENINISTËT BËHEN MË TË FORTË
E TË PAMPOSHTUR**

Nga biseda me shokun Pedro¹ Pomar¹

18 gusht 1967

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet shoku Pomar? Si është me shëndet shoku Amazonas?

SHOKU PEDRO POMAR: Faleminderit, të gjithë jemi mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Është një kënaqësi e madhe që po takohemi përsëri me ju, shokët e Partisë heroike Komuniste të Brazilit.

Ne ruajmë kujtimet më të mira nga takimi që patëm me shokun Amazonas kur ishte në Shqipëri. Sho-

¹ Shoku Pedro Pomar, udhëheqës i PK të Brazilit, së bashku me anëtarin tjetër të Komisionit Ekzekutiv të KQ të PK të Brazilit, Anhelro Arrojo, dhe me anëtarin e KQ të Partisë, Huan Batista Drumond, në dhjetor të vitit 1976 ranë heroikisht në fushën e betejës, në përpjekje me armë me forcat ushtarake reaksionare të Brazilit.

ku Amazonas është me të vërtetë një shok i vendosur për marksizëm-leninizmin, një njeri i zoti, i fortë nga shpirti dhe mendimet, si dhe në interpretimin e drejtë të njohurive marksiste-leniniste. Të gjithë shokët tanë u gëzuan shumë dhe e konsideruan një nder të madh që shoku Amazonas erdhi në Kongresin e 5-të të Partisë sonë. Me këtë rast ai dhe shokët e tjerë na bënë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen në Brazil dhe në Amerikën Latine. Kjo ka qenë për ne një ndihmë shumë e madhe.

E dimë se të dyja palët, si ju ashtu edhe ne, kemi nevojë të shkëmbejmë mendime me njëra-tjetrën, prandaj ardhja juaj në Shqipëri është një ndihmë për ne.

SHOKU PEDRO POMAR: Fjalët tuaja, shoku Enver, na ngjallin emocione shumë të mëdha. Ato janë shumë të ngrohta dhe shumë të përzemërta.

Sa herë që vijmë te ju ne ndiejmë një kënaqësi të madhe dhe jemi treguar të gatshëm për të shkëmbyer mendime me shokët shqiptarë.

Shoku Amazonas është larguar nga vendi juaj mjaft i kënaqur dhe me përshtypjet më të mira për shokët e Partisë së Punës të Shqipërisë, është larguar akoma më i bindur për drejtësinë e vijës së Partisë suaj.

Duke qenë në ballë të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit, Partia e Punës e Shqipërisë na ka dhënë shembullin e madh se, duke u bazuar në marksizëm-leninizmin, mund të përballohet me sukses çdo armik, sado i fuqishëm qoftë ai. Duke qenë të bashkuar dhe të lidhur fort me njëri-tjetrin, askush nuk mund të na thyejë. Prandaj, në emër të të gjithë sho-

këve tanë, ju përhëndesim nxehëtishtë dhe ju sigurojmë se ne do të jemi kurdoherë vëllezërit tuaj të vërtetë.

SHOKU ENVER HOXHA: Fjalët tuaja, shoku Pomar, janë një vlerësim i madh që i bëni Partisë sonë dhe na forcojnë besimin në luftën tonë të përbashkët, na rritin përgjegjësinë që Partia jonë ka ndaj lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare.

Natyrisht, eksperiencia jonë nuk është shumë e madhe dhe e vetmja. Këtë nuk e themi për modesti, por të nisur nga e vërteta se lufta dhe revolucioni janë një çështje e madhe e të gjithë popujve, për të cilën është grumbulluar e vazhdon të grumbullohet një eksperiencë e pakufishme, që tregon se revolucioni mund të kryhet e të fitohet vetëm nga ato parti që zbatojnë me konsekuencë marksizëm-leninizmin. Po ku qëndron forca e partive marksiste-leniniste? Ajo qëndron në atë se ato gjithmonë e shikojnë jetën ashtu siç është, me kontradiktat, me zigzaget e me tendencën e saj për të ecur gjithmonë përpara, drejt përparimit të pashmangshëm nëpërmjet revolucionit dhe u rrënjos atyre besimin në fitore. Ky besim tek e ardhmja i bën partitë marksiste-leniniste të orientohen drejt në luftën e tyre, të mos tremben para vështirësive e të mos dëshpërohen nga disfatat e përkohshme, sepse marksizëm-leninizmi na mëson që rruga e revolucionit nuk është e shtruar me lule. Prandaj marksistë-leninistët duhet të prijnë me guxim e me vendosmëri të papërkulur, me luftë e me përpjekje t'i kapërcejnë vështirësitë dhe gjatë kësaj lufte të grumbullojnë eksperiencën për të ecur më përpara. Partia jonë në rru-

gën e saj 26-vjeçare ka mësuar shumë, por ne shikojmë se kemi akoma për të mësuar.

Në këtë drejtim, pa pasur pretendime, mund të themi se kemi arritur rezultate mjaft të mira. Natyrisht, këto janë më të dukshme tek anëtarët e Partisë, por ne kemi arritur që jo vetëm ata, por edhe populli, në mënyrë të thjeshtë, të kuptojë se çlirimi i vendit, liria, ndërtimi i socializmit nuk mund të siguroheshin në rast se në Shqipëri nuk do të ekzistonte Partia me vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Populli ynë ka luftuar edhe herë të tjera, ka korrur edhe fitore kundër armiqve, por në të kaluarën ai kurrë s'ka fituar përfundimisht. Këtë radhë ai fitoi dhe u bë zot i vendit të tij vetëm e vetëm se u udhëhoq nga një parti marksiste-leniniste, e cila për rreth 26 vjet me radhë e ka çuar nga fitorja në fitore. Të gjitha këto fitore e kanë bindur popullin tonë se ai do t'i ndërtojë socializmin e komunizmin vetëm nën udhëheqjen e Partisë, vetëm duke kuptuar, zbatuar e mbrojtur me konsekuencë e gjer në fund marksizëm-leninizmin.

Tani jemi duke zbatuar vendimet e Kongresit të 5-të të Partisë dhe shkurtimisht mund t'ju themi se kemi suksese në realizimin e vijës së Partisë. Kjo nuk do të thotë se nuk gjejmë vështirësi, por çështja është se këto vështirësi, sado të mëdha që të jenë, në situatën e krijuar nga Partia po kapërcehen me shpejtësi, sepse Partia jonë, ashtu sikurse partia juaj, është e lidhur ngushtë me popullin dhe se vija e saj përfaqëson dëshirat dhe aspiratat e tij. Sa më mirë ta kuptojë, ta ndiejë dhe ta zbatojë populli vijën e Partisë, marksizëm-leninizmin, aq më mirë do të dijë t'i inter-

pretojë të gjitha fenomenet dhe direktivat e Partisë në frymën marksiste-leniniste.

Ne shikojmë se zbatimi i direktivave të Kongresit të 5-të të Partisë ka dhënë rezultate. Rezultati kryesor është ngritja e lartë politike e komunistëve dhe e popullit, ngritje që shfaqet në realizimin e planeve të ekonomike si kurrë ndonjëherë më parë, si në industri, në bujqësi, në arsim, në kulturë, ashtu dhe në çështjen e mbrojtjes së atdheut.

Ne, marksistët, kurrë nuk duhet të jemi pesimistë, njëkohësisht nuk na lejohet të jemi edhe optimistë pa baza, por e vërteta është se pas Kongresit të Partisë ne shikojmë një hop të madh cilësor, një hov të paparë në masat që kanë shpërthyer në iniciativa revolucionare në të gjitha fushat e jetës dhe që janë vazhdim e thellim i revolucionit. Në Kongresin e Partisë, për shembull, u hodh parulla revolucionare për hapjen e tokave të reja në malësi. Me mijëra e mijëra të rinj dhe të reja, burra e gra, duke iu përgjigjur thirrjes së Kongresit, iu ngjitën maleve dhe hapën e do të vazhdojnë të hapin me mijëra e dhjetëra mijë hektarë tokë të re. Në këtë drejtim janë tejkaluar të gjitha planct.

Kolektivizimi i bujqësisë në malësi mbaroi plotësisht brenda dy muajve. Ne kishim në malësi rreth 500 fshatra të pakolektivizuara. Partia ka punuar që vetë fshatarët të kuptonin jo vetëm me fjalë, por të shikonin edhe konkretisht sukseset e kolektivizimit në fushë. Si rrjedhim, pas Kongresit, me thirrjen që bëri Partia, me një vullnet të çuditshëm u kolektivizuan menjëherë të gjitha. Përveç kësaj, ngjau edhe diçka tjetër. Me iniciativën e tyre fshatarët propozuan të shkur-

tojnë oborret dhe të pakësojnë bagëtitë personale gjysmë për gjysmë. Këto u realizuan brenda 5-6 muajve në të gjithë fshatarësinë. Nga ana tjetër, Partia dha orientimin që të gjitha tokat dhe bagëtitë personale që u pakësuan nga oborret kooperativiste të punohen e të shfrytëzohen në mënyrë kolektive dhe përveç të ardhurave të tjera që kooperativistët sigurojnë nga puna e tyre e përbashkët në kooperativë, të marrin nga këto edhe të ardhura në natyrë. Në këtë mënyrë kooperativistët kuptuan edhe një herë se jeta në kolektivitet është më e mira. Tani ka një optimizëm më të lartë, ka një kuptim më të drejtë politik, ideologjik nga kooperativistët, por ka edhe një mobilizim akoma më të madh, sepse ato toka që më parë ata i punonin vetë, tani i punon traktori dhe prej tyre sigurojnë të ardhura më të mëdha. Krahas këtyre, te ne bëhet një punë e madhe për sistemimin dhe për kanalizimin e tokave. Shokët tanë ndofta ju kanë informuar për këtë, por ju do të keni rastin t'i shikoni edhe vetë. Natyrisht, objektet e mëdha ndërtohen nga shteti, por është e habitshme që vetë fshatarësia hap kudo kanale ujitëse, duke çarë dhjetëra e dhjetëra kilometra nëpër male për të ujitur tokat.

Të gjitha këto, shoku Pomar, kanë sjellë që këtë vit, pas Kongresit të Partisë, të kemi një hov të madh në bujqësi, të kemi prodhime shumë të mira në grurë, në misër, në luledielli, në ullinj, në pambuk dhe në të gjitha prodhimet bujqësore.

Në industri, gjithashtu, po realizohen me sukses detyrat e parashikuara nga plani.

Këto suksese e kanë burimin në kuptimin e drejtë

nga ana e popullit të çështjeve politike dhe ideologjike.

Duke u bazuar në vendimet e Kongresit, revolucionin ynë ideologjik kundër mbeturinave të huaja në ndërgjegjen e njerëzve, kundër zakoneve prapanike dhe kundër fesë mori një hov jashtëzakonisht të madh. Natyrisht, ky hop i madh nuk u bë brenda një dite, ai është rezultat i punës dhe i vijës ateiste të ndjekur qysh në fillim nga Partia, i kuptimit dhe i interpretimit të drejtë marksist-leninist të zhvillimit tonë shoqëror. Ne, kurdoherë, i kemi atakuar idealizmin, fenë, zakonet e vjetra në mënyrën e jetesës dhe kemi arritur mjaft rezultate. Por në fillim të këtij viti, kur Partia theksoi edhe një herë me forcë nevojën e thellimit të luftës kundër mbeturinave, zakoneve dhe të gjitha shfaqjeve të ideologjive të huaja që mbahen akoma gjallë, u arrit hopi cilësor. I gjithë populli, rinia, gratë dhe burrat u ngritën në këmbë dhe vendosën të prishin kishat e xhamitë, të hedhin poshtë zakonet e vjetra, të mos bëhen martesat sipas fesë etj. Priftërinjtë e hoxhallarët, tha populli, duhet të venë e të punojnë, pse të gjitha ato që na kanë thënë e që kanë bërë gjer më sot s'kanë qenë të drejta. Pra, u ngrit vetë populli dhe i hoqi fesë bazën materiale, domethënë, kishat e xhamitë. Tani situata është shumë e favorshme. Natyrisht, do të ketë sot dhe mot njerëz, sidomos pleq, që thellë në ndërgjegjen e tyre do të ruajnë besimin te zoti, te feja. Këtë Partia dhe të rinjtë e dinë, por dinë, gjithashtu, se si u duhen marrë këtyre krahët, prandaj tani po bëhet një luftë më e thellë.

Mund të ketë shokë, miq të vendit tonë, të cilët, duke e gjykuar se është e pamundur të bëhet një gjë e tillë në kushtet e vendit të tyre, të thonë se shqiptarët janë sektarë. Në një takim që patëm me disa shokë marksistë-leninistë të një vendi të zhvilluar kapitalist u thamë se në disa drejtime, si, për shembull, në zhvillimin tekniko-shkencor, vendi i tyre është më përpara sepse ka një industri shumë më të zhvilluar etj., etj., kurse ne, shqiptarët, për sa i përket fesë jemi 200 vjet përpara tyre. Mirëpo kjo është një çështje me shumë rëndësi, një çlirim i madh për popullin. Ju e kuptoni fare mirë këtë.

Por edhe te ne feja ka historinë e saj. Shumica e klerikëve, sidomos krerët e fesë, gjatë gjithë historisë së popullit tonë kanë qenë kundër çlirimit kombëtar. Kleri mysliman mbështeste pushtuesin turk, kleri ortodoks ka qenë i lidhur me shovinistët grekë që kërkonin ta copëtonin Shqipërinë, kleri katolik ishte i lidhur me borgjezinë italiane që pushtoi Shqipërinë, pra, të gjithë këta ishin në luftë me popullin. Prandaj kleri nuk kishte aspak mbështetjen e tij. Kurse fenë, megjithëse ishte pleksur me traditat e zakonet e popullit, priftërinjtë e hoxhallarët nuk kishin arritur ta zhvillonin si doktrinë filozofike, sepse edhe para Çlirimit të vendit ajo ishte e ndarë nga shteti. Përveç klerikëve katolikë, klerikët myslimanë dhe ortodoksë ishin injorantë. Edhe ato 2-3 shkolla fetare që ekzistonin më parë, pas vendosjes së pushtetit popullor u mbyllën, kështu që nuk kishin mundësi ku t'i përgatitnin kuadrot e tyre. Ne nuk lejuam, gjithashtu, të shtypen libra «të shenjtë».

Nga ana tjetër, puna e vazhdueshme politike dhe ideologjike e Partisë krijoi një situatë të tillë saqë populli i dha fesë grushtin e fundit. Këtë grusht ai ia dha jo në mënyrë administrative, por me një bindje të thellë politike dhe ideologjike. Kjo ishte një fitore e madhe, të cilën ne duhet ta zhvillojmë më tej, por këtë nuk mund ta marrin të tjerët si shembull për ta zbatuar tani. Kur ne udhëhiqim luftën, nuk e ngritëm kurrë çështjen e fesë, përkundrazi, i bëmë thirrje popullit, duke përfshirë edhe besimtarët, të bashkohej i gjithi kundër okupatorit dhe në radhët tona u hodhën priftërinj ortodoksë e klerikë myslimanë, të cilët luftuan me armë në dorë. Dy prej tyre, që u lidhën me Lëvizjen Nacionalçlirimtare e me Partinë dhe në luftë e sipër braktisën fenë, përqafuan ideologjinë dhe vijën e Partisë, i pranuan në Parti, por gjithnjë duke u bazuar në mësimet e Leninit për partinë. Ata luftuan heroikisht në radhët partizane, u bënë edhe komandantë, po pas Çlirimit të vendit reaksioni u bëri atentat dhe i vrau¹.

Me këtë dua të them se eksperiencia e të tjerëve nuk duhet marrë shabllon, se atë që bëjmë ne sot, të tjerët mund ta bëjnë nesër ndryshe, por sidoqoftë kjo është një eksperiencë.

Një çështje tjetër është ajo e gruas. Natyrisht, në vendin tonë gruaja është e lirë, ajo gëzon të drejta të barabarta me burrin, merr pjesë në prodhim, shko-

¹ Është fjala për Heroin e Popullit, Baba Faja Martaneshi, dhe për patriotin, Baba Fejzo Dervishi, që u vranë nga reaksioni më 18 mars 1947.

llat janë të mbushura me gra dhe me vajza, fabrikat, gjithashtu. Por Partia shikonte se në mendjet e njerëzve, bile dhe të disa komunistëve, ekzistonin akoma pikëpamje të gabuara për gruan, sidomos në malësi, ku sundonin zakone të vjetra feudale që e poshtëronin atë. Ky ishte një problem me rëndësi të madhe politike dhe ideologjike. Partia gjykoi se tani ishin pjekur kushtet dhe hodhi kushtimin për të thelluar më tej luftën për emancipimin e plotë të gruas. Mënjherë shpërtheu një gjë e bukur. Burrat e pleq mbështetën vijën e Partisë, vajzat e tyre, që gjer dje nuk i linin të dilnin nga dera e shtëpisë, i çuan të punojnë në hekurudhë. U prishën fejesat që ishin lidhur qysh në djep. Baballarët, nënat e vajzat folën përpara popullit, u krijua një mirëkuptim në mes tyre dhe të fejuarve.

Këto janë disa momente të rëndësishme historike për vendin tonë. Me këtë rast ne provuam edhe një herë se vija e Partisë ishte e drejtë, sepse e pamë zbatimin e saj në jetë, në praktikë. Ne pamë se të gjitha këto e ngritën revolucionin tonë në një shkallë më të lartë dhe zhvillimi i ekonomisë, i arsimit dhe i kulturës morën një hov më të madh. Në çdo fshat tani ka shtëpi kulture, biblioteka, kudo venë librat e gazetat dhe kudo po luftohet që të gjithë të lexojnë dhe të mësojnë.

Rëndësi ka pasur, gjithashtu, edhe zbatimi i direktivave të Kongresit për kalitjen e mëtejshme të Partisë. Kjo është kryesorja. Partia jonë është e pastër, e fortë dhe s'lejon punë armiqësore brenda saj. Kjo ka ardhur për arsye se janë mbrojtur kurdoherë

me konsekuencë parimet. Partia jonë nuk ka lejuar kurrë që brenda saj të ketë dy vija, por vetëm një vijë. Kjo nuk do të thotë që komunistët të mos kenë mendime, pse Partia nuk kërkon që në radhët e saj të ketë njerëz automatë, por kur ata kanë mendime, janë të lirë t'i shfaqin, dhe pasi të diskutohen, të vihet në jetë vendimi i aprovuar nga shumica. Zbatimi i tij në praktikë do të tregojë nëse ai ishte i drejtë ose jo, nëse kishte ose jo të drejtë shumica. Në qoftë se jeta vërteton se shumica nuk ka pasur të drejtë, Partia mëson që t'i jepet e drejta pakicës dhe shumica të bëjë autokritikë. Por që të bëhet kjo, thotë Partia jonë, komunistët duhet të jenë revolucionarë dhe që të jenë të tillë duhet që, në radhë të parë, parimet e normat e Partisë t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë ata e jo të shesin mendje. Pra, idetë dhe mendimet duhet t'i provojë praktika, në mënyrë që populli të thotë: Po, ti je komunist, ti punove dhe pamë se ajo që thua është e drejtë.

Partia u tha komunistëve, sidomos kuadrove të lartë, se duhet të rrojnë në mënyrë të thjeshtë, prandaj i ulëm rrogat e larta. Kështu rrogat tona zbritën në nivelin 1 me 2 dhe 1 me 2,5. Nga ana tjetër, u thamë kuadrove që të punojnë së bashku me punëtorët e fshatarët dhe të qëndrojnë sa më pak në zyrë, aq sa është e domosdoshme, prandaj u vumë gërshërën aparateve tona dhe disa mijëra veta shkuan nga administrata në prodhim. Tani të gjithë drejtuesit e fabrikave, të ndërmarrjeve, të kooperativave bujqësore drejtojnë dhe njëkohësisht punojnë në torno, në mal ose në fushë, në mënyrë që të kaliten, të mos u rritet

mendja, të lidhen ngushtë me popullin dhe t'i vërtetojnë atij në praktikë se ç'është marksizëm-leninizmi. Por a ka pasur në këtë rast vështirësi dhe hezitime të njerëzit? Ata që kanë hezituuar numërohen me gisht. Të gjitha këto ishin një provë e madhe.

Për vendin tonë, ku është në fuqi diktatura e proletariatit, marrja e këtyre masave për komunistët është e domosdoshme. Tragjedia që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e Evropës Lindore, ku janë në krye revizionistët, është një mësim i madh për marksistë-leninistët. Në rast se nuk zbatohen si duhet dhe në mënyrë revolucionare parimet, degjenerimi mund të arrijë më parë të kuadrot e lartë dhe pastaj t'i hidhet në qafë gjithë popullit dhe të rrezikohet revolucioni.

E tillë është situata te ne, shoku Pomar. Kjo nuk do të thotë se s'kemi të meta, por duke ecur përpara shikojmë nga pas e themi: Përse nuk e kemi bërë këtë gjë më parë? Atëherë dalim me konkluzionin se në disa drejtime s'kemi qenë shumë vigjilentë, s'kemi qenë aq revolucionarë, prandaj t'i vëmë gishtin kokës që të mos i përsëritim këto gabime. Kështu, me gjithë sukseset që kemi arritur, na mbetet akoma edhe shumë për të bërë.

Për sa i përket luftës së madhe të përbashkët kundër imperializimit dhe revizionizmit modern, ne gjykojmë se nuk duhet të kënaqemi kurrë me sukseset që janë arritur, për arsye se kemi akoma një luftë të madhe përpara. Edhe në qoftë se në Shqipëri janë arritur disa rezultate, dhe kryesori është vendosja e forcimi i diktaturës së proletariatit, ne duhet të men-

dojmë se shokët tanë dhe popujt e tjerë luftojnë e derdhin gjak, bëjnë sakrifica kolosale e kalojnë vësh-tirësi të panumërta në situata jashtëzakonisht të vë-shtira të brendshme e të jashtme. Prandaj, ne duhet jo vetëm t'i ndihmojmë, por edhe t'i kuptojmë dhe të kemi besim të madh te shokët tanë, në heroizmin, në luftën, në pjekurinë e tyre marksiste-leniniste dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të nxjerrim konkluzione të gabuara e të themi se ndokush është në gjendje t'u shesë mendje e t'u japë receta të gatshme të tjerëve që të bëjnë kështu apo ashtu. Kjo nuk është aspak marksiste-leniniste. Shokët e njohin shumë më mirë gjendjen në vendet e tyre. Ata i njohin më mirë situa-tën dhe mentalitetin e popullit të vet. Në bazë të kësaj njohjeje dhe duke u udhëhequr nga parimet e mar-ksizëm-leninizmit, ata janë në gjendje ta edukojnë e ta mobilizojnë partinë, ta hedhin në luftë dhe të ecin përpara. Kjo çështje është e lidhur me kuptimin dhe me zbatimin e teorisë marksiste-leniniste në bazë të situatës konkrete të vendit. Ndonjë mund të thotë se ne mund të bëjmë gabime. Por cila është ajo parti e madhe ose e vogël, e vjetër ose e re, që në punën e saj s'ka pasur edhe të meta e gabime? E rëndësishme këtu është që të mos i fshehësh ato, por t'i njohësh, t'i analizosh e t'i korrigjosh në bazë të marksizëm-leninizmit. Kjo është dialektika marksiste. Prandaj, ne mësojmë në punë e sipër edhe nga gabimet. Në qoftë se një popull ose një parti nuk lufton, ai popull dhe ajo parti s'kanë histori. Pa luftë nuk bëhet historia. Siç e dini, përpara kemi armiq të shumtë, imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe revizionistët modernë, me

ata sovjetikë në krye, të cilët janë shumë dinakë dhe kanë eksperiencë të madhe. Por, sado dinakëri e mjetë të kenë armiqtë tanë, ata s'kanë forcën tonë, sepse forca jonë qëndron në ideologjinë marksiste-leniniste, në besimin te fitorja, në besimin te populli. Populli është me ne, sepse me ne është e ardhmja, e vërteta, por për këtë të ardhme duhet që popullin ta edukojmë, ta organizojmë, ta entuziazmojmë dhe, me siguri, do të fitojmë mbi armiqtë.

Sikurse jeni në dijeni, revizionistët sovjetikë kanë shpërthyer një sulm të rreptë kundër marksizëm-leninizmit dhe kundër revolucionit në përgjithësi. Pozitat e tyre sa vjen e dobësohen, kurse pozitat tona forcohen. Këtë ne nuk e themi ashtu kot, por duke gjykuar në bazë të situatës konkrete. Revizionistët sovjetikë janë bërë aleatët më të pacipë të imperializmit amerikan. Po përse ngjau kjo? Sepse ata janë në pozita tradhtarë dhe nuk mund të bëjnë ndryshe. Përse ne jemi më të fortë? Sepse ishin marksistë-leninistët e të gjithë botës që nuk i lanë revizionistët sovjetikë të maskohen, po ua vunë këmbët në një këpucë dhe i denoncuan hapur si agjenturë e borgjezisë, gjë që e shikojnë qartë çdo ditë e më shumë komunistët dhe masat punonjëse në të gjithë botën. Nga demaskimi i tyre u arrit, gjithashtu, të demaskohen edhe revizionistët e të gjitha vendeve të ish-demokracisë popullore dhe të thellohen kontradiktat midis tyre e revizionistëve sovjetikë.

E tillë, pra, paraqitet gjendja në përgjithësi. Por, me gjithë sukseset që kemi korrur ne, marksistë-leninistët, kemi akoma shumë për të bërë.

Ndihma jonë, për të cilën folët ju shoku Pomar, është një ndihmë modeste, por ne, si marksistë-leninistë që jemi, do ta ndihmojmë me të gjitha forcat njëri-tjetrin. Ne kemi një admirim të madh për Partinë Komuniste të Brazilit, për Komitetin Qendror të Partisë suaj dhe për shokun Amazonas. Qenia e partisë suaj në pozita të drejta revolucionare është me rëndësi të madhe edhe për gjithë lëvizjen marksiste-leniniste e revolucionin në Amerikën Latine.

Ne kemi lidhje me partitë e tjera marksiste-leniniste të Amerikës Latine dhe jemi të sigurt se marksistë-leninistët, me gjithë vështirësitë që hasin, me luftë do t'i kapërcejnë ato. Rëndësi ka çështja që partitë marksiste-leniniste të Kilit, të Kolombisë, të Bolivisë etj., të arrijnë që në vendet e tyre ta kenë situatën në dorë.

SHOKU PEDRO POMAR: Ju falënderoj shumë për të gjitha ato që thatë, shoku Enver. Jam tepër i emocionuar për fjalët shumë të ngrohta dhe të përziemërta e për mundësinë që më dhatë për t'ju dëgjuar përsëri ju, personalisht.

Ju na bëtë sot një kuadër të përgjithshëm për gjendjen në Shqipëri. Unë kam qenë në vendin tuaj para katër vjetëve. Gjatë kësaj kohe ju keni kaluar situata të vështira. Me këtë nuk dua të them se tani nuk keni më vështirësi, por që nga ajo kohë keni bërë një avancim të dukshëm. Sukseset që keni arritur janë jashtëzakonisht të mëdha, rezultatet që ju keni arritur në fushën politike dhe ideologjike, vendet kapitaliste të botës nuk mund t'i arrijnë në shekuj. Shumë vende kapitaliste mund të jenë më të zhvilluara ekonomi-

kisht, por kjo nuk është kryesorja, sepse popujt në këto vende janë të shtypur e të shfrytëzuar dhe nga ky zhvillim ekonomik përfiton vetëm borgjezia. Kurse në vendin tuaj gjendja politike dhe morale e popullit është jashtëzakonisht entuziaste. Dhe s'ka dyshim se të gjitha këto fitore u detyrohen udhëheqjes së drejtë dhe vijës marksiste-leniniste të Partisë suaj, besnikërisë që ajo ka ndaj marksizëm-leninizmit, unitetit të madh të popullit me Partinë. Të gjitha këto, pa asnjë diskutim, janë për ne një stimul i madh për të ecur akoma edhe më përpara në luftën tonë. Prandaj do të luftojmë edhe më shumë kundër armiqve tanë, që janë njëkohësisht edhe armiqtë e Partisë dhe të popullit shqiptar.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i vendit, që është duke bërë populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ka një rëndësi të madhe ndërkombëtare. Bile mund t'ju them se ky revolucionarizim reflektohet edhe në vendin tonë. Disa vjet më parë populli ynë nuk e njihte dhe nuk dinte asgjë për Shqipërinë, kurse tani ai ka dijeni, interesohet vazhdimisht për të, mëson dhe gëzohet për sukseset e popullit shqiptar. Populli brazilian e di se në Shqipëri revolucioni zhvillohet në mënyrë të pandërprerë e me hapa të sigurt. Bile këtë vit edhe disa gazeta borgjeze janë detyruar të shkruajnë për vendin tuaj, të botojnë lajme dhe artikuj informativë, të flasin mbi qëndrimin e guximshëm e të pavarur të shokëve shqiptarë. Janë faktet ato që e bëjnë Shqipërinë të njihet në të gjithë botën. Ne mendojmë se Shqipëria ecën me sukses përpara.

Ne jemi plotësisht dakord me ato probleme që

keni shtruar në Kongresin e 5-të të Partisë. Nuk është aspak e rastit që të gjithë marksistë-leninistët e respektojnë Shqipërinë. Popujt revolucionarë e konsiderojnë Shqipërinë si bastion, kala, të luftës së tyre çlirimtare, si pararojë të marksizëm-leninizmit.

Me këtë rast dëshirojmë të theksojmë se ndihma juaj për ne ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Ju jemi mirënjohës për këtë dhe do të bëjmë ç'është e mundur për të dhënë edhe ne kontributin tonë.

Tani, në propagandën borgjeze, flitet shumë se Amerika Latine është një vend i vetëm, kurse në të vërtetë shtetet tona janë shumë të ndara në mes tyre, jo vetëm nga interesat midis shteteve kapitaliste, por edhe nga vetë interesat kombëtarë. Por puna e partive marksiste-leniniste të Amerikës Latine është e përbashkët, sidomos në luftën kundër imperializmit amerikan dhe kundër revizionizmit. Tani është krijuar një situatë që kërkon bashkërendimin e forcave tona. Ne duhet ta njohim mirë këtë situatë, sepse vështirësitë që kalon lëvizja marksiste-leniniste në Amerikën Latine janë të mëdha, mbasi, përveç imperializmit amerikan dhe borgjezisë e gjithë reaksionit, luftojnë kundër nesh edhe revizionistët.

Vitet e fundit, lëvizja antiimperialiste dhe demokratike në Amerikën Latine mori grushte të rënda. Në këto kushte ne duhet të përballojmë goditjet e imperializmit amerikan dhe të revizionistëve, bashkëpunimin sovjetë-amerikan, reaksionin e vendit. Të gjitha këto krijojnë për ne një situatë të vështirë.

Pas grushtit të shtetit më 1964, imperialistët amerikanë kanë marrë në Brazil të gjitha kyçet në duart

e tyre. Në Brazil mori fuqinë një qeveri që është plotësisht besnike e imperializmit amerikan, sepse gjer në atë kohë, megjithëse ndodhej në fuqi një qeveri e borgjezisë së madhe dhe e latifondistëve, ajo mbronte disa interesa kombëtarë. Kurse tani problemi është krejtësisht ndryshe. Populli e kupton se në Brazil është krijuar një gjendje e re e rëndë, por partitë borgjeze dhe revizioniste kanë punuar dhe punojnë për të krijuar iluzione në popull, duke thënë se «marksist-leninistët e ekzagjerojnë problemin kur e akuzojnë imperializmin për neokolonializëm» etj., etj. Këto probleme ne duhet t'i përballojmë, sepse ngjallin iluzione në masat, e mashtrojnë popullin dhe nuk i japin mundësi të kuptojë drejt e shpejt situatën e rëndë që është krijuar si rezultat i ardhjes në fuqi të qeverisë reaksionare proamerikane. Ndaj para nesh qëndron detyra e madhe që ta sqarojmë popullin, t'i hapim sytë dhe ta ngremë në luftën e armatosur për të siguruar lirinë kombëtare.

Gjendjen e re që po krijohet në Brazil nuk e kuptuan as përfaqësuesit e borgjezisë. Kështu, Brizola, kuanati i ish-presidentit të Brazilit, Gulartit, megjithëse ishte një njeri me prestigj të madh, në kohën që ndodhi grushti i shtetit, nuk mbajti qëndrim, por iku jashtë shtetit, gjoja për t'u kthyer përsëri. Në fakt ai nuk e kishte kuptuar situatën që ishte krijuar në Brazil.

Amerikanët panë se politikanët e borgjezisë nacionaliste nuk u shërbenin më, prandaj i flakën dhe rië vend të tyre sollën në fuqi ata që kishin përgatitur prej shumë vjetësh si oficerë në SHBA. Kjo tregon se ata kërkojnë të mbajnë me hekur diktaturën fashiste

në Brazil, për ta pasur si krah të sigurt dhe për ta përdorur në zbatimin e planeve të tyre neokolonialiste në vendet e tjera. Praktikisht Brazili mori pjesë me forcat ushtarake që pushtuan Santo-Domingon. Kjo ishte hera e parë që ushtria e vendit tonë u dërgua për të luftuar në vende të tjera.

Ne i kemi denoncuar këto ngjarje dhe punojmë për t'i bindur masat se duhet luftuar kundër imperializmit amerikan; po demaskojmë rolin tradhtar të revizionistëve sovjetikë, sepse ata jo vetëm që e kanë njohur qeverinë reaksionare në fuqi, por kanë lidhur edhe disa marrëveshje tregtare.

Për sa u përket revizionistëve në Brazil situata paraqitet më e keqe se më parë. Ata kanë pësuar një shkatërrim të madh. Para grushtit të shtetit të 1964-ës ata kishin një situatë të favorshme, sepse qeveria borgjeze e Gulartit e përkrahte politikën e revizionistëve, por jeta tregoi se kjo politikë e pranueshme nga borgjezia ishte krejt false. Pas grushtit të shtetit ne i forcua mjaft pozitat tona, mbasi i treguam popullit se vetëm marksizëm-leninizmi i mbron interesat e tij. Partia jonë doli me një influencë më të madhe. Kurse revizionistët nuk bëjnë gjë tjetër veçse ushqejnë iluzione dhe shpresojnë në rikthimin e demokracisë pa luftë të armatosur, prandaj edhe veprimtaria e tyre politike është shumë e dobët. Tani ata janë ndarë në disa grupe. Njëri nga këta ndodhet në një rrugë afri mi me ne, për arsye se është për luftën e armatosur, por njëkohësisht mban qëndrime centriste dhe oportuniste. Grupi tjetër është një grup aventurier dhe likuidator i partisë. Pastaj vjen grupi i Prestesit, i cili

është dobësuar shumë dhe karakterizohet si grup që është vënë plotësisht në shërbim të borgjezisë.

Tani pozita e klikës reaksionare në Brazil është e lëkundshme dhe e paqëndrueshme. Sovraniteti i vendit ndodhet në duart e amerikanëve. Forcat kryesore të vendit, klasa punëtore, fshatarësia dhe borgjezia e vogël duan progresin dhe zhvillimin ekonomik të vendit, mbasi niveli i jetesës së popullit është mizerabël, të gjitha pasuritë, minierat, tokat, janë në duart e amerikanëve. Fshatarët jo vetëm që s'kanë tokë, por janë varfëruar akoma më tepër. Klasës punëtore, e cila me luftën e saj kishte mundur të siguronte më parë disa fitore, regjimi diktatorial ia likuidoi të gjitha; ajo varfërohet çdo ditë e më shumë. Dëshirat e popullit për arsim dhe kulturë janë tronditur, është vendosur një terror kulturor, programet në universitetet adaptohen sipas interesave të amerikanëve etj.

Të gjitha këto kanë shtuar kontradiktat dhe, praktikisht, po të punohet mirë, ka perspektiva shumë të mira për zhvillimin e luftës së armatosur. Ashtu sikurse ka thënë Stalini, në kushtet e sotme i bie detyra partisë komuniste të ngrejë flamurin e pavarësisë kombëtare e të lirive demokratike dhe, duke shfrytëzuar të gjitha kontradiktat e thella që janë krijuar, të përgatitet për luftën e armatosur.

SHOKU ENVER HOXHA: Ekspozeja juaj, shoku Pomar, plotësoi edhe më shumë dijenitë tona mbi situatën në Amerikën Latine dhe, veçanërisht, në Brazil. Ne gjykojmë se partia juaj i bën një analizë shumë të drejtë gjendjes, në përgjithësi, në Amerikën Latine dhe në Brazil. Ne jemi të bindur se një analizë e tillë

serioze është një siguri e madhe për zhvillimin drejt të revolucionit.

Revolucioni është një çështje shumë serioze dhe, kur i futesh atij, duhet ta çosh gjer në fund. Marksistë-leninistët nuk mund të veprojnë si borgjezia, si anarkistët, si puçistët, pse revolucioni ka të bëjë me jetën dhe të ardhmen e popullit. Në bazë të analizës marksiste-leniniste të partisë suaj ju do të dini të përcaktoni edhe masat që duhet të merrni për zhvillimin e revolucionit, duke pasur parasysh të gjitha minuset e pluset. Kuptimi i mirë i situatës të jep mundësi të marrësh edhe masat përkatëse politike dhe organizative, të krijosh aleancat dhe t'i kuptosh këto në dritën marksiste-leniniste, duke mos pasur as iluzione mikroborgjeze, por as edhe pikëpamje sektare.

Në radhë të parë ka rëndësi çështja që ju luftoni për të konsoliduar partinë. Kjo është jetike për marksistë-leninistët. Sipas pikëpamjes sonë, pa një parti marksiste-leniniste nuk mund të ketë revolucion dhe çlirim të vërtetë për popullin. Ne, shqiptarët, themi se partia duhet të jetë një parti e tipit leninist. Këtë gjë e lypin situatat, pse forcat e armikut janë të shumta dhe të djallëzuara, me një eksperiencë reaksionare, të cilave mund t'u bëhet ballë vetëm me një parti të ndërtuar mbi parime politike, ideologjike dhe organizative të shëndosha marksiste-leniniste. Qëllimi jo vetëm i kapitalizmit, por edhe i revizionistëve modernë, konsiston pikërisht në shthurjen dhe në degjenerimin e partive marksiste-leniniste, në mënyrë që ato të mos jenë në gjendje për t'u bërë ballë armiqve të shumtë dhe, më në fund, në shkatërrimin e tyre. Për këto

arsye dhe shumë të tjera revizionistët u ngritën e hodhën baltë kundër Stalinit, bënë lloj-lloj shpifjesh, të cilat ne, komunistët shqiptarë, i hodhëm krejtësisht poshtë.

Për të gjykuar veprën e Stalinit, nëse ai ka bërë ose jo gabime, ka dy rrugë: ose të bazohesh në veprat e tij dhe të Partisë Bolshevike, ose të bazohesh në shpifjet e revizionistëve. Në shpifjet e revizionistëve ne nuk mund të bazohemi në asnjë mënyrë, por bazohemi në veprën e Stalinit, në politikën dhe në ideologjinë që ka mbrojtur, në atë ç'ka thënë dhe ç'kemi parë.

Por, a ka bërë gabime Stalini? Ne nuk mund të themi se Stalini s'ka bërë fare gabime, po kurrë nuk mund të pranojmë si argumente «faktet» që fabrikoj Hrushovi dhe t'i diskutojmë ato nga pozitat e tij tradhtarë. Në qoftë se lëvizja komuniste ndërkombëtare do t'i ketë në dorë faktet, dokumentet e Partisë Komuniste Bolshevike dhe të Kominternit (që ajo nuk i ka), atëherë mund të gjykojmë e të themi se Stalini këtu ka gabuar dhe këtu jo. Por edhe këto fakte duhet t'i gjykojmë duke marrë parasysh rrethanat, kohën, si kanë qenë situatat dhe pse janë marrë ato vendime, nëse mund të merreshin vendime të tjera dhe çfarë pasojash mund të kishin ato për Bashkimin Sovjetik dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Tradhtarët e marksizëm-leninizmit thonë se Kominterni ka bërë plot gabime! Jo, në asnjë mënyrë ne nuk e besojmë këtë. Thonë, gjithashtu, se të gjitha partitë që e kanë krijuar dhe kanë adoptuar vijën e Kominternit, prej kohës së krijimit të tyre e gjer tani,

s'kanë bërë veçse gjëra të këqija! As kjo nuk mund të pranohet, sepse partitë kanë luftuar në situata të ndryshme, kanë pasur suksese, kanë pasur edhe dis-fata. Ka pasur komunistë që kanë rënë në fushën e nderit, ka pasur prej atyre që kanë tradhtuar, ka pasur që kanë gabuar dhe janë ngritur përsëri, ka pasur nga ata që kanë gënjyer duke thënë se i pranojnë gabimet dhe më pas kanë tradhtuar përsëri. Por të gjitha partitë dhe të gjithë komunistët nuk kanë tradhtuar. Mundet që Kominterni dhe Stalini, për një arsye apo për një tjetër, duke mos e pasur të qartë situatën në ndonjë vend, t'i kenë dhënë partisë përkatese edhe ndonjë direktivë jo të përshtatshme. Por për këtë nuk mund t'i hedhësh gurin Stalinit. Ju, sho-ku Pomar, jeni komunist i vjetër dhe marksist-leninist i vërtetë dhe e kuptoni drejt këtë. Ju thatë më parë se para Luftës së Dytë Botërore ishte shumë e vështirë për të shkuar në Bashkimin Sovjetik. Në atë kohë informatat që merrte Kominterni nga partitë e ndryshme ishin shumë të rralla. Përgjithësisht raportet që i paraqiteshin atij në emër të partive të ndryshme ishin të sakta, por mund të ndodhte të ishin edhe të pasakta. Por duke u bazuar në një informacion jo të saktë, Kominterni mund të merrte edhe një vendim të gabuar. Prandaj këto çështje duhen gjykuar duke marrë parasysh situatat dhe momentet e asaj kohe.

Prandaj për partinë tuaj, për Partinë tonë, veçanërisht për partitë e reja dhe për çdo parti që është e vendosur të çojë revolucionin gjer në fund, çelikosja e partisë ka rëndësi të dorës së parë.

Ne jemi plotësisht dakord me pikëpamjen dhe me analizën e partisë suaj mbi zhvillimin e ngjarjeve. Duke mos e gjykuar si duhet zhvillimin e ngjarjeve dhe të aleancave, ndokush mund të thotë: «Përse ecin kaq ngadalë shokët e kësaj ose të asaj partie?».

Këtë e them se një gjë e tillë na ka ngjarë edhe neve. Por kur situata shikohet objektivisht dhe merren masat e nevojshme për të arritur qëllimin e caktuar çdo gjë do të vijë në kohën e saj. Natyrisht, revolucioni, kur fillohet, duhet çuar patjetër gjer në fund. Por, ata që duan të shpejtojnë artificialisht zhvillimin e ngjarjeve, nuk kanë një gjykim të drejtë marksist-leninist, sepse revolucioni nuk organizohet e nuk kryhet në një ditë, ai nuk është dasmë, por luftë e madhe popullore dhe në luftë armiq të godasin me gjithë egërsinë e tyre. Por nga lufta marksist-leninistët nuk tremben, megjithëse përkohësisht mund të pësojnë disfata. Përkundrazi, në luftë dhe në revolucion ata bëhen më të fortë e më të pamposhtur. Prandaj vija e partisë suaj është e drejtë.

Lufta e drejtë e partive marksiste-leniniste të Amerikës Latine, si ajo e partisë suaj, mendojmë ne, ka rëndësi të madhe për të krijuar atje një kuptim të drejtë mbi revolucionin. Në mos gaboj, në Amerikën Latine ka traditë puçiste. Kjo traditë duhet thyer, pse në këtë bazohen gjithë anarkistët aventurierë, që hiqen si marksistë revolucionarë. Në qoftë se partitë marksiste-leniniste nuk e bëjnë të qartë këtë çështje, ne mendojmë se anarkistët që dalin me parulla «ultramarksiste» do ta dëmtojnë shumë çështjen e revolucionit, mbasi ka njerëz që e barazojnë revolucionin

me puçin dhe bëjnë aventurizma, duke thirrur të rrëmbehen armët, në një kohë kur nuk janë krijuar kushtet. Partia juaj, që ka një vijë të drejtë marksiste-leniniste, i edukon njerëzit të kuptojnë se ç'është revolucioni, kush duhet të marrë pjesë në të dhe kush duhet të jetë në krye të tij.

Një parti e re marksiste-leniniste nuk ka përse të tronditet nga fakti që në fillim s'ka forcën dhe autoritetin e duhur, përkundrazi ajo të mendojë për të forcuar punën e saj dhe, nga ana tjetër, të sigurojë aleatët. Mundet që ajo të jetë e dobët, jo shumë e organizuar, të mos ketë akoma influencë në masat, por kjo nuk duhet ta bëjë atë të tregohet sektare dhe të evitojë kontaktet me ata që mund t'i sqarojë, t'i bëjë për vete dhe t'i hedhë në luftë. Njëkohësisht partia të ruhet që të mos zhdukë personalitetin e saj, të mos futet në çfarëdo fronti dhe të shkatërrohet, përkundrazi kurdoherë të ruajë pavarësinë, parimet dhe normat e saj. Rolin hegjemon në revolucion ajo do ta arrijë patjetër me luftë dhe me politikën e saj të drejtë. Që të kurorëzohet me sukses revolucioni, duhet të jetë në krye të tij partia marksiste-leniniste, por rolin hegjemon në të asaj nuk ia fal kush, por do ta fitojë me luftë.

Mendimi ynë është se partitë marksiste-leniniste të Amerikës Latine, duke ndjekur një strategji e taktikë të drejtë, janë e do të jenë faktorë shumë të rëndësishëm për revolucionin.

Më poshtë, pasi foli për luftën e partive marksiste-leniniste kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, shoku Enver Hoxha përfundoi:

Në përgjithësi këto kisha, shoku Pomar. Mendimi ynë është se lufta revolucionare po ecën përpara dhe ne të gjithë kemi suksese. Lufta, presionet, intrigat, bllokadat që kanë krijuar dhe krijojnë imperialistët e revizionistët nuk i trembin revolucionarët. Me ne është e drejta, me ne janë popujt, çështja jonë me siguri do të triumfojë.

Për sa u përket lidhjeve e marrëdhënieve midis partive tona, unë edhe një herë ju siguroj se Partia e Punës e Shqipërisë gjithmonë do t'u qëndrojë pranë partive dhe forcave marksiste-leniniste, gjithmonë do t'i ndihmojë e do t'i përkrahë në luftën e tyre të drejtë, gjithmonë krah për krah me to do të luftojë me konsekuencë e pa u përkulur për çështjen e madhe të marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit.

Jepuni përsëritjet tona të zjarra shokëve të Partisë Komuniste të Brazilit! Paçi gjithnjë suksese në luftën tuaj!

*Botuar për herë të parë,
me shkurtime, në revistën
«Rruga e Partisë», nr. 2.
Tiranë, 1977*

*Botohet sipas shënimeve të
mbajtura në këtë takim
që gjenden në AQP*

**SA MË SHPEJT T'I ZHDUKIM ZAKONET
PRAPANIKE, AQ MË SHUMË DO TË
LULËZOJË MALËSIA**

*Nga fjala në takimin me popullin e fshatit
Rrapsh-Starje të rrethit të Shkodrës dhe me
përfaqësues të popullit të malësisë së Kelmendit*

2 shtator 1967

Është një gëzim i madh për mua të takohem sot me ju, motra dhe vëllezër të malësive kreshnike të Kelmendit. Partia është krenare për ju, për cilësitë dhe virtytet tuaja të larta, për patriotizmin, besën e trimërinë. Jam i lumtur që vij të bisedoj me ju në këtë vend të bukur, në mes të kësaj natyre të ashpër e madhështore, të cilën dora e mendja e popullit dhe e Partisë do ta bëjnë edhe më të bukur në të ardhmen.

Jeta juaj ka ndryshuar shumë, por Partia mendon e punon që ajo të bëhet edhe më e mirë, që malësitë tona të zhvillohen e të lulëzojnë njësoj si fushat dhe qytetet. Deri më sot ne nuk i kemi pasur mundësitë për një gjë të tillë, sepse duhej të merrnim masa për zhvillimin e industrisë në qytete dhe të bujqësisë

në fusha, në mënyrë që ekonomia të zhvillohej më shpejt. Me këtë politikë të drejtë që ndoqi Partia, vendi ynë u fuqizua, ekonomia u zhvillua dhe tani ne kemi mundësi e mjete për të ndihmuar edhe zhvillimin e malësive. Një vepër e rëndësishme që do t'i shërbejë këtij qëllimi është edhe kjo rrugë e re¹, e cila do të lidhë më mirë krahinën tuaj me të gjitha skajet e atdheut.

Partia dhe Qeveria, kur morën vendimin për të bërë këtë rrugë, patën parasysh rëndësinë e saj të madhe për të gjithë vendin por, në radhë të parë, menduan për interesat e popullsisë së kësaj krahine të largët. Rruga e re, që vitin tjetër do të shkojë gjer në Vermosh, do të ndihmojë që edhe në këtë zonë të thellë malore të rritet shpejt mirëqenia ekonomike e kulturore, se ku ka rrugë, atje shkon edhe qytetërimi. Partia dëshiron që kjo zonë të bëhet nga më të bukurat e vendit tonë, që malet të bëhen pjellore, që ju të keni më shumë të ardhura për të jetuar më mirë. Rruga e re do të ndihmojë që të vijë këtu drita elektrike dhe të zhiduken llambat me vajguri e kandili, të hyjë në fshat radioja, të vijnë më shumë agronomë, mësues, mjekë, mami, bile edhe inxhinierë. Me kohë një pjesë e mirë e kuadrove të krahinës do të dalin nga vetë fshatrat tuaja, megjithatë, prapë do të vijnë njerëz nga rrethe të tjera, ashtu si kanë ardhur deri tani.

Malësia juaj do të ketë të gjitha ato të mira që

¹ Është fjala për rrugën automobilistike të Malësisë së Madhe që u ndërtua nga të rinjtë vullnetarë dhe u inaugurua më 13 tetor 1968.

prodhohen nga fabrikat e fushat më pjellore të vendit. Disa gjëra që ju mungojnë sot, këtej e tutje do t'ju vijjnë më lehtë e më shpejt. Kur nuk kishte rrugë, prindërit tuaj dhe ju vetë, për të vajtur deri në Shkodër që të shitnit ndonjë gjë nga prodhimet tuaja të pakta, vuanit ditë të tëra duke ecur këtyre shkrepave, kurse tani do të keni rrugën e re.

Vullnetarët janë shumë të gëzuar e të lumtur që po derdhin djersë për ndërtimin e kësaj vepre, se e dinë që në malet e Kelmendit kanë jetuar e kanë luftuar me shekuj malësorët trima, se këtu jetojnë e punojnë motrat e vëllezërit e tyre. Veç kësaj, duke ardhur këtu, të rejat e të rinjtë, kaliten edhe fizikisht, se luftojnë me shkëmbinjtë e derdhin djersë mbi ta. Njëkohësisht ata edukohen, shohin si luftohet për jetën, si u qëndrojnë malësorët dëborës, furtunave e vështirësive të panumërta të natyrës. Dhe ai që lufton e lodhet në jetë, ai që mposht çdo vështirësi, bëhet i fortë si çeliku.

Ne mburremi me ju malësorët që ju kemi kaq të fortë, që vështirësitë nuk ju kanë përkulur kurrë, që u keni qëndruar kurdoherë si burrat armiqve e natyrës së egër të këtyre maleve dhe jemi të bindur se të rinjtë që kanë ardhur këtu, po bëjnë një shkollë të madhe edukimi. Kur të kthehen pranë familjeve, në fabrika ose në kooperativa, në universitet ose në shkollat e mesme, ata, sigurisht, do t'u vihen edhe më mirë punës dhe mësimit, sepse do të kujtojnë vazhdimisht trimërinë e qëndrueshmërinë tuaj. Dashuria dhe respekti i tyre për ju do të kalojnë zemër më zemër te shokët, miqtë e të afërmit e tyre. Dhe ata do t'i

thonë njëri-tjetrit: «Shokë, të punojmë sa më shumë që të dërgojmë makineri, tela e motorë elektrikë në malësi, që edhe motrat e vëllezërit tanë malësorë të bëjnë një jetë më të mirë». Duke ju njohur ju, malësorët e mrekullueshëm, duke njohur bukuritë e papërshkrueshme të krahinës suaj, ata që do të mbarojnë universitetin, do të vijnë me dëshirë të madhe këtu dhe do t'ju mësojnë si ta punoni tokën më mirë, si të merrni më shumë misër dhe prodhime të tjera bujqësore, si ta zhvilloni blektorinë për të prodhuar më tepër mish, qumësht etj. Njerëzit që kanë ardhur dhe do të vijnë këtu, do të mësojnë shumë edhe nga ju, nga cilësitë e virtytet tuaja të rralla, me të cilat ne krenohemi. Pra, ndërtimi i kësaj rruge jo vetëm ndihmon zhvillimin dhe lulëzimin e malësisë, por është edhe një aksion ku edukohen të rinjtë dhe të rejat tona. Partia thotë se ky aksion nuk është i fundit. Në Shqipëri do të kemi akoma shumë vepra të tjera për të ndërtuar.

Ju i shikoni këto vajza dhe djem që kanë ardhur me thirrjen e Partisë, shikoni punën e sjelljen e tyre. Mos kujtoni, motra e vëllezër, se, duke mbajtur flokë të shkurtër dhe duke u veshur me pantallona, vajzat vullnetare kanë cenuar nderin. Edhe çikat tuaja, kanë shkuar të punojnë si vullnetare në hekurudhë e gjetkë, ku janë shquar për zgjuarsinë e tyre të madhe, për patriotizmin e ndershmërinë. Këto cilësi e nderojnë, si burrin, ashtu edhe gruan. Vajzat tuaja, në aksionet ku i keni dërguar, kanë punuar heroikisht dhe kanë mësuar nga shoqet e shokët e tyre shumë gjëra që nuk i dinin para se të vinin vullnetare.

Ato dolën nga malësia, panë Shqipërinë e tyre që nuk është vetëm fshati Selcë ose Tamarë, por një vend i tërë, i bukur e i fuqishëm, ku janë ndërtuar e ndërtohen fabrika, uzina, hekurudha, një vend me fusha pjellore, një vend ku njerëzit përparojnë dita-ditës. Vajzat tuaja i panë të gjitha këto përparime dhe u është bërë zemra mal. Nga aksionet ato janë kthyer më të shkathëta, më të ditura, më revolucionare. Tek ato u bë edhe më e fortë dashuria për nënën, babanë, motrën, vëllanë, për shtëpinë, për tokën, për fshatin dhe për gjithë Kelmendin. Edhe familja e fshati i duan tani më shumë vajzat e tyre që shkuan vullnetare. Këto vajza, që panë se si ka ndryshuar jeta në Shqipërinë tonë të bukur, e kuptojnë tani se babai e nëna duhen falur, edhe sikur të kenë bërë ndonjë gabim ndaj tyre, sepse aq kanë ditur dhe ato tani do të dinë të sillen më mirë se përpara.

Ju e keni marrë vesh se Partia iu drejtua gjithë popullit, fshatarëve, qytetarëve, sidomos fshatarëve të Veriut, që me gratë dhe vajzat të mbajnë një qëndrim të ndryshëm nga ai i deritanishmi. Asnjëri nuk mendon se ju nuk i doni çikat, gratë e mëmat tuaja dhe nuk i nderoni ato, por malësia, sidomos ajo e Veriut, ka pasur disa zakone të mbrapshta, shumë të rënda për gratë. Në malësi më parë thuhej se burri është çdo gjë, kurse gruaja nuk është asgjë. Ky është mendim shumë i gabuar. Gruaja në Shqipërinë socialiste vlerësohet po aq sa edhe burri. Partia ju këshillon t'i zhdukni njëherë e mirë zakonet që e bëjnë gruan skllave e i ulin dinjitetin.

Kur Partia këshillon të luftohen këto zakone posh-

tëruese për gruan, ajo nuk i mëson gratë e çikat që të mos i respektojnë burrat dhe prindërit. Përkundrazi, u thotë t'i duan dhe t'i nderojnë akoma më shumë, vetëm se vajzat e djemtë e rinj, kur shohin që prindërit bëjnë ndonjë veprim jo të drejtë ndaj tyre, duhet të kenë guxim dhe të gjejnë mënyrat t'ua thonë hapur atyre mendimin që kanë. Kështu, për shembull, prindërit bënin gabim të madh që i fejonin vajzat të vogla, pesë, gjashtë ose dhjetë vjeç dhe, nganjëherë, që në djep. Ka pasur pastaj shumë të tjerë që e shitnin vajzën me para. Në asnjë mënyrë nuk duhet të shitet vajza, se ky është një zakon shumë i keq. Partia do të zemërohej shumë me ata që do të vazhdonin t'i fejonin vajzat të vogla, ose që do t'i shitnin me para.

Përse t'i japësh çikës një burrë të madh nga moshë ose në kundërshtim me dëshirën e saj dhe me ligjet e shtetit e të moralit tonë? Një gjë e tillë nuk është e mirë, i sjell dëm familjes dhe i nxin jetën vajzës. Po ndonjë mund të thotë se «kjo nuk ka sjellë ndonjë dëm në kohët tona, ne edhe atëherë kemi jetuar». Kjo nuk është e vërtetë. Populli vërtet ka jetuar, po martesë të tilla kanë sjellë gjithnjë dëme dhe, po t'i pyesësh nënat tona plaka, do të të tregojnë se ato jetonin kurdoherë të ndrydhura e me frikë në zemër. Po të mos i bindej nusja burrit ose vjehrrit, e rrihnin, i shoqi e ndante, e poshtëronte dhe kështu gruaja vuante tërë jetën. Këto zakone të egra nuk duhet të ekzistojnë më në Shqipërinë tonë të re, ato t'i djegim në zjarr.

Ne burrat nuk duhet të kemi turp se mos thonë bota: «More, si e pyeti ky vajzën për djalin me të

cilin do të martohet? Ai nuk është më burrë si gjithë burrat». Përkundrazi, Partia mendon se ky është një prind shumë i mirë. Në fillim do të ketë njerëz që do të thonë edhe ndonjë fjalë të keqe se «po priset zakoni i vjetër» etj., por shumica, të jeni të sigurt, do të thonë: «I lumtë, ky po vepron si na këshillon Partia». Dhe jeta do të tregojë se ata prindër që i martojnë vajzat me dashuri e pëlqim reciprok, do të jenë të qetë se vajzat e tyre do të bëjnë një jetë shumë të mirë.

Shqiptarët, gjithmonë, janë dalluar për vetitë e larta të burrërisë, guximit, heroizmit, ndershmërisë, që janë një thesar i madh i popullit tonë. Këto cilësi i keni pasur në shekuj dhe i keni trashëguar edhe ju malësorët, ndaj futjani në gjak brezit të ri. Partia punon që kudo, në fshatra e në qytete, rinia dhe gjithë populli të edukohen me këto virtyte të larta shqiptare, kurse zakonet e këqija duhet t'i zhdukim, se ato na dëmtojnë të gjithë.

Partia do të jetë gjithnjë në luftë me zakonet që ulin dinjitetin e gruas. Kjo nuk do të thotë që gruaja t'i hipë burrit mbi kokë, por as të ndodhë e kundërta. Në familje të dy, burri dhe gruaja, të duhen me njëri-tjetrin dhe ta kalojnë jetën si shokë. Jeta është jetë, ata mund të kenë edhe mendime jo të njëjlojta për një problem në familje, por të ngrihet tjetri dhe të rrahë gruan këtë shoqëria jonë nuk e lejon. Kur mi-dis bashkëshortëve ka mendime të kundërta, ato duhet të shtrohen dhe të sheshohen me bindje dhe me mirëkuptim. Si të mos i thotë gjë burri gruas për një punë që nuk e ka bërë mirë? Medoemos duhet t'ia

thotë, ashtu sikurse edhe gruaja ka të drejtë ta qortojë burrin, kur ky bën një gjë që dëmton familjen, fshatin, shoqërinë. Në këtë rast burri të mos zemërohet se gruaja e tij i do vetëm të mirën.

Qëndrimet përbuzëse ndaj gruas, që Partia dhe e gjithë shoqëria jonë i dënojnë, nuk kanë të bëjnë me traditat e mira të shqiptarit, me zakonet tona të vërteta kombëtare. Megjithëse feja, pushtuesit, Kanuni rrënjosën për shekuj me radhë zakonet dhe mendimet e tyre të poshtra për gratë, malësorët tanë, thellë në shpirt, i kanë dashur gratë dhe bijat e tyre. Dhe kjo është e kuptueshme, sepse me gruan e tij malësori ndante të mirat dhe hallet e jetës, gëzimet e pakta dhe hidhërimet e shumta. Gruaja ishte për të shoqja e jetës, trime e besnike në punë, në jetë dhe në luftë. Në malësi, sikurse edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë, gratë kanë luftuar sa edhe burrat, me pushkë e pa pushkë. Po të mos luftonin edhe gratë shqiptare, nuk do të ishte fituar Lufta Nacionalçlirimtare, nuk do të ishte çliruar Shqipëria. Një pjesë e tyre luftuan maleve si partizane me pushkë në dorë, por edhe të tjerat bënë një punë të madhe në prapavija, një punë po aq heroike sa edhe lufta e atyre që rrëmbyen pushkët. Mësuesit e mëdhenj të komunizmit theksojnë se në luftërat për çlirim duhet të marrë dhe merr pjesë edhe gruaja, se pa gruan nuk mund të ketë revolucion. Kjo u provua më së miri në luftën e popullit shqiptar.

Gratë dhe vajzat tona tani janë shumë më të forta e më të përgatitura, ato dinë të përdorin pushkën, bombën e mitralozin, se i ka mësuar Partia jo

vetëm të shkruajnë e të lexojnë, por edhe të luftojnë për mbrojtjen e atdheut dhe të fitoreve të socializmit.

Përparime të mëdha janë bërë në zonën tuaj gjatë këtyre viteve, por Partia mendon se duhet të punojmë edhe më shumë, sidomos për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Organizatat-bazë të Partisë dhe ju vetë mendoni më thellë si t'i zgjeroni tokat e puneshme këtu në malësi. Të gjithë duhet të vrasin mendjen për këtë çështje. Sigurisht, pastaj do të nevojiten më shumë plugje e vegla bujqësore, do të kërkohet të vijnë këtu më shumë njerëz të mësuar për bujqësinë e blegtorinë. Do të duhen patjetër edhe më shumë qe, ndaj ju vetë duhet t'i shtoni lopët për t'i siguruar këto, por edhe për të pasur më shumë qumësht. Për të gjitha këto mblidhuni e diskutoni në organizatat e Partisë dhe të Frontit, mendoni thellë, i rrihni mirë mendimet, bëni llogari një për një për çdo gjë, në mënyrë që të përcaktoni drejt se sa qe do t'i duhen këtij ose atij fshati për sasinë e tokës që ka.

Pasi t'i keni bërë mirë llogaritë, drejtojueni Partisë dhe pushtetit në rreth e në qendër, se ata kanë vendosur t'i ndihmojnë më shumë këtej e tutje fshatrat e malësisë. Po me se do t'i ndihmojnë? Së pari, me pleh kimik, që tani jemi në gjendje t'ju japim më shumë se e prodhojmë në vend. Ju e mbani mend se si në fillim fshatari, duke mos e njohur dobinë e madhe të plehut kimik, kur i jepej, e hidhte poshtë në gropa, se kishte frikë mos i prishte bimët, kurse sot të gjithë e kanë kuptuar sa i domosdoshëm është ai. Mund t'ju japim, gjithashtu, më shumë kredi për të blerë qe, lopë e bagëti të tjera, me qëllim që blegtoria

të shtohet akoma më shumë, sepse krahina juaj deri në Vermosh ka mundësi të mëdha për kullotjen e bagëtive dhe për sigurimin e bazës ushqimore të tyre. Gjithë këto livadhe janë plotësisht të mjaftueshme për bagëtitë që keni dhe për ato që do të shtoni në të ardhmen. Prandaj punoni që këto dhe livadhe të tjera që do të krijoni, t'i përmirësoni dhe t'i shfrytëzoni mirë, për të shtuar jo vetëm bagëtitë e imëta, por sidomos lopët, se edhe në këto male duhet të ketë lopë dhe nga ato që japin prodhim të madh qumështi e mishi.

Partia dhe Qeveria janë duke studiuar një plan të madh për shtimin dhe zhvillimin e lopës në të gjithë vendin, në fushë e në malësi. Përveç racave që kemi, do të përpiqemi të sjellim disa më të përshtatshme për pllajat e ftohta të bjeshkëve. Në vende të tjera të Evropës ka male edhe më të larta se tonat, por atje rriten raca lopësh që japin nga 4-5 mijë litra qumësht për kokë në vit.

Edhe një herë po e përsërit, motra dhe vëllezër: Mblidhuni në fshatra e kooperativa dhe të gjitha këto që ju thashë për tokat, për blegtorinë, për kulturat e ndryshme, i mendoni mirë, i bëni llogari me kalem në dorë, hidhni në letër çfarë duhet të bëni më tej gjatë pesëvjeçarit dhe ia drejtoni kërkesat tuaja Komitetit Qendror të Partisë që do t'i shikojë dhe ato që duhen mund t'ju ndihmojë, duke marrë masa që t'ju dërgohen. Unë ju siguroj se Partia do t'i përkrahë kërkesat e zonave të malësisë përpara të tjerave që u është dhënë ndihmë më parë. Zona juaj e thellë malore dhe pa rrugë gjer tani, ka nevojë për këtë ndihmë që po

ju vjen me ca vonesë, prandaj ne duhet ta shpejtojmë dhënien e saj.

Dua t'ju them, shoqe dhe shokë, se, përveç ndërtimit të kësaj rruge, Partia dhe pushteti po mendojnë thellë për të marrë masa që t'ju vijnë në ndihmë më shpejt edhe në disa drejtime të tjera. Kështu, do të sigurojmë dritë elektrike për të gjitha fshatrat. U është dhënë porosi organeve të Partisë e të pushtetit në Shkodër të studiojnë të gjitha ujërat e kësaj zone për të ngritur sa më parë hidrocentrale të vogla në çdo fshat, ose më të mëdha për disa fshatra të afërta së bashku, që do të japin dritë elektrike. Punët më të vështira për ndërtimin e tyre do t'i bëjë shteti, kurse punët e thjeshta dhe sigurimin e materialeve të tjera, si gurë, shtylla etj., do t'i bëni ju vetë, se mundësitë i keni.

Jeta juaj këtu do të përmirësohet edhe nga shfrytëzimi i pyjeve të pashkelura gjer tani. Ky shfrytëzim do të sigurojë punë për shumë njerëz dhe të ardhurat e familjeve të fshatarëve do të shtohen. Po edhe në fshatrat tuaja do të duhen më shumë forca pune, se do të hapen toka të reja, do të shtohen bagëtitë. Pastaj do të ketë edhe nga të rinjtë e të rejat e qytetit që do të martohen me vajzat dhe me djemtë tuaj dhe do të krijojnë familje këtu, kështu, do të rritet popullsia, jeta do të gjallërohet, do të bëhet më e pasur e më e bukur.

I gjithë ky zhvillim do të kërkojë edhe shumë njerëz të mësuar, me shkollë e me kulturë. Në fshatrat tuaja kudo ka shkolla, prandaj t'i dërgoni rregullisht djemtë e vajzat të mësojnë. Atje ku nuk ka akoma

ndërtesa shkollore të mjaftueshme, ndërtoni të reja, se edhe mundësitë tani e tutje do t'i keni më të mëdha. Kështu, fëmijët tuaj do të bëhen të ditur, gjë që ka rëndësi të madhe për përparimin e vendit, shumë prej tyre do të ndjekin shkollat e mesme e të larta; ju do të keni mësues, mjekë, agronomë vendës, të cilët, së bashku me ata që kanë ardhur e do të vijjnë nga e gjithë Shqipëria, do t'i çojnë edhe më përpara ekonominë, arsimin, kulturën.

Shihni, pra, ç'e ardhme e ndritur e pret malësinë e Veriut! Të gjitha fshatrave të Kelmendit, të Dukagjinit, të Shalës, të Shoshit, të Shllakut etj. Partia do t'ua ndërrojë faqen. Dhe kur them Partia, them ju, pse Partia jeni ju, janë djemtë dhe çikat tuaja, që janë pranuar në Parti dhe ata që duhet e do të pranohen më vonë.

Organizatata-bazë të Partisë që keni në këto fshatra, mos i quani si organizata të mbyllura, se këto nuk janë të disave. Atje duhet të jenë njerëzit tuaj më të mirë, më të ndershëm, ata që sillen mirë me popullin, që dëgjojnë zërin e masave, që nuk i zëgjumi për punën e që janë në ballë të luftës për realizimin e detyrave. Anëtarët e Partisë e kanë për detyrë t'i japin llogari popullit. Ata duhet t'ju pyesin dhe të këshillohen me ju. Për shembull, Komiteti i Partisë i Rrethit të Shkodrës i dërgon një porosi organizatës-bazë të fshatit për kryerjen e një detyre, për hapjen e një kanali, të një rezervuari, për sigurimin e bazës ushqimore për bagëtitë etj. Organizata-bazë duhet ta diskutojë, të pyesë edhe popullin, t'i thotë mendimin e vet dhe ta argumentojë atë, pastaj,

si të marrë edhe vërejtjet e tij, t'i japë përgjigje Komitetit të Partisë të Rrethit.

Në vendin tonë po bëhen gjithë këto punë të mira: janë ngritur e ngrihen fabrika, lulëzojnë arat, qytetet e fshatrat ndryshojnë pamjen e tyre, e, mbi të gjitha, ka lindur e po edukohet njeriu i ri, me mendime e virtyte socialiste. Të gjitha këto janë arritur nga populli ynë i mrekullueshëm nën udhëheqjen e Partisë, tek e cila ai ka një besim të pakufishëm, sepse e shikon se ajo po i udhëheq masat në rrugën e drejtë, ashtu sikundër i udhëhoqi në luftën për çlirim nga shtypësit e brendshëm dhe të jashtëm. Prandaj populli ynë patriot e i zgjuar e ka në zemër Partinë, i beson dhe i zbaton fjalët e mësimet e saj, të cilat gjithmonë kanë qenë për të mirën e tij. Kështu veproi ai edhe për çështjen e fesë e të zakoneve prapanike, të cilat Partia i ka luftuar që në fillim, po shkallët i ka ngjitur një nga një dhe sot puna arriti gjer aty sa vetë populli t'i prishë kishat e xhamitë dhe hoxhallarët e priftërinjtë t'i rruajnë mjekrat jo me policë dhe gjyqe, por vetë, se populli e deshi një gjë të tillë. Ai vendosi vetë për këto çështje, se e kuptoi që feja dhe klerikët e kishin gënjyer, e kishin mbajtur në errësi të gjithë jetën. Ç'thoshin ata ishin të rreme dhe kishin për qëllim t'i mbanin masat të nënshtruara nën frikën e fuqisë së zotit, që kurrë nuk e ka parë njeri dhe që është një qenie e gënjeshtërt. Ne shohim shumë herë kur bie rrufeja, po atë nuk na e dërgon në tokë as zoti, as Krishti, as Muhameti, ajo formohet nga kontakti i reve të ngarkuara me elektricitet. Mirëpo priftërinjtë e hoxhallarët i përdornin këto fenomene të

natyrës për të frikësuar popullin me «zemërimin e zotit» që njerëzit t'u bindeshin dëshirave të klerikëve e t'u jepnin këtyre pa kundërshtim të holla, bagëti, drithë, bulmet etj., sepse, gjoja, atë që nuk u bindej kishës e xhamisë perëndia do ta dënonte, atij «do t'i binte rrufeja». Priftërinjtë kërkonin që fëmijët populli t'i pagëzonte, ndryshe nuk do të venin në parajsë, i detyronin ata që martoheshin të vinin kurorë në kishë dhe të gjitha këto shërbime «të zotit» duhej të shpërbleheshin me të holla, ndryshe as martesë, as lindja, as pagëzimi, nuk «njihej» nga «perëndia».

Të gjitha këto besime, zakone e rite, feja i kishte pleksur në një Kanun të rëndë jo vetëm për gratë, por edhe për burrat. Në të kaluarën nuk ishte e lehtë të kuptohej dëmi i tyre. Partia punoi vazhdimisht për ta sqaruar popullin që ai të çlirohej e të shpëtonte nga këto besime e zakone. Pati njerëz që i kuptuan shpejt këto, disa të tjerë i kuptojnë me vonesë, ka tani, megjithëse të rrallë, që s'i kuptojnë akoma, por edhe këta do t'i kuptojnë, se janë njerëz të mirë, prandaj ne duhet të punojmë vazhdimisht me durim me ta dhe kurrë të mos i fyejmë. Kjo nënë që kam këtu pranë është me Partinë dhe më thotë se me Partinë do të jetë derisa të vdesë. Kur u prish kisha në fshat, ajo tha: «Le të bëhet, siç do rinia», megjithëse brenda shpirtit të saj nuk i zhduket lehtë besimi te feja. Mirëpo ajo është nëna jonë; ne nuk do të zihemi me të pse ajo vazhdon të besojë, por do ta ndihmojmë, do ta sqarojmë gjithnjë, do t'i themi se s'ka asnjë kuptim ta hamë vezën të kuqe, e hamë edhe të bardhë, se ajo që thotë feja është një gënjeshtër.

Hoxhallarët shkruanin nuska që s'ishin asgjë, i zienin, dhe ua jepnin njerëzve të pinin lëngun, se, gjoja, kështu i sëmuri shërohej. Ky ishte një mashtrim. Ka raste që njeriu shërohet edhe pa mjekë, sepse organizmi i tij mund të jetë i fortë dhe e mposht vetë sëmundjen. Këtë shkenca e shpjegon me veprimin e disa elementeve të gjakut të njeriut e të mikroorganizmave në trupin e tij, të cilët i luftojnë mikrobet, ashtu si ushtarët armikun në luftë. Kjo ndodh, sidomos, kur trupi është i fortë, klima e mirë, ajri i pastër, po kur i sëmuri merr mjekun, ai shërohet edhe më shpejt. Prandaj Partia këshillon të mos u besojmë fesë, priftërinjve dhe hoxhallarëve, se këta nuk thonë asgjë të vërtetë dhe se feja nuk është e mirë për popullin. Le të zhduken, pra, këto njolla të errëta nga jeta jonë dhe të ecim në rrugën që na tregon Partia.

Sikurse luftojmë fenë, po kështu duhet të zhdukim edhe disa tradita e zakone që sot nuk i pranojnë as koha dhe as jeta jonë socialiste. Të tilla janë, për shembull, zakoni i dasmës me shpenzime të shumta, i pajës së madhe, i veshjeve të rënda etj.

Ç'është, për shembull, paja? Një harxh i madh, i kotë. Po babai dhe nëna mbase duan dhe mund t'i japin diçka vajzës si dhuratë kur e martojnë. Do t'i bëjnë, ta zëmë, një fustan, një bluzë, një palë këpucë, një çantë dhe do t'i thonë: «Shko tani në familjen tënde të re». Po sikur vajza të kërkojë krevat, dollap, komodina e kolltukë, siç bëhej në të kaluarën, mund t'i thuhet që përpara se të shkojë te burri, të vejë të punojë, të fitojë vetë ca të holla që t'i bëjë ato, po veç duhet këshilluar që të mos bëjë mobilje luksoze

me njëqind pasqyra si borgjezkat, se këto nuk i do populli, që do gjëra të thjeshta.

Po dasmë do të bëjmë kur të martojmë fëmijët? Sigurisht, do të bëjmë, se martesë e vajzës ose e djalit është gëzim, por, veç, nuk duhet të thërresim gjithë ata njerëz të hanë e të pinë, se edhe këto janë harxhe të kota. Pastaj me se t'i bëjmë këto harxhe? Të futemi në borxh? Jo, njeriu i ndershëm nuk e bën një gjë të tillë. Prandaj në dasmë mund të bëjmë një darkë të thjeshtë, ku të thërresim të vijnë disa të afërm dhe ndonjë shok ose shoqe të djalit a të vajzës. Për vizitë mund të vijnë edhe plot miq, shoqe dhe shokë të tjerë, të cilëve mund t'u jepet nga një sheqerkë, mund t'u vëmë të dëgjojnë muzikë dhe t'i ftojme të kërcëjnë e të këndojnë sa të duan, se për gëzim mblidhemi. Kështu, edhe gëzimin e bëjmë, edhe ekonomia e familjes nuk prishet.

Ju në fshat mund t'i çoni familjes që bën dasmë grupet artistike të vatrës së kulturës, disa mund të marrin lahutën e çiftelinë dhe, pasi t'i qerasë i zoti i shtëpisë, njerëzit do të kërcëjnë e do të këndojnë sa të duan. Martesë është një gëzim i madh në jetë, prandaj, kur bëhet dasma, njerëzit shkojnë të gëzojnë, por jo të mblidhen me dhjetëra vota për të ngrënë e për të pirë, siç bëhej përpara dhe i zoti i shtëpisë pas dasmës mbetet në diell për tërë vitin. Zakoni i dasmave të mëdha duhet zhdukur, se na dëmton. Partia thotë që ju, kur të fejoni ose të martoni fëmijët, të bëni dasma të thjeshta, siç është i thjeshtë vetë populli ynë.

Ose të marrim një problem tjetër. Shumë bukur

më foli këtu një motër malësore për çështjen e veshjes së grave dhe të vajzave. Partia thotë se çdo veshje që është kombëtare, duhet mbajtur. Ne do t'i ruajmë traditat e mira kombëtare, pra edhe rrobat e kostumet tona tradicionale, kurse çdo veshje dhe çdo gjë tjetër që është e huaj, e lidhur me besimet fetare dhe me zakonet e vjetra, duhet flakur tej. Ne duhet të zhdukim, gjithashtu, edhe çdo veshje që nuk është ekonomike. Pra, të ruajmë atë veshje që është kombëtare, e bukur, e thjeshtë, e lehtë dhe jo e kushtueshme.

Isha para ca kohësh në Mirditë. Një shoqe më tregoi se shokët, atje, i kishin thënë ta hiqte kostumin që kishte. Ajo ishte veshur me një kostum të bardhë dhe në mes mbante një brez të kuq me xhufka që edhe mua më pëlqeu shumë. I thashë se kostumi ishte me të vërtetë i bukur, por shokët e kishin këshilluar ta hiqte ngaqë e bardha, sidomos kur punon, bëhet shpejt pis dhe njeriu duhet ta ketë në gjak edhe pastërtinë.

Pastërtia, motra dhe vëllezër, si e trupit ashtu edhe e shtëpisë, ka rëndësi të madhe për shëndetin e njeriut, por edhe për kënaqësinë e tij, se çdo gjë e pastër është edhe e bukur. Prandaj pastërtisë i vini, gjithashtu, kujdesin më të madh. Ja, mua më vjen shumë mirë që shoh këtu te ju sot gjithë këta burra dhe gra që i kanë shumë të pastra veshjet e tyre.

Në Mirditë pashë, gjithashtu, një vajzë të re, që ishte mbështjellë me një shall të zi. E pyeta kush i kishte vdekur që mbante atë shall dhe ajo më tregoi se nuk i kishte vdekur njeri, por meqë kishte hequr xhubletën, atë e kishte zëvendësuar me shall të

zi. I thashë asaj vajze se jeta jonë është e bukur, ajo ishte e re dhe s'duhej ta mbante atë shall të zi. Edhe mëmat që janë gra të shkuara dhe vishen me të zeza nuk kanë të drejtë kur thonë se rrobat e zeza u 'kujtojnë të vdekurin. Kujtimin e të vdekurve që i kemi dashur kur ishin gjallë, ne nuk e mbajmë në rroba, por në zemër. Sigurisht, nëna, kur i vdes djali, ka një hidhërim të madh në zemër, po dashurinë dhe kujtimin e djalit të vdekur nuk e shpreh rroba, prandaj edhe veshja me të zeza nuk është një zakon i mirë.

Në krahinën tuaj veshjen rregullojeni me rrobat më të përshtatshme, duke pasur parasysh, si anën ekonomike, ashtu edhe klimën. Te ju rrobat e holla, si për burra edhe për gra, nuk rekomandohen, se bën ftohtë dhe kështu dëmtoni shëndetin, i cili është gjëja më e rëndësishme për Partinë. Në Tiranë njeriu mund të rrijë edhe me një pardesy në janar, kurse në Sarandë ka njerëz që nuk e veshin edhe këtë. Ndryshe është te ju. Këtu bie borë e madhe, ndaj njerëzit duhet të veshin rroba të trasha, të leshta ose prej kadifeje; pastaj ju keni nevojë edhe për fanella, triko, çorape leshi e këpucë me shollë a me gomë të trashë. Prandaj nuk ka të drejtë ndonjë shok në qoftë se ju thotë që nuk bëjnë veshjet që keni. Veshjet tuaja janë shumë të bukura, janë kombëtare dhe, në qoftë se tani në verë ju thonë t'i hiqni, shokët kanë parasysh që ato të mos ju pengojnë gjatë punës, por kur shikon një malësor që vishet me to në ndonjë festë, njeriut i kënaqet syri.

Malësorët i shohim shpesh të mbështjellin kokën

me një shami të madhe. Edhe kjo ka historinë e saj shekullore dhe mbahet me qëllim që ta mbrojë njeriun nga të ftohtit, nga erërat. Prandaj, kush dëshiron, mund të mbajë edhe shami, ndonjë, po të dojë, le të vërë kapelë leshi që t'i zërë edhe veshët, siç janë ato të kufitarëve, kujt i pëlqen shapka, le të vërë. Të rinjtë mbase duan të mos vënë gjë në kokë, le të rrinë pa kapelë, por te ju bën shumë ftohtë, në dimër është zor të qëndrosh pa qeleshe ose pa shami mbështjellë, që janë veshjet tona kombëtare. Për veshmbathjen, pra, të kemi parasysh anën ekonomike, anën shëndetësore dhe anën kombëtare të çështjes. Ato që nuk janë kombëtare, ekonomike dhe dëmtojnë shëndetin e njerëzve të mos i pranojmë.

Partia ju këshillon t'i luftoni e t'i shkulni mbeburinat e së kaluarës nga ndërgegjja juaj, sepse ato pengojnë ecjen e shoqërisë sonë, pengojnë ndërtimin e socializmit. Sa më shpejt t'i zhdukim zakonet fetare e prapanike, aq më shumë do të lulëzojë vendi ynë dhe në mënyrë të veçantë malësia.

Punët na shkojnë mirë në çdo drejtim, por është e domosdoshme të punohet vazhdimisht dhe të bëhen përpjekje për të kuptuar drejt të gjitha ato që na thotë Partia, t'i bluajmë në kokën tonë dhe pastaj të luftojmë që t'i zbatojmë në jetë. Këto mësimë njeriu i thjeshtë dhe i ndershëm i popullit edhe kur nuk është shumë i mësuar, i kupton, sepse ato dalin nga përvoja e popullit, nga dëshirat e tij, të cilat Partia i përpunon mbi baza shkencore, i kthen në direktiva dhe pastaj ia jep përsëri atij. Por, që ato të zbatohen në mënyrë sa më të saktë, duhen kuptuar thellë. Pra-

ndaj Partia më parë të punojë për t'i shpjeguar gjërat, pastaj të kërkojë zbatimin e tyre dhe komunistët të jenë të parët që të hidhen në luftë për të vënë në jetë mësimet dhe direktivat e saj.

Ju, njerëzit e popullit, kur shikoni se një komunist nuk punon më shumë nga të tjerët, keni plotësisht të drejtë të thoni që ai nuk është një komunist i mirë. Prandaj, nëse ia doni të mirën Partisë, kur vini re se një anëtar partie shikon më shumë interesin e vet sesa të popullit, ngrijeni zërin fort dhe kërkonin që ai të korrigjohet dhe, po nuk e bëri këtë të përjashtohet nga Partia.

Partinë e kemi shumë të fortë, se në radhët e saj janë njerëzit më të mirë të popullit, po kjo nuk do të thotë që në Parti s'ka hyrë edhe ndonjë që nuk e meriton. Ndodh që ndonjë organizatë-bazë, duke mos i pasur parasysh mësimet e Partisë, pranon një ose dy veta, por me kalimin e kohës provohet se këta nuk meritojnë të jenë anëtarë partie. Në qoftë se këta vazhdojnë të qëndrojnë në radhët e Partisë, atëherë do të veprojnë në trupin e shëndoshë të Partisë, si krimbi që i futet misrit kokërr pas kokrre dhe e kalb. Ju, kur e shihni që kalliri i misrit ka ndonjë kokërr të kalbur nga krimbi, e pastroni që të shpëtoni kokrrat e shëndosha. Kështu duhet të veproini edhe me ata anëtarë partie që janë të infektuar nga shfaqje të huaja, se kështu mbrohet Partia. Në rast se një organizatë-bazë partie ka, ta zëmë, pesë a gjashtë burra dhe një grua, të cilët e konsiderojnë organizatën si diçka të mbyllur, lejojnë të veprohet në dëm të interesave të popullit dhe, në vend që të

pastrohen nga të metat e gabimet, vazhdojnë të mbrojnë njëri-tjetrin, atëherë të bëhet mbledhja e popullit, të ngrihen njerëzit e paorganizuar në Parti një nga një e të thonë pa druajtje se këta komunistë nuk po punojnë mirë dhe t'i kritikojnë. Edhe po të ngrihet ndonjë për të frikësuar ata që kritikojnë, këta të mos e mbyllin gojën, por t'i tregojnë vendin këtij njeriu që s'meriton të jetë në Parti. Po e mbylli gojën populli për të metat dhe gabimet e komunistëve, e mori lumi punën. Por kritika duhet të jetë e drejtë, e bazuar, të bëhet haptas dhe jo duke pëshpëritur me njëri-tjetrin. Të metat të thuhen drejt në sy në mbledhjen e kooperativës ose të organizatës së Frontit. Atje kushdo ka të drejtë të flasë dhe t'i kërkojë llogari çdo anëtar të Partisë ose çdo njeriu të paorganizuar në Parti që nuk e ka kryer një detyrë që i është ngarkuar. Në qoftë se ai që merr fjalën flet drejt, do ta mbrojnë të tërë çjanë në mbledhje, anëtarë partie dhe ata që nuk janë anëtarë partie, kurse njeriu që ka gabuar, do të mbetet vetëm, do t'i hiqet veshi, do të këshillohet të mos e përsëritë gabimin dhe ai duhet të bëjë përpjekje që të ndreqet. Këtë qëndrim të mbani kundrejt çdo njeriu që bën padrejtësi, qoftë ky, për shembull, edhe një inspektor i dërguar nga qyteti, i cili vjen në fshat dhe nuk kryen detyrat që i janë ngarkuar. Një njeri të tillë ta shkundni, ta porositni të vejë e të japë llogari për gabimet e veta në Parti.

Kështu duhet punuar edhe brenda në organizatën-bazë të Partisë, të luftohet që kjo të forcohet vazhdimisht, të mos mbetet gjithnjë me tri-katër veta,

po të futen në radhët e saj elementë të rinj, të shëndoshë, vajza e djem. Në Parti të pranohen njerëz që vijnë nga familjet më të vuajtura e më të varfra në të kaluarën, sepse ata e kanë në gjak luftën kundër padrejtësive, janë më revolucionarë, kanë mësuar se gjyshi dhe babai vdisnin për bukë, prandaj mendojnë të punojnë kurdoherë me ndershmëri, kurse një njeri që vjen nga një familje që ka pasur tokë e shumë bagëti dhe ka jetuar mirë, mund të jetë i mirë, po jo sa ai që vjen nga një shtresë e varfër. Natyrisht, edhe fëmijët e shtresave të mesme tani i kuptojnë çështjet më mirë nga prindërit e tyre, se i edukon Partia, po, në radhë të parë, të synojmë të njerëzit me origjinë nga shtresat e varfra. Të kihet kujdes që në organizatën-bazë të Partisë të mos lejohet formimi i tarafeve, të mos pranohen anëtarë vetëm të një familjeje ose të një fisi, se këto sjellin rrezikun që ata të mbrojnë njëri-tjetrin në gabimet dhe në të metat e tyre.

Të kemi parasysh edhe një këshillë të Partisë: të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj armiqve të jashtëm e të brendshëm. Kjo do të thotë t'i mbajmë sytë hapur natë e ditë, se armiku, po të na gjejë në gjumë, na fut thikën, po nuk do të na gjejë asnjëherë në gjumë. Malësorët e këtyre anëve gjithmonë kanë luftuar kundër armiqve, por edhe tani kemi të tillë, prandaj barutin ta mbajmë kurdoherë të thatë. Armiaqtë sot duhet të mendojnë një mijë herë para se të vendosin ta sulmojnë Shqipërinë. Po edhe sikur ta bëjnë një marrëzi të tillë, ne do t'i dërrmojmë, do t'i thyejmë e do t'i shkatërrojmë, se jemi një

popull trim e luftëtar, se kemi një Parti të fortë, jemi të armatosur e të bashkuar si një trup i vetëm rreth saj. Edhe pse armiqtë janë më të shumtë në numër, edhe pse ata mund të kenë armë më shumë, fitorja do të jetë jona. Ne jemi të fortë, sepse luftojmë për një çështje të drejtë, mbrojmë atdheun tonë, kurse ata janë të krimbur.

Në Jugosllavi tash është vendosur kapitalizmi, atje kanë ardhur në fuqi sundimtarët e rinj titistë, të cilët po e rrjepin popullin jugosllav dhe e kanë shitur tek imperialistët amerikanë e të tjerë. Titoja dhe shokët e tij kanë grindje me njëri-tjetrin dhe urrehen nga populli. Grindje të mëdha ka në mes grupeve të tradhtarëve serbë, malazezë, kroatë, sllovenë, maqedonas e të tjerë.

Vëllezërit tanë kosovarë nuk e kanë ulur kurrë kokën as në kohën e kralëve të Serbisë, as nën kërbacin e titistëve. Ata nuk e kanë humbur kombësinë shqiptare, nuk i harrojnë kurrë atdheun e tyre, Shqipërinë, gjuhën dhe zakonet e bukura shqiptare. Në dukje pandehet sikur ata nuk e luftojnë regjimin e Titos, po nuk është kështu. Serbomëdhenjtë titistë janë munduar t'i shtypin dhe t'i zhdukin vëllezërit tanë shqiptarë, t'i shkombëtarizojnë, po nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit, sepse ata janë patriotë e luftëtarë të paepur, ruajnë të gjallë në zemrat e tyre flakën e dashurisë për historinë e lavdishme e kulturën e popullit të tyre shqiptar.

Tani Jugosllavia titiste është në kaos, atje ka përçarje, ka luftë në mes grupeve tradhtarë nacionale. Por, veçanërisht me shqiptarët atyre nuk u ka ecur

as dje, as sot, prandaj, po të duan, le ta provojnë. Shqiptarët, me burra e gra, nuk i janë trembur asnjëherë kurrkujt dhe as do t'i tremben.

Partia jonë e ka edukuar popullin me një frymë të lartë revolucionare patriotike, e ka armatosur si ushtar edhe me pushkë. Kjo ngjet se te ne Parti e popull janë të lidhur si mishi me thoin. Partia i jep popullit pushkë në dorë, se ka besim të pakufishëm tek ai. Kjo nuk ndodh në vendet borgjeze e revizioniste. Mund të mendohet që Titoja t'u japë pushkë njerëzve të popullit? Kurrën e kurrës, se populli i kthen kundër atij. Ai e konsideron regjimin titist armik, kurse populli ynë Partinë e ka në zemër. Megjithëkëtë, ne duhet të mos flemë, por të jemi kurdoherë zgjuar, sidomos në kufijtë, se këtej na vjen rreziku më i madh. Dhe ne në qendër nuk flemë. Gjithë Shqipëria është zgjuar.

Një gjendje e mrekullueshme ekziston në Shqipëri dhe sado që armiq kemi boll, njerëzve tanë nuk u trembet syri.

Të rrojë në shekuj populli shqiptar!

Rrofshin malësorët tanë!

Lavdi Partisë së Punës të Shqipërisë!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**SHQIPËRIA E RE LINDI NGA REVOLUCIONI
DHE NDËRTON SOCIALIZMIN NËPËRMJET
REVOLUCIONIT**

*Nga fjala në mitingun e organizuar me rastin
e 24-vjetorit të luftës së Reçit*

3 shtator 1967

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër
të rrethit të Shkodrës, të fushës e të malësisë,
Të dashur vëllezër e motra të Reçit,

Në këtë ditë gëzimi më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të nxehta të Partisë sonë heroike e të udhëheqjes së saj dhe t'ju uroj nga zemra për festën tuaj!

Dita e sotme është një ditë e shënuar. Gëzimi i madh që ju ndieni sot dhe që flakëron në sytë e në fytyrat tuaja ka të bëjë me një ngjarje heroike që ju kujton Luftën e madhe fitimtare Nacionalçlirimtare kundër shkelësve të huaj dhe tradhtarëve të vendit, gjatë së cilës popullit tonë iu desh të derdhte shumë gjak e të bënte sakrifica të panumërta për të fituar përgjithmonë lirinë e pavarësinë kombëtare.

Populli shqiptar ka tradita të shkëlqyera patriotike. Historia e tij është e mbushur me luftëra e përpjekje të pandërprera kundër armiqve. Vetëm ata popuj që e kanë çarë rrugën me luftë, me gjak e me sakrifica, kanë një histori të tillë të madhe e të shkëlqyer. Nëpërmjet betejave nga më të përgjakshmet, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, u hap rruga e socializmit që solli gëzim në vatrat e shqiptarëve, realizoi shpresat, lartësoi guximin dhe heroizmin e njerëzve tanë, krijoi atë bashkim të pathyeshëm të popullit rreth Partisë, i cili u dha masave forca për të bërë mrekulli brenda një kohe shumë të shkurtër.

Fitoret që gëzojmë sot, të dashur vëllezër e motra, ia detyrojmë, në radhë të parë, popullit, të udhëhequr nga Partia. Populli ynë ka lindur nga pushka. Malësori 90-vjeçar nga Kelmendi, Kol Marash Pepaj (i cili njerën këmbë e ka lënë në luftën kundër krallëve të Malit të Zi), dje, në takimin që pata me malësorët e Kelmendit në Rrapsh, më tha: «Shoku Enver, shqiptarin nuk e ka qit lokja prej barkut, por huta prej çarkut».

Shqipëria e re, pra, lindi nga revolucioni, ajo sot ndërton socializmin nëpërmjet tij dhe ne do të shkojmë në komunizëm po nëpërmjet revolucionit, të cilin e ka udhëhequr dhe e udhëheq Partia jonë e lavdishme e Punës. Në fillim Partia kishte në gjirin e saj vetëm një grusht njerëzish, por me kohë u bë një forcë kolosale, sepse në zemrat e anëtarëve të saj vlonin zjarri dhe urrejtja e gjithë popullit tonë, të grumbulluara gjatë shekujve, kundër shtypësve,

pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve, bajraktarëve, bejlerëve, agallarëve, priftërinjve e klerikëve të tjerë reaksionarë, të cilët, si kurdoherë, edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u bashkuan me armiqtë, me pushtuesit italianë e gjermanë, duke menduar se do t'i mposhtnin Partinë dhe popullin tonë. Por Partia Komuniste, zemra e popullit që e lindi, ishte plotësisht e bindur se do të triumfoje mbi të gjithë armiqtë, sepse ajo shprehte dëshirat e zjarrta të popullit për liri e pavarësi dhe kishte mbështetjen e tij të plotë. Kur një popull ngrihet i tëri në luftë dhe udhëhiqet nga një parti që u qëndron besnikë interesave të tij, ai është i pamposhtur. Për këtë arsye populli e ndoqi me besnikëri Partinë, e mbrojti atë, e rriti, e kaliti në luftëra, në përpjekje, në sakrifica dhe e bëri të jetë kurdoherë e re nga zemra e nga mosha, e pjekur në mendime, ashtu siç është vetë ai, prandaj ne fituam dhe kurdoherë do të fitojmë.

Ju kujtohen, vëllezër e motra, sidomos juve, që jeni pak më të kaluar nga mosha, kohët e vështira gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ju kujtohet se si Reçi, ku jemi mbledhur sot, ishte bërë atëherë vatra e ngrohtë dhe e sigurt e partizanëve shkodranë. Burrat dhe gratë e Reçit vunë në rrezik jetën e tyre dhe u bashkuan me Partinë, me partizanët. Ata nuk patën frikë se armiku do t'i digjte, do t'u rrëmbente tokat, do t'u shfaroste bagëtitë dhe do t'i vriste, por, të bashkuar si një grusht i vetëm rreth Partisë, u qëndruan heroikisht fashistëve italianë, gjermanë e tradhtarëve të vendit dhe luftuan në këto kodra e male së bashku me partizanët heroikë të batalionit «Perlat Rexhepi»,

duke dhënë kështu një shembull të madh për gjithë rrethin, për gjithë fushën e malësitë tona kreshnike.

Prandaj, të dashur shokë punëtorë, fshatarë, të rinj e të moshuar, të tërë, si një trup i vetëm dhe me një ideal të përbashkët, nën udhëheqjen e Partisë, edhe sot e paskëtaj të jemi si kurdoherë të gatshëm, të luftojmë e të vdesim për këtë truall, për lirinë e siguruar me kaq shumë gjak e sakrifica, për mbrojtjen e fitoreve tona, për triumfin e socializmit.

Si ish-Komisar i Shtabit të Përgjithshëm dhe ish-Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në emër të Partisë, të Qeverisë dhe të Ushtrisë sonë Popullore, unë shkova sot dhe u përula me respekt të thellë përpara varreve të shokëve tanë trimë që ranë dëshmorë nëpër këta shkëmbinj, në këto fusha, kodra e male për një ideal të madh dhe që na ndriçojnë rrugën me shembullin e jetës e të luftës së vet heroike. Me veprën e tyre të pavydoshme ata i kujtojnë rinisë sonë të mos i harrojë kurrë sakrificat që ka bërë populli ynë gjatë historisë dhe, veçanërisht, në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare; të jetë, gjithmonë, vigjilente kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm; të jetë e fortë, me iniciativë, kurdoherë me hov të lartë revolucionar dhe, nën udhëheqjen e Partisë, të punojë me vetëmohim për të zburuar atdheun, për të ndërtuar Shqipërinë e re, për ta mbushur atë me fabrika e vepra të reja, për t'i bërë tokat tona edhe më pjellore, për të çarë malet e për të hapur rrugë të reja, që Shqipëria të lulëzojë, të bëhet më e fortë dhe populli ynë të rrojë i lumtur në shekuj. Ky është amaneti që na lanë

ata që ranë për këtë qëllim të madh, i cili na jep forcë e na bën të pathyeshëm. Kjo forcë dhe vija e drejtë e Partisë, e mburjtur me këtë ideal, frymëzojnë sot çdo njeri në vendin tonë, i bëjnë të fortë e të pamposhtur pleqtë, gratë e burrat, si dhe rininë tonë heroike në punë, në luftë, në revolucion. Prandaj, në një çast solemn si ky i sotmi, kur vijmë përpara varreve të shoqeve e të shokëve tanë të rënë në luftë, nuk qajmë, sepse ata për ne nuk kanë vdekur. Ata rrojnë e do të rrojnë në shekuj në zemrat e popullit, sepse kush bie për atdheun, ai ka fituar diçka të shenjtë, që nuk mund ta fitojë dot çdo njeri, të drejtën që populli të vejë përpara varrit të tij dhe të përulet me respekt të thellë.

Me rastin e kësaj feste dëshiroj të uroj të gjithë shokët e mi të vjetër, ish-partizanët e batalionit «Perlat Rexhepi», luftëtarët e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, ish-komandantët dhe ish-komisarët e lavdishëm që kanë luftuar këtu dhe në të katër anët e Shqipërisë dhe t'ju sjell atyre me këtë rast përshëndetjet më të zjarrta revolucionare të të gjithë Partisë!

Shokë e vëllezër,

Është e dyta herë që vij në Reç dhe, kur ju shoh kështu si tani, të mbledhur, të gëzuar dhe në unitet të çeliktë me Partinë, më bëhet zemra mal. Të gjithë frymëzohemi e marrim forca të reja, të pashtershme nga një gjendje e tillë.

Sa herë që vizitohet rrethin tuaj, ndiej një gëzim të papërshterë, sepse Shkodra ka qenë dhe është

një nga kalatë e çelikut të Partisë. Historia e saj, e Malësisë së Madhe, e Dukagjinit, e Shllakut, e gjithë fushës dhe e malësisë suaj, është e mbushur me ngjarje të rëndësishme heroike dhe revolucionare. Populli i rrethit tuaj gjithnjë ka luftuar për liri dhe ka krijuar. Nga gjiri juaj kanë dalë njerëz të mëdhenj, të pushkës e të penës, që me luftën e me veprat e tyre kanë frymëzuar të gjithë shqiptarët patriotë. Të tillë i bëri ata populli, të tillë i bënë nënat heroike shkodrane të qytetit, të fushës dhe të malësisë, të cilat i mëkuan qysh në djep me ndjenjat dhe virtytet më të larta. Këta njerëz të shquar, së bashku me popullin, me mënyrat e me format e tyre, sipas situatave dhe kohëve, kanë luftuar dhe kanë dhënë kontributin e vet në historinë e lavdishme të atdheut tonë.

Në mes tyre ka pasur edhe disa klerikë patriotë, njerëz të penës, që Partia e populli i nderojnë, sepse ata u kanë kënduar me zjarr e me dashuri të madhe atdheut dhe njerëzve të varfër e të vuajtur të popullit. Këta klerikë s'kanë asgjë të përbashkët me klerikët reaksionarë e tradhtarë të shitur, që mbanin nga njëqind flamurë në xhep, që nga ai i Habzburgëve dhe deri te flamuri i rrekosur i fashizmit. Këta nuk kanë të bëjnë aspak me hajnitë e gënjeshttrat e atyre që ishin vënë në shërbim të fuqive të huaja armike dhe të merimangës së madhe të Vatikanit që, si në të kaluarën, edhe sot vazhdon të organizojë komplotet në të katër anët e botës për të mbështetur robërimin imperialist të popujve. Klerikët patriotë, qofshin këta ortodoksë, katolikë ose myslimanë, kanë qenë, pra, njerëz të popullit.

Ndihem i gëzuar kur vizitoj Shkodrën, edhe pse çdo herë që vij këtu, shoh me kënaqësi përparime të reja të mëdha në qytet e në fshat. Një zhvillim të madh ka në rrethin tuaj bujqësia. Fushat, me punën tuaj dhe me përdorimin e mjeteve të mekanizuara e të plehrave kimike, po bëhen gjithnjë e më pjellore, në to sot po merren rendimente më të larta në grurë, në duhan, në oriz dhe në prodhime të tjera. Çdo vit në rrethin tuaj hapen kanale për të ujitur fushat, hapen rrugë të reja në bjeshkë e në malësi, siç është ajo e Malësisë së Madhe ku ndalova dje.

Dëshiroj t'ju them me këtë rast se ka qenë një gëzim i papërshkruar për ne kur Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria morën vendim për të hapur këtë rrugë. Ua thashë edhe shokëve malësorë dhe u kërkova ndjesë nga ana e Partisë dhe e Qeverisë për vonesën në hapjen e kësaj rruge. Malësorët tanë e kuptojnë se, në radhë të parë, në fillim ne duhej të zhvillonim e të shfrytëzonim mundësitë e mëdha që kishte fusha dhe, pastaj, pasi të fuqizoheshim ekonomikisht, t'u drejtoheshim maleve. Tani ne kemi edhe mundësitë, edhe përvojën e do të mund të zhvillojmë brenda një periudhe jo shumë të gjatë zonat e thella malore.

Ushtria jonë, rinia shkodrane dhe e gjithë Shqipërisë që po punojnë në këtë vepër, kanë bërë e po bëjnë mrekulli. Po, kur mendojmë vështirësitë e mëdha të malësorëve tanë trima, të cilët qëndronin 6-7 muaj në vit të izoluar nga bora dhe që u duhej të bënin gjithë atë rrugë deri në Shkodër, duke kaluar greminat e thella në Leqet e Hotit, atëherë themi

me bindje se përpara vullnetit, patriotizmit dhe vendosmërisë së atyre që kanë jetuar e luftuar me shekuj në këto anë, janë pak djersa që derdh dhe trimëria që po tregon rinia jonë gjatë ndërtimit të kësaj rruge shumë të vështirë. Shokëve të ushtrisë dhe të rinisë që punojnë në rrugën e Malësisë së Madhe, u thashë se dëshiroja të shkoja gjer në Vermosh, por, duke ditur se rruga do të mbarojë vitin e ardhshëm, i njoftova se nuk do të shkoja në rast se fshatrat e kësaj krahine nuk do të pajiseshin me dritë elektrike. Prandaj, i porosita shokët e Partisë dhe të ushtrisë, të mendojnë që tok me ndërtimin e rrugës të ecë edhe puna për elektrifikimin e fshatrave të kësaj krahine. Më parë një punë të tillë s'e bënim dot, po tani i kemi të gjitha mundësitë ta bëjmë.

Së bashku me dritën elektrike në malësi, e jo vetëm në Kelmend po kudo, të dërgohen edhe njerëzit më të mirë të Partisë e të pushtetit. Por atyre që do të venë në këto zona nga qyteti, nga fusha, të mos u thotë mendja se atje ka një popull që nuk punon dhe që është i prapambetur. Jo, përkundrazi, atje ata do të gjejnë një popull që i shkëlqejnë sytë, me një mençuri të mprehtë. Atje do të gjejnë njerëz me një brumë jashtëzakonisht të shëndoshë, të etur për dituri e përparim, të vendosur për të ecur përpara.

Fjalën e Partisë, si kurdoherë, malësia do ta bëjë të sajën. Malësorët tanë kreshnikë, me ndihmën e Partisë dhe të Qeverisë, do t'i kthejnë edhe bjeshkët e larta në vende pjellore. Pllajat e bukura, rrafshnal-

tat, medoemos dhe brenda një kohe të shkurtër, t'i kthejmë në toka ku të rriten drithërat, pemët frutore, bagëtitë, e sidomos lopët e racave nga më të mirat. Të punojmë që atje të zhvillohet sa më shpejt blegto-ria e, bashkë me të, industria e përpunimit të prodhimeve blegtorale, pa folur pastaj për nxjerrjen e pasurive mincrale që me siguri mbajnë këto male në gjirin e tyre.

Në të kaluarën kurrë nuk i shkonte në mendje malësorit shqiptar që në bjeshkët e largëta mund të shkonin makineri të rënda për të shpuar nëntokën e për të nxjerrë andej pasuri të dobishme për popullin, që në to të zhvillohej industria e drurit etj. Por, që të marrin hov këto degë, së pari, atje duhet të ngrihen në një shkallë akoma më të lartë se gjer tani kultura e arsimit popullor dhe atëherë malësorët e vendit tonë do të bëjnë mrekulli.

Shihni një nga këto mrekulli, çikat e malësisë! Ato dolën nga fshati i tyre shekullor, braktisën dhe thyen në mënyrë revolucionare zakonet e rënda, të vjetra dhe, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, shkuan të punojnë me vrull për të ndërtuar hekurudhën Rrogozhinë-Fier. Prindërit, në fillim, diçka i mundonte në zemër meqë vajzat do t'u largoheshin nga familja. Por, vallë mos kishin faj ata për këtë? Jo, fajin e kishin kohët në të cilat qenë rritur, zakonet e këqija të së kaluarës që i bënë prindërit të mos guxonin t'i lejonin çikat të shkonin në aksion, i pengonin ata të bënë në mendjen e tyre atë revolucion që kërkon socializmi, të zhdukim mentalitetin e gabuar të përhapur nga armiqtë e klasës dhe kle-

rikët, se «çikave në aksion do t'u humbasë nderi». Nderi është një virtyt i popullit dhe i Partisë, atë duhet ta ruajmë kurdoherë si një gjë të shenjtë të malësorët e tek i gjithë populli ynë. Nënata dhe baballarët malësorë kanë besim të madh të Partia e të çikat e tyre, dhe, duke ditur se Partia çdo gjë e bën për të mirën e popullit, i lejuan ato të shkojnë në hekurudhë, ku ato punuan me të gjitha forcat dhe u treguan vëllezërve e motrave të qytetit cilësitë e tyre të mrekullueshme.

Ditët e para vajzat malësore, natyrisht, u druajtën ca, sepse u ndodhën përpara diçkaje të re që nuk e merrnin dot me mend: panë mijëra shokë e shoqe nga qyteti dhe fshati që punonin, djersiteshin, realizonin normat, këndonin e luanin si vëllezër e motra, me ndershmëri e respekt të madh për njëri-tjetrin. Ky ambient i mrekullueshëm e i shëndoshë i rinisë sonë i bëri çikat të çelen si trëndafili në vesën e mëngjesit dhe të lulëzojnë, i bëri të shkëlqejnë nga mprehtësia e mendjes së tyre, nga sjelljet, nga ndershmëria, nga puna e palodhur. Ato mësuan nga shoqet e shokët që gjetën në aksion, por edhe të rinjtë e të rejtat e qytetit mësuan shumë prej tyre.

Shikoni, motra dhe vëllezër, ç'fitim të madh sollën këta dy muaj aksioni. Dy muaj janë një kohë shumë e shkurtër, por kanë vlerë të pallogaritshme për edukimin e rinisë sonë heroike, sepse çikat e malësisë panë atdheun e tyre, Shqipërinë që nuk është vetëm Cukali, por është një vend i gjerë, i bukur, i madh dhe i fortë.

Me vajtjen në aksion çikat malësore panë se si

populli dhe Partia kanë punuar dhe punojnë për ta ndërtuar dhe për ta zbukuruar vendin, ato panë fabrikat e kombinatet, rrugët e hekurudhat, traktorët dhe fushat e gjera të bukura e pjellore të vendit tonë të mbjella me misër, me grurë, me luledielli, me pambuk, me vreshta e me pemë, panë shkolla e vepra të tjera. Të gjitha këto ndikojnë që në mendjen dhe në ndërgjegjen e tyre të bëhet një revolucion i madh, i cili në jetën e zakonshme, në rast se do të qëndronin në shtëpitë e tyre, nuk mund të bëhej jo më për dy muaj, po as brenda tre ose katër vjetëve. Të gjithë prindërit e çikave që shkuan në aksione, kur ato u kthyen në familje, pas këtyre dy muajve pune dhe edukimi, u gëzuan shumë, se i panë që ishin bërë shumë më të mira nga sa ishin para se të shkonin, më të shkathëta e më revolucionare.

Kur vij në Shkodër, shokë dhe shoqe, ndiej një kënaqësi të madhe sidomos pse këtu ka një klasë punëtoare heroike, që ecën përpara në të gjitha drejtimet. Tani, kudo në vendin tonë, gjen me mijëra punëtorë të dalluar, heroikë, të edukuar me kujdes nga Partia, të zgjuar, të vendosur, që ecin përpara në mënyrë revolucionare. Të tillë janë edhe punëtorët e Shkodrës, të cilët, me mendjen dhe me duart e tyre, po krijojnë gjithnjë e më shumë vepra të reja.

Kur flas për këto vepra, nuk kam parasysh vetëm fabrikat, uzinat e ndërmarrjet, me të cilat tashmë është mbushur Shkodra dhe që ne i ndërtuam me punën e djersën tonë. Punëtorët shkodranë mendojnë dhe propozojnë që në fabrikat ekzistuese të ngrihen edhe reparte të tjera të reja për të përpunuar lëndën

e parë të vendit dhe mbeturina të ndryshme që nuk shfrytëzohen, deri edhe luspat e peshkut, pa përmendur pastaj prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi, për të cilat Shkodra ka një traditë të pasur. Në këtë sektor punojnë sot 600 gra shkodrane që nesër do të bëhen 1 200. Me duart e tyre të arta at Thurin shporta e kanistra të bukura, që kërkohen shumë në tregjet e jashtme.

Veprat që keni ndërtuar e do të ndërtoni, ju, shokë punëtorë të Shkodrës, duhet t'i shfrytëzoni në maksimum, t'i ruani që të mbeten kurdoherë të reja, në mënyrë që të punojnë pa pushim për të nxjerrë gjithnjë e më shumë prodhime për forcimin e pandërprerë të ekonomisë sonë popullore dhe përmirësimin e jetës së popullit. Partia ju këshillon që, në qoftë se mendoni se duhen ngritur akoma reparte e sektorë të tjerë, të na sugjeroni dhe të na propozoni të marrim masa.

Te ju punëtorët shkodranë, që jeni ndër repartet pararojë të klasës sonë punëtore, Partia ka një mbështetje të fuqishme. Ju, shokë e shoqe punëtorë të fabrikave, uzinave, të ndërtimit, të transportit e të artizanatit, duke zbatuar me besnikëri mësimet e Partisë, me punën, me mendjen dhe me vendosmërinë tuaj i jepni tonin jetës kudo që jeni, se Partia është juaja, ideologjia e saj është juaja. Përvetësojeni sa më mirë këtë ideologji dhe i tregoni popullit rrugën, udhëhiqeni atë, forconi aleancën me fshatarësinë tonë trimë dhe heroike. Klasa punëtore është klasa udhëheqëse në revolucion, por nga kjo asaj nuk duhet t'i rritet mendja, përkundrazi, të jetë e thjeshtë dhe

të mos harrojë për asnjë çast ç'rol të madh ka luajtur fshatarësia gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Me pjekurinë dhe me heroizmin e saj fshatarësia jonë e ndoqi me besim klasën punëtore, që atëherë ishte e vogël në numër, përqafoi ideologjinë revolucionare të Partisë, programin e saj dhe luftoi në mënyrë të shkëlqyer. Vija dhe udhëheqja e drejtë e Partisë, programi i saj revolucionar, aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë bënë të mundur që të shporreshin nga trualli i shenjtë i atdheut pushtuesit e huaj dhe të shkatërrroheshin klikat tradhtare të Ballit Kombëtar, të Legalitetit, qeveritë kuislinge etj. Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, e realizuar nën udhëheqjen e Partisë, do të forcohet e do të kalitet në luftë e në revolucion deri në ndërtimin e komunizmit. Prandaj klasa punëtore, si pararoja e shoqërisë sonë socialiste, të jetë kurdoherë e thjeshtë, e sakrificës dhe e heroizmave, t'i japë fshatarësisë sonë në çdo gjë shembullin, mbështetjen e saj të plotë dhe ndihmën e saj të madhe.

Është një shembull i mirë për të gjithë vendin gjesti i mjaft komunistëve dhe i punëtorëve shkodranë që lanë shtëpitë, familjet e fëmijët dhe shkuan në malësi për të punuar e për të jetuar atje një, dy e deri tre vjet së bashku me vëllezërit malësorë, për t'i ndihmuar ata me dituritë dhe përvojën e tyre, për të çuar në malësi dritën e Partisë, frymën e klasës punëtore. Sikurse ata që gjatë Luftës Nacionalçlirimtare morën pushkët dhe dolën malit ishin partizanë për çlirimin e atdheut, edhe këta bij e bija të popullit që shkojnë në bjeshkë janë partizanë të

socializmit. Të tilla qëndrime, një shpirt të tillë solidariteti e sakrifice mund ta kenë vetëm ata që janë brumosur me virtyte të larta. Prandaj virtytet e popullit e të klasës sonë punëtore t'i ruani e t'i zhvilloni më tej, shokë shkodranë, sepse kështu forcohet Partia, forcohet aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, ndërtohet socializmi dhe zhvillohet jeta e re në vendin tonë. Këto cilësi, që Partia po i ngre në një shkallë më të lartë, janë baza e përparimeve të mëdha në të gjithë sektorët që kanë bërë rrethi juaj dhe e gjithë Shqipëria dhe e ndryshimeve akoma më të mëdha që do të bëhen në të ardhmen kudo në vendin tonë.

Ecja drejt zhvillimit e përparimit është e pafund, por edhe Partia e populli ynë nuk do të vdesin kurrë, ata janë të pamposhtur. Shekuj me radhë pushtuesit e huaj kaluan njëri pas tjetrit mbi truallin shqiptar. I vogël ishte populli ynë, por armiqtë nuk e përkulën e nuk e zhdukën dot. Dhe, ja, tani shikojmë se si po përparon ai!

Miqtë e huaj që vijnë në vendin tonë flasin me admirim për sukseset e mëdha që ka arritur populli shqiptar. Por ka edhe ndonjë nga ata që flet shumë për fabrikat dhe uzinat e ndërtuara në vendin e tij. Ne e dimë se ato nuk janë në duart e popullit, po të kapitalistëve, se atje nuk bëhet asgjë për përmirësimin e jetesës së masave dhe për edukimin e tyre me virtyte të larta. Njërit prej tyre i thashë: «Shikoni, mik i dashur (dhe me të vërtetë ai është mik i vendit tonë), ne nuk e mohojmë që ju keni një industri më të zhvilluar nga ne dhe jeni më përpara

në këtë drejtim, po, në fund të fundit, ngritja e fabrikave është një punë vitesh, megjithëse edhe ne tani jemi në gjendje që një fabrikë ta ndërtojmë brenda një ose dy vjetëve, ose brenda pak vjetëve të ndërtojmë dhjetëra të tilla, po duhet ditur diçka tjetër, më e rëndësishme. Shqipëria është më përpara nga ju, bile me shekuj». Ai hapi sytë. «Po, i thashë, mos u habitni. Shqipëria është përpara me shekuj, sepse atë që ka bërë Partia jonë për formimin e njeriut të ri me ndjenja të pastra revolucionare, juve do t'ju duhen dy-tre shekuj ta bëni». Pra, në radhë të parë, Partia i ka vënë rëndësi edukimit të njeriut të ri të socializmit, me virtytet e popullit tonë të mrekullueshëm, që Shqipëria të bëhet një shembull lufte, vendosmërie, heroizmi, diturie, pjekurie e ndershmërie marksiste-leniniste.

Edukimi komunist i masave bëhet nëpërmjet revolucionit, prandaj Partia jonë po thellon pa ndërprerje revolucionin ideologjik. Një aspekt i thellimit të këtij revolucioni është edhe lufta për zhdukjen e zakoneve prapanike dhe të bestytnive fetare që na pengojnë në rrugën e ndërtimit të socializmit. Në punën për formimin e njeriut të ri me cilësitë e moralit komunist ne nisemi nga mendimi se natyra e njerëzve tanë është e mirë dhe hedhim poshtë pikëpamjet reaksionare të atyre filozofëve pesimistë që predikojnë se njeriu nga vetë natyra është i keq dhe i pandryshueshëm. Sipas tyre vetëm feja dhe zoti mund ta ndryshojnë atë dhe «pastërtinë» e plotë ai mund ta arrijë vetëm në «botën tjetër». Po t'u besosh klerikëve dhe filozofëve në shërbim të fesë, na del

sikur në tokë njerëzit më të mirë e më të kulluar janë pasanikët, bejlerët, agallarët, fajdexhinjtë, ata që tërë jetën i kanë thithur gjakun popullit. Filozofia jonë materialiste revolucionare na mëson se natyra e njeriut, e popullit, është e mirë. Këtë e vërtetojnë vetitë e njerëzve të thjeshtë të tij, të cilat ndryshojnë, përsosen e bëhen gjithnjë më të mira. Populli është kundër hajnive, kundër gënjeshtërisë, kundër atyre që janë të pandershëm. Këto karakteristika e tradita të tij të mira Partia t'i zhvillojë më tej në masat, duke filluar që nga fëmijët deri te pleqtë.

Revolucioni ynë në fushën ideologjike ka për qëllim të zhdukë konceptet e dëmshme të njerëzve që pengojnë ecjen tonë përpara.

Mendimet dhe zakonet e vjetra e kanë bazën te besimet e kota fetare. Krahas zhvillimit të njerëzimit, klasat sunduese, nëpërmjet metodave më të stërholluara e me poshtërsi të panumërta, i inkurajuan e i zhvilluan këto besime për t'u hedhur njerëzve thonjtë në grykë.

Shekuj me radhë klasat sunduese i kanë shpjeguar fenomenet e natyrës me vullnetin e zotit, për t'i tmerruar e për t'i ndrydhur njerëzit, për t'i shfrytëzuar kështu më lehtë. Por Partia nuk mund të lejonte më një gjendje të tillë në vendin tonë. Ajo është një parti që bazohet në parimet filozofike materialiste, në marksizëm-leninizmin, që, si ideologji e partisë së klasës punëtore, është në kundërshtim me idealizmin, është, pra, kundër përfytyrimeve të gënjeshtërtë. Partia, ashtu si dhe populli, nuk mund t'i besojë gënjeshtërat që predikojnë kisha dhe xhamia, prandaj ajo ka

luftuar vazhdimisht kundër besimeve të kota. Por në këtë luftë, sikurse e dini të gjithë, Partia ka ecur me kujdes, ka punuar për t'i sqaruar e për t'i bindur vazhdimisht masat punonjëse, për dëmet e për rreziqet që sjellin besimet fetare, e ka mësuar popullin të ruhet nga këto të këqija, sepse ai është gjëja më e shtrenjtë për Partinë.

Komunistët, gratë, rinia, intelektualët tanë, nën udhëheqjen e Partisë, punuan vazhdimisht për të pas-truar ndërgjegjen e njerëzve nga mbeturinat e ideologjisë reaksionare fetare, duke krijuar premiset që flaka e luftës kundër fesë të përhapej në të katër anët e vendit. Shpërtheu kështu në Shqipëri një revolucion i tërë ideologjik, sasia u shndërrua në cilësi, u bë një hop i madh përpara, populli u ngrit në këmbë dhe i prishi vetë xhamitë e kishat, i hodhi poshtë nuskat e ikonat, u bëri thirrje hoxhallarëve e priftërinjve të mos rronin më si parazitë, po të shkonin e të punonin si të gjithë për të fituar bukën me djersën e ballit. E gjithë kjo punë u bë nga vetë populli. Asnjë dekret nuk nxorën Partia dhe shteti për këtë çështje. Kjo ishte e natyrshme, sepse, si rezultat i punës së madhe të vazhdueshme që bëri Partia për t'i edukuar masat me idetë e filozofisë materialiste, ato u bindën për kotësinë e këtyre besimeve. Masat kuptuan qartë se në të kaluarën feja ishte në shërbim të të gjithë shtypësve e shfrytëzuesve, kurse tani që mbi shpinën e tyre nuk ka më kapitalistë, bejlerë, agallarë e as kishë dhe xhami, tani që ndërgjëgjja e tyre po pastrohet vazhdimisht, ato punojnë të lumtura, zbukurojnë vendin, ngrenë fabrika e uzina, rritin prodhimet bujqësore...

Sot në Shqipëri nuk ka fshat pa shkollë fillore, arsimit tetëvjeçar është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët nën 16 vjeç, në vendin tonë ka me dhjetëra shkolla të mesme, ka universitetet dhe institutet e larta. Me dhjetëra mijë vajza dhe djem të popullit kanë mbaruar shkollat e profileve të ndryshme dhe po punojnë me zell nëpër fabrika e uzina, në ndërtim, në arsim e në shëndetësi, nëpër kooperativa bujqësore. Në këtë mënyrë, pra, populli ndërton me mendjen dhe me duart e veta jetën e tij të lumtur, socializmin, forcon besimin në vetvete dhe kupton sa i kotë ishte besimi ndaj zotit, sa e dëmshme ishte përralla se njeriut çdo e mirë i vjen nga perëndia, me të cilat feja donte ta linte popullin tonë tërë jetën në errësirë, në varfëri e në mjerim.

Shpifje të panumërta kanë bërë për komunistët e për Partinë klerikët reaksionarë. Ata thoshin se komunistët janë të poshtër, se martohen deri dhe me motrat e tyre, prishin familjet, shkatërrojnë e djegin çdo gjë etj., etj. Por populli i njohu komunistët në jetë, pa se si luftuan ata heroikisht në mbrojtje të interesave të lartë të tij për çlirimin e atdheut nga robëria, ç'dashuri të madhe e ç'moral të lartë kishin ata në marrëdhëniet me popullin e tyre e me njëritjetrin. Dhe s'kishte se si të ndodhte ndryshe, sepse, në fund të fundit, cilët ishin këta komunistë? Këta ishin dhe janë djemtë e vajzat e popullit, bijtë e tij më të mirë, që luftuan dhe sakrifkuan jetën në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare për çlirimin e atdheut, që shkatërruan nga themelet pushtetin e vjetër feudo-borgjez, sollën popullin në fuqi e udhëhoqën ma-

sat në punën për forcimin dhe për lulëzimin e vendit, për ta bërë jetën e popullit, ashtu siç po e bëjnë, çdo vit e më të begatshme. Komunistët punuan, gjithashtu, jo për prishjen, po për forcimin e familjes, jo për përçarjen, por për vëllazërimin dhe unitetin e popullit shqiptar rreth Partisë. Masat punojëse panë qartë, nga njëra anë, cilët ishin komunistët, ç'ishte Partia, që i hapi sytë popullit dhe, nga ana tjetër, ç'ishte feja. Prandaj flakën tej me neveri njëherë e përgjithmonë barrën e mashtrimit e të gënjeshtërs që u kishte hedhur mbi shpinë feja gjatë shekujve.

A ka akoma te ne njerëz që besojnë? Natyrisht, ka. Për këtë duhet të jemi realistë. Po njerëzit që ruajnë akoma njëfarë ndjenje besimi, mos vallë janë të këqij? Në asnjë mënyrë s'mund ta themi këtë, pse ata janë vëllezërit, motrat, nënat dhe baballarët tanë, që luftojnë e punojnë me ne, që e duan me shpirt Partinë, por që akoma nuk i kanë kuptuar kotësinë dhe rrezikshmërinë e besimeve fetare. Prandaj Partia na mëson që edhe në të ardhmen të punojmë vazhdimisht për t'i sqaruar ata me urtësi, kurdoherë në rrugën e bindjes, pse kështu do të zhduken me siguri mbeturinat fetare nga ndërgjegjja e tyre dhe kjo do të ndikojë edhe në përmirësimin e mënyrës së jetesës.

Klerikët gjatë gjithë kohës janë përpjekur që çdo fenomen të jetës së njeriut, çdo ndjenjë të tij ta pleksin me fenë. «Pashë një ëndërr të tillë», thotë dikush dhe pret që t'i ngjasë diçka e keqe. Por shkenca na mëson se ëndrrat nuk shpjegohen, siç predikojnë prifti ose hoxha, që thonë se po t'u shfaq në gjumë, për shembull, xhaxhai i vdekur tridhjetë vjet përpara me

një shkop, do të të ngjasë një fatkeqësi dhe, për ta larguar atë, kërkohet që hoxha ose prifti t'i këndojnë diçka të vdekurit, por që lutja të bëjë efekt u duhet dhënë atyre një sasi parash ose sende të tjera dhuratë. Prandaj të gjitha besimet e kota e zakonet e vjetra të lidhura me fenë, t'i zhdukim pa ngurrim dhe t'i zëvendësojmë me zakone të reja, të dobishme, socialiste, populllore. Kjo nuk është ndonjë gjë e rëndë, vetëm kërkohet të mendojmë si të veprojmë për t'i rrënjosur zakonet e reja në mënyrën tonë të jetesës.

Shkodra ka qenë dikur kështjella e katolicizmit në Shqipëri. Por pikërisht në Shkodër disa muaj më parë, me iniciativën e popullit, u prishën katedralet, meshat, pagëzimet. Dhe ai tani është më i gëzuar, më i zjarrtë, më revolucionar, më i vendosur dhe më i afërt se kurrë me Partinë.

Dihet se lufta kundër fesë nuk ka filluar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ajo i ka rrënjët në traditat dhe në përpjekjet e popullit shqiptar për liri e pavarësi. Klerikët reaksionarë qofshin këta myslimanë, ortodoksë ose katolikë, gjatë gjithë historisë kanë qenë kundër luftës që bënte populli ynë për të fituar lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Klerikët ortodoksë (me përjashtim të priftërinjve patriotë që ne i nderojmë dhe i respektojmë, se kanë luftuar për gjuhën shqipe dhe për këtë arsye reaksioni e kisha greke i kanë djegur si qiri), kanë qenë mbështetja e Fanarit¹ dhe e megali-

¹ Nga emri i lagjes së Stambollit, Fener, ku qëndronte patriku grek. Këtu ka kuptimin e Patrikanës së kishës ortodokse greke.

idhesë greke që janë përpjekur për pushtimin e Shqipërisë së Jugut, prandaj veprimet e tyre ishin gjithnjë në kundërshtim me dëshirat dhe aspiratat patriotike të popullit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për klerikët reaksionarë myslimanë, të cilët punonin si agjentë të pushtuesve turq në Shqipëri dhe u bënë një mbështetje e fuqishme e tyre, prandaj ishin kurdoherë kundër popullit që luftonte për liri e pavarësi. Edhe klerikët katolikë, nga ana e tyre (me përjashtim të priftërinjve patriotë), siç e kanë provuar ngjarjet historike, kanë qenë agjentë të Austro-Hungarisë, të borgjezisë dhe të fashizmit italian.

Pra, feja dhe institucionet e saj, të sjella nga të huajt në vendin tonë për të forcuar këtu pozitën e pushtuesve, kanë qenë kurdoherë në kundërshtim me ndjenjat patriotike të popullit. Prandaj edhe lufta kundër tyre në Shqipëri zë fill që në të kaluarën e largët. Kështu, lufta që shpërtheu tani kundër fesë, nën udhëheqjen e Partisë sonë marksiste-leniniste, ishte rrjedhim i natyrshëm i asaj lufte që ka bërë populli ynë gjatë gjithë kohës për liri e pavarësi.

Partia na mëson që, përveç fesë, të luftojmë edhe disa zakone të dëmshme që na kanë mbetur nga e kaluara, si ai i pajës, i dasmave të mëdha, i zisë etj., që shkatërrojnë ekonominë e familjes.

Në raste vdekjeje, për shembull, në vendin tonë janë praktikuar zakone jo të mira, të imponuara nga Kanuni. Kështu, kur i vdiste dikujt një njeri i familjes, përveç hidhërimit, atij i shkatërrohej ekonomia, sepse, për të ushqyer gjithë ata që i vinin dhe i rrinin me ditë, zakoni e detyronte të therte edhe kaun e

vetëm. Po mund të lejojmë ne të bëhen tani gjëra të tilla? Natyrisht, kur ndodh një vdekje në familje, vijnë miq e shokë për ngushëllim. Në këtë rast atyre u jepet një cigare e një filxhan kafe. Zakone të tilla, të thjeshta, janë zakonet më të mira e më të ndershme.

Duke luftuar besimet e kota fetare, si dhe zakonet e rënda të trashëguara nga e kaluara, Partia kërkon që mënyra e jetesës e masave punonjëse të jetë e re, e përparuar, socialiste, ashtu siç e kërkojnë shoqëria dhe ecja jonë përpara. Po për këtë qëllim ne sot ngremë problemin e ndryshimit të veshjes, sidomos në malësi. Me këtë nuk duhet të kuptojmë heqjen e të gjitha llojeve të kostumeve që kanë përdorur e përdorin malësorët e malësoret tona, por të atyre që nuk përbëjnë traditën e vërtetë shqiptare, që mbajnë vullën e pushtuesve dhe të fesë, kurse kostumet tona karakteristike kombëtare t'i ruajmë, sepse i kemi të mrekullueshme. Por këto kostume të bukura, që u kanë hije malësorëve tanë, s'i mban dot veshur çdo ditë, sepse kushtojnë shtrenjtë dhe janë të rënda e të pengojnë gjatë punës. Ato t'i ruajmë, t'i vëmë mënjanë dhe t'i përdorim vetëm në raste festash, si veshje karakteristike, kurse në jetën e përditshme, gjatë punës, duhen mbajtur rroba të thjeshta e të lira. Këtë e kupton kushdo nga ne. Kur kooperativisti vete për të hapur toka të reja, kur rend pas traktorit, kur korr, shin ose ujit arën, kur shpie lopët ose delct në kullotë etj., tirqet e pengojnë, prandaj ai që i ka këto, më mirë t'i ruajë në dollap dhe, gjatë punës, të mbajë rroba të tjera, më të lehta e më të lira.

Njerëzit tanë, duke i zëvendësuar gjatë punës dhe jetës së tyre të përditshme veshjet e mira kombëtare me veshje të lehta dhe të lira, të kenë parasysh që këto të fundit të mos jenë ekstravagante dhe nga ato që përdorin në vendet kapitaliste e revizioniste. Veshja të jetë sipas shijeve tona dhe në përputhje me kushtet e punës e të jetës. Gratë e malësisë, për shembull, nuk kanë pse të veshin këpucë me taka të holla si perona, sepse me to nuk ngjitesh dot në rrugët malore plot gurë. Përkundrazi, këpucët të jenë të thjeshta e të bukura dhe nga ato që mbajnë ngrohtë, sepse në malësi në dimër bën ftohtë.

Për të gjitha këto çështje Partia dhe populli kanë reflektuar thellë, prandaj tani po lindin e do të zhvillohen çdo ditë e më mirë zakone të reja dhe me frymë revolucionare. Po të mos vepronte drejt Partia në këto çështje, mësimet e saj nuk do të zinin vend. Por kjo kurrë nuk ndodh te ne, sepse ato që bën Partia përputhen plotësisht me interesat e të gjithë punonjëseve.

Populli ynë, duke ndjekur me besnikëri mësimet e Partisë për këto çështje kaq të rëndësishme, që kanë të bëjnë me botëkuptimin e njeriut, shkon me guxim përpara. Hovi i madh revolucionar që ka shpërthyer kohët e fundit në vendin tonë, vërteton edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë, kalit njerëzit, sidomos rininë, çon përpara socializmin, zhvillimin ekonomik, kulturor e shoqëror të vendit.

Shokë, vëllezër e motra,

Te ne i madh e i vogël, sipas mësimëve të Par-

tisë, e cila porosit që politika të vihet kurdoherë në radhë të parë, interesohen shumë për situatën politike brenda dhe jashtë vendit. Ju të gjithë, si njerëz politikë, jeni njohur tashmë me përparimet që po bëhen në vendin tonë në të gjitha fushat. Ne jemi të gëzuar që sivjet kemi një vit të mbarë bujqësor, një vit suksesesh edhe në industri, në arsim, në kulturë etj. Të gjitha këto u arritën në sajë të vijës së drejtë të Partisë, të unitetit të popullit rreth saj, të hovit revolucionar të masave. Si rrjedhim i gjithë këtyre sukseseve, në vendin tonë ne kemi krijuar tani një bazë të shëndoshë ekonomike, e cila na jep mundësi që në vitet e ardhshme të ecim akoma më përpara.

Në rrethin tuaj po ndërtohet hidrocentrali i madh i Vaut të Dejës. Punëtorët kanë marrë zotim ta përfundojnë atë një vit përpara afatit. Arritja e këtij objekti do të na japë mundësi të fillojmë një vit më përpara ndërtimin e një hidrocentrali të ri. Nga ana tjetër, përfundimi më shpejt i këtij hidrocentrali ka rëndësi të madhe ekonomike, sepse energjia elektrike ushqen ekonominë tonë, ashtu si gjaku që ushqen organizmin e njeriut. Prodhimin më parë i një sasie kaq të madhe energjie elektrike do të krijojë mundësi të ngrihen miniera e uzina të reja, të marrin dritë me qindra fshatra, të mekanizohen punimet në kooperativat bujqësore etj. Për shembull, sharrat, pompat etj., që te ju sot vihen në lëvizje me dorë, nesër do të punojnë me energji elektrike dhe kështu do të lehtësohet puna e njeriut. Ja, pra, ç'të mira sjell energjia elektrike. Dhe të tilla vepra të mëdha i bëjnë mendja

dhe forca e popullit, e punëtorëve, e kuadrove, e të rinjve dhe e të rejave tona.

E ardhmja që na pret, shoqe dhe shokë, është akoma më e bukur dhe më e ndritur. Prandaj le të punojmë pa u lodhur e të luftojmë për këtë të ardhme. Natyrisht, brezit tonë i bie barra të bëjë edhe sakrificat që brezi i ardhshëm i Shqipërisë të jetojë i lumtur. Ne besojmë se ata që do të vijnë pas nesh, do të na kujtojnë gjithnjë për të mirë, po nuk përjashtohet që brezi i ri të na kritikojë ndonjëherë për ndonjë punë që nuk e kemi bërë si duhet. Megjithatë jemi të bindur që ai do të thotë për ne se prindërit nuk kanë punuar keq. Puna jonë do të jetë frymëzim për të, kështu, sa më shumë e sa më mirë të punojmë sot, aq më e bukur do të bëhet jeta e popullit tonë në të ardhmen. Prandaj fshatarësia jonë kooperativiste le të hidhet e gjitha në sulm përpara për realizimin e planit të shtetit, në mënyrë që tokat të punohen shpejt, të ujiten kur duhet, të luftohen sëmundjet dhe prodhimet të korren, të vilen e të grumbullohen pa firo. Ju, shokë punëtorë të industrisë, të ndërtimit, të artizanatit etj., shfrytëzoni si duhet çdo gjë, realizoni kurdoherë planin në sasi e në cilësi, luftoni të ulet kostoja, se në këtë mënyrë jeta e popullit do të përmirësohet. Duke punuar si duhet dhe me të gjitha forcat, ne do ta bëjmë Shqipërinë gjithnjë e më të begatshme, më të bukur e më të fortë, që armiqtë të mos guxojnë ta prekin. Armiq kemi boll, por forca e popullit të lidhur ngushtë me Partinë i bën ata të mendohen mirë, se, po të lëvizin, i gjen gjëma.

Vendi ynë është i vogël, por zë një pozitë të rë-

ndësishme dhe luan një rol të madh në arenën ndër-kombëtare. Ai ka fituar respektin dhe dashurinë e gjithë popujve, prandaj armiqtë ia kanë frikën. Kushdo që mendon të godasë një popull, i cili është i vendosur të luftojë gjer në fund dhe të vdesë për të drejtat e veta, sado i vogël që të jetë, duhet të mendojë një mijë herë, sepse hesapet nuk do t'i dalin.

Shqipëria socialiste, e udhëhequr nga Partia e Punës, lufton kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik, si dhe kundër të gjithë reaksionarëve në botë. Flamuri i saj qëndron e do të qëndrojë gjithnjë lart, prandaj edhe nderimi e respekti për të përriten përherë e më shumë. Fitoret e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe forcimi i pozitës së saj ndër-kombëtare e kanë burimin te vija e drejtë marksist-leniniste e Partisë sonë, te politika e saj e jashtme e drejtë. Ne, si marksistë-leninistë, demaskuam Hrushovin dhe tradhtarët e tjerë sovjetikë, që shkelën veprën e lavdishme të Leninit dhe të Stalinit. Me qëndrimin tonë burrëror marksist-leninist u treguam popujve të të gjithë botës se në Bashkimin Sovjetik po rivendoset kapitalizmi dhe krerët e këtij vendi janë lidhur me imperializmin amerikan për të shtypur popujt dhe revolucionin. Prandaj u themi popujve sovjetikë të ngrihen pa frikë kundër këtyre tradhtarëve. Pa u kryer një revolucion tjetër nuk mund të ndreqet gjendja e krijuar nga revizionistët në Bashkimin Sovjetik.

Analizat dhe kritikët e Partisë sonë ndaj revizionistëve jugosllavë, sovjetikë e të tjerëve dolën të drejta. Ju e dini mirë ç'vijë ka ndjekur Partia ndaj tradhtarëve titistë, të cilët e kanë shndërruar prej kohësh

Jugosllavinë në një vend krejt kapitalist, të shitur kokë e këmbë tek amerikanët, anglezët, francezët, te borgjezia ndërkombëtare. Sipas ligjeve të votuara muajt e fundit në Skupshtinën jugosllave, kapitalistët e huaj lejohen të investojnë sa të duan kapitale në ekonominë e këtij vendi duke ruajtur të drejtën të zotërojnë deri në 49 për qind të aksioneve, të marrin pjesë në drejtimin e ndërmarrjeve jugosllave, dhe 80 për qind të të ardhurave t'i futin në xhepat e tyre, ndërsa 20 për qind t'i investojnë përsëri ku të duan dhe qeveria jugosllave të mos ketë të drejtën të ndërhyjë në dallaveret e tyre. Ja, pra, ç'bëhet atje! Tërë pasuria e popullit jugosllav tashmë është futur në duart e kapitalistëve të huaj dhe të kapitalistëve të rinj jugosllavë, tradhtarëve titistë. Një gjendje e tillë ka ngjallur në Jugosllavi kontradikta të mëdha në mes grupeve kapitaliste serbe, kroate, sllovene, boshnjake, maqedonase e kosovare.

Por kosovarët, vëllezërit tanë nga gjaku, nga shpirti e nga traditat, nuk po e pranojnë shtypjen titiste jugosllave. Jo! Ata lëvizin dhe qëndrojnë si kurdoherë kreshnikë. Populli kosovar, ndërsa urren klikën tradhtarë të Titos, ushqen një dashuri të madhe për atdheun e tij, për gjuhën dhe zakonet e veta, për vatrat dhe tokën e tij, për një jetë më të mirë, prandaj nuk mund të pajtohet në asnjë mënyrë me shtypjen titiste.

Në Jugosllavi, pra, ekzistojnë kontradikta të mëdha. Kapitalistët e vendeve të ndryshme, që janë të lidhur me krerët titistë, kërkojnë kush e kush të zërë pozita sunduese në ekonominë jugosllave, ku veprojnë

ligjet e kapitalizmit, prandaj titistët janë të detyruar të mbyllin fabrikat dhe t'i hedhin punëtorët në rrugë. Punëtorët e thjeshtë dhe specialistët jugosllavë braktisin fabrikat e tyre dhe emigrojnë, shkojnë për të punuar në Gjermaninë Perëndimore e gjetkë. Në fshatin jugosllav sundojnë, si dhe më parë, kulakët, tokat shiten e blihen lirisht prej tyre. Të gjitha këto vërtetojnë pikëpamjen dhe vijën e drejtë të Partisë sonë ndaj titistëve.

Një qëndrim të tillë të drejtë, të vërtetuar, gjithashtu, nga jeta ka mbajtur Partia jonë edhe ndaj revizionistëve sovjetikë, të cilët bënë çmos të na gju-njëzonin, por nuk ia arritën dot qëllimit, sepse Shqipëria qëndroi e do të qëndrojë kurdoherë fort në rrugën marksiste-leniniste. Me gjithë përpjekjet e shumta që bënë, ata nuk mundën të na thyenin dot ekonomikisht, as të na dëmtonin politikisht e ideologjikisht, përkundrazi ne çamë me sukses bllokadën e tyre dhe po ecim përpara të papërkulur e me vendosmëri në rrugën marksiste-leniniste.

Ju e dini që në Vietnam po zhvillohet një luftë e madhe popullore, që është bërë për imperializmin amerikan një det i zjarrtë, nga i cili kërkon të dalë e s'del dot. Ai do të dalë andej medoemos, në mos sot, nesër, jo fitimtar, por i mundur, i thyer. Amerikanët po bëjnë tani shantazhe të mëdha, zgjerojnë luftën në Vietnamin e Jugut, bombardojnë Vietnamin e Veriut, por populli heroik vietnamez është i pamposhtur.

Kudo, në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine, zien revolucioni. Kjo tregon se pozitat e imperializmit amerikan dhe të reaksionit botëror janë të tronditura

nga themeli. Imperializmi amerikan dhe revizionistët sovjetikë janë duke kaluar kohë të vështira, për arsye se revolucioni është në ngritje, popujt janë zgjuar dhe po i godasin me armë, me luftë të organizuar, me greva e me demonstrata nga të katër anët.

Kudo po demaskohen partitë e vjetra revizioniste dhe po formohen parti të reja marksiste-leniniste. Revolucionarët po gjejnë rrugën e vërtetë, rrugën e luftës së armatosur, prandaj organizojnë çeta dhe godasin ushtritë e jankive e të shërbëtorëve të tyre. Kjo gjendje tregon dobësinë e imperializmit amerikan, të revizionistëve sovjetikë e të armiqve të tjerë që nuk mundin dot me gënjeshttra të mashtrojnë popujt dhe revolucionarët. Një gjë e tillë sot nuk mund të ndodhë.

Të gjitha këto tregojnë se revolucioni është në marshim, ecën përpara, kurse imperializmi dobësohet. Për këto arsye imperializmi amerikan bën luftëra, me anë të të cilave shpreson të shtypë revolucionet, krijon e mbështet diktatura fashiste, kërcënon dhe i bën shantazhe Bashkimit Sovjetik që të lidhet edhe më ngushtë pas qerres së tij dhe në fakt klika tradhtare sovjetike fatet e Bashkimit Sovjetik po i lidh me imperializmin amerikan, po vihet gjithnjë e më shumë në shërbim të tij.

Në radhët e revizionistëve ngjau ajo që parashikonte Partia jonë, që revizionizmi, si ideologji e borgjezisë, do të krijojë patjetër në vendet ish-socialiste të Evropës një përçarje të madhe, e cila do të sjellë, siç po sjell, shkëputjen e këtyre vendeve nga reviz-

zionistët sovjetikë dhe lidhjen e tyre me imperialistët amerikanë dhe me imperialistët e vendeve të tjera të botës. Dhe në fakt kapitalet amerikane, franceze dhe angleze po vërshojnë në Rumani, në Bullgari, në Çekosllovakia etj. dhe po zënë pozita, ashtu siç ka ndodhur që më parë në Jugosllavi. Kjo do të sjellë skllavërimin e këtyre vendeve nga imperializmi dhe, si pasojë, zemërimin e ligjshëm dhe ngritjen e popujve të tyre, luftën e tyre revolucionare për të përmbysur armiqtë dhe tradhtarët revizionistë.

Në këtë gjendje revolucionare Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste qëndrojnë në pararojë të patrembura, me flamurin e revolucionit, të marksizëm-leninizmit.

Shokë dhe vëllezër,

Rruga e Partisë sonë është e drejtë. Ajo është rruga e popullit dhe ndriçohet nga marksizëm-leninizmi. Prandaj ta studiojmë marksizëm-leninizmin, ta kuptojmë atë, ta lidhim me jetën dhe të kemi kurdoherë iniciativë në punë. Marksizëm-leninizmi kërkon mendje të qartë, zemër të zjarrtë, duar të pastra. Kështu, nëpërmjet punës revolucionare, nëpërmjet kritikës dhe autokritikës së drejtë, pa shpifje, pa zemërime, drejtojmë kundër kujtdo kur gabon, që të luftohen të gjitha të këqijat. Kush dëshiron të mos e kritikojë populli, le të punojë mirë. Kush punon mirë, populli nuk e kritikon, atë që punon keq, populli ta vërë në vend.

Qëllimi i kritikës sonë të drejtë e revolucionare,

siç dihet, është që çdo gjë e keqe dhe e gabuar të ndreqet dhe karakteri i njeriut që ka gabuar të përmirësohet. Ne nuk jemi ndjekës të Shopenhauerit që thotë se natyra e njeriut është e keqe dhe s'ndryshohet, ne jemi ndjekës të Marksit. Të dy këta filozofë kanë qenë nga i njëjti vend, nga Gjermania, por mendimet e tyre kanë qenë diametralisht të kundërta.

Detyra jonë, shokë dhe vëllezër, është që të ngrihemi të tërë në këmbë për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, ideologjinë tonë kurdoherë fitimtare, për të mbrojtur Partinë, që ta kemi gjithnjë të pastër, luftëtare dhe trime. Por që Partia të jetë gjithnjë e tillë, duhet që brenda saj të vlojnë kritika dhe auto-kritika, mendimet të jenë të pastra e të qarta. Kështu, revolucioni ynë do të ecë gjithnjë përpara, puna ndërtimtare do të zhvillohet me sukses, Shqipëria do të lulëzojë, populli çdo vit do të shohë ditë edhe më të bukura. Kjo është rruga që ndjekim ne. Prandaj të luftojmë vazhdimisht që të realizojmë detyrat që na ngarkohen.

Të ecim kurdoherë përpara vëllezër e motra, me Partinë në zemër dhe me flamurin e saj lart!

Të rrojë populli i Shkodrës!

Të rrojë rinia heroike, e ardhmja jonë!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**MENÇURIA, ZOTËSIA, DITURIA DHE PUNA JUAJ
DO TË SHNDRROHEN NË DRITË QË DO TË
ZBUKUROJË JETËN E NJERËZVE TANË**

*Nga biseda me punëtorët e kantierit të ndërtimit
të hidrocentralit të Vaut të Dejës*

4 shtator 1967

Gjatë vizitës në këtë kantier, pasi u informua nga drejtuesit dhe teknikët e veprës për gjendjen e punimeve, shoku Enver u ndal para qindra punëtorëve të grumbulluar spontanisht në sheshin e kantierit dhe zhvilloi me ta një bisedë të përzemërt:

Vepra që po ndërtoni ju, shokë punëtorë, ka rëndësi shumë të madhe ekonomike dhe politike. Për të ndërtuar një hidrocentral të tillë duhen pjekuri e zotësi e madhe teknike, vendosmëri dhe heroizëm. Klasa jonë punëtoare i ka këto cilësi që kërkohen në një ndërmarrje të tillë të madhe, prandaj do t'ia dalë mbanë me sukses.

Hidrocentralet janë monumente të zhvillimit të vrullshëm ekonomik e kulturor të një vendi, sepse ja-

pin energji të bollshme elektrike dhe, sikurse ka thënë Lenini,

«Komunizmi është pushteti sovjetik plus elektrifikimi i të gjithë vendit...»¹.

Prandaj, veprat si kjo që po ndërtoni këtu, kanë rëndësi shumë të madhe.

Mençuria, zotësia, dituria dhe puna juaj do të shndërrohen në dritë që do të zbukurojë jetën e njerëzve tanë në të gjithë Shqipërinë, do të bëjë të mundur të shfrytëzohen pasuri të reja të mëdha që do të shërbejnë për rritjen e mirëqenies së popullit. Me anën e energjisë elektrike që do të prodhojë edhe ky hidrocentral, do të zhvillohen më tej industria, minierat, bujqësia, kultura dhe arsimit në vendin tonë.

Puna që po bëni këtu do t'ua forcojë më shumë vullnetin. Ju që keni ardhur të derdhni djersë në këtë vepër të madhe, jeni nga punëtorët pararojë të socializmit. Cilido prej jush do t'u flasë në të ardhmen brezave të rinj të Shqipërisë për këto shtylla të çelikut që po ngulni në lumë, pikërisht për ta bërë të lumtur jetën e tyre. Me punën tuaj ju kontribuoni, gjithashtu, në luftën tonë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Komplotet e tyre kundër vendit tonë do t'i shkatërrojmë me siguri, se kemi një forcë të pamposhtur, kemi marksizëm-leninizmin dhe së bashku me ne luftojnë të gjithë popujt lirisht të botës.

Kapitalistët mburren me industrinë, me hidrocent-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 480.

tralet e pallatet e tyre, që nuk i kanë bërë vetë. Ato ua kanë ndërtuar punëtorët dhe ne jemi të bindur se do të vijë koha që këta punëtorë t'ua rrëmbejnë. Imperialistët dhe kapitalistët mburren me qytetërimin dhe diturinë e tyre, po e vërteta është se ata nuk kanë qytetërim e dituri, ata janë shfrytëzues, shtypës e mizorë, prandaj nuk dinë tjetër veçse të mashtrojnë, të grabitin e të vrasin pa mëshirë popujt e tyre dhe popujt e robëruar. Qytetërim, dituri dhe zotësi për të krijuar e për të ndërtuar ka klasa punëtorë, ka proletariati ndërkombëtar, ka populli atje ku ai e ka marrë fuqinë në dorë, si në vendin tonë. Te ne çdo vepër që ndërtohet nuk i shërben pasurimit të një grushti njerëzish, po të gjitha masave punonjëse, lumturisë së tyre. Popujt e botës po e kuptojnë gjithnjë e më mirë ç'do të thotë që populli ta ketë vetë fuqinë në dorë, prandaj ata luftojnë dhe revolucioni do të ecë kurdoherë përpara.

Marksizëm-leninizmi do t'i çojë dhe po i çon punëtorët e botës në revolucion për t'u rrëmbyer kapitalistëve pasuritë e mëdha kolosale që kanë, siç janë: fushat me vajguri, minierat, fabrikat e uzinat, rrugët dhe mjetet e transportit e të ndërlidhjes, mjetet e ndërtimit, tokat, bagëtitë e çdo gjë tjetër.

Vendi ynë është i fortë, se ka një popull heroik, i cili, nën udhëheqjen e Partisë, po ndërton dhe forcon çdo vit e më shumë atdheun e vet. Ai nuk është vetëm, se ka miq dhe aleatë të fuqishëm, popujt dhe revolucionarët kudo në botë.

Edhe një herë, shokë dhe vëllezër punëtorë, në emër të të gjithë Partisë dhe të popullit, ju përshëndes,

ju falënderoj nga zemra dhe ju uroj suksese në realizimin e kësaj detyre të madhe që ju është ngarkuar! Partia dhe populli kanë besimin e patundur se ju do ta ndërtoni këtë vepër të madhe, me frymën e lartë revolucionare dhe me vendosmërinë që karakterizon klasën tonë heroike punëtore.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TË RINJTË TË BËHEN LUFTËTARËT ME TË VENDOSUR PËR ZBATIMIN E VIJËS SË PARTISË

*Fjala në takimin me të rinjtë dhe të rejat
nga Dukagjini, vullnetarë në hidrocentralin
e Vaut të Dejës*

4 shtator 1967

U gëzova shumë kur më thanë shokët që ju keni ardhur këtu nga malësia e largët e Dukagjinit për të punuar në ndërtimin e kësaj vepre. Ju duhet ta ndieni veten shumë krenarë që po merrni pjesë në punimet e një objekti me rëndësi kaq të madhe politike dhe ekonomike për vendin tonë. Por më e rëndësishmja, sidomos për ju vajza, është se për herë të parë merrni pjesë bashkërisht në një aksion kaq të madh.

Pjesëmarrja në aksionet e rinisë është e dobishme për ju. Gjatë këtyre dy muajve që do të punoni këtu, nga pikëpamja edukative ju do të fitoni përvojë sa për 5-6 vjet në kushte të zakonshme. Ky aksion nuk do të jetë i fundit, do të ketë aksione e vepra të tjera të mëdha ku do të merrni pjesë përsëri. Partia po men-

don tani që të rinjtë e të rejat të mos shkojnë vullnetarë vetëm në Vaun e Dejës ose në hekurudhë, po edhe në Vlorë, në Elbasan, në Korçë, në Gjirokastrë etj., që ta shikojnë nga të katër anët Shqipërinë. Nga kjo ju do të keni edhe një përfitim tjetër, se do të udhëtoni e do të njiheni me vendet dhe me njerëzit e shumë krahinave. Jeta tregon se ata që udhëtojnë dhe punojnë në vende të tjera, marrin njëkohësisht dituri dhe përvojë të madhe. Shumë njerëz të mësuar tregojnë se atë që kanë mësuar duke udhëtuar dhe duke u takuar me njerëz të ndryshëm, nuk e kanë marrë dot me anën e librave. Me këtë në asnjë mënyrë nuk dua të them të mos lexoni libra, pse librat dhe shkolla janë, gjithashtu, një burim i madh diturie, po edhe udhëtimet, edhe puna kanë rëndësi të madhe për ngritjen e njeriut në çdo drejtim.

Në aksione juve ju jepet rasti të vizitoni vepra të ndryshme që ka ndërtuar populli ynë nën udhëheqjen e Partisë. Duke bërë krahasime me të kaluarën, me ato që do të shikoni e me ato që po ndërtoni vetë do të kuptoni se prapambetja që ekziston në malësi mund dhe duhet të zhduket. Kjo prapambetje në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ju, malësorët, nuk jeni të zgjuar e punëtorë. Vuajtjet e jetës së vështirë në të kaluarën ju kanë bërë të mençur, trima e punëtorë. Vështirësitë e kalitin dhe e zhvillojnë njeriun, kurse rehatia kultivon dembellëkun e trupit e të mendjes. Edhe ju, vajzat malësore, keni vuajtur nga shtypja e fesë dhe e Kanunit, nga pesha e zakoneve të këqija. Sipas Kanunit, ju ju fejonin që në djep, nuk ju lejonin të flitnit një fjalë, të shfaqnit një mendim, pra-

ndaj zemra juaj ishte kurdoherë plot brengë. Megjithatë juve nuk ju mungonte mençuria, të cilën po e tregoni tani në aksione, ku, me zgjuarsinë, zotësinë dhe punën tuaj, po habitni shoqet e ardhura nga viset e tjera të atdheut. Cilësitë e mira që keni ju malësoret, si i gjithë populli ynë, Partia lufton t'i zhvillojë më tej dhe jeta jonë socialiste, arsimit dhe kulturës do të bëjnë që ato të shkëlqejnë edhe më shumë. Ajo ju këshillon të ndiqni me rregull dhe me zell të madh edhe kurset e shkollat që të merrni dituri. Në fillim do t'ju duket ca e rëndë kjo punë, po nuk ka asgjë të vështirë për ju, vajzat, që shpesh jeni edhe më të zgjuara se djemtë. Po ligjet e Kanunit i kanë pasë mbajtur të ndrydhura energjitë tuaja. Në Shqipërinë e Jugut këto ligje nuk ishin aq të egra, mbasi populli atje ishte diçka më përpara dhe kishte arritur të luftonte disa nga trashëgimet negative të së kaluarës. Kjo nuk do të thotë se në Jug ishin spastruar fare trashëgimet të tilla, pse edhe atje vajzat përpara i martonin njëlloj si në malësi dhe ato nuk kishin të drejtë të thoshin fjalën e tyre për asgjë, bile as për jetën e vet.

Sot Partia po lufton që t'i zhdukë nga faqja e dheut zakone të tilla, të mbështetura nga ligje të egra, që i kishin vendosur sunduesit për të mbajtur popullin, kurdoherë, të shtypur, me qëllim që baballarët, mëmat dhe fëmijët e tyre të ishin të bindur dhe të punonin për ta. Dhe në qoftë se dikush ngrinte krye, shpifnin kundër tij dhe, me pretekst se kishte shkelur zakonet, e poshtëronin, e gjakosnin. Prandaj duhet t'i shqelmojmë këto ligje, që nuk përputhen me normat e moralit të Partisë sonë.

Ju, të reja dhe të rinj, të bëheni luftëtarët më të vendosur për zbatimin e vijës së Partisë, për mbrojtjen e të drejtave të vajzave e të grave. Por mos harroni se duhet të jeni njëkohësisht edhe të dashur me prindërit, t'i respektoni, se as ata nuk e duan të kaluarën e egër, megjithëse ruajnë në mendjen e në ndërgjegjen e tyre disa mbeturina që duhet t'ua çrrënjosi me sjelljet tuaja, me punën tuaj bindëse plot durim. Me këtë nuk dua të them që ju t'u bindeni prindërve verbërisht kur ndonjëri prej tyre vendos ta martojë vajzën e tij me para, ose t'ju imponojë dëshirën e vet dhe nuk do të marrë parasysh ndjenjat dhe mendimet tuaja. Prindërit të marrin medoemos parasysh dëshirën dhe vullnetin tuaj, por ju të mos ziheni me ta, pse nëna dhe babai na kanë lindur e na kanë rritur. Në rast se prindërit ngulin këmbë në vendimin e tyre që s'është i drejtë, ju nuk duhet të thyheni e të tërhiqeni kur keni të drejtë, se në këto çështje do të keni kurdoherë me vete Partinë, popullin, gjithë shokët tuaj. Prandaj punoni në mënyrë që t'i bëni prindërit t'i respektojnë të drejtat, dëshirat dhe mendimet tuaja të mira. Kur të arrini këtë, ju pastaj do t'i doni e do t'i respektoni ata edhe më shumë. Çështja është që të luftoni mendimet dhe zakonet e vjetra te prindërit.

Ju duhet të punoni shumë që ta forconi organizatën e rinisë, po kini kujdes që në mbledhje të mos flasin vetëm djemtë. Prandaj, ju, vajzat, ngrini zërin dhe thoni fjalën tuaj për çdo problem e veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të gruas dhe të vajzës shqiptare. Juve ju takon një rol i madh në këtë drej-

tim. Edhe burrat të luftojnë që gruaja të zërë vendin e vet në shoqëri, prandaj të mendojmë e të punojmë që gratë dhe vajzat të mos vuajnë si në të kaluarën. Edhe të rinjtë kanë vuajtur në të kaluarën, po, sidoqoftë, kishin disa privilegje. Prandaj, ata kurdoherë në rrugën e drejtë të Partisë, të jenë krah jush.

Tani jeta në malësitë e Veriut do të ndryshojë e do të përmirësohet me një ritëm më të shpejtë, sepse Partia po u jep atyre një ndihmë të gjithanshme. Në Kelmend po ndërtohet një rrugë e re automobilistike, rrugë të tjera do të hapen në të ardhmen, do të ndërtohen hidrocentrale, fabrika, miniera e shkolla. Këto vende të bukura do të gjallërohen e do të lulëzojnë. Mua më erdhi shumë mirë kur mësova se që tani shumë vajza e djem nga Shkodra shkuan të punojnë për dy-tre vjet në malësi. Do të ketë vajza të reja nga qyteti që do të martohen me vëllezërit tuaj në fshatrat malore, sikurse do të ketë, gjithashtu, vajza malësore që do të martohen me djem nga qyteti. Nuk është e thënë që fusharakët të martohen vetëm me fusharake, qytetarët me qytetare dhe malësorët me malësore. Është një gjë shumë e mirë që një çupë qytetare apo e fushës të martohet me një malësor, ashtu sikurse një vajzë malësore mund të martohet me një djalë nga qyteti. Do të ketë, pra, edhe nga ata që do të lidhen me malësorët jo vetëm me miqësi, po do të krijojnë atje edhe familje.

Kini kujdes që lidhjet tuaja me shokët të karakterizohen kurdoherë nga thjeshtësia dhe ndershmëria komuniste. Po jeta është jetë dhe qëllon që dy të rinj

PARTIA ËSHTË E FORTË, SEPSE VETË POPULLI QË E LINDI ËSHTË I FORTË

*Nga fjala në takimin me kooperativistët e Troshanit
dhe të fshatrave të afërta të rrethit të Lezhës*

4 shtator 1967

Të dashura shoqe dhe shokë,

Kurdoherë kam pasur dëshirë të madhe të vija në Troshan për t'u takuar me ju, prandaj sot e ndiej veten shumë të gëzuar që ndodhem mes jush dhe më jepet rasti t'ju përshëndes në emër të Partisë, të udhëheqjes së saj, si dhe në emër të Qeverisë sonë. Pavarësisht se vij për herë të parë në kooperativën tuaj, me mendje dhe me zemër kam qenë, jam dhe do të jem kurdoherë pranë jush. Udhëheqja e Partisë dhe Qeveria i kanë ndjekur vazhdimisht me kujdes zhvillimin dhe përparimin e Zadrimës, në përgjithësi, dhe të kooperativës suaj, në mënyrë të veçantë, e, në rradhë të parë, zhvillimin e njerëzve tuaj trima e punëtorë të palodhur.

Sot Troshani njihet në gjithë Shqipërinë për ini-

ciativën e mrekullueshme të drejtuesve tuaj për të marrë pjesë drejtpërdrejt në prodhim. Kjo iniciativë revolucionare, që u aprovua edhe nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Qeveria, është shembull jo vetëm për kuadrot drejtues të të gjitha kooperativave bujqësore të vendit, por edhe për funksionarët e aparatit shtetëror, të Partisë dhe të organizatave shoqërore. Partia ka theksuar vazhdimisht se njerëzit që zgjedh populli në krye duhet të jenë të thjeshtë, siç është vetë ai, të mos u rritet mendja kurrë dhe një ilaç i mirë për këtë është pjesëmarrja e tyre e drejtpërdrejtë në punën prodhuese. Prandaj në qoftë se Partia, Qeveria dhe populli zgjedhin një njeri deputet, ose e emërojnë ministër, drejtor, kryetar kooperative etj., ai jo vetëm nuk duhet të lërë pas dore punën drejtuese, për të cilën është ngarkuar, por, krahas saj, të bëjë edhe punë me duar dhe me krahë, sepse kjo i kalit njerëzit, i shpëton zyrtarët e funksionarët nga shumë të këqija.

Shembulli që dhanë drejtuesit e kooperativës suaj dhe që u përgjithësua nga Partia në të gjithë vendin, është me rëndësi të madhe jo vetëm ideologjike e politike, po edhe ekonomike, sepse nga puna në prodhim që bëjnë nëpunësit e shtetit, të Partisë, të organizatave shoqërore dhe ata të kooperativave bujqësore, ekonomia jonë popullore siguron të ardhura të konsiderueshme, të cilat shkojnë në dobi të popullit.

Partia, vëllezër dhe motra, është zemra juaj. Ajo është e fortë, pse vetë populli që e lindi ka qenë dhe është i fortë. Partia nuk ka frikë nga asnjë kërcënim e vështirësi, pse populli ynë nuk trembet nga kërcë-

nimet e vështirësitë, prandaj ajo, ashtu si vetë populli, kapërcen me sukses kurdoherë çdo rrezik e pengesë. Partia jonë është e drejtë, e ndershme, pse populli nga lindi ajo është i drejtë e i ndershëm. Jeta e Partisë është jeta e popullit, rruga e saj është rruga e popullit, njerëzit e Partisë janë djemtë dhe vajzat tua-ja, jeni ju, janë të gjithë ata që dallohen për vendosmërinë, për punën e palodhur, për pjekurinë, urtësinë dhe thjeshtësinë e tyre. Në qoftë se në Parti ka hyrë ndonjë që nuk i ka këto cilësi, ai nuk bën për komunist, duhet medocemos të hiqet dhe vendin t'ia zërrë një tjetër, që është nga njerëzit më të mirë. Partinë ta ruajmë si sytë e ballit, si jetën tonë dhe ta kemi kurdoherë të fortë, që ta udhëheqë e ta kalitë çdo ditë në beteja të reja fitimtare këtë popull trim e heroik, i cili do të ecë përpara në rrugën e vet të lavdishme, duke zbukuruar gjithnjë e më shumë atdheun e tij. Ky është misioni i lartë i Partisë, ta çojë vendin në socializëm e pastaj në komunizëm, në jetën e bukur të begatisë materiale e shpirtërore, ku njeriut do t'i plotësohen të gjitha nevojat. Dhe kësaj populli ynë do t'ia arrijë.

Besimi i Partisë në këtë rrugë të lavdishme drejt komunizmit nuk qëndron mbi ëndrra të kota, por në ndjenjat dhe në forcën e klasës punëtore, të fshatarësisë, të të gjithë popullit tonë, që është bërë zot i vendit të vet, pse ka pushtetin në duart e tij.

Populli do të realizojë çdo gjë në qoftë se udhëhiqet kurdoherë me drejtësi. Po edhe në qoftë se dikush ose disa e gënjejnë përkohësisht, ai kurrë nuk mund të mashtrohet, të mposhtet e të përgjunjet, për-

kundrazi, janë armiqtë e tij ata që do të mposhten. Kush vete kundër popullit, mund të livadhisë pesë, dhjetë ose njëzet vjet, por pastaj medoemos, do të zhduket, kurse populli do të rrojë gjithmonë.

Partia e Punës e Shqipërisë përfaqëson çdo gjë të mirë që ka populli; ajo realizon atë që mendon e dëshiron ai. Marksi dhe Engelsi, filozofët e mëdhenj të klasës punëtore botërore, Lenini dhe Stalini, që vazhduan veprën e tyre, na kanë lënë trashëgim këto mësimë që ndjekim sot, të cilat i ndriçuan rrugën Partisë sonë dhe i forcuan besimin në fitore, si dje në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, edhe sot në ndërtimin e socializmit. Disa nuk besonin se do të fitonte populli ynë, gjer atëherë fukara e i shtypur. Bejlerët, agallarët, borgjezët e klerikët përbënin një pakicë, kurse ne, populli, ishim shumica e udhëhequr nga Partia, që kishte në bazë të luftës e të gjithë veprimtarisë së vet marksizëm-leninizmin fitimtar.

Në fillim Partia jonë ishte e vogël në numër, por nga forca ishte e madhe. Ajo e dinte se tërë populli do të ishte me të dhe, nën udhëheqjen e saj, do t'ua shtypte kokën të gjithë atyre që e kishin shfrytëzuar gjatë shekujve. U desh të derdhej shumë gjak për çlirimin e atdheut dhe të popullit, pse pa gjak e sakrificë nuk fitohej lufta, nuk mund të çlirohej Shqipëria. Bejlerët dhe agallarët nuk e linin lehtë fronin, prandaj u duhej rrëmbyer pushteti me luftë, gjatë së cilës na u vranë qindra e mijëra shoqe dhe shokë nga më të mirët. Po ata nuk vdesin kurrë, ata do të kujtohen në shekuj në Shqipërinë e lirë, të lumtur, të fortë e të paprekshme. Ishte gjaku i derdhur lumë nga partiza-

nët e komunistët që çliroi popullin, klasën punëtore, fshatarësinë tonë nga gjëma e madhe e pushtimit nazi-fashist, nga shtypja e bejlerëve, e agallarëve, e tregtarëve.

Partia, menjëherë pas Çlirimit, hodhi parullën se toka u përket fshatarëve, se zotër të saj duhet të jenë ata që e punojnë dhe realizoi Reformën Agrare, e cila përbënte një pjesë të programit të Partisë. Reforma Agrare i shpronësoi feudalët dhe realizoi ëndrrën e fshatarësisë për tokë. Kolektivizimi i bujqësisë, bashkimi i tokave, i mjeteve dhe i punës, i cili u bë me vullnetin e fshatarëve, sipas mësimeve të Partisë, e futi fshatin shqiptar në rrugën e socializmit, të përparimit dhe të mirëqenies. Sot jeta e fshatarëve tanë është bërë më e mirë, më e bukur. Më vonë ne do të arrijmë në atë nivel që jeta në fshat, pra edhe këtu në Troshan, të mos ketë ndryshime të mëdha nga jeta në qytete të tilla, si: Shkodra, Vlora, deri edhe Tirana. Pra, zhvillimi i bujqësisë dhe i gjithë ekonomisë në vendin tonë do të bëhet në mënyrë të tillë që jo vetëm të krijohet bollëk, por edhe jetesa në fshat të bëhet si në qytet. Dhe ne po ecim në këtë rrugë.

Ju, shokë të Zadrimës, keni dëgjuar e keni parë me sytë tuaj se në Shqipëri janë bërë përparime dhe ndryshime të mëdha në sektorin e bujqësisë: janë tharë kënetat, janë ndërtuar qindra e mijëra kilometra kanale ujitëse e kulluese, janë ndërtuar rezervuarë të mëdhenj, janë hapur toka të reja e tarraca. Tokat e punueshme të vendit tonë janë përmirësuar dhe prodhojnë çdo vit e më shumë. Në to punojnë sot mijëra traktorë. Në vendin tonë po zhvillohet një bleg-

tori si kurrë më parë, janë ndërtuar fabrika e uzina, që ndihmojnë zhvillimin e bujqësisë, siç janë uzinat e plehrave kimike; po rriten rendimentet e prodhimeve bujqësore dhe, në radhë të parë, të drithërave, po kështu edhe të pambukut, të lulediellit etj.; blegtoria po shtohet dhe po përmirësohet vazhdimisht me llojet më të mira të bagëtive; po rritet sipërfaqja e tokave të punueshme jo vetëm në fusha, ku rrallë mund të gjesh një pëllëmbë tokë pa punuar, por edhe në malësi. Kooperativat bujqësore të zonave malore kanë hapur e po hapin kudo me dhjetëra mijë hektarë toka të reja, po krijohen ndërmarrje të reja bujqësore në këto zona, po prodhohet më shumë misër, grurë, patate, po shtohen tufat e lopëve etj.

Shumë përparime janë bërë në krahasim me të kaluarën, po megjithatë Partia mendon se kemi bërë pak; ajo nuk kënaqet me kaq dhe na porosit të bëjmë akoma më shumë. Në Malësinë e Madhe pashë se kanë hapur mjaft toka të reja, po ato janë akoma plot me gurë dhe pa ujë. Çfarë duhet bërë? Vitin tjetër, me siguri, do të punohet edhe më mirë, gurët do të pastrohen më tej, tokës do t'i hidhet pleh, kështu, në qoftë se tani atje merren 7 kuintalë drithë për hektar, së shpejti do të merren më tepër dhe kështu të ardhurat e kooperativistëve do të shumëfishohen. Jo vetëm në malësi, por edhe në fusha nuk duhet të kënaqemi me rendimentet e tanishme, sepse me kushtet që ka krijuar Partia kemi mundësi të ecim edhe më përpara. Kjo s'do të bëhet «me frymën e shenjtë», siç predikonin feja, priftërinjtë e hoxhallarët që e grabitnin, e shtypnin dhe e mashtronin popullin, por me punën

tonë të palodhur, të ndriçuar nga idetë e Partisë. Klerikët i këshillonin njerëzit e popullit të punonin «për në atë botë» dhe të mirat që prodhonin në tokë le t'i gëzonin të pasurit, kisha, xhamia. Po Partia, ashtu si dhe populli, nuk besojnë në ëndrra të kota, këmbët i kanë mbi dhe. «Në atë botë» po të dojë le të vejë dom Luigji me priftërinjtë e tjerë. Partia na mëson që gjithçka prodhohet në këtë tokë, ta gëzojnë njerëzit e punës, jo ata që s'punojnë e bëjnë vetëm predikime boshe, prandaj edhe «bota tjetër» le të mbetet për priftërinjtë e hoxhallarët. Malësitë tona së shpejti do t'i ndryshojmë krejtësisht, do të luftojmë t'i bëjmë vende të begata, do të shtojmë në to bagëtitë, do të ngremë atje punishte e fabrika për përpunimin e bulmetrave, që jeta e popullit të bëhet më e mirë. Të gjitha këto punë do t'i bëjë dhe po i bën dora e njeriut, e punëtorit dhe e fshatarit tonë. Po pse nuk bëheshin edhe përpara punë të tilla? Nuk dinin njerëzit të hapnin toka të reja e të përmirësonin jetën e tyre? Populli ynë heroik nuk i bënte dot këto më përpara jo se i mungonin mendja, forca, vullneti, por sepse duart ia kishin lidhur dhe sytë ia mbanin mbyllur. Kurse sot, nën udhëheqjen e Partisë, populli në fuqi është ngritur në këmbë, forca e vullneti i tij janë shtuar dhe janë bërë të papërmbajtshëm, se tani ai punon për lumturinë e vet. Të gjitha këto janë arritur, sepse populli i lirë ka dëgjuar fjalën e Partisë.

E ardhmja e bujqësisë, e fshatarësisë sonë kooperativiste, është e siguar. Sivjet prodhimet bujqësore, si: të drithërave, të pambukut, të panxharit, të lulediellit, të ullirit, të frutave etj., si kurrë ndonjë-

herë tjetër janë të mira në të gjithë Shqipërinë. Na ndihmoi ca edhe moti, po faktori kryesor është puna, pse, po nuk punove vetë, koha nuk të ndihmon. Në të ardhmen prodhimet do të rriten përherë e më shumë, sepse do të kemi edhe dituri e përvojë më të madhe, kuadrot do të na shtohen, do të na shtohen, gjithashtu, traktorët, plehrat, blegtoria etj. Kështu që, domosdo, hapat do t'i bëjmë më të mëdhenj se gjer tani. Vetëm duhet mësuar kurdoherë dhe jo vetëm nga librat, por edhe nga përvoja e njëri-tjetrit. Të rinjtë të mësojnë nga pleqtë dhe pleqtë nga të rinjtë, të gjithë të mësojmë pa pushim nga puna në ara, në stalla e kudo, nga përvoja e madhe e sotme dhe e së kaluarës së popullit. Të gjitha këto mësimet t'i përvetësojmë mirë dhe t'i vëmë në jetë. Duke punuar pa u lodhur e duke mësuar vazhdimisht do të realizojmë me sukses planet e zhvillimit të ekonomisë. Kështu, edhe në kooperativën tuaj, me siguri, do të realizohet çdo plan dhe jo vetëm do të plotësohen nevojat e kooperativistëve, po do t'i jepen edhe shtetit teprica. Fshatarësinë ne e kemi patriote dhe të arsyeshme, ajo e kupton dhe e ndien se duhet t'i japë klasës punëtore një pjesë nga prodhimet e veta, ashtu si dhe klasa punëtore i jep asaj mallra industriale. Socializmi siguron një zhvillim harmonik të industrisë dhe të bujqësisë, gjë që bën të mundshme plotësimin e të gjitha nevojave jetike të fshatarësisë dhe të klasës punëtore. Prandaj kjo nxjerr detyrën që fshatarësia, pas plotësimit të nevojave të saj, t'i shesë shtetit sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale për klasën punëtore dhe për punonjësit e tjerë të qytetit.

Bujqësia jonë mori këtë zhvillim që shohim sot, sepse fshatarësia patriote duke u bindur në drejtësinë e mësimeve të Partisë, hyri në rrugën e kolektivizimit, e cila ishte rruga e socializmit në fshatin shqiptar. Tani edhe ata që në fillim patën ngurrime u bindën për të mirat e sistemit kooperativist. Sot para bujqësisë sonë dalin detyra më të mëdha, prandaj të punojmë pa u lodhur për forcimin e pandalshëm të sistemit tonë kooperativist në fshat. Për t'ia arritur kësaj është e domosdoshme të luftojmë që çdo kooperativë të sigurojë prodhime të mëdha pse kështu forcohet ekonomikisht dhe rritet mirëqenia e fshatarëve, që kooperativistët nga puna e tyre të marrin edhe të holla, edhe prodhime në natyrë, si: drithëra, qumësht, perime etj. Kur u hodh parulla për të shkurtuar oborret kooperativiste, pati në disa raste ngurrime dhe kjo kuptohet, por Partia porositi që prodhimet që do të siguroheshin nga tokat dhe nga blegtoria e oborreve që u shkurtuan të shfrytëzoheshin në mënyrë kolektive për të plotësuar nevojat e kooperativistëve, duke ua dhënë anëtarëve këto prodhime në natyrë dhe pa i futur në planin e dorëzimeve etj. Në qoftë se kryesia e kooperativës suaj nuk e ka zbatuar këtë porosi të Partisë, atëherë i kërkoni të japë llogari përpara jush dhe të vërë në jetë porosinë e dhënë. Qëllimi i shkurtimeve të oborreve, pra, ishte të sigurohet një fond toke i bashkuar që do të prodhojë më shumë sesa kur secili e kishte vetë atë pjesë në oborrin e vet personal.

Nga ana tjetër, për të realizuar forcimin e mëtejshëm të sistemit kooperativist, Partia në rreth dhe në fshat duhet të jetë kurdoherë afër jush, t'ju ndihmojë,

kurse ju t'ia thoni asaj haptazi mendimet, të bëni kritikë, vërejtje dhe të mos tuteni nga kurrkush. Këto mendime ose vërejtje organizata e Partisë dhe kryesia e kooperativës duhet t'i dëgjojnë me kujdes, t'i shtrojnë për diskutim në mbledhje ku të merren vendime nga masa e kooperativistëve. Problemet e kooperativës nuk duhet t'i lëmë në dorë të një ose dy njerëzve. Pushteti ynë socialist, është pushteti i masave punonjëse, demokracia jonë është demokraci e madhe. Vetëm për armikun e klasës dhe të popullit nuk lejon demokraci Partia, se ata duan të na bëjnë varrin si në të kaluarën, kurse populli ka liri të plotë të flasë dhe të thotë ç'mendon, se është vetë në fuqi. Ai do që çdo gjë të shkojë kurdoherë në rregull dhe nëse ndonjëri mund ta ketë kokën të turbullt, populli ia kthjellon, në qoftë se dikush thotë diçka çapraz, ka një mijë të tjerë që e kundërshtojnë, e vënë në vend dhe i thonë se nuk e ka drejt. Pa demokracinë e masave punonjëse nuk mund të rrojë populli sot, pa këtë lloj demokracie nuk ka as parti të fortë, as socializëm. Një njeri, sado i zoti të jetë, nuk sheh dot gjithçka bëhet, kurse qindrave e mijërave, masës së popullit, nuk i shpëton asgjë.

Populli është i drejtë në çdo gjë dhe me çdo njeri, ai kurrë nuk i bie në qafë më kot kujtdo qoftë. Dhe Partia ndjek po këtë rrugë. Kështu, kur ndonjëri bën diçka jo të mirë, pa qëllim të keq, e ndreq, e korrigjon, po kur e bën me qëllim, i shkund leqet e këmbëve, e këshillon të ecë mirë, pse interesat e popullit janë shumë më të mëdhenj dhe nuk mund të vihen në balancë me interesat e 4-5 vetave. Duhet të mbro-

hen, pra, interesat e popullit. Prandaj po i zhvillon Partia këtë demokraci dhe këtë revolucion të madh në vendin tonë.

Më poshtë shoku Enver Hoxha u foli kooperativistëve për lëvizjet revolucionare që kishin shpërthyer në vendin tonë kundër fesë, pikëpamjeve e zakoneve konservatore, fetare e patriarkale. Ai i trajtoi gjerësisht këto probleme, duke sqaruar edhe vijën dhe taktikën e Partisë sonë në këtë luftë të madhe revolucionare. Në mënyrë të veçantë shoku Enver nënvizoi domosdoshmërinë e çrrënjësjes së koncepteve e të zakoneve reacionare lidhur me gruan dhe i porositi kooperativistët të përqafojnë zakonet e reja socialiste në veshje, në mënyrën e jetesës dhe të zëvendësojnë festat e vjetra fetare, me festat tona popullore, me një përmbajtje të re. Duke folur për këtë çështje, shoku Enver Hoxha tha:

Përpara kishim shumë festa fetare, ditën e shën Kollit, të shën Mitrit, të shën Gjergjit etj., etj. Ishin kaq shumë këta shenjtorë sa në një ditë bëheshin edhe disa të tillë dhe, sa herë kujtoheshin këta, në kishë çoheshin mesha, që i përvetësonte prifti, i cili s'kishte pse të mos thoshte: «Na rrofshin shenjtorët!» Ç'i donim ne gjithë këto festa që s'ishin tonat dhe që na i kishin sjellë pushtuesit? Tani ne kemi sa e sa festa të popullit: 1 Majin, 7 dhe 8 Nëntorin, 28 dhe 29 Nëntorin, 1 Janarin, 8 Marsin, ditën e çlirimit të fshatit nga partizanët, ditën e themelimit të kooperativës e shumë të tjera. Veç këtyre, ka edhe plot raste të tjera që njerëzit të gëzojnë dhe të dëfrenjë pas punës. Për shembull, sekretari i Partisë, kur mbush ndonjë kooperati-

vist i dalluar 40 vjeç, i thotë përgjegjësit të vatrës së kulturës të përgatitet një pjesë e bukur teatrale. Kështu, mbasi të bëhet ceremonia në vatrën e kulturës, ku të vihen në dukje jeta dhe puna e kooperativistit, jepet shfaqja, apo mund të zhvillohet një mbrëmje dëfrimi dhe pjesëmarrësit mund të kërcejnë e të këndojnë në vatrën e kulturës. Po të kujdesen organizatata-bazë e Partisë dhe kryesia e kooperativës, mbrëmje të tilla mund të bëhen herë pas here me kooperativistët e sidomos me rininë. Në raste të tilla mund të ngrihet edhe sekretari i Partisë dhe t'u flasë kooperativistëve për probleme të ndryshme që shtron Partia. Kështu njerëzit edhe gëzojnë, edhe mësojnë, kurse në kishë ose në xhami njerëzit vetëm i faleshin Krishtit ose Muhametit, rronin me frikën e zotit dhe asnjë gëzim nuk ndjenin.

I ndiqni, motra dhe vëllezër, këto këshilla të urta që na jep Partia, mendoni kurdoherë për to dhe i zbatoni. Unë jam i bindur se nuk ka njeri të ndershëm në vendin tonë që, po të mendojë, të mos e gjejë të drejtë rrugën e Partisë. Nuk them se të gjithë i shikojnë qartë të gjitha ato që bën Partia, ka që thonë: «Mos nuk është e mirë, mos është e shpejtuar, mos na vjen ndonjë e keqe nga lufta kundër fesë e zakoneve prapanike?». Por mendoni thellë, Partia do t'ju ndihmojë për këtë dhe do të shikoni se kjo është rruga e vetme e drejtë e popullit.

Punët në vendin tonë në përgjithësi na venë mirë. Vendi ynë është i fortë si çeliku, pse ka popullin dhe Partinë të fortë si çeliku. Por, edhe në marrëdhëniet me vende të tjera ne jemi të fortë, se kemi aleatë e

miq të shumtë. Shqipëria, sot, respektohet nga të katër anët e botës, në sajë të luftës së popullit dhe të Partisë. Edhe armiqtë tani na njohin dhe sa më të fortë të jemi, aq më shumë na e kanë frikën. Zhurmë bëjnë plot, bërtasin, ulërijnë dhe na shajnë, po shqiptarëve nuk ua bën syri tërr, prandaj ata nuk guxojnë të na prekin. Kushdo që do të përpiqet t'i bëjë ndonjë të keqe Shqipërisë, do ta pësojë. Pastaj le ta dinë se, po t'i ngjasë gjë vendit tonë, do të kërcasë pushka në të katër anët dhe lufta do të përfundojë me fitoren tonë dhe me shkatërrimin e armiqve.

Këtë situatë ia krijuan vendit tonë Partia dhe populli, ia krijoi njeriu i ri socialist, masat tona punonjëse që punojnë, mendojnë dhe luftojnë për të ardhmen e bukur të vendit dhe që bashkë me kazmën mbajnë afër edhe pushkën dhe barutin të thatë. Pushkë ka i gjithë populli te ne. Mjafton që Partia të japë kushtrimin dhe të gjithë rrokin armët e vihen pas saj në gatishmëri. Nuk ka vend në botë ku të jetë i armatosur i gjithë populli si në Shqipëri. Në rast se na sulmojnë armiqtë, duke qenë të armatosur të gjithë, çdo shteg dhe çdo arë, kodër apo luginë, do të bëhet pengesë e pakapërcyeshme për ta. Te ne të gjithë mësojnë të përdorin pushkën, mitralozin e topin. Kurrë mos ardh të rreziku, po ne duhet të përgatitemi, sepse kjo është kryesorja e kryesoreve, prandaj të gjithë të stërviten, të mësojnë dhe të organizohen.

Unë kaq kisha për të folur. Kur të kthehem në Tiranë, shokëve të udhëheqjes do t'u raportoj për pritjen kaq të nxehtë, si edhe për dashurinë e besnikërinë e madhe që ushqeni ju, kooperativistët e Tro-

shanit dhe gjithë populli i rrethit tuaj për Partinë. Ju uroj suksese në punën tuaj, sidomos në drejtim të edukimit ideopolitik të të gjithë kooperativistëve, sepse ai që është i edukuar mirë ideologjikisht dhe politikisht shquhet në punë dhe në zbatimin e detyrave për realizimin e planit.

Partia na mëson të kemi kurdoherë parasysh mirëqenien e popullit. Të gjitha forcat e organizatës-bazë të Partisë, të kryesisë dhe të çdo kooperativisti, të shkrihen për këtë qëllim të lartë, që populli të shikojë ditë gjithnjë e më të mira, të rritet niveli i tij ekonomik, politik, ideologjik, arsimor dhe kulturor, që njerëzit, kudo që punojnë, në uzina, në fabrika, në kantiere, në shkolla e në kooperativa, të mendojnë orë e çast që atdheu ynë të lulëzojë, që populli të rrojë i lumtur në socializëm. Kështu, vendi ynë do të mbajë lart flamurin e marksizëm-leninizmit, do të qëndrojë kurdoherë në vijën e parë të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, kështu, Shqipëria jonë socialiste do të jetë shembull për popujt.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**PËR MIQTË E VËRTETË DYERT JANË
KURDOHERË TË HAPURA NË SHQIPËRINË
SOCIALISTE**

*Nga biseda me një mik nga Turqia
dhe me vajzën e tij*

7 shtator 1967

Porsa u takuan përzemërsisht, vajza turke i dorëzoi shokut Enver Hoxha një mesazh të shkurtër në emër të disa qindra vajzave të Ankarasë, si dhe disa dhurata të vogla.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem shumë që na erdhët si miq në vendin tonë, në mes të popullit shqiptar, mik e vëlla i popullit turk për të cilin ne kemi një simpati të madhe.

Mesazhi që më dhatë ju¹ më kënaqi shumë, sepse në të shpreheshin ndjenjat e pastra të rinisë turke për popullin dhe për rininë shqiptare. Gjithashtu, u gëzo-

1 I drejtohet vajzës turke.

va edhe kur më dërguat portretin tim të punuar me duart tuaja. Tek ai punim mua më pëlqeu shumë kujdesi i veçantë dhe zotësia juaj në kompozim. Me këtë rast dëshiroj t'ju falënderoj nga zemra, si për atë që më dërguat, ashtu edhe për dhuratat e çmueshme që më sollët sot.

Në këtë takim kishte dëshirë të vinte edhe bashkëshortja ime, Nexhmija, por ajo është me punë jashtë Tiranës, prandaj ju kërkon ndjesë për mungesën e saj, por mbase do të ketë rast të takohet me ju një herë tjetër. Nexhmija ka qenë partizane, ka marrë pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare me armë në dorë.

MIKU NGA TURQIA: Na falni për dhuratat e thjeshta, por të sinqerta që ju dhamë sipas zakonit që kemi ne në Turqi. Përgatitjen e tyre e kemi vendosur bashkërisht në familjen tonë, e cila ka një simpati të madhe për Qemal Ataturkun, por njëkohësisht ajo ushqen një simpati të madhe edhe për shkëlqesinë tuaj. Ne ju konsiderojmë si udhëheqës jo vetëm të popullit shqiptar, për të cilin keni bërë shumë sakrifica për ta rimëkëmbur e për ta futur në rrugën e përparimit, por edhe në shkallë ndërkombëtare, prandaj kemi një konsideratë të madhe për ju. Na bëri shumë përshtypje, sidomos mikpritja e sinqertë dhe trajtimi i mirë që na u bë nga ana e gjithë personelit të vaborit shqiptar, me të cilin erdhëm. Ata na kanë mbajtur si në pëllëmbë të dorës. Për këtë arsye i përgatitëm kapitenit të vaborit një dhuratë të vogël. Por, pas pak, edhe ai na solli si dhuratë nga ana e tij, një shishe

esencë, portretin e shkëlqesisë suaj të qëndisur bukur dhe një flamur shqiptar. Qysh në vapor, pra, ne pamë shprehjen e parë të miqësisë së singertë. Të gjitha këto ne i konsideruam si një manifestim dashurie të të gjithë popullit shqiptar ndaj popullit tonë dhe u bindëm për miqësinë e singertë që ushqen populli juaj për popullin turk.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderoj shumë për fjalët e mira që thoni për vendin dhe popullin tonë dhe dëshiroj t'ju them me këtë rast se populli shqiptar, që ka lidhje të lashta me popullin tuaj, ushqen një miqësi të singertë për të. Tani që na erdhët, dëshira jonë është që të bëni edhe disa vizita nëpër Shqipëri, të merrni takim me popullin tonë, sepse kështu do të shihni akoma më mirë sa e madhe dhe e singertë është miqësia e popullit shqiptar për popullin turk, do të kuptoni, gjithashtu, ndjenjat fisnike e të pastra të popullit tonë, si dhe të grave e të vajzave shqiptare. Veçanërisht ju, zonjushë, që do të merrni kontakt me të rejat shqiptare në ndonjë mbledhje që mund të organizohet në Tiranë, si edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, ku vajzat tona do të flasin me ju, por edhe ju mund t'u flitni atyre për vajzat e vendit tuaj.

Gjatë kohës që do të qëndroni këtu ju do të shikoni edhe përparimet e ndryshimet e mëdha që ka bërë vendi ynë. Edhe revolucioni i madh që bëri populli turk, me Mustafa Qemal Ataturkun në krye, e çoi vendin tuaj, dhe veçanërisht gruan turke, në rrugën e përparimit, gjë që ka pasur rrjedhime të mëdha edhe jashtë Turqisë. Ky revolucion u prit me simpati

të madhe edhe në Shqipëri në atë kohë, sepse ishte një revolucion demokratik përparimtar.

Mustafa Qemali e donte popullin shqiptar. Sipas historisë së popullit tonë nëna e tij ka qenë shqiptare. Kam lexuar diku se një mbrëmje, kur u njoftua se kryetari i Republikës Shqiptare, në atë kohë Ahmet Zogu, u bë mbret i shqiptarëve, Ataturku u ngrit menjëherë në këmbë, i zemëruar pa masë dhe tha se Ahmet Zogu me këtë që bëri tregon se është një hajdut, një njeri i poshtër. Në këtë gjykim ai nuk u gabua aspak, sepse i tillë ishte në të vërtetë Ahmet Zogu, që e shiti Shqipërinë te imperialistët italianë. Kjo e detyroi popullin shqiptar të ngrihej në luftë, në revolucion dhe me gjak e me sakrifica të panumërta, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, mundi të shporrte pushtuesit italianë, gjermanë, njerëzit e Ahmet Zogut, feudalët, bejlerët, agallarët dhe të merrte pushtetin në duart e veta.

Me qeverinë e tanishme turke ne po përpiqemi për të vendosur marrëdhënie të mira miqësore dhe shohim se edhe nga ana e saj ka shenja të mira. Pavarësisht nga forma e regjimeve të ndryshme që ekzistojnë në vendet tona, në shërbim të interesave të përbashkët, nga ana jonë, ne do të bëjmë përpjekje për ta ngritur më lart miqësinë tonë me popullin vëlla turk, për të zhvilluar me vendin tuaj marrëdhënie normale ekonomike e kulturore, për të shkëmbyer në mënyrë reciproke delegacione punonjësish të shkencës, të kulturës, të sportit, të arteve etj.

Të dy popujt kanë bërë një luftë të pandërprerë kundër armiqve të tyre. Armiqtë e popullit turk janë

edhe armiqtë e popullit tonë. Në radhë të parë armiqtë tanë më të egër janë imperialistët amerikanë. Janë, gjithashtu, armiq të popujve tanë edhe revizionistët sovjetikë. Por ne nuk ua kemi frikën. Populli shqiptar vërtet është një popull i vogël, por në rast se sot ai rron i lirë, kjo i kushtohet luftës që ka bërë gjithë jetën për lirinë e tij e të atdheut. Me luftë fitohet liria. Kur populli ngrihet në këmbë për të mbrojtur të drejtat e tij, nuk ka forcë në botë që ta mposhtë.

Ne e njohim popullin turk. Ai është shumë trim. Këtë nuk e themi për t'ju mburrur, por sepse e ka provuar jeta. Ne mendojmë dhe jemi të bindur se, po të guxojë ndokush ta sulmojë dhe ta prekë popullin turk, agresori do të humbasë dhe Turqia do të fitojë.

Flakët e luftës që u ndezën kohët e fundit në ishullin e Qipros janë rrjedhim i rivalitetit sovjetiko-amerikan. Të dyja superfuqitë përpiqen të ringjallin armiqësitë e vjetra turko-greke me qëllim që të krijohet një gjendje e tillë që do të lehtësonte ekspansionin e tyre. Populli shqiptar dhe Qeveria e tij i kanë mbështetur e do t'i mbështetin edhe në të ardhmen interesat jetikë e të drejtat e ligjshme të qipriotëve.

Ne u themi miqve turq se armiqtë nuk kanë ç'i bëjnë Shqipërisë Demokratike.* Asnjë mizë nuk kalon dot në kufijtë tanë dhe prej kohësh kemi deklaruar se, kushdo që do të orvatet ta godasë Shqipërinë, do të gjejë vdekjen. Këtë duhet ta dinë mirë armiqtë tanë. E dinë mirë këtë imperialistët amerikanë, titistët, fashistët italianë, revizionistët sovjetikë dhe monarko-

-fashistët grekë. Të gjithë këta na kanë rrethuar, por, në rast se na prekin, ne do të luftojmë dhe do t'i asgjësojmë. Pastaj ne kemi edhe miq të shumtë e të mëdhenj kudo në botë, midis të cilëve edhe popullin turk, i cili është me ne dhe jemi të bindur se, po t'i ngjasë gjë popullit shqiptar, do të ngrihet në këmbë për të na mbrojtur.

Armiqtë tanë të jashtëm propagandojnë se në Shqipëri «ka diktaturë», «nuk ka liri» etj., kurse te ne ekziston një demokraci e gjerë, e vërtetë. Për ta kuptuar këtë duhet të jetosh këtu, të marrësh pjesë në mbledhjet që bën populli. Në këto mbledhje të gjera popullore, ku shtrohen të gjitha çështjet ekonomike, politike, shoqërore etj., gjithkush ka të drejtën të thotë fjalën e vet, të vlerësojë kush punon mirë e kush punon keq, nëse është bërë mirë një punë apo jo, nëse Qeveria e ka zbatuar këtë ose atë vendim etj. Po të gjykohet se nuk është kryer mirë diçka, Partia e çon çështjen në popull dhe këtu, në mbledhje të gjera ngrihen me qindra e mijëra njerëz të thjeshtë të popullit, analizojnë çështjen dhe bëjnë vlerësimin e punës së çdo njeriu. Partia jonë e Punës e mëson popullin që çdo njeri ta peshojë sipas punës që bën. Ilaçi më i mirë për ata që bëjnë gabime, mendojmë ne, është që këta të venë t'ia tregojnë sinqerisht popullit gabimet e tyre. Kështu i mëson Partia njerëzit tanë. Ajo u thotë ministrave, ushtarakëve, drejtorëve, gjithë funksionarëve të venë në popull dhe t'i flasin haptazi atij për gabimet që mund të kenë bërë. Dhe populli në mbledhje i heq veshin atij që ka gabuar, por Partisë ose Qeverisë i thotë që ta falin kur sheh

se dikush ka vepruar gabim pa dashje, dhe e paralajmëron të gabuarin që herën e dytë, po të bëjë faj, do të ndëshkohet rëndë dhe vendin e tij do ta zëre një tjetër më i mirë.

Në vendin tonë deputetët, këshilltarët, si dhe kuadrot e pushtetit në rrethe e në qendër, nuk emërohen, por zgjidhen nga populli, i cili ka të drejtë ta heqë cilindo prej tyre, kur e sheh që s'punon mirë. Vetëm populli mund ta heqë një person të zgjedhur. Unë ose kryeministri, fjala vjen, nuk kemi të drejtë të pushojmë vetë nga puna asnjë njeri, pasi për secilin duhet të vendosim në mënyrë kolegjiale. Gjithashtu, te ne nuk mund të arrestohet asnjë i zgjedhur pa pëlqimin e organeve të zgjedhura nga populli. Populli është çdo gjë për ne. Tërë jetën ne do të jemi kurdoherë shërbëtorë të tij.

Të gjitha shtetet kanë pasur dhe sot kanë, gjithashtu, ushtri të rregullta. Edhe Shqipëria ka ushtrinë e saj të rregullt dhe të fortë, por ajo ka edhe diçka tjetër që nuk e kanë vendet e tjera. I gjithë populli është ushtar. Çdo njeri te ne është i armatosur. Cili shtet mund ta bëjë këtë që të armatosë gjithë popullin? Vetëm një shtet, një parti dhe një qeveri që janë të lidhur ngushtë me popullin. Në vendin tonë pushkë nuk mbajnë vetëm burrat. Edhe gratë janë të organizuara në batalione e në brigada dhe kanë mësuar të përdorin jo vetëm pushkën, por edhe topin dhe të gjitha llojet e armëve të tjera, me qëllim që, në rast se do t'i vijë ndonjë rrezik Shqipërisë, me shenjën e parë që do të japë Partia, të gjithë, burra e

gra, do të ngrihen në këmbë për të mbrojtur atdheun.

Në vendin tonë gratë kanë bërë një përparim të madh, veçanërisht në fushën e arsimit. Ne kemi sot shkolla fillore në të gjitha fshatrat. Në çdo krahinë kemi shumë shkolla tetëvjeçare që janë të detyrueshme për të gjithë fëmijët e Republikës, djem dhe vajza gjer në moshën 15 vjeç. Arsimi i të gjitha kategorive në vendin tonë është krejt falas. Me mijëra studentë e studente ndjekin universitetin dhe shkollat e tjera të larta në Shqipëri dhe vetëm ata të rinj e të reja që janë nga Tirana ndjekin studimet duke jetuar në familje, gati gjithë të tjerët janë me bursë të shtetit. Djemtë e vajzat, të fushës e të malësisë, që nuk kanë shkollë të mesme në vendbanimin e tyre, marrin, gjithashtu, bursë nga shteti.

Të gjitha këto që po ju them, ju do t'i shikoni vetë, prandaj do të ma bëni shumë qejfin, po të shkoni në të katër anët e Shqipërisë, si nga Veriu i Shqipërisë, edhe në Korçë, në Durrës, në Vlorë e gjetkë. Vizitoni gjithçka që do të dëshironi, si miqtë tanë të dashur, edhe kooperativa bujqësore, edhe shkolla, fabrika e çdo gjë tjetër dhe ta ndieni veten si në shtëpinë tuaj, si në Ankara. Çdo dëshirë që do t'ju lindë gjatë vizitave në Shqipëri, do të përpiqemi t'ju plotësojmë.

Sidoqoftë, kjo vizitë, nuk duhet të jetë as e vetmja dhe as e fundit. Të na vini sa herë që të dëshironi, pa teklif. Për miqtë e dashur dera është kurdoherë e hapur në Shqipëri.

Tani, para se të ndahemi, ta pimë këtë gotë për shëndetin tuaj!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

MASAT TË EDUKOHEN ME NDJENJËN E RESPEKTIMIT TË LIGJEVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit
Popullor të RPSH¹*

8 shtator 1967

Në politikën penale, në përgjithësi, nuk kemi gabime të rënda. Mund të ketë vendime të shpejtuara për sa i përket caktimit të masës së dënimit ose dënime standarde, por këto nuk janë gjëra flagrante e në një shkallë të tillë që të na shqetësojnë.

Kjo tregon se shokët e Prokurorisë, të gjykatave dhe të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë fituar eksperiencë në drejtim të zbatimit të vijës së Partisë dhe të ligjeve. Sigurisht, edhe në këtë sektor delikat, siç thashë, ka të meta të cilat mund dhe duhet të ndreqen. Kështu, për sa u përket dënimeve standarde, që përmenda më lart, mendoj se ka vend për një punë më të kujdesshme, që edhe ligji të zbatohet, por edhe diferencimi i dënimeve të bëhet.

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Gjykata e Lartë dhe nga Prokuroria e Përgjithshme e RPSH «Mbi politikën penale për krimet kundër shtetit, vrasjet, përvetësimet dhe dëmtimet e pasurisë socialiste».

Paraqiten raste kur duhen bërë diferencime duke marrë parasysh të kaluarën e të dënuarit, aktivitetin e tij politik etj. Ligji është ligj dhe duhet zbatuar, por në caktimin e masës së dënimit të shihen edhe rrethanat e kryerjes së krimit, personaliteti i atij që gjykohet etj.

Diferencimi në ata që kanë shkelur ligjin të bëhet, jo vetëm sepse shteti nuk ka interes t'i dënojë të gjithë, por edhe sepse do të ketë nga ata që kanë shkelur pa dashje ligjin ose janë shtyrë në këtë rrugë nga elementë të këqij. Ata që nuk i dërgohen gjyqit, duhet t'i kalojnë masës për t'i gjykuar politikisht, për të diskutuar dëmin që i kanë sjellë shoqërisë me fajet e tyre, kurse në gjykimin e atyre që shkelin ligjet të merret edhe opinionin e masës. Kjo çështje ka rëndësi të madhe parimore dhe praktike, por është e nevojshme që me masat të bëhet një punë sqaruese, me qëllim që ato të gjykojnë në frymën e ligjit e jo jashtë saj. Mendimi i masës është i drejtë në thelb, por kjo nuk do të thotë që gjykata të veprojë mekanikisht. Gjykatësit do të dëgjojnë opinionin e masës për fajtorin dhe për vlerësimin e krimit, por do t'i përmbahen rigorozisht zbatimit të ligjit. Masa, për shembull, e shtyrë nga një ndjenjë e drejtë mund të thotë që ky apo ai person duhet dënuar rëndë për krimin e kryer, por gjykata nuk mund ta ndëshkojë fajtorin tej maksimumit të parashikuar nga Kodi Penal. Po të veprohet ndryshe, do të thotë që gjykatësit bien në pozitë të gabuar dhe harrojnë orientimin që jep ligji, kështu mund të bëhen gabime që e ngarkojnë gjykatën me përgjegjësi.

Gjykatat tona, që i ka zgjedhur populli, janë populllore. Ato kanë për detyrë edhe të japin llogari para masave të popullit për zbatimin e ligjit; gjithashtu, gjyqtarët të dëgjojnë zërin e masave, sepse mund të mësojnë shumë gjëra prej tyre.

Nga ana tjetër, me masat duhet bërë një punë e gjithanshme që të edukohen me ndjenjën e respektimit të ligjit. Përveç të tjerash, ky edukim bëhet mirë edhe nëpërmjet marrjes së vendimeve të drejta në proceset gjyqësore. Krahas kësaj është e rëndësishme që masat të kenë të qarta shkaqet që e shtynë gjykatën të marrë këtë apo atë vendim, të caktojë këtë apo atë masë dënimi. Në qoftë se, për shembull, vendoset nga gjykata që një person, për të cilin është kërkuar dënimi, të marrë pafajësinë, atëherë masa duhet të sqarohet pse s'ka faj ky person i akuzuar.

Edhe gjyqet shoqërore të bëhen, sepse kanë karakter edukativ, politik dhe joshtrëngues sikurse gjykatat populllore; ato luajnë rol të madh në edukimin e masave me ndjenjën e përgjegjësisë dhe në njohjen e në respektimin e ligjeve. Veç kësaj, në gjyqet shoqërore mund të dalë edhe ndonjë vjedhje e pazbuluar dhe gjëra të tjera që formojnë krime dhe që, pasi të hetohen, mund t'i kalojnë për gjykim gjykatës populllore.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Presi-
diumit të Kuvendit Popullor
të RPSH që gjendet në AQP*

NE E NDIEJMË VETEN KRENARË QË LUFTOJMË SË BASHKU ME TË GJITHË MARKSISTË- -LENINISTËT PËR TË NJËJTËN KAUZË

*Nga biseda me një përfaqësues të Partisë Komuniste
të Italisë (marksiste-leniniste)*

11 shtator 1967

*Pasi u shkëmbyen përshëndetjet e rastit, fjalën e
mori shoku Enver Hoxha:*

U gëzua shumë për ardhjen tuaj në vendin tonë.

Besoj se shokët tanë ju kanë informuar mbi sukseset e ekonomisë së vendit tonë gjatë këtij viti. Bujqësia është mjaft mirë. Gati në të gjithë zërat, si në prodhimin e drithërave e të bimëve industriale, edhe në mbarështimin e blegtorisë, planet po realizohen. Kjo ka ngjallur një entuziazëm të madh në popull. Edhe në sektorin e industrisë parashikohet që planet të tejkalohen. Të gjitha këto suksese në fushën ekonomike janë arritur në sajë të direktivave të Komitetit Qendror, të bazuara në vijën që u përcaktua në Kongresin e 5-të të PPSH.

Gjendja në vendin tonë, në përgjithësi, është shu-

më e mirë. Kudo ka entuziazëm të madh. Në Parti ka shpërthyer një hov i madh revolucionar për edukimin politik marksist-leninist të anëtarëve. Radhët e saj po zgjerohen me revolucionarë të rinj. Atje ku kishim organizata-bazë të vogla, tani i shtojmë me gjak të ri dhe, në radhë të parë, me vajza e me gra punëtore. Në format e edukimit, në kurse e në shkolla të arsimit të përgjithshëm e profesional kemi një ngritje, një përparim të paparë. Po kjo nuk është e tëra, kemi akoma shumë për të bërë në lidhje me edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të masave, pavarësisht se Partia është shumë monolite, pa asnjë të çarë, pavarësisht se anëtarët e Partisë janë në unitet monolit mendimi e veprimi. Edukimi ideopolitik nuk ka fund, prandaj mendojmë se në këtë drejtim jemi akoma prapa. Çdo ditë e më shumë shikojmë që edukimi ideologjik dhe politik i njerëzve luan rol vendimtar.

Të gjitha fenomenet negative që shfaqen te disa nga njerëzit tanë e kanë burimin te niveli i tyre i ulët ideologjik. Ka komunistë që janë luftëtarë dhe gati të hidhen në zjarr për çështjen e Partisë, po ka nga ata që disa gjëra nuk i kuptojnë si duhet dhe veprojnë kundër direktivave të Partisë në drejtim të ruajtjes së pasurisë së përbashkët, në luftën kundër zakoneve prapanike, në trajtimin e gruas etj. Prandaj edukimin ideopolitik të masave Partia e merr shpeshherë në shqyrtim dhe çdo herë merr masa të mëtejshme për ngritjen e tij.

Ne kënaqemi shumë kur marrim vesh se edhe partia juaj, Komiteti i saj Qendror, i kushton një

rëndësi të madhe edukimit marksist-leninist të anëtarëve. Ashtu si ju, edhe ne mendojmë që në Itali duhet dhe është i domosdoshëm një kujdes i tillë. Italia ka një ndryshim të madh nga Shqipëria. Atje ka një borgjezi të organizuar, të fortë, me një ideologji dhe aparat të fuqishëm, kurse në vendin tonë para Çlirimit nuk ka pasur një borgjezi të tillë, ajo ishte në formim e sipër. Në Shqipëri s'ka pasur as parti politike. Populli ka qenë, si të thuash, i virgjër dhe atë e ka shqetësuar kurdoherë çështja e çlirimit kombëtar.

Në këto kushte Partia jonë, sa u krijua, gjeti një truall shumë të favorshëm dhe punoi që popullin shqiptar ta udhëhiqte në rrugën patriotike, socialiste. Edhe populli italian vazhdimisht ka hequr e heq në kurriz shumë vuajtje e plagë të rënda, që e kanë bërë atë të hidhet në zjarr, në revoltë dhe nga kjo anë ai ka një përvojë të madhe. Pikërisht këtu qëndron roli i partisë marksiste-leniniste që këtë zjarr, këtë revoltë dhe këtë përvojë të popujve të dijë t'i shfrytëzojë; këtu qëndron rëndësia e punës së madhe që duhet të bëjë Partia për edukimin e njerëzve me ideologjinë e saj. Ju vetë na thoni se i keni vënë rëndësi çështjes së edukimit. Kjo është themelore. Për t'u orientuar drejt në çdo situatë duhet një formim i mirë e serioz i ndërgjegjes revolucionare të njerëzve. Vetëm duke qenë të sqaruar mirë ideologjikisht, ata mund të përballojnë çdo situatë sado e rëndë të jetë. Ju e dini më mirë nga ne se borgjezia e madhe italiane përdor një mijë e një taktika për t'i bërë për vete njerëzit.

Një punë e madhe është bërë dhe vazhdon të

bëhet te ne edhe në lidhje me luftën kundër fesë, besimeve fetare e zakoneve prapanike. Natyrisht, situata te ju ndryshon nga ajo jona, sidomos lidhur me fenë. Po nuk është e vërtetë ajo që thonë disa se në Itali nuk ka njerëz që duan të bëjnë një luftë parimore kundër një fuqie të tillë obskurantiste, jo vetëm shpirtërore po edhe temporale, siç është Vatikani. Edhe atje ka, bile me miliona, që janë kundër kësaj qendre të fortë shekullore të reaksionit. Feja në Shqipëri nuk ka pasur baza teorike dhe organizative të shëndosha. Ajo nuk ka qenë e lidhur me lëvizjet revolucionare, përparimtare e çlirimtare të popullit shqiptar. Kleri reaksionar, në përgjithësi, dhe, veçanërisht, ai i sferave të larta, qoftë ai mysliman, ortodoks e sidomos ai katolik, ka luajtur një rol të hapët anti-kombëtar, pro pushtesve turq, austro-hungarezë, grekë, e, më në fund, edhe pro fashistëve italianë e nazistëve gjermanë. Ai, pra, ka qenë kurdoherë në luftë kundër çështjes kombëtare, kundër lirisë së popullit.

Pas Çlirimit organizimi i feve të ndryshme në Shqipëri, me përjashtim të asaj katolike, ishte gati i paqenë. Veprimtaria e institucioneve të fesë myslimane ishte thujtë formale, ajo e fesë ortodokse ishte kufizuar vetëm në liturgji, kurse kisha katolike u përpoq ta zhvillonte ideologjikisht e të përhapte fenë katolike, por nuk arriti ta bënte këtë si në Itali, në Francë etj. Kuadri klerik mysliman dhe ortodoks ishte fare injorant, kurse kuadrot e kishës katolike ndryshonin nga dy të parët, ata ishin të përgatitur. Klerikët kishin në dispozicion vetëm institucionet fetare dhe asgjë tjetër, ndërsa përballë kishin

luftën revolucionare të popullit. Kurse tani edhe kishat e xhamitë, si mjete për përhapjen e ideologjisë fetare, u zhdukën. Priftërinjtë e paktë që mbetën, e hoqën veshjen dhe u futën në punë. Shumë prej tyre dolën përpara popullit dhe bënë autokritikë për çka i kanë shkaktuar atij. Të gjitha këto masa ne nuk i morëm në rrugën administrative, bile Komiteti Qendror i Partisë në direktivat që dha, porosi të bëhej kujdes nga kjo anë, po ishte vetë populli ai që kërkoi të ecej më tej dhe eci.

Tani së fundi, kur isha në Shkodër pashë se ish-qendra më e madhe e franceskanëve, kuvendi, ku më parë përgatiteshin kuadrot më të shumtë të katolicizmit në Shqipëri, ishte transformuar në pallat kulture. Gjatë takimeve që pata me masat, sidomos me fshatarët, lola shumë për fenë. Ata më dëgjuan me vëmendje. I pyeta se ç'mendonin për të gjitha këto që ishin bërë. Ish-klerikë dhe masat më folën hapur e me gjithë zemër kundër fesë. Megjithatë mendova që me disa njerëz të bisedoja ca si mënjancë. Prandaj mbajta rreth 20 gra që ishin afër meje e u thashë të më flitnin si vëllait të tyre se ç'mendonin për atë që ishte bërë kundër fesë. Ato më thanë se unë, kur kisha folur kundër fesë s'kisha thënë asgjë përpara të këqijave që kishin bërë klerikët kundër tyre.

Në Troshan të rrethit të Lezhës, për shembull, më treguan se para Çlirimit 50 për qind e tokës së fshatit kishte qenë pronë e kishës dhe fshatarët ishin të detyruar t'i paguanin dy herë më shumë taksa kishës sesa qeverisë së Zogut. Ndërsa në raste mar-

tesash, lindjesh a vdekjesh ata ishin të detyruar t'i jepnin kishës shuma të konsiderueshme. Në fakt, edhe nga gjysma e të ardhurave që u mbeteshin fshatarëve, një të katërtën ua merrte kisha.

Ka shokë dhe miq jashtë që, duke mos e njohur gjendjen reale, kushtet objektive e subjektive të vendit tonë dhe vijën e Partisë sonë, thonë se ne jemi treguar sektarë në këtë çështje. Ata harrojnë se rrethanat te ne janë ndryshe nga ato të vendeve të tyre. Kur para një muaji ishin këtu disa shokë francezë, u thashë se ne e dimë që nga ana e zhvillimit teknik vendi i tyre është përpara vendit tonë, por nga pikëpamja e çlirimit të ndërgjegjes së njerëzve Shqipëria socialiste është jo me vite, por me shekuj përpara.

Shokët më thanë që partia juaj është duke u forcuar dhe çdo ditë po e shton numrin e anëtarëve. Sigurisht, ju keni përpara shumë vështirësi, po, për t'i kapërcyer ato me sukses, rëndësi të dorës së parë merr uniteti në udhëheqje. Partia jonë ka përvojë të paktë, por, duke u mbështetur në të, ajo ka mësuar se armiqtë e saj, veçanërisht ata të brendshmit, janë orvatur kurdoherë ta thyejnë unitetin e Partisë dhe në mënyrë të veçantë atë të udhëheqjes. Këto orvatje nuk janë kristalizuar menjëherë, ato kanë filluar me disa shfaqje në formë kritike, gjoja objektive, të cilat Partia dhe udhëheqja i kanë marrë kurdoherë parasysh, kanë njohur ato që ishin të drejta, po në to kanë vënë re edhe prirjet jo të drejta të tyre dhe nëpërmjet këtyre kanë zbuluar synimet e armiqve. Por, ndërsa udhëheqja jonë qëndronte në mënyrë revolucionare përpara çdo kritike, merrte ma-

sa e bënte çmos që të ndreqte të metat që rridhnin nga vështirësitë e zhvillimit, armiqtë vazhdonin veprimtarinë e tyre se kishin qëllime të tjera, të cilat nuk mund t'i mbanin gjer në fund të fshehta. Ata nuk mund të pajtoheshin me qëndrimin revolucionar të Partisë, se shikonin që ky qëndrim ishte në dëm të tyre. Në këto rrethana, kur prirjet e tyre zhvilloheshin e dilnin hapur kundër Partisë, ajo i vinte me shpatulla për muri, u tregonte rrugën drejt së cilës duhej të shkonin, ndryshe, kur mbushej kupa, u tregonte edhe vendin. Natyrisht, këta ishin njerëz antiparti, të futur kontrabandë në Parti, dhe doli se disa prej tyre ishin agjentë të revizionistëve jugosllavë, disa të tjerë të revizionistëve sovjetikë, të monarko-fashistëve grekë e të tjerëve. Ata kishin menduar të korruptonin Partinë, në radhë të parë, ideologjikisht dhe ta përçanin atë. Por asnjëri nuk ia arriti qëllimit. Të gjithë dështuan. Procesi i zhvillimit të Partisë sonë ka vërtetuar se uniteti i saj ka rëndësi të madhe. Ky unitet ka ardhur gjithnjë duke u çelikosur dhe ka bërë që vija e përgjithshme e Partisë sonë të ketë qenë gjithnjë e drejtë, marksiste-leniniste.

Në Parti duhet të ketë mendime e diskutime, po diskutimet e sëmura nuk i ka pranuar Partia jonë. Më 1947 ne përjashtuam nga Partia njëfarë Sejfulla Malëshova, gjoja teoricien dhe njeri i Kominternit. Ai erdhi në Shqipëri me plot pretendime e me paragjykimë, me kritika e me mendjemadhësi. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare nuk zhvilloi asnjë veprimtari. Që gjatë luftës pamë tek ai shenja jo të mira, por pas Çlirimit doli se ishte një buharinist i maskuar. E

gjithë «teoria» e tij konsistonte në mbrojtjen dhe në ruajtjen e borgjezisë tregtare e të kulakëve, të mos u merreshin tatimet mbi fitimet e luftës elementëve shfrytëzues etj. Partia e shporri nga udhëheqja dhe nga radhët e saj dhe tani ai punon diku si llogaritar.

Konceptet oportuniste, trockiste, buhariniste të elementëve borgjezë e të reaksionarëve të maskuar, që ishin futur kontrabandë në radhët e Partisë, i likuidoi vija e shëndoshë revolucionare e Partisë, gjë që ndihmoi në forcimin e unitetit të radhëve të saj.

Edhe ju, si ne, e kuptoni rëndësinë e madhe të unitetit. Ju e dini më mirë punën tuaj, po në bazë të përvojës së Partisë sonë dua t'ju them se gjatë gjithë kohës në mes shokëve të Komitetit tonë Qendror dhe të Byrosë Politike ekzistojnë një seriozitet dhe rreptësi marksiste-leniniste në mbrojtjen e vijës së Partisë. Ne ndaj njëri-tjetrit mbajmë qëndrime marksiste-leniniste. Gjithsecili thotë hapur mendimin e tij për punën, për rezultatet dhe mosrealizimet, praktikë kjo që është vendosur prej kohësh te ne dhe nuk ka keqkuptime në këtë drejtim. Askush nga ne nuk preokupohet se mos nuk kuptohet drejt nga shokët kjo apo ajo që thotë. Të gjithë vijnë në mbledhje me të vetmin preokupacion, si e si të zgjidhet më mirë problemi. Ky është një nga sukseset e mëdha të Partisë sonë.

Partia kurrë s'ka lejuar që oportunizmi të hedhë rrënjë në radhët tona. Në qoftë se Partia jonë ka bërë ndonjë lëshim në vitet e para, kjo ka ndodhur se atëherë kemi qenë të rinj, nuk kishim këtë përvojë

që kemi sot, disa gjëra nuk i kishim kuptuar si duhet ideologjikisht, prandaj edhe kemi bërë ndonjë gabim. Po tani nuk i lejohet asnjërit nga ne të gabojë.

Ne ua presim kokën jo atyre që gabojnë, por vetëm atyre që tradhtojnë, armiqve. Ka ndonjë shok nga parti të tjera që na akuzon sikur nuk kemi vepruar drejt ndaj disave. Por kjo s'është e vërtetë dhe, po të lexohen dokumentet e Partisë sonë, do të shihet se sa shumë është përpjekur ajo për t'i ndihmuar e për t'i shpëtuar këta njerëz para se të binin plotësisht në batak, atëherë do të na thonë të kundërtën, se ne bile e kemi zgjatur shumë me ta. Po luftë është kjo. Ata që nuk luftojnë, popull a parti qoftë, nuk kanë histori. Jeta e shqiptarit ka qenë kurdoherë në luftë, e tillë është edhe historia e tij — luftë tërë jetën. Një malësor 90-vjeçar, që nuk e njeh marksizëm-leninizmin, kur e takova para 10 ditësh, më tha se «shqiptarin nuk e ka nxjerrë lokja prej barkut, por huta prej çarkut». Ky mendim është sinteza e luftës shekullore për liri e pavarësi e popullit tonë.

Mbasi foli edhe miku nga Italia, fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:

Edhe ne ju falënderojmë shumë për ndihmën që na jepni me shkëmbimin e hapët të mendimeve. Duke vepruar kështu, ndihmojmë shoku-shokun. Jemi dakord, gjithashtu, edhe me atë që thatë ju, se njohja në Itali e zhvillimit të vendit tonë në rrugën e socializmit jo vetëm ndihmon në mirëkuptimin dhe në forcimin e miqësisë midis dy popujve tanë, por përbën edhe një ndihmë për shokët komunistë italianë.

Ne themi kurdoherë që përvoja jonë është e vogël, por megjithatë jemi plotësisht dakord me ju që duhet të shkëmbejmë më shpesh eksperiencën, sido që është, me të mira dhe me të meta, se i shërben shumë çështjes sonë të përbashkët. Përvoja e partive tona është fituar mbi baza marksiste-leniniste dhe është zbatuar e zbatohet në përputhje me kushtet e vendeve tona. Zbatimi në mënyrë shabllon, qoftë nga ne, qoftë nga ju, i përvojës së partive të tjera nuk jep përfundime të mira. Këtë mësim ne e kemi pasur kurdoherë parasysh dhe besojmë se nuk kemi qenë të gabuar. Ne kemi përfituar nga eksperiencia e të tjerëve, po duhet thënë se edhe kemi vuajtur. Në radhë të parë, kemi përfituar shumë nga përvoja e Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik. Parimet marksiste-leniniste, mësimet e Leninit dhe të Stalinit, kanë qenë në taban të Partisë sonë. Përpara vitit 1948 ne përdorëm edhe përvojën jugosllave. Atëherë ishim akoma të rinj, pa eksperiencë, megjithatë, shikonim, po jo dhe aq qartë, se diçka jo të mirë kishte në të. Më vonë u pa qartë se ç'ishte ajo.

Partia jonë ka tani përvojën e vet në çdo drejtim, veçanërisht në çështjen e lidhjeve të Partisë me masat e të futjes së saj në to. Ky është një parim i njohur, një tezë marksiste shumë e rëndësishme. Po, që ta zbatosh mirë këtë, duhet të kesh parasysh gjendjen e vendit, pse ajo që ishte dhe është e zbatueshme për kushtet e vendit tonë, mund të mos jetë e pranueshme plotësisht për Italinë. Një parti marksiste-leniniste, që bazohet në parimet e drejta, nuk mund të mos marrë parasysh rrethanat dhe situatat

objektive e subjektive edhe mbi këtë çështje. Për Kinën mund të jetë i përshtatshëm leximi në kor i citateve të Mao Ce Dunit, kurse për Partinë tonë jo. Ne bile luftojmë që njerëzit të mos mësojnë mekanikisht, po direktivat e Partisë t'i zbërthejnë e t'i kuptojnë mirë në të gjitha drejtimet. Kur njeriu i studion me kujdes, në tru bëhet procesi i fiksimit të mendimeve. Kur këto pastaj zbërthehen e lidhen mirë me situatën e orientojnë drejt njeriun për çdo problem. Kjo është një çështje me rëndësi. Gjithmonë duhet pasur parasysh që Partia në një situatë mund të zbatojë një metodë, por në një situatë tjetër del e nevojshme të zbatojë një metodë tjetër.

Ju interesoheni të mësoni se si duhet të futet partia në masa. Ky është një problem shumë i rëndësishëm sidomos për vendin tuaj, ku ka edhe parti të tjera që ndikojnë me punën e tyre në masa. Në Itali gati të gjitha masat janë «të organizuara» nga partitë e tjera. Ne mendojmë se partia marksiste-leniniste duhet të luftojë që të ketë medoemos lidhje me masat, që të përhapë ideologjinë marksiste-leniniste në to, pavarësisht se ato janë «të rrëmbyera» nga të tjerat. Në ndonjë rast kur shihet që partia marksiste-leniniste dhe ndonjë parti tjetër kanë një problem të përbashkët dhe luftojnë t'i mobilizojnë masat për ta zgjidhur atë problem, atëherë ajo ose mund të bjerë në ujdi me tjetrën për çështje konkrete, ose pa rënë dakord del në rrugë bashkë me masat pa asnjë marrëveshje. Me një parti, për shembull, që rrethanat e detyrojnë të dalë (ose të shprehet) kundër imperializmit amerikan e në favor të luftës

së popullit vietnamez, megjithëse dihet ç'qëllim ka dhe ç'rrethana e detyrojnë atë të dalë në rrugën tonë, partia marksiste-leniniste mund të bashkohet në këtë rast me të për këtë çështje, por në këtë luftë të përbashkët ajo nuk mungon të popullarizojë vijën e saj, të futë në masat synimet e drejta të saj, parullat e veta, të cilat do të penetrojnë patjetër edhe në organizatat e partisë tjetër, do të zhvillohet kështu një luftë. Kjo do të jetë në favorin tonë. Të kufizohet partia marksiste-leniniste vetëm te masat që kanë mbetur akoma «të paorganizuara», «të pathitura» nga partitë borgjeze e revizioniste nuk është e mjaftueshme. Edhe kjo duhet bërë, po ato janë pak, pra, duhet punuar edhe me masat që janë nën ndikimin e partive të tjera.

Do t'ju lutem t'u transmetoni të gjithë shokëve të udhëheqjes suaj urimet dhe përgëzimet më të mira për punën e madhe revolucionare që po bëni dhe për sukseset që po korr partia juaj.

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Kundër
revizionizmit modern
1965-1967», f. 564*

*Botohet sipas shënimeve të
mbajtura në këtë takim
që gjenden në AQP*

KONGRESI YNË DO TË CAKTOJË DETYRA TË REJA

Fjala e hapjes në Kongresin e 4-t të FDSH

14 shtator 1967

Të dashur shokë dhe shoqe,

Më lejoni që, në emër të Këshillit të Përgjithshëm, t'ju përshëndes ju, delegatët e mbledhur këtu nga të katër anët e vendit, për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të 4-t të Frontit Demokratik dhe t'ju uroj sukses të plotë në misionin e rëndësishëm që ju kanë besuar masat punonjëse.

Ky Kongres mbledhet në pragun e 25-vjetorit të formimit të organizatës sonë të madhe, e udhëhequr nga Partia jonë heroike e Punës. Në radhët e Frontit Demokratik është realizuar bashkimi i gjerë i popullit shqiptar, si në luftën për çlirimin kombëtar dhe vendosjen e pushtetit popullor, ashtu edhe në luftën për socializëm. Punimet e këtij Kongresi kanë rëndësi të madhe, sepse ai, i mbështetur në direktivat e Kongresit të 5-të të Partisë, do të përcaktojë

detyrat e reja dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë së organizatës sonë në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për ta bërë atdheun tonë më të fortë, më të lulëzuar, më të bukur.

Duke qenë se shumica e delegatëve të zgjedhur janë në sallë, më lejoni që Kongresin e 4-t të Frontit Demokratik të Shqipërisë ta deklaroj të hapur.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 222 (5947), 15 shtator 1967

Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 222 (5947), 15 shtator 1967

**MBI ROLIN DHE DETYRAT E FRONTIT
DEMOKRATIK NË LUFTËN PËR FITOREN E PLOTË
TË SOCIALIZMIT NË SHQIPËRI**

Raport i mbajtur në Kongresin e 4-t të FDSH

14 shtator 1967

Shoqe dhe shokë,

Ne jemi mbledhur sot këtu, në Kongresin e 4-t të Frontit Demokratik, të organizatës së madhe politike revolucionare të popullit shqiptar, që të bëjmë bilancin e punës e të luftës sonë, të përgjithësojmë përvojën e fituar dhe të përcaktojmë detyrat e mëdha që i dalin përpara organizatës së Frontit, për t'i vënë në jetë idetë dhe vendimet historike të Kongresit të 5-të të Partisë sonë të lavdishme.

Kongresi i tanishëm mblidhet në ditët e jubileut të shënuar, 25-vjetorit të themelimit të Frontit Demokratik. Që nga ajo ditë historike, kur në Pezën heroike, në zjarrin e luftës për liri, me iniciativën e Partisë Komuniste, u vunë bazat e bashkimit të madh politik të popullit tonë, Fronti ka kaluar prova të

mëdha dhe ka luajtur një rol të dorës së parë në gjithë jetën e vendit tonë, si gjatë Luftës Nacional-çlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore, ashtu edhe pas Çlirimit të vendit, në luftën për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit, për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

25 vjetët që kanë kaluar nga dita e krijimit të Frontit përbëjnë periudhën më të shkëlqyer në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar. Gjatë kësaj kohe, populli ynë, i bashkuar si një trup i vetëm në Front, nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës, ka arritur fitore të mëdha revolucionare që kanë ndryshuar rrënjësisht gjendjen dhe fatet e atdheut.

Shqipëria, dikur një vend i skllavëruar, gjysmë-kolonial dhe një plaçkë tregu në duart e ujqve imperialistë, është sot një vend i lirë, socialist, i pavarur, sovran e i paprekshëm. Populli shqiptar, deri dje i shtypur egërsisht nga regjimet reaksionare, sot ka në dorë pushtetin shtetëror, është zot i plotfuqishëm i vendit dhe ndërton me duart e veta e për vete një jetë të re.

Shqipëria e vjetër, vendi më i prapambetur në Evropë, vendi i parmendës së drurit, i analfabetizmit dhe i malarjes, i shfrytëzimit çifligaro-borgjez dhe imperialist, nuk ekziston më. Tani bota njeh një Shqipëri tjetër, Shqipërinë e re socialiste, me industri e bujqësi të zhvilluar dhe moderne, me arsim e kulturë masive, Shqipërinë që marshon me vrull të pandalshëm drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste

dhe ku jeta e popullit punonjës përmirësohet nga dita në ditë.

Atdheu ynë po përparon me ritme të shpejta në rrugën e shndërrimit në një vend industrialo-agrar. Mbi 40 herë është rritur prodhimi industrial në krahasim me vitin 1938. Miniera e kombinate, uzina e fabrika të shumta të industrisë së rëndë, të lehtë dhe ushqimore janë ngritur sot në të katër anët e vendit. Degë krejt të reja e moderne si metalurgjia dhe industria kimike i janë shtuar nga viti në vit industrisë sonë socialiste. Hidrocentrale e termocentrale vigane janë ndërtuar dhe po ndërtohen për t'u dhënë sa më shumë energji e dritë vendit e popullit. Industria jonë e re është bërë sot një bazë e fuqishme për tërë zhvillimin e ekonomisë, ajo ka dhënë dhe po jep një ndihmë gjithnjë e më të madhe për zhvillimin e përparimin e fshatit dhe të bujqësisë sonë socialiste.

Bujqësia, gjithashtu, nuk ka krahasim me të kaluarën. Nga një bujqësi e copëtuar dhe e prapambetur, ajo është bërë tani një bujqësi e kolektivizuar plotësisht dhe e përparuar, që zhvillohet me sukses në rrugën e socializmit. Ajo po plotëson gjithnjë e më mirë me drithëra buke dhe me produkte të tjera bujqësore e blegtorale nevojat e popullsisë gati të dyfishuar të vendit, dhe po u përgjigjet me sukses kërkesave në rritje të industrisë socialiste për lëndë të parë. Mbi 213 për qind është rritur sipërfaqja e mbjellë kundrejt vitit 1938. Afro 7 herë e gjysmë është shtuar sipërfaqja e tokës së ujitur, në krahasim me paraluftën. Veprat e mëdha të bonifikimit, të

kryera nga pushteti popullor, kanë sjellë ndryshime të theksuara në hartën e Shqipërisë: janë zhdukur tanimë kënetat e Maliqit, e Tërbufit, e Jubës, e Roskovecit, e Vurgut, e Thumanës, e Gjadrit etj. Mbi 8 900 traktorë punojnë në fushat, kodrat dhe malësitë, nga 30 gjithsej që kishte Shqipëria para Çlirimit.

Ndryshime kolosale janë kryer në fushën e arsimit e të kulturës. Është zhdukur përgjithmonë plaga shekullore e analfabetizmit dhe e padijes, është zhvilluar në mënyrë të gjerë e të gjithanshme arsimi popullor; kultura dhe artet janë bërë e po bëhen me të vërtetë pasuri e masave më të gjera të popullit. Përgatitja e mijëra kuadrove të kualifikuar nga bijtë e punëtorëve e të fshatarëve ka krijuar ushtrinë e madhe të inteligjencies popullore, besnike gjer në fund ndaj interesave të popullit dhe idealeve të revolucionit e të socializmit. Sot Universiteti Shtetëror dhe institutet e tjera të larta, afro 3 700 shkolla të arsimit fillor, 8 e 12-vjeçar, institucionet e ndryshme shkencore, kinostudioja «Shqipëria e re», radiostacionet e fuqishme, Teatri i Operës e i Baletit, Pallati i Madh i Kulturës dhe një rrjet i gjerë teatrosh, estradash, shtëpish e vatrash kulture përhapin gjer në skajet më të largëta të atdheut dijet, kulturën dhe dritën e socializmit.

Të gjitha këto suksese madhështore janë arritur në sajë të punës së palodhur, të ndërgjegjes së lartë socialiste dhe të vrullit të paepur revolucionar të popullit tonë të mrekullueshëm, të klasës punëtore heroike, të fshatarësisë kooperativiste e të inteligjencies popullore, të cilat, të frymëzuara e të udhëhequra me

urtësi, guxim e vendosmëri marksiste-leniniste nga Partia jonë e Punës, të bashkuara në unitet të çeliktë në radhët e Frontit Demokratik, kapërcyen e mposhtën me vetëmohim të pashoq të gjitha vështirësitë dhe pengesat e shkaktuara nga prapambetja e trashëguar dhe nga bllokadat armiqtësore të imperialistëve e të revizionistëve modernë hrushovianë, titistë e të tjerë.

I tillë është, në vija të përgjithshme, bilanci i fitoreve historike, me të cilin populli ynë vjen në Kongresin e 4-t dhe në jubileun e 25-vjetorit të themelimit të Frontit Demokratik. Kongresi ynë po i zhvillon punimet e tij në një kohë kur revolucioni socialist të ne po thellohet e po zhvillohet me sukses në të gjitha fushat, në rrugën e përcaktuar nga Kongresi i 5-të i Partisë. Në të katër anët e atdheut kanë shpërthyer lëvizje dhe iniciativa të mrekullueshme, që po i revolucionarizojnë më tej ndërgjegjen dhe botëkuptimin e njerëzve, jetën dhe punën e tyre. Transformime të thella politike, ideologjike dhe ekonomike po bëhen në jetën e vendit dhe të popullit tonë. Ne jetojmë sot në një periudhë krijimtarie të madhe e të paparë që po kryhet nga një popull revolucionar, nën udhëheqjen e një Partie që frymëzohet nga një ideologji revolucionare.

Mbajtja e Kongresit të 4-t të Frontit Demokratik në këto çaste historike ka rëndësi të veçantë. Para nesh qëndrojnë detyra të mëdha e me përgjegjësi për t'i çuar përpara revolucionin dhe ndërtimin tonë socialist, për t'i forcuar më tej ekonominë dhe pushtetin popullor, për të plotësuar planin e katërt pesëvjeçar, për t'i edukuar masat me frymën klasore

revolucionare dhe me ndjenjat e dashurisë për atdheun socialist. Të gjitha këto janë probleme të mëdha edhe për Frontin, sepse s'ka problem të jetës së popullit apo të vendit që të mos i interesojë atij. Detyra kryesore e Kongresit tonë është t'i japë një shtytje të re e të fuqishme gjithë punës së Frontit, ta forcojë më tej atë, të ngrejë më lart rolin e tij në sistemin tonë të diktaturës së proletariatit.

I

ROLI HISTORIK I FRONTIT PËR ÇLIRIMIN E VENDIT, PËR MBROJTJEN E PAVARËSISË KOMBËTARE DHE PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT

Fronti Demokratik ka qenë kurdoherë, në të gjitha etapat, arma e fuqishme e Partisë për bashkimin politik të popullit rreth saj, tribuna e madhe e zhvillimit të vetëveprimtarisë dhe iniciativës së gjallë të masave të gjera të popullit në luftë e në ndërtim.

Përvoja e fituar gjatë 25 vjetëve të ekzistencës së Frontit, që ka vërtetuar plotësisht politikën e drejtë të Partisë sonë në lidhje me këtë organizatë, ka një rëndësi të madhe teorike dhe praktike. Prandaj, studimi dhe përgjithësimi i vazhdueshëm i kësaj përvoje janë detyra të dorës së parë për të gjithë ne, sepse kështu do t'u jepet mundësia, si organizatave të Partisë, ashtu edhe atyre të Frontit, të nxjerrin sa më shumë mësimë të dobishme për punën në të ardhmen.

1. — Partia e Punës e Shqipërisë — e vetmja forcë udhëheqëse dhe e vetmja parti politike në vendin tonë

Fronti Demokratik është vazhdim i drejtpërdrejtë i Frontit Nacionalçlirimtar, i cili lindi, u rrit dhe u forcua si bashkim vullnetar politik i masave të gjera të popullit. Themelet e tij u hodhën nga poshtë në luftën kundër pushtuesit fashist. Fronti është vepër e Partisë. Në krye të tij, si forcë udhëheqëse, që nga fillimi e vazhdimisht, ka qenë dhe është Partia marksiste-leniniste e klasës punëtore. Këtë rol udhëheqës ajo e ka fituar me vijën e saj të drejtë që shpreh dhe mbron interesat jetësorë të popullit shqiptar dhe me luftën heroike të saj, të komunistëve shqiptarë, të cilët, me guximin, vendosmërinë, shpirtin e tyre të sakrificës e të vetëmohimit, kanë treguar se janë luftëtarët më konsekuentë për çështjen e popullit, të atdheut e të socializmit. Fronti nuk ishte dhe nuk është një parti politike, ai nuk ishte dhe as u bë një koalicion partish, meqenëse veç Partisë sonë nuk kishte dhe nuk ka në vend parti të tjera.

Partia jonë përbën, ndoshta, shembullin e vetëm si parti marksiste-leniniste e klasës punëtore që u krijua në një vend ku më parë nuk ekzistonin as parti socialiste e socialdemokrate, as parti të tjera borgjeze dhe që mbeti e vetmja parti e klasës punëtore dhe e vetmja parti politike në jetën e vendit.

Në periudhën e parë pas fitores së pavarësisë, për një kohë ka pasur synime dhe janë bërë orvatjet e

para për krijimin e partive borgjeze liberale, disa herë edhe me prirje përparimtare. Por ato u zhdukën para se të lindnin, sepse programet e tyre nuk ishin të qarta e luftarake, ato nuk shprehnin dëshirat e masave dhe tendencat objektive të zhvillimit të Shqipërisë në atë periudhë, kurse nga pikëpamja organizative ato thuajse ishin të paqena, prandaj dhe nuk lanë asnjë gjurmë në jetën e vendit tonë.

Me ardhjen në fuqi të regjimit çifligaro-borgjez të Zogut, si shtypës i çdo lirie demokratike, i çdo shfaqjeje të lirë mendimi dhe orvatjeje organizimi, u zhduk çdo mundësi për krijimin e partive të ndryshme politike legale nga klasat e shtypura e të shfrytëzuara. Por edhe klasat sunduese e shfrytëzuese, feudalët e borgjezia, nuk mundën të krijonin dot partitë e tyre politike. Në vendet e zhvilluara kapitaliste, siç dihet, ekziston sistemi i shumë partive borgjeze. Kjo është e lidhur me vetë gjendjen e borgjezisë, si një klasë e zhvilluar dhe e konsoliduar prej kohësh, ku edhe grupimet e shtresat e ndryshme të saj krijojnë parti të veçanta politike për mbrojtjen e interesave dhe të pozitave të tyre në pushtet. Te ne gjendja ishte krejt ndryshe. Shqipëria ndodhej në mes dy periudhave historike, asaj të rënies së feudalizmit dhe asaj të zhvillimit të kapitalizmit, kur çifligarët, si një klasë e vjetër, shkonin drejt rrënimit të tyre dhe kur borgjezia nuk kishte arritur atë shkallë zhvillimi që të kishte jo më shumë parti, por as edhe një parti të vetme politike. Kështu e gjeti Shqipërinë edhe pushtimi fashist.

Në gjendjen e rëndë që u krijua për fatet e

atdheut tonë, i cili jo vetëm humbi lirinë, por rrezi-kohej të shuhej edhe si popull, detyra imperative e çdo shqiptari ishte të rrëmbente pushkën dhe të fillonte luftën e shenjtë antifashiste, luftën për çlirimin kombëtar. Pikërisht në këto çaste vendimtare, në një situatë revolucionare, në zjarrin e luftës çlirimtare, lindi Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia e klasës punëtore, Partia që me programin e saj iu përgjigj dëshirave dhe aspiratave të masave të gjera popullore, kushteve objektive konkrete që kalonte vendi ynë. Partia Komuniste e Shqipërisë u krijua nga komunistët shqiptarë si një parti marksiste-leniniste revolucionare, si një parti e tipit të ri nga teoria që e udhëhiqte, nga parimet organizative mbi të cilat u ndërtua dhe nga programi i saj politik. Ajo lindi si një domosdoshmëri objektive për të udhëhequr luftën revolucionare për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Kështu, nga gjiri i popullit u krijua e vetmja Parti e klasës punëtore me një program të qartë politik, organizativ, ushtarak dhe ekonomik-shoqëror, të përpunuar shkencërisht. Klasa punëtore, megjithëse e paktë në numër, ishte klasa më revolucionare dhe më përparimtare e shoqërisë sonë. Asnjë klasë, asnjë shtresë ose grupim tjetër politik nuk doli me partinë e vet për të marrë në dorë flamurin për çlirimin kombëtar, sepse nuk ishte në gjendje të luante një rol të pavarur në arenën politike të vendit, të thoshte në mënyrë të pavarur fjalën e vet, të krijonte një parti politike të vetën, të qëndrueshme mbi baza të shëndosha ideologjike e organizative.

Partia Komuniste e Shqipërisë ishte dhe qëndroi

e vetmja Parti e pararojës që mori përsipër dhe e kreu me nder barrën e rëndë, por të lavdishme, të mobilizimit dhe të organizimit të popullit, të udhëheqjes së tij në luftën çlirimtare kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të brendshëm. Në sajë të Partisë, të udhëheqjes së saj të drejtë revolucionare, populli ynë fitoi mbi armiqtë e tij, i mundi dhe i shporri ata tej kufijve të atdheut, shkatërroi krejt pushtetin e vjetër, ngriti pushtetin e vet të ri të diktaturës së proletariatit, siguroi dhe forcoi lirinë e pavarësinë e tij të plotë dhe po ndërton me sukses shoqërinë socialiste.

Tradhtarët ballistë dhe gjithë miqtë e tyre, imperialistët amerikanë, anglezë e të tjerë, kanë shpifur e shpifin se gjoja Partia Komuniste e Shqipërisë as lejoi krijimin e partive të tjera politike në vendin tonë, as ishte e gatshme për të bashkëpunuar me to në luftën për çlirim. Kuptohet se me këtë armiqtë duan ta paraqitin Partinë tonë si një parti jodemokratike, sektare dhe të ngurtë nga pikëpamja taktike. Por realiteti objektiv i hedh poshtë kategorikisht këto shpifje. Është fakt historik që në vendin tonë nuk u krijuan parti të tjera politike antifashiste veç Partisë Komuniste të Shqipërisë. Në rast se parti të tilla përparimtare do të formoheshin, Partia jonë nuk do të ishte kundër bashkëpunimit me to në çështjen e organizimit të luftës kundër pushtuesve. Ajo, si Parti marksiste-leniniste, nuk kishte përse të trembej nga bashkëpunimi me to. Në dokumentet e Partisë Komuniste të Shqipërisë të kohës së luftës theksohet shprehimisht: «... s'do të thotë se jemi kundër formimit të partive të ndryshme politike, por këto parti,

që të mund të formohen, duhet që në programin e tyre të kenë në ballë të parë luftën kundër okupatorit, luftën me prova dhe jo me fjalë dhe këto parti të marrin pjesë në Frontin Nacionalçlirimtar, duke pasur të drejtë të ruajnë individualitetin e tyre»¹.

Duke pasur parasysh faktin historik që te ne nuk pati parti të tjera politike, ne themi se kjo për klasën punëtore dhe popullin shqiptar, për çështjen e revolucionit dhe të socializmit në Shqipëri, ishte një e mirë e madhe e pallogaritshme, kurse për borgjezinë, për reaksionin kombëtar e ndërkombëtar, ishte një fatkeqësi e madhe, një humbje fatale. Ç'karakter dhe ç'qëllime do të kishin partitë e tjera politike, ç'do të përfaqësonin dhe interesat e kujt do të mbronin ato? Natyrisht, interesat e bejlerëve, të agallarëve, të tregtarëve, të kapitalistëve të qytetit e të fshatit. Ato, në goftë se do të krijoheshin, do të luanin një rol reaksionar, do t'u shërbenin drejtpërdrejt pushtuesve fashistë, ose do të bashkëpunonin në forma të ndryshme edhe me pushtuesit, edhe me imperialistët anglo-amerikanë, kundër popullit. E gjithë veprimtaria e tyre do të zhvillohej në dëm të unitetit të popullit, në dëm të luftës çlirimtare, do të drejtohej kundër pushtetit popullor, kundër reformave të mëdha ekonomike, politike e organizative, do të ishte në dëm të rindërtimit të vendit dhe të ndërtimit të socializmit.

Kjo u provua katërcipërisht gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, kur organizatat politike të Ballit Kombë-

¹ «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. I, bot. i dytë, f. 212. Tiranë, 1971.

tar e të Legalitetit, në të cilat ishin grumbulluar përfaqësuesit e klasave sunduese e shfrytëzuese të vendit, kaluan hapur në anën e pushtesve nazifashistë dhe u bënë vegla në duart e imperialistëve anglo-amerikanë për ta minuar luftën çlirimtare të popullit shqiptar. Kjo u provua edhe pas Çlirimit të vendit, kur përfaqësuesit e borgjezisë dhe agjentët e amerikanëve e të anglezëve, Riza Dani, Shefqet Beja, Gjergj Kokoshi e të tjerë u orvatën të krijonin një parti politike për t'i minuar pushtetin popullor dhe ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste, orvatje që u dërrmua nga Partia jonë dhe nga Fronti Demokratik.

Pikërisht sepse borgjezia dhe reaksioni i brendshëm e i jashtëm nuk i arritën dot këta objektiva antipopullorë, Partinë dhe regjimin tonë të demokracisë popullore i akuzojnë sikur «shtypin demokracinë dhe lirinë». Është e qartë se ç'do të thotë «demokraci dhe liri» për ta. Ata kërkojnë demokraci dhe liri për armiqtë e popullit, për çifligarët e kapitalistët, për reaksionarët e kundërrevolucionarët. Ja pse ata nuk durojnë dot që në Shqipëri të ketë një parti të vetme; ja pse ata kërkojnë, nën maskën e «demokracisë», të ketë shumë parti, që të mos ndërtohet kurrë një demokraci e vërtetë për popullin, të mos ketë kurrë një shtet me të vërtetë demokratik, të mos ndërtohet kurrë socializmi, por mbi popullin tonë të sundojë thundra e hekurt e kapitalit.

Në vendin tonë interesat e mbarë popullit punonjës i përfaqëson dhe i mbron plotësisht Partia e Punës, pararoja e organizuar e klasës sonë punëtore. Interesat dhe qëllimet e klasës punëtore, që përfaqëson

Partia e Punës, janë në të njëjtën kohë edhe interesat e qëllimet e fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies sonë socialiste. Të gjitha këto shtresa të popullsisë janë bashkuar në Frontin Demokratik, Fronti i vetëm i popullit shqiptar, dhe luftojnë për të vënë në jetë politikën e direktivat e Partisë, në të cilat shprehen aspiratat e popullit. Atëherë kujt do t'i duheshin partitë e tjera në Front apo jashtë tij, interesat e cilës klasë do të përfaqësonin e do të mbronin ato, kur dihet se çdo parti politike shpreh e mbron interesat e një klase të caktuar, lufton për realizimin e qëllimeve të saj, udhëheq luftën e saj për pushtet? Është e qartë se ato do t'u duheshin vetëm atyre shtresave dhe elementëve të pakicës shfrytëzuese, të çifligarëve dhe të kapitalistëve që u mundën në luftë dhe me luftë, që u dërrmuan politikisht dhe ekonomikisht nga klasa punëtore në aleancë me fshatarësinë, nën drejtimin e Partisë, nga diktatura e proletariatit.

Përvoja jonë tregon se partia e klasës punëtore, në qoftë se ndjek një vijë revolucionare, me të vërtetë marksiste-leniniste, në qoftë se me luftën e saj të vendosur e shembullore mbron me guxim interesat e popullit dhe të lirisë e të pavarësisë së atdheut, kur nuk ekzistojnë parti të tjera borgjeze, e kryen edhe më mirë misionin e vet historik për çlirimin kombëtar, për kryerjen e revolucionit socialist dhe ndërtimin e socializmit.

2. — Fronti si hallka kryesore për bashkimin politik të popullit tonë

Partia në luftë e në revolucion nuk mund të shkojë vetëm. Revolucioni është vepër e masave, pra ndaj detyra e parë kryesore e çdo partie revolucionare është t'i bëjë të ndërgegjeshme masat, t'i bashkojë, t'i organizojë dhe t'i udhëheqë ato. Forma më e mirë dhe më efektive që gjeti Partia jonë, për arritjen e këtij qëllimi, në përshtatje me rrethanat e vendit e të kohës, ishte krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar. Konferenca e Pezës, që u mbajt vetëm 10 muaj pas formimit të Partisë, hodhi themelet e shëndosha të bashkimit politik e organizativ të popullit në shkallë kombëtare dhe pranoi platformën e Luftës Nacionalçlirimtare të përpunuar nga Partia Komuniste.

Fronti Nacionalçlirimtar ishte Fronti unik i të gjithë popullit kundër armikut të jashtëm që na kishte pushtuar vendin. Vija e Partisë në Front ishte për bashkimin pa dallim klase, bindjeje politike, feje dhe krahine e të gjithë shqiptarëve të vërtetë, e të gjitha forcave patriotike e demokratike të vendit, e të gjithë atyre që ishin gati të luftonin kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve për një Shqipëri të lirë, të pavarur, demokratike e popullore. Ky orientim ishte plotësisht i drejtë dhe i përgjigjej situatës së atëhershme të vendit tonë, kur kontradiktat e brendshme klasore kishin kaluar në plan të dytë dhe kryesore ishin bërë kontradiktat e jashtme midis popullit shqiptar, që luftonte për lirinë, pavarësinë e sovranitetin

e tij, dhe pushtesve italianë e gjermanë, që kishin shkelur vendin tonë.

Duke zbatuar këtë vijë, Fronti përfshiu në gjirin e vet shumicën dërrmuese të popullsisë — klasën punëtore, fshatarësinë e varfër e të mesme, borgjezinë e vogël e të mesme të qytetit, intelektualët patriotë dhe gjithë elementët e tjerë antifashistë. Në themel të Frontit qëndronte aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë. Kjo aleancë ka një rëndësi jetike për çdo vend që ngrihet në luftë e në revolucion, ajo përbën parimin më të lartë të diktaturës së proletariatit. Por për kushtet e vendit tonë, ku klasa punëtore ishte e paktë në numër dhe fshatarësia përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë, tërheqja e saj në luftë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të Partisë së saj revolucionare, ishte faktori vendimtar që përcaktonte fatin e luftës e të revolucionit. Partia jonë e vlerësoi drejt dhe seriozisht këtë problem. Fshati u bë baza kryesore dhe fshatarësia forca kryesore e luftës sonë çlirimtare. Partia jonë, si parti e klasës punëtore, shprehte e mbronte njëkohësisht edhe interesat e fshatarësisë punonjëse. Problemet që e prekuponin fshatarësinë, reformat ekonomike, politike e arsimore që aspironte ajo, figuronin në programin e Partisë sonë, mbroheshin e zbatoheshin me konsekuencë prej saj. Në Partinë e klasës punëtore fshatarësia gjeti për të parën herë në histori udhëheqësen e vërtetë dhe revolucionare të luftës së saj për liri, tokë e begati.

Edhe politika e jashtme e Frontit Nacionalçlirimtar, që frymëzonte Partia, ishte aleanca me të gjitha shtetet antifashiste dhe me të gjithë popujt që

luftonin kundër fashizmit dhe sidomos aleanca me Bashkimin Sovjetik, i cili me politikën e tij të urtë dhe luftën e tij legjendare, të udhëhequr me zotësi nga Stalini i madh, u bë shpresa e shpëtimit të popujve nga murtaja fashiste, që i kërcënonte me shfaqje. Vija e Frontit për të bashkëpunuar edhe me Britaninë e Madhe dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadrin e luftës së përbashkët kundër koalicionit nazifashist ishte e drejtë. Megjithatë, ne për asnjë çast nuk shuam vigjilencën tonë revolucionare, sepse ishim të ndërgjegjshëm se do të ndesheshim me qëllimet grabitqare, kolonialiste, skllavëruese e shtypëse të imperialistëve ndaj popujve. Dhe jeta na dha plotësisht të drejtë. Aleatët anglo-amerikanë u përpoqën me të gjitha mënyrat ta merrnin në dorë drejtimin e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, t'i likuidonin Frontin dhe Partinë Komuniste dhe më në fund të zbarkonin e ta pushtonin vendin tonë, ashtu siç bënë në Greqi. Por këto orvatje dështuan dhe kjo është meritë e madhe e Partisë dhe e Frontit, që nuk u lejuan imperialistëve t'i futnin hundët në punët e brendshme të vendit tonë.

Programi i Frontit Nacionalçlirimtar ishte në fakt programi minimum i Partisë. Ai ishte një program i qartë, i kuptueshëm, luftarak e revolucionar. Detyrat kryesore të këtij programi ishin: lufta e paprërë dhe pa kompromis kundër pushtuesve dhe tradhtarëve për çlirimin e vendit, për lirinë dhe pavarësinë kombëtare, për qeverinë demokratike popullore; kryengritja e përgjithshme e armatosur dhe krijimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, organizimi i ndihmës së

gjithanshme politike dhe ekonomike për luftën popullore, duke pësuar si burim vendimtar popullin e fshatit e të qytetit; shkatërrimi i pushtetit të pushtuesve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre (që përfaqësonin interesat e klasave kryesore shfrytëzuese të vendit), krijimi i pushtetit të këshillave nacionalçlirimtarë si i vetmi pushtet politik i popullit; përgatitja e gjerë politike dhe ideologjike e masave për kryengritjen e përgjithshme popullore dhe për vazhdimin e luftës edhe pas Çlirimit të vendit për mbrojtjen e fitoreve të arritura, për rindërtimin e vendit dhe për kryerjen e transformimeve të mëdha shoqërore-ekonomike në interes të popullit.

Fronti Nacionalçlirimtar i arriti të gjithë objektivat që i kishte caktuar Partia. Ai i zgjidhi me sukses të gjitha detyrat kryesore që përmbante programi i tij revolucionar. Kështu, lufta dhe jeta vërtetuan se sa drejt veproi Partia me krijimin e Frontit, se sa drejt e ndërtoi ajo vijën e Frontit, vijë që u përgjigjej dëshirave dhe aspiratave të popullit, që u përshatatej kushteve historike të vendit tonë.

Formimi i Frontit Nacionalçlirimtar ishte një goditje vdekjeprurëse për pushtuesit e huaj dhe për gjithë reaksionin e brendshëm që i kishte lidhur fatet me ta. Ata i tmerronin vrulli revolucionar i Luftës Nacionalçlirimtare, rritja e autoritetit të Partisë Komuniste dhe forcimi i bashkimit politik të popullit shqiptar në radhët e Frontit. Përballë kësaj gjendjeje forcat e reaksionit dhanë alarmin e rrezikut të madh që i kërcënonte. Ata shpallën në fillim krijimin e organizatës së Ballit Kombëtar dhe më vonë të Lega-

litetit, të cilat ia kundërvunë drejtpërdrejt Frontit Nacionalçlirimtar. Këto dy organizata, që u ngritën me përkrahjen e pushtesve italianë e gjermanë dhe me nxitjen e imperialistëve anglo-amerikanë, nuk ishin parti politike, por grumbullime heterogjene të forcave reaksionare të vendit, çifligarëve, tregtarëve të mëdhenj, intelektualëve borgjezë e klerikëve reaksionarë, të të gjitha fundërrinave të shoqërisë, që kishin bërë kauzë të përbashkët me pushtuesin.

Cili ishte qëllimi i këtyre organizatave? Me gjithë nuancat e tyre krejt të parëndësishme dhe me gjithë maskat e tyre pseudopatriotike e pseudonacionaliste, qëllimi i tyre i përbashkët ishte të likuidonin Partinë Komuniste, të shkatërronin Frontin Nacionalçlirimtar, të shuanin Luftën Nacionalçlirimtare, të siguronin për vete gjithë pushtetin politik pas lufte, për të ruajtur të paprekur sundimin e tyre mbi popullin. Politika e Ballit Kombëtar dhe e Legalitetit ishte aleanca me pushtuesit fashistë kundër Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe kundër aleancës antifashiste të shteteve dhe popujve që luftonin fashizmin. Për reaksionin dhe organizatat e tij tradhtarë kontradiktat kryesore u bënë kontradiktat e brendshme me Partinë Komuniste dhe Frontin Nacionalçlirimtar, të cilat ata i shndërruan në kontradikta antagonistë, duke na goditur me armë së toku me pushtuesit.

Partia jonë duke iu përmbajtur vijës së vet në Frontin Nacionalçlirimtar për bashkimin e të gjithë shqiptarëve në luftën kundër fashizmit «pa dallim feje, krahine dhe ideje», u përpoq dhe bëri gjithçka për të mos lejuar shndërrimin e kontradiktave me

Ballin dhe Legalitetin në kontradikta kryesore e antagonistë. Partia dhe Fronti u bënë atyre më se një herë thirrje për të luftuar së bashku kundër pushtuesve të vendit, u përpoqën t'u tregojnë atyre rrugën e drejtë, t'i largojnë nga rruga e tradhtisë, ta mënjanojnë vëllavrasjen. Por të gjitha këto përpjekje të shumta të Partisë dhe të Frontit u sabotuan nga reaksioni. Partia ishte e bindur se kështu do të ngjiste, pasi ajo e njihnte mirë karakterin kundërrevolucionar të këtyre organizatave, si përfaqësuese të interesave të çifligarëve e të borgjezisë. Por për këtë duheshin bindur edhe një pjesë e vogël e njerëzve, te të cilët në fillim kishte disa iluzione të ndryshme për karakterin e këtyre organizatave dhe për disa njerëz që merrnin pjesë në to si «patriotë». Edhe këta njerëz, të gabuar në fillim, duhej të bindeshin nga përvoja e tyre në zjarrin e luftës, se «patriotizmi» i krerëve të Ballit dhe të Legalitetit ishte kallp dhe thirrjet e tyre «patriotike» ishin fund e krye demagogjike dhe maskonin tradhtinë.

Guri i vetëm i provës ishte qëndrimi ndaj armikut të huaj që kishte pushtuar vendin. Partia dhe Fronti u kërkuan këtyre organizatave të hidheshin me të gjitha forcat dhe menjëherë, pa pritur «kur të vijë dita», në luftën pa rezerva dhe pa kompromis kundër pushtuesve italo-gjermanë. Konsekuentë në rrugën e tyre të tradhtisë, Balli dhe Legaliteti jo vetëm nuk hodhën asnjë pushkë kundër armikut pushtues, por u bashkuan kokë e këmbë me të në luftë kundër popullit. Jo vetëm kaq, por, kur pushtuesve fashistë po u vinte fundi, Balli dhe Legaliteti kaluan

hapur në shërbim të imperialistëve anglo-amerikanë, duke dashur që, me përkrahjen e këtyre, t'i rrëmbejnë popullit fitoret nga duart dhe të arrinin atë që s'e arritën dot me ndihmën e nazifashistëve. Kështu, u zbulua sheshit karakteri antipopullor e antikombëtar i çifligarëve dhe i borgjezisë, i intelektualëve borgjezë e i të tjerëve. Si rrjedhim, në vendin tonë lufta kundër pushtuesit fashist, lufta për çlirimin kombëtar, u gërshetua me luftën kundër bashkëpunëtorëve të pushtuesit, kundër klasave kryesore shfrytëzuese dhe organizatave të tyre politike — Ballit Kombëtar e Legalitetit. Kjo pati pasoja të mëdha revolucionare në zhvillimin e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë dhe në përfundimet e saj politike. Kjo i dha Luftës Nacionalçlirimtare karakterin e një revolucioni të thellë popullor dhe bëri që, bashkë me shpartallimin e pushtuesit, të shkatërrohen edhe organizatat tradhtarë, që, bashkë me çlirimin e atdheut, të përmbysen nga pushteti edhe klasat kryesore shfrytëzuese të vendit.

Merita e madhe e Partisë sonë dhe e Frontit Nacionalçlirimtar, ishte se luftën për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj nuk e ndanë kurrë nga lufta për marrjen e pushtetit nga ana e masave punonjëse. Rëndësia historike e Konferencës së Pezës nuk qëndron vetëm se aty u krijua Fronti Nacionalçlirimtar, por edhe se aty u hodhën themelet e pushtetit të ri popullor. Këshillat nacionalçlirimtarë, që u ngritën kudo në vendin tonë, lindën dhe u rritën edhe si organe demokratike e revolucionare të pushtetit popullor, nën udhëheqjen e vetme të Partisë Komuniste. Ata ishin

mohimi i të gjitha organeve dhe organizatave shtetërore antipopullore e shfrytëzuese. Pushteti i ri popullor u zgjerua dhe u forcua krahas me rritjen dhe me forcimin e luftës së armatosur. Kongresi i Përmetit dhe Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në Berat, që u mbajtën përkatësisht në maj dhe në tetor 1944, janë dy ngjarje të mëdha me rëndësi të jashtëzakonshme historike, në të cilat u plotësua vullneti i popullit për kalimin e gjithë pushtetit në duart e tij, për krijimin e shtetit të ri shqiptar, për ndërtimin e Shqipërisë së re demokratike e popullore. Kështu, që në prag të çlirimit të vendit problemi i pushtetit ishte zgjidhur në dobi të popullit.

Partia jonë ishte kurdoherë vigjilente dhe luftoi pa mëshirë çdo kapitullim e tradhti në të gjitha drejtimet. Ajo mbrojti me konsekuencë pavarësinë e saj politike e organizative, rolin e saj udhëheqës në Front dhe në Luftën Nacionalçlirimtare dhe nuk lejoi që drejtimin e luftës ta merrte në dorë borgjezia, gjë që ishte një ndër objektivat kryesorë të imperialistëve anglo-amerikanë dhe të organizatave tradhtare të Ballit e të Legalitetit. Partia e dinte se nënshtrimi ndaj borgjezisë, marrja në dorë e drejtimit të luftës nga borgjezia, do të sillte vetëm dështimin e revolucionit dhe ruajtjen e rendit të vjetër shtypës e shfrytëzues. Këtë qëllim kishte Mukja, këtu qëndronte kapitullimi i Ymer Dishnicës përpara borgjezisë. Prandaj Partia dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar e hodhën poshtë me vendosmëri mbledhjen e Mukjes si një akt tradhtie ndaj interesave të popullit e të

revolucionit, që i hapte rrugën kalimit të drejtimit të luftës dhe të pushtetit politik në duart e borgjezisë reaksionare, e cila, jo vetëm nuk pranonte të luftonte kundër pushtuesve fashistë, por kishte bashkëpunuar e bashkëpunonte me ta kundër popullit dhe luftës së tij.

Krijimi i Frontit dhe parulla për bashkimin në këtë organizatë e të gjithë atyre që ishin për luftën kundër pushtuesit, përbënin një nga detyrat kryesore taktike të Partisë për arritjen e qëllimit themelor strategjik të asaj kohe që ishte çlirimi i plotë i vendit dhe vendosja e pushtetit popullor. Jeta vërtetoi drejtësinë e kësaj vije, si dhe aprovimin e plotë të saj nga ana e popullit. Ajo, gjithashtu, vërtetoi rolin e madh e të pazëvendësueshëm që luajti Fronti Nacionalçlirimtar për bashkimin e popullit rreth Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, për mobilizimin e të gjitha energjive dhe aftësive krijuese të popullit në shërbim të çështjes së madhe të revolucionit.

3. — Roli i Frontit në luftën për ndërtimin e socializmit

Pas Çlirimit të vendit, në luftën për zhvillimin e revolucionit socialist dhe për ndërtimin e socializmit, Fronti vazhdon të punojë nën drejtimin e Partisë, si një organizatë demokratike e masave të gjera të popullit. Vija e Partisë në lidhje me Frontin ka qenë dhe është ajo e forcimit të vazhdueshëm të rolit të tij të madh për bashkimin e gjithë punonjësve në radhët e kësaj organizate, për edukimin e tyre në

frymën e patriotizmit, të dashurisë për atdheun dhe të mbrojtjes së lirisë dhe të pavarësisë së fituar, të mobilizimit të masave të popullit në luftën për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, të edukimit të tyre me ndjenjat e internacionalizmit proletar.

I armatosur me një përvojë të pasur dhe duke vazhduar traditat e tij të Luftës Nacionalçlirimtare, Fronti ka dhënë dhe jep një kontribut të madh në arritjen e të gjitha fitoreve të popullit tonë në luftën për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut. Direktivat e Partisë, që shprehin interesat jetësorë të punonjësve, kanë qenë dhe janë gjithnjë direktiva pune dhe lufte edhe për Frontin Demokratik, i cili ka gjetur e ka zhvilluar forma të ndryshme pune, organizimi dhe edukimi për t'i vënë ato në jetë e për t'i bërë realitet. Kudo e kurdoherë Fronti ka qenë ajo levë e fuqishme, me anën e së cilës Partia është lidhur gjithnjë e më ngushtë me masat, ka çuar në to vijën e saj të drejtë, i ka edukuar e i ka mobilizuar ato për vepra të mëdha e heroike.

Në zjarrin e madh të revolucionit, në luftën e madhe për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, Fronti është forcuar politikisht e organizativisht, ka çuar dhe ka zbatuar në gjirin e popullit mësimet e Partisë mbi luftën e klasave kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, mbeturinave feudale e patriarkale, zakoneve prapanike e paragjyqimeve fetare, kundër çdo gjëje që dobëson unitetin e popullit, aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë e inteligjencien popullore, që pengon përparimin e shoqërisë sonë drejt socializmit e komunizmit. Fronti

është një shkollë e madhe e edukimit politik të masave të popullit.

Fronti është organizata më e gjerë e masave që bën pjesë në sistemin tonë të diktaturës së proletariatit. Në këtë sistem hyjnë edhe të gjitha organizatat e tjera të masave, si: Bashkimet Profesionale, Bashkimi i Rinisë dhe Bashkimi i Grave. Këto organizata, bashkë me Frontin Demokratik, janë leva të Partisë për lidhjet e saj me masat dhe kanë luajtur e luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e vendit. Ato, duke pasur parasysh problemet dhe kërkesat e veçanta të punëtorëve, të rinisë dhe të grave, ndërtojnë punën e tyre politike, edukative e organizative në mënyrë që direktivat e Partisë të kuptohen dhe të zbatohen drejt nga të gjitha këto shtresa të popullsisë. Të gjitha organizatat e masave e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën, por asnjëra nga këto nuk mund të zëvendësojë punën e tjetrës. Çdo organizatë ka specifikën dhe rolin e vet në luftën për ndërtimin e socializmit. Në qoftë se organizatat e tjera kanë të bëjnë me shtresa të caktuara të popullsisë, Fronti Demokratik është organizata në të cilën realizohet bashkimi politik i të gjithë popullit. Anëtarët e organizatave të tjera, duke milituar në organizatat përkatëse, janë njëkohësisht edhe anëtarë të Frontit Demokratik dhe marrin pjesë gjallërisht në të gjitha debatet dhe aktivitetet që zhvillojnë organizatat e Frontit.

Prandaj, Fronti është mbështetja më e gjerë e Partisë dhe e pushtetit popullor dhe roli i tij edhe në etapën e sotme të ndërtimit të shoqërisë socialiste

jo vetëm nuk mbaron e nuk dobësohet, por bëhet edhe më i rëndësishëm.

Forca e vetme drejtuese dhe udhëheqëse në sistemin tonë të diktaturës së proletariatit është Partia e Punës. Pa Partinë dhe rolin e saj udhëheqës, ashtu si edhe organizatat e tjera të masave, Fronti nuk mund të ekzistojë si një organizatë me të vërtetë demokratike e popullore, që shpreh dhe mbron interesat e masave. Partia i frymëzon ato, bashkërendon punën dhe drejton gjithë veprimtarinë e tyre për t'i shërbyer qëllimit të madh — fitores së socializmit e të komunizmit.

Partia jonë ka hedhur poshtë dhe ka demaskuar predikimet e revizionistëve modernë, që mohojnë rolin udhëheqës të partisë në sistemin e diktaturës së proletariatit dhe në organizatat e masave, që predikojnë «pavarësinë» e organizatave të masave nga partia, që ngrihen kundër tezës së drejtë të Leninit e të Stalinit se organizatat e masave janë leva, rripa transmissioni, për lidhjen e partisë me masat. «Pavarësia» që kërkojnë revizionistët është false. Në shoqëri, sa kohë vazhdon lufta e klasave, asnjë njeri, e jo më organizatë, nuk mund të qëndrojë mbi klasat, mbi partitë, jashtë politikës dhe i pavarur nga politika. Pavarësia që kërkojnë revizionistët s'është gjë tjetër veçse pavarësi nga politika proletare, nga partia komuniste për të kaluar në varësi të plotë të politikës borgjeze e të partive borgjeze.

Vija e ndjekur nga Partia jonë në Front dhe përvoja jonë në këtë drejtim, me gjithë veçoritë që kanë

lidhje me kushtet konkrete historike të vendit, vërtetojnë edhe një herë disa mësimë themelore të marksizëm-leninizmit që janë të domosdoshme për të çuar përpara me sukses çështjen e çlirimit kombëtar, të revolucionit e të socializmit.

Edhe në përvojën e vendit tonë u provua se vetëm partia marksiste-leniniste, si pararojë e ndërgjegjshme dhe e organizuar e klasës punëtore, revolucionare konsekuente, besnike deri në fund ndaj parimeve ideologjike të doktrinës sonë, mund t'i çojë vendin dhe popullin në fitore, si në revolucionin nacionalçlirimtar e demokratik, ashtu edhe në revolucionin proletar e në luftën për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste. Si përvoja jonë, ashtu dhe përvoja e lëvizjes çlirimtare e revolucionare botërore provojnë se në etapën e imperializmit borgjezia dhe partitë e saj politike, për vetë natyrën e tyre klasore, nuk janë në gjendje dhe nuk mund t'i çojnë deri në fund as luftën kundër imperializmit për çlirimin e vërtetë kombëtar dhe as revolucionin demokratik e antifeudal. Predikimet e revizionistëve modernë hrushovianë, titistë e të tjerë, që mohojnë rolin udhëheqës të partisë proletare në revolucion e në ndërtimin socialist dhe që propagandojnë se mund të kalohet në socializëm edhe nën udhëheqjen e partive të tjera borgjeze e mikroborgjeze, bile edhe të sindikatave në shërbim të monopoleve kapitaliste, janë një tradhti e madhe ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit, klasës punëtore dhe çështjes së saj revolucionare.

Që të fitojë çështja e çlirimit dhe e revolucionit, është e nevojshme që partia marksiste-leniniste të

bashkojë nën udhëheqjen e saj të gjitha forcat revolucionare në një front të gjerë popullor. Në krijimin e fronteve të gjera popullore, partia komuniste marksiste-leniniste në asnjë mënyrë nuk duhet t'i vërë shpresat e t'i përqendrojë të gjitha përpjekjet tek aleancat e bashkëpunimi me krerët e partive dhe organizatave të ndryshme politike. Pa e lënë pas dore këtë punë, Partia e ka për detyrë t'ia kushtojë të gjithë kujdesin dhe forcat e saj luftës për krijimin e bashkimit të popullit nga poshtë, nëpërmjet një pune të gjerë, sqaruese e bindëse me masat dhe, sidomos nëpërmjet organizimit të aksioneve konkrete, të përgatitura e të menduara mirë.

Përvoja ka treguar se bërthama e frontit të bashkuar, baza e bazave, është aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse. Pa këtë aleancë nuk ka front popullor, nuk ka front nacionalçlirimtar. Këto janë dy forcat kryesore lëvizëse të çdo revolucioni të vërtetë të kohës sonë, që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së çdo vendi. Pra, që fronti të jetë me të vërtetë një organizatë e gjerë politike, luftarake e revolucionare, ai lipset të jetë, para së gjithash, një bashkim i masave të gjera të popullit, i arritur me luftë e nëpërmjet luftës dhe jo një bashkim i thjeshtë partish e aq më pak krerësh, i arritur mbi bazën e kombinacioneve të ndryshme politike.

Në kushtet e një revolucioni demokratiko-popullor dhe të luftës nacionalçlirimtare, kur ekzistojnë parti të ndryshme borgjeze e mikroborgjeze, partia komuniste mund dhe duhet të përpiqet për bashkëpu-

nim me to në kuadrin e një fronti të gjerë demokratik popullor ose nacionalçlirimtar. Në këto raste fronti ka specifikën e vet që e dallon atë nga Fronti Nacionalçlirimtar te ne, ku nuk kishte parti të tjera politike përveç Partisë Komuniste. Është e qartë se, kur partia komuniste shkon në luftë e në revolucion bashkë me parti të tjera përparimtare, asaj do t'i duhet të kapërcejë shumë vështirësi, qoftë për sigurimin e fitores në luftën çlirimtare, qoftë për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit nga etapa demokratike anti-imperialiste e antifeudale në etapën e revolucionit socialist. Këtë proces ajo nuk do ta kalojë aq lehtë dhe në atë mënyrë, siç e kaloi Partia jonë. Çështja është se kur partitë borgjeze e të ashtuquajtura socialiste do të shohin se interesat e klasave që ato përfaqësojnë dëmtohen ose rrezikohen, do të bëjnë dredhi të shumta politike, organizative e ushtarake për të dobësuar luftën çlirimtare, revolucionin, për të prishur aleancat, për të shkatërruar frontin e përbashkët dhe në mënyrë të veçantë për të minuar rolin udhëheqës të partisë komuniste në këtë front. Kjo është e lidhur me natyrën, pozitën dhe prirjet klasore të borgjezisë. Prandaj, duke ndjekur vijën e bashkëpunimit me shtresa të ndryshme të borgjezisë ose me partitë e tyre, partia komuniste duhet të zbatojë njëkohësisht edhe vijën e luftës kundër lëkundjeve e dredhive të tyre, kundër kompromiseve të tyre me forcat e pushtetit e të reaksionit. Të ndjekësh vetëm vijën e unitetit dhe të lësh pas dore vijën e luftës kundër veprimeve përçarëse e reaksionare në front, do të thotë të mbash një qëndrim oportunist,

me pasoja shumë të rrezikshme për luftën çlirimtare, për revolucionin.

Aktualisht, në arenën politike botërore, përveç partive borgjeze e socialdemokrate, tanimë të diskredituara, veprojnë edhe partitë revizioniste që kanë tradhtuar interesat e klasës punëtore dhe të çështjes së saj revolucionare. Ndaj këtyre partive forcat dhe partitë marksiste-leniniste duhet të bëjnë një luftë të pamëshirshme për të demaskuar tradhtinë e tyre, qëllimet e tyre kundërrevolucionare, për t'i shpartalluar ato si parti politike, duke u tërhequr njerëzit e bazës së tyre dhe pa bërë asnjë kompromis me to në parimet. Disa parti revizioniste do të bëjnë demagogji mbi luftën e armatosur, disa të tjera, nga e keqja se mos demaskohen, do të ndërmarrin sa për formë edhe ndonjë aksion. Marksistë-leninistët nuk duhet të mashtrohen nga këto taktika djallëzore, ata kurrë nuk duhet të konfundojnë dëshirën e masave për luftë me qëllimin sabotator të krerëve revizionistë. Prandaj vetëm me bazën, në zjarrin e luftës dhe për luftën revolucionare, është e vetmja rrugë kontakti dhe kjo për t'i neutralizuar dhe për t'i likuiduar revizionistët.

Duke ndjekur vijën e bashkëpunimit me partitë e tjera në revolucionin nacionaçlirimtar e demokratik, partia komuniste marksiste-leniniste është e domosdoshme të ruajë patjetër pavarësinë e saj të plotë ideologjike, politike e organizative si parti e klasës punëtore, të mos qëndrojë në hije apo në bisht të ngjarjeve, të mos shkrihet në asnjë mënyrë në front, por të luftojë për të siguruar rolin udhëheqës, të

luftojë për hegjemoninë. Në të njëjtën kohë është e nevojshme që ajo të mos harrojë për asnjë çast perspektivën e zhvillimit të revolucionit dhe arritjen e qëllimit të fundit. Partia e vërtetë marksiste-leniniste dhe revolucionarët e vërtetë duhet t'u qëndrojnë kurdoherë besnikë parimeve marksiste-leniniste, ligjeve të revolucionit proletar edhe në kushtet e luftës kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, revizionistëve modernë. Kurrë të mos i harrojnë këto parime dhe këto ligje, të mos bien në grackën e aventurave e të formave gjysmake revolucionare ose parullave boshe që gjoja u përshtaten «specifikave» të vendeve të ndryshme. Specifika të ndryshme ekzistojnë, ato duhen mbajtur kurdoherë parasysh, por këto specifika mund të shfrytëzohen drejt vetëm mbi bazën e parimeve themelore të marksizëm-leninizmit dhe ligjeve të revolucionit proletar. Çdo largim nga këto parime e ligje, në çfarëdo forme e preteksti që të bëhet, shpie në mënyrë të pashmangshme në disfatë për partinë dhe revolucionin.

Krijimi i frontit të gjerë popullor në asnjë mënyrë nuk duhet të shërbejë si bazë për përhapjen e iluzioneve oportuniste e reformiste se gjoja me anën e fitimit të shumicës në masa dhe në parlamentet borgjeze mund të bëhet automatikisht transformimi paqësor i rendit ekzistues, mund të sigurohen fitorja e revolucionit dhe kalimi në socializëm. Përkundrazi, fronti që krijohet në procesin e luftës revolucionare duhet t'u shërbejë çështjes së edukimit, bashkimit politik dhe mobilizimit të popullit për luftën e armatosur, për të përmbysur me forcë imperialistët, pu-

shtuesit, klasat reaksionare të vendit, të cilët, siç ka vërtetuar historia, kurrë nuk largohen vullnetarisht nga pozitat e tyre. Revolucioni me dhunë është një ligj i përgjithshëm jo vetëm i revolucionit proletar, por dhe i çdo revolucioni të vërtetë demokratik e çlirimtar të kohës sonë. Predikimet e revizionistëve hrushovianë e titistë mbi të ashtuquajturën rrugë paqësore, të cilën ata e kanë shpallur si një parim strategjik botëror, shkaktojnë vetëm disfatë për partinë e klasës punëtore, për revolucionin dhe socializmin.

Pasi është vendosur dhe është konsoliduar diktatura e proletariatit, e cila realizohet nën udhëheqjen e partisë komuniste, ekzistenca për një kohë të gjatë e partive të tjera, në front ose jashtë tij, qofshin këto dhe «përparimtare», nuk ka asnjë kuptim, asnjë arsye, qoftë dhe formalisht, gjoja për shkak të traditave të tyre. Çdo traditë përparimtare shkrihet me vijën revolucionare të partisë komuniste. Revolucioni përmbys një botë të tërë dhe jo më një traditë. Derisa lufta e klasave vazhdon gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të shoqërisë socialiste dhe të kalimit në komunizëm dhe meqenëse partitë politike shprehin interesat e klasave të caktuara, do të ishte absurde dhe oportuniste prania e partive të tjera jomarksiste-leniniste në sistemin e diktaturës së proletariatit, sidomos pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit. Kjo nuk e cenon aspak demokracinë, por, përkundrazi, forcon demokracinë e vërtetë proletare. Karakteri demokratik i një rendi nuk matet aspak me numrin e partive, por përcaktohet nga baza e tij ekonomike, nga klasa që është në fuqi, nga gjithë politika dhe

veprimtaria e shtetit nëse ajo është në interes të masave të gjera të popullit dhe nëse u shërben ose jo atyre.

Revizionistët modernë, për arritjen e qëllimeve të tyre kundërrevolucionare në shërbim të borgjezisë dhe të imperializmit, gjithnjë e më me zell po ecin në rrugën e degjenerimit të partive komuniste dhe të regjimeve socialiste. Ata po likuidojnë partitë e klasës punëtore, duke mohuar karakterin e tyre klasor proletar dhe duke i shpallur «parti të të gjithë popullit». Në fakt ata i kanë shndërruar ato në parti borgjeze të një tipi të ri. Degjenerimi i partive dhe i rendit socialist në disa vende ku janë në fuqi klikat revizioniste, po sjell ringjalljen e sistemit të dy ose më shumë partive borgjeze me maska pseudosocialiste dhe në emër të gjoja zhvillimit të demokracisë socialiste. Frontet që ekzistojnë në disa nga këto vende kanë mbetur në letër, janë pa jetë dhe që tani po duken shenjat e gjallërimit dhe të aktivizimit politik e organizativ të partive që bëjnë pjesë në këto fronte për të fituar pozita drejtuese e sunduese në shtetin socialist që po merr gjithnjë e më shumë tiparet e një shteti borgjez. Grupimet më ekstremiste të revizionistëve modernë, sidomos në vendet kapitaliste, si në Francë e Itali, po përpiqen t'u mbushin mendjen kolegëve të tyre revizionistë në vendet socialiste që ata të ecin sa më shpejt në këtë rrugë, për të dhënë edhe një provë tjetër para borgjezisë perëndimore se ata janë të gatshëm t'i japin fund «socializmit stalinist» e të rivendosin një «socializëm» të ri borgjez të tipit socialdemokrat dhe të lehtësojnë kështu punën

e revizionistëve në vendet kapitaliste për bashkimin dhe shkrirjen e tyre me borgjezinë dhe me partitë e saj politike, për të ndërtuar së bashku një rend të tillë «socialist» në këto vende.

Përvoja 25-vjeçare e Frontit Demokratik tregon se Partia jonë ka ndjekur kurdoherë një vijë të drejtë, ka mbrojtur e ka zbatuar me sukses parimet e marksizëm-leninizmit dhe ligjet e revolucionit proletar e të ndërtimit socialist. Kjo u ka siguruar Partisë dhe popullit tonë të gjitha fitoret e mëdha që ne gëzojmë sot. Përvoja e deritanishme tregon, gjithashtu, se Fronti mbetet edhe në ditët e sotme, siç e përcaktoi Kongresi i 5-të i Partisë, hallka kryesore e bashkimit politik të popullit rreth Partisë e pushtetit popullor për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, tribunë e madhe për sqarimin dhe edukimin e punonjësve me vijën e Partisë, mjet i fuqishëm për pjesëmarrjen aktive të masave të gjera punonjëse në drejtimin dhe zgjidhjen e problemeve të mëdha shoqërore e shtetërore.

II

DETYRAT AKTUALE TË FRONTIT DEMOKRATIK PËR TË VËNË NË JETË IDETË DHE VENDIMET E KONGRESIT TË 5-TË TË PARTISË

Kongresi i 5-të i Partisë përpunoi një program madhështor pune dhe lufte për të gjithë komunistët e punonjësit e vendit tonë. Realizimi i këtij programi

do të shënojë një hap të ri të rëndësishëm në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Fronti Demokratik, si organizata e bashkimit të popullit, që ka për qëllim të ndihmojë Partinë për plotësimin me sukses të programit të saj, ndodhet para detyrash shumë të rëndësishme politike, edukative, ekonomike e organizative.

1. — **Forcimi i bashkimit politik të popullit ka qenë e mbetet detyra themelore e Frontit Demokratik**

Një ndër burimet kryesore të forcës e të pathyeshmërisë së popullit tonë gjatë këtyre 25 vjetëve ka qenë kurdoherë bashkimi i tij politik rreth Partisë së Punës të Shqipërisë në Frontin Demokratik.

Baza ekonomiko-shoqërore e këtij bashkimi është sot prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit, janë marrëdhëniet socialiste në prodhim, që janë vendosur si në qytet, ashtu edhe në fshat; baza e tij politike është vija e përgjithshme e Partisë për ndërtimin e socializmit e për mbrojtjen e atdheut; ndërsa baza ideologjike është marksizëm-leninizmi, që udhëheq e frymëzon gjithë jetën e vendit tonë. Në themel të këtij bashkimi qëndron, si kurdoherë, aleanca luftarake e klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse.

Uniteti i popullit në Frontin Demokratik përbën një mur të pakapërcyeshëm ku kanë thyer kokën gjithë armiqtë e brendshëm e të jashtëm të atdheut tonë socialist. Ai u ka bërë ballë me sukses kërcënimeve,

shantazheve dhe kompleteve të vazhdueshme të imperialistëve të ndryshëm dhe armiqve të tjerë të vendit tonë. Vitaliteti i këtij bashkimi monolit u shfaq në mënyrë të shkëlqyer edhe një herë këto vitet e fundit, kur kundër Partisë dhe popullit tonë u vërsulën me të tëra mjetet dhe egërsinë e tyre edhe revizionistët modernë, me klikën hrushoviane të Bashkimit Sovjetik në krye. Populli ynë, i lidhur si mishi me thoin me Partinë e vet, i dërrmoi e i shpartalloi të gjitha kërcënimet, shantazhet, komplotet e bllokadat e revizionistëve, doli fitimtar dhe dha një shembull të shkëlqyer se si duhet qëndruar e luftuar kundër tradhtisë revizioniste.

Ky unitet i çeliktë shprehet çdo ditë në mënyrë më bindëse në aprovimin dhe në përkrahjen pa rezerva për politikën e Partisë nga mbarë populli ynë punonjës, në mobilizimin e tij të plotë për zbatimin e saj. Këtë unitet e shohim në rezultatet e shkëlqyera të zgjedhjeve për organet e pushtetit popullor të të gjitha hallkave, ku mbarë populli voton njëzëri për vijën e Partisë, për programin e Frontit Demokratik, e shohim në pjesëmarrjen aktive të masave të gjera punonjëse të qytetit e të fshatit në hartimin dhe në diskutimin e planeve të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, në mobilizimin e plotë të popullit për realizimin dhe tejkalimin e tyre. Atë e shohim në lëvizjet e mëdha masive të punonjësve për të revolucionarizuar tërë jetën e vendit, për të shkukur nga rrënjët zakonet, traditat dhe ndikimet e huaja, besimet e kota fetare dhe qëndrimet skllavëruese ndaj gruas. Ai u shfaq me forcë në gatishmërinë shembullore e patriotike, me të

cilën fshatarësia përqafoi iniciativat revolucionare për të përfunduar brenda një periudhe të shkurtër kolektivizimin e zonave malore dhe për të shkurtuar oborret personale në kooperativat bujqësore. Atë e tregon vrulli i lartë patriotik i mbarë popullit tonë në përgatitjen ushtarake dhe në forcimin e mbrojtjes së vendit. Ky unitet shfaqet pareshtur në të gjitha fushat e jetës sonë shoqërore, në çdo hap të luftës sonë për të çuar përpara revolucionin dhe ndërtimin socialist.

Duke e vlerësuar bashkimin politik të popullit si një fitore të madhe historike dhe si një forcë kolosale, në të cilën qëndrojnë pathyeshmëria jonë dhe garancia e të gjitha sukseseve tona, edhe në të ardhmen forcimi i mëtejshëm e i pareshtur i këtij bashkimi, përbën detyrën themelore, detyrën numër një të Frontit Demokratik.

Organizatat e Frontit nuk duhet ta quajnë asnjëherë të kapërcyer e të përfunduar problemin e bashkimit politik të popullit. Kalitja dhe forcimi i unitetit është një proces i vazhdueshëm, i lidhur me zgjidhjen e drejtë të kontradiktave shoqërore, sidomos të kontradiktave në gjirin e popullit, me zhvillimin e drejtë të luftës së klasave kundër kujtdo dhe çdo gjëje të huaj që pengon marshimin tonë fitimtar përpara. Jashtë luftës së klasave dhe pa luftën e klasave nuk mund të mendohen as kapërcimi i kontradiktave dhe as forcimi i unitetit. Ta marrësh çështjen e unitetit jashtë luftës së klasave, të mohosh gjoja për hir të këtij uniteti luftën e klasave dhe kontradiktat joantagoniste të shoqërisë socialiste, do të thotë të vësh në gjumë vigjilencën politike e ideologjike të Partisë e të

punonjësve, të minosh vetë unitetin dhe çështjen e socializmit. Prandaj organizatat e Frontit duhet t'i kenë mirë parasysh mësimet e Partisë mbi luftën e klasave dhe kontradiktat e shoqërisë sonë, t'i zbatojnë drejt ato me pjesëmarrjen aktive të vetë masave. Në luftën e përditshme ato duhet të bëjnë mirë dallimin e kontradiktave midis nesh e armiqve dhe të kontradiktave në gjirin e popullit, të mos ngatërrojnë popullin me armiqtë, sepse një gjë e tillë do të dëmtonte rëndë çështjen e unitetit dhe do të dobësonte lidhjet e Partisë me masat.

Partia, në çdo etapë të revolucionit e të ndërtimit tonë socialist, e ka bashkuar popullin në luftë për zbatimin e një programi të caktuar, për plotësimin e detyrave dhe për zgjidhjen e problemeve konkrete të kohës. Sot forcimi dhe kalitja e mëtejshme e këtij uniteti duhet të arrihen duke organizuar një punë të gjerë sqaruese e bindëse me masat për t'u shpjeguar atyre përmbajtjen politike e ideologjike të vijës dhe të direktivave të Kongresit të 5-të të Partisë, duke i mobilizuar ato për plotësimin me sukses të detyrave që shtroi ai në të gjitha fushat. Sa më mirë të njohin masat përmbajtjen ideopolitike të vijës dhe të detyrave të Partisë, sa më të larta të jenë ndërgjegjja politike dhe fryma e tyre patriotike revolucionare, aq më shpejt e më mirë do të kryhen detyrat tona, aq më i çeliktë do të jetë uniteti i popullit në Frontin Demokratik.

Shqipëria socialiste me pesëvjeçarin e katërt do të hedhë një hap tjetër të madh historik në rrugën e zhvillimit të saj revolucionar. Klasa jonë heroike pu-

nëtoje do ta zbkurojë atdheun me vepra të reja industriale. Një zhvillim të gjerë do të marrin industria e minierave, industria mekanike, elektrike, e ndërtime, industria ushqimore dhe e lehtë. Pesëvjeçari i katërt shënon një kthesë të rëndësishme në zhvillimin e industrisë së rëndë drejt ngritjes së degëve të reja të prodhimit të mjeteve të prodhimit, drejt zhvillimit të metalurgjisë e të industrisë kimike. Sa më e fuqishme të jetë industria jonë socialiste, aq më mirë bëhet ajo një bazë e sigurt për ecjen përpara të të gjithë ekonomisë me ritme të larta, aq më e pathyeshme, më e paprekshme bëhet pavarësia ekonomike e vendit, fuqia mbrojtëse e shtetit tonë të lirë e sovran.

Një ndryshim rrënjësor do të pësojë bujqësia jonë e kolektivizuar. Për të parën herë në historinë e vendit tonë fshatarësia jonë patriote, me ndihmën e fuqishme të shtetit socialist, duke zbatuar porosinë e Partisë, i ka dalë për zot detyrës jetësore kombëtare, për të siguruar bukën e popullit në vend. Perspektiva në këtë drejtim është e shkëlqyer. Intensifikimi i bujqësisë, vënia në jetë e kërkesave të agroteknikës, përhapja dhe zbatimi në shkallë të gjerë e përvojës shumë të çmuar përparimtare të kooperativistëve tanë, përçafimi me aq entuziazëm dhe zbatimi me aq vendosmëri i direktivës së Partisë për t'i kthyer malet e kodrat në toka pjellore — të gjitha këto, si dhe masa të tjera që parashikon plani i katërt pesëvjeçar, do ta çojnë me siguri bujqësinë tonë me hapa të shpejtë përpara.

Rritja e industrisë dhe e bujqësisë do të shoqërohet me një ngritje më të lartë e më të gjerë të ar-

simit, të arteve e të kulturës, me një përmirësim të mëtejshëm të mirëqenies së popullit, nevojat materiale të të cilit do të plotësohen edhe më mirë. Në mënyrë të veçantë do të përmirësohen kushtet e jetës shoqërore-kulturore të fshatit.

Organizatat e Frontit Demokratik duhet të bëjnë që çdo anëtar i Frontit t'i njohë konkretisht detyrat që shtron Partia për zhvillimin e ekonomisë, të zhvillojnë iniciativën e masave dhe të mobilizojnë energjitë e tyre për plotësimin e tejkalimin e planit të katërt pesëvjeçar. Arritja e këtij objekti kërkon në mënyrë të domosdoshme që organizatat e Frontit ta ngrenë në një shkallë më të lartë punën e tyre politike edukative, të gjejnë e të përdorin forma të reja më frytdhënëse të veprimtarisë së shumanshme me masat, të bëjnë me njerëzit një punë me durim e të diferencuar sipas shtresave, shkallës së kulturës, krahinës etj. për të cilën Fronti ka tradita shumë të mira, të krijuar qysh në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare.

Detyra të posaçme qëndrojnë sot para Frontit Demokratik për zhvillimin e një pune të madhe e të pandërprerë për ngritjen ideologjike të punonjësve, për përhapjen e gjerë të ideologjisë marksiste-leniniste në masat, për pastrimin e ndërgjegjes së njerëzve nga çdo gjë e huaj, e prapambetur dhe reaksionare, për edukimin e tyre me normat e moralit komunist, për të vënë në jetë thirrjen e Partisë «Të mendojmë, të punojmë e të jetojmë si revolucionarë».

Nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se pikërisht në frontin ideologjik armiku i klasës i përqendron sot goditjet e veta kryesore, me qëllim që t'i çoroditë

mendjet e njerëzve, të pengojë zbatimin e detyrave që shtron Partia, të përçajë e të minojë unitetin e popullit rreth Partisë dhe të përgatitë kështu terrenin për kundërrevolucion, për ndërhyrjen imperialiste, për rivendosjen e kapitalizmit.

Lufta për rrënjosjen dhe triumfin e plotë të ideologjisë proletare në ndërgjegjen e gjithë punonjësve përbën sot hallkën themelore dhe një drejtim tjetër kryesor të punës së Frontit Demokratik për forcimin e mëtejshëm të unitetit të popullit. Përvoja e fituar në këtë drejtim, sidomos format e përdorura kohët e fundit për zbërthimin dhe për zbatimin e direktivave të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit, duhen zhvilluar me guxim dhe duhen pasuruar më tej, duke pasur si synim unitetin ideologjik të popullit.

Mbrojtja e atdheut ka qenë e do të jetë për organizatën tonë të Frontit Demokratik çështje kapitale. Që Shqipëria të mbetet gjithmonë e lirë, sovrane, Shqipëri e popullit e për popullin, është detyrë e përditshme e çdo patrioti, e çdo anëtar i Frontit Demokratik të militojë si revolucionar për mbrojtjen e atdheut, të rrojë orë e çast me preokupacionin për të forcuar mbrojtjen e vendit, të jetë kurdoherë i gatshëm e të përgatitet ushtarakisht e fizikisht për mbrojtje. Çdo shqiptar në momentet sa të lavdishme, aq edhe heroike që kalon Republika jonë këtu në brigjet e Adriatikut, duhet të qëndrojë vigjilent në postin e tij luftarak të punës, në fabrikë apo në arë, në shkollë apo në kufi, duke mbajtur fort në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën.

Organizatat e Frontit Demokratik duhet të zhvillojnë në mënyrë sistematike një punë të dendur ideopolitike edukative për t'i rrënjosur edhe më thellë dashurinë dhe besnikërinë ndaj atdheut, për të mbajtur gjithnjë të gjalla e për t'i zhvilluar më tej traditat patriotike e revolucionare të të parëve tanë që nga epoka legjendare e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, në epopenë edhe më madhështore, më vigane të Luftës heroike Nacionalçlirimtare, deri në ditët po aq të lavdishme të ndërtimit socialist të vendit. Çdo organizatë fronti, në fshat apo në lagje të qytetit, le ta kthejmë në një vatër të edukimit patriotik të masave për lulëzimin dhe për mbrojtjen e atdheut, për të forcuar urrejtjen kundër armikut të klasës, kundër imperializmit dhe revizionizmit hrushovian e titist. Le t'i bëjmë traditat patriotike e revolucionare një burim të pashtershëm frymëzimi, sidomos për brezin e ri, për vepra të reja heroike në shërbim të atdheut e të popullit, të revolucionit e të socializmit!

2. — Roli i Frontit Demokratik për forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletariatit dhe për zgjerimin e demokracisë socialiste

Përvoja e vendit tonë të lirë e të pavarur ka treguar se pa diktaturën e proletariatit nuk mund të sigurohen fitoret e revolucionit, nuk mund të thyhen e të mposhten rezistenca dhe veprimtaria e armiqve të jashtëm e të brendshëm, nuk mund të garanto-

het mbrojtja e atdheut socialist, nuk mund të çohet përpara ndërtimi i shoqërisë socialiste e komuniste.

Fronti Demokratik, ashtu si dhe të gjitha organizatat e tjera të masave, ka luajtur një rol të madh dhe ka bërë një punë të gjithanshme për forcimin e vazhdueshëm të pushtetit popullor. Ai ka edukuar masat punonjëse të qytetit e të fshatit me frymën e dashurisë e të besnikërisë për pushtetin, i ka mobilizuar ato për të realizuar vendimet e ligjet e tij, i ka tërhequr gjithnjë e më shumë në veprimtarinë shtetërore e shoqërore.

Partia ka theksuar edhe herë të tjera se forcimi e demokratizimi i mëtejshëm i pushtetit popullor nuk mund të arrihen pa luftuar kundër burokratizmit dhe ka bërë vazhdimisht një luftë të vendosur kundër tij. Veçanërisht vitet e fundit ajo ka ndërmarrë një sulm në front të gjerë kundër shfaqjeve e shtrembërimeve burokratike në aparatet dhe në organet shtetërore të ekonomisë dhe të Partisë. Përfundimet e kësaj lufte janë mjaft të mira. Brenda një kohe relativisht të shkurtër u bë një punë kolosale dhe u morën një varg masash revolucionare që njihen prej të gjithëve. Rëndësi ka fakti se edhe këto masa të Partisë e të Qeverisë u mbështetën si kurdoherë fuqimisht nga punonjësit e vendit tonë dhe po realizohen me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë dhe aktive. Kjo i ka dhënë luftës kundër burokratizmit karakterin e një lëvizjeje të gjerë popullore me përmbajtje të thellë ideologjike. Thelbi i kësaj lufte është forcimi i diktaturës së proletariatit, për ta çuar deri në fund revolucionin tonë

socialist, për t'u prerë rrugën shfaqjeve revizioniste dhe çdo mundësie për rivendosjen e kapitalizmit në vendin tonë.

Por, në qoftë se i kemi dhënë një goditje të fortë burokratizmit, ne akoma nuk e kemi likuiduar atë dhe nuk e kemi mposhtur përfundimisht, prandaj nuk ka vend për t'u kënaqur me rezultatet e arritura. Një punë e madhe na pret për ta thelluar më tej lëvizjen revolucionare të luftës kundër burokratizmit.

Para së gjithash, Fronti Demokratik duhet të vazhdojë të zhvillojë një punë të gjerë e të gjithanshme sqaruese me masat e popullit për të kuptuar rrezikun real që përfaqëson burokratizmi tani e në të ardhmen për pushtetin popullor, për rendin tonë socialist dhe për fitoret e revolucionit, t'i bëjë të ndërgjegjshme për të qenë luftëtare të vendosura kundër tij. Të kuptohet mirë dhe nga të gjithë se lufta kundër burokratizmit është një luftë e gjatë dhe e shumanshme, se ajo është në radhë të parë një luftë ideologjike për të çrrënjësuar konceptet burokratike të drejtimit, për të edukuar e për të kalitur konceptet revolucionare që t'i përgjigjen plotësisht karakterit thellësisht popullor të pushtetit tonë. Vetëm kështu mund të luftohet me sukses kundër konceptit të ngushtë që e redukton luftën kundër burokratizmit në pakësimin e shkresave dhe të organikave dhe të mënjanohet praktika e luftës me fushata.

Kontrolli i masave të gjera të punëtorëve dhe të fshatarëve, i të gjithë popullit tonë mbi veprimtarinë e organeve dhe të njerëzve të pushtetit, është një nga kushtet më të rëndësishme për forcimin e për demo-

kratizimin e mëtejshëm të pushtetit popullor dhe për të luftuar me sukses burokratizmin.

Detyra e Frontit Demokratik është pikërisht që, nga njëra anë, ta organizojë e ta nxitë kontrollin e masave mbi organet shtetërore dhe njerëzit që punojnë në to dhe, nga ana tjetër, të zhvillojë një punë të gjerë ideopolitike e edukative, në mënyrë që funksionarët e nëpunësit, përfaqësuesit e popullit në organet shtetërore të të gjitha hallkave, ta ndiejnë kurdoherë veten shërbëtorë të popullit.

Por ç'do të thotë të jesh shërbëtor i popullit? Para së gjithash, kjo do të thotë t'i shërbesh popullit me besnikëri të madhe në bazë të vijës luftarake të Partisë sonë, të jesh punëtor i palodhur për zbatimin e vendimeve e të ligjeve në fuqi, që për asnjë rast të mos shpërdorosh për përfitime e privilegje vetjake besimin që të ka dhënë populli, por kurdoherë të jesh i drejtë e i sinqertë, i papajtueshëm me çdo shfaqje hatëri, miqësie dhe akrobllëku. Kjo do të thotë, gjithashtu, të jesh i sjellshëm dhe korrekt me popullin, jo vetëm gjatë shërbimit në punë, por dhe jashtë tij, të mbash lidhje të ngushta me masat e të dëgjosh me kujdes zërin e tyre, të mbash qëndrim parimor ndaj vërejtjeve e kritikave të popullit, të jesh i papajtueshëm me shfaqjet e arrogancës, të mendjemadhësisë e të fodullëkut. Më në fund, kjo do të thotë që kurdoherë e mbi të gjitha të vësh interesat e popullit, interesat e shoqërisë sonë socialiste, që këtyre t'u nënshtrosh interesat personalë, që për interesat e popullit të jesh i gatshëm për çdo sakrificë.

Çdo punonjës i pushtetit, cilido qoftë ky, duhet ta

shikojë veprimtarinë e tij dhe të luftojë në vetvete çdo gjë që bie në kundërshtim me funksionin e tij si shërbëtor i popullit. Me këtë sy ta shikojë edhe populli veprimtarinë e njerëzve të pushtetit. Mendimi se «ka kush e shikon punën e tyre» duhet flakur tej si një mendim i gabuar që frenon iniciativën e masave dhe atë të organizatave të Frontit Demokratik, për të organizuar e për të nxitur kontrollin e punonjësve. Asnjë kontroll tjetër nuk mund të zëvendësojë kontrollin e popullit të bashkuar në organizatën e tij të Frontit Demokratik. Prandaj, ky kontroll duhet të ushtrohet rregullisht me të gjithë forcën dhe në rrugë të drejtë, në mënyrë që t'u shërbejë përmirësimit e forcimit të pareshtur të punës nga të gjithë njerëzit dhe nga organet e pushtetit.

Si kanë punuar deri tani organizatat e Frontit në këtë drejtim? Në krahasim me të kaluarën ka disa përmirësime, por ato janë ende të pamjaftueshme. Ndërsa marrin pjesë aktive dhe luajnë një rol të dorës së parë gjatë fushatave të zgjedhjeve, organizatat e Frontit pak kujdesen për të ndjekur se si punojnë këta përfaqësues të popullit pasi zgjidhen, si i kryejnë detyrat dhe si e justifikojnë besimin e popullit. Ato pak kontribuojnë për t'i vënë këta njerëz nën kontrollin e masave, duke organizuar mbledhje të Frontit ku ata të japin periodikisht llogari para tyre, për t'i edukuar ato që të jenë kërkuese të rrepta ndaj njerëzve që kanë zgjedhur, që të përdorin me guxim kur e shohin të nevojshme edhe të drejtën e revokimit ndaj atyre përfaqësuesve që nuk tregohen të denjë dhe nuk e justifikojnë me punë besimin e masave. Më

të gjalla e më luftarake duhet të jenë organizatat e Frontit si tribuna nga të buçasë i fuqishëm zëri kritik i masave për çdo të metë e dobësi në punën e organeve shtetërore e të njerëzve që punojnë në to. Më me vendosmëri, guxim e rreptësi të luftojnë ato kundër kujtqo që nuk përfill masat dhe mbyt zërin e tyre.

Problemet e pushtetit janë probleme të mbarë popullit punonjës. Ato vendosen e zgjidhen jo nga disa këshilltarë e deputetë, aq më pak nga disa funksionarë të emëruar, por nga populli në fuqi. Këtë duhet ta kuptojmë mirë. Prandaj sa më e gjerë të jetë pjesëmarrja e masave punonjëse në veprimtarinë shtetërore, aq më mirë e aq më drejt do të studiohen e do të zgjidhen problemet. Në këtë drejtim një rol i madh i takon organizatës së Frontit Demokratik për të rritur pjesëmarrjen e masave në studimin e në zgjidhjen e problemeve të mëdha të pushtetit popullor, për t'i bërë masat sa më të ndërgjegjshme që të marrin pjesë aktive në qeverisjen e vendit. Pa këtë nuk mund të bëhet fjalë për forcimin dhe për demokratizimin e mëtejshëm të pushtetit të popullit, nuk mund të luftohet me sukses kundër burokratizmit.

«Burokratizmi, — thotë Lenini, — mund të luftohet deri në fund, deri në fitoren e plotë kundër tij vetëm atëherë, kur gjithë popullsia do të marrë pjesë në qeverisjen e vendit»¹.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 196.

Përvoja e shumë organizatave të Frontit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Tropojë, Mirditë, Korçë e gjetkë, që tërheqin rregullisht mendimin e masave për problemet e ndryshme të pushtetit, si: për çështjet e shërbimit komunal, të artizanatit, të shëndetësisë, të arsimit e të kulturës, deri te problemet e mbrojtjes së atdheut dhe i mobilizojnë për zgjidhjen e tyre të përdoret e të përhapet kudo.

Pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit kërkon, gjithashtu, që ato të marrin pjesë gjerësisht, si në hartimin e vendimeve dhe të ligjeve, që udhëheqin gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe rregullojnë jetën e shoqërisë sonë socialiste, ashtu edhe në mobilizimin për t'i vënë ato në jetë. Fronti Demokratik duhet të bëjë një punë të madhe për t'i njohur ligjet e shtetit dhe jo thjesht anën teknike, por kryesisht përmbajtjen politike e ideologjike të çdo ligji, ta edukojë popullin me frymën e respektit për ligjet e shtetit për të qenë i papajtueshëm me çdo shfaqje e shtrembërim burokratik në zbatimin e tyre.

Partia jonë gjithnjë ka luftuar me konsekuencë për zhvillimin dhe për forcimin e pareshtur të demokracisë së gjerë të masave të popullit dhe në këtë drejtim ne kemi arritur fitore të mëdha. Jo vetëm zgjedhjet, por edhe gjithë veprimtaria e organeve të pushtetit e të ekonomisë, të arsimit e të kulturës, gjithë jeta e vendit tonë zhvillohet në bazë të demokracisë socialiste.

Lufta kundër burokratizmit, që zhvillohet me sukses në vendin tonë, po spastron e po i hap rrugë zhvillimit më të madh të demokracisë proletare, po forcon

frymën revolucionare e popullore të saj, po e ngre atë në një shkallë më të lartë. Në kuadrin e kësaj lufte Fronti Demokratik të bëjë një punë të madhe që populli ta thotë fjalën e tij pa frikë për çdo gjë, sepse ai është zot i vendit dhe i pushtetit politik, se vullneti i tij është ligj për të gjithë e nuk mund të shkelet prej askujt. Organizatat e Frontit Demokratik në mbledhjet e tyre duhet t'i inkurajojnë diskutimet e gjera e të lira të popullit për çdo problem që i intereson dhe e preokupon atë. Veçanërisht ato të nxitin kritikën e hapët të masave, pa asnjë kufizim, kundër të metave e gabimeve. Kritika e masave në mbledhje ose me fletërrufe t'i fshikullojë pa mëshirë burokratët, indiferentët dhe cilindo që shkel direktivat e Partisë dhe ligjet e pushtetit popullor.

Duke forcuar kontrollin e masave nga poshtë mbi veprimtarinë e organeve të pushtetit dhe të aparateve të tyre, duke rritur pjesëmarrjen e popullit në qeverisjen e vendit dhe duke zhvilluar vazhdimisht demokracinë socialiste, ne do të thajmë çdo burim që ngjall burokratizmin, do t'i presim rrugën çdo shfaqjeje të lindjes së revizionizmit dhe çdo mundësie për rivedosjen e kapitalizmit në vendin tonë, do të forcojmë e do të demokratizojmë më tej pushtetin popullor, armën më të fuqishme në duart tona për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe për mbrojtjen e atdheut.

3. — Të rritim veprimtarinë e Frontit Demokratik për zgjidhjen e problemeve shoqërore

Fronti Demokratik ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve shoqërore. Ky rol vazhdimisht ka ardhur duke u rritur dhe ka marrë një zhvillim të ri, sidomos këto kohët e fundit. Nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, organizatat e Frontit, në bashkëpunim me ato të rinisë, të gruas e të bashkimeve profesionale, kanë organizuar në të gjitha rrethet e vendit shumë mbledhje e kuvende të gjera popullore, ku punonjësit tanë, të frymëzuar nga vija dhe nga vendimet e Partisë, kanë diskutuar gjallërisht probleme të mëdha shoqërore. Ato kanë dënuar zakonet prapanike, feudale e patriarkale që shtypin e skllavërojnë gruan, besimet dhe paragjykimet fetare, gjithçka të huaj, konservatore e reaksionare, që pengon vendosjen e marrëdhënieve të drejta në familje e në shoqëri, që pengon përparimin e vendit tonë.

Lëvizjet, iniciativat dhe zotimet e shumta që janë marrë në këtë drejtim kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, sepse problemet shoqërore janë probleme të mëdha e të ndërlikuara, si në qytet dhe aq më tepër në fshat. Ato kanë ligjet e veta të shkruara e sidomos të pashkruara, që shpesh shprehen në zakonet e ndryshme prapanike e të dëmshme, në normat e huaja për moralin tonë komunist. Këto janë tepër të rrezikshme e kryeneçe, i rezistojnë me këmbëngulje së resë dhe zhduken me vështirësi të madhe. Këto zakone e norma

kanë bazën e vet ekonomike, politike, ideologjike, fetare, etike, kanë rrënjët e tyre klasore që nga kapitalizmi e feudalizmi, bile edhe nga bajraku e fisi. Krijimi i marrëdhënieve të reja shoqërore, të bazuara mbi normat e moralit tonë komunist, nuk mund të arrihet pa luftuar zakonet e vjetra prapanike e reaksionare. Kjo luftë nuk mund të bëhet me sukses pa njohur thellë rrënjët e prejardhjen e tyre, pa zbuluar e pa demaskuar përmbajtjen e tyre klasore, pa treguar qartë dëmin dhe të këqijat e tyre. Këtu shtrihet një fushë e gjerë pune për organizatën e Frontit Demokratik.

Le të marrim, për shembull, problemin e emancipimit të gruas. Ky është një problem i madh për çdo vend, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tij. Por për vendin tonë ky problem merr një rëndësi të veçantë, për shkak të prapambetjes së madhe që trashëguam nga e kaluara, prapambetje që rëndonte më shumë te gratë, të cilat, në fakt, i nënshtroheshin një shtypjeje e skllavërimi të shumëfishtë nga klasat shfrytëzuese e të huajt dhe nga zakonet prapanike të kanuneve, të kishës e të sheriatit. S'ka dyshim se ne kemi arritur në këtë fushë fitore kolosale. Një revolucion i madh dhe i vërtetë është bërë në jetën e gruas shqiptare. Kjo doli nga errësira në dritë, nga skllavëria shtëpiake në jetën e madhe ekonomike, politike e shoqërore të vendit, nga pabarazia e thellë në barazinë e vërtetë të garantuar me ligj nga pushteti popullor. Nga një krijesë e përbuzur dhe e poshtëruar, ajo u bë një forcë e madhe, e nderuar dhe e respektuar në shoqërinë tonë të re socialiste. Tani Partia ka shtruar me forcë të madhe dhe ka vënë në rend të ditës luftën për çli-

rimin e plotë të gruas, për ta tërhequr atë plotësisht në prodhim dhe në tërë jetën politiko-shoqërore, për ta bërë gruan shqiptare të ndërgjegjshme e të aftë për të luajtur rolin që i përket në revolucion e në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Nuk është nevoja të ndalemi këtu me hollësi rreth problemeve të emancipimit të plotë të gruas. Ne kemi për këtë një program të madh pune e lufte, të përpunuar nga Partia. Materialet e Partisë për këtë çështje janë një armë e fuqishme në duart tona për ta kuptuar thellë dhe për ta zhvilluar drejt luftën për çlirimin e plotë të gruas. Tani gjithë çështja është si ta organizojmë konkretisht punën dhe ç'detyra qëndrojnë para organizatës së Frontit në luftën për emancipimin e gruas.

Fronti Demokratik ka meritat e tij të mëdha në luftën për emancipimin e gruas. Në radhët e tij militant gjatë Luftës Nacionalçlirimtare mijëra vajza e nëna shqiptare. Të frymëzuara nga një ndjenjë e lartë patriotike, revolucionare, ato nuk kursyen as jetën e tyre për Shqipërinë e lirë, për çlirimin e popullit, që ishte kusht i parë e i domosdoshëm për çlirimin edhe të vetë grave. Pas Çlirimit, Fronti Demokratik, gjithashtu, ka dhënë një kontribut të madh për emancipimin e plotë të gruas. Në mënyrë të veçantë është rritur roli i tij këto kohët e fundit. Thirrja e Partisë «Gjithë vendi e populli të ngrihen në këmbë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave tona», u përkrah aktivisht nga Fronti Demokratik, i cili zhvilloi e po zhvillon një punë të gjerë e të frytshme në këtë drejtim.

Organizatave të Frontit e kanë bërë problemin e gruas problem të të gjithë shoqërisë. Me iniciativën e Frontit dhe në bashkëpunim me organizatat e tjera, në disa rrethe, si: Pukë, Gramsh, Lezhë, Mat etj., janë prishur qindra fejesa të miturish ose fejesa me ndryshim të madh moshe. Në Tepelenë, në Librazhd e në rrethe të tjera organizatat e Frontit kanë ndër-marrë aksione e masa të ndryshme për lehtësimin e gruas nga punët e shtëpisë, për heqjen e ngarkesës së grave, për ndërrimin e veshjes së rëndë e të papërshtatshme etj. Tani organizatat e Frontit po tregojnë më tepër kujdes për tërheqjen e sa më shumë grave në aktivitetet politike, shoqërore e kulturore. Në organet lokale të pushtetit janë zgjedhur në të gjitha instancat e tij afro 11 000 gra e vajza, ndërsa në kryesitë e organizatave të Frontit mbi 10 000 gra e të reja.

Të gjitha këto flasin për një kthesë pozitive në punën e Frontit Demokratik për emancipimin e plotë të gruas. Por duhet të jemi të ndërgjegjshëm se ky është vetëm fillimi i një lufte të madhe që duhet të bëjmë akoma për ta arritur këtë objektiv. Nuk duhet harruar për asnjë çast ajo që theksoi me forcë Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të Partisë, se në kushtet e sotme të vendit tonë, kur ne kemi likuiduar pronën private dhe klasat shfrytëzuese, kur kemi vendosur kudo marrëdhëniet socialiste në prodhim, kur gruaja ka fituar me ligj të gjitha të drejtat e barabarta me burrin dhe për të janë hapur të gjitha dyert për arsim e kulturë, për pjesëmarrje aktive në tërë jetën e vendit, ato që na pengojnë më shumë se çdo gjë tjetër në emancipimin e plotë të gruas janë konceptet, normat e

zakonet prapanike, borgjeze e feudale, patriarkale e fetare. Këto koncepte janë të rrënjosura thellë në radhë të parë te burrat, prandaj problemi i emancipimit të gruas nuk është punë vetëm e organizatës së gruas. Këtu del në pah roli vendimtar i organizatës së Frontit Demokratik, si organizata që përfshin në radhët e veta tërë popullin. U përket, në radhë të parë, organizatave të Frontit që, nën udhëheqjen e Partisë, të marrin seriozisht në duart e veta problemin e emancipimit të plotë të gruas, si një nga problemet më jetësore të shoqërisë sonë dhe t'u bëjnë një luftë të pamëshirshme koncepteve, normave e zakoneve të huaja, që e poshtërojnë dhe e skllavërojnë akoma gruan, që e pengojnë atë të zërë plotësisht vendin që i përket në shoqërinë tonë socialiste.

Duhet të bëhet e qartë se kjo nuk është çështje e një fushate që mund të zgjidhet me një ose disa mbledhje të Frontit, por një luftë e gjatë, e përditshme, e ndërlëkuar e delikate që ka të bëjë me transformimin e botës së brendshme të njerëzve.

Krahas punës ideopolitike ne duhet të tregojmë një kujdes të vazhdueshëm për marrjen e masave konkrete ekonomike, organizative e administrative, që kanë të bëjnë me çlirimin e gruas nga skllavëria e punëve shtëpiake dhe me krijimin e kushteve materiale për pjesëmarrjen e saj më të gjerë në prodhimin shoqëror e në tërë jetën politike shoqërore.

Një fushë tjetër jo më pak e rëndësishme për Frontin Demokratik është puna e madhe që duhet të bëjë ai për një jetë më të kulturuar, sidomos në fshat, për çështjet e higjienës, për problemet komunale, për

përhapjen e arsimit e të kulturës, për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Për të gjitha këto çështje Fronti ka në dorë një program të madh, të hartuar nga Plenumi i Qershorit i vitit 1963 i Komitetit Qendror të Partisë. Në bazë të detyrave që shtroi ky Plenum, Fronti ka bërë deri më sot një punë të frytshme në çdo rreth. Por, megjithatë, ne shohim se detyrat e këtij Plenumi nuk janë zbatuar si duhet. Shumë organizata të Frontit morën në fillim vendime të mira, të drejta, përcaktuan detyra konkrete, por, për fat të keq, shumë prej tyre kanë mbetur në letër. Më mirë është punuar për këto probleme në zonat fushore, ku edhe përfundimet janë më të mëdha. Më dobët është punuar në zonat malore e të thella, ku ndryshimet e bëra janë më të vogla e krejt të pamjaftueshme. Në këto dobësi kanë ndikuar shumë edhe stili e metoda burokratike e administrative në punë, disa çështje nuk janë kuptuar sa duhet politikisht, ato nuk janë bërë aksione të masave, nuk është mbështetur dhe nuk është zhvilluar si duhet iniciativa e tyre.

Tani kërkohet që për këto probleme të bëhet një kthesë rrënjësore, të vlerësohen drejt ato si probleme të mëdha shoqërore që kanë të bëjnë me jetën e popullit, të organizohet më mirë puna dhe të tërhiqen vetë masat për zgjidhjen e tyre, të vihen para përgjegjësisë organet shtetërore dhe ekonomike, që secili t'i kryejë si duhet detyrat e veta.

Kujdes i veçantë duhet treguar sidomos për zonat malore, të cilat për shumë arsye, historike, shoqërore e natyrore, kanë mbetur më prapa nga zonat fushore. Tani ka ardhur koha dhe janë krijuar edhe kushte që,

pa lënë pas dore punën në zonat fushore dhe duke e pasur të fortë këtu gjendjen ekonomike, shoqërore e kulturore, të rritim kujdesin për malet dhe të fitojmë sa më parë kohën e humbur në malësi.

Është e domosdoshme që ndihma shtetërore e caktuar për malësitë të ketë prioritet në të gjitha drejtimet, që brenda kuadrit të mundshëm të plotësohen në radhë të parë nevojat e zonave malore në Jug dhe sidomos në Veri. T'i përgjigjemi më mirë etjes së madhe të popullit të malësisë për edukim, arsim e kulturë, për përhapjen e librit e të shtypit. Atje të dërgojmë kuadrot më të mirë, më heroikë e më të zhvilluar të Partisë dhe të pushtetit, mjekët, mamitë, infermierët më të zotë, agronomët, zooveterinerët dhe teknikët e mesëm më të mirë, mësuesit më të aftë. Të merren masa të shpejta dhe të efektshme për zhvillimin e tregtisë dhe të artizanatit në këto zona, pavarësisht nëse ka apo jo rrugë, nëse ka apo jo dëborë. Të shtohen përpjekjet për lidhjen e fshatrave malore me rrugë automobilistike, për zgjerimin e elektrifikimit, për higjienën dhe për gjithë shërbimet komunale.

Problemet politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e organizative në zonat malore duhet t'i kuptojmë, thellë politikisht dhe t'i bëjmë ato një aksion shumë të madh e të vazhdueshëm për gjithë Partinë, shtetin, për organizatat e masave, të bazës dhe të qendrës dhe, në radhë të parë, për Frontin Demokratik. Kudo të sundojë një frymë e lartë revolucionare, të kapërcehet me guxim çdo pengesë e vështirësi, të thyhen konceptet prapanike se «mali s'kthehet dot në fushë», të hidhen poshtë të gjitha justifikimet se «nuk i bëjmë

dot të gjitha përnjëherësh». Ne duhet të punojmë me besim të patundur në kthesën vendimtare për zhvillimin e gjithanshëm të malësive tona, sepse këtu jetojnë, punojnë e luftojnë njerëz të mrekullueshëm, patriotë të flaktë, besnikë të Partisë, të vijës së saj të drejtë, të zgjuar dhe të etshëm për përparim, që kanë shpërthyer si vullkan dhe po bëjnë mrekulli në zbatimin e vijës së Partisë.

Detyra e madhe e Frontit Demokratik është të zhvillojë një punë të gjerë bindëse me masat fshatare të malësive, t'i ngrejë peshë, të forcojë në to ndërgjegjen dhe besimin se me fjalën e Partisë në zemër ata janë në gjendje të çajnë malet, të kapin qiejt e jo më të mos zhdukin prapambetjen dhe të rrënjoshin të renë, mënyrën socialiste të jetesës. Ne jemi të ndërgjegjshëm për vështirësitë që kemi dhe që do të hasim akoma në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit të malësive tona, por kemi plotësisht të drejtë të jemi optimistë. Ç'po ngjet me vajzat e malësisë në hekurudhë, në këtë shkollë të madhe revolucionare të rinisë sonë heroike? Ato venë në hekurudhë të turpshme, të ndrydhura, të mbyllura, me një barrë zakonesh e konceptesh që u janë qepur si ferra pas trupit. Kurse pas dy muajsh, e theksoj: vetëm pas dy muajsh, në to bëhet një ndryshim kolosal, kryhet një hop cilësor, ato largohen nga hekurudha zjarr, plot ndjenja të pastra e frymë të lartë revolucionare, të cilën e shpien, si luftëtare të së resë, deri në skajet më të largëta e më të thella të atdheut tonë.

Për problemet e fshatit, sidomos për ato shoqërore e kulturore, Fronti Demokratik duhet të aktivizojë më

mirë gjithë inteligjencien e fshatit dhe veçanërisht arsimtarët, të cilët përbëjnë një armatë të madhe, një forcë kolosale për të përhapur atje kudo të renë, përparimtarë. Të gjithë ne jemi në dijeni të iniciativës revolucionare që morën arsimtarët e Mirditës e të Kolonjës dhe për rezultatet e arritura prej tyre. Kjo iniciativë është përhapur tani në të gjitha rrethet e vendit. Detyra jonë është të thellojmë dhe të tërheqim në të jo vetëm të gjithë arsimtarët, por edhe gjithë inteligjencien tjetër të fshatit e të qytetit. E theksojmë këtë sepse ka akoma edhe ndërmjet arsimtarëve nga ata që këmbët i kanë në fshat e kokën në qytet, që mbyllen brenda mureve të shkollës dhe nuk duan të dinë se ç'bëhet jashtë saj, që nxënësve u mësojnë vetëm abëcënë dhe pak ose aspak interesohen për të tjerat, që janë ambientuar me zakonet prapanike e papastërtinë, që jo vetëm nuk janë në pararojë, por shpesh qëndrojnë në pozita prapanike, të cilët, për çdo gjë të huaj që shohin, rrinë me gojë mbyllur, duke menduar se e kanë kryer detyrën vetëm sepse u kanë mësuar fëmijëve historinë e romakëve.

Partia dhe populli ynë kanë respektin më të madh për mësuesit dhe për punën e tyre fisnike, pavarësisht nga kritikën që ne u bëjmë atyre pak mësuesve që lënë pas dore detyrën e tyre të shenjtë të edukatorit të rinisë dhe të popullit. Qëllimi është që mësuesit dhe mësueset të mos harrojnë kurrë misionin e tyre fisnik, sidomos në fshat, por ta kryejnë atë duke mos njohur asnjë tërheqje, sepse kush tërhiqet është dezertor, duke thyer çdo vështirësi e pengesë, sepse kush thyhet është kapitullant, duke dhënë dhe jetën, po që nevoja,

siç e dha mësuesi hero i Mirditës, Ndrec Ndue Gjoka.

Problemet shoqërore e kulturore janë të mëdha e të shumta. Si gjithë çështjet e tjera, edhe ato mund të zgjidhen me sukses kur bëhen të masave, kur tregohet më shumë iniciativë e frymë revolucionare. Në bazë ka mundësi kolosale për të bërë me forcat e veta vepra të mëdha. Në këtë drejtim ka shumë shembuj pozitivë. Në mjaft rrethe e kooperativa bujqësore janë marrë iniciativa të mira për zgjerimin e hapjes së furrave kolektive, për ndërtimin e banjave e të lavanderive, për rregullimin e çezmave të ujit të pijshëm, për ngritjen e punishteve të ndryshme, për zgjerimin e artizanatit në fshat, për shtrirjen e rrjetit elektrik, për hapjen e rrugëve të reja automobilistike etj., etj. Këto iniciativa duhet të bëhen të njohura dhe të përhapen kudo, sepse kudo, me një punë të mirë edukative, organizuese e mobilizuese, mund të bëhen shumë punë të mëdha e të dobishme. Në këtë drejtim pikërisht Frontit Demokratik i takon një rol i dorës së parë.

Një problem i madh shoqëror e ideologjik është lufta për çrrënjosjen e paragjyqimeve fetare dhe të zakoneve prapanike që janë të gërshetuara midis tyre. Te ne feja nuk mundi të zhvillohej në formën e një botëkuptimi filozofik të stërholluar, por ajo është pleksur ngushtë me zakonet, traditat dhe mënyrën e jetesës, ka futur helmin e saj në gëzimet e hidhërimet, në të gjitha shfaqjet e përditshme të jetës së njeriut, që nga lindja e tij dhe deri në vdekje. Feja është munduar që çdo gjë, çdo ngjarje në jetën e njeriut, ta veshë me petkun e saj mistik e reaksionar. Këto prak-

tika të fesë janë futur jo vetëm në jetën e atyre që besojnë, por bile edhe të atyre që nuk besojnë, të cilët i zbatojnë ato nganjëherë pa i ditur dhe pa i kuptuar. Prandaj, pa luftuar këto praktika të fesë dhe të gjitha dogmat, mbi të cilat ato bazohen, nuk mund të çrrënjosen zakonet e traditat e vjetra prapanike dhe nuk mund të vendosen plotësisht normat e reja në jetën tonë, marrëdhëniet e reja shoqërore socialiste.

Në këtë drejtim kohët e fundit, sidomos pas Kongresit të 5-të të Partisë, ka shpërthyer një lëvizje e madhe, që po zhvillohet në front të gjerë në qytet e në fshat, në të gjitha shtresat e popullit dhe që dallohet nga aksione goditëse e të drejtpërdrejta jo vetëm kundër botëkuptimit reaksionar e antishkencor fetar, por edhe kundër festave, ceremonive e riteve fetare, si edhe kundër vetë bazës materiale të fesë. Tipari më i rëndësishëm i kësaj lëvizjeje është se ajo filloi me iniciativën e vetë masave dhe po zhvillohet e po thellohet me pjesëmarrjen aktive të tyre, të cilat, në procesin e jetës dhe të luftës së tyre, po binden gjithnjë e më mirë për kotësinë dhe dëmin e besimeve fetare.

Lufta kundër fesë e zakoneve prapanike, në të cilën një rol të madh ka luajtur e luan organizata jonë e Frontit Demokratik, është një nga drejtimet e rëndësishme të revolucionit ideologjik e kulturor. Në këtë fushë, në vendin tonë, po kryhet një hop i madh revolucionar i paparë deri më sot. Ky nuk është as i rastit, as erdhi vetvetiu. Ai është rezultat i transformimeve të mëdha social-ekonomike, që janë bërë në jetën e vendit, i vijës së drejtë të Partisë për ndar-

jen e kishës nga shteti dhe të shkollës nga feja dhe i punës shumëvjeçare që kanë bërë Partia, shteti, Fronti Demokratik dhe të gjitha organizatat shoqërore për përhapjen e arsimit e të kulturës dhe për edukimin e masave në frymën e ateizmit. Në tërë qëndrimin e saj ndaj fesë Partia i është përmbytur parimit marksist-leninist se botëkuptimi fetar dhe botëkuptimi komunist janë të kundërt, të papajtueshëm dhe në luftë midis tyre, sepse shprehin e mbrojnë interesat e klasave të ndryshme antagoniste. Ajo gjithnjë luftën kundër ideologjisë fetare ia ka nënshtuar luftës për çlirimin e punonjësve nga shtypja sociale e shfrytëzimi ekonomik dhe për arritjen e qëllimit të saj nuk ka lejuar përdorimin e masave administrative, por në themel të punës së vet ateiste ka vënë metodën e bindjes dhe të edukimit të masave.

Sukseset që janë arritur në luftën kundër ndikimeve të fesë dhe bazave të saj janë të lidhura edhe me faktin se populli ynë nuk ka qenë dhe nuk është aq fanatik dhe i lidhur me fenë, e cila gjithmonë ka qenë në kundërshtim me aspiratat dhe me luftën e tij çlirimtare. Të gjitha fetë, që ekzistojnë te ne, janë sjellë në Shqipëri nga pushtuesit e huaj dhe u kanë shërbyer atyre e klasave sunduese e shfrytëzuese të vendit. Nën petkun e fesë, të perëndisë e të profetëve, fshihej ligji i egër i pushtuesve të huaj dhe i shërbëtorëve të tyre brenda vendit. Historia e popullit tonë dëshmon qartë se ç'vuajtje, ç'mjerime, ç'gjakderdhje e ç'shtypje ka pësuar populli ynë nga feja, si e përçante ajo, si vinte në luftë vëllanë kundër vëllait që pushtuesi të na shtypte më mirë, të na ro-

bëronte më lehtë dhe të na pinte gjakun në emër të fesë. Prandaj asgjë e mirë nuk na lidhte e nuk na lidh me fenë, me praktikat e saj, jo vetëm si ateistë, por edhe si patriotë shqiptarë. Gjatë përpjekjeve të popullit tonë për liri ka pasur edhe klerikë patriotë, që, edhe pa e mohuar haptazi besimin e tyre, kanë qenë të lidhur me popullin dhe me idenë e çlirimit kombëtar. Por feja si fe, si ideologji, në asnjë kohë nuk ka qenë te ne një faktor jo vetëm përparimtar, por as të ketë dhënë ndihmën më të vogël për çështjen e popullit e të çlirimit të tij kombëtar. Për pasojë, u desh vetëm një shkëndijë e lëshuar nga nxënësit revolucionarë të shkollës «Naim Frashëri» në Durrës, të frymëzuar nga mësimet e Partisë, që të ndizej ai zjarr i madh, që fshiu nga faqja e dheut vatrat e obskurantizmit fetar.

Me gjithë sukseset e mëdha të arritura në luftën kundër zakoneve, traditave e normave të vjetra, kundër besimeve të kota e botëkuptimeve fetare, në asnjë mënyrë të mos kënaqemi e të flemë mendjen. Ato kanë akoma rrënjë të thella dhe ushtrojnë ndikimin e tyre në një pjesë të popullit tonë, sidomos te të moshuarit. Të luftohet koncepti i gabuar se feja është kisha, xhamia, prifti, hoxha, ikona etj. dhe se, po u zhdukën këto, u zhdukën automatikisht edhe feja e ndikimi i saj në popull. Ne duhet të jemi realistë. Lufta kundër zakoneve, traditave, normave të vjetra, kundër botëkuptimeve fetare, të rrënjosura për shekuj në jetën dhe në ndërgjegjen e njerëzve, nuk ka marrë fund. Kjo është një luftë e gjatë, e ndërlikuar dhe e vështirë. Prandaj puna jonë eduka-

tive bindëse, propaganda jonë ateiste të vazhdojnë pa ndërprerje për të konsoliduar fitoret e arritura, për të zbatuar zotimet që janë marrë në mbledhjet e në kuvendet popullore, për të çuar përpara pa ndërprerje luftën kundër asaj që është e huaj dhe e dëmshme për çështjen tonë, për të rrënjosur në njerëzit botëkuptimin tonë të ri, revolucionar, marksist-leninist, shprehitë, zakonet dhe normat e reja socialiste.

Me gjithë këtë punë ne duhet të kemi vazhdimisht parasysh porosinë e Partisë se kemi të bëjmë me ndjenjat e popullit, me njerëzit tanë, të lidhur me Partinë e patriotë të flaktë, që do të ruajnë në ndërgjegjen e tyre edhe për shumë kohë, mundet edhe derisa të vdesin, zakonet e konceptet e vjetra dhe besimet e tyre fetare. Puna me ta të jetë një punë bindëse e vazhdueshme dhe me durim të madh. Puna e Partisë dhe e Frontit me këta njerëz të jetë si ajo e një mjeku të mirë që bën të gjitha përpjekjet për ta shëruar të sëmurin, për ta kthyer atë në gëzimet e jetës. Prandaj të mos lejohet asnjë veprim arbitrar, i ngutur e i pamatur. Për çdo hap që ndërmerret, të përgatitet mirë më parë terreni politik e ideologjik.

Nga ana tjetër, Partia dhe Fronti Demokratik duhet të mendojnë e të punojnë seriozisht, duke nxitur e duke përkrahur aktivisht çdo iniciativë, çdo gjë të re, që synon në vendosjen e normave, zakoneve dhe festave tona të reja popullore që t'i përshtaten jetës së re që po ndërtojmë. Zhdukja dhe kufizimi i shumë festave, ceremonive e zakoneve të vjetra kërkojnë

që ato të zëvendësohen patjetër me të reja. Duke mohuar të vjetrën, ne duhet të afirmojmë patjetër të renë, ndryshe e vjetra ngjallet e përtërihet përsëri. Të mos lejojmë të krijohet asnjë boshllëk në jetën e popullit. Kjo ka rëndësi të madhe. Zakonet, doket, ceremonitë e festat e ndryshme janë një pjesë e pandarë e jetës së popullit, të cilën ne duhet ta bëjmë gjithnjë më të pasur, më të begatshme, më të gëzueshme e më të larmishme.

Pra, lufta për të çrrënjosur çdo gjë të huaj, konservatore, reaksionare e borgjeze, feudale e patriarkale, të trashëguara nga shoqëria e vjetër shfrytëzuese, lufta për të renë, përparimtarë, për atë që është revolucionare dhe e kohës, për ta përkratur, për ta përhapur e për ta rrënjosur atë në mendjen dhe në psikologjinë e njerëzve, në zakonet, në normat dhe në rregullat e jetës sonë shoqërore, përbën një ndër detyrat themelore e të përhershme të Frontit Demokratik. Kjo është luftë për të çuar përpara pareshtur revolucionin ideologjik e kulturor drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, për të konsoliduar rendin tonë socialist dhe fitoret e arritura.

4. — **Ta gjallërojmë më tej organizatën e Frontit Demokratik, të rritim frymën e saj luftarake e vetëvepruese**

Detyrat e mëdha që ne po shtrojmë në këtë Kongres nuk mund të kryhen me sukses pa forcimin organizativ të Frontit Demokratik, pa gjallërimin e

mëtejshëm të jetës së tij, pa rritjen e frymës luftarake e vetëvepruese të të gjitha organeve dhe organizatave të Frontit, pa përmirësuar vazhdimisht metodën dhe stilin e tyre në punë.

Partia ka ngritur me forcë të madhe, sidomos këto vitet e fundit, thellimin e vijës së masave, që ka qenë gjithmonë vija e patundur e Partisë sonë, si në luftën çlirimtare, ashtu edhe në ndërtimin socialist. Në Frontin Demokratik dhe në organizatat e tjera shoqërore gjen mishërimin e vet zbatimi i vijës së masave. Prandaj nuk mund të kuptohen zbatimi e thellimi i kësaj vije pa forcimin dhe gjallërimin e mëtejshëm të të gjitha organizatave, në mënyrë të veçantë të organizatës së Frontit, si organizata më masive, pa rritjen e rolit dhe zhvillimin e veprimtarisë së gjithanshme të saj.

Që Fronti të luajë si duhet rolin e tij të madh politik, ai duhet të jetë një organizatë e gjallë luftarake e revolucionare. Kjo varet shumë nga problemet që shtrohen në organizatat e Frontit dhe nga mënyra se si diskutohen e zgjidhen ato. Shpesh mbledhjet e Frontit janë bërë të mërzitshme dhe formale, sa për të kaluar radhën. Kjo ka ndodhur sepse mbledhjet nuk janë përgatitur mirë, në to nuk janë shtruar ato probleme që preokupojnë popullin, ose janë shtruar në një mënyrë shumë të përciptë, me fraza të përgjithshme, pa kritikë e autokritikë, pa vendime e masa konkrete. Kjo vjen, sepse në shumë njerëz ka një kuptim shumë të ngushtë për detyrat e Frontit. Kuptohet sikur detyrat e vetme të Frontit janë puna vullnetare dhe fushatat e zgjedhjeve të organeve të ndry-

shme të pushtetit. Këtej buron edhe e meta tjetër që disa njerëz, ndërmjet tyre edhe ndonjë komunist, i nënvleftësojnë mbledhjet e Frontit.

Këtyre fenomeneve negative, që vihen re në organizatat e Frontit, t'u japim fund. Mbledhjet e Frontit janë mbledhje politike shumë të rëndësishme. Problemet e tij janë problemet e jetës së popullit. Ai duhet të merret me të gjitha ato çështje që preokupojnë popullin, qofshin këto politike, ekonomike, ideologjike, shoqërore, kulturore apo arsimore. Në mbledhjet e Frontit të ziejë rrahja e lirë e mendimeve në format më demokratike, nëpërmjet kritikës e autokritikës, nëpërmjet zhvillimit dialektik të të kundërtave. Ato duhet të bëhen shkolla të bashkimit e të edukimit politik të popullit, ku anëtarët e Frontit të njihen me politikën e direktivat e Partisë, të diskutojnë gjallërisht për problemet që shtron Partia e që ngre jeta dhe të marrin vendime për zbatimin e tyre. Të luftojmë çdo shfaqje të formalizmit në punën e organizatave të Frontit, sepse formalizmi është një e keqe e madhe, që i heq punës së tij gjallërinë dhe e bën një barrë të mërzitshme, shuan frymën e diskutimeve të zjarra për problemet e mprehta të jetës sonë shoqërore, i hedh njerëzit në pasivitet e në indiferentizëm.

Ne kemi tani mjaft shembuj pozitivë të një lufte efektive kundër shfaqjeve të formalizmit në jetën e organizatave të Frontit. Ç'treguan, për shembull, mbledhjet e Frontit të kohëve të fundit, kur në to u shtruan e u diskutuan në një frymë të lartë revolucionare probleme të mprehta shoqërore e ideologjike?

Ato qenë mbledhje të gjalla e luftarake, ku buçiti i fortë e i drejtë zëri i masave, urrejtja e tyre për çdo gjë të vjetër, prapanike e reaksionare, ato qenë mbledhje me efekt të madh edukativ, që lanë mbresa të thella në ndërgjegjen e njerëzve, që, megjithëse shpesh zgjatnin me orë, bile ngandonjëherë edhe me seanca, asnjëri nuk donte të largohej dhe jehona e tyre vazhdonte me ditë të tëra në qendrën e punës, në rrugë e në familje. Ja, të tilla duhet të jenë mbledhjet e Frontit. Këtë përvojë ne duhet ta përgjithësojmë, ta zhvillojmë e ta çojmë përpara.

Partia jonë dhe Fronti Demokratik e kanë përdorur gjerësisht e me sukses aksionin, si një metodë revolucionare për edukimin e njerëzve dhe për të çuar përpara prodhimin, revolucionin, socializmin. Kjo metodë ka marrë një përhapje të gjerë në ditët tona. Sot në gjithë vendin janë ndërmarrë shumë aksione, kanë shpërthyer shumë iniciativa e lëvizje të mrekullueshme revolucionare. Veçoria e momentit të tanishëm është se, krahas aksioneve, lëvizjeve e iniciativave të shumta në fushën ekonomike, të prodhimit, një rëndësi të madhe e përhapje të gjerë kanë marrë aksionet, lëvizjet e iniciativat në fushën ideologjike e kulturore, në atë të eksperimentimit shkencor dhe të rritjes së gatishmërisë luftarake për mbrojtjen e vendit. Brenda një kohe fare të shkurtër, me një ritëm me të vërtetë revolucionar, ato kanë transformuar mendjet e njerëzve, kanë ndryshuar konceptet e tyre të rrënjosura brez pas brezi.

Këtë metodë të aksionit, të shoqëruar kurdoherë me një punë të gjerë bindëse e sqaruese, individuale

e masive organizatat e Frontit duhet ta përvetësojnë, ta zhvillojnë, ta pasurojnë e ta perfeksionojnë paresh-tur, ta vënë në themel të metodës e të stilit të tyre në punë.

Forcimi dhe gjallërimi i organizatës së Frontit varen shumë nga puna e organeve të tij drejtuese dhe e njerëzve që janë zgjedhur nga populli në këto organe. Zgjedhjet e reja të Frontit që u zhvilluan gjatë muajit korrik e gusht në një frymë të shëndoshë revolucionare, me diskutime të gjalla, kritikë e auto-kritikë, forcuan më tej përbërjen e organeve drejtuese të Frontit. Në krye të organizatave të Frontit në fshatra, lagje, qytete e rrethe janë zgjedhur njerëzit më të mirë, me parti e të paorganizuar në Parti, burra dhe gra, të moshuar e të rinj, aktivistë të dalluar e me ndërgjegje të lartë politike. Kjo është garanci për një punë akoma më frytdhënëse në të ardhmen. Por kjo është vetëm njëra anë e çështjes. Ana tjetër është që çdo njeri i zgjedhur në organet e Frontit ta kuptojë mirë përgjegjësinë e tij para masës që e ka zgjedhur, ta justifikojë besimin që i ka dhënë ajo dhe të kryejë me nder detyrat e ngarkuara. Asnjëri nuk duhet ta konsiderojë këtë si barrë, por si një nder e detyrë të lartë shoqërore.

Puna e Frontit është një punë shoqërore që bëhet kryesisht mbi baza vullnetare dhe me pjesëmarrjen e gjithë anëtarëve të tij. Sado mirë të punojnë organet drejtuese të Frontit dhe njerëzit e zgjedhur në to, ata kurrë nuk do të mund t'i kryejnë detyrat e mëdha që ka Fronti, po nuk u vunë në lëvizje të gjithë anëta-

rët e kësaj organizate e, në radhë të parë, aktivistët e saj më të dalluar. Tani, në shumë organizata të Frontit në rrethe, fshatra e lagje, është krijuar një aktiv i gjerë njerëzish, që punojnë për problemet e Frontit, duke e konsideruar këtë si një detyrë të lartë patriotike. Është shumë kuptimplotë ajo që thonë shokët e Tropojës se, kur nuk ngarkohet për një kohë të gjatë me detyra ndonjë aktivist i Frontit, ai e ndien veten të fyer. Të tillë njerëz të mrekullueshëm, patriotë e revolucionarë, ne kemi me mijëra në të gjithë vendin tonë. Është detyra jonë t'i tërheqim ata në punën e Frontit, t'i edukojmë e t'i aktivizojmë për problemet e ndryshme që na preokupojnë. Rrethi i aktivistëve të Frontit të mos kufizohet vetëm në disa njerëz të njohur. Ai duhet zgjeruar me aktivistë të rinj, me të cilët të bëhet një punë e veçantë edukative nga organet e zgjedhura të Frontit. Puna me aktivistët është një punë me shumë rëndësi, që ka të bëjë me vetë gjallërimin dhe forcimin e organizatës së Frontit.

Kanë kaluar 12 vjet që kur kemi aprovuar Statutin e Frontit tonë Demokratik. Nga përvoja e fituar deri më sot dhe në përshtatje me kushtet e reja del nevoja të bëhen disa ndryshime, të cilat janë pasqyruar në projektin e statutit të ri që u është shpërndarë të gjithë delegatëve për diskutim e aprovim.

III

DISA ÇËSHTJE TË GJENDJES NDERKOMBËTARE

Shokë e shoqe,

Republika Popullore e Shqipërisë qëndron si një shkëmb graniti dhe ndërton socializmin duke mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën. Historia na ka mësuar se, për të jetuar të lirë e të pavarur, ne duhet të jemi gjithnjë vigjilentë e ta mbajmë barutin të thatë. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme në ditët e sotme kur duket qartë prirja drejt zgjerimit të synimeve dhe të veprimtarisë agresive të imperialistëve amerikanë për të vënë në jetë strategjinë e tyre globale të sundimit botëror.

Këtë e tregojnë zgjerimi i agresionit të ndyrë fashist të imperialistëve amerikanë në Vietnam, sulmi izraelito-imperialist kundër vendeve arabe, ndërhyrjet brutale për t'i shuar me zjarr e me hekur lëvizjet çlirimtare të popujve, planet e shumta të imperialistëve amerikanë për ta shkatërruar gjithkund rendin socialist.

Shtimi i agresivitetit të imperialistëve amerikanë është i lidhur jo vetëm me natyrën agresive e skllavëruese të imperializmit, por edhe me tradhtinë e revizionistëve hrushovianë, që u ka dhënë zemër dhe u ka ngjallur shpresa të mëdha manjatëve të kapitalit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, reaksionarëve të vendeve të ndryshme, të gjitha forcave antikomuniste

e kundërrevolucionare të botës. Ata e dinë mirë se veprimet e tyre agresive jo vetëm nuk kundërshtohen nga klika revizioniste hrushoviane, por, përkundrazi, gjejnë përkrahje. Jeta po e provon se sa i drejtë është konkluzioni i Kongresit të 5-të të Partisë mbi aleancën sovjeto-amerikane, si një nga tiparet kryesore të gjendjes aktuale ndërkombëtare, që ka për qëllim ndarjen e zonave të influencës dhe vendosjen në botë të sundimit të dy superfuqive.

Bisedimet e presidentit Xhonsn me tradhtarin Kosigin në Glasboro, shënojnë një etapë të re shumë të rrezikshme të kësaj aleance të përbindshme. Atje u thurën komplete të reja kundër socializmit, paqes dhe lirisë së popujve. Efektet e këtij takimi po duken që tani në shumë drejtime: në shkallëzimin e mëtejshëm të agresionit në Vietnam, në shtimin e presioneve për t'u imponuar vendeve arabe një zgjidhje të favorshme për Izraelin dhe për politikën sovjeto-amerikane të ndarjes së zonave të influencës, në projekt-traktatin e përbashkët sovjeto-amerikan për mospërhapjen e armëve atomike etj.

Për realizimin e marrëveshjeve të përbashkëta imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë po luajnë të gjithë gurët. Këtu hiqen si miq të këtij apo të atij populli, si liridashës dhe paqedashës, atje tregohen «bujarë» dhe ofrojnë ndihma ekonomike e ushtarake. Në një rast tjetër kanosen me shantazhin atomik, me flotat e tyre, me potencialin ushtarak. Dhe për çdo gjë vënë në lëvizje kukullat e sahanlëpirësit e tyre që nga papa Pavli, te renegati, agjenti dhe komplotisti i vjetër Tito dhe deri tek Indira Gandhi. Këta,

me porosi të drejtpërdrejtë të qeverisë amerikane dhe asaj sovjetike, bredhin nga një vend në tjetrin, bëjnë zhurmë shurdhuese, përdorin mjete e forma të ndryshme për ta mashtruar opinionin publik botëror, për ta lëkundur vendosmërinë e popujve revolucionarë, që t'i bëjnë ata të kapitullojnë e t'i nënshtrohen sundimit amerikano-sovjetik.

Por ngjarjet, në të njëjtën kohë po vërtetojnë se revolucioni shkon përpara në mënyrë të pandalshme. Ai kapërcen çdo pengesë e vështirësi, shkatërron planet agresive skllavëruese të imperializmit dhe po bëhet gjithnjë e më shumë një rrezik vdekjeprurës për të. Lufta klasore dhe lufta çlirimtare revolucionare e popujve kundër imperializmit dhe veglave të tij, revizionistëve modernë, kanë përfshirë me shpejtësi gati të gjitha kontinentet, po tronditin nga themelet shoqërinë e vjetër të kapitalizmit dhe sistemin kolonial, duke paralajmëruar përmbysje të pashmangshme në vende të ndryshme të botës, fitore të reja për revolucionin.

Në Azi, në Afrikë e në Amerikën Latine popujt kanë rrëmbyer armët dhe po luftojnë me heroizëm. Një shembull i shkëlqyer është lufta heroike e popullit vietnamez. Vatra të luftës revolucionare janë ndezur në Laos e në Tajlandë, në Arabinë Jugore dhe në Birmani, në Angola e në Mozambik, në Guinenë «Portugeze» e në Kongo, në Venezuelë, në Indonezi e gjetkë. Me një forcë të paparë kanë shpërthyer në vetë strofkën e imperializmit zemërimi dhe revolta e armatosur e zezakëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Popujt janë zgjuar, kanë rritur ndërgjegjen

politike, kanë fituar besim në forcat dhe në solidaritetin e tyre që të kundërshtojnë me guxim dhe dhëmb për dhëmb imperializmin e të dalin fitimtarë mbi të. Përvoja e luftës po i bind ata se imperializmi amerikan është armiku i tyre i përbashkët. Ajo po u tregon atyre se revizionistët hrushovianë nuk janë aleatë e përkrahës të tyre, por miq të rremë e të rrezikshëm, se ata janë shërbëtorë dhe aleatë të imperializmit dhe të reaksionit, që duhen demaskuar e luftuar pa mëshirë. Kjo përvojë tregon, gjithashtu, se, sado të mëdhenj e të fuqishëm që duken nga jashtë imperialistët, revizionistët e gjithë reaksionarët, nga brenda janë të kalbur e të pafuqishëm përpara forcës dhe vrullit të luftës revolucionare të popujve.

Fronti imperialisto-revizionist është mbërthyer, gjithashtu, në darën e kontradiktave të thella që e brejnë nga brenda, si një rën palë, ashtu edhe tjetrën. Tani shihen edhe më mirë të çarat e mëdha në kampet e tyre, tendencat centrifugale e policentriste që po shtohen e po trashen, kaosi që mbretëron atje, vësh-tirësitë e pakapërcyeshme që gjejnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët hrushovianë për t'i mbajtur nën kontrollin e vet satelitët e tyre. Duket edhe më qartë rivaliteti midis dy superfuqive për t'ia marrë njëra-tjetrës miqtë e aleatët.

Një arenë tipike e këtyre kontradiktave të thella, e këtij kaosi, e luftës së ashpër që zhvillohet në kopetë e ujëve imperialistë e revizionistë, është Evropa. Revizionistët sovjetikë e të tjerë u bëjnë reklamë të madhe parullave të tyre demagogjike të «qetësisë në Evropë», të «sigurimit evropian», të «zonave pa armë

atomike» etj. Këtyre parullave u mbajnë iso edhe shumë qarqe të borgjezisë sunduese në vende kapitaliste të Evropës. Në të vërtetë Evropa është shndërruar në një fushë të madhe rivalitetesh, kontradiktash, pazarllëqesh e tradhtish, në mes klikave kapitaliste imperialiste e revizioniste, në dëm të lirisë, të sovranitetit dhe të pavarësisë së popujve evropianë dhe të popujve të botës.

Kush e kush nga këto klika përpiqet të shesë dhe të shitet më shtrenjtë te njëri e te tjetri. «Urat» e Xhonsnit janë vendosur në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët dhe tani «trenat» kalojnë lirisht, pa pengesa. Të gjithë revizionistët po shesin popujt dhe vendet e tyre tek imperialistët dhe përpiqen ta fshehin tradhtinë e tyre duke përdorur metodat e strucit. Disa nga këta luajnë rolin e primadonës dhe paradojnë veshur me rrobat e tradhtisë, duke kujtuar se nuk i sheh kush se ç'janë në të vërtetë; të tjerët flasin hapur se po lidhin miqësitë e vjetra tradicionale të borgjezisë dhe të mbretërve të tyre të dikurshëm.

Ku do të çojë kjo politikë pazarllëqesh, kapitullimi e tradhtie? Sigurisht, kjo do të çojë në rrugën e konflikteve të reja të përgjakshme, në vendosjen e hapët të diktaturave fashiste ushtarake drejt një lufte tjetër botërore. Dhe këtë luftë që përgatitet nën mantelin e «bashkekzistencës paqësore», e këtij blofi të madh antirevolucionar, e organizojnë imperialistët dhe revizionistët sovjetikë.

Por, megjithëkëtë, fjalën e fundit e ka revolucioni, i cili do t'i dërrmojë pa nam e pa nishan armiqtë

e popujve. Dhe revolucioni po përgatitet, po ngrihet e po rritet si furtuna. Sa më parë, sa më e furishme, sa më e pamëshirshme që të jetë kjo furtunë, aq më shpejt do të shpëtojë njerëzimi nga armiqtë e tij, të cilët janë të njëjtët, të vazhdueshmit, por të mbuluar me maska të ndryshme.

Është e vërtetë se revolucioni kërkon guxim, heroizëm, sakrifica, por këto janë vetitë e popujve, të komunistëve, të revolucionarëve patriotë. Armiqtë e popujve, që kanë frikë për veten e tyre, përpiqen që këto virtyte të larta të njerëzve t'i shkatërrojnë me gënjeshtër, me demagogji, me presione dhe me terror për të mbrojtur regjimet e tyre shtypëse dhe pasuritë e grabitura. Le të ngrihemi, pra, kudo në revolucion dhe t'i dërrmojmë armiqtë tanë, kudo që janë dhe nën çdo maskë që ata fshihen, t'ua çjerrim maskat dhe me zjarr e me revolucion t'i futim në varr.

Revizionistët sovjetikë dhe të gjitha klikat revizioniste që janë në fuqi në Evropë, pa asnjë përjashtim, po bëjnë tregti me interesat jetikë të Republikës Demokratike Gjermane. Ata e konsiderojnë këtë si një ferrë nëpër këmbë, si një pengesë për marrëveshjet e tyre me imperializmin amerikan, me Bonin dhe me gjithë kapitalistët e Evropës. Revizionistët e Evropës, me ata të Bashkimit Sovjetik në krye, po e mbytin Republikën Demokratike Gjermane çdo ditë e më shumë. Ata e kanë vënë atë në darën e një komploti të kurdisur në errësi, të cilin po e zbatojnë me konsekuencë çdo ditë e në të gjitha drejtimet, derisa ta shesin më në fund tërësisht. Çdo parullë e këtyre tradhtarëve për Republikën Demokratike Gjermane

është thjesht demagogji. Por, ndërsa këta tradhtarë të regjur veprojnë në këtë mënyrë, deri kur do ta durojnë populli i Republikës Demokratike Gjermane dhe marksistë-leninistët e vërtetë gjermanë tradhtinë që po u bëhet vetë atyre dhe atdheut të tyre socialist, deri kur do të durojnë ata që t'u hidhen zinxhirët në duar dhe të shkaktohet katastrofa e re në Evropë?

Duhet ngritur kundër kësaj tradhtie dhe kështu do t'u bëhet një shërbim i madh atdheut tuaj, Evropës, botës dhe revolucionit! Në rast se ju ngrini krye kundër kësaj tradhtie të madhe, atëherë bota do të shohë se populli gjerman i Republikës Demokratike Gjermane ka nxjerrë mësim të thella nga katastrofa e shkaktuar nga hitlerianët, se ai e shikon që hitlerianët e rinj po përgatitin një kasaphanë të re, se Xhonsonet e Kisingerët, Brezhnevët e Kosiginët, këta Trockë dhe Tukaçevskë të rinj, po mprehin thikat. Populli shqiptar dhe Partia e tij e Punës, si deri sot, ashtu edhe në të ardhmen, do ta mbështetin kurdoherë çështjen e drejtë të Republikës Demokratike Gjermane.

Klikat revizioniste të disa shteteve të ish-demokracisë popullore të Evropës, për të mbrojtur dhe për të forcuar pozitat e tyre, përpiqen t'i zgjidhin vështirësitë e mëdha ekonomike e politike që ka sjellë kursi i tyre tradhtar, duke hyrë drejtpërdrejt në marrëveshje nënshtrimi me imperializmin amerikan, gjermano-perëndimor, francez etj., duke sfiduar kështu politikën hegjemoniste të klikës udhëheqëse të Bashkimit Sovjetik. Nga ana e tyre, fuqitë e ndryshme imperialiste janë në garë me njëra-tjetrën për t'i futur në orbitën

e tyre vendet ish-socialiste dhe për ta shpejtuar rivendosjen e kapitalizmit në këto vende.

Si rrjedhim i kësaj politike tradhtare, jo vetëm rendi socialist, por edhe vetë pavarësia kombëtare e disa shteteve të Evropës Lindore vihet në pikëpyetje. Në një gjendje të tillë, popujve vëllezër të këtyre vendeve nuk u lejohet të presin katastrofën në qetësi. Në radhë të parë, kjo nuk i lejohet popullit të madh sovjetik. Është një krim i madh që 50 vjet pas Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, i cili, nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit, çeli epokën e çlirimit të njerëzimit nga çdo shtypje e shfrytëzim, epokën e triumfit të socializmit e të komunizmit, një klikë tradhtare renegatësh ta kthejë Bashkimin Sovjetik në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit, ta shndërrojë vendin e lavdishëm të sovjetëve nga një kështjellë e revolucionit dhe e lirisë së popujve, si ka qenë në kohët heroike të bolshevikëve, në një fuqi imperialiste, mbytëse të flakës së luftërave revolucionare. Ne nuk mund të besojmë që populli sovjetik nuk po e sheh akoma tradhtinë e madhe të atyre që kanë uzurpuar udhëheqjen e partisë e të shtetit sovjetik, se ai nuk e sheh greminën drejt së cilës ata po e shtyjnë vendin e tyre. Ne nuk mund të besojmë se ai nuk e sheh dhe nuk e ndien izolimin e Bashkimit Sovjetik nga miqtë e tij të vërtetë dhe nga popujt e botës, se ai nuk e sheh se si klika tradhtare revizioniste po shkatërron veprën e lavdishme të Leninit e të Stalinit, të Partisë Bolshevike dhe të miliona njerëzve sovjetikë.

Ne besojmë se popujt sovjetikë dhe marksistë-leninistët e vërtetë sovjetikë nuk do të durojnë gjatë së

dëgjuari gënjeshtat e neveritshme të shtypit dhe të radios të klikës revizioniste, se gjoja ajo po mbron popujt, se gjoja po lufton imperializmin amerikan dhe se ka aprovimin e përkrahjen e partive komuniste të botës.

Populli sovjetik nuk mund të mos revoltohej ndaj këtyre gënjeshtave trashanike dhe kësaj demagogjie të ulët të hrushovianëve, të cilët, nga njëra anë, janë bashkuar plotësisht me imperializmin amerikan e me gjithë reaksionarët, dhe, nga ana tjetër, luftojnë e komplotojnë me egërsi kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, Republikës Popullore të Kinës, kundër partive marksiste-leniniste, kundër revolucionit dhe lirisë së popujve.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë marksistë-leninistët i kanë dërrmuar me guxim e vendosmëri të gjitha komplotet dhe veprimtaritë e revizionistëve hrushovianë dhe nuk do të lejojnë kurrë që këta tradhtarë të rrezikshëm dhe bashkëpunëtorë të ngushtë të imperializmit të arrijnë ndonjëherë të realizojnë qëllimet e këqija që kanë kundër nesh. Por interesat e lartë të marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të socializmit në botë, kërkojnë nga të gjithë revolucionarët e vërtetë, nga të gjithë komunistët që u qëndrojnë besnikë mësimëve ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, të ngrihen në këmbë me vendosmëri dhe t'ua grisnin deri në fund maskën «antiimperialiste» e «socialiste» udhëheqësve sovjetikë hrushovianë, në mënyrë që të dalë lakuriq përpara gjithë botës fytyra e vërtetë tradhtarë e këtyre renegatëve, komplotistëve dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë të imperializmit dhe të gjithë reaksionit botëror.

Në këtë situatë me përgjegjësi të madhe historike për fatin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për të ardhmen e revolucionit e të komunizmit, bota pret shumë nga revolucionarët, bolshevikët dhe gjithë popujt sovjetikë, nga vendi që i pari ngriti flamurin e revolucionit socialist dhe çeli epokën e lavdishme të socializmit.

Ç'po bëni dhe ç'do të bëni ju vëllezër sovjetikë? A mos vallë ju jeni frikësuar nga revizionistët, a mos vallë keni humbur besimin në revolucionin dhe në komunizmin dhe jeni zhytur në apati? Lenini, Stalini, Partia juaj e lavdishme Bolshevike e Lenin-Stalinit, Revolucioni i Madh i Tetorit, na kanë mësuar se duhet t'u besojmë veprave dhe jo fjalëve. Presim ne dhe gjithë popujt veprat tuaja revolucionare, si në kohërat më heroike të së kaluarës suaj, presim dhe kemi bindjen se në Bashkimin Sovjetik do të pëlçasë prapë revolucionin për t'i shkatërruar revizionistët tradhtarë.

Historia do t'ju gjykojë për të mirë a për të keq. Ne kemi bindjen se do t'ju gjykojë për të mirë dhe sa më shpejt që ju të veproni, aq më mirë do të jetë për ju, për mbarë popujt, për revolucionin.

Republika Popullore e Shqipërisë, duke ndjekur me vendosmëri politikën e saj të jashtëme parimore revolucionare, nuk ka qëndruar e nuk qëndron kurrë indiferente ndaj ngjarjeve ndërkombëtare. Partia dhe Qeveria jonë e kanë thënë me guxim fjalën e tyre për këto ngjarje dhe kanë dhënë e japin kështu kontributin e vet në luftën për sigurimin e paqes në Evropë e në botë, për demaskimin e politikës agresive e sklla-

vëruesc të imperialistëve, si edhe të politikës tradhtarë kundërrevolucionare të revizionistëve hrushovianë. Ata kanë dënuar e do të dënojnë kurdoherë të gjitha pazarllëqet imperialisto-revizioniste në kurriz të popujve, do të përkrahin pa rezerva luftërat çlirimtare antiimperialiste dhe do të forcojnë pa pushim solidaritetin me të gjitha forcat që luftojnë kundër imperializmit, kundër reaksionit e kundër revizionizmit.

Populli, Partia dhe Qeveria jonë do të vazhdojnë ta përkrahin deri në fund pa rezerva luftën çlirimtare të popullit vietnamez, të cilën ne e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë si luftën tonë, si një luftë që i shërben çështjes së përbashkët të revolucionit e të socializmit.

Lufta e armatosur e popullit vietnamez është një goditje e rëndë për imperializmin amerikan dhe një pengesë e madhe për realizimin e planeve të tij grabitqare. Fitoret e rëndësishme që ai ka arritur në këtë luftë e thyen njëherë e përgjithmonë mitin e fuqisë së epërsisë ushtarake dhe të armatimeve moderne. Ngjarjet në Vietnam treguan se një popull, sado i vogël, kur lufton me vendosmëri dhe pa u përkulur për lirinë e pavarësinë e tij, mund të rezistojë me sukses dhe të fitojë edhe atëherë kur ka përballë një armik të fuqishëm, qoftë ky edhe imperializmi amerikan.

Por lufta e Vietnamit ua grisi maskën edhe revizionistëve hrushovianë, ajo tregoi gjithë falsitetin, hipokrizinë dhe demagogjinë e politikës së tyre kapitulluese. U provua tanimë se qëllimi i revizionistëve nuk është të ndihmojnë popullin vietnamez të çlirojë Jugun

dhe të bashkojë atdheun e tij, por të shpëtojnë imperializmin amerikan, ta ndihmojnë atë të qëndrojë në Vietnam dhe ta kthejnë këtë vend në një plasdarmë kundër Republikës Popullore të Kinës dhe vendeve të tjera të Azisë. Revizionistët hrushovianë mundohen të luajnë në Vietnam rolin e «kalit të Trojës» dhe thurin një mijë plane e komplete djallëzore, përdorin presione e mashtrime nga më të ndryshmet për ta detyruar Vietnamin të pranojë «bisedimet paqësore» të Xhonsanit. Por ata nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë kurrë në gjendje të lëkundin vendosmërinë e popullit vietnamez, ta shuajnë luftën e tij çlirimtare.

S'ka asnjë dyshim se tani, pas komplotit të Glasboros, populli heroik vietnamez do ta shtojë edhe më tepër vigjilencën e tij për të qenë kurdoherë në gjendje t'u bëjë ballë me sukses kompleteve të reja imperialisto-revizioniste, për t'i bërë pluhur e hi presionet e reja ushtarake, politike, diplomatike e demagogjike që po vërshojnë kundër tij.

Ne e kemi deklaruar me forcë dhe botërisht se qëndrimi ndaj Vietnamit është një kufi i përcaktuar qartë që ndan imperialistët nga popujt, marksistë-leninistët nga revizionistët. Lufta e popullit vietnamez është një luftë që i shërben kauzës së përgjithshme të revolucionit, socializmit dhe çlirimit të popujve. Prandaj solidariteti dhe përkrahja e luftës së popullit të Vietnamit nuk është një gjest mirëbërës, siç pretendojnë revizionistët, por një detyrë e lartë internacionaliste për të gjithë revolucionarët. Por që kjo ndihmë të jetë efektive dhe e vlefshme, duhet të hidhen poshtë me forcë parullat demagogjike e mashtruese të revi-

zionistëve hrushovianë, «të unitetit për të ndihmuar Vietnamin», ose «të frontit të përbashkët kundër imperializmit». Demaskimi dhe shkatërrimi me vendosmëri e tërësisht i politikës tradhtare dhe i demagogjisë së revizionistëve sovjetikë është një kusht i domosdoshëm dhe paraprak për fitoren e popullit vietnamez në luftën kundër imperializmit amerikan.

Populli ynë, si kurdoherë, do të jetë solidar me luftën e drejtë të popujve arabë kundër imperializmit amerikan dhe veglës së tij, Izraelit. Ne kemi besim të patundur se këta popuj do t'i kapërcejnë me sukses të gjitha vështirësitë e përkohshme, do t'i shpartallojnë agresorët e do të korrin fitoren përfundimtare mbi imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e veta, si edhe në përkrahjen e popujve revolucionarë, duke mos u zënë besë miqve të rremë — revizionistëve hrushovianë e titistë.

Popujt vëllezër arabë janë popuj trima, revolucionarë, me një të kaluar të shkëlqyer, me një kulturë të lashtë dhe me një të ardhme të ndritur. Ata po luajnë sot dhe do të vazhdojnë të luajnë në vitet e ardhshme një rol të rëndësishëm revolucionar në botë. Ata nëpërmjet luftërave të gjata kanë fituar lirinë e pavarësinë dhe po i farkëtojnë këto çdo ditë e më tepër. Armiq kanë boll, brenda dhe jashtë vendeve të tyre, ashtu siç kanë të tillë të gjitha vendet dhe popujt e tjerë revolucionarë të botës. Por në popujt arabë është e rrënjosur ndjenja e unitetit arab, ndjenjë kjo shumë përparimtare, megjithëse midis vendeve arabe ka akoma shumë kontradikta, të cilat nxiten nga imperialistët, revizionistët dhe reaksionarët e ndryshëm.

Por nëpërmjet luftës të të kundërtave uniteti i tyre po kalitet. Ky unitet revolucionar arab do të zhvillojë patjetër progresin dhe do të çojë, me siguri, drejt demokracisë së vërtetë, drejt konsolidimit të pavarësisë së çdo shteti sovran. Kjo do të ndodhë, pasi vendet arabe në unitet, janë në luftë të hapët dhe të paprerë kundër imperializmit amerikan, kundër veglave të tij të ndyra si Izraeli, kundër revizionizmit modern sovjetik, këtij imperializmi të ri, që kërkon t'u hedhë popujve arabë pranga të reja.

Imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, revizionistët sovjetikë, duke i goditur tradhtisht dhe në befasi popujt arabë, po nguten të konsolidojnë fitoren e tyre agresive, duke bërë presione mbi vendet arabe. Nga fuqitë imperialiste dhe revizioniste po zhvillohet në kohën tonë politika e vjetër e Orientit. Kjo është politika e kanonierave moderne, e presioneve dhe e shantazheve, politika përça e sundo. Merren nëpër këmbë brutalisht interesat jetikë të popujve arabë në përgjithësi dhe të popullit arab palestinez në veçanti, në favor të Izraelit sionist, pjellë e ndyrë e imperializmit dhe kobure në brezin e imperialistëve amerikanë. Por, intrigat e kanë jetën të shkurtër. Popujt arabë kurrë nuk do t'i hedhin armët, ata do ta vazhdojnë luftën e tyre revolucionare. Çdo ujdj imperialisto-revizioniste do të qëndrojë si mbi një vullkan në erupsion të plotë.

Por kemi bindjen se armiqtë e popujve arabë do të dështojnë. Ne jemi të sigurt për një gjë: se vëllëzërit arabë i kanë plotësisht të qarta manovrat dhe qëllimet e imperialistëve amerikanë, të revizionistëve so-

vjetikë, të titistëve e të këlyshëve të tjerë të imperia-
lizmit. Dhe kjo është çështja kryesore, vendimtare për
arritjen e fitores. Kur e njeh armikun, sado i fortë që
të jetë ai në dukje, do t'ia bësh varrin. Dhe popujt
arabë, po ua përgatitin varrin armiqtë të tyre të be-
tuar, që janë njëkohësisht armiqtë tanë, armiqtë e
gjithë popujve.

Popujt arabë janë të fortë, të gjithë popujt që i
duan ata janë të fortë dhe ne së toku do të fitojmë.
Armiqtë të përbashkët do t'ua shtypim kokën për
vdekje. Me rastin e këtij Kongresi u çojmë vëllezër-
ve tanë arabë përshëndetje të zjarrta dhe u themi se
populli shqiptar është dhe do të jetë kurdoherë me ta,
si në ditë të mira, ashtu edhe në ditë të vështira.

Politika e jashtme revolucionare e Partisë dhe e
Qeverisë sonë mbështetet plotësisht nga i gjithë po-
pulli shqiptar, i bashkuar në Frontin Demokratik. Në
sajë të kësaj politike, Republika Popullore e Shqipërisë
ka fituar një autoritet të merituar ndërkombëtar,
miq e përkrahës të sigurtë në mbarë botën.

Shqipëria socialiste është një vend paqedashës, që
nuk kërkon të kërcënojë, ose të frikësojë njeri. Me
politikën e saj të jashtme të drejtë dhe korrekte, Re-
publika Popullore e Shqipërisë ka synuar kurdoherë
që me të tre fqinjët e saj që ka rreth e rrotull, të rro-
jë në fqinjësi normale. Në qoftë se ndonjëherë prej tyre,
jo për fajin tonë, nuk i pëlqeka kjo fqinjësi normale
dhe korrekte, atëherë s'na priset puna, socializmi
çdo ditë e më mirë lulëzon në Shqipëri.

Monarko-fashistët grekë kanë gati 25 vjet që de-
klarojnë se janë «në gjendje lufte me Shqipërinë», për

arsyen «bindëse» se Italia fashiste, që sulmoi me armë dhe pushtoi Shqipërinë më 1939, sulmoi edhe Greqinë.

Për prapa këtij qëllimi absurd qëndron një tjetër qëllim agresiv, akoma më absurd, ai i rivendikimeve tokësore ndaj atdheut tonë nga ana e pseudopalikarëve të Athinës. Ata na dashkan Shqipërinë e Jugut, pasi, sipas tyre, na qenka tokë greke!

Monarko-fashistët grekë dhe aleatët e tyre ballkanikë dhe ekstraballkanikë kujtojnë se rrojnë në ato kohë, kur klikat shoviniste të Ballkanit, të ndihmuara nga fuqitë imperialiste, i vërsuleshin Shqipërisë, e copëtonin atë, rrëmbenin troje të saj të gjera dhe robëronin pjesë të mëdha të popullit të saj.

Ne u themi monarko-fashistëve grekë: «Nuk kanë lindur akoma as dje dhe as sot ata burra që të frikësojnë shqiptarët. Kufijtë e Shqipërisë dhe tokat shqiptare i mbron një popull dhe një Parti shqiptare».

Tani dy fjalë edhe për sa u përket revizionistëve modernë, me ata sovjetikë në krye. Ne u themi atyre: «Ju jeni aleatë me imperializmin amerikan dhe me monarko-fashistët grekë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, prandaj e keni kot që lëshoni lot krokodili dhe trumbetoni atë leckë që quhet Traktati i Varshavës, gjoja për t'i ardhur në ndihmë Shqipërisë. Shqiptarët ju njohin dhëmbë e dhëmballë, pavarësisht se ato janë edhe atomike. Ne s'jua kemi aspak frikën dhe nuk kalojnë te ne as lotët e krokodilit, as Traktati i Varshavës, dhe as pseudonduarit tuaja në kohë rreziku. Çdo rrezik, po të na vijë, jemi në gjendje ta përballojmë me sukses vetë».

Besojmë se revizionistët modernë, me ata sovjeti-

kë, në radhë të parë, e kanë edhe ata të qartë këtë çështje.

Shqipëria socialiste do të rrojë në shekuj, e lirë, sovrane dhe e pavarur. Ajo do të qëndrojë kurdoherë shembull i heroizmit dhe i vitalitetit të një populli të mrekullueshëm e patriot, që është i bashkuar grusht në Frontin Demokratik rreth Partisë së tij heroike të Punës, e cila, brenda këtyre 25 vjetëve, e ka bërë Shqipërinë e re të fortë dhe të paprekshme, të rrethuar nga një dashuri e zjarrtë e miqve të sinqertë dhe e popujve revolucionarë të botës.

Të dashur shokë e shoqe,

Të gjithë ne jemi krenarë për organizatën tonë të madhe politike të Frontit Demokratik, për kontributin e pallogaritshëm që ajo ka dhënë dhe jep për ta bërë atdheun tonë socialist më të bukur, më të fortë e më të begatshëm.

Detyrat që do të caktojë ky Kongres do të jenë një program i madh pune dhe lufte revolucionare për të gjithë anëtarët e Frontit, në mënyrë që të kthehen në realitet perspektivat e shkëlqyera që çeli për të ardhmen e vendit tonë Kongresi i 5-të i Partisë.

Le të vëmë të gjitha forcat tona, le të ngremë në këmbë gjithë popullin tonë në luftën e madhe për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit, për ndërtimin e socializmit, për forcimin e mbrojtjes së atdheut. Të mos kursejmë asgjë për të ruajtur si sytë e ballit dhe për të çelikosur akoma më shumë unitetin monolit të popullit tonë rreth Partisë, që ka qenë dhe është

kurdoherë kushti vendimtar në marshimin tonë fitimtar.

T'i përvishemi, shokë e shoqe, edhe më me hov punës për plotësimin me sukses të detyrave madhështore që shtron plani i katërt pesëvjeçar në të gjitha fushat, sepse nuk ka gjë më të shenjtë e më fisnike sesa të derdhësh mundin, talentin dhe djersën për socializmin, për lulëzimin e atdheut, për ta bërë jetën e popullit më të lumtur, më të pasur e më të gëzuar. Në mënyrë të veçantë ta forcojmë punën e Frontit në drejtim të fshatit, për t'i çuar edhe më përpara hovin dhe iniciativat revolucionare të fshatarësisë kooperativiste patriote për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë dhe për përparimin e gjithanshëm ekonomik, arsimor e kulturor të fshatit e posaçërisht të malësisë.

Fronti Demokratik, ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, të jetë luftëtar i papërkulur për të çuar kudo përparimin, për të luftuar me vendosmëri prapambetjen, për të përhapur dijen, kulturën dhe ideologjinë proletare dhe për të luftuar për çrrënjosjen e çdo gjëje të huaj, anakronike dhe reaksionare. T'i hapet rruga së resë, përparimitares, në mënyrë që të shpërthejnë me një forcë të re fryma krijuese, energjitë e pafund, talenti dhe iniciativa e popullit tonë të lavdishëm, e burrave dhe e grave, e të rinjve dhe e pleqve.

Organizatrat e Frontit Demokratik të mbajnë kurdoherë të ndezur në zemrën e çdo shqiptari flakën e dashurisë së pakufishme për Partinë e atdheun e tij socialist, për të mprehur vigjilencën revolucionare dhe për të ngritur gatishmërinë luftarake, në mënyrë që populli ynë të jetë kurdoherë në këmbë për t'i bërë

ballë çdo rreziku dhe për të dërrmuar çdo armik të Republikës sonë Popullore.

Me Partinë tonë heroike në krye, duke mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit fitimtar, të bashkuar si një trup i vetëm në Frontin Demokratik, le të marshojmë gjithnjë përpara në rrugën e ndritur të socializmit e të komunizmit!

Rroftë populli ynë heroik, punëtor e revolucionar!

Rroftë Partia e lavdishme e Punës, organizatorja e udhëheqësja e të gjitha fitoreve tona!

Rroftë Fronti Demokratik i Shqipërisë!

Përpara, gjithmonë përpara, për fitore të reja më të mëdha!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 222 (5947) 15 shtator 1967

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 147. Tiranë, 1969

TË ÇOJME NË MASAT PUNONJËSE FRYMËN REVOLUCIONARE TË KËTIJ KONGRESI

Fjala e mbylljes në Kongresin e 4-t të FDSH

16 shtator 1967

Shokë dhe shoqe,

Kongresi i 4-t i Frontit Demokratik po u jep fund me sukses punimeve të tij. Kongresi ynë, që u zhvillua në një atmosferë entuziazmi të madh, që diktohet nga fitoret e arritura, nga gjendja e shëndoshë që karakterizon vendin tonë, nga besimi i patundur në vijën e ndërtimit socialist në të cilën na udhëheq Partia jonë e Punës, ishte shprehja më e qartë e unitetit të çeliktë që karakterizon popullin tonë të bashkuar në Frontin Demokratik.

Tri ditë me radhë ne diskutuam, me një unanimitet të mrekullueshëm, për problemet më kryesore të vendit, të popullit, të së sotmes dhe të së ardhmes së shkëlqyer që e pret atdheun tonë socialist. Ne përcaktuam detyrat e mëdha të Frontit, në mënyrë që ky, si në të kaluarën, edhe në të ardhmen të luajë një rol të dorës së parë për zbatimin e detyrave të rëndësishme që shtroi Kongresi i 5-të i Partisë.

Detyra e të gjithë neve, delegatëve, është të çoj-

më frymën revolucionare, vendimet e këtij Kongresi, në masat punonjëse, në qytet e në fshat, kudo ku populli ynë heroik punon e lufton për lulëzimin dhe për begatinë e atdheut socialist.

Populli ynë po jeton një nga periudhat më revolucionare dhe më të lavdishme të tij. Ai ka vënë të gjitha energjitë, gjithë talentin e vendosmërinë e tij për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për ngritjen e uzinave më moderne, për intensifikimin e bujqësisë dhe për t'i bërë edhe malet pjellore si fshat; ai po lufton me guxim për të çliruar ndërgjegjen nga çdo gjë e huaj, nga zakonet e nga besimet fetare, nga ideologjia borgjeze e patriarkale. Vendi ynë po transformohet, si nga ana materiale, ashtu edhe nga ana shpirtërore. Vija e drejtë e Partisë, masat që ajo ka marrë dhe merr për revolucionarizimin e jetës së vendit kanë vënë në lëvizje gjithë popullin tonë të mrckullucshëm.

Në këtë situatë revolucionare akoma më qartë po dalin në pah karakteristikat e popullit tonë: dashuria e tij për Partinë e atdheut, patriotizmi i tij, shpirti luftarak, talenti dhe aftësitë e tij dhe, mbi të gjitha, fryma e tij revolucionare dhe përparimtare. Këto karakteristika, kjo frymë sunduan edhe këtu në Kongresin tonë të Frontit Demokratik, sepse pjesëmarrësit e tij, ju, shokë delegatë, përfaqësuar denjësisht ndjenjat e popullit punonjës që ju kishte zgjedhur.

Fronti Demokratik, bashkë me të gjitha organizatat e tjera të masave, duhet t'aj mbajë të gjallë e ta zhvillojë më tej frymën revolucionare që përfshin sot vendin tonë, në mënyrë që gjithë populli ynë, klasa

punëtore heroike, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia popullorë, rinia e lavdishme dhe gratë trime të vendit tonë të dhjetëfishojnë forcat, të zhvillojnë iniciativat krijuese, që vendi ynë të ecë me hapa akoma më të mëdhenj përpara, që industria, bujqësia, arsimit e kultura, jeta e popullit të përparojnë, që atdheu ynë të bëhet më i fortë e më i begatshëm. Vendimet e këtij Kongresi të përdoren si një armë e rëndësishme për të vënë në lëvizje për këtë qëllim të lartë e fisnik të gjitha organizatat e Frontit Demokratik, të gjithë aktivistët dhe anëtarët e tij.

Shqipëria socialiste, nën udhëheqjen e Partisë, është kalitur e forcuar si asnjëherë. Ajo është e fortë dhe e paprekshme, ashtu siç është populli ynë heroik. Partia jonë, me vijën e saj të drejtë, me qëndrimet e saj parimore marksiste-leniniste, me luftën e saj të guximshme kundër armiqve të shumtë e të pabesë, në krye të të cilëve qëndrojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët hrushovianë e titistë, ka bërë që vendi ynë të gëzojë përkrahjen, dashurinë dhe solidaritetin e gjithë popujve dhe të forcave revolucionare të botës.

Por ne të mos harrojmë për asnjë çast se armiqët tanë, imperialistët, revizionistët dhe shërbëtorët e tyre, i kanë halë në sy Republikën tonë, popullin tonë. Prandaj ta mbajmë barutin të thatë dhe të ngremë vigjilencën revolucionare. Vendimet e Kongresit tonë të na shërbejnë për të forcuar punën për mbrojtjen e atdheut, për t'i edukuar masat me frymën e patriotizmit socialist, për t'i bërë ato sa më të ndërgjegjshme se çështja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut, çështja e

mbrojtjes së tyre, është gjëja më e shenjtë, për të cilën i madh e i vogël, në çdo moment, duhet të jetë gati të japë edhe jetën e tij.

Të dashur shokë,

Le t'i përvishemi punës së madhe që na pret për të vënë në jetë vendimet e rëndësishme të këtij Kongresi.

Më lejoni që, në emër të Këshillit të ri të Përgjithshëm që ju zgjodhët, t'ju falënderoj për besimin e madh që treguat ndaj nesh dhe t'ju siguroj se ne do të vëmë të gjitha energjitë tona, pa kursyer asgjë, për të zbatuar porositë e Kongresit, për të farkëtuar unitetin revolucionar të popullit tonë, për të bërë që Shqipëria jonë e dashur, nën udhëheqjen e Partisë së Punës, të marshojë drejt fitoresh të reja, akoma më të mëdha, në rrugën e socializmit e të komunizmit dhe të ndrijë përjetë, këtu në buzë të Adriatikut, si kësh-tjellë e pamposhtur e marksizëm-leninizmit fitimar.

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Partia e Punës, udhëheqëse dhe organizatore e të gjitha fitoreve tona!

Lavdi popullit tonë trim e patriot!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 224 (5949), 17 shtator 1967

Botohet sipas gazetës «Zëri i popullit», nr. 224 (5949), 17 shtator 1967

KINEZËT TË KUPTOJNË MIRË SE NE JEMI MARKSISTË-LENINISTË, I KRITIKOJMË PËR GABIMET QË BËJNË

*Radiogram drejtuar delegacionit të PPSH dhe
të Qeverisë së RPSH¹*

26 shtator 1967

E rilexuar fjalimin e tij² dhe ai e ka thënë atë.

1. Qëndrojmë në atë që biseduam që t'ua vini në dukje, duke i cilësuar fjalët e tij jomarksiste dhe jomiqësore për vendin dhe për Partinë tonë.

1 Prej 26 shtatorit deri më 14 tetor 1967 një delegacion i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i Qeverisë së RPSH bëri një vizitë miqësore në Kinë për të marrë pjesë në festimin e 18-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës.

2 Është fjala për një fjalim të mbajtur në shtator 1967 nga Lin Biaoja, në të cilin ai, përveç mburrjeve megalomane për PK të Kinës dhe ekzaltimit të situatës në Kinë, shprehte pikëpamjen se «gjendja në të gjitha vendet e Evropës është e zezë», duke bërë kështu një insinuatë kundër vendit tonë dhe PPSH. Kur delegacioni ynë kërkoi të njihej me këtë material, ai iu dha i riparuar.

2. Gjenerali momentin e përshtatshëm që të mos e marrin sikur keni vajtur për t'u thënë këtë dhe jo për festë e për t'i mbështetur. U thoni, ashtu siç është realiteti, që në momentin e fluturimit morët dijeni mbi atë fjalim.

Në këtë mënyrë e lokalizojmë problemin, ua themi ç'mendojmë, u lëmë, gjithashtu, të kuptojnë se nuk kemi mendimin që kjo përbën vijën e tyre ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Ata do të shqetësohen shumë dhe mendojmë se do ta riparojnë. Derisa çështjet mund të zhvillohen kështu, interesat e mëdhenj e kërkojnë që problemi të lokalizohet dhe atëherë vazhdoni programin, si miq dhe shokë.

Me një fjalë, ata të kuptojnë mirë se ne jemi marksistë-leninistë, i kritikojmë për gabimet që bëjnë, s'mbajmë gjë përsipër, por, kur këto gabime ndreqen, miqësia jonë ecën përpara dhe kalitet.

Kjo mënyrë e shtruarjes duhet të mbështetet edhe në supozimin se ai mund të mos ketë menduar për vendin tonë kur ka folur, pse dihen deklaratat e tyre zyrtare ndaj nesh, por fakti është fakt, ai e ka thënë nga megalomania etj., etj.

Prandaj, si kurdoherë, të jemi në lartësinë e Partisë sonë, të shikojmë interesin e madh kombëtar dhe ndërkombëtar në rrugën marksiste-leniniste, se, ç'është e vërteta, të gjithë me të drejtë u nevrokosëm ca dje në mëngjes, kur mësuam ç'kishte thënë.

Kemi bindjen e plotë se ju do ta zgjidhni si duhet edhe këtë çështje.

Ju përqafojmë

E n v e r

H y s n i

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TA BËJMË USHTRINË POPULLORE NJË SHKOLLË TË MADHE REVOLUCIONARE, POLITIKE DHE USHTARAKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shtator 1967

Në fillim të mbledhjes për shqyrtimin e këtij problemi shoku Enver Hoxha u interesua dhe i pyeti shokët e ushtrisë për ta informuar si qëndron në përgjithësi gjendja ekonomike e oficerëve pas masave që janë marrë:

Përveç oficerëve të aviacionit, që e dimë se janë të rregulluar, të tjerët a janë sistemuar me shtëpi? Si domos oficerët e tjerë, të shpërndarë në qendrat e stërvitjes, si janë nga kjo anë? Po furnizimi i tyre si

¹ Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim raportet e komiteteve të Partisë të disa reparteve ushtarake «Mbi punën politike e ideologjike në ushtri dhe në mënyrë të veçantë me rininë» ku asistonin edhe sekretarët e komiteteve të Partisë të këtyre reparteve.

bëhet? U shkojnë fëmijët në shkollë? Oficerët që i kanë fëmijët të rritur ç'bëjnë me këta, në qoftë se familjet e tyre qëndrojnë me ta në ato qendra?

Shokët e komiteteve të Partisë të reparteve ushtarake i raportuan Sekretariatit të Komitetit Qendror se organizatat-bazë të Partisë dhe komandat kanë treguar një kujdes më të mirë dhe këto çështje, me përjashtim të rasteve të rralla, nuk përbëjnë ndonjë problem. Megjithatë, shoku Enver Hoxha u rekomandoi atyre që organizatat e Partisë të interesohen, vazhdimisht edhe për të tilla çështje. Pastaj ai pyeti:

A ka burokratizëm nga komandat më të larta në drejtimin e reparteve vartëse? Udhëzimet që dërgohen nga lart kanë kurdoherë frymë revolucionare, apo mbi-sundon në to, pak a shumë, ana teknike? Shokët e Komandës dhe të Drejtorisë Politike a i kanë ndërruar metodën dhe stilin e punës ndaj reparteve dhe organizatave më të ulëta të Partisë në ushtri dhe ku shikohen ndryshimet në këto çështje?

Duke u interesuar për ruajtjen dhe për zhvillimin e traditave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shoku Enver Hoxha pyeti sekretarin e komitetit të Partisë të repartit, që mban emrin e Brigadës së Parë Sulmuese të UNÇSH, si e kanë organizuar ata këtë punë dhe, pasi dëgjoji përgjigjen e tij, porositi:

Ju, shokët e Brigadës së Parë, si edhe shokët e reparteve të tjera, duhet t'i studioni, t'i ruani dhe t'i zhvilloni më tej traditat e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, të Brigadës së Parë e të çdo njësie tjetër, emrin e të cilave mbajnë sot repartet tona. Për këtë, për shembull, ju shokët e Brigadës së Parë, së bashku me

ushtarët dhe me oficerët, të organizoni takime e marshime dhe të bëni shpjegime në terren, në rrugët e në shtigjet ku ka luftuar e ku ka kaluar Brigada e Parë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Çështja është që efektivit i Brigadës së Parë duhet t'i njohë mirë traditat e paraardhësve, luftën, përpjekjet dhe sakrificat e tyre, rrugën e lavdishme nëpër të cilën kanë kaluar ata etj. Në këto marshime të venë të gjithë të rinjtë.

Por, me sa thatë edhe ju, gjer tani këtë punë nuk e keni organizuar, domethënë, sikur juve, shokëve të Brigadës së Parë, t'ju bëjnë pyetje anëtarët e organizatës së rinisë në repart, nëse e njihni këtë ose atë vend ku ka rënë në përpjekje Brigada në kohën e luftës, nuk do të keni ç'tu thoni, veçse këto që i dini vetëm në letër, kurse ata do të insistojnë se duan t'i njohin këto përpjekje në vendet ku kanë ngjarë. Atëherë ju do të filloni të justifikoheni: jo nuk keni kohë, jo nuk keni mundësi të lëvizni dot etj. Kjo të lë të kuptosh që planet e punës edukative ju i bëni në mënyrë shumë burokratike.

Kjo, mendoj unë, është një çështje me rëndësi që duhet ta shikojnë të gjitha repartet e ushtrisë sonë. Çdo gjë ato ta planëzojnë me kujdes, çdo përpjekje të paraardhësve në repartin përkatës ta shohin në vend, siç kemi thënë. Të punojmë, pra, që t'i zbatojmë në mënyrë joformale, po konkrete, të gjitha ato që kemi thënë për të njohur vendet, terrenet, shtigjet nëpër të cilat do të kalohet në rast lufte kundër armikut. Kjo do të jetë një gjë shumë e mirë. Pastaj ju oficerët duhet të njihni jo vetëm rrugën ku kanë kaluar Brigada e Parë, e katërt,

e pestë, e gjashtë etj. të UNÇSH, po gjithë territorin e vendit tonë, të njihni në mënyrë të veçantë, si në pëllëmbë të dorës, vendin ku është vendosur reparti juaj. Pra, edhe traditat e çdo brigade duhet të njihen mirë, edhe gjithë territori i Republikës, po, në radhë të parë, ambienti ku është vendosur reparti që drejtoni.

Pastaj shoku Enver Hoxha kërkoi që Sekretariati të informohej lidhur me luftën kundër burokratizmit në ushtri. Pasi dëgjoji shokët e ftuar, ai vazhdoi:

Po kur ju vijnë shokë nga lart u qëndrojnë besnikë në mënyrë mekanike udhëzimeve, apo jua shpëgojnë mirë çështjet? Si jua japin udhëzimet, këshillat etj.? A mendoni ju se kanë bërë ndonjë përparim shokët e Ministrisë së Mbrojtjes në krahasim me të kaluarën?

Shokët kryesorë që vijnë nga qendra, përveç konsultimeve që bëjnë me ju, a bëjnë takime edhe me bazën? A venë ata të marrin takim me oficerët në qendrat e stërvitjes për të parë si i kanë kuptuar dhe si i zbatojnë direktivat dhe udhëzimet ushtarët dhe oficerët, apo kufizohen vetëm me takimet që bëjnë me ju, shokët e shtabit?

Sekretarët e komiteteve të Partisë të këtyre reparteve sugjeruan se organet e forumet më të larta duhet të bëjnë më shumë në drejtim të përgjithësimin të përvojës së mirë e t'i ndihmojnë edhe më mirë për t'u hapur horizonte në problemet që preokupojnë repartet.

Sekretari i komitetit të Partisë të repartit ushtarak N raportoi se me nxënësit dhe me arsimtarët e shkollës 12-vjeçare të qytetit, ku është vendosur ky

repart, kanë organizuar stërvitje ushtarake dhe qitje me artileri për të gjitha specialitetet e kësaj arme, që prej janarit deri në korrik të këtij viti dhe rezultatet e qitjes kanë qenë njëlloj si ato të ushtarëve efektivë. Kjo ka forcuar akoma më shumë marrëdhëniet midis repartit ushtarak e shkollës dhe ka rritur gatishmërinë luftarake të rinisë. Por, me gjithë këtë punë të mirë që kanë bërë, shokët e repartit ushtarak nuk kanë mbajtur evidentimet e nevojshme.

Lidhur me këtë problem shoku Enver Hoxha dha këto porosi:

Mësuesit dhe nxënësit, që stërviten nga shokët e ushtrisë për të mësuar, për shembull, artilerinë, duhet të marrin patjetër ndonjë dëshmi të veçantë, me qëllim që komanda t'i ketë parasysh në kohë mobilizimi. Në këtë dëshmi të thuhet që ky mësues ose ai nxënës ka bërë kaq muaj stërvitje në artileri, të tregohet me ç'rezultate ka dalë gjatë stërvitjes etj. Pastaj në dokument të jenë edhe vërejtje të tjera të veçanta dhe mendimi i komandës së repartit, nëse ky njeri në kohë lufte mund të komandojë një nën-repart ose një repart etj. Unë besoj se këto gjëra nuk mbahen fare në shënim. Të tilla shënime ju shokët e ushtrisë dhe komandat duhet t'i keni dhe t'i mbani kurdoherë në evidencë. Kjo punë të organizohet medoemos, ndryshe përse i mësojmë këta njerëz? Po të mos mbahen shënime, atëherë të gjithë këta, kur të venë ushtarë, ose do të stërviten në drejtime të tjera, ose do të fillojnë nga e para dhe do të përsëritin të njëjtat gjëra që kanë mësuar gjatë stërvitjeve që kanë bërë në jetën civile. Në këtë mënyrë

e gjithë kjo punë do të na vejë kot dhe, si rrjedhim, komandat do të na mbeten pa njerëz. Gjersa me këta kuadro që mësojnë për qitje me top bëhet një punë përgatitore, ne përfitojmë kohë dhe fonde me një punë të tillë. Këto stërvitje nuk i bëjmë kot, po me qëllim që të përgatiten kuadro në masë për të plotësuar nevojat që kemi në njerëz në armët e ndryshme të ushtrisë.

Prandaj, për të gjitha këto punë që po bëhen, duhen mbajtur shënime në rregull, se ato kanë rëndësi të madhe, nuk janë lodra. Kështu, gjithçka të bëhet gjatë stërvitjeve të reflektohet në dokumentet e komandës dhe të çdo personi, të vihen në dukje rezultatet e kësaj pune, në mënyrë që, kur të bëhet mobilizimi, çdo gjë të jetë e përgatitur. Nga të tilla stërvitje ne duhet të përfitojmë sa të jetë e mundur më shumë kohë dhe kjo punë të merret me seriozitetin më të madh. Ata që fillojmë t'i mësojmë tani, mbase nuk bëjnë për oficerë, se janë njerëz të thjeshtë, po pas 6-7 muaj stërvitje ata që do të dalin me rezultate të shkëlqyera e do të dallohen, ne mund t'i bëjmë, ose t'i konsiderojmë oficerë ose nënoficerë rezervë të ardhshëm për në kohë lufte, të cilëve mund t'u japim pa frikë të drejtojnë një repart.

Sekretari i komitetit të Partisë të repartit ushtarak N shtroi para Sekretariatit të Komitetit Qendror problemin e ngritjes ideopolitike të kuadrit politik, të punëtorëve politikë, të cilët në disa raste nuk u përgjigjen detyrave të kohës, nivelit të vetë ushtarëve, që janë me shkollë 7 e 8-vjeçare ose të mesme.

Atëherë, shoku Enver Hoxha, duke pyetur për

nivelin dhe për detyrat që kryejnë sekretarët e organizatave të rinisë, të cilët janë ushtarë të shërbimit të detyrueshëm, i sugjeroi sekretarit të komitetit të Partisë të brigadës:

U vini syrin nja dhjetë vetave që keni atje nga këta sekretarë, i stërvitni dhe i përgatitni, jo vetëm në drejtim të punës politike, por edhe të punës ushtarake komanduese dhe pastaj bëni me ta një propagandë të madhe që t'i bindni të rrinë në ushtri, për t'i destinuar për punëtorë politikë.

Duke diskutuar lidhur me gatishmërinë dhe me përgatitjen tekniko-ushtarake të kuadrit, sekretari i komitetit të Partisë të repartit ushtarak N i raportoi Sekretariatit të Komitetit Qendror punën e mirë që bëhet në këtë drejtim në repartin ku ai punon. Ai tregoi edhe aktin e aviatorit Bilal Sina i cili, megjithëse iu shua motori i aeroplanit gjatë fluturimit, e solli atë në aeroport. Shoku Enver Hoxha lidhur me këtë theksoi:

Çdo gjë e bën njeriu dhe jo mjeti. Aeroplanin, pra, e ktheu shëndoshë e mirë Bilal Sina, se mund të ndodhë që një aeroplan teknikisht të jetë fare në rregull dhe piloti për paaftësi ta hedhë në erë. **Pra, faktori kryesor, vendimtar, si në çdo rast, është kurdoherë njeriu.**

Në fund të mbledhjes së Sekretariatit të Komitetit Qendror, shoku Enver Hoxha, duke e marrë përsëri fjalën, bëri këto konkluzione:

Kisha për të thënë edhe disa fjalë, megjithëse ato që do të prek, janë çështje që në përgjithësi dihen.

Desha të theksoj me këtë rast që ju, shokë të

ushtrisë, siç e thoni edhe vetë, duhet ta bëni edhe më mirë kombinimin e punës politike me atë ushtarake. Këtu ka rëndësi puna përgatitore e atyre që referojnë në byro, në organizatën-bazë, në komitetin e Partisë dhe përpara ushtarëve. Ata të kenë mirë parasysh që asnjë çështje ushtarake të mos e shtrojnë në forumet e Partisë, në organizatat-bazë ose në repart, pa e shoqëruar atë kurdoherë edhe me një punë politike dhe ideologjike të gërshetuar mirë. **Ju duhet t'i rishikoni mënyrat dhe metodat e punës së përgatitjes politike me një sy revolucionar dhe jo të inkua-druara, siç bëheshin përpara, kur çdo veprim ushtarak, shoqërohej me një përgatitje politike të kufizuar brenda disa caqeve. Ne duhet t'i kapërcejmë këto kufizime.**

Kur flas për përgatitjen politike, ju nuk duhet të kuptoni vetëm punën politike specifike të lidhur vetëm me problemin ushtarak, sepse nuk është kjo e vetmja. Mundet dhe duhet të ngjasë që edhe në problemet e tjera që nuk kanë fare lidhje me përgatitjen ushtarake të trupës dhe të oficerëve, të flitet për çështje politike. Po marr një shembull, që, nga ana politike, mund të duket si pa lidhje me problemet ushtarake. Ta zëmë, kur u flasim ushtarëve për rëndësinë e madhe politike dhe ekonomike të sigurimit të bukës. Kjo mund të duket sikur nuk ka fare lidhje me armët ose me përgatitjen e tyre ushtarake, po kjo temë ka një kuptim të madh politik. Punëtori politik mund të gjejë shumë probleme të tilla politike, me qëllim që bashkë me edukimin ushtarak ta bëjë ushtarin edhe politikisht të zotin, të zgjuar dhe të mprehtë për de-

tyrat e tij. Në qoftë se përgatitja politike do të kufizohet vetëm brendapërbrenda punës ushtarake dhe stërvitjes, ose do të punohet që ajo të puqet ngushtë vetëm me temat ushtarake që zhvillohen në raste të caktuara, atëherë ka rrezik që ne të bëjmë një punë politike formale.

Metoda e përdorur nga ju për edukimin politik dhe ideologjik të efektivit të forcohet akoma në qendrat e stërvitjes duke marrë parasysh ndërtimin e ushtrisë sonë tani.

Koncepti «ushtar» ka kuptim të thjeshtë në hierarkinë ushtarake dhe te disa oficerë mund të ekzistojnë mentalitete nënvleftësimi për ushtarët, sipas të cilave, këta janë në shkallën e fundit të kuptimit të problemeve, kurse oficeri i di të gjitha dhe vetëm këtij i ka vënë detyrë Partia t'u shpjegojë ushtarëve çdo gjë. Në ushtrinë tonë sot nuk është më gjendja e disa vjetëve përpara, tani te ne ka ushtarë që në shumë raste, për sa i përket kulturës, qëndrojnë më lart edhe se ndonjë oficer. Është një lumturi për vendin tonë që tani kemi ushtarë me shkollë të mesme dhe 7 e 8-vjeçare, por kjo gjendje duhet të zhdukë te kuadrot tanë pikëpamjen e vetëkënaqësisë dhe të iluzionit të ngritjes së tyre të shumanshme. Oficerët tanë të shfrytëzojnë me kujdes edhe metodikat që, siç na tha një shok këtu, përdoren në repartin ku është ai. Ato duhet të perfeksionohen kudo dhe vazhdimisht, sidomos në qendrat e stërvitjes.

Kjo ka edhe një gjë tjetër të mirë, lufton zyrtarizmin në dhënien e urdhrave, në zhvillimin e leksioneve etj. Në rast se ne i lejojmë ushtarët të shfaqin

lirisht pikëpamjet e tyre dhe i aktivizojmë të flasin, me një punë të tillë ndihmojmë të luftohet zyrtarizmi. Oficeri ynë nuk është njeri me nivel të ulët, pa mend e pa kulturë. Ai, kur sheh se gjithë kjo masë ushtarësh zhvillon leksione, biseda, bën diskutime në nivel të mirë, si njeri i Partisë, do ta ndiejë se është anakronik me zyrtarizmin e tij, se do të shohë që ndryshe vepron masa, ndryshe vepron ai dhe do të bëjë medoemos përpjekje që ta ndryshojë metodën e punës.

Pra, aktivizimi i vetë ushtarëve për punë politike është një gjë e mirë që duhet zgjeruar e duhet thelluar më tej. Në këtë drejtim oficerët duhet t'i ndihmojnë aktivisht ata. Në asnjë mënyrë të mos mendojnë oficerët se u ulet autoriteti, në rast se i lënë ushtarët të flasin dhe të shpjegojnë tërë kohën gjatë orës së punës politike dhe ata vetë, kur është nevoja, të bëjnë vetëm disa ndërhyrje me mendime plotësuese.

Një çështje tjetër që më ra në sy është se në një nga raportet thuhet që plani i stërvitjes është realizuar me sukses dy muaj para afatit. Kjo është një gjë shumë e mirë. Komanda këtë çështje duhet ta ndjekë në të gjitha repartet, se koha e fituar është flori.

Ne kemi thënë shpeshherë që leksionet të pastrohen nga ujërat dhe të fitohet koha e humbur nga gjërat e panevojshme. Të fitosh, për shembull, dy muaj kohë në përgatitjen luftarake, është diçka me shumë rëndësi. Kjo do të thotë që ne të shohim planëzimin e punës mësimore gjatë këtyre dy muajve, për ta shfrytëzuar këtë kohë të fituar për veprimtari të tjera politike dhe për punë edukimi. Kështu, krijohen mundësi të bëhet më mirë edhe punë politike,

edhe ekonomike. Mirëpo kur vjen puna në letër, themi se kemi pak kohë për materializimin historik, pak për atë ose për këtë lëndë. Prandaj përvoja që na jepet në këtë material, të përhapet; të punojmë kudo që të fitojmë kohë dhe këtë ta planëzojmë, në mënyrë që koha e fituar të mos na shkojë bosh, po, përveç atyre që kemi në program, të mund të bëjmë edhe punë tjetër politike, edukuese dhe ekonomike. Në këtë mënyrë ne do të kemi një fitim të madh.

Edhe një çështje tjetër kisha. Shokët që kemi thirrur sot në këtë mbledhje na thanë se bëjnë me ushtarët edhe recensione të librave artistikë e politikë. Kjo punë, natyrisht, mund të ketë të meta, po është një punë serioze, me shumë rëndësi, pse ndihmon për të sqaruar masën e ushtarëve, i ndihmon ata t'i kuptojnë më mirë ato që lexojnë, nxit dëshirën e tyre për lexim. Këto lexime ju duhet t'i shikoni pak më gjerë, të mos kufizoheni vetëm brenda kuadrit ushtarak. Kjo është një metodë orientimi pune për ushtrinë, që ushtari e bën të vetën dhe, kur kryen shërbimin ushtarak, e çon në familje dhe në punë, te shokët e tij. Prandaj mos e shihni shumë ngushtë këtë gjë, vetëm si një detyrë të thjeshtë që ju caktohet posaçërisht nga Partia; thellohuni në brendinë dhe në efektin e madh që shkakton kjo punë te ushtarët, të cilëve t'u bëhet shprehi dhe kur largohen nga ushtria të marrin me vete edhe këtë, ashtu si shumë metoda pune të pëlqyeshme në drejtime të ndryshme që i fitojnë gjatë kohës së shërbimit ushtarak.

Ju duhet t'ju preokupojë më tepër çështja e përgatitjes së kuadrit në shumë drejtime. Këto çështje i

lidhni mirë, mendoni që ushtari që keni sot në repart, nesër do të vejë në fshat, tjetri në uzinë, një i tretë do të punojë mësues etj. Prandaj oficeri të përpigjet që metodën e drejtë të punës së studimit dhe të kryerjes së çdo pune tjetër që bëhet në ushtri, t'ua rrënjosë ushtarëve në kokë dhe në shpirt, që t'u mbetet për gjithë jetën, pse kështu do t'i kemi sjellë një shërbim të madh vendit.

Kuadrot e ushtrisë duhet t'i njohin thellë problemet shoqërore që preokupojnë Partinë dhe vendin në përgjithësi dhe, në mënyrë të veçantë, ato të zonës ku vepron reparti. Mbi këtë bazë të zhvillohet edhe tematika e programit të punës ideopolitike, me qëllim që ushtarët e reparteve të përgatiten si kuadro politike, që, kur të kthehen në fshatrat e tyre, të dallohen si njerëz të pararojës dhe të veprojnë kurdoherë si të tillë. Prandaj të mos bëhet punë politike për punë politike, kjo të lidhet me fshatin, me problemet ekonomike e shoqërore që preokupojnë atje Partinë, me jetën e me luftën e fshatarëve etj., në mënyrë që ushtarët t'i njohin mirë këto probleme, të jenë të lidhur me to. Kjo punë t'i bëjë ata që të mos thonë se në ushtri mësuan vetëm topin dhe pushkën, po të ndiejnë se atje morën njohuri edhe për shumë çështje shoqërore dhe ekonomike që do t'u hyjnë në punë çdo ditë.

Iniciativa e përvetësimit të një, dy ose më shumë specialiteteve nga ushtarët është, gjithashtu, një gjë shumë e mirë dhe me rëndësi të madhe. Këtë iniciativë ne duhet ta përhapim në gjithë ushtrinë. Rëndësia nuk qëndron vetëm në përvetësimin e specialiteteve ushtarake, po edhe të zanateve të ndryshme që

ushtarit do t'i shërbejnë, kur të rikthehet në jetën civile, pas mbarimit të shërbimit. **Ushtria është si një familje, ajo është një shkollë e madhe.** Atje nevojiten zdrukthëtarë, këpucarë, rrobaqepës, kuzhinierë, kovaçë e të tjerë, me një fjalë, njerëz të të gjitha mjeshtërive. Prandaj këto mjeshtëri është mirë të zhvillohen kudo, në çdo repart dhe ushtarët t'i mësojnë, në radhë të parë, për të shërbyer sa më mirë në ushtri, por edhe si të largohen andej, zanati që do të kenë marrë t'u vlejë edhe në jetën civile. Ne duhet të përpiqemi që, po të ketë mundësi, të mos mësojnë zanate një numër i kufizuar ushtarësh, por çdo ushtar gjatë kohës në ushtri të mësojë diçka, t'i zërë dora diçka. Kjo, natyrisht, do të jetë një përgatitje empirike prej 1 ose 2 vjetësh, po, sidoqoftë, kur ushtari mëson në ushtri për kuzhinier, kur në familjen e tij, të të afërmeve të tij në fshat ose në mensat që do të ngrihen kudo në kooperativat bujqësore, nuk i gatuajnë mirë gjellët, atëherë këtë mjeshtëri ai do t'ua mësojë edhe këtyre. Ose në fshat tani kemi shumë nevojë për kovaçë, sikurse për muratorë, marangozë e për artizanë të çdo lloji; përgatitja e ushtarëve në të gjitha këto fusha do t'i shërbejë, pra, jo vetëm ushtrisë, po edhe zhvillimit, sidomos të fshatit. Prandaj e gjithë kjo çështje duhet parë me një sy të veçantë.

Më në fund doja të prekja edhe një herë çështjen e ngritjes së nivelit arsimor të kuadrove, ndjekjen me kujdes e me zell të madh të shkollave, nga ana e tyre. Nga Partia dhe nga komandat duhet të merren masa serioze për vazhdimin e arsimit të përgjithshëm nga ana e oficerëve, sepse kur kuadri nga ana

kulturore është me nivel më të ulët nga ushtarët e vet, atij do t'i ulet patjetër autoriteti dhe, si rrjedhim, do të ulet edhe autoriteti i ushtrisë. Mungesa e ngritjes arsimore shkakton lindjen e prirjeve jodemokratike tek oficerët që komandojnë. Duhet të kuptohet se një nga burimet e arrogancës, të mbytjes së iniciativës dhe të kritikës në ushtri, sot, është edhe kjo. Është e qartë se, kur oficeri është me nivel më të ulët se ushtarët nga kultura e përgjithshme, atëherë ose ai do të lejojë t'i dalë kallaji dhe t'i ulet autoriteti, ose do të fillojë të bëhet arrogant dhe njerit do t'i thotë: «Pusho ti, mos fol!», tjetrit: «Mbylle gojën!» etj., dhe do të bëjë që ushtari të dobësojë dashurinë për repartin, për ushtrinë. Ose kur të shohë ndonjë ushtar mjaft të zgjuar që të ngrihet dhe të zhvillojë biseda e diskutime në nivel të lartë, te ndonjë oficer që ka mbetur prapa nga kjo anë, do të fillojë të lindë dhe të zhvillohet një sedër shumë e sëmurë, se do të shohë që ky ushtar po e errëson dhe, në mos haptazi, tërthorazi, do të gjejë një mijë e një mënyra që ta heqë qafe. Kjo çështje, pra, ka rëndësi të madhe, prandaj oficerët tanë të punojnë shumë dhe, në këtë drejtim, Partia dhe komandat duhet të tregojnë kujdes të madh për ndjekjen e shkollave nga ana e tyre.

Ju përgëzoj shokë për sukseset që keni arritur dhe ju uroj suksese të reja më të mëdha në punën tuaj!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Në ndihmë të Ushtrisë Popullore», vëll. III, f. 170

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Në ndihmë të Ushtrisë Popullore», vëll. III, f. 170

TË EVITOHJË HALLKAT E TEPËRTA NË NDËRTIMIN ORGANIZATIV TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shtator 1967

Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët, prandaj nuk do të hyj në hollësi, se sukseset, dobësitë, metodat dhe format e punës që kanë dhënë rezultate dhe që ne duhet t'i përmirësojmë akoma, njihen nga të gjithë, po dëshiroj të ngre disa probleme të tjera.

Lidhur me mbledhjet e hapëta që duhet të bëjnë organizatat-bazë të Partisë, të kihet kujdes që ato të zhvillohen në mënyrë të tillë që organizatat-bazë të mos kthehen në organizata fronti. Vetëm kur ka ndonjë problem me rëndësi të ftohen në mbledhjet e organizatave-bazë punonjësit e paorganizuar në Parti, me

¹ Në këtë mbledhje u thirrën në raport komitetet e Partisë të rretheve Berat e Pogradec për punën e bërë në zbatim të orientimeve të Byrosë Politike të KQ të PPSH për punën e organizatave-bazë të Partisë në sektorë dhe u diskutua rreth propozimeve për ngritjen e komiteteve të Partisë të zonave.

qëllim që të shohin si bëhen kritika dhe autokritika në Parti, për t'i mësuar, për t'i edukuar ata dhe për t'i armatosur me përvojën dhe me frymën revolucionare të Partisë. Kështu, kur ata të bëjnë mbledhjet e tyre në Front ose në organizatën e bashkimeve profesionale, duke pasur parasysh si i diskutojnë problemet anëtarët e Partisë, si e kritikojnë këta njëri-tjetrin kur zbulohen gabime e të meta, do të luftojnë gabimet e të metat e tyre, pra, do të bëjnë autokritikë, ose do të kritikojnë pa druajtje kur shfaqen të meta e dobësi të shokët e tyre. Edhe në rastet kur anëtarët e Partisë bëjnë gabime që i ka marrë vesh masa, mund të thirren në mbledhje të hapëta të organizatave-bazë punonjës të paorganizuar në Parti dhe, kur të kritikohet në organizatën-bazë komunisti që ka bërë gabimin, ata me siguri do të thonë: «Shikoni ç'i bënë organizata-bazë e Partisë atij; Partia është e fortë dhe, kushdo qoftë ai që nuk punon mirë, ajo i tregon vendin, nuk lejon shtrembërime».

Për organizatat-bazë të Partisë të sektorëve jam dakord me gjithë sa thanë shokët, sepse e kanë justifikuar qenien e tyre. Ato ne i ngritëm për arsye se organizatat-bazë të përgjithshme për ndërmarrjen, institucionin ose për kooperativën bujqësore nuk jepnin rendimentin e duhur, kurse organizatat-bazë të sektorëve janë të lidhura ngushtë me bazën, me problemet, me jetën, prandaj diskutimet në to bëhen më konkrete, kritika dhe autokritika më të hapëta, e, si rrjedhim, edhe edukimi i shokëve bëhet më mirë.

Tani ne duhet të shohim nëse është akoma e nevojshme qenia e organizatës-bazë të përgjithshme apo jo.

Sipas mendimit tim organizata-bazë e përgjithshme, atje ku ka organizatë-bazë sektori, nuk është më e nevojshme, përkundrazi, ajo bëhet një pengesë burokratike. Gjersa organizatës-bazë të sektorit ne i kemi dhënë të gjitha të drejtat të vetëveprojë në bazë të vijës së Partisë, atëherë përse na duhet organizata-bazë e përgjithshme?

Organizata-bazë e përgjithshme sot mblidhet vetëm se është vendosur të bëhet kështu dhe në mbledhjet e saj flitet në vija të përgjithshme, gati njësoj sikur të mos flitej fare. Përveç kësaj, ne shikojmë se na janë krijuar një numër hallkash, siç janë organizata-bazë e sektorit, sekretari dhe zëvendëssekretari i saj dhe mbi këta kemi pastaj organizatën-bazë të përgjithshme dhe byronë e sekretarin e saj. Të gjitha këto janë hallka që venë në kundërshtim me vetëvendosjen dhe vetëveprimin e organizatës-bazë. Prandaj unë propozoj ta studiojmë këtë çështje, të shohim çfarë na jep organizata-bazë e përgjithshme, gjersa ekzistojnë organizatat-bazë të sektorëve dhe sa kohë u ha komunistëve kjo hallkë.

Nga përvoja del se midis organizatës-bazë të përgjithshme dhe organizatës së Partisë në sektorë ka paralelizëm. Organizata-bazë e përgjithshme nuk vepron si duhet, ajo u bën vetëm një shpjegim në përgjithësi problemeve dhe, natyrisht, pengon organizatat-bazë të sektorëve, të cilat, duke respektuar format organizative ekzistuese të ndërtimit të Partisë, duke u ndeshur me një shkallëzim të tillë të organizatës së Partisë brendapërbrenda ndërmarrjes ose kooperativës së bashkuar, kur të dalë një problem në sektor,

në vend që të vendosin për të, njerëzit do të fillojnë të thonë: «Dale, ta shohim, të pyesim një herë edhe organizatën-bazë të përgjithshme, të pyesim byronë e kësaj organizate, të pyesim sekretarin e saj» dhe kështu çështjet në vend që të zgjidhen në kohën e duhur, do të zvarriten. Këtë problem duhet ta studiojmë sa më shpejt. Të shohim, nëse është e nevojshme ta kemi mbledhjen e përgjithshme apo jo dhe, në qoftë se na del që nuk jep rezultate (dhe unë jam i këtij mendimi), atëherë ta zhdukim këtë hallkë. Në ndërmarrje, në institucione e në qendra pune më të mëdha, si dhe në kooperativat bujqësore të bashkuara, përvoja po na tregon se duhet të kemi organizata-bazë partie më të vogla në sektorë. Duke parë që organizatat e sektorëve kanë dhënë rezultate pozitive, atëherë këto duhet t'i mbajmë, prandaj në ndërmarrje e në qendra pune të mëdha, të krijohen kudo organizata-bazë sektori. Atëherë, kur kemi këto, përse na duhen organizatat-bazë të përgjithshme, për fjalë? Por, më parë se të vendosim ta studiojmë çështjen nga të gjitha anët, të konsultohemi me komitetet e Partisë të rretheve për këtë formë të ndërmjetme organizative, pastaj të vendosim nëse do ta heqim ose jo.

Kur them se duhet kujdes në studimin e kësaj çështjeje e kam fjalën që ta shohim nga çdo drejtim rolin e organizatës së përgjithshme, tematikat, vendimet e saj etj. Në qoftë se këtë e kemi si një «mbiorganizatë», si një organizatë më të fortë, atëherë mirë, por po shohim se kjo nuk po e luan dot këtë rol se jeta, lufta është poshtë në bazë, në sektorë. Në qoftë se ne duhet ta kemi organizatën-bazë të

përgjithshme, ajo duhet të jetë e tillë që të përgjithësojë përvojën e të gjitha organizatave të sektorëve dhe një ose dy mbledhjet që do të bëjë gjatë vitit, të jenë me të vërtetë në lartësinë e duhur. Po të jetë kështu mirë, por, në fakt, nuk ndodh kështu, prandaj mendoj se kjo hallkë nuk ka përse të ekzistojë. Në qoftë se do ta heqim këtë duhet të mendojmë kush do ta koordinojë punën e organizatave të sektorëve. Mund të dalë kështu nevoja e krijimit të një byroje ose komiteti partie, duke ia caktuar me kujdes kompetencat që të mos na bëhet pengesë për vetëveprimin dhe iniciativën e organizatave-bazë të sektorëve, por të jetë ndihmës i tyre.

Kur të ketë probleme që duhen diskutuar në një shkallë më të gjërë, atëherë të bëhet aktivi i komunistëve të ndërmarjes, të kooperativës së bashkuar ose të institucionit, pra, një formë tjetër, jo si ajo e organizatës-bazë të përgjithshme. Atje ku nuk ka sektorë, kuptohet vetvetiu, ne do të kemi, si gjer tani, organizatat-bazë të zakonshme.

Lidhur me krijimin e komiteteve të Partisë të zonave, rrethet, që kanë propozuar të ngrihen të gjitha këto, më duket se nuk kanë aspak arsye. Mendoj se ne nuk duhet të lejojmë që të abuzohet në shtimin e komiteteve të Partisë të zonave, se atëherë shkelim kriterin. Tani shohim se po na propozojnë të ngremë komitete jo vetëm në zonat e thella, siç kemi vendosur, por edhe në zonat jo të thella, bile edhe atje ku nuk ka shumë organizata-bazë partie. Ne ngritëm disa komitete partie zonash në krahina të thella dhe jeta e vërtetoi nevojën e tyre. Mirëpo

komitetet e Partisë të rretheve, siç duket, kanë prirje ta përgjithësojnë këtë formë organizative. Po të ecim kështu, siç po na propozohet herë pas here, brenda pak muajve ne do të kemi në çdo rreth nga gjashtë, tetë e nga dhjetë komitete partie zonash. Mua më duket që nuk është e drejtë të veprojmë kështu dhe duhet ta ndalim këtë prirje, sepse, po ta lejojmë, s'do të bëjmë gjë tjetër veçse do të shtojmë instancat e drejtimit, do të krijojmë në rrethe një hallkë të re, së cilës nuk i duhen parë vetëm pluset, por edhe minuset. Në pluset, siç mendojnë shokët e rretheve, mund të llogaritet pikëpamja se komiteti i Partisë që krijohet në zonë do t'i ndihmojë më mirë organizatat-bazë të Partisë. Mirëpo krahas kësaj ane pozitive, kjo ka në vetvete dy minuse më të mëdha: Së pari, komiteti i Partisë i rrethit shkëputet nga baza dhe, së dyti, organizata-bazë do t'i humbasë iniciativën dhe vetëveprimin, pse mbi të do të jenë sekretari, organizata-bazë e përgjithshme, byroja e organizatës së përgjithshme, pastaj komiteti i Partisë i zonës, komiteti i Partisë i rrethit dhe Komiteti Qendror. Kjo, më duket mua, është një burokratizëm me punë të shumta formale. Të gjitha këto hallka do të shkaktojnë me doemos shpërndarjen e shkallëzuar të përgjegjësisë. Prandaj, mendoj të mos e lejojmë në asnjë mënyrë një shkallëzim të tillë, të mos lejojmë formimin e komiteteve të Partisë të zonave atje ku nuk është nevoja.

Ne duhet të jemi shumë të shtrenguar në këtë çështje dhe t'i këshillojmë seriozisht komitetet e Partisë të rretheve që atje ku janë ngritur komitetet e

Partisë të zonave, këto të mos kthehen në instanca burokratike, thjesht në transmetuese urdhrash, që t'u zënë frymën organizatave-bazë dhe t'u shuajnë iniciativën e vetëveprimin, t'i bëjnë që për çdo gjë ato të detyrohen të pyesin komitetin e Partisë të zonës. Pastaj vetë komitetet e Partisë të rretheve në asnjë mënyrë të mos lënë pas dore kontaktet e gjalla me bazën, prandaj edhe atje ku ekziston komiteti i Partisë i zonës, nuk duhet reduktuar takimi i shokëve të komitetit të Partisë të rrethit vetëm me sekretarin e komitetit të Partisë të zonës. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe që në parim kuptohet, po në praktikë për fat të keq nuk zbatohet mirë. Sekretarët e komiteve të Partisë të zonave të shumtën marrin kontakt vetëm me sekretarët e organizatave-bazë, u transmetojnë atyre urdhrat që marrin nga komiteti i Partisë i rrethit dhe mendojnë se janë në rregull me këtë çështje.

Prandaj t'i evitojmë këto komitete partie, pse në propozimet që na janë paraqitur në këtë mbledhje, po shohim kërkesa të pamenduara mirë. Që të kemi një komitet partie në Lekbibaj e kuptoj që është e arsyeshme. Po ç'e do Përmeti komitetin e Partisë të zonës së Ballabanit, që është vetëm gjysmë ore larg qytetit? Lëre pastaj sa i nevojshëm do të ishte komiteti i Partisë i zonës së qendrës së Korçës ose i lokalitetit të Kryevidhit në Durrës, që është dhe në zonë fushore, ose ai që propozohet të ngrihet në Dropullin e Posh-tëm, fare afër Gjirokastrës. Nuk ka asnjë arsye që të ngrihen këto komitete partie. Përse na propozojnë t'i krijojmë këto hallka? Kështu po shkelen kriteret që

kemi vendosur dhe qëllimet për të cilat u mendua ngritja e këtyre komiteteve për disa zona të caktuara.

Prandaj këto dy çështje, si ajo e organizatës-bazë të përgjithshme, edhe kjo e krijimit të komiteteve të Partisë të zonave, duhen studiuar me kujdes e me përgjegjësi dhe mendoj që Sekretariati të mos bëjë lëshime në këtë drejtim.

Atëherë, të shihen këto dy çështje dhe të vendoset përfundimisht, mbasi të bëhen konsultime me shokët e komiteteve të Partisë të rretheve.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

PUNA EDUKUESE ME PUNONJËSIT E ARTIT TË JETË E DENDUR DHE E SHUMANSIIME

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shtator 1967

Ne e kemi theksuar kurdoherë kujdesin e madh që duhet të kenë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe organet e Partisë, veçanërisht për njerëzit e sektorëve ideologjikë. Shfaqje negative ideopolitike nuk shohim të kemi në shkollat e profileve të tjera, kurse në Institutin e Lartë të Arteve që ka një punë delikate, na ndodhin gjëra të tilla.

Diskutimi i këtij problemi që sot kufizohet vetëm me këtë institucion arsimor, ka rëndësi të madhe, pse ka lidhje dhe rrjedhime në gjithë zhvillimin e artit tonë. Ky problem është i gjerë, politik, ideologjik, profesional dhe organizativ. Prandaj të mos mbetemi ve-

1 Në këtë mbledhje ishin thirrur për të raportuar për përgatitjen ideologjike të kuadrit të ri artistik e letrar Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë.

tëm me këtë analizë, ta rishikojmë një çikë më nga afër punën e Institutit të Lartë të Arteve, ta shohim këtë me një frymë të shëndoshë kritike dhe të marrim të gjitha masat që u thanë këtu për të forcuar gjendjen.

Kur theksoj për ta parë këtë çështje me një frymë të shëndoshë kritike, dua të them që as të mos i nënvleftësojmë rezultatet e arritura, as të mos e flemë mendjen për mjaft shfaqje negative që theksohen në raport, që u përsëritën këtu dhe janë mjaft shqetësuese. Këto gjëra ndodhin në këtë institucion edhe për shkak të vetë natyrës që ka ky sektor ku favorizohen shfaqje negative. Po të lejojmë që të zhvillohet situata pa një kontroll të fortë politik dhe ideologjik, pra, pa dorën dhe kujdesin e Partisë, njerëzit atje, për shkak të terrenit, mund të shkasin më lehtë, si në brendi, ashtu edhe në formë. Natyrisht, një gjë e tillë do të ngjasë, po të mos punohet për formimin ideologjik të pedagogëve, të artistëve dhe të studentëve. Prandaj roli i Partisë dhe i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës për ta vënë në vend si duhet këtë çështje të madhe, është shumë i rëndësishëm. Unë nuk them se Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës dhe ministria nuk janë interesuar për këtë institucion, po kujdesi në këto kushte mendoj se duhet të jetë akoma më i madh. Sidomos Ministria e Arsimit dhe e Kulturës këtë çështje të mos e shikojë vetëm teknikisht po, në radhë të parë e kurdoherë, politikisht, ideologjikisht dhe në mënyrë të veçantë për çdo degë të këtij sektori.

Në Institutin e Lartë të Arteve ne dërgojmë djem dhe vajza të popullit, që jo vetëm kanë dhe tregojnë

aftësi dhe talente të mëdha, po tek ata mund të them se nuk duken shfaqje të dënueshme dhe të kritikueshme nga ana morale dhe politike. Përkundrazi, kur Partia shtron probleme të mëdha për revolucionarizimin e artit në vendin tonë, të letërsisë, të teatrit, të muzikës, të pikturës etj. dhe të vetë artistëve, ne shikojmë një gatishmëri të madhe nga ana e të gjithë punonjësve të këtij sektori, bile vëmë re shembuj shumë pozitivë që nderojnë ata vetë dhe Partinë. Shembuj na u përmendën edhe sot këtu, kemi lexuar edhe në shtyp se si artistët tanë, kur kanë shkuar në bazë për të punuar e për të dhënë shfaqje, kanë lënë përshtypje shumë të mira në popull, kanë punuar dhe kanë kënduar me vullnet të madh dhe me frymë revolucionare. Mirëpo, kur vijnë brënda sferës së zanaetit, kur mbyllen në guaskën e tyre në institut, në teatër etj., vëmë re që tek ata duken shfaqje, të cilat nuk duhen lejuar. Kjo duhet të na bëjë ta shikojmë me shumë kujdes forcimin e mëtejshëm të punës politike, ideologjike dhe organizative në përgjithësi në këta sektorë e në mënyrë të veçantë në Institutin e Lartë të Arteve ku përgatiten dhe edukohen kuadrot e rinj. Dhe kjo nuk është një punë aq e lehtë. Çështja është që te studentët dhe te trupi mësimor i këtij institucioni të krijohet, në radhë të parë, një frymë e shëndoshë edukimi moralo-politik e ideoartistik proletar.

Të gjithë u kënaqëm kur mësuam nga shoku Manush Myftiu¹ se organizata-bazë e Partisë në Insti-

¹ Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

tutin e Lartë të Arteve është një organizatë e mirë. Atëherë gjersa kemi një organizatë-bazë partie të tillë të mirë, përse të mos kemi atje edhe një organizatë rinie të fortë, që të edukojë në këtë frymë të gjithë kuadrot dhe studentët e institutit?

Prandaj edhe unë, si gjithë shokët që morën fjalën, mendoj të rishikohet e gjithë gjendja në këtë institut, duke filluar në radhë të parë nga pedagogët. Në përgjithësi, pedagogët tanë, duke përfshirë edhe ata të këqij sektori, janë të mirë, por ka nga ata që në formimin e tyre janë me boshllëqe, të cilat ne e kemi për detyrë t'ua plotësojmë. Ata, në radhë të parë, kanë boshllëqe politike e ideologjike dhe pikërisht nga kjo rrjedhin disa pikëpamje jo të drejta të tyre. Ata harrojnë rolin e madh që ka pedagogu për edukimin e nxënësve me moralin dhe me frymën proletare, gjithashtu, nuk njohin mirë vijën ideologjike të Partisë në art, e cila është përpunuar sipas mësimëve të marksizëm-leninizmit dhe zbatohet në luftë të papajtueshme me ndikimet nga ideologjia borgjeze, të cilat te disa mund të kenë lënë gjurmë dhe nuk është aq e lehtë t'ua zhdukim. Kjo mund dhe duhet të bëhet vetëm nëpërmjet ngritjes së tyre ideologjike të pandërprerë dhe nëpërmjet punës së shëndoshë politike dhe ideologjike. Partia dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të studiojnë dhe të përcaktojnë mirë ku qëndrojnë dobësitë e pedagogëve në këtë drejtim, për të forcuar edhe më shumë tek ata partishmërinë në art.

Edukimi ideologjik i artistëve dhe i shkrimtarëve tanë është një punë shumë delikate, së cilës duhet t'i jepet një rëndësi e veçantë edhe në Institutin e Lartë

të Arteve, ku studentët hedhin bazat e formimit të tyre ideologjik e profesional. Në mes të tjerash, të kihet kujdes dhe të punohet që mësimi teorik i botëkuptimit marksist-leninist t'u bëhet i lidhur mirë me profesionin e tyre. Por shohim se pedagogët e marksizëm-leninizmit që dërgojmë në Institutin e Lartë të Arteve, jo vetëm nuk i njohin mirë problemet e artit, por as nuk u vihet detyrë serioze që në dritën e marksizëm-leninizmit, t'i studiojnë thellë ato, të studiojnë, gjithashtu, rrezikshmërinë e artit borgjez dhe këtë t'ua argumentojnë pedagogëve të tjerë të lëndëve profesionale-artistike, artistëve e studentëve që punojnë e mësojnë aty, për t'i edukuar ata me ideologjinë e Partisë. Pa një gjë të tillë nuk do të kemi rezultatet që duam. Pedagogëve ose artistëve, duke dëgjuar leksione të kësaj natyre, të përgatitura mirë ideologjikisht dhe të lidhura me problemet e sektorit të tyre, natyrisht, do t'u mbetet diçka në kokë. Por duhet pasur parasysh që me këtë punë dëgjuesve t'u lihet të nxjerrin edhe vetë konkluzione, ku e kanë mirë dhe drejt dhe ku nuk i kanë drejt pikëpamjet e tyre në fushën e artit, të muzikës, të letërsisë etj., në mënyrë që edhe mendja e tyre të punojë në këtë drejtim. Prandaj pedagogu i marksizëm-leninizmit çdo temë që zhvillon, ta lidhë kurdoherë me luftën që duhet bërë kundër orientimeve bazë të artit, të teatrit, të muzikës borgjeze që ai e di se ekzistojnë në mendjen dhe në pikëpamjet e disa njerëzve tanë në fushën e artit. Në qoftë se ai do t'u flasë vetëm në përgjithësi për marksizëm-leninizmin, pa ua lidhur këtë me problemet e sektorit të tyre në art dhe do të qëndrojë i huaj ndaj shqetësi-

meve të artistëve, të kompozitorëve, të punonjësve të teatrit e të tjerëve, ai nuk e ka bërë detyrën.

Shokëve, që do të caktojmë të japin marksizëm-leninizmin në Institutin e Lartë të Arteve, t'u vëmë detyrë të nxjerrin çfarë kanë shkruar Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini për fushat e ndryshme të artit dhe të kulturës dhe çfarë ka treguar zbatimi krijues i marksizëm-leninizmit në vendin tonë në këto fusha. Kur të japë mësimin e marksizëm-leninizmit, pedagogu të dijë t'i gërshetojë të gjitha këto me nevojat që kanë studentët dhe kuadrot e institutit, pse kështu ai do të ndihmojë pozitivisht për edukimin e tyre, për t'i ruajtur nga ndikimet e huaja. Në këtë drejtim, pra, t'u ngarkohet atyre të punojnë konkretisht, sepse kjo është një detyrë me shumë rëndësi që duhet të kryhet medoemos.

Por në institut mund të kemi edhe shokë që japin marksizëm-leninizmin dhe kanë njëkohësisht njohuri edhe nga piktura, muzika etj. Po të kemi njerëz të tillë, ne duhet të punojmë vazhdimisht, se do të kemi shumë fitim, mbasi, me siguri, puna do të na bëhet më mirë nga këta, sesa po ta bëjë këtë një njeri që nuk ka njohuri nga muzika apo arti.

Përpyekjet që do të bëjmë për edukimin e këtyre njerëzve duhet të sjellin si përfundim zhdukjen e disa karakteristikave mikroborgjeze që ekzistojnë te disa nga artistët dhe shkrimtarët tanë, siç janë: mania e lavdisë personale, prirja që çdo gjë të tyre, sidomos pikëpamjet e tyre, t'i mbivlerësojnë etj. Me këtë nuk dua të them që të hidhemi në anën tjetër, t'i nënvlef-tësojmë pikëpamjet e tyre, pse kur këto janë të drejta, ne duhet t'i inkurajojmë, t'i mbështetim. Por ka raste

që «uni» i bën ata të harrojnë misionin e tyre të lartë dhe të merren me mosmarrëveshjet personale që kanë midis tyre. Gjëra të tilla ndodhin shpesh ndërmjet tyre, sidomos kur i bëjnë kritika njëri-tjetrit. Shumë herë këto kritika janë të drejta, po shpesh ata nuk kanë parasysh dhe nuk vlerësojnë edhe anët e mira që mund të ketë ky ose ai krijues që kritikohet, janë, pra, të njëanshme.

Të marrim, për shembull, një kompozitor, i cili është një kuadër me shumë anë të mira dhe njeri me përvojë në profesion. Në qoftë se një koleg i tij do t'i bëjë atij ndonjë kritikë, që mund të jetë edhe e drejtë, për punën dhe metodën që ndjek, por, në të njëjtën kohë, duke u përpjekur të nënvleftësojë ose duke mos vënë në dukje meritat e shumta të kompozitorit, ky do të marrë menjëherë qëndrim, do të thotë që kritikuesi ia bën këto vërejtje për të ngritur veten dhe çështja do të kalojë, kështu, në plan personal. Në qoftë se kritikuesi i lë pas dore anët e shumta pozitive të kompozitorit dhe kritikën e bën në plan thjesht personal, kjo do të thotë se tek ai ekziston i fortë «uni» personal që e shtyn të nxjerrë në dukje personalitetin e vet nëpërmjet kritikave që i bën tjetrit. Të mos harrojmë se ekzistojnë të tilla shfaqje negative të punonjësit e fushës së artit.

Prandaj puna ideologjike me punonjësit e këtij sektori të jetë e dendur dhe e shumanshme, të jetë e tillë që të ndihmojë efektivisht për të spastruar shumë shfaqje negative të kësaj natyre, që nxjerrin herë pas here kokën edhe në sektorë të tjerë, por që janë më të theksuara te njerëzit e sektorëve të ideo-

logjisë e të kulturës, sidomos tek ata të artit, të muzikës, të teatrit, të letërsisë etj.

Në këta sektorë ka rrezik të depërtojnë teori e koncepte dekadente, revizioniste. Te punonjësit e këtyre fushave herë pas here lindin si kudo probleme. Ka njerëz, për shembull, që thonë: «Ç'është kjo, pse të hidhet poshtë te ne arti klasik?» etj., etj. Ne nuk e hedhim poshtë artin klasik, por e kemi për detyrë që në grumbullin e veprave të artit klasik të marrim pjesët me përmbajtje të shëndoshë, të bëjmë, pra, seleksionimin e tyre, duke zgjedhur ato që na shërbejnë për edukimin e masave tona punonjëse, ato që ideologjikisht nuk bien në kundërshtim me moralin dhe me ideologjinë tonë marksiste-leniniste. Artistët tanë e kuptojnë dhe e pranojnë këtë parimisht, prandaj, kur i bëhet kritika kësaj ose asaj vepre artistike, të muzikës klasike apo të letërsisë, që seleksionimi të bëhet në atë nivel që synojmë ne, kërkohet që punonjësit e artit të jenë të qartë, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht. Ata që bëjnë seleksionimin të japin arsye të shëndosha, të argumentojnë mirë përse nuk na duhet neve kjo ose ajo vepër, në mënyrë që edhe ai që mbron tezën se ne duhet të kemi pjesë klasike në repertorët tanë të bindet se nuk ka të drejtë dhe të pranojë që nga arti klasik ne të shfrytëzojmë ato që na interesojnë dhe që vlejnë për edukimin revolucionar të njerëzve tanë.

Një pjesë klasike mund të ketë një muzikë shumë të këndshme, por duhet parë e analizuar ç'përfaqëson ajo, kujt i shërben, ndjenjat, dëshirat dhe qëllimet e cilës klasë shpreh etj. Po të veprohet në këtë mënyrë,

atëherë nuk ka ç'të thotë ai, i cili kërkon që ne t'u japim masave çdo vepër të artit klasik dhe do të bëjë shumë përpjekje që të ngrihet edhe vetë ideologjikisht që t'i kuptojë çështjet, se një njeri i tillë ka talent, është me Partinë, por ka akoma disa lakra në kokë e duhet t'i pastrojë ato. Partia të punojë dhe ta nxitë që ai të bëjë përpjekje për të bërë pjesë me të vërtetë të bukura, të frymëzuara nga lufta e popullit dhe e Partisë sonë për socializëm.

Ne kemi shumë për të bërë në këtë drejtim dhe duhet ta vazhdojmë një punë të tillë me pedagogët, që në përgjithësi i kemi njerëz me talent dhe të cilëve u kemi besuar edukimin e të rinjve dhe të rejave, pavarësisht se në radhët e atyre që na vijnë në institut paska depërtuar edhe ndonjë me përbërje jo të mirë politike. Po nuk janë këta që bëjnë shumicën atje. Pastaj vija e Partisë është që edhe vajzën ose djalin e një elementi jo të mirë, ta edukojmë me frymën e saj, të përpiqemi që të bëhet një element i vlefshëm që të ecë në rrugën e popullit. Shumica e elementëve që vijnë në institut, pra, janë njerëz të popullit. Po në qoftë se atje ka ndonjë nga këta që thoni ju dhe që nuk qëndron në rregull, mos do ta lejojmë të na krimbë të tjerët? Jo, në asnjë mënyrë! Prandaj të tregohet kujdes në këtë drejtim dhe të mbahet qëndrim i drejtë sipas rastit.

Mund të ketë ndonjë këngëtar me të kaluar jo të mirë, si të vetën, ashtu edhe të rrethit familjar por, që, pas Çlirimit, gjatë këtyre 23 vjetëve, ka qëndruar mirë dhe për të nuk kemi asnjë të dhënë negative. Duke marrë parasysh rrethin shoqëror, të kaluarën e

tij, shkollën që ka kryer, ai mund të ruajë akoma mendime dhe ide të tij që s'përputhen me vijën tonë, ai mund të ketë plot probleme të paqarta. Po, duke parë qëndrimin e tij të mirë pas Çlirimit, a na lejohet neve të marrim masa administrative kundër tij për t'ia zhdukur këto paqartësi? Jo. Ky nuk do të ishte një qëndrim i drejtë. Ai që gjatë gjithë kësaj kohe ka mbajtur qëndrim pro pushtetit, nuk është aq budalla që t'i bjerë së mirës me këmbë, por paqartësi, pikëpamje të shtrembra mund të ketë, prandaj për t'ia zhdukur ato, është detyra e Partisë të punojë me të duke bërë me durim një punë bindëse edukative, politike dhe ideologjike që gradualisht të sqarohet.

Pra, ka rëndësi të madhe çështja e edukimit ideologjik dhe politik të kuadrove artistikë. Edhe ato që ngritën shokët kanë, gjithashtu, rëndësi të madhe dhe t'i thellojmë më tej, pse shkollën ne nuk e bëjmë për të nxjerrë vetëm dy-tre violinistë. Me kuadrot që nxjerrim nga instituti, ne kemi për qëllim t'u japim muzikës dhe artit një zhvillim të madh masiv në vendin tonë. Ne nuk i themi ndonjë djali me talent ta lërë violinën, po tek ai duhet të zhdukim pikëpamjen që e bën të mendojë vetëm për vete e të ushqejë ambicie të sëmura në vetvete, për famë e lavdi personale. Pikëpamje e prirje të tilla nuk janë të shëndosha. Ai mund të ketë talent dhe atë ta zhvillojë, po puna është që edhe kur të arrijë ta luajë violinën në mënyrë virtuoze, të mos shikojë vetëm interesin dhe «unin» e tij, po të vërë interesin e përgjithshëm mbi atë personal, të ketë parasysh anën edukative, të punojë që të nxitë te njerëzit dëshirën që të merren me art dhe

ta kuptojnë artin, të bukurën, muzikën, teatrin, bale-tin etj. Kjo nxitje pastaj të kanalizohet në shkolla, domethënë, ai të punojë për përhapjen në masë të artit të bukur muzikor, në mënyrë të veçantë në rini. Po kështu edhe një piktor të mos mendojë vetëm për em-rin dhe famën e tij. Ai mund dhe duhet të bëjë edhe piktura shumë të bukura, të mrekullueshme, po këto të shërbejnë për të ngjallur në masën e njerëzve ta-në dashurinë për pikturën, dashurinë e thellë për ven-din dhe bashkatdhetarët. Këtu qëndron roli edukativ i kësaj pune. Pra, të mos tërhiqemi nga dëshirat e kribura individualiste të disave, po të kemi parasysh që, sa më gjerë të zhvillohen arti dhe kultura në qytet dhe në fshat, aq më shumë do të dalin talente të më-dha nga masat. Të punojmë, pra, që të zhdukim pikë-pamjet individualiste që mund të mos jenë të kristali-zuara, por që ekzistojnë në mentalitetin e shumë nxë-nësve, pikëpamje që ndoshta nxiten dhe edukohen edhe nga disa pedagogë, të cilët nuk e kuptojnë sa du-het gjerësinë dhe rëndësinë e madhe, brendinë ideolo-gjike dhe politike të punës së Partisë në fushën e ar-tit dhe të kulturës. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto, pluset dhe minuset, të kaluarën e peda-gogëve dhe të artistëve tanë, ndikimet negative në vetë këta sektorë, të ecim me kujdes dhe durim të madh në këtë drejtim.

Ju na thoni se gjendja e përgjithshme morale e ideopolitike në institut është e mirë. Kjo është një gjë pozitive, po duhet të keni kurdoherë parasysh të mos flemë mendjen përpara rrezikut të degjenerimit mo-ral të studentëve dhe të artistëve tanë. Mendoni se janë

elementë të rinj këta artistë dhe artiste, nxënës e nxënëse, prandaj duhet pasur kujdes me ta. Puna politike dhe idcologjike me punonjësit e këtyre sektorëve të jetë e thellë dhe këmbëngulëse. Ky problem duhet parë mirë dhe besoj se do të kemi më shumë rezultate.

Prandaj ta shihni më thellë këtë çështje. Kërkoni mjete dhe kuadro, bëni edhe ndonjë seleksionim dhe jepini në këtë drejtim institutit çdo ndihmë të mundshme, për të cilën ka nevojë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

FORCA E PARTISË QËNDRON JO TE NUMRI I ANËTARËVE, POR TE CILËSITË E TYRE

Nga biseda me një udhëheqës të PK të Cejlonit

9 tetor 1967

Pasi i uroi mikut nga Cejloni mirëseardhjen, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

U gëzuan që na erdhët në Shqipëri, sepse takimet me shokët e partive të tjera marksiste-leniniste na ndihmojnë shumë. Edhe përvoja e partisë suaj ndihmon dhe shërben mjaft, si për punën tonë, ashtu edhe për shokët e partive të tjera marksiste-leniniste të Evropës, të cilat, edhe në qoftë se nuk i kanë problemet që ju preokupojnë ju, kanë nevojë të madhe të dinë për zhvillimin e lëvizjes komuniste në botë.

Përveç përvojës që këmbejmë me njëri-tjetrin, në këto takime na forcohet njëkohësisht besimi në forcat tona, bashkëbisedojmë për ngjarjet që zhvillohen në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe së bashku ndiejmë një gëzim të madh, entuziazmohemi për sukseset

e arritura, gjë që na ndihmon për të çuar edhe më përpara çështjen tonë të madhe.

Ne e kemi ndjekur vazhdimisht me kujdes dhe simpati punën e partisë suaj, që është partia e një vendi që ka qenë koloni e Anglisë dhe ku më parë ka ekzistuar ndikimi i një partie oportuniste. Forcimi i vazhdueshëm i gjendjes në partinë tuaj, sqarimi në parti i pozitave të Kumarasirit dhe të grupit të tij dhe sidomos verifikimi i partisë e organizimi, që mendoni të bëni, janë probleme jetike, zgjidhja e të cilave do ta forcojë më tej partinë.

Forca e partisë nuk qëndron te numri i anëtarëve, por te cilësitë e tyre, te përbërja e saj. Kur cilësia e partisë është në nivelin që kërkohet, ajo përbën një forcë të madhe, sepse një parti e tillë është në gjendje t'i udhëheqë masat e gjera të popullit, t'i sqarojë dhe t'i tërheqë ato me vete. Ne e kemi të qartë se partia nuk mund të shkojë vetëm në revolucion, prandaj ajo duhet të mobilizojë e të udhëheqë në luftë masat e gjera punonjëse dhe proletariatin, në radhë të parë. Por në qoftë se në parti vegjetojnë elementë deviatorë, njerëz të paqartë, fraksionistë, atëherë sigurimi i unitetit të saj në revolucion dhe sqarimi i masës nuk mund të bëhen.

Partia Komuniste e Cejlonit ka arritur ta realizojë mirë qëndrimin e saj ndaj klasave dhe shtresave të ndryshme të popullsisë në vendin tuaj. Kjo ka rëndësi të madhe. Partia marksiste-leniniste, më parë duhet të njohë thellë se cilat klasa dhe shtresa të popullsisë janë më afër saj, kush është kolona e saj vertebrore, cila është aleatja e klasës punëtore, cilët

duhet të drejtojë dhe të udhëheqë ajo etj. Çdo gjë dhe në çdo vend varet nga interpretimi i drejtë i gjendjes konkrete.

Me sa jemi vënë në dijeni nga ju, në Cejlon ekziston si një forcë e madhe proletariati i fshatit. Vlerësimi i tij nga ana e partisë suaj më duket i drejtë, sepse ai është një forcë e madhe që qëndron shumë afër klasës punëtore, ose mund të themi, bile, që, nga pikëpamja klasore është pjesë përbërëse e saj, sepse, ashtu si proletariati industrial, edhe proletariati i fshatit nuk ka asgjë përveç krahëve të tij. Proletarët e fshatit rrojnë dhe punojnë në fshat, aspiratat e tyre janë për përmbysjen e trusteve të çajit, të kapitalistëve të tokave në Cejlon, qofshin këta të huaj ose të brendshëm, për të realizuar dëshirën që toka të bëhet e tyrja. Kur në çështjet konkrete të fshatit, si, për shembull, në luftën agrare, udhëhiqen nga idealët e proletariatit, ata përbëjnë një forcë të madhe dhe një levë të rëndësishme të partisë.

Marrja e pushtetit me armë, me dhunë nga ana e proletariatit, është një domosdoshmëri historike, pasi borgjezia nuk e lëshon pushtetin vullnetarisht. Për përmbysjen e saj partia dhe proletariati përgatiten dhe kryejnë revolucionin e armatosur. Revolucionin, na mëson Lenini, është një çështje shumë serioze, me të cilin nuk mund të luhet.

Lëvizja komuniste botërore po ecën përpara dhe po forcohet vazhdimisht. Natyrisht, kuptohet që jo çdo gjë ecën si në gjalpë, sepse ka akoma shumë vështirësi, objektive e subjektive, por kudo bëhet luftë ideologjike e politike, brenda çdo partie dhe jashtë tyre.

Në këtë luftë ka edhe zigzage, edhe taktika të ndryshme, por përvoja tregon se kudo që ka fituar revolucioni, ai është bazuar në mësimet e Leninit, në marksizëm-leninizmin. Në vendet ku borgjezia nuk është përmbysur akoma çdo gjë varet nga zotësia e marksistë-leninistëve dhe e partive të tyre marksiste-leniniste, që duhet të dinë të shfrytëzojnë mirë situatat konkrete dhe të zbatojnë në përputhje me to doktrinën tonë sipas rrethanave të çdo vendi. Për këtë qëllim është e domosdoshme që përvoja e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, e bolshevikëve sovjetikë, të mësohet nga të gjithë marksistë-leninistët. Kësaj përvoje, natyrisht, duhet t'i shtohet çdo ditë edhe ajo e të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste.

Situatat në vende të ndryshme janë të ndryshme. Këtë fakt nuk mund të mos e mbajnë parasysh partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste. Në disa vende mungon zhvillimi industrial dhe klasa punëtore është fare e vogël; në disa të tjera industria dhe klasa punëtore janë të zhvilluara; ka vende të tjera ku ekziston një shfrytëzim i madh kapitalist ose një klasë fshatare shumë konservatore. Pra çdo parti proletare e zbaton përvojën revolucionare në kushtet konkrete të atij vendi ku militon.

Lëvizja komuniste ndërkombëtare ka një përvojë shumë të madhe. Na vihet detyrë të gjithëve që këtë përvojë, të mirë ose edhe me gabime, ta njohim dhe përvojën e mirë ta vëmë në jetë që ne dhe brezat pas nesh të mësojmë prej saj, si dhe nga gabimet e lëvizjes komuniste në të kaluarën. Natyrisht, forcat e Partisë sonë për një vlerësim të tillë të lëvizjes komuniste

ndërkombëtare, në fakt, janë të vogla dhe nuk kemi ndonjë pretendim, por të gjitha partitë marksiste-leniniste së bashku përbëjnë një forcë shumë të madhe. Për këtë arsye të gjithë ne duhet t'i rritim forcat tona, t'i unifikojmë ato dhe kështu, të bashkuar, të luftojmë duke përfituar nga përvoja e njëri-tjetrit, e cila nuk njih kufij dhe distanca. Midis partive marksiste-leniniste ekziston një unitet i çeliktë, një unitet i shëndoshë mendimi dhe veprimi, pasi marksistë-leninistët e të gjithë botës kanë të njëri-tjetri shokët më besnikë, më të vendosur e më të sigurtë në frymën marksiste-leniniste.

Me këtë dua të them se ç'rëndësi të madhe ka uniteti midis marksistë-leninistëve. Qëndrimet e drejta dhe të vendosura të partive marksiste-leniniste tronditin dhe shkatërrojnë të gjitha planet e imperialistëve dhe të revizionistëve modernë.

Për sa i përket gjendjes në vendin tonë, ju e patë vetë gjatë shëtitjes që bëtë nëpër Shqipëri. Por kjo ishte një shëtitje e shpejtë, fort e shkurtër. Megjithatë, besoj se ju formuat një përshtypje të përgjithshme për Shqipërinë. Te ne janë bërë ndryshime të thella në revolucionarizimin e gjithë jetës. Kudo që të shkohesh në vendin tonë do të shohësh se anëtarët e thjeshtë të Partisë dhe çdo punonjës zbatojnë në mënyrë revolucionare direktivat e Partisë. Kjo na ka dhënë rezultate të mira në konsolidimin politik dhe ideologjik të revolucionit tonë, në ngritjen e nivelit politik të Partisë dhe të masave, gjë që po manifestohet me rezultate konkrete në të gjithë sektorët. Si rrjedhim, kudo po realizohen dhe po tejkalohen

planet, në industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë.

Në përgjithësi, viti që po kalojmë është një vit i mbarë ekonomik dhe politik, por rëndësi ka çështja që ne po e thellojmë dhe po e përmirësojmë gjithnjë e më shumë këtë gjendje. Si rezultat i kësaj po bëjmë hapa përpara në ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, në ngritjen e tij politike dhe ideologjike në krahasim me vitet e mëparshme. Natyrisht, si në revolucionin e çdo vendi, edhe te ne ka gjëra të mira, ka edhe shfaqje negative, pengesa e vështirësi, por këto kapërcehen. Kryesorja është se te ne uniteti në Parti dhe në popull dhe ai midis popullit e Partisë janë të çeliktë. Kjo është baza e fitoreve tona.

Ju nesër do të largoheni nga vendi ynë. Ne ju sigurojmë se Partia jonë do të jetë kurdoherë krah për krah partisë suaj, së cilës nuk do t'ia kursejë kurrë ndihmën e saj modeste dhe të sigurtë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

MBI KOOPERIMIN DHE REVOLUCIONIN TEKNIKO-SHKENCOR

Fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH¹

14 tetor 1967

Shokë dhe shoqe,

Punimet e këtij Plenumi të Komitetit Qendror, rrahja e gjerë e mendimeve dhe vendimet që do të merren, do të kenë një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë sonë.

Tani të marrim të gjitha masat që këto vendime të zbatohen me përpikëri dhe me sukses në jetë. Partia

¹ Plenumi i 3-të i KQ të PPSH, që i zhvilloi punimet më 13-14 dhjetor 1967, dëgjoi dhe diskutoi rreth dy raporteve të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Për punën e bërë dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në industrinë mekanike, për specializimin dhe kooperimin e mëtejshëm të saj» si dhe «Për punën e organizatave-bazë të Partisë, të organizatave të masave e të organeve shtetërore për shpikjet, racionalizimet dhe kursimet në industri e në ndërtim dhe për masat që duhen marrë për zhvillimin e kësaj lëvizjeje».

dhe pushteti t'ua bëjnë ato të njohura dhe të kuptueshme punonjësve e, në radhë të parë, në mënyrë të thellë dhe të detajuar klasës punëtore, e cila, nën udhëheqjen e Partisë e nën kujdesin e Qeverisë dhe të ministrive përkatëse, duhet ta marrë fuqimisht në dorë këtë problem të madh jetik, ta kuptojë këtë si një detyrë të sajën tekniko-politiko-ekonomike dhe jo thjesht administrativo-burokratike. Në këtë frymë të punohen në Parti edhe vendimet e këtij Plenumi.

Rëndësi të veçantë merr punimi i tyre në gjirin e klasës punëtore, prandaj duhet të përgatiten dhe të dërgohen për t'ia punuar asaj, specialistët tekniko-politikë më të mirë dhe më të kualifikuar të Partisë, t'ua shpjegojnë punëtorëve në gjuhën e tyre të punës dhe të profesionit dhe jo vetëm t'ua shpjegojnë, por të dinë dhe të jenë në gjendje që të orientojnë edhe diskutimet, jo me fraza slogane, por me mendime të pjekura teknike. Ata të dinë jo vetëm t'i orientojnë diskutimet, por të jenë në gjendje të përfitojnë shumë nga përvoja e madhe e punëtorëve dhe të bëjnë sin-teza të reja nga kjo përvojë.

Të mos harrojmë se shtrimi në Parti i vendimeve të Komitetit Qendror ose të Qeverisë është vetëm fillimi i punës dhe jo mbarimi i saj, siç e kuptojnë disa shokë në mënyrë formale. Shtrimi do të thotë vetëm marrje njohurish, kuptim i problemit për t'u zgjidhur. Përpara, pra, mbetet zbatimi në jetë i vendimit, që është çështja më e madhe. Këtu duhet bërë luftë me një mijë vështirësi e pengesa objektive dhe subjektive, që duhen kapërcyer.

Zbatimi kërkon organizim, plan, mobilizim, studim e ristudim dhe të gjitha këto jo në kartë, jo vetëm në libra, por në punë dhe për punë. Të gjitha këto punë, vlera e tyre dhe e njerëzve, vërtetohen vetëm me rezultatet konkrete.

Në fjalën time të mbylljes të këtij Plenumi të Komitetit Qendror dëshiroj të theksoj disa aspekte të kooperimit dhe të revolucionit tekniko-shkencor, që përbëjnë thelbin e raporteve të Byrosë Politike dhe të diskutimeve shumë të vlefshme të shokëve të Komitetit Qendror, si dhe të shokëve të tjerë.

Kooperimi, që preokupon sot industrinë tonë në kuptimin e gjerë të fjalës, është një problem jo i ri për Komitetin Qendror dhe Qeverinë tonë, të cilin duhet ta kuptojmë edhe teorikisht, edhe teknikisht, pasi duket sikur është vetëm një problem tekniko-administrativ.

Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kooperimit në sistemin tonë të ekonomisë socialiste kanë rëndësi të madhe. Kooperimi në vendet kapitaliste ndryshon krejtësisht nga kooperimi në vendin tonë, si nga kuptimi, ashtu edhe nga qëllimi.

Në vendet kapitaliste kooperimi ekziston si në mes degëve të ndryshme të ekonomisë, ashtu edhe në degë të ndryshme të industrisë, ai ekziston në mes kapitalistëve industrialistë të një shteti, në mes tyre dhe shtetit borgjez, në mes trusteeve e konsorciumeve të shteteve të ndryshme kapitaliste. Një rrugë e tillë ka çuar edhe në organizime ndërkombëtare, në të cilat sundojnë trustet më të fuqishme kapitaliste.

E gjithë kjo formë kooperimi kapitalist bazohet

në pronën private kapitaliste, në shfrytëzimin e egër kapitalist të punonjësve, në luftën për sundim në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare, në ligjin e xhunglës, sipas të cilit «peshku i madh e ha të voglin», në krijimin e trusteve të plotfuqishme kombëtare e ndërkombëtare, për të sunduar e për të shfrytëzuar në mënyrë barbare popujt dhe pasuritë e vendeve të këtyre popujve.

Ligji i egër i konkurrencës në tregjet kapitaliste ka me vete edhe anarkinë në prodhim, zbutja e së cilës është e pamundur. Shtetet e fuqishme kapitaliste orvaten t'i shuajnë ato me thikë në dhëmbë, me luftë të madhe për të realizuar integrimin ekonomik kapitalist të shteteve më të dobëta kapitaliste nga ato që ekonomikisht dhe ushtarakisht janë më të fuqishme. Kjo çon drejt humbjes së lirisë politike dhe ekonomike të vendit që hyn në rrugën e integritit kapitalist. Kjo e shndërron atë vend që hyn në këtë rrugë në një vend kolonial dhe popullin në një popull të robëruar.

Rruga tradhtarë titiste i ka çuar Jugosllavinë dhe popujt e saj në një gjendje të tillë. Vetadministrimi jugosllav ka hapur plotësisht rrugët e kolonizimit të Jugosllavisë nga kapitali amerikan dhe nga ai i shteteve të tjera kapitaliste. Në Jugosllavi po mbyllen me mijëra fabrika si gjoja jorentabël, por kjo do të thotë krijim koncernesh të mëdha, që gëlltitin të voglat, që bëjnë transformimin e krejt ekonomisë në rrugën kapitaliste, nënshtrimin e plotë të saj ndaj koncerneve të huaja kapitaliste. Më në fund, nga ky transformim rrënjësor në Jugosllavi është krijuar ajo

anarki tipike në ekonomi, në treg, në politikë dhe në ideologji, që ne po e shohim sot çdo ditë në skëterrën kapitaliste titiste. Ekonomia jugosllave është futur e tëra në kthetrat e kapitalit financiar amerikan e ndërkombëtar, i cili bën ligjin ekonomik, politik dhe ideologjik në Jugosllavi.

Në këtë rrugë po ecin edhe revizionistët sovjetikë dhe satelitët e tyre të vendeve të ish-demokracisë popullore të Evropës. Rruga jugosllave, pavarësisht nga format që përdorin, ndiqet besnikërisht prej tyre, esenca dhe qëllimet e kësaj rruge janë të njëjta. Një rrugë e tillë e zhvillimit kapitalist, që udhëhiqet nga parimet dhe qëllimet që thashë më lart, nuk mund ta pranojë zhvillimin ekonomik të vendit në bazë të një plani të centralizuar, pavarësisht se edhe revizionistët kanë një plan të zhvillimit të tyre, por ky bazohet në parime dhe në qëllime diametralisht të kundërta nga ato që udhëheqin dhe drejtojnë ekonominë tonë socialiste. Për këtë arsye ne shohim se në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik etj. kanë hequr dhe po heqin dorë nga parimet socialiste të planifikimit të centralizuar socialist të ekonomisë.

KNER-i është shndërruar në një organizatë revizioniste kooperimi të industrisë dhe të shumë degëve të tjera të ekonomisë së vendeve anëtare. Në këtë organizatë sundojnë revizionistët sovjetikë, të cilët, nëpërmjet saj, në interesin hegjemonist të tyre, kanë për qëllim të shfrytëzojnë dhe të drejtojnë ekonominë e vendeve të tjera anëtare, ta detyrojnë këtë të zhvillohet në drejtimet që dëshirojnë ata, t'i lidhin ekonomitë e vendeve të tjera në një mënyrë të tillë që, tok me

këtë kooperim gjoja socialist, t'i sundojnë edhe politikisht këto shtete.

Natyrisht, KNER-i nuk është veçse njëfarë «tregu i përbashkët», apo «ekonomi e përbashkët e komunitetit evropian» borgjez, i ndërtuar në bazë të parimeve shfrytëzuese e shtypëse të të vegjëlve nga të mëdhenjtë, prandaj brenda tij nuk mund të ketë veçse kontradikta të mëdha lufte në mes njëri-tjetrit. Janë të njohura reagimet e Republikës Socialiste të Rumanisë, që vazhdon të qëndrojë anëtare e KNER-it, ndaj skllavërimit hrushovian, i cili nuk u mjaftua me formën e kooperimit në KNER, por u përpoq të fuste edhe gjithë territorin kufitar rumun brenda Bashkimit Sovjetik, duke përfshirë edhe Bukureshtin, si një masë gjoja ekonomike, gjë që më hapur do të thoshte kolonizim i plotë edhe politik i Rumanisë. Kooperimi antimarksist brenda caqeve të KNER-it shoqërohet me skllavërimin e dyfishtë kapitalist, pasi të gjithë anëtarët e KNER-it revizionist, me ata sovjetikë në krye, veç e veç, nëpërmjet kredive dhe kooperimit, janë futur nën zgjedhën dhe kthetrat e kapitalit monopolist amerikan e të tjerë.

Kurse Partia dhe Qeveria jonë, njëkohësisht me demaskimin e plotë të revizionistëve tradhtarë hrushovianë, braktisën e demaskuan edhe të gjitha format e bashkëpunimit dhe të kooperimit skllavërues ekonomik që ata kanë vendosur në mes tyre. Të gjithëve na kujtohet lufta e Partisë sonë kundër renegatëve të vjetër të marksizëm-leninizmit, titistëve jugosllavë, të cilët, nën maskën e aleancës, u orvatën të bënin bashkimin politik dhe ekonomik, projektuan koordinimin

e ngushtë të planeve tona ekonomike, për t'i hapur rrugën kështu kolonizimit të vendit tonë nga ana e tyre. Por të gjitha këtyre orvatjeve armiqësore Partia dhe populli ynë u bënë ballë me sukses dhe fituan kundër tyre. Ne fituam kështu një përvojë të madhe në teorinë dhe në praktikën e ndërtimit të socializmit, përvojë që sot na ndihmon ta zhvillojmë drejt e me sukses ekonominë tonë në rrugën socialiste dhe të korrin suksese, kurse revizionistët modernë, në të kundërtën, po korrin disfata.

Zhvillimi i ekonomisë sonë socialiste bëhet në bazë të një plani shtetëror të mbështetur në parime dhe në organizime marksiste-leniniste, të frymëzuara nga teoria dhe përvoja jonë. Një plan i tillë mbështetet realisht në gjendjen dhe në realitetin objektiv të vendit tonë në procesin dinamik të zhvillimit, bazohet kryesisht në mundësitë dhe në forcat tona.

Plani ynë i shtetit zhvillon dhe shfrytëzon në mënyrë rrënjësore të gjitha pasuritë materiale dhe morale të vendit drejt një qëllimi të madh e të vetëm, ndërtimit të plotë të socializmit, përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të mirëqenies materiale dhe kulturore të popullit. Zhvillimi i ekonomisë sonë është i harmonishëm; ajo nuk i njeh plagët e ndryshme, nga të cilat vuan dhe i ka si pjesë të saj përbërëse ekonomia kapitaliste; ajo nuk njeh as krizat e super-prodhimit kapitalist, as papunësinë, as qëndrimin në vend dhe konkurrencën në treg.

Plani i shtetit i zhvillimit të ekonomisë ka në vetvete çështjen e kooperimit të harmonishëm të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë sonë, të sektorëve

të prodhimit të mjeteve të prodhimit, të ngritjes dhe të përgatitjes së kuadrit etj. Pra, problemi i kooperimit nuk është një problem as i ri dhe as i panjohur për Partinë dhe për shtetin tonë. Në çdo sektor të zhvillimit tonë ne kemi një pleksje kooperimesh, që shumë herë nuk na bien në sy, por veprojnë me efekt të madh e pa të cilat nuk mund të ekzistojë as ai zhvillim i harmonishëm, as ai përparim i dukshëm. Nëpërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe brenda çdo sektori ekziston kooperimi, ose krijohen mundësitë e kooperimit.

Le të hedhim një vështrim si qëndron kjo çështje në kooperativat bujqësore. Vetë emri kooperativë e tregon se në të ekziston ideja e madhe e kooperimit. Në kooperativën bujqësore është bërë fakt kalimi i mjeteve të prodhimit nga prona individuale në atë të përbashkët të tyre dhe, mbi këtë bazë, po punohet, po bashkëpunohet, po kooperohet bashkërisht, shoqërisht. Pra, në kooperativat bujqësore ekziston kooperimi socialist në bazë të punës shoqërisht të përbashkët dhe të mjeteve të përbashkëta të prodhimit. Është ky kooperim, janë këta faktorë bazë që e çojnë bujqësinë tonë përpara, që revolucionarizojnë njerëzit dhe prodhimin, sepse organizojnë, ngrenë në një nivel më të lartë punën artizanale, si të thuash, të ish-ekonomisë individuale të prapambetur e të copëtuar në drejtimin e kooperimit të degëve të ndryshme të kësaj ekonomie bujqësore, ku mbisundonin ndjenjat mikroborgjeze të pronës së vogël, anarkia në prodhim, me një fjalë, interesi i ngushtë i ekonomisë familjare, interesi i kapitalit privat me të gjitha të këqijat e tij.

Por, përveç këtij kooperimi bazë ideologjiko-politik dhe ekonomik të fshatarësisë që krijoi Partia në fshat, brendapërbrenda tij ekziston një kooperim tjetër i madh ekonomik, i cili është aq i lidhur saqë na duket si diçka e natyrshme. Si në pronën e vjetër individuale në bujqësi, ashtu edhe sot në pronën e përbashkët socialiste ekziston kooperimi i ngushtë i përhershëm i bujqësisë me blegtorinë. Këta janë sektorë prodhimi të të njëjtit trung ekonomik, njëra nuk mund të bëjë pa tjetrën. Kooperimi i bujqësisë me blegtorinë që është bërë traditë, jetë, ka ligjet e veta të zhvillimit, të organizimit, që, në rast se shkelen, në rast se nuk njihen e nuk zbatohen si duhet, në rast se nuk u përgjigjen situatave objektive të krijuara nga ndryshimet revolucionare dhe objektive, ai dëmtohet, dëmtohen të dy sektorët njëkohësisht ose njëri në kurriz të tjetrit.

Këtë kooperim të harmonishëm luftojmë ta zhvillojmë më tej në baza shkencore. Kooperativizimi i fshatit na krijon dhe na imponon mundësitë dhe detyrat që këto dy degë kryesore të bujqësisë t'i zhvillojmë harmonikisht dhe sipas normave të reja socialiste.

Fshatari ynë ka një eksperiencë shekullore në bujqësi, por të mos harrohet se në këtë, si në çdo gjë, ruhet edhe përvoja e vjetër e zhvillimit të bujqësisë, që përcaktohej nga prona e vogël, nga perspektiva e ngushtë e zhvillimit kapitalist të kësaj prone dhe ku kooperimi i bujqësisë dhe i blegtorisë, brendapërbrenda pronës, organizohej në bazat kapitaliste të fitimit, të tregut etj.

Në të kaluarën, në vendin tonë ekzistonte edhe

ana tjetër, ndarja e këtyre dy sektorëve të natyrshëm të bujqësisë. Te ne ekzistonin edhe blegtorë kapitalistë, me tufa të mëdha bagëtish, që e zhvillonin këtë degë në mënyrë të shkëputur nga bujqësia.

Prandaj kooperimi bujqësor nuk duhet konsideruar si një punë e arritur lehtë, si një punë e njohur dhe të veprojmë në të në mënyrë anarkike ose të paorganizuar. Në këtë «fabrikë të madhe pa çati», me shumë të dhëna të njohura e të panjohura, luan një rol të madh faktori njeri, me gjykime përparimtare dhe me gjykime prapanike, veprojnë kushte të njohura e të panjohura, të qëndrueshme e të paqëndrueshme biologjike për bimët e kafshët, ekzistojnë ligje objektive të natyrës, që duhen njohur e duhen vënë në shërbim të njerëzve. Të gjitha këto hapin përpara Partisë dhe të gjithë punonjësve pa përjashtim një fushë të madhe betejash dhe eksperimentesh.

Neve na janë hapur fusha betejash për përsosjen e mëtejshme të kooperimit të bujqësisë, për forcimin e ndjenjës së pronës së përbashkët dhe të punës shoqërisht të përbashkët, por njëkohësisht, me zhvillimin dhe me përparimin e mëtejshëm të ekonomisë socialiste në bujqësi, ne jemi duke bërë dhe duhet të zhvillojmë betejën në një shkallë të madhe, të gjerë dhe të thellë për shkencën, për agroteknikën moderne.

Zhvillimi i kooperimit brendapërbrenda sektorëve të ndryshëm të kooperativave bujqësore duhet të bëhet dhe të zgjerohet, për t'i dhënë një hov më të madh ekonomisë së tyre, mirëqenies së kooperativistëve, ngushtimit të disnivelit në mes qytetit dhe fshatit. Duke filluar nga kooperativat e bashkuara, përpunimi

në vend i qumështit dhe i nënprodukteve të tij, përpunimi i një sërë zarzavateve e frutave, prodhimi i një sërë produkteve të nevojave të ngutshme për jetën e fshatit nga mbeturinat e prodhimeve bimore, do të krijojnë një gjendje të re materiale dhe psikologjike në jetën e kooperativistëve. Zhvillimi i artizanatit në kooperativat bujqësore dhe jo vetëm në drejtim të riparimeve të veglave të punës, por edhe të konfeksioneve trupore e shtëpiake dhe të punimeve të drurit për orendi e ndërtime shtëpish, tok me skuadrat e ndërtimit në fshat, krijimi i skuadrave të zdrukhtarëve e të karpentierëve — i gjithë ky kooperim do t'i japë një shtytje të madhe, të paparë, jetës materiale, kulturore dhe morale në fshatin tonë socialist.

Nga ana tjetër, në kooperativat bujqësore ne duhet të krijojmë një numër të madh kuadrosh që, përveç njohurive bujqësore e blegtorale, të pajisen edhe me zanate të tjera të nevojshme e të domosdoshme për fshatin dhe, në rast nevojë, edhe për ndihmë sektorit shtetëror. Kjo është një metodë, sido që empirike, e edukimit politeknik të njerëzve të fshatit në masë. Një metodë e tillë punc dhe edukimi, po të praktikohet edhe në ushtri, nga e cila kalojnë pastaj në fshat kontingjente të shumta njerëzish kur mbarojnë shërbimin ushtarak, do ta fuqizojë këtë orientim shumë të nevojshëm për fshatin tonë.

Në rast se duam të njohim seriozisht të kaluarën, për të ndërtuar me baza të rene, ne nuk duhet të lëmë pa studiuar si kuptohej dhe si zhvillohej kooperimi i brendshëm i bujqësisë dhe i blegtorisë në kohën e pronës private dhe si kuptohet, si zbatohet dhe si do

të zhvillohet ai sot dhe në të ardhmen. Në njohjen e tokave, në punimin e mirë të tyre, në zgjedhjen dhe në përcaktimin e bimëve bujqësore, në zhvillimin, në mirërritjen dhe në diversitetin e kafshëve, në shfrytëzimin racional të prodhimit, të veglave të punës, të makinave moderne bujqësore, të kafshëve të punës e të prodhimit dhe deri te forca mendore e fizike e njerëzve, çkzistojnë aq shumë afinitete, aq shumë forma të domosdoshme kooperimi, të cilat duhen studiuar imtësisht gjatë procesit, duhen ruajtur e duhen perfeksionuar më tej të mirat që i vërtetojnë koha dhe përvoja dhe duhen krijuar të tjera të reja. Me një fjalë, Partinë duhet ta preokupojë vazhdimisht ky proces i madh, që konsiston në një kooperim të harmonishëm shkencor të të gjitha degëve dhe mjeteve të bujqësisë. Me këto dua të them se problemi që trajtojmë sot shtrihet i fuqishëm e i domosdoshëm edhe në bujqësinë tonë socialiste.

Në industrializimin socialist të vendit ne ndjekim dhe perfeksionojmë të njëjtin proces të drejtuar me plan dhe të bazuar realisht, në radhë të parë, në kushtet dhe në mundësitë e vendit tonë. Nga një gjendje artizanale ne krijuam progresivisht industrinë tonë të rëndë dhe të lehtë, ndërtoam miniera dhe fabrika. Por edhe në atë stad të zhvillimit industrial të vendit tonë ka ekzistuar në forma të ndryshme kooperimi, si në industri edhe në artizanat, brendapërbrenda tyre dhe me njëri-tjetrin, si dhe në mes industrisë dhe bujqësisë e midis sektorëve të tjerë. Këto forma kooperimi kanë marrë tani zhvillim të madh, zhvillohen dhe perfeksionohen.

Nga format artizanale për prodhimin e artikujve industrialë ne nuk jemi akoma në gjendje të heqim dorë, por pas një periudhe kohe, ato do të zëvendësohen plotësisht me prodhimin industrial dhe forma artizanale do të mbetet në riparimet.

Studimi që po bëjmë dhe masat që po marrim kanë për qëllim shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese të industrisë sonë, sidomos të asaj mekanike, të cilën duhet ta përqendrojmë dhe ta specializojmë.

Industria mekanike ka tani baza të mira. Në vendin tonë janë krijuar uzina mekanike, përveç reparateve të shumta mekanike të shpërndara në fabrika, parqe automobilistike, në SMT dhe në punishte të ndryshme, të pajisura me torno e me mjete të tjera metalprerëse, sipas nevojave dhe rasteve.

Për rritjen e efektivitetit ekonomik dhe të specializimit të mëtejshëm, tani na vihet si nevojë e ngutshme që të bëhet përqendrimi i këtyre mjeteve, ato të mos lihen më të shpërndara andej-këtej. Të kapërcehen pengesat dikasteriale dhe në rang ndërmarrjesh, të cilat, duke na vënë përpara nevojat e tyre, duan të kenë në dispozicion të tyre, si të thuash, armë të tilla. Sigurisht, nevoja ato kanë, por shumë mund të bëjnë edhe pa to, pasi do t'ua përmbushin uzinat mekanike, kurse ato duhet të ruajnë vetëm diçka të vogël për riparimet urgjente të veglave.

Pretendimet dhe arsyet për t'i ruajtur këto mjete vetë çdo ndërmarrje, duke kërkuar që t'u bëhet ngarkesë e plotë, t'u vihen detyra plotësuese, të punojnë me tri turne etj., etj., nuk qëndrojnë. Këtë na e ka vërtetuar përvoja e gjertanishme.

Ne duhet t'i shikojmë qartë përfitimet e mëdha të këtij përqendrimi.

Në radhë të parë, përqendrimi sjell me vete një shfrytëzim dhe një organizim më të përsosur, krijon mundësi të mëdha për specializim në prodhimin e pjesëve të ndërrimit për të gjithë mekanizmat në vendin tonë. Kjo është detyra kryesore e momentit, në radhë të parë e mbi të gjitha, dhe e dyta, është çështja e perspektivës për fuqizimin e fabrikimit të mjeteve të prodhimit, duke filluar nga mjetet e punës në fabrika të vogla dhe pastaj në fabrika më të mëdha. Kjo nuk mund të arrihet pa një përqendrim dhe pa një përqendrim nuk ka specializim.

Disa mund të qahen dhe të thonë: «Si do të bëjmë ne pa to?». Si bënim kur nuk kishim vegla ndërrimi? Atëherë këto i sillnim nga jashtë me një mijë belara. A do të vazhdojmë më në këtë rrugë? Jo. Atëherë t'i bëjmë në vend dhe për këtë duhen mjete. Prandaj këto mjete nuk mund të jenë më në dispozicion të çfarëdo fabrike, ndërmarrjeje ose punishteje, të cilat, përveç mjeteve, mbajnë edhe mekanikët më të shquar të vendit, që janë në gjendje dhe është më mirë të na mësojnë breza të tërë mjeshtrish sesa të rrinë duke lëmuar ndonjë detal.

Duke fuqizuar industrinë tonë mekanike, ne po theksojmë sot domosdoshmërinë e zgjerimit të kooperimit të degëve të ndryshme të industrisë. Kjo do të jetë një karakteristikë e theksuar e kësaj periudhe. Them një karakteristikë e theksuar, pasi kooperimi në këtë fazë, brendapërbrenda industrisë sonë, do të forcojë dhe do të zgjerojë lidhjet dhe kooperimin me

shumë sektorë të ekonomisë sonë, me bujqësinë, me transportin, me ndërtimin, me sektorin e arsimit dhe të edukimit etj., etj.

Ne po zhvillojmë tani kooperimin në fabrikimin e pjesëve të ndërrimit, të veglave bujqësore e të materialeve të ndërtimit etj. Jemi në stadin foshnjor, si të thuash, të prodhimit të makinave. Me forcat tona ne kemi filluar ndërtimin e disa fabrikave të vogla, të disa makinave komplete bujqësore, por nuk do të ndalemi këtu. Zhvillimi i ekonomisë sonë socialiste na ka hapur mundësi të reja dhe perspektiva plotësisht të realizueshme brenda një periudhe jo shumë të largët. Ne kemi ndërtuar dhe po i zgjerojmë minierat tona të kromit, të bakrit, të hekur-nikelit etj. Studimet e kërkimet do të na e pasurojnë edhe më këtë gamë mineralesh. Kemi hedhur bazat e para të fillimit të përpunimit metalurgjik të bakrit, të hekurit, kemi në plan krijimin e metalurgjisë së hekur-nikelit, të ferro-kromit, kemi krijuar dhe po zgjerojmë bazën elektrike. Të gjitha këto krijojnë për ne mundësinë për fazën e një kooperimi më të lartë, më kompleks, që do të na lejojë të ndërtojmë vetë makina dhe fabrika, me forcat tona. Siç po shohim, Partia është duke e përgatitur këtë fazë. Ky është realiteti ynë, kjo është perspektiva. Realitetin ne duhet ta fuqizojmë që të realizohet perspektiva.

Ç'duhet të bëjmë atëherë? T'i futemi me forca të shumëfishuara revolucionit tekniko-shkencor jo vetëm në industri, por edhe në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Në të gjitha drejtimet të kapërcejmë nga faza artizanale në teknikë të përparuar, në agroteknikë

moderne. Ne mund të themi se i kemi bazat e nevojshme për ta thëlluar revolucionin tekniko-shkencor. Për këtë na vihet si detyrë jetike të shfrytëzojmë plotësisht çdo kapacitet dhe çdo mundësi që kemi, na vihet detyra t'i shtojmë këto kapacitete dhe të krijojmë mundësi të reja, na vihet detyra të shtojmë prodhimet në të gjithë gamën dhe të prodhojmë me shumicë, me çmime të lira dhe me cilësi të mirë.

Që të mund ta bëjmë si duhet këtë, revolucioni tekniko-shkencor të jetë në rendin e ditës. Partia t'ua bëjë të qartë të gjithë punonjësve, nxënësve e studentëve se zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë sonë socialiste, ngritja e shpejtë dhe e vazhdueshme e mirëqenies së popullit varen nga shkalla e kuptimit të këtij revolucioni dhe nga pjesëmarrja sa më e gjallë në të. Teknika moderne të fitohet nga njerëzit tanë. Për këtë duhen, në radhë të parë, punë dhe studim.

Të zhduket nga mendja e njerëzve tanë dhe nga ndërgjegjja e tyre ndjenja e inferioritetit që ka mbi-sunduar dhe ndihet përsëri, sikur ne nuk qenkemi kaq të zotët për të përvetësuar teknikën moderne, se qenkemi prapa, se s'paskemi as njerëz të kualifikuar, as edhe njetet e nevojshme. Më në fund, të kihet parasysh se sjellja nga jashtë e shumë gjërave që mund të bëhen e që mund të krijohen në vend, me mendjen dhe me duart tona, duhet të marrë fund progresivisht. Kooperimi teknik është një pjesë e këtij revolucioni tekniko-shkencor që ka filluar me ngritjen e industrisë sonë, me përgatitjen e kuadrove, me kualifikimin e tyre, me legjislacionin e punës, me kodin agroteknik e me shumë masa të tjera të marra në bujqësi dhe në

sektorë të tjerë të prodhimit. Po t'i hedhim një sy kritik zhvillimit teknik të kuadrove dhe të punëtorëve tanë, mund të themi me bindje të plotë se rezultati është shumë pozitiv dhe jashtëzakonisht inkurajues dhe s'ka vend për të thënë se «ne s'e bëjmë dot këtë», «nuk e bëjmë dot atë». Çdo gjë mund të bëjnë njerëzit tanë njëjloj si nga më të mirat e vendeve të tjera, mjaft që të zhvillojmë më tej mundësitë e punës dhe të studimit.

Të gjithë njerëzit tanë i preokupon shumë zhvillimi i tyre, duke e lidhur këtë detyrë me krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë. Cilido përpiqet të mësojë, të shpikë, të krijojë. Ajo që shpik ose krijon ai (nuk ka rëndësi se në vendet e tjera e kanë shpikur dhe janë shumë më përpara), ka në vetvete atë vullnet të madh krijues dhe atë parim politik dhe ideologjik të klasës që na mëson Partia, të cilët e bëjnë njeriun tonë shumë të aftë dhe e përgatitin për ta kaluar në shpikje dhe në racionalizime stadin artizanal, të imponuar nga kushtet objektive të vendit tonë në të kaluarën.

Në Tiranë e gjetkë këto vitet e fundit po shohim se gati rreth çdo fabrike të madhe, që kemi ngritur, të ngrihen punishte, dhe disa herë fabrika të shumta të vogla, që transformojnë prodhime, që nxjerrin prodhime të reja të konsumit të gjerë. Ngandonjëherë këto mund të mos jenë të gjitha plotësisht rentabël, por kjo, përveç të tjerave, vjen edhe për arsye se sasia e prodhimit është akoma e vogël. Duke marrë parasysh sasinë e madhe dhe gamën e gjerë të prodhimeve për të cilat ka nevojë populli, na vihet përpara detyra të fillojmë të ndërtojmë me forcat tona, në një shkallë më të gjerë dhe me një nivel më të lartë, makina pro-

dhuese të reja, moderne, të automatizuara. Kur them të automatizuara, hëpërhë nuk kam parasysh automatizimin komplet. Ky do të vijë më vonë, por, megjithatë, këtë çështje tani ne duhet ta kemi vazhdimisht parasysh në sjelljen e makinave dhe të fabrikave nga jashtë.

Në mëkëmbjen e këtyre fabrikave të vogla një rol të madh do të luajë kooperimi më i zhvilluar dhe më i organizuar që po vendosim. Këto punishte në rangun e fabrikave të vogla, aktualisht shumë të nevojshme, për një kohë të gjatë do të vazhdojnë të jenë ndihmëse të mira të industrisë sonë të lehtë, edhe kur ne të jemi në gjendje të ngremë fabrika moderne.

Për ta thelluar revolucionin tonë tekniko-shkencor, duke u bazuar në realitetin objektiv të vendit tonë dhe në perspektivën e tij të pashmangshme, duhet të veprojmë në shumë drejtime.

Revolucioni tekniko-shkencor kërkon një mobilizim të përgjithshëm, një vëmendje dhe kujdes të veçantë për studimin e teorisë dhe të praktikës, të lidhura këto ngushtë me njëra-tjetrën dhe asnjëherë të shkëputura. Teoria nuk duhet nënvleftësuar, siç bëjnë disa që, duke u munguar vullneti i studimit, rrëshqasin në praktikizëm dhe këtë shumë herë e lënë të degenerohet në një rutinë pa perspektivë. Praktika pa teorinë është e verbër, kurse teoria pa praktikën është e vdekur. Zhvillimi bëhet në bazë të një sërë ligjesh gjenetike, biologjike, fizike, kimike etj., që, pa i njohur në kompleksin dhe në veçantitë e tyre, nuk mund ta çosh dot përpara revolucionin tekniko-shkencor. Disa mendojnë thjesht duke thënë: «Ja, edhe pa shkollë, edhe pa teori, ne po e çojmë punën përpara vetëm

me përvojë, me praktikë». Këta njerëz harrojnë se ligjet, për të cilat fola më lart, veprojnë vetvetiu në praktikë, por veprojnë jo në harmoni, prandaj, duke mos i njohur ato, ndodhin shumë të papritura të cilat, për atë që nuk i di mirë ligjet, janë të pashpjegueshme, ose u gjendet një shpjegim empirik i paqëndrueshëm, kurse rezultateve të arritura u gjenden «arsye» të rastit, shumë herë të paqena, imagjinare, ose që nuk kanë të bëjnë fare me fenomenin.

Por mungesa e teorisë, e shkencës, e kulturës speciale, e bën shumicën dërrmuese të praktikienëve në praktikën e tyre të pakujdesshëm sa duhet në vëzhgimin, në regjistrimin dhe në kombinimin e akteve e të fenomeneve, në krahasimin dhe në ballafaqimin e tyre me njëri-tjetrin. Konkluzionet këta i lënë t'i bëjë rasti, e panjohura, e papritura. Disiplina në përvojë është e shthurur, metodika e dobët dhe shumë herë e paqenë. Edhe në qoftë se me një praktikë të gjatë arrihet në një shkallë zhvillimi, rezultati prapë duhet të konsiderohet i pakënaqshëm, pasi këtij eksperimentimi i është dashur një kohë e gjatë që të arrihet, është humbur një kohë e madhe dhe ky vazhdimisht është i kapërcyeshëm, në rast se bëhen përpjekje të mëtejshme për zhvillim.

Nga ana tjetër, teoria e mësuar në libra dhe jo e lidhur me jetën dhe me praktikën (qoftë e lidhur vetëm me laboratorin, i konsideruar ky si qëllim dhe jo si mjet), mbetet diçka pa shpirt, pa jetë, një gjë e vdekur. Disa e mbivlerësojnë një kuptim të tillë të shkencës dhe të teorisë, por këta në mund t'i quajmë njerëz pa shumë vlerë dhe antishkencorë, pasi nuk

kanë kuptuar abëcënë, që ajo teori dhe shkencë që mësohen në libra, shpjegojnë ose sintetizojnë një përvojë të madhe praktike, shpjegojnë ligjet objektive të natyrës, ligje dhe përvoja që duhet të provohen në dinamizmin e vazhdueshëm të zhvillimit të pandërprerë të botës materiale, e cila nuk qëndron kurrë statike, siç qëndrojnë dhe mendojnë të tillë të ashtuquajtur shkencëtarë mbi libra dhe në laboratorë pa dritë dhe pa jetë.

Do të jetë gabim të mendohet që revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë vetëm disa njerëz të mësuar që kanë edhe teorinë, edhe shkencën, qofshin këta edhe disa mijëra. Jo, si çdo revolucion të vërtetë, edhe revolucionin tekniko-shkencor do ta bëjnë masat e gjera të popullit, masat e gjera të punonjësve, që janë akoma larg zotërimit të teorisë dhe të shkencës dhe, për t'ia arritur kësaj, do të duhet një kohë akoma e gjatë që të krijohet kështu një vazhdimësi në këtë çështje të pafund.

Mjetet e përshtatshme materiale për një edukim të tillë masiv, të përshtatshëm, na mungojnë hëpërhë, po këto mjete — dhe me këtë unë kuptoj shkollat e çdo lloji, institutet, fakultetet — pjesërisht ne i kemi, i zhvillojmë, i pasurojmë çdo vit. Ky pasurim nuk ka fund, por megjithëkëtë masat e gjera nuk do të jenë dot në gjendje të ngrihen që të gjitha në një stad të lartë për sa i përket studimit të teorisë.

Mirëpo edhe kjo pamundësi ka ilaçin e saj. Njerëzit tanë që mbarojnë shkollat në drejtime të ndryshme, duke u lidhur fort me njerëzit e prodhimit, me praktikën e prodhimit, duhet t'i veshin kësaj praktike diturinë shkencore dhe disiplinën shkencore.

Ç'kuptoj unë me veshje të diturisë shkencore? Kuptoj atë që një nga detyrat kryesore të njeriut të mësuar dhe me shkollë, duke e fituar më parë vetë në radhë të parë praktikën dhe pasi ta lidhë mirë këtë me shkencën, është që punonjësve praktikienë ai t'u shpjegojë ligjet shkencore që janë në bazë të punës së tij eksperimentale, praktike. Ai nuk duhet të shkojë nga parimi se filan punëtor ose kooperativist po e bën buillonin ose prashitjen, prandaj atij nuk kam ç't'i mësoj më. Një edukim i tillë bëhet nëpërmjet kursesh të shumta, konferencash, siç po i bëjnë dhe që kanë marrë një hov shumë të lavdërueshëm, por edhe në punë e sipër, si dhe në biseda të lira e të shkëputura, mjaft që të kihet parasysh vazhdimisht qëllimi i madh që synohet: të edukohen kuadro në masë me njohuri shkencore. Kështu, ne do të krijojmë armata njerëzish që s'kanë mundësi të ndjekin shkolla speciale, por të cilëve u krijohen mundësi që praktika e tyre gjatë punës të sqarohet e të pasurohet me teorinë, t'u hapen kështu horizonte të gjera pune e zhvillimi, t'u hapen perspektiva dhe t'u krijohen mundësi reale studimi, përparimi dhe zhvillimi. Shkenca dhe mësimi në këtë rast nuk do të jenë më gogolë për ta.

Ç'kuptoj kur them që praktikën ta veshim me disiplinën shkencore? Revolucioni socialist pa një disiplinë të hekurt degjeneron në anarki. Kështu ndodh edhe me revolucionin tekniko-shkencor, që, si çdo revolucion, udhëhiqet në radhë të parë nga politika. Edhe ky, pra, duhet të udhëhiqet nga një disiplinë e fortë shkencore.

Fshatarët më shumë dhe punëtorët më pak nuk e njohin, nuk e ndiejnë nevojën dhe forcën e kësaj di-

sipline shkencore në revolucionarizimin e prodhimit. Këtej rrjedhin të gjitha ato të meta e dobësi që ne i kritikojmë dhe i luftojmë çdo ditë. Ne luftojmë që ta vendosim këtë disiplinë shkencore, por jemi akoma shumë larg asaj që synojmë të arrijmë.

Në çdo proces pune ka rregulla, duhet disiplinë. Kjo disiplinë nuk qëndron vetëm në realizimin e normës, të shpejtësisë së sondës, ose vetëm në daljen që në mëngjes në ara. Disiplina shkencore qëndron në njohjen dhe në zbatimin si duhet të procesit që zhvillon dhe transformon materien dhe procesin vetë. Shkrirja dhe kalitja e hekurit kanë një proces të caktuar shkencor, por ka edhe një disiplinë shkencore lidhur me të, të cilën, po nuk e zbatove si duhet dhe në kohën e caktuar, atëherë procesi nuk kryhet normalisht. Kështu është edhe me shumë procese të tjera të industrisë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për proceset e bujqësisë.

Në bujqësi nuk kërkohet vetëm një disiplinë empirike, për shembull, ajo e kohës kur duhen mbjellë kulturat e ndryshme, kur duhen prashitur, ujitur ato etj. Jo, ne duhet të vendosim një disiplinë shkencore në të gjithë procesin e punimeve, pasi zhvillimi i prodhimit dhe revolucionarizimi i tij nuk varen nga një punim mekanik dhe diletant, por toka, bima, plehu, uji, dielli etj., etj. kanë ligjet e tyre biologjike, gjenetike, fizike, kimike, në kompleksitetin e të cilave nuk lejohet as diletantizëm dhe as anarki, pasi ato veprojnë, ndikojnë mbi njëra-tjetrën, për të mirë dhe për të keq. Këto procese jo vetëm duhet t'i njohim, por edhe të veprojmë në mënyrë të rregullt dhe me disiplinë shkencore

që t'i sundojmë, t'i orientojmë atje dhe për atë qëllim që do njeriu.

Eksperimentimet shkencore, të cilave kudo ne duhet t'u japim hov, janë pjesë përbërëse e këtij revolucioni të madh tekniko-shkencor që po bëjmë dhe që duhet ta zhvillojmë kudo. Pikërisht në këto eksperimente nevojitet disiplina shkencore, që kërkon njohjen shkencore të procesit dhe zbatimin e tij shkencor deri në mbajtjen parasysh të ndryshimeve më të vogla që pësojnë gjërat gjatë zhvillimit dhe transformimit. Të gjitha këto eksperimente shkencore nuk është arritur të përgjithësohen akoma si duhet dhe të vihen në zbatim në shkallë kombëtare. Ato vihen në jetë me shumë ngurrime. Përhapjen e tyre dhe revolucionarizimin e prodhimit e pengojnë shumë mungesa e organizimit të centralizuar, burokratizmi dhe rutina e planit, e shikuar në mënyrë të ngushtë dhe pa telashe e kokëçarje. Disiplina e planit, që zihet në gojë vazhdimisht, por që në shumë raste shkelet, kur është çështja për revolucionarizimin e prodhimit, bëhet pengesa më serioze.

Për të gjitha këto probleme ministritë e ndryshme duhet të jenë, në radhë të parë, shembull dhe në pararojë. Në qoftë se Ministria e Bujqësisë, ta marrim për shembull, nuk tregon një kujdes të lartë për problemin e patates (dhe këtu nuk e kam fjalën për administrimin e thjeshtë, por për trajtimin me rreptësi dhe shkencor të saj), ne mund të dështojmë në këtë aksion të madh. Në rast se për problemin e farërave, në përgjithësi, lejohet anarki e trajtim joshkencor në varietete dhe tregohet interes vetëm në kuptimin tregtar të tyre, atëherë ne do të vuajmë shumë, do të har-

xhojmë tepër dhe nuk do ta stabilizojmë dot gjendjen e drithërave, që është problemi kyç i bujqësisë sonë. Si këto ka shumë probleme në bujqësi, në industri dhe në sektorë të tjerë, për të cilat duhet ta shtojmë shumë vëmendjen, të shtojmë dituritë e masës dhe të perfeksionojmë organizimin dhe disiplinën në punë.

Me pak fjalë ne duhet:

1. T'i vëmë rëndësi shumë të madhe edukimit sistematik dhe në masë të kuadrove në të gjithë sektorët, me shkolla, me kurse, me punë etj. Në botëkuptimin e njerëzve tanë të krijojmë nevojën në jetë të të mësuarit, nevojën e një perfeksionimi të vazhdueshëm dhe jo vetëm në kuptimin e ngushtë, të vogël, egoist, për të fituar bukën, por në radhë të parë për të kuptuar e për të zotëruar shkencën dhe diturinë, për të transformuar natyrën, për t'i bërë të begatshëm atdheun dhe jetën e njerëzve.

Vetëm krijimi i një kuptimi të tillë të gjerë dhe të drejtë për mësimin dhe perfeksionimin do të largojë dhe do të zhdukë pikëpamjet mesquine që shfaqen kur thuhet: «Të bëj disa përpjekje për të kaluar në një kategori më të lartë, që të më shtohet kështu rroga»; ose: «Meqë jam në një kategori më të lartë, nga kualifikimi që kam, ç'më duhet mua të vazhdoj mësimin e mëtejshëm». Këto janë mendime të mykura, që të bëjnë të mos shohësh më larg se hunda jote, pasi, po të mendohet nga të gjithë kaq ngushtë, atëherë qëndrohet në «vend numëro» dhe bukën nuk e nxjerrim dot. Kurse çdo qytetar i Republikës sonë duhet të ketë të qartë perspektivën dhe të punojë për ta arritur atë, duke kaluar nga edukimi i thjeshtë në edukimin më

të lartë e më kompleks. Çdo njeri të ecë me kohën, me situatat, me kushtet që krijohen dhe me nevojat jo vetëm të ngushta të personit dhe të familjes së tij, por të të gjithë shoqërisë.

Masa duhet ta shohë perspektivën dhe të ardhmen qartë, të shohë botën tonë në zhvillim, që cilido të mund të dalë nga guaska e ngushtë e botës së tij të vogël.

2. Të zotërohet teknika e përparuar që kemi dhe që më vonë do ta shtojmë dhe të vihet ajo në lëvizje nga njerëz të përparuar e të ngritur politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht.

3. Përparimi individual, novacionet dhe racionalizimet individuale të kuptohen dhe të bëhen pjesë përbërëse e kolektivave të gjerë, të konsiderohen pasuri e masave për qëllimet e realizimit të aspiratave të mbarë popullit.

Lëvizja e shpikjeve dhe e racionalizimeve nuk duhet të ketë drejtim të kufizuar individual, sido që mendimi dhe përpjekjet individuale janë në bazë dhe duhen inkurajuar, pasi janë të domosdoshme. Individit, me shpikjen dhe racionalizimin e tij, politikisht duhet ta ndiejë veten pjesëtar të kolektivit ku punon dhe mendimi e racionalizimi i tij të mos përqafohen nga i gjithë kolektivi vetëm kur ai ka marrë formën e përsosur, por që në fillim të përpunimit të tij të bëhet objekt i diskutimeve dhe i perfeksionimit nga grupe të gjera punëtorësh të kolektivit; pasi vetëm kështu zhvillohet e mprehet krijimtaria masive dhe, nga ana tjetër, luftohet ideja e «lavdisë personale», ndjenjë kjo egoiste dhe mikroborgjeze.

Po të veprohet në këtë mënyrë, unë mendoj se do

të luftohen zvarritjet dhe puna burokratike në pranimin dhe në vënien në zbatim të shpikjeve dhe të racionalizimeve. Një drejtor, një inxhinier ose një ministri do ta kenë zor të zvarritin, ose të lënë në sirtar ta zërë pluhuri punën e grupeve të punëtorëve e të specialistëve, që kanë bashkuar forcat e tyre krijuese, që kanë derdhur djersë, ashtu siç mund të lënë shpikjen ose racionalizimin e një individi.

4. Të realizohen uniteti i plotë i punëtorëve dhe i teknikëve, lidhje të ngushta pune dhe edukimi reciprok në thjeshtësinë proletare marksiste, puna e përbashkët krijuese, lufta e përbashkët kundër çdo mendjemadhësie e frenimi të dëmshëm, kundër çdo nënvleftësimi të punës dhe të krijimtarisë së tjetrit, kundër çdo konservatorizmi ose skepticizmi në forcën dhe në zotësinë krijuese të punonjësve tanë.

5. Të ngremë gjithë brezin e ri në një nivel të lartë politik, ideologjik dhe teknik, që të bëhet shtylla e këtij revolucioni tekniko-shkencor, pjesë përbërëse e revolucionit tonë proletar. Studentët e universitetit ta kuptojnë mirë, politikisht dhe ideologjikisht, vlerën e mësimit dhe të shkencës që marrin në bankat e shkollës e në punët praktike dhe të përpiqen si ta zhvillojnë atë më tej në jetë, në interesin e popullit dhe të socializmit.

Në të gjithë industrinë tonë, dhe veçanërisht në industrinë mekanike, t'i vëmë kujdesin më të madh aftësimin të punëtorëve. Në këtë drejtim të përdoren të gjitha format e mundshme dhe i gjithë kujdesi i udhëheqjes së çdo fabrike, uzine mekanike dhe i inxhinierëve të ndryshëm. Lufta të përqendrohet në

përprojekjet për t'i kthyer punëtorët në specialistë, për të krijuar me mijëra e me mijëra mjeshtër të vërtetë, pa të cilët industria jonë, në përgjithësi, dhe ajo mekanike, në mënyrë të veçantë, nuk mund të ecin përpara. Këta mjeshtër të zanatit janë shtylla kurrizore e saj. Pa ta nuk mund të arrihet ashtu si duhet zbatimi i proceseve teknologjike, nuk mund të shfrytëzohen si duhet as kapaciteti i makinerive, as koha dhe shpejtësia me precizion në punë, as të bëhen shpikje e racionalizime që i japin një hov prodhimit, nuk mund të shfrytëzohen si duhet as rezervat e brendshme dhe as të përdoret me nikoqirllëk lënda e parë e nuk mund të ngrihet rendimenti. Pra, pa këta mjeshtër, puna nuk mund të bëhet si duhet.

Organizimi i përsosur i punës në fabrika dhe në uzina nuk qëndron, pra, vetëm në marrjen e masave administrative, por sidomos në ato çka thashë më sipër, duke mos harruar kurrë që, krahas punës për përgatitjen e mjeshtërve të përsosur, të punojmë që këta të jenë njëkohësisht mjeshtër të pararojës edhe nga ana politike dhe ideologjike. Pra, roli i Partisë, i organizatës-bazë, është i madh, i shumanshëm dhe jo i thjeshtë e i lehtë, siç mund ta kuptojnë disa. Detyra e Partisë dhe edukimi i saj nuk është dhe nuk duhet bërë kurrë i shkëputur nga edukimi teknik i punëtorëve dhe i mjeshtërve. Vetë diskutimi dhe marrja e këtyre problemeve në Komitetin Qendror e vërtetojnë në këtë gjë, pasi ndryshe, për to mund të merreshin vendime thjesht shtetërore nga ana e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave.

Prandaj, kur flasim për zbatimin e proceseve tek-

nologjike, për pakësimin e orëve të punës në proceset e ndryshme, kur flasim për prodhimin dhe përdorimin me aftësi të instrumenteve të përpikta, për cilësinë që kanë dhe që duhet t'u japim metaleve, për anët tekniko-ekonomike të prodhimit në seri dhe të specializuar, të mos harrojmë për asnjë çast faktorin njeri, faktorin kryesor, vendimtar. Prandaj të punojmë që njeriu të edukohet, të specializohet, të perfeksionohet politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht.

Përgatitja e vetë kuadrove në këtë shkallë të gjerrë, për të realizuar revolucionin e madh kulturor dhe tekniko-shkencor, lyp një kooperim të përsosur në mes punës dhe shkollës, në mes nevojës dhe mundësive, në mes sasisë dhe cilësisë, në mes gjendjes aktuale dhe perspektivës.

Punimet e këtij sesioni të Plenumit të Komitetit Qendror për këto probleme të rëndësishme, raportet e Byrosë Politike që u mbajtën këtu, si dhe diskutimet e shokëve, do t'u japin Partisë, punonjësve dhe kuadrove një orientim dhe një ndihmë shumë të madhe për ta çuar punën akoma më përpara, për të fuqizuar ekonominë tonë socialiste, për të kalitur dhe për të kryer me sukses perfeksionimin politik, ideologjik dhe teknik të kuadrove dhe të punonjësve tanë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 253 (5978), 21 tetor 1967

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968», f. 236.
Tiranë, 1969*

**KUSH ORVATET TË SABOTOJË LUFTËN NË
VIETNAM, SHKEL MBI GJAKUN E VIETNAMEZËVE,
ËSHTË RENEGAT E TRADHTAR**

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike
të Vietnamit*

21 tetor 1967

*Pasi i uroi mirëseardhjen ambasadorit të ri, sho-
ku Enver Hoxha vazhdoi:*

Populli dhe Partia jonë kanë një admirim dhe dashuri të veçantë për popullin tuaj të Veriut dhe të Jugut. Imperialistët amerikanë po e përvëlojnë barbarisht Vietnamin e Veriut nga ajri me bombardime dhe po djegin e po shkatërrojnë me zjarr e me hekur Vietnamin e Jugut me qëllime të caktuara për të mbajtur popullin tuaj nën thundrën e tyre dhe për ta pasur Vietnamin si një plasdarm kundër vendeve të tjera të Azisë. Ne jetojmë çdo ditë me luftën tuaj, pse ajo është dhe jona. Sukseset dhe sakrificat e mëdha që po bëni, qoftë në Jug, qoftë në Veri, ne i konsiderojmë si tonat. Lufta e Vietnamit për çlirim është

një luftë që u shkakton dhe do t'u shkaktojë humbje e disfata të pandreqshme jo vetëm imperialistëve amerikanë, por edhe revizionistëve modernë. Ajo është njëkohësisht një ndihmë e madhe për luftërat çlirimtare të popujve, është simbol trimërie kundër një force të madhe barbare, por, në fakt, e dobët, derisa nuk po u qëndron dot as goditjeve të një populli të vogël, por heroik, siç është populli juaj. Ne e kemi të qartë se disfatat e mëdha, që u shkakton populli heroik vietnamez imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve modernë, i detyrojnë ata të mendohen mirë para se të guxojnë të shkaktojnë Vietname të tjera në botë, pse zjarre të tilla të reja lufte do të ishin të rrezikshme për ta dhe do të shpejtonin disfatën përfundimtare të tyre.

Lufta e popullit tuaj është një ndihmë e madhe për luftën antiimperialiste e çlirimtare të popujve të tjerë dhe për fitoren e revolucionit në shkallë botërore.

Partia jonë na ka mësuar që këto vlerësime të mos i bëjmë vetëm ne, udhëheqja e Partisë dhe e shtetit, po i gjithë populli shqiptar, i cili, në sajë të mësimave të Partisë sonë, sot i kupton qartë lidhjet e ngushta me ju, prandaj ai, në punën dhe në luftën që bën, çdo ditë e çdo orë, me shpirt e me zemër është me popullin vietnamez.

Partia, shteti dhe populli ynë kanë qenë dhe janë në luftë të përditshme kundër imperialistëve amerikanë, revizionistëve modernë sovjetikë, titistë dhe gjithë revizionistëve të tjerë, që, të lidhur me njëri-tjetrin, janë kundër socializmit, komunizmit, kundër vendeve tona.

Luftën kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, ju e bëni drejtpërdrejt me armë, kurse ne me të gjitha mjetet e tjera që kemi në dispozicion.

Partia dhe populli ynë kanë shumë vjet që janë ngritur në këmbë dhe po luftojnë edhe kundër tradhtisë revizioniste hrushoviane dhe titiste. Ata kanë demaskuar e do të demaskojnë gjer në fund të ashtuquajturën bashkëjetesë paqësore, aleancën reaksionare amerikano-sovjetike, veprimet e tyre tradhtare e dinake përballë heroizmave e sakrificave të pallogaritshme të popujve. Gjithashtu, ne s'do të pushojmë, por do të demaskojmë gjer në fund orvatjet e revizionistëve për ta detyruar e për ta mashtruar Vietnamin që të tërhiqet nga lufta e të bjerë në pozita oportuniste, të bëjë lëshime e të hyjë në marrëveshje me imperialistët amerikanë. Ne jemi optimistë dhe kemi besim të patundur se populli i Vietnamit, i Jugut dhe i Veriut, kurrë nuk do t'i hedhë armët, por do të luftojë gjer në fitoren e plotë, ashtu siç na e do zemra neve dhe juve.

Ne e kuptojmë pozitën tuaj dhe jemi të bindur që edhe ju e kuptoni tonën. Duke kuptuar pozitën tonë, ju e merrni me mend që ne luftojmë dhe përpigemi ta ndihmojmë rrugën e drejtë të luftës suaj heroike. Çfarëdo mund të bëjnë imperialistët dhe revizionistët, por nuk do ta shuajnë dot kurrë shpirtin luftarak të popullit tuaj. Shumë intriga po bëhen tani prej tyre, edhe më shumë do të përpiqen të bëjnë në kurrizin tuaj në të ardhmen, por armiqtë do të dështojnë. Imperialistët amerikanë tremben për vdekje nga lufta juaj, ata janë në vështirësi të mëdha politiko-ush-

tarake dhe kërkojnë të dalin, po nuk dinë si të dalin nga kjo gjendje e turpshme dhe pa krye për ta. Siç e gjykojmë ne, për ta nuk ka rrugëdalje, disfata e turpshme i pret. Natyrisht, ata përpiqen dhe do të vazhdojnë të kërkojnë rrugëdalje. Mashtrimi është në natyrën e tyre dhe për këtë kanë kohë që punojnë. Ja, megjithëse kanë vite të tëra që po bëjnë propagandë për «paqe», vazhdimisht po e shkallëzojnë luftën në Vietnam, por përsëri po pësojnë disfata. Në këto situata të vështira për imperialistët një rol të ulët po luajnë revizionistët modernë sovjetikë. Këta po u vijnë në ndihmë imperialistëve agresorë amerikanë me çdo gjë që kanë në dispozicion, me qëllim që si e si t'i shpëtojnë nga disfatat. Kjo duket hapur. Po të ishin me Vietnamin, me popullin e tij heroik që po derdh gjak, revizionistët sovjetikë jo vetëm që nuk do të mundoheshin t'i shpëtonin imperialistët amerikanë nga disfata, por do t'i kishin prerë urat, ecejaket e bisedimet me ta. Po përse nuk i presin? Është e kuptueshme, ata ndjekin qëllime akoma më të thella. Për ta ka rëndësi t'i realizojnë ato qëllime, të bashkëpunojnë në mes tyre, pa gjaku i vietnamezëve le të derdhet. Për ne janë shumë të qarta qëndrimi dhe pozita e renegatëve dhe e tradhtarëve revizionistë të Moskës.

Ne kemi besim se edhe ju kështu e kuptoni këtë çështje. Çfarë po bëni në fakt, mos hidhni valle? Jo, ju po gjakoseni ditë e natë. Kjo do të thotë se ditë e natë ju jeni në luftë me imperialistët amerikanë. Atëherë, përveç tradhtarëve, kujt tjetër mund t'i shkojë në mendje dhe të veprojë nën rrogëz që ju, luftëta-

rët heroikë, të zbutni luftën kundër barbarëve amerikanë, të cilët përpigën me zjarr e me hekur t'ju rrëmbejnë lirinë? Jo, ju këtë s'e bëni në asnjë mënyrë! Marksistë-leninistëve as u shkon në mendje një gjë e tillë. Vetëm tradhtarët mund të mendojnë ashtu. Ne jemi të bindur se do të fitoni, se lufta kundër imperializmit dhe lakenjve të tij do të vazhdojë, gjersa ata të shkallmohen plotësisht dhe përfundimisht.

Populli ynë gëzohet shumë çdo ditë që dëgjon lajme për fitoret e mëdha të popullit tuaj, në Jug e në Veri. Ai gëzohet për rezistencën heroike të popullit vietnamez, për rrëzimin e aeroplanëve të panumërt amerikanë. Kjo, për politikën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është katastrofë. Është e vërtetë se ato janë një fuqi e madhe dhe mund të prodhojnë avionë me shumicë, por edhe dëmtimet s'janë të vogla, aeroplanët e tyre po rrëzohen me shumicë në Veri, rrëzohen, gjithashtu, bile më me shumicë edhe në Jug. Sipas lajmeve edhe në Laos janë rrëzuar gjer tani me qindra aeroplanë. Ne s'e dimë ekzakt, po sipas të dhënave, gjer tani në Vietnam janë rrëzuar mbi 5 mijë aeroplanë gjë që do të thotë rreth 10 mijë pilotë të humbur, të vrarë ose të zënë robër. Rezervat e tyre në kuadro të aviacionit vijnë gjithnjë duke u pakësuar, bile jo vetëm në ushtarë e në oficerë, por edhe në armë e në fonde monetare. Ky është një inkurajim që shpejton fitoren tonë.

Ju, shoku ambasador, sikundër edhe ambasadorët e mëparshëm vietnamezë që kanë ardhur në vendin tonë, Shqipërinë, popullin dhe Partinë tonë duhet t'i konsideroni si vendin, popullin dhe partinë tuaj. Të

gjithë ne do t'ju duam si shokun dhe vëllanë tonë. Edhe ju kështu duhet të na konsideroni ne. Dhe kemi bindje të plotë se kështu do të na konsideroni. Te ju shohim përfaqësuesin e popullit vëlla heroik vietnamez. Prandaj në Shqipëri ta ndieni veten si në shtëpinë tuaj, si në vendin tuaj, të shkoni kudo, të takoheni me popullin tonë në gjirin e të cilit ju do të shikoni vetë si rreh pulsi i punonjësve dhe i anëtarëve të Partisë sonë për luftën e Vietnamit. Ne e ndiejmë për detyrë komuniste që popullin ta njohim nga afër me Vietnamin, me luftën dhe me sakrificat e tij të mëdha. Ky solidaritet po kalitet vazhdimisht.

Në luftën e madhe kundër imperialistëve amerikanë, populli juaj ka fituar një përvojë shumë të çmuar. Arti i luftës popullore është i kuptueshëm dhe i afërt për popullin, ai jo vetëm që nxit heroizmin dhe iniciativën, por rrit edhe pjekurinë politike të masave popullore. Lufta juaj do të pasurojë shkencën e artit luftarak popullor. Imperializmi amerikan, në pamundësi të shpërthimit të një lufte të përbotshme, do të përpiqet, me gjithë disfatat, të hapë fronte lufte të reja, luftëra lokale, në vende e në rajone të ndryshme të botës. Përvoja juaj do t'u duhet e do t'u shërbejë shumë popujve në të tashmen dhe në të ardhmen, sepse ju keni njohur gjithë ingranazhin e luftës së imperializmit amerikan, i njihni dobësitë, mundësitë dhe metodat e tij të luftës, strategjinë e taktikat e tij dhe mbi këtë bazë keni një përvojë të madhe për shkatërrimin e tij.

Le ta pimë këtë gotë, shoku ambasador, për vëllazërimin tonë marksist-leninist, për popullin heroik

vietnamez, për fitoren e tij të plotë dhe të shpejtë!
Ju uroj sukses në punën tuaj!

*Botuar për herë të parë në
librin: Enver Hoxha. «Kun-
dër revizionizmit modern
1965-1967», f. 589*

*Botohet sipas shënimeve të
mbajtura në këtë takim
që gjenden në AQP*

REVOLUCIONI ECËN ME HAPA VIGANË KUR NË TË MERR PJESË RINIA

*Nga fjala në mbrëmjen solemne me rastin
e 50-vjetorit të krijimit të gjimnazit
«Raqi Qirinxhi» në Korçë*

30 tetor 1967

Të dashur nxënëse e nxënës, mësuese e mësues,
të vjetër e të rinj të gjimnazit «Raqi Qirinxhi»,
Të dashur shokë, motra dhe vëllezër korçarë,

Jemi mbledhur sot këtu për të festuar një ditë historike, një jubile të lavdishëm, 50-vjetorin e shkollës sonë. Prandaj, çdonjëri nga ne ndien sot në zemër një gëzim të papërshkruar dhe emocione të forta, sepse kaloi gjysmëshekulli që nga ajo ditë kur në këtë qytet nga më të lavdishmit e Shqipërisë, në gjirin e këtij populli heroik, patriot e kulturëdashës deri në sakrificën më të madhe, u ngrit Liceu, tani shkolla 12-vjeçare «Raqi Qirinxhi». Gjatë këtij gjysmëshekulli, Liceu i Korçës ka kaluar nëpër një rrugë të zjarrtë, heroike, prandaj s'ka si të mos provojmë sot, në këto çaste, në zemrat e në mendjet tona,

ndjenja kaq të pastra mirënjohjeje revolucionare ndaj popullit tonë të papërkulur e në mënyrë të veçantë ndaj popullit dhe klasës punëtore korçare, ndaj mësuesve tanë, të vjetër dhe të rinj, që i dhanë jetë, gjallëri e shkëlqim kësaj vatre të flaktë patriotike të kulturës dhe të arsimit tonë.

Në këtë ditë të gëzueshme ne, gjithashtu, kujtojmë me respekt djemtë dhe vajzat e Shqipërisë, veçanërisht djemtë dhe vajzat e Korçës e të Liceut të saj që, me kushtrimin e parë të Partisë sonë të lavdishme, lanë bankat e shkollës, dolën në mal, u hodhën në Luftën Nacionalçlirimtare dhe luftuan me trimëri. Shumë prej tyre ranë në përpjekje me pushtuesit e huaj dhe tradhtarët e atdheut për t'i sjellë popullit këto ditë të lumtura që gëzojmë sot. Hidhërimi që ne ndiejmë për humbjen e shokëve e të shoqeve tona, plekset sot me gëzimin e këtyre çasteve, por ai nuk na mposht, nuk na ligështon, përkundrazi, na jep forcë e kurajë për të punuar e për të luftuar për popullin.

Në raste të tilla si ky i sotmi, të dashur shokë e shoqe, zakonisht mbahen fjalime akademike. Unë nuk do ta bëj një gjë të tillë se as që jam i përgatitur për këtë, prandaj të më falni, të më falin sidomos shkrimtarët dhe poetët se nuk e kam prirjen e tyre, nëse fjala ime do të ketë ndonjë frazë të palidhur mirë, sepse, si njerëz që jemi, kemi edhe ndjenja, të cilat sot janë veçanërisht të forta, e që ndoshta do të më pengojnë të shprehem si duhet.

Shoku Guri Pandeli, drejtor i gjimnazit «Raqi Qirinxhi», na bëri sot një tablo të plotë dhe frymëzuese të punës së kësaj shkolle në të kaluarën dhe sot. Naty-

risht, siç e dimë të gjithë, veprimtaria e saj ndahet në dy periudha: në atë të paraçlirimit dhe në atë të pasçlirimit. Po t'i bëjmë një bilanc periudhës së paraçlirimit, do të shohim se edhe ajo ka qenë pozitive, ka shërbyer për të mirën e popullit dhe të atdheut, pse edhe në atë kohë është punuar për lirinë dhe pavarësinë e tij. Si rezultat i punës së kryer në atë periudhë kjo shkollë dha një kontribut të shquar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare që udhëhoqi Partia jonë heroike.

Megjithëse para Çlirimit populli ynë kaloi kohë shumë të vështira, duke vuajtur nën regjimin e feudo-borgjezisë, me gjithë shtypjen e egër, obskurantizmin mesjetar dhe persekutimet pa mbarim që u bëheshin njerëzve përparimtarë, patriotëve, punëtorëve e fshatarëve, edhe në atë kohë në Shqipëri u hapën disa shkolla. Kjo jo se donte regjimi i Zogut, por nga presioni i fortë i popullit. Të gjithë e dimë ç'frikë të madhe kishte regjimi zogollian nga dituria, nga njerëzit e mësuar, pse e dinte që këta punonin për t'i zgjuar masat, për t'i edukuar dhe për t'i armatosur ato, prandaj, shkollat atëherë hapeshin në numër shumë të kufizuar, me vështirësi të madhe dhe, kur gjendej rasti, ato prapë mbylleshin, mësuesit patriotë e përparimtarë internoheshin, nxënësit më të mirë e revolucionarë dëboheshin nga shkolla. Megjithatë as mësuesit, as nxënësit nuk përkuleshin dhe kështu shprehej në këtë fushë vullneti i papërkulur i popullit tonë, shprehej atdhedashuria e mësuesve patriotë, veçanërisht e atyre të Korçës ku u krijua Liceu këtu e pesëdhjetë vjet më parë.

Edhe kjo shkollë pati, si të gjitha të tjerat, peripetitë e saj, derisa gjeti njëfarë stabiliteti. Liceu i Korçës filloi si një shkollë kombëtare dhe gjithnjë mbeti kombëtare, megjithëse për një kohë shumica e lëndëve jepeshin në gjuhën franceze. Mirëpo nxënësit dhe shumë nga mësuesit e Liceut ishin shqiptarë dhe përjetë mbetën të tillë, se nënat që na dhanë gji, na mësuan qysh në djep të jepnim dhe të japim edhe jetën për popullin dhe atdheun. Populli, nënat tona dhe mësuesit patriotë na mësuan me pasion që në kohë të fëmënisë, që në vitet e para të shkollës historinë e lavdishme të popullit tonë, luftërat e tij legjendare, kryengritjet, revolucionet, disfatat dhe fitoret. Të gjithë ne, pra, u mbrujtëm vazhdimisht me ideale të larta kombëtare, kështu që kultura franceze në asnjë mënyrë nuk mund të na i trondiste dot themelet prej graniti të ndjenjave tona të pastra e të thella patriotike.

Po, është, gjithashtu, e vërtetë që ne përfituam edhe nga kultura franceze që jepej në Lice e që ishte një kulturë pak a shumë përparimtare. Ne përfituam jo vetëm nga shkencat ekzakto, por edhe nga paraqitja që i bëhej në këtë shkollë zhvillimit shoqëror të njerëzimit, qoftë edhe ashtu siç e trajtonte këtë zhvillim programi i shkollave borgjeze franceze. Nga mësimet dhe nga librat e historisë ne merrnim atë që na duhej dhe profesorët francezë nuk ishin në gjendje të errësonin dot çdo gjë, pavarësisht se çështjet i trajtonin jo në atë interpretim dhe në atë gjerësi, siç i trajton marksizëm-leninizmi, siç i trajtojnë me vërtetësi Marksi, Engelsi dhe Lenini ngjarjet e ndryshme histo-

rike, fjala vjen kryengritjet e mëdha fshatare në Francë, në Gjermani e gjetkë.

Ne, djemtë e popullit të vuajtur shqiptar, nëpërmjet historisë që na bëhej këtu, gëzoheshim shumë kur mësonim se «të pabrekët» e Parisit ia fluturuan kokën mbretit të Francës dhe ëndërronim kur do të vinte ajo ditë që edhe ne t'ia pritnim kokën mbretit tonë, satrapit Ahmet Zogu. Neve, nxënësve të Liceut, që na kishte frymëzuar lufta e jakobinëve dhe e Robespierit, nuk na mbushej mendja me trajtimin himnizues që u bëhej nga profesorët e huaj luftërave të Napolconit, të këtij perandori gjakatar dhe gëzoheshim pa masë kur mësonim se furtunat revolucionare gjatë historisë rrëzonin mbretër dhe frone, sepse bindeshim se të njëjtin fat do të kishin edhe mbreti satrap dhe regjimi i tij që sundonin mbi popullin tonë.

Ne mësuam, këtu, në Lice, por muret e kësaj shkolle nuk na izolonin dot nga jeta dhe nga hallet e popullit. Shumica e djenve dhe e vajzave që ndiqnin Liceun, ishin bijtë e njerëzve të thjeshtë, prandaj dhe jetonin në gjirin e popullit trim heroik korçar, që i rrethonte nxënësit e Liceut me dashuri e me ngrohtësi.

Këtu në qytetin tuaj ekzistonte dhe punonte klasa punëtore korçare, e udhëhequr nga grupi komunist, i cili bënte një punë të madhe me ne, nxënësit e mësuesit, duke na edukuar politikisht dhe ideologjikisht. Ajo na mësonte e na përgatiste për revolucionin që do të bëhej edhe në vendin tonë, jo si ai revolucion që ne e mësonim nëpër librat e shkollës, por si revolucionin i bolshevikëve të udhëhequr nga Lenini dhe nga Stalini, mësimet e të cilëve ne i këndonim

fshehurazi në skuta e në oda të errëta. Punëtorët e Korçës na mësuan, që kur ishim akoma të rinj, të mos kishim frikë as nga dënimet, as nga torturat, as nga internimet, as nga talljet e sarkazmat e borgjezisë.

Këtu afër qytetit, diku aty nga zalli i lumit, ishte një kafe e vogël, nuk e di nëse është edhe tani, po në të punonte një plak i quajtur Nisi. Kjo kafe ishte qendra e militantit tonë të lavdishëm, të dërguarit të Kominternit, shokut Ali Kelmendi. Ne mbledheshim shpesh në këtë lokal me shokët, ku bisedonim për punën tonë. Por, qëllonte nganjëherë që kalonte andej njëfarë Petraq Katro, që ju korçarët e njihni më mirë se unë, i veshur me këpucë me taka të larta, i lustratur, i pudrosur, i livandosur, si gratë e liga të Parisit, dhe e porosiste Nisin me kapadaillëk t'i bënte një kafe. Por, sa na shihte ne, vinte dorën në ballë dhe na thoshte: «Ju, bolshevikë, po komplotoni, po nuk do të na rrëzoni dot». Ne i thoshim se koha punonte për popullin dhe kundër tyre dhe, në fakt, vërtet ashtu punoi, për popullin, për klasën tonë punëtore, sepse nga gjiri i popullit shqiptar, nga gjiri i klasës punëtore të vendit tonë, lindi Partia jonë heroike Komuniste, e vogël në numër, por e pamposhtur kurrë. Ajo me Luftën Nacionalçlirimtare mundi pushtuesit italianë e gjermanë të armatosur deri në dhëmbë, shkuli nga rrënjët pushtetin e borgjezisë reaksionare e të feudalëve, dërrmoi gjithë tradhtarët e atdheut, çliroi njëherë e përgjithmonë Shqipërinë, i dha popullit lirinë dhe tani po e udhëheq me sukses në ndërtimin e socializmit. Në këtë luftë heroike bijtë dhe bijat e Korçës, nxënësit dhe mësuesit e këtij Liceu dha-

në gjakun e tyre dhe treguan me prova e me sakrifica të mëdha se nga ç'brumë ishin gatuar.

Ne, shoqe dhe shokë të rinj, aq sa mundëm mësuam, por me këtë rast dëshiroj t'ju them që, kur ishim në moshë të re, kishim një etje të madhe për mësim. Por e them haptazi se etjen tonë nuk mund ta krahasojmë kurrë me etjen tuaj të madhe, nuk mund t'i krahasojmë kurrë njohuritë dhe dijet që kishim ne me tuajat, nuk mund ta barazojmë kurrë hovin tonë revolucionar me hovin tuaj të papërmbajtur revolucionar. Dhe kjo është e natyrshme. Kur ne ishim të rinj, qemë nën pushtetin shtypës të regjimit feudo-borgjez, kurse ju jetoni në socializëm; ne jetuam nën regjimin e errësirës, ju ndriçoheni nga drita e pashuar e Partisë; ju tash keni mëmën Parti, që ju mëson, ju udhëzon dhe ju ka hapur horizonte të pakufishme. Për të gjitha këto edhe ne dhamë kontributin tonë modest. Të gjithë shokët e vjetër që marrin pjesë sot në këtë takim, janë nxënësit e ish-Liceut të Korçës, shumë prej tyre me punë të palodhur janë bërë personalitete në fusha të ndryshme, pse kanë zotësi të rralla shkencore, teknike, organizative e, mbi të gjitha, një patriotizëm të shkëlqyer.

Ju e dini se këto ditët e fundit u mbajt në Tiranë Kongresi i 6-të i Bashkimit të Grave të Shqipërisë¹. Ky ishte një Kongres madhështor, ku shpërtheu në mënyrë të papërskruar forca e madhe e gruas shqiptare. Dëshiroj të tregoj një ndodhi nga të këtij Kon-

¹ Kongresi i 6-të i BGSH i zhvilloi punimet më 25-28 tetor 1967 në Tiranë.

gresi, me të cilën dua të bëj krahasimin midis rinisë së kohës sonë me rininë e sotme, që ka përgatitur Partia. Hipi në tribunën e Kongresit një vajzë, një shqiponjë e vërtetë nga malësia e Lekbibajt të Tropojës. Ajo, si dhe shumë shoqe të saj, që ishin në sallë, kishin dalë për herë të parë nga kullat e gurta të familjeve të tyre dhe kishin shkuar me guxim në hekurudhë. Me diskutimin e saj të zjarhtë kjo vajzë, që kishte vetëm pesë klasë shkollë, elektrizoi dhe ngriti peshë tërë pjesëmarrësit e Kongresit. Mbase diskutoi erdhi tek unë të më takonte. E ftova të qëndronte afër meje në presidium. Kur të tjerat po diskutonin, unë fillova bisedën me të me zë të ulët. Dhe kjo vajzë e maleve më tregonte përshtypjet e veta për sa kishte parë kur doli nga kufijtë e fshatit të saj, si e pa ajo Shqipërinë, më tregoi për luftën që kishin bërë ajo dhe shoqet e saj për të bindur prindërit që t'i lejonin të shkonin në aksion dhe, duke më treguar, sytë e saj ndritnin gjithë gjallëri. Unë vija re se me ç'vëmendje e etje për të mësuar shikonte ajo çdo gjë rreth e rrotull. Gjatë bisedës, midis të tjerash, më pyeti për një aparat, një radio të vogël me kufje nga ato që ishin vendosur për të dëgjuar në gjuhë të huaja fjalimet që mbaheshin në Kongres. Dhe unë, në vend që t'ia tregoja me fjalë ia vura kufjet në vesh dhe e pyeta nëse po dëgjonte. «Dëgjoj shumë mirë», m'u përgjigj vajza malësore. Por mbase ndenji pak, më pyeti përsëri ç'ishin ata pesë numra që ishin shkruar mbi këtë aparat. I shpjegoja se, duke lëvizur çelësin nëpër numra të ndryshëm, mund të dëgjoeshin fjalimet e Kongresit në gjuhën angleze, franceze

etj. dhe ia vura kufjet në vesh. Vajza donte të më kërkonte shpjegime të tjera për aparatën, por, pasi dëgjoi pak, më tha: «Shoku Enver, të lutem, ma kthe çelësin për me ndigjue në gjuhën e nanës, se ajo është ma e bukura e të gjithave».

Edhe Partia, pas Çlirimit të atdheut, i ktheu mësimet në ish-Liceun e Korçës në gjuhën e bukur të nanës Shqipëri.

Dhe pikërisht që nga ajo kohë filloi një pjesë tjetër e historisë së lavdishme të gjimnazit, të cilit iu dha emri «Raqi Qirinxhi», mësuesit të shquar të Liceut, intelektualit komunist që dha jetën për liri. Në këtë periudhë u duk që njerëzit tanë, mësuesit shqiptarë, si në këtë shkollë dhe në të gjitha shkollat e tjera të vendit tonë, nuk ishin më pak të zotë nga mësuesit dhe profesorët e huaj, megjithëse duhet thënë që edhe këta nuk ishin njerëz të paaftë. Por mësuesit tanë treguan me të vërtetë besim në forcat e veta, treguan patriotizmin e tyre të lartë, që ua frymëzoi Partia, e cila u dha krahë, i inkurajoi dhe i ndihmoi për të kapërcyer vështirësitë e panumërta që u dilnin përpara. Duhet njohur se pas Çlirimit të Shqipërisë nuk ishte çdo gjë shesh me lule, se ne nuk kishim gjithçka na nevojitej dhe shumë gjëra na mungonin jo vetëm për jetesë, por edhe në shkolla. Megjithatë, po t'u hedhësh një sy gjithë të rinjve e të rejave që kanë vazhduar e kanë mbaruar shkollat tona pas Çlirimit, do të shikosh ç'njerëz të zotë, të aftë e të mrekullueshëm na kanë përgatitur këto shkolla. Kjo u arrit, pse në krye kishim dhe kemi Partinë, udhëheqësen e lavdishme të popullit, që është

pararoja e klasës punëtore dhe ndjek me besnikëri e me konsekuencë një politikë të drejtë marksiste-leniniste.

Partia jonë u vuri rëndësi të dorës së parë rritjes dhe edukimit revolucionar të brezit të ri. Kjo të kuptohet mirë. Për këtë duhet të mendojmë ditë dhe natë të gjithë, sepse brezi i ri është e ardhmja e Shqipërisë, e socializmit, e komunizmit. Brezat vijnë njëri pas tjetrit, po socializmi e komunizmi ndërtohen e fuqizohen më shpejt e më mirë, sa më tepër të kalitet dhe të edukohet me frymën revolucionare dhe me shkencë të përparuar brezi i ri. Prandaj Partia këshilloi që brezi i ri, të rinjtë e të rejat, nëpër shkolla, në ara, në fabrika kurdoherë të mësojnë me etje të madhe dhe me një kuptim të lartë politik, shkencën, teknikën, lëndët humanitare dhe, në radhë të parë, marksizëm-leninizmin. Partia i këshilloi të rinjtë dhe të rejat të mos jenë të urtë, në kuptimin mikroborgjez të kësaj fjale, por revolucionarë, të marrin pjesë kudo, me zjarr e me hov revolucionar dhe të luftojnë çdo pengesë. Lufta jonë për komunizmin kërkon që jo vetëm disa të jenë revolucionarë dhe të tjerët vetëm t'i ndjekin pas. Jo, të gjithë duhet t'i futemi punës dhe revolucionit dhe kur në revolucionin tonë të pandalshëm merr pjesë aktive rinia, atëherë hapat bëhen viganë, kur në revolucionin tonë të madh futet grujaja, fitoret nga kjo pjesëmarrje janë të pallogaritshme.

Rinia është gjaku ynë i ri, janë të rejat dhe të rinjtë që do të na zëvendësojnë nesër. Por kjo të mos kuptohet sikur tash rinia duhet të rrijë rehat, të hajë,

të pijë, të këndojë dhe të mendojë sikur një ditë, në të brezit të vjetër do t'i biem borisë dhe do ta thërrësim të na zëvendësojë. Jo, stafetën e revolucionit ju, të rinj e të reja e merrni çdo ditë, në luftë, në revolucion, në jetën e përditshme. Kështu, vazhdimisht duhet t'i përgatitim të rinjtë dhe të rejat tona, t'u japim atyre besim të plotë dhe t'i ngarkojmë me çdo punë. Për këtë të moshuarit duhet të spastrojnë mirë mendimet e tyre. Asnjë të mos kujtojë se, po të mos jemi ne, u prish Shqipëria, sikur jemi ne që bëjmë gjithçka. Në asnjë mënyrë! Çdo gjë që krijohet e ndërtohet në vendin tonë e bën populli, e bëjnë masat, komunistët, të rinjtë e të rejat, gratë tona heroike, e bën gjithë kjo forcë e madhe e bashkuar e popullit, e kalitur, e brumosur, e udhëhequr nga Partia, nga marksizëm-leninizmi. Nën udhëheqjen e Partisë, te ne i madh e i vogël, janë hedhur në sulm në frontet e punës e të mësimit e po vërshojnë si uji i kulluar, që njom fushat dhe i bën pjellore; të gjithë ecin përpara plot entuziazëm, prandaj të bëjmë kujdes të mos i frenojmë në vrullin e tyre të madh. Përkundrazi, detyra jonë është t'i edukojmë dhe t'i ndihmojmë të ecin gjithnjë përpara në rrugë të drejtë.

Qëllon te ne që ndonjë komitet partie qahet se s'gjejnë dot një shoqe për ta vënë përgjegjëse të organizatës së gruas të rrethit, pse gjoja s'kanë kë të vënë. A është e mundur kjo? Çështja është se këta shokë nuk i njohin mirë njerëzit. Në Kongresin e grave, dëgjova të diskutonte një vajzë të re, nga një fshat i largët i Librazhdit. E pakët ishte nga trupi, por fliste si një sokoleshë sypatrembur, me një zjarr

revolucionar, me një kuptim të thellë politik, me një qartësi të madhe dhe ngriti peshë gjithë sallën. Ajo është në gjendje që jo vetëm gratë e rrethit të vogël të Librazhdit, por edhe gratë e një rrethi më të madh t'i ngrejë në këmbë dhe, pavarësisht se nuk ka akoma një kulturë të gjerë dhe nuk i njeh punët e drejtimit, atë, me siguri, do ta ndjekin gratë me hov e me dashuri, sepse do të shohin ç'zotësi e ç'forcë e madhe mobilizuese, ç'aftësi të mëdha fshihen tek ajo vajzë e re e thjeshtë e popullit.

Këtu dua të theksoj edhe një herë porosinë e vazhdueshme e me rëndësi të madhe të Partisë që i këshillon komunistët të futen medoemos dhe kurdoherë në popull, të lidhen sa më ngushtë me masat, të dëgjojnë me vëmendje zërin e tyre, të punojnë e të realizojnë sa më shumë për popullin, sepse, megjithëse kemi bërë shumë gjëra në vendin tonë, këto janë akoma pak.

E ardhmja e vendit tonë, shoqe dhe shokë, është e ndritur, e sigurt. Armiqtë nuk kanë ç'na bëjnë. Shqipërinë sot nuk guxojnë ta prekin as imperialistët, as revizionistët tradhtarë të Moskës, as titistët e të tjerë, kudo që të jenë. Por, edhe sikur të vendosin të na prekin, ata do të gjejnë në vendin tonë vdekjen e sigurt.

Mos vallë këto që them janë mburrje? Jo! Ne, populli dhe komunistët shqiptarë, nuk e kemi zakon të mburremi, por është fakt që Partia jonë ka ditur të zbatojë me zgjuarsì marksizëm-leninizmin në kushtet tona dhe ka krijuar një unitet të çeliktë Parti-popull, që s'ka forcë, të jashtme ose të brendshme, ta

dobësojë. Të gjithëve na vihet detyrë që këtë forcë të madhe, unitetin tonë, ta kalitim gjithnjë e më shumë dhe kjo arrihet vetëm në revolucion, me punë, me ndershmëri, duke luftuar çdo mbeturinë të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve tanë, duke vendosur me guxim e heroizëm ligje e norma të reja, duke thyer çdo barrikadë që na pengon në rrugën tonë të socializmit. Një punë e tillë është në interesin e madh të popullit, të atdheut, të së ardhmes. Ajo është njëkohësisht një inkurajim i madh për gjithë shokët tanë komunistë dhe elementët revolucionarë në botë, për popujt që luftojnë dhe vuajnë akoma në kthetrat e skllavërisë kapitaliste.

Detyrat që kemi përpara kërkojnë nga të gjithë që t'i njohim dhe t'i përvetësojmë thellë në mendjen tonë mësimet e Partisë; të mendojmë kurdoherë për popullin që të mos kthehet kurrë më e kaluara e errët e të mos lejohet lindja e revizionizmit në vendin tonë. Për të siguruar realizimin e këtij qëllimi kaq të lartë e fisnik për të ardhmen e popullit shqiptar, kërkojmë sakrificë, bile të mëdha; duhen luftuar me vendosmëri mendimet e konceptet jo të drejta që ekzistojnë te shumë njerëz dhe që shfaqen herë mbas here, ku më të acaruar, ku më pak të acaruar, ku të sipërfaqshme, ku më të thella, por që, në një shkallë ose në një tjetër, e bëjnë dëmin e vet. Këtë luftë që bëjmë të gjithë, ta bashkojmë në një të tërë: të themi hapur, pa frikë, para shoqi-shoqit çdo gjë që na pengon të ecim përpara, ta lavdërojmë atë që punon në mënyrë shembullore, po të mos kursehemi t'i heqim veshin atij që nuk punon mirë dhe duhet korrigjuar. Edhe

kjo duhet bërë, pse ka akoma thashetheme, ekzistojnë mentalitete të dëmshme, të rrezikshme, kundër të cilave duhet të luftojmë pa hezitim. Në këtë drejtim komunistët, në radhë të parë, të jenë shembull ndershmërie, sakrifice dhe vendosmërie. Nga ata kërkohet të jenë të parët në punë e të fundit në pretendime. Kur Partia bën thirrje për të shkuar për të punuar e për të jetuar në fshat, komunisti të vejë i pari; kur Partia i bën thirrje komunistit të punojë në minierë, ai përsëri të jetë i pari e kështu për kudo.

Sot gjithë Shqipëria, shoqe, shokë e vëllezër të dashur, zien si një vullkan nga lëvizjet dhe nga iniciativat revolucionare që janë aq të shëndetshme për jetën dhe për njerëzit tanë. Frytet e tyre janë të mëdha: njerëzit po pastrojnë ndërgjegjen, po punojnë e po luftojnë me hapin e kohës, po ndiejnë edhe më shumë nevojën e ngritjes arsimore, kulturore e ideologjike. Shkolla, arsimi, kultura na duhen patjetër neve, ndërtuesve të socializmit. Partia i ka krijuar kushtet që, brenda një kohe të shkurtër, me dhjetëra mijë punonjës të hidhen me të gjitha forcat edhe në frontet e mësimt.

Vetë zhvillimi i jetës po sugjeron kapërcimin e disa rregullave ekzistuese në organizimin e shkollave tona. Kudo janë duke u ngritur dhe do të ngrihen të tjera shkolla tekniko-profesionale. Çdo ndërmarrje, fabrikë, uzinë, çdo kooperativë e ndërmarrje bujqësore po krijon shkollën e vet dhe kjo punë, që sa ka filluar, me siguri, brenda një kohe shumë të shkurtër do të ndihmojë që niveli kulturor, arsimor e teknik i punëtorëve e i kooperativistëve tanë të ngrihet lart

dhe me të shpejtë. Ky është një tjetër revolucion që po bëhet te ne.

Njerëzit tanë tani nuk luftojnë vetëm për diploma. Sigurisht, edhe diploma ka rëndësinë e vet, por rëndësi më të madhe kanë mësimi, dituria dhe këtë ata e kanë kuptuar, sidomos rinia jonë. Gjer disa vjet më parë, kur hapej ndonjë shkollë ose kurs, diskutohesh për një kohë të gjatë me ç'shkollë do të barazohesh diploma që do të merrej prej saj, e ç'niveli do të ishte shkolla ose kursi, ndërsa kjo çështje nuk ka rëndësi përpara asaj që populli, socializmi duan njerëz të mësuar, të zotë, që të dinë teorinë dhe ta zbatojnë atë në jetë me sukses. Natyrisht, filozofë e shkencëtarë nuk do të dalin të tërë ata që venë në shkollë, por, veç, ata që do të dalin mësues, që do t'u japin dituri të tjerëve, do të shohin se nuk do të gjejnë tani njerëz të paditur si dikur, por njerëz që u janë futur shkencës, teknikës, diturisë, qoftë edhe nëpërmjet praktikës për t'i shërbyer prodhimit. Po t'i takojë ndonjërit nga ju të vejë tani në rrethin e Matit, le të kërkojë të vizitojë kabinetin e farërave të zgjedhura. Ai do të gjejë atje një fshatar, i cili të fut në një sallë me tavan të përshkuar nga trarë, në të cilët do të shikosh të varur në mënyrë të hijshme kosha të tërë me vargje prej kallinjsh misri e që kanë të gjithë nga një etiketë «Mati nr. 1», «Mati nr. 2», «Mati nr. 3» etj. Asnjëri nuk lejohet të hyjë në këtë sallë me veshje e mjete që mund të rrezikojnë infektimin e farërave. Për cilindo që futet atje, zbatohet një regjim i rreptë. Ata që merren me këtë punë janë njerëz të mësuar dhe kjo përvojë e përparuar nuk do

të kufizohet vetëm me një kooperativë, por nëpërmjet kurseve e shkollave që po çelim do të përhapet edhe në të tjerat. Kjo do të bëjë që nesër të dalin me mijëra njerëz të mësuar në këtë fushë, edhe gra e vajza, që do të mësojnë edhe më shumë në të ardhmen e do të përvetësojnë dije të gjera. Kjo do t'i hapë horizonte të mëdha atdheut, do t'i japë ekonomisë popullore prodhime të bollshme.

Sa shumë ka luftuar Partia gjatë gjithë kësaj kohe që fshatarësia jonë kooperativiste t'i rritë rendimentet e misrit, të grurit etj.! Sa vështirësi u desh të kaloheshin për të arritur këtu ku jemi sot! Mos harroni, shoqe dhe shokë, se gjithë ky revolucion në prodhim e në çdo lëmë të jetës sonë nuk u bë me një të shtypur të sustës! Ai është rezultat i punës së palodhur të Partisë, të komunistëve, të fshatarësisë sonë patriotike që kanë synuar dhe kanë punuar nga viti në vit, nga muaji në muaj e ditë për ditë për të rritur vazhdimisht prodhimin, rendimentet, për të zhvilluar ekonominë, kulturën, arsimin. Dhe tani u arrit të bëhet një hop i madh në këto fusha, hop që nuk duhet ndalur, por të zhvillohet e të ndiqet nga hope të tjera.

Për mbylljen e pesëvjeçarit të katërt na duhen akoma edhe tre vjet, po, duke parë gjendjen e krijuar në vendin tonë, Partia, Komiteti Qendror janë të bindur se zhvillimit tonë i hapen perspektiva të mrekullueshme. Brenda një kohe të shkurtër ne do të mund ta shtojmë kapacitetin e uzinës së plehrave azotike, duke dyfishuar kështu prodhimin, do të rritim kapacitetin e uzinës së superfosfatit, të fabrikave

të çimentos etj.; do të vazhdojmë zgjerimin e metalurgjisë së zezë, e cila do të japë tri herë më shumë prodhim nga sa kishim parashikuar në plan. Të gjitha këto do t'i bëjë forca e madhe e popullit, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë sonë. Partia ka bërë të qartë çdo gjë, punën, metodat, rrugët që duhen ndjekur dhe populli, klasa punëtore, fshatarësia, mësuesit e pedagogët, nxënësit, kudo që janë, i zbatojnë me besim të plotë mësimet e saj të urta.

Pastaj, duke folur për disa probleme të gjendjes ndërkombëtare, për ngjarjet në Kinë, për luftën e popullit vietnamez kundër imperializmit amerikan etj., midis të tjerash, shoku Enver Hoxha, tha:

Sot, kundër imperializmit dhe kundër tradhtisë revizioniste, janë ngritur popujt e revolucionarët e vërtetë të botës. Edhe në vendet ku sundojnë revizionistët klasa punëtore dhe komunistët e vërtetë po fillojnë të zgjohen. Prandaj revizionistët sovjetikë i kanë drejtuar tanket e mitralozat kundër punëtorëve që demonstrojnë në Bashkimin Sovjetik. Edhe në Bullgari burgjet janë mbushur me revolucionarë, në Çekoslovakia, gjithashtu, po shturet gjendja, njerëzit kanë filluar të kundërshtojnë, bile edhe brenda në parti, sepse shohin që po u shitet vendi. Kështu po ndodh edhe në vendet e tjera revizioniste. Këto ngjarje tregojnë se atje gjendja po zien. Ne i ndjekim me interes ato, sepse dëshirojmë që atje të shpërthejë revolucionin proletar. Pikërisht për këtë luftojmë, për këtë po punojmë, për revolucionin proletar botëror, i cili me siguri do të fitojë. Natyrisht, do të duhet të derdhet edhe gjak, por në mos sot, nesër, ai do

të fitojë patjetër, ngjarjet do të zhvillohen zinxhir dhe kurdoherë në favor të proletariatit botëror e të popujve, në favor të socializmit.

Prandaj, shokë e vëllezër, sa më të fortë të jemi, aq më pak do të guxojnë të na prekin armiqtë tanë. Ata, po të duan, le të vijnë të shohin sa u vlen lëkura, kushdo qofshin, në daçin edhe revizionistët sovjetikë, të cilët para ca kohësh bënë një propagandë shurdhuese për të na frikësuar, sikur gjoja Greqia po përgatitej për të na sulmuar etj., etj. Renegati Leonid Brezhnjev dërgoi përfaqësuesin çekoslovak në Shqipëri, për të njoftuar Ministrinë tonë të Punëve të Jashtme se paskeshin informata sikur Greqia do të sulmonte Shqipërinë, po shokët tanë i thanë të dërguarit të revizionistëve sovjetikë se ne s'kemi frikë nga kurrkush dhe se këta që na hiqen si miq i njohim mirë dhe do t'i luftojmë deri në fund. Armiqtë, kur s'të kafshojnë dot dorën, kërkojnë të të puthin, por «puthja» e tyre është me helm.

Revizionistët jugosllavë ndodhen në situata jashtëzakonisht të vështira. Ata janë diskredituar politikisht e ideologjikisht edhe brenda në Jugosllavi, ku po zhvillohet një proces dezintegrimi. Ku ka shpërthyer një valë e shfrenuar shovinizmi e nacionalizmi të tërbuar dhe ku kapitalizmi i huaj ka kapur për gryke tërë ekonominë jugosllave. Klika e Titos, bashkë me tradhtarët shqiptarë të Kosovës, po përpiqen tani t'u hedhin hi syve edhe vëllezërve tanë kosovarë, prandaj ata s'lënë ditë pa folur sikur gjoja dashkan miqësinë me Shqipërinë, u predikojnë të harrojnë të kaluarën e të tjera përralla si këto. Pse po e bëjnë këtë? Që t'i

thonë popullit kosovar sikur revizionistëve jugosllavë po u qan zemra dhe duan të forcojnë marrëdhëniet me Shqipërinë, po nuk dashkan shqiptarët. Por ne e dimë mirë se populli i Kosovës nuk gënjehet lehtë, ai është një popull i vuajtur shumë, pse ka hequr të zitë e ullirit nga shovinistët serbë dhe titistët, prandaj nuk mashtrohet nga demagogjia e tyre. Ne do t'u japim vëllezërve kosovarë ç'të duan; libra të shkrimtarëve tanë, filma shqiptarë apo tekstin e Historisë së Shqipërisë etj. Ne, njëkohësisht, i japim Qerime Galicës, Shotës, bijës trimëreshë kosovare, që luftoi me vite të tëra kundër reaksionit serb për të drejtat e popullit shqiptar të Kosovës, titullin e lartë «Hero i Popullit».

Vëllezër dhe motra, të rinj e të reja, nxënës të gjimnazit «Raqi Qirinxhi»,

Edhe një herë dëshiroj t'ju them se jam shumë i gëzuar që sot ndodhem midis jush. Gjithçka pashë në shkollën tuaj dhe në këtë sallë, më kanë dhënë forca për të bërë edhe më shumë nga ç'kam bërë gjer më sot për popullin dhe Partinë, për këtë popull dhe për këtë Parti që më mësuan, më edukuan dhe më ngarkuan me një përgjegjësi të madhe. Unë do të vë të gjitha forcat për të kryer detyrën që më është ngarkuar, si dhe çdo detyrë tjetër që do të më ngarkojë Partia. Partia, që rron dhe militon në gjirin e këtij populli të lavdishëm, për ato që bën, duhet të thotë kurdoherë se ka bërë pak, ajo do të bëjë dhe duhet të bëjë më shumë, se ju ka ju, ka gjithë popullin tonë të pamposhtur si malet tona, me një karakter të lartë,

një popull të zotin e të zgjuar që e ka rrethuar Partinë me një dashuri të zjarrtë e besim të madh. Partia do të bëjë kurdoherë detyrën që ta meritojë këtë dashuri dhe besim të madh të popullit shqiptar.

Rroftë Partia!

Rroftë populli!

Rroftë rinia!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

NXËNËSIT DHE MËSUESIT TANË JANË PATRIOTË, REVOLUCIONARË

*Nga biseda me nxënës e mësues të shkollës
8-vjeçare «Stavri Themeli» në Korçë*

31 tetor 1967

Vizitën e parë në këtë shkollë, shoku Enver Hoxha e bëri në klasën e shtatë B, ku po zhvillohej mësimi i matematikës. Pasi i pyeti nxënësit dhe mësuesin si shkonte klasa me mësim, u ul në një nga bankat, në mes nxënësve dhe zhvilloi një bisedë të shkurtër me ta. Në mes të tjerash ai tha:

Gëzohem shumë që ju, vajza dhe djem të kësaj klase, jeni mirë me shëndet dhe me mësim. T'i doni Partinë, popullin, mësuesit që ju mësojnë; përpiquni të bëheni të ditur dhe të silleni mirë! Partia kërkon që ju në shkollë të mësoni shumë gjëra, të mos kufizoheni vetëm me lëndët e ndryshme që ju japin mësuesit. Ajo mendon se ju duhet të mësoni edhe përdorimin e armëve për luftë kundër armiqve që mund të na sulmojnë, prandaj mësoni të përdorni pushkën e armët e tjera, me qëllim që, kur të mba-

roni shkollën e mesme, të jeni të përgatitur për përdorimin e tyre dhe disa nga ju të jenë në gjendje edhe të komandojnë formacione ushtarake. Ne këto gjëra i mësuam vonë, kur Partia na bëri thirrje për luftë, ndërsa ju dini shumë gjëra që tani, në moshën e rinisë.

Kur u fut në një nga klasat e pesta, shoku Enver u uroi nxënësve suksese në mësim, i këshilloi të mësojnë mirë, të bëhen revolucionarë, të jenë kurdoherë të gjallë dhe aktivë, t'i duan atdheun, Partinë, popullin, mësuesit, mësimin dhe punën. Ai i porosi ata të jenë kurdoherë aktivistë shoqërorë revolucionarë dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet. Pastaj, duke iu drejtuar mësuesit të klasës dhe drejtuesve të shkollës, vazhdoi:

Ju, mësuesit, mos u shqetësoni, kur shikoni se të rejat e të rinjtë janë ca të hedhur, po punoni me ta që ta kuptojnë rëndësinë që ka dëgjimi me vëmendje i mësimeve. Mësuesit duhet të kuptojnë që nganjëherë nxënësit edhe mund të bisedojnë me njëri-tjetrin në klasë për çështje mësimi. Në qoftë se ata bisedojnë për çështje të tjera, atëherë mësuesi ka të drejtë t'u tërheqë vëmendjen, por, kur nxënësi i kërkon një shoku një shpjegim të vogël, ai nuk duhet të mërzhitet. Edhe kur shikon në klasë gjallëri e dinamizëm revolucionar te nxënësit, të përpiqet të mos i ndrydhë ata për hir të disiplinës formale. Ne nuk duam që rinia jonë të jetë e ndrydhur, saqë për çdo gjë, edhe kur diçka nuk është e drejtë, të thotë «si urdhëron».

Pastaj shoku Enver vizitoi klasën e tetë C, ku

zhvillohej ora e mësimit të gjuhës shqipe. Kur po fliste një e re në këtë orë mësimi, shoku Enver, pasi i bëri asaj disa pyetje, kërkoi mendimin e nxënësve se ç'notë t'i vinte: të gjithë u shprehën njëzëri për notën 10, pse përgjigjja ishte e plotë, e qartë dhe e shpejtë.

Duke vizituar klasën e gjashtë C, shoku Enver Hoxha, mbasi përshëndeti nxënësit, u tha:

Mësuesit i keni shumë të mirë, revolucionarë dhe të mësuar. Ata i mësoi Partia. Tani gjendja në vendin tonë nga çdo pikëpamje është e mirë.

Dëgjova se keni marrë ca zotime, po ju e dini që, kur merret një zotim, duhen bërë përpjekje që të mbahet dhe unë jam i bindur se ju do t'i mbani ato gjer në fund.

Në klasën e tetë B ku po zhvillohej mësimi i matematikës shoku Enver pyeti cilët janë nxënësit e nxënëset më të dalluara dhe, pasi dëgjoi emrat e tyre, ai e porositi mësuesen të mos jetë e kënaqur me pak. Pastaj ai vazhdoi:

Zotësia e mësuesit qëndron në atë që ta bëjë të gjithë klasën të përparuar.

Çështja është që, sidomos ju, mësuesit e matematikës, t'ua bëni nxënësve sa më të dashur këtë shkencë, pse ajo paraqit me të vërtetë ca vështirësi për t'u përvetësuar, por, po të bëni të gjitha përpjekjet për t'ua bërë të kuptueshme lëndën, të jeni të afërt me ta, të krijoni me pamjen dhe me qëndrimin tuaj të qeshur në klasë një atmosferë të ngrohtë, nxënësve do t'u ngjallet dëshira për matematikën, do t'u zhduket ai emocion i rëndë që u krijohet kur hyjnë në orët e

këtij mësimi. Sado e vështirë të jetë matematika, kur nxënësit të shohin mësuesin që ua shpjegon mirë dhe ua bën të kuptueshme të gjithëve dhe jo vetëm katër-pesë vetave, kur të shohin mësuesin të qeshur dhe me humor të mirë, ata do të vijnë me gëzim në klasë. Pra, po të ketë mësuesi një predispozicion të tillë, nxënësi do të vihet ta mësojë patjetër këtë shkencë.

Matematika është shumë e bukur. Sot në shekullin tonë, kur shkenca dhe teknika kanë marrë një zhvillim të madh, matematika është e domosdoshme për të gjithë, sepse nuk ka sektor ku nuk hyn ajo, prandaj përpiquni ta zotëroni atë! Nga ish-Liceu i Korçës, që ka qenë në këtë godinë, kanë dalë njerëz të dëgjuar në matematikë, një pjesë e të cilëve kanë hyrë në analet e universiteteve të huaja. Këto tradita të mira të kësaj shkolle ju, jo vetëm t'i ndiqni, por edhe t'i zhvillonit më tej, se atëherë ishin të tjera kohë, mësuesit kënaqeshin me tre-katër nxënës të shkëlqyer, kurse tani kaq na duken shumë pak, prandaj mësuesit të punojnë në mënyrë të tillë që nga shkollat të dalin të tërë nxënësit me nota të mira, jo vetëm në matematikë, por në çdo lëndë.

Një bisedë zhvilloi shoku Enver Hoxha edhe në klasën e gjashtë A:

Kur erdha për herë të parë në ish-Liceun e Korçës, pikërisht në këtë klasë kam hyrë. Atëherë ne i sillnim kokëçarje drejtor Papakristos, po, veç duhet thënë se mësuesit e asaj kohe nuk e kuptonin si duhet natyrën e rinisë, të të rinjve e të rejave tona, ata donin që ne të rrinim sus, të mos lëviznim fare në shkollë. Mirëpo Partia dëshiron që rinia të jetë e gjallë, e he-

dhur, revolucionare dhe jo e fjetur, siç këshillon pedagogjia borgjeze, e cila kërkon që rinia të jetë e bindur verbërisht. Kjo nuk është aspak e drejtë, prandaj ju jo vetëm mos pranoni kur diçka nuk ju duket e drejtë, por edhe kur nuk e kuptoni mësimin mos u druani t'i thoni mësuesit që nuk e kuptuat, pse ai e ka për detyrë t'ju shpjegojë edhe një herë. Mësuesit i kemi revolucionarë, të mirë, patriotë, disa prej tyre janë edhe komunistë dhe ju duan ju dhe Partinë me gjithë shpirt, e kanë kuptuar detyrën e madhe që u kanë ngarkuar Partia dhe populli për t'ju mësuar dhe për t'ju edukuar. Dhe kjo është një detyrë shumë fisnike.

Ju keni dëgjuar për revolucionarin e madh bullgar, Gjergj Dimitrovin, shok i ngushtë i Stalinit, sekretar i Kominternit. Kur u çlirua Bullgaria, ai u bë Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Ministrave të Bullgarisë. Gazetarët e pyetën një herë cilin zanat do t'i pëlqente të ushtronte sikur ta lejonin dhe ai tha se dëshira e tij do të ishte të shkonte mësues në fshat për të ngritur rininë bullgare në këmbë, për t'i shërbyer sa më mirë popullit të vet. E shihni, pra, ç'detyrë të rëndësishme ka mësuesi?

Mësuesit tanë janë njerëz të mirë. Ata bëjnë përpjekje ta kryejnë si duhet detyrën që u është ngarkuar dhe në çdo rast mendojnë për ju. Prandaj t'i doni e t'i nderoni mësuesit me gjithë shpirt, por edhe mos i lini rehat, i pyetni për çdo gjë dhe të jeni të bindur se ata nuk do të mërziten, bile do të gëzohen kur t'i pyetni për gjithçka, edhe për politikë, edhe

për shkencë, sepse ata i ka edukuar Partia të mos jenë apolitikë. Edhe mësuesi i matematikës është te ne njeri politik, që e njih mirë vijën e Partisë. Mund të ndodhë që ndonjëri prej tyre të mos jetë plotësisht i qartë për diçka, megjithatë ai nuk do të mbajë pozën e mësuesve të vjetër e të ketë turp t'ju thotë se nuk e di, përkundrazi, do t'ju flasë hapur që këtë çështje do t'jua sqarojë një herë tjetër, pse i duhet të mendojë, të pyesë një shok ose të lexojë diçka që t'ju përgjigjet në mënyrë të saktë. Një qëndrim i tillë e ngre edhe më shumë autoritetin e mësuesit përpara jush dhe asnjë nga ju nuk do të thotë që mësuesi nuk di, përkundrazi, do të shihni tek ai një njeri me të vërtetë të ndershëm, që dëshiron ta thotë çdo çështje drejt, ashtu siç është. Në këtë mënyrë do të rriten edhe më shumë dashuria dhe respekti për të.

Kur shoku Enver Hoxha pyeti më në fund mësuesin si quhej, doli se ky paskësh qenë ish-nxënës i tij kur ishte profesor në këtë shkollë. Shoku Enver e përqafoi me dashuri dhe i uroi sukses në detyrë.

Në fund të vizitës shoku Enver Hoxha pa laboratorët e shkollës dhe bëri një fotografi me mësuesit, me nxënësit dhe me punonjësit e tjerë të kësaj shkolle.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 36-TË V-X

1967

- MBI DISA ASPEKTE TË PROBLEMIT TË GRUAS SHQIPTARE – Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (15 qershor 1967) 1-31
- MBI ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË REVOLUCIONIT KULTUROR PROLETAR KINEZ – Fjala në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (16 qershor 1967) 32-60
- GJYKATËSIT TË ZBATOJNË DREJT DHE NGA POZITAT E PARTISË FRYMËN E LIGJIT – Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (20 qershor 1967) 61-66
- REVIZIONISTËT SOVJETIKË – ZJARRFIKËSIT NDËRKOMBËTARË TË REVOLUCIONIT DHE TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE TË POPUJVE – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (21 qershor 1967) 67-84
- NUK MUND TË THYHET NJË POPULL QË UDHËHIQET NGA MARKSIZËM-LENINIZMI – Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike të Vietnamit (21 qershor 1967) 85-91

HISTORIA E PARTISË I FRYMËZON KOMUNISTËT DHE POPULLIN PËR FITORE TË REJA – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 qershor 1967)	92–100
TË BËJMË NJË KTHESË VENDIMTARE NË ZHVILLIMIN E MALËSIVE TONA – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 qershor 1967)	101–113
MË TEPËR KUJDES, KONTROLL, INICIATIVË E ORGANIZIM PËR KUALIFIKIMIN E KUADRIT – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (1 korrik 1967)	114–124
DOBËSITË T'I SHOHIM DREJT NË SY – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (1 korrik 1967)	125–128
NË RADHË TË PARË E MBI TË GJITHA QËNDRON ÇËSHTJA E PARTISË, PA TË NUK MUND TË KETË FITORE – Nga biseda me një delegacion të «gardistëve të kuq» kinezë (8 korrik 1967)	129–138
REVOLUCIONI FITON VETËM KUR PARTIA MARKSISTE-LENINISTE I ZGJON MASAT DHE I BËN ATO TË NDERGJEGJSHME PËR DOMOSDOSH-MËRINË E TIJ – Nga biseda me dy shokë sudanezë (12 korrik 1967)	139–164
TË MBROSH MARKSIZËM-LENINIZMIN DO TË THOTË TË MBROSH TË ARDHMEN E BOTËS – Nga biseda me disa marksistë-leninistë francezë (12 gusht 1967)	165–183
NË LUFTE DHE NË REVOLUCION MARKSISTË-LENINISTËT BËHEN MË TË FORTË E TË PAMPOSHTUR – Nga biseda me shokun Pedro Pomar (18 gusht 1967)	184–209

- SA MË SHPEJT T'I ZHDUKIM ZAKONET PRAPANIKE, AQ MË SHUMË DO TË LULËZOJË MALËSIA — Nga fjala në takimin me popullin e fshatit Rrapsh-Starje të rrethit të Shkodrës dhe me përfaqësues të popullit të malësisë së Kelmendit (2 shtator 1967) 210—233
- SHQIPËRIA E RE LINDI NGA REVOLUCIONI DHE NDËRTON SOCIALIZMIN NËPËRMJET REVOLUCIONIT — Nga fjala në mitingun e organizuar me rastin e 24-vjetorit të luftës së Reçit (3 shtator 1967) 234—264
- MENÇURIA, ZOTËSIA, DITURIA DHE PUNA JUAJ DO TË SHNËRROHEN NË DRITË QË DO TË ZBUKUROJË JETËN E NJERËZVE TANË — Nga biseda me punëtorët e kantierit të ndërtimit të hidrocentralit të Vaut të Dejës (4 shtator 1967) 265—268
- TË RINJTË TË BËHEN LUFTËTARËT MË TË VENDOSUR PËR ZBATIMIN E VIJËS SË PARTISË — Fjala në takimin me të rinjtë dhe të rejat nga Dukagjini, vullnetarë në hidrocentralin e Vaut të Dejës (4 shtator 1967) 269—275
- PARTIA ËSHTË E FORTË, SEPSE VETË POPULLI QË E LINDI ËSHTË I FORTË — Nga fjala në takimin me kooperativistët e Troshanit dhe të fshatrave të afërta të rrethit të Lezhës (4 shtator 1967) 276—289
- PËR MIQTË E VËRTETË DYERT JANË KURDOHERË TË HAPURA NË SHQIPËRINË SOCIALISTE — Nga biseda me një mik nga Turqia dhe me vajzën e tij (7 shtator 1967) 290—298
- MASAT TË EDUKOHEN ME NDJENJËN E RESPEKTIMIT TË LIGJEVE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (8 shtator 1967) 299—301

NE E NDIEJMË VETEN KRENARË QË LUFTOJ- MË SË BASHKU ME TË GJITHË MARKSISTË- -LENINISTËT PËR TË NJËJTËN KAUZË — Nga bi- seda me një përfaqësues të Partisë Komuniste të Italisë (marksiste-leniniste) (11 shtator 1967)	302—313
KONGRESI YNË DO TË ÇAKTOJË DETYRA TË REJA — Fjala e hapjes në Kongresin e 4-t të FDSH (14 shtator 1967)	314—315
MBI ROLIN DHE DETYRAT E FRONTIT DEMO- KRATIK NË LUFTËN PËR FITOREN E PLOTË TË SOCIALIZMIT NË SHQIPËRI — Raport i mbajtur në Kongresin e 4-t të FDSH (14 shtator 1967)	316—402

I

ROLI HISTORIK I FRONTIT PËR ÇLIRIMIN E VENDIT, PËR MBROJTJEN E PAVARËSISË KOM- BËTARE DHE PËR NDËRTIMIN E SOCIALIZMIT	321—348
1. — Partia e Punës e Shqipërisë — e vetmja forcë udhëheqëse dhe e vetmja Parti politike në vendin tonë	322
2. — Fronti si hallka kryesore për bashkimin politik të popullit tonë	329
3. — Roli i Frontit në luftën për ndërtimin e socializmit	337

II

DETYRAT AKTUALE TË FRONTIT DEMOKRATIK PËR TË VËNË NË JETË IDETË DHE VENDIMET E KONGRESIT TË 5-TË TË PARTISË	348—383
---	---------

- | | |
|--|-----|
| 1. — Forcimi i bashkimit politik të popullit ka qenë e mbetet detyra themelore e Frontit Demokratik | 349 |
| 2. — Roli i Frontit Demokratik për forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletaria-tit dhe për zgjerimin e demokracisë socialiste | 356 |
| 3. — Të rritim veprimtarinë e Frontit De-mokratik për zgjidhjen e problemeve shoqërore | 364 |
| 4. — Ta gjallërojmë më tej organizatën e Frontit Demokratik, të rritim frymën e saj luftarake e vetëvepruese | 378 |

III

- | | |
|--|---------|
| DISA ÇËSHTJE TË GJENDJES NDËRKOMBËTARE | 384—402 |
| TË ÇOJMË NË MASAT PUNONJËSE FRYMËN RE-VOLUCIONARE TË KËTIJ KONGRESI — Fjala e mbylljes në Kongresin e 4-t të FDSH (16 shta-tor 1967) | 403—406 |
| KINEZËT TË KUPTOJNË MIRË SE NE JEMI MARKSISTË-LENINISTË, I KRITIKOJMË PËR GA-BIMET QË BËJNË — Radiogram drejtuar delegacio-nit të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH (26 shtator 1967) | 407—409 |
| TA BËJMË USHTRINË POPULLORE NJË SHKOLLË TË MADHE REVOLUCIONARE, POLITIKE DHE USHTARAKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretari-atit të KQ të PPSH (27 shtator 1967) | 410—423 |
| TË EVITOJMË HALLKAT E TEPËRTA NË NDËRTI-MIN ORGANIZATIV TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shta-tor 1967) | 424—431 |

PUNA EDUKUESE ME PUNONJËSIT E ARTIT TË JETË E DENDUR DHE E SHUMANSHME – Disku- tim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shtator 1967)	432—443
FORCA E PARTISË QËNDRON JO TE NUMRI I ANËTARËVE, POR TE CILËSITË E TYRE – Nga biseda me një udhëheqës të PK të Cejlonit (9 te- tor 1967)	444—449
MBI KOOPERIMIN DHE REVOLUCIONIN TEKNI- KO-SHKENCOR – Fjala e mbylljes në Plenumin e 3-të të KQ të PPSH (14 tetor 1967)	450—477
KUSH ORVATET TË SABOTOJË LUFTËN NË VIET- NAM, SHKEL MBI GJAKUN E VIETNAMEZËVE, ËSHTË RENEGAT E TRADHTAR – Nga biseda me ambasadorin e Republikës Demokratike të Vietnamit (21 tetor 1967)	478—484
REVOLUCIONI ECËN ME HAPA VIGANË KUR NË TË MERR PJESË RINIA – Nga fjala në mbrëmjen solemne me rastin e 50-vjetorit të krijimit të gjimnazit «Raqi Qirinxhi» në Korçë (30 tetor 1967)	485—504
NXËNËSIT DHE MËSUESIT TANË JANË PATRIO- TË, REVOLUCIONARË – Nga biseda me nxënës e mësues të shkollës 8-vjeçare «Stavri Themeli» në Korçë (31 tetor 1967)	505—510

Shtypur: Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1982